



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

PLANI PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË HAS

VLERESIMI STRATEGJIK MJEDISOR

RAPORT PERFUNDIMTAR



DPKZHT: NOVRUZ BARDHOSHI

KONSULENT "GJEOKONSULT&CO": me përfaqësues ligjor Z.Hamit Mustafa , Nr.Liç. N6408/18

Gjeo Konsult & CO & Prof.Ing.Av Sazan GURI

Përgatiti: Gjeokonsult & CO

Nr Lic: N6408/18



Ekspert Mjedisor: Prof. Ing. Av Sazan GURI

Nr Vendimi: Nr.6, Nr.010 Regj.





SHKURTIME

ADA	Agjencia Austriake per Zhvillim
AKM	Agjencia Kombetare e Mjedisit
AKPT	Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit
AKU	Agjencia Kombetare e Ushqimit
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Informatizimit te Ndertimeve Informale
AP	Autoriteti Propozues
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
BB	Banka Boterore
BE	Bashkimi Evropian
DEU	Delegacioni i Bashkimit Evropian ne Shqiperi
EBRD	Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim
EEC	Keshilli Ekonomik Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikave
KfW	Banka Gjermane per Zhvillim
KKT	Keshilli Kombëtar i Territorit
LPT	Ligji i Planifikimit të Territorit
MÇV	Ministria e Çeshtjeve Vendore
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NJQV	Njesi e Qeverisjes Vendore
PhD	Doktor i Shkencave
PINS	Plani i Integruar Ndërsektorial
PKS	Plani Kombëtar Sektorial
PLANI	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
PPKT	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
SECO	Organizata Zvicerane per Bashkepunim Ekonomik
ToR	Termet e References
UNDP	Programi i Kombeve te Bashkuara per Zhvillim
UNECE	United Nations Economic Commission for Europe



USAID	Agjencia e Shteteve te Bashkuara per Zhvillim Nderkombetar
VKM	Vendim i Keshillit te Ministrave
VNM	Vleresim i Ndikimit ne Mjedis
VSM	Vleresimi Strategjik Mjedisor



Tabela e Permbajtjes

PËRKUFIZIME	9
SEKSIONI 1-PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE	11
1.1 HYRJE	11
1.2 KUADRI I VLERËSIMIT	12
1.3 OBJEKTIVAT E VSM.....	12
1.3.1 Vlerësimi Mjedisor	13
1.4 HAPAT E RRADHËS	14
PARATHËNIE	15
SEKSIONI – 2 HYRJE	17
2.1 ÇFARË ËSHTË VSM	17
2.2 KUADRI LIGJOR I VSM.....	17
2.3 FAZAT KYÇ TË PROCESIT TË VSM-SË.....	18
2.3.1 Fazat kyç të procesit të VSM-së	18
2.3.2 Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor	19
SEKSIONI – 3 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PLANIT	21
3.1 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE	21
3.1.1 Objektivat e PPU për Bashkinë Has	21
3.1.2 Parimet e Planit Stategjik	22
3.2 OBJEKTIVAT E VSM PËR BASHKINË HASI	27
3.2.1 Projekt - Raporti Paraprak	28
3.3 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR	29
Kuadri Institucional për Mbrojtjen e Mjedisit.....	29
3.4 LEGJISLACIONI MJEDISOR	31
3.4.1 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit	32
3.4.2 Strategjitë dhe Programet Ndërkombëtare	39
3.4.3 Çështjet, Zonat dhe Objektet E Rëndësishme Kombëtare	40
3.4.4 Ligji për Ratifikimin e Protokollit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.....	40
3.4.5 Ligji për Planifikimin e Territorit.....	40
3.5 LIDHJA ME POLITIKA DHE DOKUMENTE TË TJERË.....	41
3.5.1 Kuadri Përkatës Ligjor që Lidhet me Hartimin e Planeve Vendor.....	41
3.5.2 Konteksti Ndërkombëtar	42
3.6 ANALIZA, NISMA DHE PROGRAME ZBATIMI	45
3.6.1 Situata Ekzistuese në Shqipëri	45
3.6.2 Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë	48
SEKSIONI 4 - PËRSHKRIMI I GJËNDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT	63
4.1 MJEDISI ATMOSFERIK.....	63
4.1.1 Ndotësit e Ajrit	63



4.2 REKOMANDIME	66
4.3 MJEDISI AKUSTIK – ZHURMAT	67
4.4 KLIMA	67
4.5 NDËRTIMI GJEOLGIK	70
STRATIGRAFIA	70
4.6 DEPOZITIMET E REJA PLIO-KUATERNARE	74
4.7 HIDROGJELOGJIA	80
4.8 SISTEMI UJOR	86
4.9 KRITERE PËR PËRDORIM TË UJRAVE TË PUJSHËM	93
4.10 TIPARET E RELIEVIT	94
4.11 BIODIVERSITETI - FLORA DHE FAUNA	95
4.12 VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI	98
Tipet aktuale te pyjeve dhe potenciali natyror	98
4.13 BIOTOPE TE VEÇANTE	99
4.14 PROBLEMET E MJEDISIT	100
4.15 GJEOMONUMENTET	100
4.16 GJEOMONUMENTE ME VLERA RAJONALE	103
Rrethi Has	103
4.17 PYJET	107
4.18 TERRITORI DHE GJENDJA VEXHETATIVE EPYJEVE DHE KULLOTAVE	109
4.19 <i>TE DHENA MBI FUNKSIONET E PYJEVE E KULLOTAVE, SIPAS PERDORIMIT DHE QELLIMIT</i>	111
4.20 PRODHIMET PYJORE	113
4.21 SISTEMI I MENAXHIMIT TE PYJEVE	117
4.22 RITJA VJETORE E PYJEVE NE KRUME	119
4.23 PRODHIMET DRUSORE, MUNDESIA VJETORE E SHFRYTEZIMIT	120
4.24 TURIZMI DHE POTENCIALI I TIJ NË BASHKINE KRUME	123
4.25 MONUMENTET NATYRORE TE KRUMES	126
4.26 LLOJET E TURIZMIT	128
4.27 TURIZMI NË BASHKINË KRUME DHE PËRGJEGJËSIA E QYTETARËVE	132
4.28 HAPAT PËR NJË TURIZËM TË QËNDRUESHËM	135
ASPEKTE GJEOMJEDISORE PËR BASHKINE E HASIT	143
4.29 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	150
4.30 INFRASTRUKTURA MJEDISORE	151
4.31 GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTI I MBETJEVE	165
4.33 ENERGJIA	180
4.34 PRESIONET NATYRORE	188
4.34.1 FENOMENET E RREZIKUT GJEOLGIK, PËRHAPJA DHE PËRSHKRIMI I TYRE	188



4.35 RREZIQET NGA TEKTONIKAT DHE NEOTEKNIKAT AKTIVE	193
4.36 STANDARDET E BE DHE OBSH PËR CILËSINË E AJRIT	199
4.37 ÇFARË DËMTIMESH MUND TË SJELLË NË SHËNDETIN E NJERIUT PËRQËNDRIMI I ATYRE SUBSTANCAVE TEJ NIVELIT TË SIPËRËRSHKRUAR?.....	201
4.38 TEKTONIKA	203
4.39 AKTIVITETI SIZMIK.....	203
4.40 KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE NË BASHKINË HASI	205
4.41 KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE TË TROJEVE TË NDERTIMIT	209
4.42 FENOMENET E RREZIKUT GJEOLOGJIK, PËRHAPJA DHE PËRSHKRIMI I TYRE.....	217
Në territorin e qarkut Kukës gjejnë përhapje shumë elemente të rrezikut gjeologjik, të cilat krijojnë shqetësime dhe dëmtime të veprave inxhinierike që kryhen në këtë territor. Këto elemente rreziku janë:	217
4.43 ZONIMI I TERRITORIT MBI BAZËN E KUSHTEVE GJEOLIGO – INXHINIERIKE DHE PREZENCËS SË FENOMENEVE TË RREZIKUT GJEOLOGJIK.....	221
4.44 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	223
4.45 REKOMANDIME	223
4.46 ASPEKTE GJEOMJEDISORE TË BASHKISË HASIT	226
4.47 MINERALIZIMET SULFURE TË TJERA NË QARKUN E KUKËSIT.....	227
4.48 POPULLSIA	230
4.49 ANALIZA SWOT	233
4.50 PROJEKTET PILOTE	237
SEKSIONI 5 - TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN.....	243
5.1 TOKA	243
5.2 AJRI	243
5.3 FAKTORËT KLIMATIKË	244
5.3.1 Përshatja ndaj Ndryshimeve Klimatike	244
5.3.2 Masat Zbutëse ndaj Ndryshimeve Klimatike.....	244
5.4 UJI	245
5.5 BIODIVERSITETI.....	245
5.6 MBETJET	245
5.7 ZHURMA.....	246
5.8 POPULLSIA DHE ASETET MATERIALE	246
5.9 TRASHËGIMIA KULTURORE	247
5.10 PEIZAZHI	247
SEKSIONI 6 - BAZA PËR PËRGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR	248
6.1 PËRCAKTIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE.....	248
6.1.1 Detyrimet e specifikuar në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë.....	249
6.1.2 Identifikimi i ndikimeve mjedisore	258



6.2 METODIKA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	259
6.2.1 Metodika e Vlerësimit	259
6.2.2 Përshkrimi i Kriteve Dhe Metodologjisë së Vlerësimit për Objektivat Mjedisore	260
SEKSIONI 7 - VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE.....	271
7.1 VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË.....	271
7.2 VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE DHE POLITIKAVE TË PLANIT ME OBJEKTIVAT MJEDISORE.....	271
SEKSIONI 8 - VLERËSIMI I PROJEKTEVE	277
SEKSIONI 9 - VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE	295
9.1 VLERËSIMI I PASOJAVE NGA ZBATIMI I PLANIT DHE NDIKIMET E PASOJAVE TË ZBATIMIT TË PLANIT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE MJEDISORE TË PLANIT	295
9.1.1 Toka.....	295
9.1.2 Ajri.....	297
9.1.3 Faktorët klimatikë	300
9.1.4 Uji	301
9.1.5 Natyra.....	302
9.1.6 Mbetjet.....	304
9.1.7 NDOTJA PREJ ZHURMËS.....	306
9.1.8 Popullatat dhe asetet materiale.....	307
9.1.9 Trashëgimia kulturore	309
9.1.10 Peisazhi	310
9.1.11 Konkluzioni mbi Vlerësimin	310
9.2 IMPAKTET KUMULATIVE.....	311
9.3 IMPAKTET NDËRKUFITARE	312
SEKSIONI 10 - UDHËZIME DHE MASAT ZBUTËSE	313
10.1 TË PËRGJITHSHME	313
10.2 UDHËZIMET DHE MASAT MBROJTËSE.....	313
10.2.1 Toka	313
10.2.2 Ajri	315
10.3 FAKTORËTKLIMATIKË.....	316
10.3.1 Masat zbutëse ndaj ndryshimeve klimaterike	316
10.3.2 Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	317
10.3.3 Uji	318
10.4 MJEDISINATYROR.....	320
10.5 MBETJET	322
10.6 ZHURMAT	323
10.7 POPULLSIA DHE ASETET MATERIALE	325
10.8 TRASHËGIMIA KULTURORE	326
10.9 PEISAZHI	326



10.9.1 Strategjia e Peizazhit	327
10.9.2 Masat e përgjithshme zbutëse ndaj peizazhit	327
10.9.3 Faza e ndërtimit.....	328
SEKSIONI 11 - MONITORIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS	329
SEKSIONI 12 - PËRFUNDIME DHE MENDIME PËR T'U MARRË PARASYSH	334
12.1 PËRFUNDIME	334
12.2 MENDIME PËR T'U MARR PARASYSH	339
SHTOJCA 01: Dokumenteve strategjike në nivel kombëtar.....	343
SHTOJCA 02: PËRSHKRIM I PËRGJITHSHEM I PROCESIT TË PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË SEKTORIN E MJEDISIT	347
SHTOJCA 03: Përfshirja e palëve të interesuara dhe takimi publik	350
LEGJISLACIONI REFERENCË.....	356





PËRKUFIZIME

Mjedisi – është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotikë dhe jo biotikë që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë.

Mbrojtja e mjedisit – është veprimtaria që synon parandalimin dhe kufizimin e ndotjes dhe degradimit të mjedisit, dhe përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.

Mbrojtja e tokës siguron mbrojtjen e funksioneve të saj natyrore në mënyrë të qëndrueshme.

Mbrojtja e ujit përfshin ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor, burimet e tyre, sasinë dhe cilësinë, shtretërit dhe brigjet e ujërave sipërfaqësor dhe formimet akuifere.

Mbrojtja e biodiversitetit përfshin të gjithë organizmat e gjallë, biocenozat dhe habitatet e tyre.

Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes dhe së ardhmes pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm.

Ndikimi në mjedis është çdo ndryshim i mjedisit fizik, përfshirë pasojat shëndetësore, ekonomike, shoqërore, estetike, natyrore, fizike.

Ndotja e mjedisit është futja e drejtpërdrejt ose e tërthortë e lëndëve, vibracioneve, energjisë, nxehtësisë, rrezatimit, zhurmës e faktorëve biologjikë në ajër, në ujë e në tokë, të cilat mund të ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe të dëmtojnë cilësinë e jetës.

Shkarkimi në mjedis është çlirimi dhe dalja në mjedis

Mbetjet janë lëndët, objektet ose pjesë të tyre që përcaktohen nga autoriteti përgjegjës të cilat nuk përdoren më ose që pronari do t'i largojë.

Ndotja e ujit – është veprimi dhe ndikimi i futjes së materialeve të ngurta, të gazta, të lëngëta, qenieve të gjalla dhe formave të energjisë në ujë, që drejtpërdrejt e tërthorazi ndryshojnë cilësinë e ujit.

Rezervat ujore – janë të gjitha ujërat e brendshme lumore, sipërfaqësore nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike nën juridiksionin dhe kontrollin e R. SH

Basen ujëmbledhës – është sipërfaqja e tokës brenda së cilës uji pasi konvertohet në një rrjedhë të vetme, nëpërmjet një rrjeti rrjedhash sipërfaqësore e nëntokësore derdhet në det.

Informacion mjedisor – nënkupton çdo informacion me shkrim, vizual, gojor, elektronik ose të çdo lloj forme tjetër materiali mbi gjendjen e elementëve të mjedisit, si ajri e atmosfera, uji, toka, peizazhi e shumëllojshmëria biologjike e komponentët e tij;

Publiku – nënkupton një ose shumë persona fizikë ose juridikë, në përputhje me legjislacionin e praktikën kombëtare, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre;

Publiku i interesuar – nënkupton publikun ndikuar ose që mund të ndikohet, apo që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore; për qëllimet e këtij përkufizimi, shoqatat joqeveritare që promovojnë më tej mbrojtjen e mjedisit dhe plotësojnë kërkesat e vëna në ligjet kombëtare, do të konsiderohen të



interesuara.

Parimi "Ndotësi paguan" nënkupton koston që paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme.

Planifikim urban nënkupton një sintezë dhe mjedhojë e analizave në disa disiplina të ndryshme si të asaj sociale, ekonomike, historike dhe ekologjike.

Qeverisja është arti që bën të punojë lokomotivën qytet, përtej diferencave politike e kufizimeve burokratike e arbitrare, e cila kërkon udhëheqje, imagjinatë, fleksibilitet, pjesëmarrje dhe aftësi negocimi.

Zhvillim i qëndrueshëm urban është ai zhvillim, i cili kënaq nevojat e brezit që jeton pa dëmtuar mundësitë që do të kenë brezat e ardhshëm për të kënaqur nevojat e tyre e për të zgjedhur stilin e tyre të jetës.

Qëndrueshmëria e plot nënkupton ruajtjen dhe zhvillimin me efikasitet të tri përbërësve kryesorë potencialë si të atij social, ekologjik dhe ekonomik.

Përdorim toke nënkupton reduktimin e rritjes së sipërfaqeve të ndërtuara, ripërdorimin e territoreve djerrë urbane dhe ndërtesave të pazëna, shfrytëzimin maksimal i dendësisë së ndërtimit, ruajtjen dhe lidhjen me sipërfaqet e lira klimaterike, si dhe zvogëlimin e sipërfaqeve të asfaltuara.

Ruajtje e vlerave ekologjike të peisazhit nënkupton kursimin e energjisë dhe përdorimin më të gjerë të burimeve rigjeneruese të energjisë, pakësimin e lëndëve të dëmshme për atmosferën dhe lëndëve djegëse, ruajtjen dhe përkujdesjen për burimet tokësore ujore dhe ato vendore, si dhe forcimin e riciklimit të lëndëve dhe pakësimin e mbetjeve urbane.

Përgjegjësi sociale për banim nënkupton burime për ndërtim me kosto të reduktuar të banesave, strehim të të pastrehëve me nevoja specifike banimi, mbështetje të nismave të Bashkisë apo Qarkut.



- të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

1.2 KUADRI I VLERËSIMIT

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendim-marrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara. Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet si “një proces sistematik i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrë të përshtatshme që në fazat më të hershme të vendim- marrjes”.

Kuadri ligjor i VSM-së përfshin në mënyrë të detyrueshme Ligjin Shqiptar për VSM-në, ndërkohë që, për të qenë koherent, nuk është lënë mënjanë edhe kuadri ligjor ndërkombëtar. Referencat përkatëse ligjore janë dhënë më poshtë:

- Ligji nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”
- Direktiva 2001/42/EC e Komisionit Evropian
- Protokollin i VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo (UNECE)

1.3 OBJEKTIVAT E VSM

Bazuar në analizën e:

- detyrimeve të specifikuar në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë,
- situatës ekzistuese të mjedisit,
- ndikimeve potenciale mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan.

Raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndësishëm mjedisore dhe objektivat mjedisore, si më poshtë:

Toka

Objektiva Mjedisorë 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj. Objektiva Mjedisorë 2 (OM 2): Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.

Ajri

Objektiva Mjedisorë 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasinë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.



Faktorët klimatikë

Objektiva Mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Uji

Objektiva Mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat breglumore dhe burimet e ujit te pijshëm.

Mjedisi natyror

Objektiva Mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.
Objektiva Mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Mbetjet

Objektiva Mjedisore 8 (OM 8): Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfilleve e incineratorëve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

hurma

Objektiva Mjedisore 9 (OM 9): Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Popullsia dhe asetet materiale

Objektiva Mjedisore 10 (OM 10): Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëdrueshme.

Trashëgimia Kulturore

Objektiva Mjedisore 11 (OM 11): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Peisazhi

Objektiva Mjedisore 12 (OM 12): Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peisazhi me cilësi të lartë.

Shpjegimi i përcaktimit të objektivave mjedisore jepet në seksionet në vijim.

1.3.1 Vlerësimi Mjedisor

Në këndvështrimin e lidhjes mes politikave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Konkretisht:

- Politikat që lidhen me Përmirësimin e Cilësisë Urbane dhe ato që lidhen me Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Cilësisë së Mjedisit kanë klasifikimin më të lartë në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore.
- Politikat që lidhen me Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik dhe Përmirësimin e Infrastrukturës kanë klasifikimin më të ulët në nivelin e përputhshmërisë me objektivat



mjedisore. Sidoqoftë, secila prej këtyre politikave është në përputhshmëri të plotë me të paktën një, dhe në shumicën e rasteve me 2 dhe 3 objektiva mjedisore.

- Dy politika të Planit, specifiku: Vendosija e standarteve të projektimit urban, dhe Krijimi i Parqeve Rajonale, janë në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore, duke marrë rezultatin maksimal të mundshëm.
- Secila prej politikave të planit (përveç dy politikave që klasifikohen me përputhshmëri të plotë) nuk kanë lidhje me të paktën një objektivë mjedisore dhe në shumicën e rasteve me dy objektiva.
- Dy objektiva të Planit që lidhen me Sistemin Urban janë pothuajse në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore.
- Politika e cila ka lidhje me Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik dhe më specifiku me Programin specifik për zhvillimin e biznesit, financave të qëndrueshme, nuk ka lidhje me asnjë prej objektivave tona mjedisore.
- Objektiva mjedisore 1 që lidhet me menaxhimin e tokës, dhe objektiva 10 që lidhet me popullsinë, janë në përputhshmëri të plotë me pjesën më të madhe të politikave të planit. Duhet theksuar se të dyja këto objektiva janë në përputhshmëri të plotë me politikën e planit.
- Objektiva 11 që lidhet me ruajtjen e trashëgimisë kulturore është objektiva që nuk lidhet me pjesën më të madhe të politikave të Planit.
- Të gjitha objektivat e tjera mjedisore paraqesin një diversitet të madh lidhur me nivelin e përputhshmërisë së tyre me politikën përkatëse të Planit.

Në përgjithësi, konkludohet se duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

1.4 HAPAT E RRADHËS

Siç parashikohet në Ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, do të mbahet degjese publike lidhur me Raportin Paraprak të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit. Të gjitha komentet, vërejtjet, sugjerimet e mara, do të paraqiten dhe adresohen në Raportin Final të VSM-së.



PARATHËNIE

Raporti Paraprak i Vlerësimit Strategjik Mjedisor – RPSM në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Hasit (PPVBH) është një nga dokumentet kryesore për t'iu paraprirë analizave të mëtejshme mjedisore. RPSM synon të përcaktojë drejtimit kryesore të zhvillimeve dhe mbrojtjeve përkatëse mjedisore të territorit brenda afatit të tij të vlefshmërisë, i cili zgjat 15 vite që nga dita e miratimit të tij. Ky dokument i ofron lexuesit/përdoruesit të krijojë një panoramë të përgjithshme analitike të gjendjes ekzistuese mjedisore në Bashki, si dhe të kuptojë drejtimit e ardhshme të zhvillimeve mjedisore përmes vizionit të planifikim e zhvillim të territorit.

Gjendja ekzistuese është bazuar në Raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese të çështjeve mjedisore, si dhe te raporti mbi Stategjinë për Bashkinë Has, dokumente të hartuara gjatë fazës së parë dhe të dytë të këtij projekti, i cili ka patur synimin grumbullimin dhe shqyrtimin e të gjithë informacionit ekzistues nga institucionet shtetërore sipas ligjeve në fuqi për të siguruar të dhënat e nevojshme për në fazën e tretë të këtij projekti.

Për të kuptuar më mirë vlerësimin e gjendjes mjedisore ekzistuese në territorin e ri të bashkisë, janë prodhuar disa harta, profile e tabela për secilën prej njësive të reja administrative që i janë shtuar territorit të bashkisë së re. Këto profile janë prodhuar nga bashkëpunimi i drejtpërdrejt i stafit të Bashkisë Hasit me ekspertët e studiove konsulente. Metodologjia e gjenerimit të gjetjeve është bazuar te vizita të drejtpërdrejta në zyrat e njësive administrative, konsultime me personelin dhe të dhënat e administratës në kohën e takimeve, vizita e studim i drejtpërdrejt i territorit të njësisë dhe takime të rastësishme me qytetarët.

Drejtimit kryesore të zhvillimit të synuar për 15 vitet e ardhshme të Bashkisë Hasit shtjellohen në kapitujt e tjerë të këtij dokumenti, duke bërë të mundur që:

1. të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore,
2. të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të neojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private,
3. të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit,
4. të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjisacionin,
5. të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur rezultatin e synuar nga të gjitha veprimet e nevojshme për t'iu ndërmarrë gjatë kësaj periudhe. Raporti zbërthehet në dimensionë të përgjithshme zhvillimi, mbi



bazën e të cilave janë hartuar masat përkatëse për secilin dimension. Çdo objektiv strategjik trajtohet me programe specifike dhe konkretizohet me projekte të veçanta sipas një plani veprimi të ndarë në faza dhe të shtrirë në kohë. Zhvillimi i ardhshëm i Bashkisë, nga termat e planifikimit strategjik të këtij dokumenti do të përkthehet në terma vazhdimisht të ndryshueshme territoriale, të cilat specifikohen në Planin Territorial dhe menaxhohen drejtpërdrejt nga strukturat e Bashkisë Hasi.



SEKSIONI – 2 HYRJE

2.1 ÇFARË ËSHTË VSM

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendim-marrjen.

Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet si “një proces sistematik i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrë të përshtatshme që në fazat më të hershme të vendim-marrjes”.

Qëllimi i VSM-së mund të përkufizohet si garantimi që konsideratat mjedisore informojnë dhe integrohen në vendim-marrjen strategjike në mbështetje të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm nga këndvështrimi mjedisor. Më konkretisht, procesi i VSM-së mbështet autoritetet përgjegjëse për planet dhe programet, si dhe vendim-marrësit, që të marrin në konsideratë:

- Tendencat kyç mjedisore, potencialet dhe shqetësimet që mund të prekin apo mund të preken nga plani apo programi;
- Objektivat dhe indikatorët mjedisorë që janë në përputhje me planin apo programin;
- Efektet e mundshme dhe të konsiderueshme mjedisore të opsioneve të propozuara dhe të zbatimit të planit apo programit;
- Masat për të shmangur, zvogëluar apo zbutur efektet negative dhe ato për të rritur e përforcuar efektet pozitive;
- Pikëpamje, sugjerime dhe informacion nga autoritetet përkatëse, publiku dhe – sipas rastit – vendet fqinje që preken nga zbatimi i planit apo programit.

Në përgjithësi, VSM-ja aplikohet për plane rregulluese territoriale, programe, politika dhe dokumente të tjerë me natyrë strategjike (përfshirë mundësisht edhe dokumentet ligjore).

2.2 KUADRI LIGJOR I VSM

Kuadri ligjor i VSM-së përfshin në mënyrë të detyrueshme Ligjin Shqiptar për VSM-në, ndërkohë që, për të qenë koherent, nuk është lënë mënjanë edhe kuadri ligjor ndërkombëtar. Referencat përkatëse ligjore janë dhënë më poshtë:



- *Ligji nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i cili ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet dhe autoritete përkatëse, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe rregullat e procedurës për kryerjen e vlerësimit strategjik mjedisor. Ligji është përafshuar me Direktivën 2001/42/KE, datë 27 qershor 2001. Më shumë informacion gjendet në http://www.legjislacioni.gov.al/frontend/change_documents/129.*
- *Direktiva 2001/42/EC e Komisionit Evropian mbi vlerësimin e efekteve në mjedis prej planeve apo programeve të caktuara (Direktiva e VSM-së). Më shumë informacion gjendet në <http://ec.europa.eu/environment/eia/home.htm>.*
- *Protokolli i VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo (UNECE). Më shumë informacion gjendet në http://www.unece.org/env/eia/sea_protocol.htm.*

2.3 FAZAT KYÇ TË PROCESIT TË VSM-SË

2.3.1 Fazat kyç të procesit të VSM-së

Në tabelën më poshtë përshkruhen fazat kyç të procesit të VSM-së.

Tab. - 1 Fazat kyç të procesit të VSM-së

Faza	Përshkrimi
Shqyrtimi	Gjatë shqyrtimit identifikohet nevoja për VSM që aplikohet në një plan, program apo projekt specifik. Shqyrtimi si proces fokuson burimet tek ato plane, programe apo projekte të cilat mund të shkaktojnë efekte të konsiderueshme në mjedis dhe shëndet, dhe përjashton nga procesi i VSM-së ato të cilat kanë ndikime të vogla, ose nuk kanë fare ndikime. <i>Qëllimi i shqyrtimit është të identifikojë nëse VSM-ja duhet të aplikohet për një plan, program apo projekt specifik.</i>
Studimi i shtrirjes /qëllimit të VSM	Çështjet e identifikuar gjatë studimit të shtrirjes /qëllimit të VSM-së do të orientojnë vlerësimin e gjendjes bazë të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM-ja merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve më të gjera mjedisore apo sociale, siç janë adaptimet ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë për punësim etj. <i>Qëllimi i kësaj faze është të përcaktohen çështjet kyç që duhen adresuar në raportin e VSM-së.</i>
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese do të përbëjë bazën për vlerësimin e ndikimeve dhe përpilimin e skemës së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme që të përvijohen tendencat e mundshme në të ardhmen – kështu që duhet të bëhet analiza e tendencave në të kaluarën, me qëllim që të parashikohen zhvillimet që do të ndodhin në të. Vlerësimi i ndikimeve të pritshme nuk mund të bëhet pa kuptuar mirë gjendjen ekzistuese të çështjeve kyç të identifikuar në studimin e shtrirjes/qëllimit të VSM-së. <i>Qëllimi i analizës së gjendjes ekzistuese është që të orientojë drejt një specifikimi më të mirë të çështjeve kyç, dhe një identifikimi më të mirë të problemeve kryesore që lidhen me planet, programet apo projektet përkatëse.</i>




<p>Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse</p>	<p>VSM-ja analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. Një nga përfitimet kryesore prej VSM-së është se ai mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të një numri projektsh të përfshira në dokumentin strategjik, dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme kumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve të vogla individualisht, por të konsiderueshme të marra së bashku, që do të kryhen për një periudhë të caktuar kohore.</p> <p>Në vijim të rreziqeve dhe ndikimeve të identifikuara, VSM-ja sugjeron masa zbutëse për të adresuar efektet e pritshme negative si dhe për të rritur ndikimet pozitive që do të vijnë nga zbatimi i planeve, programeve apo projekteve përkatëse. <i>Kjo fazë ka për qëllim të vlerësojë efektet e konsiderueshme negative dhe pozitive të planeve përkatëse, dhe, në vijim të konkluzioneve të analizës së ndikimeve, të marrë në konsideratë alternative dhe opsione, dhe të formulojë masat zbutëse për të parandaluar, reduktuar dhe, sa më shumë të jetë e mundur, të kompensojë çdo ndikim të konsiderueshëm negative të planeve programeve apo projekteve përkatëse.</i></p>
<p>Hartimi i raportit të VSM-së</p>	<p>Raporti i VSM-së përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë gjithë procesit të VSM-së dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit. <i>Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti të shkruar mirë dhe të kuptueshëm, i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në një mënyrë të qartë, dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit.</i></p>
<p>Adoptimi</p>	<p>Jepet informacion mbi adoptimin e planit, programit apo projektit përkatës, si janë reflektuar komentet dhe sugjerimet e procesit të konsultimeve, si dhe për metodat e monitorimit të efekteve të konsiderueshme mjedisore që vijnë nga zbatimi i planit, programit apo projektit përkatës.</p>
<p>Monitorimi</p>	<p>Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese / zbutëse për çdo efekt mjedisor të konsiderueshëm të paparashikuar.</p>

2.3.2 Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim me origjinë njerëzore që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në tërësi të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të “parandalimit”, sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht, që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret. Po ashtu, edhe politikat, planet, dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore edhe mjedisore, planet apo strategjitë mund të përfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata dhe të llojit strategjik. Për këtë specifikë, ato i nënshtrohen një procedure të veçantë dhe të ndryshme nga VNM-ja, siç është Vlerësimi Paraprak Strategjik Mjedisor (VPSM). Procesi i VPSM-së është një detyrim ligjor për politikat, planet apo programet.

VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive.



Vlerësimi i situatës

Për të ngritur një infrastrukturë miqësore urbane me mjedisin, sikundër dhe rajoni e ka në ADN e vet, kërkohet të merren në konsideratë disiplina e fusha si:

- Kuadri administrativ, Plani rregullues egzistues (realizimet dhe mosrealizimet, struktura ekzistuese e fshatit, zonimi dhe identifikimi i nevojave);
- Pozicionin gjeografik të Bashkisë Hasit dhe kufinjtë administrativ të saj;
- Relievi i azhornuar, të dhëna gjeologjike dhe gjeomorfologjike;
- Të dhëna hidro-gjeologjike, të dhëna klimatike dhe hidrologjike;
- Të dhëna mbi komunitetet bimore, shtazore dhe ekosistemet e zonës në studim;
- Raporti i ndikimit në mjedis;
- Kushtet sizmike e tektonike të rajonit;
- Burimet territoriale dhe ekonomike;
- Historia, monumentet e kulturës, arkeologjia;
- Popullsia (gjëndja ekzistuese dhe tendecat e ndryshimeve);
- Pronësia mbi trojet, Strehimi, Arsimi;
- Profili ekonomi (biznesi i vogël, ndërmarrjet, turizmi), Punësimi;
- Infrastruktura (rrjeti rrugor, sheshet e grumbullimit të mbetjeve urbane, ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefoni);
- Të dhëna mbi infrastrukturën sociale.



SEKSIONI – 3 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PLANIT

3.1 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE

3.1.1 Objektivat e PPU për Bashkinë Has

Vizioni: Bashkia Has – promovimi dhe zhvillimi i bashkisë së Hasit si një qendër e re terciare, në aspektin e bujqësisë/blegtorisë, turizmit kulturor të traditës vendase, rritjes së aksesueshmërisë brenda dhe jashtë territorit të vetë bashkisë, me tendencë rritjen dhe promovimin e vlerave hapësinoro-funksionale të saj.

Plani Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Hasit është pjesë integrale e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, propozimet që vijnë nga strategjitë sektoriale, gjetjet kryesore të analizave, të dhënat e nxjerra nga studimi i profilit të çdo njësie administrative, takimet publike dhe rezultatet e anketës mbi vlerësimin dhe prioritetet e qytetarëve për territorin e bashkisë. Bashkia e Hasit mbizotërohet nga sistemi urban në qendrën e saj, në qytetin e Krumës, e cila është qendra kulturore, shëndetësore, arsimore e bashkisë, ndërkohë, njësitë administrative (më parë ish - komunat) dhe fshatrat përbërëse të tyre kanë një territor 100% rural duke bërë që në to të mbizotërojnë sistemi bujqësor dhe ai natyror.

Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Hasit (PPVBH) do të orientojë përdorimin dhe shfrytëzimin e kësaj zone, si dhe do të krijojë infrastrukturën e përshtatshme për një zhvillim të qëndrueshëm. Qëllimet që synon të përmbushë ky Plan janë:

1. të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
2. të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private ;
3. të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit ;
4. të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislaicionin;
5. të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

Plani është ndeshur me disa sfida, si në nivel rajonal, ashtu edhe në atë lokal. Këto sfida prekin thuajse të gjithë sektorët e marrë në konsideratë. Masa e kapërcimit të tyre do të sjellë masën e suksesit të planit. Sfidat janë:



- Ekonomia Globale dhe Konkurenca Rajonale;
- Integrimi i hapësirave Informale, Rigjenerimi Urban dhe Strehimi;
- Mobiliteti dhe Transporti;
- Kapërcimi Teknologjik dhe Infrastruktura dixhitale;
- Situata Mjedisore dhe Menaxhimi i Mbetjeve;
- Ndryshimi i Stilit të Jetesës.

Për të kapërcyer sfidat, plani ka marrë në konsideratë mundësitë specifike që e bëjnë të konkurrueshëm territorin në fjalë:

- Kultura dhe Kreativiteti;
- Diversiteti i Lartë i Sektorëve Ekonomikë;
- Popullsi në moshë të re;
- Pozita Gjeografike e Favorshme.

Mundësia për të zbatuar koncepte dhe priorite të zhvillimit territorial të Komunitetit European është parë në disa perspektiva për t'u përputhur si më poshtë:

- Koncepti i Zhvillim i balancuar Policentrik. (Sistemi Policentrik i Qendrave Urbane);
- Vendosja e një forme të re zhvillimi Urban-Rural në nivel të Zonave Funktionale Urbane;
- Barazi në aksesin në infrastrukturë, energji dhe shërbime;
- Mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshem të kapitalit dhe aseteve natyrore.

Strukturat ekologjike dhe resurset kulturore si potenciale zhvillimi në rajonet që janë më të vonuar në zhvillim dhe janë të klasifikuar si zona ekologjike dhe kulturalisht sensitive. Hartimi i vizionit është realizuar, duke ndërthurur në një koncept të vetëm Sfidat, Mundësitë, Qëllimet dhe Parimet e planit, duke krijuar kështu një qëndrueshmëri të tij dhe përkthimin më tej në objektiva strategjike më efektive.

3.1.2 Parimet e Planit Strategjik

Integrimi

Objektivat e planit strategjik marrin parasysh ndërlidhjet e ekosistemeve të ndryshme dhe shqyrtohen dhe vlerësohen nga ndikimi që ato kanë tek këto eko-sisteme me kompleks urban dhe rural, për t'iu përgjigjur nevojave të së ardhmës. Infrastruktura është faktori kryesor për të siguruar një zhvillim progresiv të Bashkisë dhe për t'iu përgjigjur potencialit zhvillimor.

Qëndrueshmëria

Vizioni, objektivat dhe programet strategjike synojnë një habitat të shumëllojshëm mjedisor, social dhe ekonomik për popullsinë aktuale pa kompromentuar mundësinë e gjeneratave të ardhshme të plotësojnë nevojat e tyre dhe të progresojnë.



Jetueshmëria

Jetueshmëria është shuma e faktorëve që përkufizojnë standartin e jetesës së një komuniteti – përfshirë mjedisin urban, natyror, zhvillimin ekonomik, stabilitetin social, mundësinë e arsimit, të kujdesit shëndetësor si dhe mundësitë kulturore dhe të argëtimit. Plani strategjik i Bashkisë Hasit synon rritjen e cilësisë së jetesës për banorët e vet duke konsideruar faktorët e mëposhtëm:

- Hapësirat publike,
- Formën urbane,
- Zhvillimin ekonomik,
- Aksesin në shërbime,
- Kujdesi social,
- Mjedisi natyror,
- Pjesëmarrja e publikut në Qeverisje

Inovacioni

Një qasje ndaj planifikimit që inkurajon dhe mundëson përmirësime dhe adoptime të teknikave, teknologjive, produkteve dhe mënyrave të reja për të pasur rezultate sa më të mira. Inovacioni është parim i rëndësishëm që synon të tejkalojë edhe kufizimet financiare me të cilat mund të përballet Bashkia për të realizuar programet dhe projektet e dëshiruara. Plani Strategjik i Hasit synon të përshtasë elemente të “Smart City”.

Ruajtja dhe zhvillimi i traditës

Bashkia e Hasit ka ruajtur tipologjitë e ndërtimit kullë, karakteristike e këtyre territoreve, të ndërtuara me gur lokal, dritare të vogla dhe mure të trasha guri ato janë element shumë i rëndësishëm i definimit të zhvillimit tradicional të ndërtimit vendas dhe për pasurinë e trashëgimisë historike arkitektonike. Zhvillimi i territorit të Bashkisë do të bëhet duke vlerësuar e mbrojtur trashëgiminë e kullave, ndërtimet karakteristike, elementët ndërtimor dhe materialet lokale si element i rëndësishëm i peisazhit urban.


Dimensionet Strategjike

Zhvillimi i territorit të bashkisë Hasit do të orientohet përmes pesë dimensionesh zhvillimi të cilat kanë për synim udhëheqjen dhe monitorimin e përparimit të objektivave strategjike të zhvillimit, programeve dhe projekteve të zhvillimit në drejtimin e:

6. Formës urbane;
7. Infrastrukturës;
8. Jetesës në komunitet;
9. Zhvillimit ekonomik dhe inovacioni;



10. Mjedisi Natyror.



Dimensionet e zhvillimit të territorit

Vizioni është formuluar me disa fasha:

1. Të kthehemi në një nga rajonet ekonomike të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor, me prosperitet të lartë dhe që redukton pabarazitë me rajonet e tjera, i drejtuar nga zhvillime të qënësishme në punësim dhe infrastrukturë konkurruese.
2. Një ekonomi e bazuar në investime inovative, të cilat promovojnë bizneset kreative dhe të bazuara në njohuri si dhe nxisin një nivel të lartë edukimi dhe aftësish profesionale.
3. Të përmirësojë cilësinë e jetesës për të gjithë, me anë të promovimit të stileve të shëndetshme të jetesës, aksesit në shërbime shëndetësore cilësore dhe zhvillimin e komuniteteve të qëndrueshme.
4. Përmirësimi i lëvizshmërisë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, falë zgjidhjeve në transport të cilat ndërlidhin komunitetet me mundësitë për punësim dhe shërbime lokale, kontrollojnë dhe zvogëlojnë trafikun, si dhe përmirësojnë lidhjet strategjike tokësore, hekurudhore dhe ajrore me anë të Aeroportit Ndërkombëtar dhe atij lokal.
5. Specializim, densifikim dhe mbështetje e bizneseve të vogla dhe të mesme të cilat promovojnë ekonominë lokale.
6. Suksesi duhet të sigurohet me mënyra të cilat promovojnë eficiencën energjitike, mbrojnë cilësinë e ajrit, minimizojnë dhe menaxhojnë mbetjet si dhe mbrojnë e përmirësojnë mjedisin natyror dhe atë të ndërtuar.

Në kuadër të plotësimit të vizionit janë përcaktuar gjashtë objektiva strategjike kryesore. Secila prej objektivave strategjike shtjellohet në kapitullin pasardhës me anë të politikave përkatëse, të cilat drejtojnë hartimin e PPV për Bashkinë Hasi:

Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik

Rajoni Bashkia Hasit është klasifikuar si një qendër urbane terciare e cila duhet ti nënshtrohet proceseve të fuqizimit dhe rigjenerimit, me sipermarrje dinamike, bujqësi të zhvilluar, turizëm shumëdimensional, e fokusuar tek inovacioni dhe duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për mjedisin, si dhe atributi si hub logjistik, si rezultat i pozitës gjeografike favorizuese që ka duke qene se është një bashki kufitare me Kosovën dhe afërsia me Kukësin, si një nga qytetet porta të përcaktuar në PPK.

Rajoni do të shërbeje si arterie shumë efikase në këmbimet tregëtare mes dy vendeve, por dhe një mundësi më shumë për zhvillimin e bujqësisë/blegtorisë, turizmit kulturor të traditës vendase, rritjes së aksesueshmërisë brenda dhe jashtë territorit të vetë bashkisë, me tendencë rritjen dhe promovimin e vlerave hapësinore funksionale të saj.

1. *OS 1* Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit Zhvillimi i potencialit të vetë bashkisë duke ndërhyre në mjedis, sidomos me ndotjen, duke marrë masa mbrojtëse nga vetë bashkia edhe duke rritur zonat bufferike pranë zonave natyrore, shtratave të lumenjve etj
2. *OS 2* Ruajtja e aseteve kulturore natyrore dhe monumentale
3. *OS 3* Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit duke e transformuar bashkinë e Hasit në një destinacion turistik me dimensione si:
 - i) kulturore,
 - ii) natyrore (eko-turizëm),
4. *OS 4* Përmirësimi i bujqësisë edhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase
5. *OS 5* Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese edhe asaj lidhëse me vendet fqinje
6. *OS 6* Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar të bashkisë si pasojë e pozicionit gjeografik të saj
7. *OS 7* Përmirësimi i gjendjes ekzistuese të kushteve të ujësjellës-kanalizime, shërbime, shëndetësi arsim,
8. *OS 8*; Zhvillimi i qëndrueshëm i industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të produkteve minerare

Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit

Duke parë ndotjen në Bashkinë e Hasit sidomos në zonat e nxjerrjes së metaleve edhe të jometalorëve ka bërë që të rritet së tepërmi ndotja. Për të lejuar zhvillimin e turizmit, të punësimit dhe të zhvillimit të vetë bashkisë është e nevojshme që ndërhyrjet në mjedis, sidomos me ndotjen, të minimizohen duke u marrë masa mbrojtëse nga vetë bashkia edhe duke rritur zonat buffer pranë zonave natyrore, shtratave të lumenjve etj.

Përmirësimi i këtij mjedisi me anë të projekteve të rigjenerimit të zonave të ndotura, do të ofrojë një mundësi të mirë për ofrimin e modeleve të mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit, do të rrisë atraksionin e këtij rajoni edhe në nivel ndërkufitar, si dhe do të nxisë industrinë e turizmit, të cilat janë në një nivel jo të kënaqshëm për momentin. Duke përmirësuar proceset planifikuese



dhe manaxhuese, Hasi do të ketë një formë urbane që i përshtatet objektivave ambicioze të bashkisë dhe mbështesë zhvillimin në teresi.

1. *OS1 Konsolidimi i një sistem modern të planifikimit urban bazuar mbi platforma inteligjente të dhënash dhe burime njerëzore të kualifikuara që rrisin cilësinë e formës urbane dhe zhvillojnë territorin në mënyrë të qëndrueshme.*
2. *OS2 Përmirësimi i teksturës urbane*

Përmirësimi i Infrastrukturës së Transportit dhe Mobilitetit në Rajon

Zhvillimi dhe optimizimi i lëvizshmërisë midis zonave të kësaj hapësire me qëllim përmirësimin e ndërlidhjes midis bizneseve dhe furnitoreve të tyre, si dhe aksesin e individëve tek shërbimet e ofruara nga kjo hapësirë ekonomike. Master plani i transportit duhet të marrë parasysh zhvillimin e rrugëve dhe transportin publik, si dhe të sigurojë më shumë lidhje ndërmjet fshatrave; të rrisë aksesueshmërinë nga të gjithë. Për më tepër, duhet të nxisë modelet alternative të transportit dhe të theksojë nocione specifike për transportin publik. Plani ka propozuar zhvillimin e një sistemi rrugësh këmbësorësh dhe biçikletash që duhet të përdorin topografinë e qytetit. Rrjetet e këmbësorëve dhe të biçikletave synojnë të çojnë në ulje të varësisë nga makinat dhe në ulje të nivelit të ndotjes, e nga ana tjetër të sjellin një ndikim shumë pozitiv mbi shëndetin dhe cilësinë e jetës publike. Infrastruktura publike që rrit mundësinë e zhvillimit të bizneseve dhe komuniteteve, duke u shoqëruar me rritjen e mobilitetit për qarkullimin e njerëzve dhe mallrave në mënyrë të “zgjuar” dhe efçente.

1. *OS1 Përmirësimi i rrjeteve rrugore dhe shërbimeve të transportit*
2. *OS2 Përmirësimi i shërbimeve të Transportit*

Mbrojtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit Natyror

Ruajtja e Burimeve Natyrore dhe Mbrojtja e Mjedisit, ku konsiderohet Uji si prioritet i zhvillimit, përmirësimi i kualitetit dhe i sigurisë së aksesit me ujërat liqenore e sipërfaqësorë, përdorimi teknologjive me zero emetim të dëmshëm. Integrimi i sistemeve natyrore me dizajnin e infrastrukturës si dhe krijimi i rrjeteve të parqeve nga niveli lokal tek ai rajonal. Mjedis natyror i mbrojtur duke implementuar standartet teknike e ligjore për trajtimin e ekosistemeve dhe ruajtjen e biodiversitetit, duke siguruar kushtet e nevojshme për zhvillimin urban.


Toka

Objektiva Mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Objektiva Mjedisore 2 (OM 2): Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.

Ajri

Objektiva Mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasi të vjetore të



shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

Faktorët klimatikë

Objektiva Mjedisore 4 (OM 4): Përshatja e infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Uji

Objektiva Mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat breglumorë dhe burimet e ujit të pijshëm.

Mjedisi natyror

Objektiva Mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Objektiva Mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Mbetjet

Objektiva Mjedisore 8 (OM 8): Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfillëve e incineratorëve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Zhurma

Objektiva Mjedisore 9 (OM 9): Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Popullsia dhe asetet materiale

Objektiva Mjedisore 10 (OM 10): Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Trashëgimia Kulturore

Objektiva Mjedisore 11 (OM 11): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.


Peisazhi

Objektiva Mjedisore 12 (OM 12): Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peisazhi me cilësi të lartë.

3.2 OBJEKTIVAT E VSM PËR BASHKINË HASI

Objektivi kryesor i VSM-së është orientimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues (PPRr) së Bashkisë Hasit për minimizimin e çdo ndikimi potencial negativ që mund të rezultojë nga zbatimi i tij.

Kjo VSM identifikon ndikimet e mundshme mjedisore të PPRr, vlerëson ndikimet e mundshme, jep rrugët e minimizimit apo shmangies së tyre.



VSM analizon disa skenarë. Skenari “0”, pra “i të mos bërit asgjë” në këtë Bashki do të çonte me shumë gjasa në një spirale të përshpejtuar të përkeqësimit mjedisor të deritanishëm. Në vend të kësaj, VSM-ja synon të orientojë planin për realizimin e objektivave të tij në një mënyrë të qëndrueshme. Për Planin Rregullues të Bashkisë, vlerësimi merret veçanërisht me ndikimin mjedisor që mund të ketë zbatimi i planit. Siç u tha në paragrafin më sipër, skenari “0” nuk është zgjidhja e duhur, pasi gjendja aktuale mjedisore në Bashkinë Hasi është e mirë po t’i referohemi standardeve bashkëkohore, dhe do të përkeqësohet edhe më shumë nëse vazhdon të mos merren masa në përmirësimin e kësaj situate. Veçanërisht për PPRr, ky vlerësim shqyrton aspektet mjedisore të zhvillimit të planit në lidhje me tendencat dhe situatën aktuale dhe bën një analizë të:

- mjedisit urban në tërësi – përdorimit të tokës, florës, faunës, cilësisë së ajrit dhe ujit, rekreacionit aktiv dhe pasiv, zonave të ndotura, zonave me bukuri natyrore apo me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, zonave potencialisht të ekspozueshme ndaj rreziqeve natyrore;
- mjedisit dhe trashëgimisë së ndërtuar – monumentet e godinat kulturore dhe historike, aspektet dhe vlerat të qytetit;

3.2.1 Projekt - Raporti Paraprak

Instrumentet dhe çështjet që influencojnë planifikimin e territorit

Bazuar në përcaktimet e rezultateve të pritshme në Termat e Referencës si dhe në zbatim të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij, veçanërisht referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” një ndër analizat e para të cilat zhvillohen në kuadër të hartimit të një dokumenti planifikimi është analiza dhe studimi i planeve të hartuara më parë ose në proces që ndikojnë në zhvillimin e territorit të Bashkisë. Metodologjia e hartimit të analizës së planeve të mëparshme është bazuar në një studim të dokumenteve të planifikimit, që për strukturim të informacionit ato janë ndarë në dy kategori kryesore:

1. Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë, që përmban jo vetëm analizat e planeve të mëparshëm territorial të hartuar për Bashkinë Hasi por edhe një pasqyrë të strategjive ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale që ndikojnë në zhvillimin e Bashkisë;
2. Dokumentimi dhe rishikimi i direktivave të planeve ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale, standarteve dhe normave. Prej secilit dokument janë identifikuar objektivat dhe disa nga masat kryesore të cilat kanë implikime në hartimin e planit të ri të përgjithshëm vendor për Bashkinë Hasi.

Ky Projekt-Raport Përfundimtar është rezultati kryesor raportues i procesit të VSM-së. Mbas shqyrtimeve dhe komenteve të Bashkisë Hasi, si dhe seancave të dëgjësive me publikun, do shihen pyetjet, komentet apo sugjerimet që dalin gjatë procesit, do u jepet përgjigje dhe do integrohen nëse gjykohen të drejta, dhe në fund do të prodhohet Raporti Përfundimtar për miratim nga Këshilli i Bashkisë dhe Ministria e Mjedisit. Raporti paraprak i vlerësimit strategjik mjedisor bën të mundur:

- a. përshkrimin e qëllimit dhe objektivave kryesore të planit ose programit dhe të përputhjes së tij me plane ose programe të tjera që lidhen me të, fazën e vendimmarrjes dhe sqarimet nëse disa çështje janë vlerësuar ose do të vlerësohen në nivele dhe procese të tjera planifikimi;
- b. përshkrimin e metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VSM-së, përfshirë vështirësitë e hasura gjatë përgatitjes së tij, dhe burimet e informacionit ekzistues, që përdoren për qëllim të hartimit të raportit;
- c. përshkrimin e alternativave të konsideruara gjatë hartimit, rishikimit, ndryshimit apo modifikimit të planit ose programit të propozuar, përfshi edhe alternativën e mosplanifikimit (alternativa zero), si dhe arsyetimet përkatëse;
- d. objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, nivel kombëtar, rajonal apo lokal, të cilat lidhen me planin ose programin dhe mënyra në të cilën këta objektiva janë marrë në konsideratë në propozim;
- e. përshkrimin e përbërësve të mjedisit në zonën e shtrirjes të planit ose programit të propozuar;
- f. përshkrimin e cilësisë së elementeve të mjedisit në zonën ku propozohet plani apo programi, të cilat mund të ndikohen nga zbatimi i planit ose programit të propozuar;
- g. ndërveprimet e mundshme me mjedisin të planit ose programit të propozuar, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore, si zonat e mbrojtura;
- h. pasojat e mundshme negative në mjedis, duke përfshirë ndikimet në biodiversitet, në tokë, në ujë, në ajër, faktorët klimaterikë, trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike, peizazhin apo dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;
- i. pasojat e mundshme negative në mjedisin ndërkufitar, në rast të zbatimit të nenit 17 të këtij ligji;
- j. masat e parashikuara për të shmangur apo zbutur sa më shumë të jetë e mundur pasojat e ndikimeve në mjedis, gjatë zbatimit të planit ose programit;
- k. identifikimin e investimeve apo të infrastrukturës mjedisore të nevojshme, në kuadër të planit apo programit të propozuar;
- l. përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e pasojave në mjedis gjatë zbatimit të propozimit.

Raporti paraqet përfundimet me një përmbledhje të shkurtër jo teknike dhe sugjeron disa prej veprimeve kryesore mjedisore që duhen ndërmarrë dhe pasur parasysh gjatë zbatimit të PPRr dhe detajimit të punës gjatë hartimit të Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit.

3.3 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

Kuadri Institucional për Mbrojtjen e Mjedisit

Institucionet mjedisore në Shqipëri kanë kaluar nëpërmjet një procesi reformash të thella institucionale gjatë dy dekadave të fundit. Si rezultat i përpjekjeve disa vjeçare të të gjithë aktorëve të interesuar brenda vendit, si dhe kontributit të komunitetit ndërkombëtar, në Shtator 2001 u

suprimua Agjencia Kombëtare e Mjedisit (nga 1991 deri 1998; Komitet për Mbrojtjen e Mjedisit) dhe në vend të saj u krijua Ministria e Mjedisit, e cila në vazhdim të trendit për rritjen e autoritetit në mbrojtjen e mjedisit, në vitin 2005 transformohet në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU) dhe sot në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, është autoriteti kryesor përgjegjës për menaxhimin e mjedisit dhe politikave mjedisore në nivel kombëtar në Shqipëri. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit u krijua si organi shtetëror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit në Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politikën e qeverisë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit, harton projekt-akte ligjore e nën-ligjore në funksion të mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe turizmit, bashkërendon aktivitetet e institucioneve të linjës për çështje të mjedisit, organizon dhe koordinon punën për monitorimin e mjedisit, përgatit projekt-marrëveshjet ndërkombëtare apo bilaterale për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit, përgatit Raportin “Për Gjendjen e Mjedisit”, shqyrton dhe jep lejet mjedisore për aktivitetet e ndryshme ekonomike, nxit informimin, ndërgjegjësimin dhe tërheqjen e publikut në diskutime të rendësishme për mjedisin dhe turizmin, etj. Ministria ka 12 Agjensi Rajonale të Mjedisit. Përgjegjësitë e tyre janë zbatimi i legjislacionit; kryerja e inspektimeve; kontrollimi i funksionimit të aktiviteteve dhe përdorimi i burimeve natyrore në rajonet e tyre, duke marrë pjesë në dhënien e lejeve mjedisore për aktivitetet e reja dhe në mbështetjen e monitorimit dhe të vlerësimit mjedisor. Agjencia ka detyrat e mëposhtme:

- Të organizojë dhe menaxhojë programe vjetore të menaxhimit mjedisor, të cilat aprovohen nga Ministri;
- Në bazë të të dhënave të monitorimit, AMP përgatit raporte vjetore mbi gjendjen e mjedisit. Ministri paraqet raportin në Këshillin e Ministrave për aprovim;
- Agjensitë Rajonale të Mjedisit, përgatisin raporte mbi gjendjen e mjedisit dhe turizmit në nivel rajonal, që aprovohen nga Këshillat e Qarqeve. Pas aprovimit këto raporte publikohen në mediat elektronike dhe në ato të shkruara;
- Të mbështesë grupet e inspektimit të Inspektoratit Mjedisor për analizimin e shkarkimeve në ajër, tokë dhe ujë;
- Të mbështesë autoritetet lokale në aktivitetet e menaxhimit dhe të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e turizmit nën juridiksionin e tyre;
- Të promovojë përdorimin e teknologjive më të pastra dhe të vërë në funksionim sisteme të menaxhimit mjedisor;
- Të marrë pjesë në procesin e aprovimit të licensave dhe deklaratave mjedisore, duke përmbushur detyrat e përcaktuara nga ministri;
- Të bashkëpunojë me autoritetet lokale në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për aktivitete nën juridiksionin e saj;
- Të informojë publikun dhe të sigurojë pjesëmarrje të publikut në procesin e vendimmarrjes;
- Të publikojë të dhënat mjedisore dhe turistike, dhe të përmbushë kërkesat e publikut për

informacion mjedisor dhe turistik.

Aktualisht funksioni kryesor i Agjensisë është të organizojë dhe të menaxhojë zbatimin e programit vjetor të monitorimit mjedisor dhe turistik dhe të raportojë situatën mjedisore e turistike nëpërmjet hartimit të raportit vjetor mbi gjendjen e mjedisit dhe turizmit.

Autoritete të Tjera në Nivel Qëndror me Përgjegjësi Mjedisore

~~Komisioni i përhershëm për shëndetin dhe mjedisin punon për Parlamentin dhe rishikon draftet e ligjeve të përgatitura nga MMPAU, aprovon marrëveshje mjedisore ndërkombëtare dhe të tjera në lidhje me çështjet mjedisore. Mandati i tij përcaktohet nga Parlamenti dhe anëtarët e tij janë përfaqësues nga të gjitha grupet parlamentare.~~

Niveli Rajonal dhe Vendor

Në nivel vendor, Bashkitë janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, megjithëse nuk kanë njësi të specializuara mjedisore, përveç Bashkive. Në bazë të ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore Nr.8652, datë 31.7.2000, autoritetet lokale morën përgjegjësinë për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e rezervave ujore, mbetjeve urbane, infrastrukturën e transportit dhe zonat e gjelbra, në fillim të vitit 2001. Bashkitë gjithashtu, janë përgjegjëse për zonat industriale të mbyllura dhe të braktisura që ndodhen në territorin e tyre.

Organizatat Jo-Qeveritare

Organizatat mjedisore shqiptare kanë ndërmarrë aktivitete sensibilizues dhe ndërgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit ndër, të cilat mund të përmendim në fushat si:

- a. Mbrojtja e biodiversitetit, vlerësim i habitateve, depozitimi i mbetjeve të ngurta, studim i problemeve të lidhura me ndotjen urbane, etj.
- b. Përfshirje e komunitetit në vendimmarrje, diskutime në tryeza të rrumbullakta, nënshkrimin e vendimeve, etj.
- c. Edukim mjedisor i komunitetit nëpërmjet workshopeve dhe trajnimeve, programeve në media, publikimeve, aktivitete të lidhura me shkollat dhe studentët, etj.

3.4 LEGJISLACIONI MJEDISOR

Qeveria i përkushton kujdes të veçantë harmonizimit të ligjeve me ato të Bashkimit Evropian (BE). Deri në vitin 2002, mbrojtja e mjedisit bazohej në ligjin e vitit 1993 të titulluar “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe në një amendim të tij të vitit 1998. Për kohën e vet këto ligje dhanë ndihmesën e nevojshme dhe vunë themelet e shumë proceseve e veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit që sot zhvillohen normalisht. Kërkesat mjedisore të BE-së janë shumë të gjera dhe kanë nevojë për veprim, jo vetëm në bazë të prioriteteve të vendit, por për një sërë sektorësh mjedisorë. Legjislacioni evropian mjedisor përbëhet nga rreth 300 akte ligjore dhe do të trajtohet gjatë gjithë procesit të përafrimit. Procesi i përafrimit kërkon ndërveprim të zgjeruar institucional si në hartimin e legjislacionit



mjedisor dhe në zbatimin e tij. Megjithëse ka një proces të qartë në zhvillimin e legjislacionit mjedisor, pika e dobët qëndron në zbatimin e kërkesave ligjore mjedisore.

3.4.1 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Parimet kryesore, të cilat rregullojnë legjislacionin mjedisor në Shqipëri, janë të njëjta me ato të Bashkimit Evropian. Ato janë të konsaktuara në ligjin e ri për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 10 431, datë 9.6.2011, kapitulli II:

- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake;
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore;
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit;
- Parimi i përafrimit të integruar;
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit;
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit;
- Ndotësi paguan;
- Ndërgjegjësimi i publikut dhe pjesëmarrja në vendimmarrje.

Lidhur me planet e zhvillimit, të nenit 23 të këtij Ligji, duke ju referuar dhe Ligjit për Planifikimin e Territorit, kërkohet që në hartimin e planeve të zhvillimit të mbahen parasysh ndjeshmëria e mjedisit të një zone të caktuar, kapaciteti bartës i saj, lidhja dhe harmonia e vlerave të peizazhit natyror, lidhja ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe të papërtëritshme, trashëgimia kulturore, si dhe tërësia e ndërveprimeve ndërmjet zhvillimeve ekzistuese në mjedis dhe atyre të planifikuara. Në nenin 24 ku bëhet fjalë ekskluzivisht për VSM, theksohet ndër të tjera se këtij vlerësimi i nënshtrohen projektet e planifikimit të territorit, si dhe planet e programet e zhvillimit kombëtar, rajonal e vendor; Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit, është pasuruar progresivisht me akte ligjore dhe nënligjore, të cilat janë përgjithësisht përafrim me direktivat dhe standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. Ndër to do të veçonim ligjet:

- “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”;
- “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”;
- “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- “Për mbrojtjen e biodiversitetit”;
- “Për trajtimin e ujrave të ndotur”;
- “Për substancat dhe preparatet kimike”;
- “Për administrimin e zhurmave në mjedis”;
- “Për zonat e mbrojtura”;
- “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;
- “Për taksën e karbonit e të ambalazhit plastik”.



Krahas hartimit të ligjeve, vitet e fundit, është punuar për plotësimin me akte nënligjore të ligjeve të miratuara, me qëllim që të lehtësohet zbatimi praktik i tyre:

- Vendimi “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi “Për normat e cilësisë së ajrit”;
- Vendimi “Për normat e shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit”;
- Vendimi “Për shpalljen e monumenteve të natyrës shqiptare”;
- Vendimi “Për administrimin e zonave të mbrojtura”;
- Vendimi “Për rregullat e miratimit të zonave të mbrojtura dhe buferike”;
- Vendimi “Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit të shtretërve të lumenjve”
- Vendimi “Për çertifikimin e specialistëve për hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”;
- Vendimi “Për miratimin e strategjisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit”.

LIGJ Nr. 68/2014 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9587, DATË 20.7.2006, “PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT”, TË NDRYSHUAR

Çështje të këtij ligji që lidhen me problematikat e zonës

“Zona me interes për komunitetin” është zona, e cila, në rajonet biogeografike ose në rajonet të cilave u përket, kontribuon dukshëm në ruajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje të një tipi habitati natyror ose lloji, që mund të kontribuojë dukshëm në lidhje me rrjetin “Natura 2000”, dhe/ose kontribuon dukshëm në ruajtjen e diversitetit biologjik brenda rajonit biogeografik ose rajoneve në fjalë.

“Zonë veçanërisht e mbrojtur” është zona ku shpendët e egër klasifikohen si të rrallë e të cenueshëm (vulnerabël) dhe, si rregull, u përkasin llojeve migratore që janë strikte të mbrojtura.”.

Përcaktimi dhe menaxhimi i habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve

Ministria përzgjedh një listë të zonave me interes për komunitetin, duke identifikuar dukuritë e tipave të habitateve dhe llojet, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 17/4, të këtij ligji, në çdo rajon përkatës biogeografik, me qëllim propozimin Komisionit Europian të listës së zonave, të cilat strehojnë këta tipa habitatesh dhe llojesh. Lista kombëtare e zonave me interes për komunitetin, së bashku me një përshkrim të tipareve karakteristike të zonave specifike, përgatitet në përputhje me dokumentacionin dhe kërkesat e përcaktuara për çdo zonë, sipas shtojcës 1, të vendimit nr. 897, datë 21.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes”.

Projekti “Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit kombëtar të biosigurisë”, mbështetur nga (UNEP-GEF) Maj 2011- Qershor 2015.

Projekti pas një periudhe 18 mujore vonesë në zbatimin e aktiviteteve të tij për arsye të ndryshme, ka

filluar qysh prej Janarit 2013 riaktivizimin e tij pas një rishikimi total të aktiviteteve dhe fonde respektive të alokuara në mënyrë që të rikuperohet koha e humbur. Është ngritur Komiteti Drejtues i projektit dhe janë organizuar një numër workshopesh trajnuese me institucionet zbatuese të protokollit të Kartagenës në të cilin Shqipëria është Palë qysh prej vitit 2005. Projekti ka si qëllim të kontribuojë në finalizimin e politikave kombëtare për biosigurinë, në hartimin e kuadrit rregullator, kompletimin e testimit pilot të sistemit administrativë dhe vendosjen e sistemit të monitorimit dhe zbatimit të ligjit, si dhe ndërgjegjësimin e publikut për bio-sigurinë dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut në vendim marrjen për biosigurinë.

Projekti “Rishikimi dhe Përditësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për biodiversitetin (2011-2020), mbështetur nga GEF. Ka filluar në Janar 2013, pas miratimit të VKM nr. 674, datë 3.10.2012 “Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit të Fondit Global për Mjedisin (GEF) midis qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe IBRD për financimin e projektit “Rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin dhe Raportin e 5-të kombëtar të Konventës së Biodiversitetit (CBD)” në linjë me Aichi targets të Konventës së Biodiversitetit dhe planin e saj strategjik për këtë periudhë. Projekti do të realizojë një SPVB të përditësuar në linjë me objektivat globale të CBD dhe me Strategjinë e Biodiversitetit të BE-së (Korrik 2011). Është në proces hartimi i draftit të parë të Raportit Stock Taking. Gjithashtu është publikuar ftesa për hartimin e Raportit të 5-të Kombëtar të Konventës së Biodiversitetit.

Përgatitjet për Natura 2000 Kemi përgatitur Fiche projektit për IPA 2013 dhe për fillimin e procesit Natura 2000. Propozimi merr parasysh zbatimin e planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura të Shqipërisë, ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese për zonat e mbrojtura, të cilat do të përbëjnë thelbin e Natura 2000 të ardhshëm për Shqipërinë. Projekt-fisha është në proces shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni Evropian. Për vitin 2013 është shqyrtuar Programi Kombëtar për Monitorimin dhe janë dhënë mendime krahas treguesve të tjerë dhe për treguesit e tokave. Po ashtu në përputhje me kërkesat e VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, në bashkëpunim me Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, është kontribuar e janë dhënë mendime e komente për draft programin e monitorimit, sikurse janë dhënë komente e sugjerime për Raportet Vjetore të gjendjes së mjedisit, ku tokat, gjendja dhe mbrojtja e tyre kanë qenë pjesë e këtyre raporteve.

MARRËVESHJET NDËRKOMBETARE, KONVENTA, PROTOKOLLE, MEMORANDUME PËR FUSHËN E NATYRËS

Drejtoria e Biodiversitetit ndjek një numër të konsiderueshëm Marrëveshjesh Shumëpalëshe Mjedisore (MShM) të fushës së mbrojtjes së natyrës:

- **Konventa për Biodiversitetin**, në të cilën Shqipëria është Palë qysh prej 10.11.1996.
- **Protokolli i Biosigurisë**, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 9279, datë 23.9.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kartagenës për Biosigurinë të Konventës “Për larminë biologjike”.
- **Konventa “Për ruajtjen e jetës së egër dhe të habitateve natyrore Evropiane”** (konventa

- e Bernës) e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8294, datë 2.3.1998 “Për ratifikimin e “Konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (konventa e Bernës)”.
- **Konventa “Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër” (CITES)**, në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 9021, date 6.3.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”.
- **Konventa “Për Ruajtjen e Llojeve Shtegtare të Botës së Egër” (Konventa e Bonit) dhe Marrëveshjet e saj për Cetacete (ACCOBAMS), lakuriqët e natës (Eurobats) dhe për shpendët migratorë euroaziatikë (AEWA)**, në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 8692, datë 16.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bonit “Për mbrojtjen e llojeve shtegtarë të kafshëve të egra” dhe mirëkuptimet e kësaj Konvente”.
- **“Konventa e Ligatave të Rëndësishme Ndërkombëtare Veçanërisht si Habitat i Shpendëve të Ujit” (Konventa e Ramsarit)**, në të cilën Shqipëria është Palë prej 29.2.1996.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të luftuar shkretëtirëzimin (UNCCD)**, në të cilën Shqipëria është palë prej 26.7.2000, pas miratimit të ligjit nr. 8556, datë 22.12.1999 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të luftuar shkretëtirëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësira serioze dhe /ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë”.

Në zbatim të këtyre Konventave janë hartuar strategji, plane veprime e programe. Gjithashtu hartimi i legjislationit në fushën e mbrojtjes së natyrës mbështetet në parimet dhe detyrimet e konventave, si dhe përfshin dispozita për zbatimin e tyre.

ECURIA DHE GJENDJA AKTUALE E ZONAVE TË MBROJTURA

Objektivat kryesore konsistojnë në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, nëpërmjet mirë administrimit në 3 nivelet përbërëse të tij: lloje, habitate dhe ekosisteme dhe arritjen e statusit të favorshëm për llojet e florës dhe faunës së egër që do të sigurojnë mbijetesën e tyre. Këto objektiva themelore parashikohet të arrihen nëpërmjet rritjes së sipërfaqes së ZM-ve dhe zbatimit me efikasitet të planeve të tyre të menaxhimit si dhe nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Administratave të Zonave të Mbrojtura. Përmirësimi më i rëndësishëm në menaxhimin e zonës së mbrojtur duhet të jetë forcimi i zbatimit të ligjit, ç’ka kërkon një bashkëpunim më të mirë midis institucioneve dhe autoriteteve të ndryshme në nivel qendror e lokal. Gjatë kësaj periudhe zonat e mbrojtura e kryesisht parqet kombëtar janë ndeshur me mjaft probleme si:

1. Degradimi i habitateve, erozioni kodrinor dhe malor mbetet një dukuri në rritje kjo dhe për shkak të ndërhyrjeve në lumenjt, dhe nga prerja e pyjeve dhe zjarret. Në këtë situatë kanë ndikim dhe degradimi i rregjimit ujor, ndotjet nga materialet e pa rikuperueshme si plastikë, shkarkimet e ujrave të zeza dhe industriale, etj.

2. Prerjet abuzive të pyjeve dhe kullotja e pakontrolluar brenda territorit apo në afërsi të të gjithë ZM-ve janë evidente. Për parqet kombëtare është kërkuar që të ngrihen skuadra të përhershme sinjalizim-vrojtimi dhe të veprimt në raste zjarresh,
3. Përndjekja e shpendëve dhe të kafshëve të egra, gjuetia, mbipeshkimi, peshkimi ilegal dhe përdorimi i mjeteve të ndaluara, kryesisht në zonën fushore, dhe në laguna mbetet problem.
4. Po kështu ndërtimi i parqeve eolike apo dhe ata fotovoltaike përbëjnë një problem serioz në disa zona të mbrojtura si dhe janë në kundërshtim me statusin e zonës Ramsar dhe të konventës së Bonit.
5. Guroret dhe minierat përbëjnë një dukuri tepër negative në shkatërrimin e natyrës e të peizazhit, të habitateve dhe zvogëlimin e tyre.

Kësisoj jemi shprehur që të shmanget planifikimi i minierave dhe i gurove në:

- Të gjitha kategoritë e Zonave të Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës;
- Sipërfaqet pyjore, ripyllëzimet, shkurret mesdhetare, tokave me bimësi pyjore;
- Pyjet e përcaktuar mbrojtës të tokave, të burimeve ujore, të liqeneve, të ujëmbledhësve, të qendrave të banuara dhe rezervatet gjenetike;
- Zonat me rrezikshmëri të lartë për rënien e zjarreve;
- Zonat e planifikuara për zhvillimin e turizmit dhe peizazhet me vlera të jashtëzakonshme të vlerësuar si një aset thelbësor i zhvillimit të turizmit;
- Lugina, ujëvara, gjire, kepe, kanione, maja, shpate të thepisur, liqene natyror, ujëmbledhësit, shpella, përgjatë lumenjve e përrenjve dhe në shtretërit apo brigjet e tyre, në një distancë jo më afër se 2 km dhe/ose me shtrirje deri në kufirin ujëndarës;
- Vendet rezerva të burimeve ujore nën e mbi tokësore, zonat që shërbejnë si rezerva ujore për ujin e pijshëm dhe territoret e rimbushjes së ujrave nëntokësore, grykëderdhjet e shkarkimit të burimeve, lumenjve dhe përrenjve;
- Peizazhin që duket nga qendrat e banuara rurale e të qyteteve, në zonat industriale, sportive, argëtuese, portet, aeroportet, në një distancë jo më afër se 2-5 km si dhe në brezin e gjelbërt urban;
- Territoret e ndjeshme ndaj erozionit, rrëshqitjeve, shembjeve, etj.

PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË RUAJTJES SË NATYRËS ME LEGJISLACIONIN EVROPIAN

Aktet ligjore

- Ligj Nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e Mbrojtura”, përafuar Direktiva e Habitatit - 31992L0043, “Direktiva e Këshillit 92/43 EEC të 21 Majit 1992 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër”, Fletorja zyrtare L 206, 22/07/1992, Faqe 7-50;
- Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, përafuar Direktiva e Habitatit -31992L0043, “Direktiva e Këshillit 92/43 EEC të 21 Majit 1992 për ruajtjen e

habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër”, Fletorja zyrtare L 206, 22/07/1992, Faqe 7-50;

- Ligji nr. 9868, date 04.02.2008 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906, date 6.06.2002 “Per zonat e mbrojtura”, perafuar Direktiva e Habitatit -31992L0043, “Direktiva e Keshillit 92/43 EEC te 21 Majit 1992 per ruajtjen e habitateve natyrore dhe te faunes dhe flores se eger”, Fletorja zyrtare L 206, 22/07/1992, Faqe 7-50;
- Ligji nr. 9867, datë 31.01.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 19.2.2008, faqe 629-639, përfaqëuar 31997R0338, Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 338/97 e 9 Dhjetorit 1996 “Për mbrojtjen e llojeve të faunës dhe florës së egër duke rregulluar tregtinë e tyre”, Fletore Zyrtate L 061, 03/03/1997, Faqe 0001-0069 që siguron kuadrin ligjor të përgjithshëm për zbatimin e Konventës “Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër” (CITES) në territorin e BE-së.
- Ligji nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 168, Viti 2008, Faqe 8273, Data e botimit 31.10.2008, është bërë përaftrim i pjesëshëm i direktivës nr. 79/409 EEC të 2 Prillit “Për ruajtjen e shpendëve të egër”, Fletorja Zyrtare Oj L 103, 24/04/1979, Faqe 0001-0018.
- Ligj nr. 10253, datë 11.02.2010 “Për Gjuetinë”, përaftrim i pjesëshëm i direktivës nr. 79/409 EEC të 2 Prillit “Për ruajtjen e shpendëve të egër”, Fletortja Zyrtare Oj L 103, 24/04/1979, Faqe 0001-0018.
- Objektivi i përgjithshëm i strategjisë është të kontribuojë në nivel kombëtar për arritjen e objektivave të 2020 në ndalimin e humbjeve të biodiversitetit dhe degradimin e shërbimeve të ekosistemit.

Objektiva të tjera sektoriale strategjike për mbrojtjen e natyrës janë:

- Adresimi i shkaqeve të humbjes së biodiversitetit
- Ulja e presioneve të drejtpërdrejta mbi biodiversitetin dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm
- Rritja e zbatimit përmes planifikimit me pjesëmarrje, menaxhimin e njohurive dhe ndërtimin e kapaciteteve
- Rritja e përfitimeve për të gjithë, nga biodiversitetet dhe shërbimet e ekosistemit

Parqet të krijuara për të ruajtur funksionet esenciale të ekosistemeve, të cilat i shërbejnë mbijetesës së popullsisë lokale. Kjo nënkupton që masat për ruajtje dhe mbrojtje janë para së gjithash në interes të njerëzve. Duhet të mirëmbahen funksionet e ekosistemeve si më poshtë:

- Cilësia e habitateve për speciet;
- Sigurimi i hapësirave të mjaftueshme që lejojnë zhvillimin pa shqetësime të proceseve ekologjike, siç janë ciklet jetësore dhe qarkullimi fizik i substancave inorganike);
- Përmirësimi i aftësisë ripërtëritëse dhe i qëndrueshmërisë së ekosistemeve;

Mirëmbajtja e shërbimeve të ekosistemeve:

- Burimet natyrore për popullsinë vendase për sigurimin e nevojave për dru zjarri dhe prodhime të dyta pyjore, ajër i pastër dhe mbrojtje uji.
- Prodhim të ardhurash për popullsinë lokale

Regjimi i ujit dhe rigjenerimi i tij

- o Mbrojtja e klimës;
- o Mbrojtja nga erozioni;
- o Zona për çlodhje dhe eksperiencia në natyrë.

Zona e mbrojtur duhet të konsiderohet si një park zhvillim. Do të duhen disa dekada deri sa parku të arrijë statusin që të jetë i krahasueshëm me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, është e rëndësishme që të futen këto standarde, në mënyrë që menaxhimi i Parkut të çohet në drejtimin e duhur.

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR PËR ZONAT E MBROJTURA NË SHQIPËRI

Ligji nr. 9806, datë 06.06.2002 "*Për zonat e mbrojtura*" përbën bazën ligjore për menaxhimin e zonave të mbrojtura, sikundër në Shqipëri edhe në rajon. Ky është ligji kuadër për deklarimin, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore e biologjike. Ndërmjet të tjerave, një qëllim i rëndësishëm i këtij ligji është informimi dhe edukimi i komuniteteve lokale lidhur me përfitimet ekonomike të drejtpërdrejta dhe të tërthorta dhe nxitja e zhvillimit të eko-turizmit. Ligji 8906, në përputhje me kriteret e mbrojtjes së natyrës të përcaktuara nga Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), identifikon gjashtë kategori të "zonave të mbrojtura", duke u dhënë staturë dhe nivele të ndryshme të mbrojtjes. Neni 4/2 i ligjit nr. 8906, të amenduar, përcakton se territori i çdo zone të mbrojtur, do të ndahet në nënzona, në përputhje me rëndësinë e habitateve dhe ekosistemeve të pranishëm në territoret e caktuara. Ligji përcakton ndarjen në nënzona si vijon:

- zonë qëndrore,
- zonë e përdorimit të qëndrueshëm,
- zonë rekreative,
- zonë e përdorimit tradicional dhe zona të tjera të vogla, të cilat janë në përshtatje me territoret të caktuara.

Zonimi përcakton nivelin e mbrojtjes së zonës në përputhje me specifikat e saj, duke marrë parasysh natyrën e zonës dhe aktivitetet njerëzore që zhvillohen në të.

Zbatimi i ligjit "*Për zonat e mbrojtura*" të amenduar, shoqërohet edhe me akte të ndryshme nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave, që përfshijnë:

- VKM nr. 676, datë 20.12.2002 "*Për shpalljen e monumenteve të natyrës në Shqipëri si zona të mbrojtura*", i cili deklaron si zona të mbrojtur monumentet e natyrës të listuara në aneksin

- e këtij vendimi;
- VKM Nr.267, datë 24.04.2003 "Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike";
 - VKM Nr 266, datë 24.04.2003 "Për administratat e zonave të mbrojtura";
 - VKM Nr 86, datë 11.02.2005 "Për krijimin e komiteteve të menaxhimit për zonat e mbrojtura";
 - VKM Nr 519, datë 30.06.2010 "Për propozimin dhe miratimin e procedurave dhe rregullave për administrimin e parqeve natyrore rajonale";
 - VKM nr 897 datë 21.12.2011 "Për miratimin e rregullave për caktimin e zonave të veçanta të ruajtjes".

3.4.2 Strategjitë dhe Programet Ndërkombëtare

Strategjia 2020 e Evropës Jug-Lindore – Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim Evropian (BE/ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)

Ky dokument është hartuar në vitin 2011, si përgjigje ndaj kërkesës së qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në bashkëpunim me qeveritë e vendeve të këtij rajoni, për përgatitjen e një dokumenti në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me konkurrencën rajonale dhe strategjitë e rritjes. Ky dokument fokusohet në pesë shtylla të modelit të ri zhvillimor:

1. Rritje e Integruar – me fokus Tregjet Rajonale, ekonominë e orientuar drejt eksportit dhe - investimeve të huaja, etj.
2. Rritje e Zgjuar – me fokus rritjen e konkurrueshmërisë Rajonale, udhëheqjen nga njohuria dhe novacioni dhe bazuar në kapitalin njerëzor, teknologjitë moderne të komunikimit dhe industritë kreative
3. Rritje e Qëndrueshme – me fokus në infrastrukturën dhe energjinë e qëndrueshme, në përdorimin me efikasitet dhe ndjeshmëri të burimeve, sidomos atyre natyrore
4. Rritje Gjithëpërfshirëse – me fokus avancimin përtej një shoqërie përjashtuese drejt një situatë ku të gjithë përfitojnë nga zhvillimi në mënyrë të drejtë
5. Qeverisje në funksion të rritjes - me fokus qeverisjen transparente, funksionale dhe efikase.




Fig. - I

3.4.3 Çështjet, Zonat dhe Objektet E Rëndësisë Kombëtare

Dokumentet që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 16, të Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, janë si më poshtë:

1. Vendimi nr. 5 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 18.10.2013, “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”
2. Vendimi nr. 1 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 09.09.2015, “Përcaktimi si Zona të Rëndësisë Kombëtare në Planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me urdhër të Ministrit të Kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve për periudhën 2014-2015”.

3.4.4 Ligji për Ratifikimin e Protokollit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Ligji aktual nr. 9424, datë 6.10.2005 “Për Ratifikimin e Protokollit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Protokolli i Kievit) është hartuar në kuadër të Konventës “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar”. Qëllimi i këtij protokollit është të krijojë kushtet për një nivel më të lartë mbrojtjeje të mjedisit, përfshirë edhe shëndetin:

- a. duke siguruar që çështjet mjedisore, përfshirë edhe ato shëndetësore, të merren thellësisht në konsideratë në zhvillimin e planeve dhe programeve;
- b. duke kontribuar në marrjen në konsideratë të çështjeve mjedisore dhe shëndetësore në përgatitjen e politikave dhe legjislacionit;
- c. duke vendosur procedura të qarta, transparente dhe efektive për vlerësimin strategjik mjedisor;
- d. duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në vlerësimin strategjik mjedisor; dhe
- e. duke integruar me këto instrumenta çështjet mjedisore dhe shëndetësore në masat dhe instrumentet e përcaktuara për zhvillim të qëndrueshëm.

3.4.5 Ligji për Planifikimin e Territorit

Ky akt ligjor me nr. 10119, datë 23.4.2009, azhurnuar në vitin 2010, dhe i ndryshuar më datë 31.07.2014 ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë, përgjegjësisive, rregullave dhe procedurave për planifikimin e territorit. Ligji ka për qëllim:

- të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe

interesave publike e privatë, duke bashkënduar: mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri;

- uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;
- krijimin e garantimin e territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale;
- nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor;
- garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;
- nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve;
- të nxisë veprimtarite e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit;
- të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me instrumentet planifikuese dhe ligjet mjedisore;
- të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë;
- të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht instrumente të planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale;
- të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese, për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit;
- të garantojë, sipas legjislationit për ndërtimin, zbatimin e rregullave të sigurisë së ndërtimeve dhe të punimeve të ndërtimit për jetën dhe shëndetin e njerëzve;
- Kërkesa për VSM për planet, ashtu si dhe në ligjet për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe atë të VSM, përshkruhet nominalisht në nenet 21, 47 dhe 48 të këtij ligji.

3.5 LIDHJA ME POLITIKA DHE DOKUMENTE TË TJERË

Në këtë pjesë synohet që të jepet konteksti i politikave dhe dokumenteve të tjerë brenda së cilave funksionon Plani dhe ku është bazuar hartimi i VSM-së. Për këtë qëllim janë konsultuar dhe përdorur një sërë dokumentesh, përfshirë konventat ndërkombëtare, Direktivat e BE-së dhe politikat në nivelin kombëtar.

3.5.1 Kuadri Përkatës Ligjor që Lidhet me Hartimin e Planeve Vendor

Kuadri përkatës ligjor që lidhet me hartimin e planeve vendor është si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 107/2014, datë 29.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore";
- Ligji nr. 8654, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës";
- Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për Mbrojtjen e mjedisit" (amenduar në 2008);

- Ligji nr. 9734, datë 14.05.2007 "Për Turizmin" (me gjithë ndryshimet);
- Ligji nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për Rezervat ujore" (me gjithë ndryshimet);
- Ligji për Furnizimin me Ujë dhe Rregullimin e Sektorit Sanitar (1996);
- Ligjet dhe rregulloret e përshtatshme për zhvillimin e brigjeve ujore (ndër të tjera Ligjit për Zonat e Mbrojtura, amenduar në 2008);
- Ligji mbi themelimin dhe funksionimin e mbrojtjes së tokës dhe strukturave të administratës;
- Ligji mbi themelimin e mbrojtjes së pyjeve;
- Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit";
- Kuadri rregullator për përgatitjen e Vlerësimeve të Impaktit Mjedisor (EIA-s) dhe një Projektligji për vlerësimin strategjik të Ndikimit Mjedisor (SEA-s).

Kuadri ligjor pritet të rishikohet, për ta plotësuar dhe bërë atë me funksional. Kjo do të garantojë një fushë veprimi të koordinuar dhe mirëadministruar në të gjithë territorin e rajonit. Gjatë hartimit të PPVBK duhet të garantohet që "ekuilibri midis interesave publike dhe private" në zhvillimin e tokës, si dhe interpretimi dhe administrimi i saktë i të "drejtës së zhvillimit", të jenë pjesë integrale e mendësisë dhe realitetit të zbatimit.

3.5.2 Konteksti Ndërkombëtar

Legjislacioni Horizontal

- Direktiva 2004/35/KE "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin";
- Direktiva 2001/42/KE "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara";
- Direktiva 2003/4/KE mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor;
- Direktiva 2003/35/KE mbi "Tërheqjen e publikut në vendimmarrje në hartimin e planeve programeve në fushën e mjedisit dhe amendimet për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi";

Cilësia e Ajrit:

- Direktiva 2008/50/KE mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për Evropën;
- Direktiva 2001/81/KE mbi Tavanet Kombëtare të Shkarkimit për disa ndotës atmosferikë;
- Direktiva 2012/33 në lidhje me përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse në transportin ujor;
- Direktiva 2004/42/KE mbi limitimin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme për shkak të përdorimit të tretësve organik në disa bojëra dhe llaqe të caktuara dhe produkteve për lëvizjen e automjeteve;
- Direktiva 97/68/KE mbi përafrimin e legjislacionit të vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jo rrugore;


- Direktiva 2005/55/KE mbi përfrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimeve të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive që djegin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete.

Ndryshimet Klimatike:

- Vendimi i Këshillit 2002/358/KE në lidhje me miratimin, në emër të Komunitetit Evropian, të Protokollit të Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe përmbushjen e përbashkët të angazhimeve në përputhje me to,
- Direktiva 2003/87/KE për krijimin e një skeme të tregtimit të njësisve të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit e cila amendon Direktivën e Këshillit 96/61/KE;
- Direktiva 2004/101/KE për krijimin e një skeme të tregtimit të njësisve të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit, në lidhje me mekanizmat e Protokollit të Kiotos-s;
- Direktiva 2009/29/KE e cila amendon Direktivën 2003/87/KE në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë skemën tregtare të kompensimit të njësisve të lejuara të emisioneve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2010/2/BE i cili përcakton një listë të sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohet të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit;
- Direktiva 2008/101/KE e cila amendon Direktivën 2003/87/KE në mënyrë që të përfshijë aktivitetet e aviacionit në skemën e tregtisë së njësisve të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit;
- Direktiva e Këshillit 85/337/KE "Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin";
- Direktiva 1999/94/KE në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e lëndës djegëse dhe emetimet e CO₂ në lidhje me tregtimin e makinave të reja të pasagjerëve;

Administrimi i Mbetjeve:

- Direktiva 2008/98/KE mbi mbetjet;
- Direktiva 86/278/EKE Për mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht të tokës, kur llumrat e ujërave të ndotura përdoren në bujqësi;
- Direktiva 2006/66/KE Për bateritë dhe akumulatorët, mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët;
- Direktiva 94/62/KE Për Ambalazhet dhe Mbetjet nga Ambalazhet;
- Direktiva 2000/53/KE Për automjetet në fund të jetës
- Direktiva 2002/96/KE dhe Direktiva 2012/19/EU Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike;
- Direktiva 1999/31/KE Mbi landfillin e mbetjeve;
- Direktiva 2006/21/KE Për menaxhimin e mbetjeve nga industria nxjerrëse;
- Direktiva 2011/65/EU Për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike.



Cilësia e Ujërave:

- Direktiva 2000/60/KE për krijimin e një kuadri ne fushën e politikave te ujit;
- Direktiva 91/271/EKE për trajtimin e ujerave te ndotur urbane;
- Direktiva 98/83/KE për cilësinë e ujit te pijshëm;
- Direktiva 91/676/KE për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratat e përdorura në bujqësi;
- Direktiva 2006/7/KE për menaxhimin e cilësisë se e ujërave të larjes;
- Direktiva 2006/118/KE për mbrojtjen e ujerave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi;
- Direktiva 2013/39/BE për sa i përket substancave prioritare ne fushën e politikave te ujit;
- Direktiva 2009/90/KE që parashtron specifikimet teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të ujit;
- Direktiva 2007/60/KE për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmytjet.

Mbrojtja e Natyrës:


- Direktiva 2009/147/KE Për ruajtjen e shpendëve të egër;
- Direktiva 92/43/KE Për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër;
- Direktiva 83/129/KE lidhur me importin në shtetet anëtare të lëkurës së disa llojeve të vegjlish të fokave dhe produkteve të derivuara prej tyre;

Zhurmat:

- Direktiva 2002/49/KE 2 Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis.
- Direktiva 70/157/EKE mbi përfrimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me nivelin e lejueshëm të zhurmës dhe të shkarkimeve nga mjetet motorike;
- Direktiva 97/24/KE mbi disa komponentë dhe karakteristika të mjeteve motorike me dy ose tri rrota;
- Direktiva 2001/43/KE mbi gomat e mjeteve motorike dhe te rimorkiove të tyre si dhe montimi i tyre;
- Direktiva 2009/40/KE mbi kontrollat e përshtatshmërisë rrugore per mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre.

Konventat:

- UNESCO Konventa e UNESCO-s për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (2003);
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC);
- Konventa e Bernës (1976): Ruajtja e Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror Evropian;
- Konventa e Biodiversitetit (Diversiteti Biologjik) (1992);
- Konventa e Ramsarit per Ligatinat (1971);
- Konventa e Aarhusit (Konventa mbi Të Drejtën për Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendim-marrje dhe Të Drejtën për t'ju drejtuar Gjykatës për Çështjet Mjedisore) (1998);
- Konventa e Bonit (1979); Konventa për Mbrojtjen e Specieve Shteguese të Kafshëve të Egra;



- Konventa CITES (1975): Konventa mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër;
- Konventa e Espoos (1991): Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar së bashku me Amendimet dhe Protokollet;
- Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore (2001).

Konteksti Rajonal

- Strategjia e Evropës Juglindore 2020 (SEJ 2020);
- Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor (KIBP);
- Strategjia e Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko - Jonian (SBERAJ);
- Programi IPA II;
- Samiti i Ballkanit Perëndimor – rrjeti i korridoreve kyç rajonale të transportit.

Konteksti Kombëtar

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020
- Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020
- Strategjia e Furnizimit me Ujë & Kanalizimet 2014-2020
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Administrimin e Mbetjeve 2010-2025
- Plani Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve 2010-2025
- Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020 (draft)
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar për Territorin (draft)
- Legjislacioni përkatës mbi ekologjinë, ajrin, mjedisin ujor, zonat e mbrojtura, VSM dhe VNM, administrimin e mbetjeve, trashëgiminë kulturore, zhurmat, ujin, bujqësinë, pyjet, etj.

3.6 ANALIZA, NISMA DHE PROGRAME ZBATIMI

3.6.1 Situata Ekzistuese në Shqipëri

Në Shqipëri, mungesa e planeve hapësinore dhe moszbatueshmëria e bazës ligjore janë konsideruar si dy prej pengesave më të madhe për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Ritmi i përgatitjes së planeve hapësinore ka qënë shumë i ngadaltë për të parandaluar praktikën e ndërtimeve ilegale. Mosrealizimi i planeve dhe programeve territoriale, moskoordinimi dhe bashkërendimi në shkallë rajonale dhe kombëtare, konsiderohen si arsyt kryesore të pamundësisë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të koordinuar për zonën qendrore ekonomike. Edhe pse ka patur disa tentativa për hartimin e PPV, mosarritja në fazën e implementimit apo edhe mungesa e kapaciteteve administrative të Bashkive si autoritet planifikimi, kanë shkaktuar një problem madhor. Fakti është se, për këtë hapësirë strategjike nuk ka ekzistuar një Plan i Integruar Kombëtar që të shërbejë si kuadër rregullues dhe promovues për të siguruar standarde në planifikim dhe instrumenta që mundësojnë rritjen e qëndrueshme ekonomike. Bashkitë aktuale kanë nevojë për një strategji dhe plan gjithpërfshirës që të sigurojnë përdorimin efektiv të burimeve të pakta publike, të shmangë

Bazuar në draft Planin e Përgjithshëm Kombëtar të publikuar nga AKPT dhe MZHU disa nga direktivat kryesore të cilat rrjedhin për PPV e Bashkisë Hasit janë:

Rajonalizimi - Një nga kerkesat që ploteson Plani i Përgjithshëm Kombëtar është krijimi i bazave për zhvillim rajonal. Tre janë tipet e Rajoneve të përcaktuara nga PPK:

- RAJONE NDËRKUFITARE
- RAJONE EKONOMIKE KOMBËTARE
- RAJONETË SPECIALIZUARA

Rajonet ndërkufitare burojnë drejtpërdrejt nga Programet IPA Crossborder (Vetëm për periudhën 2014-2020 Shqipëria do të sigurojë një mbështetje financiare prej 75 milion eurosh.)

SISTEMI INFRASTRUKTUROR

Objektivi: Integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmërisë së vendit dhe shpërndarje e balancuar e flukseve.

Politikat: Organizimi i territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i korridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës.

TRANSPORTI

Objektivi: Multimodal dhe miqësor ndaj ambjentit konkurrues

Politika: Krijimi dhe konsolidimi i një sistemi të integruar multimodal mbarë Kombëtar, rritje dhe konsolidim i pikave të aksesit dhe të lidhjes së territorit. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Një sistem i integruar multimodal mbarë kombëtar
- Dy aeroporte të reja në Kukës dhe Delvinë;
- Për transportin ajror PPK sygjeron ish fushat aeroportuale në Shkodër dhe Kukës propozohen të ruhen të lira nga ndërtimet për të vlerësuar mundësinë në një të ardhme për zhvillimin e transportit ajror.
- Dhjetë Stacione Intermodale Ndërkombëtare në Tiranë, Durrës, Lezhë, Shkodër, Kukës, Pogradec, Bulqizë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, të cilat do të përmbushin nevojat ndërkombëtare dhe tranzitore të lëvizjes dhe shkëmbimit të modaliteve të transportit me vendet e tjera.





Fig. - 2 Skema nga PPK, ndërlidhja hapsinore

ENERGJIA

Objektivi: Zhvillimi i një rrjeti eficient energjistik;

Politika: Diversifikimi drejt energjise së rinovueshme;

Në sistemin e infrastrukturës energjitike, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Katër korridore energjetike: TAP – IAP – WBR – Kosovë do të mundësojnë integrimin e sistemit energjistik të Shqipërisë në infrastrukturën energjitike të Ballkanit Perëndimor dhe Europës.
- Shqipëria përbën një korridor të rëndësishëm që lidh Greqinë me vendet e Bashkimit European dhe Kroacinë.
- Ky korridor siguron një mundësi për lidhje energjetike nëndetare mes Shqipërisë dhe Italisë, një nga ekonomitë më të mëdha të Bashkimit European;

3.6.2 Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë

Rehabilitimi i rrugëve—Karakterit kodrinoro-malor i zonës e vështirëson shërbimin e transportit të njerëzve dhe mallrave, por kjo nuk përbën faktorin kryesor për situatën e tij. Në rajonin e bashkisë Has transporti automobilistik është i vetmi shërbim transporti për njerëzit dhe mallrat. Arteriet kryesore që kalojnë në rajon dhe që e lidhin atë me qytetet e tjera të Kukësit, Tropojës, Gjakovës dhe Prizrenit janë aksi rrugor Kukës-Krumë, Krumë-Gjakovë, Gjakovë-Prizren dhe Krumë-Tropojë. Megjithatë, rrjeti rrugor rural që lidh fshatrat me rrugën shtetërore ose me qendrat e njësive administrative, është në gjendje jo të mirë, i pa asfaltuar dhe me vështirësi kalimi gjatë stinës së dimrit. Mungesa e fondeve dhe kapaciteteve ka sjellë probleme në organizimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale ndër vite, por, vihet re dhe mungesa e një strukture efektive të mirëmbajtjes së sistemit rrugor

rural. Rikonstruksioni me asfaltim i rrugës së fshatit Zahrisht, Gjinaj, Dobrunë dhe rehabilitimi i një seri rrugësh të tjera, shihet prioritar. Këto rrugë do iu mundësonin banorëve të fshatrave lëvizje të lirë, nxjerrjen e produkteve bujqësore e blegtorale në tregjet e Krumës, Kukësit apo Gjakovës, rritje të numrit të turistëve në zonat turistike dhe qasje më të mirë në arsim, shëndetësi, shërbime sociale e informacion. Duke ndjekur përpjekjet e bashkisë gjatë viteve të fundit, pritet të përfundohen hapat e mëposhtme nëpërmjet programit për “*Rigjenerimin e Rrugëve dhe të Hapësirave*”:

- Asfaltimi i rrugëve të dëmtuara/të paasfaltuara;
- Restaurimi i rrugëve me kalldrëme;
- Rigjenerimi i bulevardeve urbane;
- Masa për qarkullimin e trafikut dhe sigurinë në rrugë (përmirësimi i kryqëzimeve, sinjalistikës rrugore);
- Përmirësim të eksedit të njerëzve me aftësi të kufizuara;

Master plani i transportit –Hasi, që tani ka probleme të dukshme me qarkullimin për shkak të transportit të pa planifikuar të viteve të fundit. Kjo situatë ka të ngjarë të përkeqësohet më tej për shkak të rritjes së parashikuar të automjeteve. Është e qartë se sistemi i transportit të qytetit aktualisht është larg të qenit i përgatitur për të trajtuar zhvillimin dhe rritjen e pritur, si rezultat Master Planit i Transportit për Hasin do të duhet të:

- Krijojë një hierarki rrugësh (me ngarkesa të shoqëruara të trafikut dhe me karakteristikat fizike)
- Riforcojë sistemin e transportit publik,
- Ofrojë mjete alternative dhe plotësuese për të udhëtuar rreth qytetit (korsi për biçikleta dhe për këmbësorë),
- Zhvillojë rrugë të reja dhe rrugë akses, i,
- Krijojë zona këmbësorësh,

Rrjeti i sipërfaqeve të hapura - Plani bën thirrje për zhvillimin e një rrjeti të integruar hapësire të hapur që i referohet të gjithë qytetit. Hapësirat e konsiderueshme të gjelbra të qytetit krijojnë një tërësi të vazhdueshme natyrore dhe mjedisore. Plani synon të rrisë në maksimum aksesin në hapësirat e mëdha të gjelbra, duke ofruar një gamë të gjerë korridoresh të gjelbra dhe duke nxitur zonat për biçikletat dhe këmbësorët. Për më tepër, sipërfaqet e hapura në nivel lagjeje do të duhet të rehabilitohen si kopshte xhepa në zonat e banimit të periferi të qytetit dhe në komplekset kolektive të banimit. Ndikimi i pritshëm do të jetë rigjenerimi i mjedisit urban dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe i mikroklimës. Më konkretisht në plan përfshihen:

- Krijimi i një rrjeti të integruar të sipërfaqeve të hapura brenda qytetit, duke përfshirë kodrat apo parqe të ndryshëm
- Vijimin e programit bashkiak “Për rigjenerimin e rrugëve dhe sipërfaqeve të hapura”.
- Rritje e mbjelljes së pemëve përgjatë rrugëve të qytetit (duke i kushtuar rëndësi pemëve që rriten shpejt).
- Rehabilitimi i hapësirave të gjelbra të vogla (kopshtet xhepa).



Rehabilitimi i vend depozitimit të mbetjeve – Në bashkinë Hasi ushtrohet një aktivitet i ulët teknologjik, që nuk arrijnë të ndikojnë dukshëm në mjedisin përreth me mbetjet e tyre. Gjithsesi, i vetmi burim ndotje mendohet se janë dampat minerare aktuale, por më tepër ajo historike pa lënë mënjanë dhe ato antropogjene. Që nga viti 1994, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve, si dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve vendore, duke i bërë plotësisht përgjegjëse për manaxhimin e tyre. Sistemet që trashëguan dhe sot operojnë, konsistojnë në grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane në një rrymë të vetme dhe transportimin e tyre në vendet lokale të depozitimit të tyre. Procesi i delegimit të kompetencave, pavarësisht përmirësimeve graduale të vërejtura është kthyer në një sfidë për autoritetet vendore. Ato janë ballafaquar me mungesën e instrumenteve të nevojshme për manaxhimin mjedisor të mbetjeve, mungesën e teknologjive dhe të investimeve, si dhe të kapaciteteve të mjaftueshme të burimeve njerëzore dhe financiare. Vend depozitimi i mbetjeve paraqet një kërcënim të madh për ndotjen ujore, gjë që përbën rrezik mjedisor dhe shëndetësor. Duhet të punohet për ndërtimin e një vend depozitimi të mbetjeve. Plani duhet të mbështesë mbylljen e vend depozitimit aktual të mbetjeve dhe rehabilitim të tij në mënyrë që ky vend të transformohet në një Park të Gjelbër dhe Kreativ për qytetin. Kjo do të jetë zona më e rëndësishme e gjelbër e qytetit që do të ketë kapacitet të mikropresë sportive të ndryshme, aktivitete që ushtrohen gjatë kohës së lirë, aktivitete kulturore dhe rekreative. Objektivat e këtij projekti strategjik investimesh të integruara janë:

- Eliminimi i një rreziku të madh shëndetësor;
- Mbrojtja e burimeve ujore për gjeneratat e ardhshme;
- Krijimi i një zone për aktivitete rekreative dhe të kalimit të kohës së lirë në nivel qyteti, e ku do të mund të vijnë dhe banorë nga zonat përreth;
- Ofrimi i një burimi potencial të ardhurash për bashkinë nga objekte të ndryshme (të tilla si parku për kalimin e kohës së lirë, park për kurs golfi, etj.);
- Të vepruarit si katalizator për rigjenerimin gradual dhe përmirësimin e sektorit juglindor të qytetit, i cili aktualisht paraqet probleme të ndryshme;
- Ofrimi i një lidhje të re në formën e një korridori të gjelbër, duke lidhur qendrën e qytetit me këtë destinacion të ri, me regjenerimin e lagjeve të ndërmjetme.

Rehabilitimi i vend depozitimit do të kërkojë hapat e mëposhtme:

- Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM) për kontaminimin e zonës
- Planifikimin e detajuar fizik (mundësisht sipas studimit të Institutit Kombëtar të Monumenteve të Mjedisit)
- Rehabilitimin e vend depozitimit aktual dhe projektimin e peizazhit
- Zhvillimin e aktiviteteve rekreative, sportive, kulturore dhe çlodhëse
- Zhvillimin e një korridori të gjelbër që do të lidhë parkun rekreativ me qendrën e qytetit.



Menaxhimi i hedhjes së mbetjeve - Menaxhimi i hedhjes së mbetjeve në Has mbetet i kufizuar dhe i pamjaftueshëm. Mbetjet spitalore hidhen pa u trajtuar siç duhet, gjë e cila mund të çojë në rreziqe sanitare (kullime të mbetjeve sanitare në tokë, në ujëra nëntokësorë ose në atmosferë). Në mënyrë që të arrihet zhvillim i qëndrueshëm, Hasi do të duhet të bëhet një qytet i pastër, i shëndetshëm dhe i sigurt, i cili garanton cilësinë e jetës për të gjithë banorët dhe mbron mjedisin e saj natyror. Si rezultat, zhvillimi i qytetit kërkon një sistem mbledhje dhe menaxhimi mbetjesh.

Komponentë të projektit përfshijnë:

- Zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës për sistemin e mbledhjes dhe menaxhimit të mbetjeve;
- Planifikimin e integruar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivel rajonal;
- zbatimin e studimit rajonal të vitit 2005 duke i kushtuar përparësi trajtimit të mbetjeve mjekësore;
- Rehabilitimin e vend depozitimit ekzistues dhe zhvillimin e një parku rekreativ në nivel qyteti (shih edhe projektin për rehabilitimin e vend depozitimit të mbetjeve);
- Krijimin e një programi bashkiak riciklimi dhe zhvillimin e një qendre përzgjedhje manual;
- Fushata dhe iniciativa pastrimi për pastrimin e qytetit nga mbeturinat;
- Plan për menaxhimin e materialeve inerte;
- Studim fizibiliteti për zhvillimin e qendrës së riciklimit;
- Zhvillimin e një korridori të gjelbër që do të lidhë parkun rekreativ me qendrën e qytetit.




Fig. - 3 Ndarja e re administrative



SISTEMI UJOR

Në përgjithësi rajoni i Hasit ka rrjedhje të varfra ujore dhe kjo lidhet me reshjet nën mesataren e vendit 800-900mm dhe me ndërtimin nga formacionet terrigjene dhe ultrabazikë pak të përshkueshëm.

Hasi bën pjesë në basenin ujëmbledhës të Drinit, ku një pjesë e liqenit të Fierzës depëron në territorin e bashkisë, më saktësisht në pjesën perëndimore të tij. Kjo gjë mundëson shfrytëzimin e ujit të liqenit për vaditje në sektorin e bujqësisë, për këtë pjesë. Ndërsa vaditja e tokave bujqësore në pjesët e tjera të Hasit, bëhet me rezervuare artificiale të krijuar pas viteve 90'. Të cilët janë të tipit kaskadë të diktuar nga terreni malor. Gjithsej janë 9 të tillë me kapacitete të ndryshme ujëmbledhëse, të shtrirë nga veri-perëndimi dhe vazhdojnë shpërndahen drejt jugut të territorit të bashkisë Has.


Lumi i Krumës zë fill në burimin e madh karstik të Vrellës, që del në afërsi të qytetit homonim. Ky lumë ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 227km², lartësi mesatare 687m dhe rënie të shtratit 22m/km, ndërsa gjatësia e tij është 26.5km. Ngritja e nivelit të ujit afër 100m të liqenit të Fierzës e ka reduktuar mjaft gjatësinë e tij. Burimi i madh karstik përbën edhe ushqimin kryesor të tij. Në përgjithësi rrjedhja e këtij përroi është e varfër, gjë që pasqyrohet në prurjen mesatare shumëvjeçare prej 1.96m³/sek, ndërsa moduli i rrjedhjes është 8-10lit/sek/km². Ndërhyrje të nevojshme:

- marrja e masave për evitimin e ndonjë ndotje mjedisore me pasoja për zonën
- marrje e masave, duke vlerësuar rrezikun potencial dhe duke hartuar projekte dhe vepra për mbrojtje nga përmytjet apo erozionet për ato zona që janë të lokalizuara përgjatë lumenjve që rrjedhin nga malet drejt liqenit të Fierzës.

Sistemi i kullimit - Qyteti i Krumes aktualisht është i lidhur me një sistem të integruar ujërash të zeza dhe kullimi nëpërmjet tubacioneve të konsoliduara, pa pasur sistem veçmas për ujërat e zeza dhe veçmas për kullimin. Sistemi i integruar konsiderohet si problematik pasi kërkon mbingarkesë të panevojshme të rrjetit të kanalizimeve dhe të impiantit të trajtimit të ujërave të mbetura. Tipografia unike e Hasit do të jetë faktori përcaktues i sistemit të kullimit të qytetit. Në zonat që gjenden në rrëpirat kodrinore (baza tradicionale), forca e gravitetit dhe rrëshqitja natyrore do të përdoren për kullim dhe për furnizim me ujë. Në zonat e sheshta të qytetit, në veçanti në zonat që identifikohen si të prekshme ndaj përmytjeve, infrastruktura e kullimit do të integrohet nën sipërfaqen e tokës për të parandaluar përmytjet e zonave të sheshta. Ndarja e sistemit të kullimit nga sistemi i ujërave të zeza do të çojë në ofrim më të mirë të shërbimeve si dhe në një organizim racional dhe të qëndrueshëm të ndërmarrjeve publike brenda qytetit.

Situata Ekzistuese në Bashkinë e Hasi

Bashkia e re e Hasit shtrihet në verilindje të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Kukës. Ajo kufizohet në jug me Bashkinë Kukës dhe në perëndim me Bashkinë Fushë- Arrëz, me të cilat e ndan liqeni i Fierzës në një gjatësi prej rreth 40 km. Në veri-perëndim kufizohet me Bashkinë Tropojë, me të cilën e ndan përroi i Skatinës. Në veri- lindje kufizohet me Komunat e Gjakovës dhe Prizrenit. Në përbërje të bashkisë ka 4 njësi administrative, 1 qytet dhe 29 fshatra. Sipas Censurit (2011), Bashkia Has ka një popullsi prej 16 790 banorësh me dendësi 35.49 banorë për km², ndërkohë sipas gjendjes civile



ka 21 764 banorë. Qendra e bashkisë është Kruma, e shpallur qytet në 1972. Përgjatë viteve 1921-1925, ajo ka qenë qendra e Prefekturës së Kosovës që përfshinte Kukësin, Hasin dhe Tropojën. Emërtimi Has vjen nga emërtimi i kahershëm i trevës, gjysma e së cilës shtrihet në Kosovë. Bashkia ka relief kodrinoro-malor, me lartësi mesatare 400-500 m mbi nivelin e detit dhe me kontraste të mëdha. Lartësia më e ulët mbi nivelin e detit është 296 m në bregun e liqenit të Fierzës, ndërkohë lartësia më e madhe është 1988 m në malin e Pashtrikut. Pyjet dhe kullotat zënë rreth 83.5 % të sipërfaqes dhe shtrihen në lartësitë mbi 1000-1200 m. Ato gjenden në bjeshkët e Krumës, Vranishtit, Gjinajve, Dajçit, Mujajve, Cahanit dhe Kishajve dhe përbëjnë një burim të qendrueshëm për zhvillimin e blegtorisë dhe turizmit malor.



Fig. - 4 Harta administrative, Bashkia Hasi

A) Situata demografike

Kruma, ku përfshihet qyteti dhe qendra e Bashkisë, ka një popullsi prej 6,606 banoresh, shifër e cila përfaqëson 36% të popullsisë së bashkisë dhe 7% të Qarkut Kukës. Kruma nuk është njësi më e madhe për nga sipërfaqja dhe numri i banorëve. Ai është fshati Golaj me 6,806 banorë. Tabela më poshtë tregon dendësinë (numri i personave për kilometër katror). Kështu, duket se Kruma është shumë më e populluar dhe madje me shumë diferencë administrative, fakt i pritshëm, duke pasur parasysh madhësinë e popullsisë dhe sipërfaqen shumë të vogël. Gjinaj, me vetëm 15.6 banorë për km^2 , është më pak e populluar. Duke marrë parasysh shkallën e urbanizimit të të gjithë territorit shqiptar, bazuar në një kategorizim modern, totali i Bashkisë renditet në zonat me popullsi të paktë nga njësitë e tjera.

Qendra e banuar	Banorë për km^2
KRUMË	83.7



FAJZË	49.6
GJINAJ	15.6
GOLAJ	33.6

Së pari, duhet theksuar se momentalisht në Shqipëri ka dy lloje burimesh që përdoren në lidhje me shifrat e popullsisë:

1. Të dhënat e popullsisë sipas Gjendjes Civile
2. Të dhënat e popullsisë sipas Censurit të vitit 2011

Bashkia	Njësitë administrative	Klasifikimi administrativ		Klasifikimi bazuar në rrjet	
		%urban	%rural	%urban	%rural
Has	Krumë	84	16	0	100
	Fajzë	0	100	0	100
	Gjinaj	0	100	0	100
	Golaj	0	100	0	100


Nga totali i popullsisë banuese, janë 49.75% meshkuj dhe 50.25% femra. Raporti gjinor është 1.01 dhe evidenton një dominancë të lehtë të femrave në krahasim me meshkujt. Me një popullsi totale prej 16 900 banorë ekzistuese të regjistruar në gjendjen civile, për bashkinë e Hasit parashikohet një rritje e vogël e popullsisë në vitet e ardhshme deri në 15%-20% të saj.

Kjo sepse shifrat ekzistuese të popullsisë së sotme nuk paraqesin personat që banojnë fizikisht në territor, kjo pasi një pjesë e mirë e tyre kanë migruar ose emigruar. Prurja e popullsisë është më e madhe në periudhën e verës dhe pranverës ku kryesisht emigrantët ritkehën në territor duke krijuar një rritje fiktive sezonale.



Lëvizjet dhe Projektioni i Popullsisë

Projektioni i popullsisë për periudhën e ardhshme është një domosdoshmëri për planifikimin e zhvillimit social-ekonomik të Bashkisë. Në vijim, do të paraqitet projektioni i popullsisë për 15 vitet



e ardhshme i bazuar në parametrat që parashikon INSTAT. Sipas studimit të INSTAT, në nivel kombëtar, popullsia e Shqipërisë është përfshirë, në këto 25 vite, në lëvizje të brendshme dhe ndërkombëtare në shkallë të gjerë dhe gjithashtu është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme numri i lindjeve. Efektet e kombinuara të lindshmërisë së ulët dhe largimeve në shkallë të gjerë, kryesisht të të rinjve, përsheptuan ritmin e moshimit të popullsisë dhe kjo vihet re në pothuajse të gjitha qarqet/bashkitë. Nga ana tjetër zhvillimet e viteve të fundit ku vendet e destinacionit të migrantëve shqiptarë (kryesisht Greqi dhe Itali) kanë qenë pjesë e recesionit ekonomik ka dhënë disa shenja të kthimit të emigrantëve, dhe e bëjnë edhe parashikimin e popullsisë pak më të vështirë sesa duke u bazuar thjesht në trendet e mëparshme.

Fig. - 5. Lëvizja e popullsisë gjatë periudhës 2001-2011. (Burimi: INSTAT 2014)

Emigrimi i të rinjve, rënia e lindshmërisë, si dhe vdekshmëria më e ulët që nga viti 1989, kanë zvogëluar peshën e brezave të rinj dhe kanë rritur atë të brezave më të vjetër në popullsinë e përgjithshme, duke çuar drejt një moshimi demografik.

INSTAT ka bërë një përlllogaritje të projektionit të popullsisë bazuar në 3 skenarë:

- 1- Skenari 1 – Vdekshmëri e Lartë, Lindshmëri e Ulët, Migrim i Lartë
- 2- Skenari 2 – Vdekshmëri e Mesme, Lindshmëri e Mesme, Migrim i mesëm
- 3- Skenari 3 – Vdekshmëri e Ulët, Lindshmëri e Ulët, Migrim i Ulët




Fig. – 6 Popullsia dhe norma e rritjes së saj në Shqipëri për periudhën 1923-2011

Konkluzione paraprake

- Struktura moshore e popullsisë së Bashkisë së Hasit tregon një potencial të madh përse i përket segmentit ekonomikisht aktiv të popullsisë (15-64 vjeç). Në kushtet e nxitjes së mundësive për punësim, ky segment ofron një motor të burimeve njerëzore që mund të shtyjë pozitivisht



zhvillimin ekonomik të Bashkisë. Bashkia duhet t'i përgjigjet këtij segmenti me politika që nxisin punësimin.

- Duke vlerësuar diferencat që ekzistojnë midis dy burimeve të ndryshme për popullsinë, sugjerohet që për efekt të planifikimit, të përdoret burimi i Gjendjes civile. Megjithatë, kur të diskutohen shpërndarje specifike shërbimesh (mbulim me shkolla apo me ambiente shëndetësore psh) duhen marrë parasysh edhe vlerësimet që vijnë përlllogaritjet e Censurit të INSTAT.

B) Situata urbane dhe informaliteti

Në hapësirën gjeografike të administruar nga bashkia Hasi gjenden të dy tipat e vendbanimeve, urbane dhe rurale. Qyteti sot ka një karakter urban, ndërkohë, njësitë administrative (më parë ish - komunitat) dhe fshatrat përbërëse të tyre kanë një territor 100% rural duke bërë që në to të mbizotërojnë sistemi bujqësor dhe ai natyror. Nga pikëpamja administrative bashkia Hasi ndahet në 4 njësi administrative përkatësisht:

- Njësia administrative Krumë e cila është dhe qendra administrative e bashkisë, si dhe e vetmja njësi që mund të konsiderohet me karakter urban.
- Njësia administrative Golaj është njësia territori i së cilës përbleh të gjithë pjesën veriore të bashkisë Has, si e tillë ajo zotëron pjesën më të madhe të kufirit me Kosovën dhe ka sipërfaqen më të madhe ndër njësitë përbërëse të bashkisë.
- Në kufij me Kukësin dhe Fushë Arrëzin në pjesën jug perëndimore ndodhet njësia Fajzë e cila ka në përbërje të saj gjashtë fshatra: Fshati Fajzë si qendër administrative e njësisë ndodhet në qendër të saj
- Edhe njësia administrative Gjinaj përbëhet nga gjashtë fshatra dhe zë pjesën juglindore të bashkisë Has

Në bashkinë e Hasit sot ekzistojnë disa tipologji interesante ndërtimesh.

Zona e Krumës, si qendra kryesore e banuar karakterizohet nga ndërtime të para viteve 90, të cilat janë të shpërndara në qendrën e qytetit, të shoqëruara me oborret e përbshkëta përkatëse për komunitetin e këtyre objekteve. Ato arrijnë një lartësi deri në 5 kate të vendosur në territorin me pak pjerrësi të qytetit.

Tipologji interesante e cila haset në disa zona të Hasit, kryesisht në fshatra, madje ato më shumë të abandonuar, janë tipologjitë e ndërtimit kullë, karakteristike e këtyre territoreve. Të ndërtuara me gur lokal, dritare të vogla dhe mure të trasha guri ato janë element shumë i rëndësishëm i definimit të zhvillimit tradicional të ndërtimit vendas. Sot shumica e tyre janë të braktisura por janë një potencial shumë me rëndësi në rihvillimin dhe rikonceptimin e tyre në formën e bujtinave lokale për rritjen e turizmit dhe të reklamimit të produkteve e territorit lokal të bashkisë. Në disa fshatra disa prej banorëve kanë filluar restaurimin e tyre, ndërkohë një pjesë e madhe e tyre për shkak të karakterisitkave të vecanta kanë marr status "Monument kulture të kategorisë së dytë ose të tretë"



Ndërtime të tjera që dominojnë territorin janë banimet 1-2-3 katëshe të ndërtuara pas viteve 90 dhe pas viteve 2000 ku banorët vëndas me ndihmën e familajrëve jashtë vendit kanë ndërtuar objekte të ulëta (sidmos në fshtra), në ndihmë të strehimit të tyre por dhe të punimit të tokës bujqësore që ato kanë në to.

Kërkesa për shërbime publike

Kërkesa për shërbime publike në Has është e theksuar pasi sot hasim zhvillimin e një rrjeti të konsoliduar të ujësjellës kanalizimeve vetëm në qendrën e banuar të Krumës. Kjo vlen edhe për pjesën e furnizimit me energji elektrike.

Pjesa tjetër e zonave të banuara ende furnizohet me linjat e vejtra elektrike, brume natyrore të afërta në lidhje me furnizimin me ujë dhe gropa septike për derdhjen e kanalizimeve.

Në kushte të tilla, zhvillimi i një infrastrukture të rregullt kërkon të bëhet në raport me zhvillimin e propozuar të territorit për të plotësuar nevojat e banimit dhe të popullsisë, që sado e vogël në rritje duhet të ketë akses në plotësimin e nevojave primare për jetesën e saj.

Kërkesa për infrastrukturës

Përsa i përket projekteve të infrastrukturës te transporti, përveç disa detyrimeve që burojnë nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar, projekte konkrete të tilla praktikisht mungojnë. Ndonëse sipas Kodit Rrugor, siç do e analizojmë më poshtë duhet të ishin bërë në vijimësi që mbas aprovimit të tij. Planet Urbane të Trafikut (PUT) dhe Planet Kombëtare të Trafikut (PKT) apo dhe Planet Urbane të Transportit (PUTr), nga të cilat mund të trashëgonim një “Kadastër të Rrjetit Rrugor” urban dhe kombëtar, mbi bazën e të cilës mund të planifikonim më mirë “Land use”, duke përdorur në çdo rast standartet e duhura. Bashkia Has ka fatin të jetë shumë pranë me rrugën Durrës-Kukës-Morinë. Një nga rrugët kryesore që lidhin bregun perëndimor të Shqipërisë me pjesën kontinentale lindore të vendit tonë dhe më tej me Kosovën. Gjithashtu në vijimësi të të njëjtit korridor në Kosovë, nëpërmjet Prishtinës lidhet me Korridorin X pan-europian. Përgjatë të njëjtës trajektore, PPK propozon shtrimin e një hekurudhe që nis nga qyteti i Rrëshenit dhe përfundon në Prizren. Një arterie shumë efektive në këmbimet tregëtare mes dy vendeve, por dhe një mundësi më shumë për transport pasagjerësh.

Të dhënat nga Bashkia Has tregojnë se rrjeti rrugor rural përbëhet nga 172 km, nga ku 12.5 km janë të asfaltuara dhe 159.9km janë me çakëll. Vitet e fundit infrastruktura rrugore ka pësuar ndryshime të rëndësishme, si rezultat i rikonstruksionit dhe asfaltimit të rrugës shtetërore Nr. 23 dhe të rrugës së Vlahnës me gjatësi 6km. Megjithatë, rrjeti rrugor rural që lidh fshatrat me rrugën shtetërore ose me qendrat e njësisë administrative, është në gjendje jo të mirë, i pa asfaltuar dhe me vështirësi kalimi gjatë stinës së dimrit.

Nevoja për rrugë të reja dhe përmirësimin apo zgjerimin të atyre ekzistuese është gjithmonë e pranishme në një qytet me synim zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimit për banorët e zonës prandaj nuk mund të bënte përjashtim dhe bashkia e Hasit. Duke parë situatën e mësipërme dhe duke marrë parasysh gjendjen në të cilën ndodhen rrugët ekzistuese, objektivi është që të mirëmbahen në mënyre optimale funksionale rrugët e asfaltuara duke marrë në konsideratë. Gjithashtu dhe gjetja e mundësive



financiare per asfaltimin e segmenteve të pashtuara dhe mirëmbajtja e tyre duhet të jetë një ndër prioritetet e qeverisjeve vendore për qarkullimin sa më të lirë të banorëve të zonës.




Fig. - 7 Harta e gjendjes ekzistuese të Sistemit Infrastruturor

C) Zhvillimi Social dhe Ekonomik

Hasi ka numrin më të vogël të bizneseve/1000 banorë në rajon (12 biznese/1000 banorë), ndërkohë Tropoja ka 23 dhe Kukësi 19. Sipas zyrës së tatimeve në Has ushtrojnë aktivitetin e tyre 167 subjekte private (142 persona fizikë dhe 25 persona juridikë) dhe 6 subjekte publike jo-buxhetore. Pjesa dërrmuese e subjekteve private janë njësi shërbimesh dhe pak janë njësi prodhues. 1 subjekte private veprojnë në fushën minerare. Për periudhën 2011-2014, të dhënat për kapacitetet financiare të ish-NJQV-ve tregojnë se ish- Bashkia Krumë ka pasur kapacitete financiare më të mira se të tre njësitë e tjera të marra së bashku. Ish-Komuna Gjinaj ka kapacitetin më të ulët financiar midis 4 njësive. Ndërkohë, kapacitetet e ish-Komunës Golaj nga viti 2011 e në vazhdim kanë qenë në përmirësim. Kapacitetet e ish-Komunës Fajza kanë pasur një përmirësim të vogël në vijim. Transfertat e pakushtëzuara për periudhën 2011-2014 kanë ardhur në rritje.

Zhvillimi ekonomik është i orientuar në bujqësi, blegtori dhe industri minerare, ndërsa ka potenciale në turizëm dhe në grumbullimin e bimëve mjekësore. Bujqësia është e organizuar në ferma të vogla



familjare. Rreth 28.8% e të punësuarve janë angazhuar në sektorin e bujqësisë. Të dhënat tregojnë se vetëm 55.45% e tokës bujqësore është ndarë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”, ndërsa pjesa tjetër është e pandarë (e uzurpuar nga pretendentët për pronarë). Kjo ka sjellë konflikte pronësie dhe është bërë faktor pengues për thithjen e investimeve private.

D) Infrastruktura dhe korridoret ekonomike

Duke qënë midis 2 poleve zhvillimi rajonal atij të-Kukës-Has-Tropojë dhe të Shkodër-Lezhë bashkia e Hasit do të përfitojë nga zhvillimet që parashikohen të ndodhin në këto rajone. Hasi për shkak të pozitës gjeografike që ka, është pjesë e dy nga polet kombëtare të zhvillimit, Poli i zhvillimit rajonal Shkodër - Lezhë, porta perendimore e rajonit malor verior dhe polit Kukës-Has-Tropojë. Poli i pare perbehet nga 5 bashki, ku bashkia Shkoder parashikohet si qendra kryesore, bashkia Lezhe si qender e specializuar dhe bashkite Vau i Dejes, Malesi e Madhe, Kurbin, jane qendra lokale. Bazuar ne te dhenat e INSTAT-it ne vitin 2001 ne rajon numeroheshin 344.213 banore, ndersa ne vitin 2011, 308.797 banore, duke shenuar nje pakesim te popullates me 10.3%. Gjithsej siperfaqja territoriale e tij eshte 310.093 ha dhe perbehet nga 37 njesi administrative. Si rezultat ky pol zhvillimi parashikohet të fuqizohet, sidomos në drejtim të infrastrukturës.

- Realizimi i gazifikimit të rajonit nëpërmjet lidhjes IAP - Kosovë.
- Aktivizimi i aeroportit të Kukësit përbën një potencial për këtë rajon dhe veriu e vëndit në tërësi, rajon me shkallë të lartë të emigrimit në vëndet e BE-së.
- Përmirësimi i infrastrukturës lidhëse mes qendrave Kukës-Has-Tropojë dhe në raport me qendrat kufitare në Kosovë, Prizren-Gjakovë-Pejë, e cila do të shkurtonte distancat e udhëtimit nëpër këto qendra dhe do të forconte dhe konkretizonte bashkëpunimin ndërkuftar mes tyre.
- Rigjenerimi i aksit Hasi-Tropojë.
- Krijimi i një poli ekonomik ndërkuftar midis zonave të Kukësit, Prizrenit dhe Gjakovës. Lehtësim i politikave të tarifave, praktikave të bashkëpunimit doganor dhe tatimor si edhe midis pushtetit vendor, pa burokraci, vonesa dhe pengesa, nga qeverisja në nivel qendror.

Drejtimet për ekonominë dhe infrastrukturën përfshijnë:

- Vlerësimin e zonave minerare dhe zhvillimin e industrisë minerare dhe përpunimit të mineraleve.
- Zhvillimin e turizmit me fokus zonat me prioritet turistik dhe vozitës përgjatë liqenit të Fierzës. Gjithashtu, pole dhe akse të zhvillimit turistik përbëjnë edhe ët natyrore, zonat e lumenjve ku është e dëshirueshme të funksionojnë si korridore të gjelbra - ekologjike dhe korridoret e çiklizmit.
- Përmirësimin e aksesit të qendrave lokale nga qendra e bashkisë me nyjet multimodale kombëtare.
- Ruajtjen e tokës bujqësore, zhvillimin e kulturave të specializuara dhe prodhimin e produkteve cilësore lokale.
- Trajtimi i burimeve të ndotjes të mjedisit dhe sidomos të ujërave.



E) Turizmi

Zhvillimi i turizmit në Has ka ecur me hapa të ngadaltë vitet e fundit dhe në raport me atë çka ofron Hasi mund të themi që është i zhvilluar pak. Pasuarja e madhe, përgjithësisht ajo natyrore, por edhe ajo kulturore dhe etnografike, që gëzon Hasi, i japin saj një potencial të jashtëzakonshëm turistik. Ndër atraksionet kryesore të kësaj bashkie mund të përmendim:

Gjeomonumentet

Bjeshkët e Krumës

Ofrojnë gjithashtu peizazhe të bukura, ajër të pastër dhe destinacion të favorshëm veror për banorët vendas. Potencialet turistike të zonës përfshijnë: Klimë të shëndetshme dhe bukuri natyrore. Destinacione pelegrinazhi Kullota të pasura Shpellat si dhe pamje natyrore dhe arkeologjike, ngjitje alpinistike në maje të Qytezes etj. Ngjitje në mal bëhet me makine nga Cahani ose në kembe e kafshe nga Kruma.

Shpella e Daçit

Shpella e Daçit (2600 PES—1200 PES) rreth 10 km në lindje të Krumës. Kjo shpellë gjendet në Lagjen Daç të fshatit Mujaj. Është një shpellë shumë karakteristike në llojin e vetë ajo daton që në kohë shumë të lashta nga gërmimet arkeologjike e kryera këtu tregojnë se kjo shpellë është banuar që në lashtësi dhe gjithë zona për rrethë ka tuma të ndryshme.

Shpella e Pellumbave (Shpella e Llapatanava)

Kjo shpellë ka marrë emrin e shpellës së Pellumbave (ose në të folmen e Hasit quhet shpella e Llapatanave sepse aty qëndrojnë shumë pellumba të eger në dimër dhe në verë), ajo shtrihet në vargmalin e Pashtrikut në kufirin mes fshatave Vlahen.

Pisha e Gjinit

Kjo ka një pamje shumë të bukur e cila është shumë karakteristike për zonën sepse e gjithë zona për rrethë është e zivëshur dhe e mbuluar me shkurre të vogla. Kjo pishë është si kurorë mes tyre dhe fshatit prej mëse një shekulli, ajo është dhe mes dy burimeve të cilat janë në mes të fshatit Gjinaj.

Burimet karakteristike.

Lumi i Krumes (Vrella) Në vendin ku buron ky lumë ka një pamje shumë të mahnitshme por për shkak të shfrytësimit të saj për ujë të pishem ajo e ka humbur shumë bukurinë. Por po të vazhdosh në rredhën e saj deri në lumin drin (Liqeni Firzes) ajo ka pamje shumë të bukura ku për gjatë gjithë rrjedhjes aty ka shumë pemë dhe veçanërisht arrat e saj karakteristike uji këtij lumi përdoret nga fermerët për vaditje të tokave bujqësore.

Monumentet kulturore:

Historia, kultura dhe traditat



EMËRTIMI	STATUSI	KATEGORIA	NËNKATEGORIA	NJ. ADMINISTRATIVE	BASHKIA	QARKU
BANESA E ALI DHE ADEM PAVDOJËS	Monument kulture i kategorise I	Turizmi i Kulturës	Trashëgimi/Arkitecture	Krumë	Has	Kukës
SHKOLLA DHE INTERNATI	Monument kulture i kategorise I	Turizmi i Kulturës	Trashëgimi/Arkitecture	Krumë	Has	Kukës

Mënyrat më të rëndësishme dhe traditat e banorëve të Hasit janë:

- Fjala e nderit (Besa), e rrënjosur thellë në etikën e popullsisë shqiptare, përfaqëson kodin e sjelljes së këtij vendi, sepse kjo tregon respektin absolut të pakteve dhe fjalës së dhënë.
- Ligji i Kanunit, kod i roman, për arsye të caktuara është vëzhguar në ditët e sotme, transmetohet brez pas brezi.
- Mikpritja familjare, e cila zakonisht pranon turistët në shtëpinë e tyre tradicionale të bërë me gurë mijëra vjeçarë, të ndërtuar për mbrojtje nga të ftohtët e dimrit.

Etnografia

Folklori koreografik i krahinës së Hasit përbëhet nga vallet, muzika, pantomimat, termat, elementet koreografike në lodrat dhe argëtimet popullore dhe etimologjia. Vallja ne Has, ashtu si në të gjithë vendin tonë, është pjesë përbërëse e jetës shpirtërore të popullit dhe një nga format e shprehjes së emocioneve dhe mendimeve të tij nga më të ndryshmet. Vallet praktikohen dhe sot e kësaj dite në raste festash dhe gëzimesh shoqërore e familjare.


Artizanati –Hasi trashëgon disa zanate, ndër të cilat më të njohura janë në vijim: Punimet me gur dhe dru.

Aktivitetet/sportet që mund të praktikohen:

- Spelologji

PËRFUNDIME PARAPRAKE

- Hasi është një vend i bukur dhe magjepsës. Ajo ka një gamë të gjerë atraksionesh historike, kulturore dhe natyrore, që përbëjnë një interes të madh për turistët ndërkombëtarë.
- Vendi është i sigurtë dhe njerëzit janë mikpritës dhe miqësorë. Ajo që është më e rëndësishme, vendi është ende “autentik”.
- Ai mbetet në një shkallë të madhe i paprekur nga ndikimi i huaj, ku njerëzit jetojnë dhe punojnë në mënyrat tradicionale në shumicën e vendit dhe kultura lokale shprehet në mënyra nga më të ndryshmet. Kombinimi i këtyre faktorëve e ben këtë vend të jetë i veçantë dhe vlera potenciale e tij për tregjet e turizmit ndërkombëtar është shumë e lartë.
- Puka në përgjithësi dhe Bashkia Hasit në veçanti nuk janë një destinacion turistik i lehtë për t’u kuptuar nga tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Zona ofron potenciale për dhjetëra aktivitete të ndryshme turizmi në dhjetëra destinacione. Në formë individuale, të gjitha janë interesante, por pak prej tyre janë të veçanta apo që ngjallin



mjaft admirim në vetvete për të tërhequr turistë vendas e ndërkombëtarë.

- Është kombinimi i saktë i aktiviteteve dhe destinacioneve brenda zonës ajo që ofron mundësitë më të mira për ndërtimin e një sektori të suksesshëm turizmi.
- Zona është komplekse. Kultura, historia, gjeografia dhe arkeologjia e tij janë magjepsëse, por të komplikuar dhe jo lehtësisht të mbërritëshme, madje edhe nga turistë të edukuar.
- Zbulimi i Hasit nëpërmjet atraksioneve të saja natyrore e kulturore është me interes kryesisht për turistët ndërkombëtarë të arsimuar, relativisht të pasur. Ky segment demografik shpenzon dukshëm më shumë, për produktet e turizmit që përfshijnë eksperiencë të reja të tilla si, edukimi, aventura dhe kultura.
- Në Has gjenden në një numër të madh qytetesh shumë përparësi të gatshme për zhvillimin e produkteve të turizmit, me strategji të ndryshme dhe plane për itinerare shumë ditore të bazuara në kulturën, historinë dhe natyrën e tyre.

Strategjitë e zhvillimit të turizmit

- zhvillimin e qëndrueshëm dhe zbatimin e parimit të qëndrueshmërisë në të gjitha nivelet,
- krijimin e strukturave institucionale në nivel qendror dhe lokal, të cilat garantojnë zbatimin e planeve dhe objektivave strategjike,
- hartimin apo rishikimin e planeve urbanistike të zonave me prioritet turizmin mbështetur në analiza të plota ekonomike, sociale-kulturore, mjedisore,
- zhvillimi i elementëve infrastrukturorë,
- arsimimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore në shërbim të turizmit,
- rritja e financimeve dhe gjetja e skemave rregullatore, në funksion të krijimit të mjediseve tërheqëse,
- rritja e financimeve për mbrojtjen dhe rruajtjen e vendeve me rëndësi natyrore dhe kulturore,
- angazhimi i sektorit publik/privat,
- marketingu dhe promovimi i turizmit brenda dhe jashtë vendit
- investimi në burime të ndryshme kritike njerëzore në mënyrë që sektori i turizmit të zhvillohet efektivisht
- telekomunikacioni dhe interneti janë një komponent i rëndësishëm dhe domosdoshmërisht në rritje për promovimin e sektorit të turizmit dhe komunikimin.



SEKSIONI 4 - PËRSHKRIMI I GJËNDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT

4.1 MJEDISI ATMOSFERIK

Shkaqet Kryesore të Ndotjes së Ajrit

Në përgjithësi shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit janë:

- aktivitetet industriale;
- mjetet automobilistike dhe sasia e trafikut në përgjithësi;
- pajisjet e ngrohjes nëpër ndërtesa.

Faktorët kryesor që ndikojnë në ndotjen e ajrit janë sektori i transportit dhe djegia për ngrohje që mbeten burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban. Kjo lidhet me numrin e madh të automjeteve që nuk plotësojnë standartet e shkarkimeve në ajër, cilësia e lëndës djegëse që përdorin, viti i prodhimit të tyre, si dhe përdorimi i automjeteve me motor pa konvertor katalitik, duke favorizuar rritjen e përmbajtjes së pluhurit, si dhe shkarkimet e gazta gjatë djegjes së karburantit. Gjithashtu, mos përdorimi i energjive alternative në banesat, panele diellore, mulli ere, gjeotermi, peleta, etj, kanë ndikimin e tyre në ndotjen e cilësisë së ajrit, sidomos në shkarkimin e pluhurave, blozave dhe dioksideve të karbonit e të azotit.

4.1.1 Ndotësit e Ajrit

Gjatë vitit 2014- 2015 janë ndërmarrë disa nisma ligjore që lidhen me cilësinë e ajrit të mjedisit dhe me sistemin e taksave për lëndët djegëse. VKM nr. 594, datë 10.09.2014, miratoi Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Ligjin nr. 162/2014, datë 04.12.2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit. Ky ligj përbën kornizën për mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe është bazuar në Direktivën 2008/50/EC dhe 2004/107/EC. Ligji hyn në fuqi në Dhjetor 2017. VKM nr 352/2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të, u miratua ne date 29.04.2015.

Dioksidi i squfurit

SO₂ është formuar nga oksidimi i squfurit dhe kryesisht nga djegia e lëndës djegëse me përmbajtje squfuri. Sektori i prodhimit të energjisë elektrike është burimi kryesor i SO₂. SO₂ gjithashtu mund të ndihmoj në formimin e grimcave dytësore sulfate dhe formimin e shiut acid. SO₂ është një ndotës që shkakton probleme serioze në shëndetin e popullatës si përkeqësimin e astmës si dhe redukton funksionin e mushkrive dhe irriton aparatit respiratorar. Kjo mund të shkaktojë dhimbje koke, shqetësim dhe ankth. SO₂ ndihmon në formimin e shiut acid, impaki i të cilit mund të jetë i dukshëm



duke shkaktuar dëmtimin e pyjeve dhe ekosistemin e liqeneve dhe lumenjve. Siç është përmendur dhe më lart SO₂ kalon në formën e shiut acid dhe në formën e grimcave të pluhurit duke ndikuar në mënyrë indirekte në shëndetin e popullatës dhe në ekosistem. Po ti referohemi dhe vlerave orare dhe ditore në asnjë nga stacionet nuk kemi tejkalim të standartit të BE-së.

Dioksidi i azotit, Nox

NO₂ është një ndotës që emetohet në atmosferë si rezultat i djegies së lëndës djegëse nga proceset industriale dhe sektori i transportit rrugor. NO₂ është grup gazesh i përbërë nga NO (Monoksidi i Azotit) dhe NO₂ (Dioksidi i Azotit). NO përbën pjesën më të madhe të emisioneve të NO₂ dhe ndihmon në formimin e ozonit dhe grimcave të pluhurit. NO₂ është i lidhur me efekte të padëshiruara në shëndet, ky mund të dëmtojë mëlçinë, mushkритë, shpërkën dhe gjakun. Ashtu si SO₂ dhe NO₂ ndikon në formimin e shiut acid dhe në eutrofikimin e tokës dhe ujit. Në qytetin e Hasiit burimi primar i oksidit nitror janë makinat, ndonëse po rritet edhe kontributi relativ nga banesat (ngrohja dhe ftohja). Niveli i kuq i NO₂ për një periudhë të caktuar si ajo në dimër tregon vlera mbi norma. Ky nivel i lart shpjegohet me arsye të ndryshme, si:

- Aktivitetin e përdorimit të druve të zjarrit për nevoja të banesave;
- mungesa e rrugëve ekologjike (biçikleta) dhe e trafikut urban me kors të dedikuar;
- rrjedhshmëria e ulët e tyre me bllokime në trafik;
- njësi shërbimi brenda qytetit me ndotje të caktuara apo emetime në ajër, të pa kontrolluara;
- qarkullimit të automjeteve të vjetra me emetime të larta gazrash, etj;
- mos përdorim të energjive alternative në banesat, si panele diellore, mulli ere, gjeotermi, peleta.

Grimcat e pluhurit (PM)

Grimcat e pluhurit janë një përzierje e aerosoleve (të ngurta ose të lëngëta) që përfshin një diapason të gjerë në madhësi dhe kompozime kimike. PM₁₀, PM_{2.5} i referohet grimcave me diameter 10 dhe 2.5 micrometer ose më të vogël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO₂, NO_x, NH₃ dhe NMVOC PM emetohen nga shumë burime antropogjenike si djegia e lëndës djegëse, ndërtime, pluhuri natyral pezull, etj. PM mund të shkaktojë dhe përkeqësojnë sëmundjet e zemrës dhe mushkrive, goditje në zemër dhe aritmi. PM mund të dëmtojë sistemin nervor qendror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojë kancer. Një nga rezultatet e ekspozimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme.

Niveli i lartë i PM₁₀

PM₁₀ – ose “particulate matter” është lënda e grimcuar e imët, me diametër grimcash më të vogël se 10µ (mikron, ose të mijtat e milimetrit). Niveli i kuq i PM₁₀ ekziston për rastet kur përdoren djegia e druve nëpër banesa. Ky nivel i lartë i përqendrimit të PM₁₀ mund të shpjegohet me arsye të ndryshme, si:

- Aktivitetin e përdorimit të druve të zjarrit për nevoja të banesave;
- mungesa e rrugëve ekologjike (bicikleta) dhe e trafikut urban me kors të dedikuar;



- rrjedhshmëria e ulët e tyre me bllokime në trafik;
- njësi shërbimi brenda qytetit me ndotje të caktuara apo emetime në ajër, të pa kontrolluara;
- qarkullimit të automjeteve të vjetra ose me emetime të larta gazrash, etj;
- mos përdorim të energjive alternative në banesat, si panele diellore,ulli ere, gjeotermi, peleta.

Në këto kushte dhe në këtë nivel të përqendrimit të PM10 qytetarët duhet të bëjnë kujdes, duke evituar përdorimet e drurëve për djegie të pastazhionuara, dhe përdorimin e tyre jo më pak se 3 vjet stazhionim.

Niveli i PM2.5

PM2.5 janë grimcat e pluhurit me diametër të barabarta dhe më të vogël se 2.5 mikron, ndryshe quhen dhe grimcat ultrafine. Këto grimca janë të rrezikshme për shëndetin e popullatës pasi depërtojnë thellë në mushkri duke shkaktuar probleme serioze të cilat të çojnë dhe në vdekje të parakohshme. PM2.5 – ose “particulate matter” është lënda e grimcuar e imët, me diametër grimcash më të vogël se 2.5µ (mikron, ose të mijtat e milimetrit). Niveli i PM2.5 tregon vlerën e lartë që i kalon 35 µg/m3. Në qytetin e Hasiit kjo vjen si rezultat i përdorimit të druve si lëndë djegëse për ngrohjen e banesave.

Gazrat me Efekt Serë

Shqipëria ka ratifikuar dokumentet e Konventës së Vjenës dhe Protokollit të Montrealit më 8 tetor 1999 dhe duke filluar prej 7 janarit 2000 është palë me to. Nga qenia palë në Konventën e Ozonit buron dhe detyrimi i Shqipërisë për raportimin e konsumit në vite të substancave ozonholluese, si dhe zbatimin e kuotave të caktuara nga Protokollit i Montrealit. Prej vitit 2001 Shqipëria ka planin kombëtar të ozonit, në të cilin përfshihet plani kombëtar i heqjes nga përdorimi i substancave që hollojnë shtresën e ozonit. Plani kombëtar u hartua nga Ministria e Mjedisit me asistencën e Agjencive Implementuese, UNEP-it dhe UNIDO-s. Për të realizuar planin kombëtar të ozonit dhe gjithë aktivitetet që janë parashikuar në të, është krijuar Njësia Kombëtare e Ozonit dhe Implementimit të Projekteve – National Ozone Projects Implementation Unit (NOPIU). Konsumet e substancave ozon holluese CFC (klorfluorkarboneve) dhe HCFC (hidrogjen flourklorkarboneve) sipas viteve të shprehura me Mton/vit, janë si më poshtë:

Tab.- Lendet ozonholluese ne vite (Burimi: Raport per Gjendjen e Mjedisit, 2011)

VITI	2006	2007	2008	2009	2010	2011
CFC	15.2	4.08	2.2	0	0	-
HCFC22	-	46.34	74.5	97.37	107.1	102.5
HCFC142	-	-	-	-	9.07	13.12
HCFC124	-	-	-	-	1.08	-



Ozoni i nivelit të ulët të troposferës nuk emetohet direkt në atmosferë, ai formohet si rezultat i zinxhirit të reaksioneve kimike me gazet pararendëse të emetuara në atmosferë si NO_x, CO, NMVOC dhe CH₄ në prani dhe të rrezatimit diellor. Niveli i lartë i ozonit mund të shkaktojë problem të shëndetit respirator duke zvogëluar funksionimin e mushkrive, përkeqësimin e astmës dhe sëmundje të tjera të mushkrive deri në vdekje të parakohshme. Ozoni gjithashtu është gaz me efekt serë duke kontribuar në ngrohjen e atmosferës.

Ky nivel flet për:



- prani të ndotësve të tjerë, të cilët së bashku me dritën e fortë të diellit rrisin përqendrimin e ozonit në atmosferë;
- prani të klorinave (tetrakloridi i karbonit, kloroformi metilen) të prodhuara nga njeriu si dhe ato klorfluorkarbonet (CFC) e prodhuara nga kondicionerët, halonet ose gazet e prodhuara nga frigoriferet;
- djegie të vegjetacionit për qëllime bujqësore ose dhe urbane;
- emisione të oksidit të nitrogjenit dhe e përbërësve organik volatil (motorrët e automobilëve si burimi kryesor i këtyre ndotësve).
- përqëndrim të lart të sulfateve dhe nitrateve, të cilat bien në formë shiu acid;
- me përqëndrim të lart të pluhurit, e blözës nga djegiet njerëzore, si komponente të formimit të smogut, ku zvogëlohet gradienti vertikal i temperaturës, sepse është prezent mbulesa konjektive e resë, që rezulton në një ndriçim më të madh dhe në një ngrohje të sipërfaqes.

Monoksidi i Karbonit

Monoksidi i Karbonit (CO) emetohet në atmosferë për shkak të djegies jo të plotë të lëndës djegëse. Burimet kryesor të shkarkimit të CO në ajër janë transporti rrugor, biznesi, shtëpitë dhe industria. CO hyn në reaksion me ndotësit e tjerë duke prodhuar ozonin e niveleve të ulëta të atmosferës. Monoksidi i karbonit (CO) është një ndotës që në nivele të larta mund të shkaktojë probleme në zemër dhe të dëmtojë sistemin nervor. Ky gjithashtu mund të shkaktojë dhimbje koke, marramendje dhe lodhje.

4.2 REKOMANDIME

1. Implementimi i Strategjisë për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, hartimi i planeve Kombëtare dhe Rajonale me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit.
2. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimeve me institucione përgjegjëse për:
 - a. Zvogëlimin e numrit të makinave nëpërmjet përmirësimit të transportit publik.
 - b. Menaxhimi i rrjetit rrugor dhe trafikut.
 - c. Promovimi i teknologjive të pastra të automjeteve
 - d. Promovimi i përdorimit të biçikletave
 - e. Kontrolli dhe përmirësimi i cilësisë së karburanteve
 - f. Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta, pastrimi dhe larja e rrugëve
3. Forcimin e kapaciteteve teknike për monitorimin e të gjitha llojeve të shkarkimeve në ajër në vendin tonë.



4. Ngritjen e kapaciteteve për modelim të shpërndarjes së ndotjes, hartimin e studimeve dhe analizave për gjendjen e ajrit.

4.3 MJEDISI AKUSTIK – ZHURMAT

Ndotja e ajrit mbetet një nga problemet mjedisore në Shqipëri. Në kompleksitetin e tij ndotja akustike nuk është vetëm një çështje personale, por ajo është një problem social i cili tejkalon nivelin e kontrollit nga individi. Kështu me gjithë dinamikën dhe vëmëndjen ndaj ndotjes nga zhurma, vëmë re se trendi i nivelit të zhurmave përgjatë viteve nuk rezulton me në koherencë me tendencat e reduktimit të nivelit sipas objektivave politikë dhe strategjike

4.4 KLIMA

Relievi në bashkinë Hasi është mjaft i copetuar dhe me kontraste morfologjike dhe kushte klimatike të ndryshme. Keto nën vecori e bëjnë që regjimi mujor apo vjetor, si për temperaturat dhe reshjet të jenë të ndryshueshme. Klima është e ashpër malore, me dimër të gjatë e të mbushur kryesisht me reshje bore dhe verë të shkurtër e të freskët. Temperaturat minimale dhe maksimale arrijnë në nivelet -10° Celcius (Janari) dhe rreth $20 - 22^{\circ}$ Celsius (Korriku). Sasia e reshjeve është kryesisht në formë dëbore, sidomos në zonat e thella rrethinat rurale, por duke përfshirë edhe qytetin, zona ka një dominim të përgjithshëm të reshjeve të borës. Dallohet për mikroklimat, përgjithësisht në luginat e zonës.




Fig. - 8 Harta e zonave dhe nënzonave klimatike (Burimi: Banka Botërore dhe UNDP, 2012)

 - Zona e studimit, Bashkia Hasi

Reshjet në vargjet e larta malore janë më të larta. Mesatarja vjetore është rreth 1900mm dhe deri në 2700mm në disa zonave veriore. Malet e larta në brendësi kanë më pak reshje (800-1100mm/vit), pastaj vijojnë tokat e larta të ndërmjetme dhe malet veriore. Më shumë se 70% e shirave vjetore bien në gjysmën e ftohtë të vitit, sidomos në tetor dhe nëntor. Vera është e thatë dhe në maj ka më pak shi. Reshjet e dëborës janë prezente gjatë tre muajve, dhe zgjasin pothuajse 130 ditë, atëherë kur ajo kalon trashësinë 1.5m dhe arrin 4-5m.

Ererat: Në klimën e kësaj zone një ndikim të madh përveç vendodhjes në një territor kodrinor – malor, kanë ererat detare dhe ato të veriut. Era jugore e cila deperton nepermjet grykes së lumit shpesh arrin në 40 m/sek ose rreth 150 km/h, duke u klasifikuar me ererat e rrembyeshme me pasojë shkatërruese për



bimesine e kultivuar te zones. Nga drejtimi veri-lindor e jug-lindor ererat jane me te rralla, per shkak te mbrojties nga malet.

Fig. - 9 Harta e shperndarjeve te reshjeve (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

 - Zona ne studim, Bashkia Hasit

Temperaturat: Nga studimi i te dhenave klimatike shume vjecare vihet re se ka rritje te lehte te tre elementeve te temperaturave: maksimale, mesatare mujore dhe absolute maksimale, sikurse edhe rrezatimi diellor ne keto 20 vitet e fundit. Edhe temperaturat minimale, si ato mesatare dhe absolute jane ne rritje te vogla si rrjedhoje e demtimeve te renda pyjeve nga prerjet pa kriter dhe djegieve te pyjeve fletore, kryesisht me shkurre e dushqe.

Skenarët e Ndryshimeve Klimaterike

Pas finalizimit fillestar dhe të dytë të Komunikimit Kombëtar të Konventës të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, Shqipëria ka filluar procesin për përgatitjen e Komunikimit të Tretë Kombëtar të UNFCCC, pjesë e të cilit do jenë edhe skenarët e mundshëm, si pasojë e ndryshimeve klimatike. Si rezultat i ndryshimit të temperaturës dhe regjimit të reshjeve, janë parashikuar ndikimet e mëposhtme:





Fig. - 10 Harta e diellëzimit të Shqipërisë (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

 - Zona ne studim, Bashkia Hasit

- Rritja e temperaturave minimale ditore më shumë se ato maksimale ka të ngjarë të ndodhë në të gjitha zonat e tokës
- Thatësira të shpeshta të gjata dhe me rrezik të madh zjarri janë të mundshme - Numri i ditëve me temperaturë mbi 35°C është parashikuar të rritet mesatarisht 10 ditë në vit deri 2100 si pasojë e kësaj, numri i valëve të nxehta dhe i ditëve me temperaturë të ftohtë janë parashikuar gjithashtu të rriten.

- Ditët e freskëta dhe valët e flohta janë shumë të mundshme të zvogëlohen. Dimërat e ngrohtë do të reduktojnë kërkesën e energjisë për ngrohje - Një rritje e numrit të ditëve me shira të rrëmbyeshëm që shkaktojnë përmbytje (rreth 3-5 ditë) deri në 2100. -Temperaturat e rritura të pranverës do të rrisin temperaturën e tokës, të mbjellat e verës në zonat e përshtashme do të zgjasin periudhën e rritjes. Zgjatja e periudhës së rritjes është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990.



Ndryshimet e parashikuara në regjimin e reshjeve

Të gjitha skenarët tregojnë një rënie të reshjeve vjetore në lidhje me 1990 për të gjitha horizontet kohore. Duke përgjithësuar rezultatet e tyre rezultojnë se reshjet vjetore kanë mundësi të ulen deri në -8,5% (nga -56,0 deri në 47,4%) në 2050; deri në -18,1% (nga -89,7% deri 94,0%) në 2100

Fig. - 11 Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me diell (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

- Zona në studim, Bashkia Hasit

Disa ndikime të përgjithshme

Si rezultat i ndryshimit të temperaturës dhe regjimit të reshjeve, janë parashikuar ndikimet e mëposhtme:

- Rritja e temperaturave minimale ditore më shumë se ato maksimale ka të ngjarë të ndodhë në të gjitha zonat e tokës ;
- Thatësira të shpeshta të gjata dhe me rrezik të madh zjarri janë të mundshme ;
- Numri i ditëve me temperaturë mbi 35°C është parashikuar të rritet mesatarisht 10 ditë në vit deri 2100. Si pasojë e kësaj, numri i valëve të nxehta dhe i ditëve me temperaturë të ftohtë janë parashikuar gjithashtu të rriten ;
- Ditët e freskëta dhe valët e flohta janë shumë të mundshme të zvogëlohen. Dimërat e ngrohtë do të reduktojnë kërkesën e energjisë për ngrohje ;
- Një rritje e numrit të ditëve me shira të rrëmbyeshëm që shkaktojnë përmbytje deri në 2100 ;
- Temperaturat e rritura të pranverës do të rrisin temperaturën e tokës, të mbjellat e verës në zonat e përshtatshme do të zgjasin periudhën e rritjes. Zgjatja e periudhës së rritjes është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990 ;
- Si rezultat i reduktimit të reshjeve totale vjetore, zonat breglumore mund të përjetojnë një rënie të përgjithshme. Kërkesa për ujë mund të rritet, veçanërisht në verë;
- Deri në vitin 2100 kushtet që do të jenë më të mira për turistët do të zgjerohen. Në verë kushtet do të ndryshojnë nga idealia në të shkëlqyeshme.

Ngjarje të Pazakonta Klimatike

Ndër dukuritë e pazakonta klimatike bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me regjimin e reshjeve. Shqipëria, si vend me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një regjim i çrregullt i reshjeve nga pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%). Çrregullsia e reshjeve vihet re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike. Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin me ngjarje jo të zakonshme si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmytje apo mungesa e theksuar e reshjeve që sjell thatësira të zgjatura. Këto ndryshime të klimës do të ndikojnë edhe në rezervat ujore duke shkaktuar:

- Zvogëlim të rrjedhjes së ujërave sipërfaqësorë gjatë thatësirës së verës, veçanërisht në zonat jugore të Shqipërisë me 2% deri në 2030 dhe 5% deri në 2100;
- Keqësim të problemeve të ujit, veçanërisht atij të pijshëm, si gjatë stinës së verës për shkak të pakësimit të reshjeve, ashtu edhe gjatë vjeshtës për shkak të rritjes së turbullirës së ujit;
- Rritje e evapotranspirationit për shkak të rritjes së temperaturës duke sjellë dhe zvogëlim të sasisë totale të ujit.

4.5 NDËRTIMI GJEOLOGJIK

STRATIGRAFIA

Rajoni i Bashkisë së Krumës është pjesë përbërëse e Albanideve. Tiparet themelore të gjeologjisë së Bashkisë së Krumës janë të lidhura me pozicionin e Albanideve, me brezin Alpin Mesdhetar si dhe me zhvillimet evolucionare të trevave të tjera fqinje. Përshkrimin e stratigrafisë së territorit të Bashkisë së Krumës do ta paraqesim bazuar në zonat tektonike të cilat takohen në të.

Formacioni gabro-plagiogranitik i Trokusit

Përbëhet nga gabrot, grandioritet e plagiogranitet. Këto lloje perfaqesojnë një unitet shkëmbor, me kalime graduale tek njëri tjetri. Me formacionin sedimentaro-vullkanogjen, ai formon marrëdhënie intruzivë, ndërsa me formacionin vullkano-sedimentar ka marrëdhënie të ftohta. Formacioni vullkano-sedimentar Rupe-Sylbicë. Edhe ky formacion, sipas mbizotërimit të llojeve shkëmbore, është ndarë në disa pako.

Formacioni konglomerato-ranor-kuarcor Kershii i Vujkut-Qafa e Ali Çelës

Evidentohet i vendosur edhe mbi pjesë të formacionit vullkano-sedimentar të Permianit dhe dokumenton tektogjenezën paleozoike. Sipas litologjisë, duket ngjashmëri me serinë "Verrukano" në Itali e suitën "Luma" në Shqipëri, moshë e të cilave pranohet si Permian deri në Triasik i poshtëm.

Zona e Korabit

Është zona më lindore e Shqipërisë. Ajo karakterizohet nga përhapje e gjerë e formacioneve të Paleozoikut të poshtëm dhe të Permo-Triasikut të poshtëm, si dhe të formacioneve pelagjike Triasike e Jurasike. Në drejtimin perëndimor, zona e Korabit kufizohet me nënzonën e Gjallicës të zonës së Mirditës.

Prerja sedimentare

Në zonën e Korabit, nga perëndimi në lindje, veçohen 2 nënzona: Nënzona e Muhurr-Çajës, Nënzona e Kollovozit.

Nënzona e Muhurr-Çajës

Përhapet gjerësisht nga lugina e lumit Luma në veri, deri në Muhurr dhe Bllacë në jug. Në perëndim, sikurse përmendem nënzona e Muhurr-Çajës kufizohet me nënzonën e Gjallicës. Ky kufi kalon pranë fshatrave Belë e Lojme në veri, vazhdon në drejtimin jugor pranë Buzëmadhes, Lusnës e Draç Reçit dhe akoma më në jug, në jugperëndim të Fushë Muhurrit, etj.

Nënzona e Kollovozit

Është nënzona më lindore e Shqipërisë me marrëdhënie të qarta branisëse me nënzonën e Muhurr-Çajës në perëndim dhe M. Korabit në jug. Balli i branisjes së saj mbi dy nënzonat e mësipërme shpreh shumë qartë karakterin mbulesor të nënzonës. Kjo gjë dokumentohet dhe në dritaret tektonike të nënzonës së Muhurr Çajës, që zhvishen në përroin e Borjes dhe afër Shishtavecit, si dhe me klipet tektonike në rajonin e Vilës dhe Bushtricës. Nënzona e Kollovozit vazhdon gjerësisht në lindje të kufirit shtetëror.




Fig. - 12 Depozitime të O-D në prerjen e Kollovozit.

1-Vullkanite bazike; 2- rreshpe të zeza dhe gëlqerorë me scyphocrinites; 3- rreshpe alevrolitike me shtresa ranorësh e kuarcitesh; 4- kuarcite e ranorë me ngjyrë hiri të çelur e të bardhë; 5- rreshpe argjilore e argjilo-silicore; 6- rreshpe argjilore, kloritike, tufike e tufe; 7- në bazament vullkanite e më lart ignimbrite.

Depozitimet e Ordovikian-Silurianit

Ndërtohen nga ranore e kuarcite e me shtresa të kuarciteve e metakuarciteve. Me këto depozitime lidhen mineralizimet metamorfike të kuarciteve dhe shtresa tufitesh të blerta, acide, takohen ignimbritet me diabaze me llava aglomeratike, ranorët kuarc-sericitike, me shtresa të holla të rreshpeve klorit-sericitike, me shtresa të kuarciteve masive (fig.I. 3). Ranorët e Shtrezit, në disa nivele përmbajnë përqendrime të rutilit, zirkonit, sfenit dhe monacitit. Në nivelet e mësipërme, takohen ranorë, metakuarcite, mbi të cilin vendoset xeherori i hekurit sllikat.




Fig. - 13 Prerje gjeologjike skematike e njesisë së Kollovozit në sektorin Resk-Shishtavec.
 1-Monconit-sienite; 2-depozitime të T1-2; 3-konglomeratë-ranorë të P-T1; 4-depozitime flişoidale të O-D; 5-kuarcite të O-D; 6-prishje shkëputëse.

Depozitimet e Permian-Triaskut

Përfaqësohen kryesisht nga konglomeratë-ranorë të kuqërremtë "Luma", të facies epikontinentale, ndërkohë që në pjesën lindorë të nënzonës së Muhur-Çajës përfaqësohen nga konglomeratë-ranorë të gjelbër me thjerrëza gëlqerorësh pelagjike. Mes ranorëve, jo rrallë, takohen shkrifërime hematitike me ngjyrë të zezë. Depozitimet e Triasikut takohen në rajonet e Kollovozit dhe Çajës (Rrethi i Kukësit) dhe përfaqësohen nga formime me pamje flişoidale ranoro-karbonatike, ranore me ndërshtresa karbonatike, gëlqerorë dhe rreshpe me vullkanite, nga një formacion vullkano-sedimentar me bazalte, andezite dhe dacite ndërthurur me shiste e silicorë dhe në pjesën e sipërme gëlqerorë pllakorë me silicorë dhe gëlqerorë shtresë mesëm- trashë dhe rreshpe karbonatike, nga gëlqerorë dolomitikë rozë, gëlqerorë nyjorë me ammonite, në disa sektorë vullkanite, silicorë radiolaritikë etj.

Depozitimet jurasike- dalin në sektorin e Çajës dhe përbëhen nga: silicorë radiolaritikë, argjilite me copa ranore, stralle, rrallë gëlqerorë dhe ofikalcite. Kanë përhapje të kufizuar sidomos.

Prerja magmatikë

Shkëmbinjtë e kësaj zonë në rajonin e Kukësit janë pranuar të moshës paleozoike dhe të moshës mesozoike. Shkëmbinjtë me moshë paleozoike takohen kryesisht në njësinë e Kollovozit e më pak të Çajës, në krahinat e Gores dhe të Lumes. Përfaqësohen nga lloje të shumta shkëmbinjsh kryesisht vullkanikë e më pak intruzivë dhe dajkorë të natyrës bazike dhe acide si ignimbritet-porfirë kuarcore, ortofire dhe dalje të vogla gabrodiabazesh, diabazesh, porfirite diabazike, spilite, mikrolitike etj.

Triasiku i mesëm-Jurasiku i mesëm (T₂-J²)

Gabro diabazet subvullkanike takohen në Nimçe, Sarokol e Terfonje e të tjera. Janë trupa damarore pajtues me shkëmbinjtë rrethues dhe kanë shkaktuar dhe gurbrinorizime.

Magmatizmi triasik

Shkëmbinjtë magmatikë triasike përfaqësohen me facie vullkanike të Triasikut të poshtëm, të vendosura mbi konglomeratet e serisë Luma në ranorët e Verfenianit. Ky magmatizëm përfaqësohet nga derdhje bazike si diabaze, gabrodiabaze, porfirite diabazike etj. Dalje të tyre takohen në Belë, Gryka e Vanave, Lojme, Nimçe, Brekije, Tërshenë, Limth, Belesh, Skavicë e deri në Tej Drinë etj. Si magmatizëm triasik, nga autore të ndryshëm konsiderohen edhe dalje të vogla mjaft interesante të përbërjes acide-alkalinore-tufe liparitike dhe porfire kuarcore. Këto takohen në trajte trupash

Kernaje- Markaj-Fierzë-Porav, ndërsa në pjesën lindore kjo prerje zhvillohet nga Morini-Gjegjani, Bardhoci, Pobregu, Aliaj deri në Arren. Shkëmbinjtë sedimentare dhe vullkano-sedimentare vendosen në bazamentin e ofioliteve në skajet kontinentale siç është treguar dhe në paraqitjet e tjera. Duhet theksuar se një pjese e mire në të dy daljet e kësaj serie si në lindje dhe në perëndim janë të mbuluara me shkëmbinj ofiolitike.

Prerja e depozitimeve karbonatike të Kretakut të poshtëm e të sipërm

Depozitimet kretake në zonën Mirdita ndeshen në trajtë sinklinalësh dhe monoklinalësh të vendosura në përgjithësi me mospajtim mbi ofiolitet dhe mbulesën e tyre, më rrallë ato takohen edhe mbi karbonatet në buzët kontinentale (Peza L.H., etj. 1981, 1985, Kodra, Gjata 1982, Shehu R., etj. 1990, Marku D.). Si rrjedhojë i relievit parakretak shumë të aksidentuar, vërehen dhe diferenca të theksuara qoftë përta i takon kohës së mbulimit të sektorëve të ndryshëm nga këto depozitime, qoftë dhe përta i përket përbërjes faciale të tyre. Kjo prerje zhvillohet në rajonin e Hasit (nga Vlahna në Cahan, Kishaj, Zahrisht, Gjinaj deri në Morinë) (fig. 2-a), si dhe në Gjegjan, Myç Mamëz, Trull Surroj, Aliaj, Qafë Benë, Arrën e deri në Verri. Prerja e mësipërme përfaqësohet nga depozitimet e moshës të Kretakut të poshtëm dhe të sipërm me një përshkrim të shkurtër si vijon:



4.6 DEPOZITIMET E REJA PLIO-KUATERNARE

Plioceni (N₂)- Depozitimet pliocenike përhapjen më të madhe e kanë në gropat e brendshme, ku ato përfshijnë gjithë formimet kontinentale në rajonet e Tropojës, Hasit dhe Kukësit. Në gropën e Tropojës, depozitimet pliocenike dalin në sipërfaqe sidomos në pjesën verilindore dhe lindore të saj, si dhe në Tpla. Në pjesën e poshtme, prerja përfaqësohet nga ranore kokërrtraste e kokërrmesëm e argjila me ngjyre të kuqërremta (rreth 10-12 m) dhe lart kalon në një seri të fuqishme (260-270 m) diatomitësh e argjilash diatomike me dy nivele qymyrbajtëse (qymyre të dobëta e argjila qymyrore).

Kuaternari (Q)- Depozitimet e Kuaternarit takohen në gropat e rajonit të Tropojës, Hasit dhe Kukësit, në luginat lumore dhe në shpatet lumore dhe malore të këtij rajoni. Ato përfaqësohen nga depozitimet aluviale, proluviale, koluviale, deluviale, akullnajore, kënetore, liqenore. Në disa raste, ato janë të ndërthurura me njëra tjetrën dhe formojnë tipe gjenetike të përziera. Ndërmjet depozitimeve kuaternare, veçohen: depozitimet e Pliocenit të Sipërm-Kuaternarit të vjetër, depozitimet e Kuaternarit të poshtëm, të mesëm, dhe të sipërm (seksioni i pl

Plioceni i sipërm-Kuaternari i poshtëm (N₂-Q₁). Depozitimet e Pliocenit të sipërm-Kuaternarit, i përkasin facies liqenore, liqenore-proluviale e liqenore- aluviale. Ato takohen në mbulesën kuaternare të re në gropat e Tropojës, Krumës dhe Kukësit. Në Tropojë, Berishë, Krumë dhe Kukës, këto depozitime vendosen gati horizontalisht mbi ofiolitet dhe mbi gëlqerorët mesozoike dhe në pjesën e poshtme përfaqësohen nga konglomerate me zaje e popla shkëmbinjsh ofiolitike e gëlqerorësh që doradores kalojnë në mikrokonglomeratë, ranorë e suargjila.

Kuaternari i poshtëm, i mesëm, i sipërm (i pandarë) (Q₁₋₃). Depozitimet e Kuaternarit të pandarë përfaqësohen nga depozitime aluviale që ndërtojnë pjesën akumulative të terracave, konuset e vjetra të



derdhjeve, brekçiet shpatore, formimet koluviale, formimet e përziera (proluviale, koluvialo-deluviale, deluvialo-proluviale), formimet akullnajore, formimet liqenore-aluviale, liqenore-proluviale.

Kuaternar i sotëm (Q₄) Seksioni holocenik- Depozitimet e Kuaternarit të sotëm kanë përhapje të madhe. Zhvillim më të madh kanë depozitimet aluviale. Shumica e lumenjve, në rrjedhjen e mesme dhe të poshtme të tyre, duke meandruar dhe duke ndërruar shpesh shtratin e tyre, kanë formuar fusha të tëra aluviale. Edhe gjatë rrjedhjes së tyre të mesme kanë formuar tarraca, zallishte dhe shtretër të gjere të mbushur me aluvione (zhavorre, rëra, surëra, suargjila) etj., të cilat janë një pasuri e rëndësishme për materiale ndërtimi, si ato të Lumit Drin, Valbonë, Tropojë, Krumë, Lumi i Vanave, tek Ura e Uzinës e të tjera.

Magmatizmi- Shkëmbinjtë magmatikë përfaqësohen nga shkëmbinj plutonikë dhe vullkanikë. Shkëmbinjtë plutonikë përbejnë formacionin gabro-plagjiogranitik të Trisaikut me një sipërfaqe prej 25-50 km², në të cilët gabrot zënë rreth 1 km². Këto lloje shkëmbore përfaqësohen nga gabrot, dioritet, granodioritet, plagjiogranitet dhe granitet. Sipas përbërjeve kimike paraqiten me natyrë subalkalinore e me prirje paksa alkaline. Shkëmbinjtë vullkanike janë takuar në dy formacionet e rajonit të Gashit, në atë sedimentaro-vullkanogjen dhe në atë vullkano-sedimentar, duke zënë respektivisht sipërfaqet 0.2 km² dhe 58 km². Këto lloje shkëmbore rezultojnë, dacite, andezite, nefelinite, bazalt-pikritik-toelitik dhe bazalte shumë aluminore.

Tektonika- Bashkia e Hasit, si pjese e territorit Shqiptar bën pjese në brezin e rrudhosur Alpin Mesdhetar, në harkun Dinarido-Albanido-Helenid. Rajoni i Bashkisë së Krumës bën pjesë në zonat tektonike të Korabit, Mirditës, Gashit, Alpeve Shqiptare dhe Krasta Cukalit.

Përfundime-Në rajonin e Bashkisë së Krumës kemi të zhvilluar këto zona sipas dy grupime themelore: Albanide të Brendshme (zonat Mirdita, Korabi dhe Gashi) dhe Albanide të Jashtme (zona e Alpeve Shqiptare, Valbonës dhe n/zona e Cukalit)







Fig. – 15 HARTA GJEOLGJIKE E QARKUT KUKËS

Zona në studim, Bashkia Krumë





Kufij gjeologjikë

- Kufi gjeologjik normal
- - - Kufi gjeologjik me pushim
- ==== Kufi gjeologjik mospajties
- Kufi gjeologjik ndërmjet shkëmbinjve magmatike të një formacioni
- Kufi tektonike afrovertikal
- Kufi tektonike mbihyqes
- Kufi tektonike të mbihyqjeve dhe mbulesave para kretake
- ▲▲ Kufi tektonik mbulesor
- Kufije të rreshtqijeve dhe billoqeve gravitative

Elementet e rënies

- ▲▲ Elemente të shtruarjes së shkëmbinjve: a) normale, b) të përmbysura
- ▲▲ Element i folacionit

- N₁-Q₀** Pliocen-Pleistocen i Poshtëm. Konglomerate, ranorë dhe argjila.
- C₁** Kretak i Sipërm. Gëlqerorë me rudatë dhe gëlqerorë të dolomitizuar në zonën e Mirditës; gëlqerorë shtresorë dhe pllakorë biomikritikë me globotunkana, gëlqerorë turbiditë dhe silicorë në zonën Krasta-Cukali.
- C₂** Kretak i Poshtëm. Fish gëlqeroro-argjiloro-mergelore në nenzonën e Krastës dhe gëlqerorë konglomeratikë e konglomerate në zonën e Mirditës.
- J₁₂** Jurasik i Mesëm. Andezitobazalte, boninite, andezitodacite, nodacite, riolite.
- J₁₁** Jurasik i Mesëm. Intruzione ultramafike.
- J₂** Jurasik i Mesëm. Plageogranite, dionite kuarcore.
- J₃** Jurasik i Mesëm. Sekuencë mantelike kryesisht harzburgitike me ndërthurje të rafta dunitesh në pjesën e sipërme.
- T₁-J₁** Triasik i Mesëm-Jurasik i Poshtëm. Ofiolite, kryesisht formacioni vulkano-sedimentar.

Fig. – 16 Harta Gjeologjike, Krume



Harta skematike e formacioneve te pergjitheshme litologjike te Shqiperise




Fig-17 Harta e formacioneve litologjike



4.7 HIDROGJEOLOGJIA

Bashkia Krume ka shumë burime ujore disa prej të cilave janë mjaft të rëndësishme për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm. Kështu burime me prurje nga 0- 1 l/s janë 145, nga 1 deri në 10 l/s ujë ka rreth 90 burime, me prurje nga 10 deri në 100 l/s janë 25 burime, nga 100-1000 l/s 19 burime dhe mbi 1000 l/s janë 3 burime që shërbejnë për furnizimin e disa fshatrave, të Bashkisë Krume. Prandaj themi se si ujërat sipërfaqësore ashtu edhe ato nëntokësore, përbëjnë një pasuri të madhe për komunitetin që i shfrytëzon për të pirë apo për nevoja të tjera. Këto ujëra si një pasuri e dorës së parë për njeriun, në këtë qark mundësohen nga akuifere të tipeve të ndryshme si:




Fig. - 18 Sipërfaqet e akuiferëve sipas llojeve:

1. Akuiferë me porozitet ndërkokrrizor me ujëpërshkueshmëri mesatare deri të ulët 8%.
2. Akuiferë me porozitet poro-çarje me ujëpërshkueshmëri mesatare-të ulët 7%.
3. Akuiferë me porozitet çarjesh me ujëpërshkueshmëri të ndryshueshme mesatare deri të ulët 36%.
4. Akuiferë me porozitet çarje-karst me ujëpërshkueshmëri shumë të ndryshueshme nga shumë e lartë në shumë të ulët 28%.
5. Jo akuiferë 21%.
6. Akuiferë me porozitet poro-çarjesh me ujëpërshkueshmëri mesatare-të ulët.
7. Akuiferë të shkrifët me porozitet ndërkokrrizorë me ujëpërshkueshmëri mesatare deri të ulët. Akuiferë me porozitet çarje-karst me ujëpërshkueshmëri të ndryshueshme nga shumë e lartë deri shumë e ulët.
8. Akuiferë me porozitet çarjesh me ujëpërshkueshmëri të ndryshueshme mesatare deri të ulët.
9. Së fundi kemi edhe formacione shkëmbore të ashtuquajtura jo akuifer.



Fig. - 19 Zona ne studim, Bashkia Krumë





Fig. - 20. Rrisqet e vërshimit të ujit, erozioni dhe ndotja e lumenjve

Në vazhdim do ti trajtojmë të gjithë tipet e lartpërmendura më me hollësi. Bashkia përkohet nga disa perrenj që janë uniformisht të shpërndara nëpër territor, si dhe Lumi Krumes. Nga këta perrenj që kanë prurje relativisht konstante, fshataret marrin ujë për vaditje dhe përfitojnë për mbarshtimin e blegtorisë. Me pashtje po përmendim disa perrenj që janë me kryesoret.



- 1.Lumi Krumes qe kalon permes bashkise me burim ne qytetin Krume.
- 2.Perroi Ligates.
- 3.Perroi i Shirezes.
- 4.Perroi Shajezes.
- 5.Perroi Breshezes.
- 6.Perroi Kasnec.
- 7.Perroi Beres.
- 8.Perroi Derrit.
- 9.Lumi Vlahnes qe eshte mes bashkise dhe komunes Golaj.




Fig. - 21 Vrella e Krumes dhe Rezervuari Llates.

Ka edhe disa rezervuare ne funksion te bujqesise te cilet ja vlen ti permendim.

1. Rezervuari i Llates (Pla).
2. Rezervuari i Beres (Gajrep).

Nga sa shihet rrjeti hidrografik eshte i larmishem dhe i shumllojshem.

Akuifer të shkrifët me porozitet ndërkokrrizorë me ujëpërshkueshmëri mesatare deri të ulët. Janë depozitime të përziara aluvialo-proluviale me rëra, zhavore dhe alevrite si dhe depozitime aluvialo- proluvialo-liqenore me alevrite, rëra e zhavorre. Nga ky akuifer drenojnë mbi 40 burime por e theksojmë që në fillim se të gjitha burimet, sidomos ato me prurje të madhe mbi 1 l/s, ushqehen nga akuiferët karstikë karbonatikë të T1, T2, T3. Në teritorin e Krumes, këto burime që dalin në depozitimet e Qp-h dhe Qp, në fakt ushqehen dhe vijnë nga formacionet e T3-J1, T2-J1, S-D, dhe P-T me përfaqësues respektivë gëlqerorë me megalodonte, reshpe të zeza me graptolite dhe gravelite, ranorë, konglomerate e thjerza gëlqerorësh pra nga akuifer i tipit me porozitet çarje-karst. Ujërat kanë veti të mira fiziko-kimike dhe cilësi të mira për tu pirë. Nga ana hidrokimike këto ujëra për zonën janë të tipit hidrokimik HCO₃-Ca-Mg. Prurja e përgjithëshme



nga drenimi i ujërave të këtyre akuiferëve është rreth 3200 l/s. Sasia më e madhe nga kjo prurje (rreth 2800 l/s) i takojnë Luginës së Valbonës.

Akuiferë me porozitet poro-çarjesh me ujëpërshkueshmëri mesatare- të ulët

Përfaqësohen kryesisht prej depozitimeve të N2-Qp dhe N2 me përfaqësues respektivë konglomerate, ranorë, argjila dhe argjila, ranorë, gravelite, konglomerate etj. Më pak janë depozitime të T1-2 të përfaqësuar nga rreshpe, gëlqerorë, gëlqerorë amonitikë, vullkanite etj. Takohen edhe depozitime të T2-J1 që përfaqësohen me ofiolite të formacionit vullkanogjenosedimentar. Në përbërje të akuiferit shfaqen edhe depozitime të J2 të cilët përfaqësohen me lava jastëkore bazaltike dhe bazalto-andezitike. Teritori ku ky akuifer shfaqet më tepër është Kukësi dhe konkretisht fshatrat Skavicë, lugina e Lumit Luma, Nangë, Bicaj, lugina e lumit Sheje, prroi i Bisticës, Miç Mamëz, Shtiqen, Gjostil, Kënetë, Gjogjan e Bardhoc.

Akuifer me porozitet çarjesh me ujëpërshkueshmëri të ndryshueshme mesatare deri të ulët. Akuiferët me porozitet çarjesh nga pikpamja hidrogeologjike, bëjnë pjesë në akuiferët shkëmborë, ose siç njihen ndryshe si akuiferë të çarë apo të ndërprerë pra jo të vazhdueshëm. Kanë marrë këtë emërtim sepse në akuifer dallohen qartë dy mjedise me veti krejtësisht të ndryshme hidrogeologjike që janë vetë shkëmbi (dunit, peridotit etj.) që është i papërshkueshëm dhe ndërton pjesën më të madhe të mjedisit akuifer dhe çarjet me gjenezë të ndryshme formimi që përmbajnë ose lejojnë qarkullimin e ujërave nëtokësore nëpër to duke zënë një përqindje mjaft të ulët në volumin e përgjithshëm të akuiferit. Në këtë tip akuiferi, karakteristikat ujëmbajtëse të zonës ku lokalizohet burimi, nga sipërfaqja drejt thellësisë, përfaqësohet me dy zona hidrodinamike me veçori të ndryshme dhe konkretisht:

1. Zona e sipërme hidrodinamike
2. Zona e poshtme hidrodinamike.

Shkarkimet mesatare afatgjata në rrjet dhe ngarkesat ss (burimi: Poulos & Collins-2002, Pano -2004

Lumi	Ujëmbledhësit e rrjetit km ²	Shkarkimet e rrjetit m ³ /sek	Ngarkesa SS e rrjetit milion ton/vit
Drini	5973	218.0	6.1

Zona e sipërme hidrodinamike, shtrihet deri në thellësinë 10 apo 20m nën sipërfaqen e tokës. Në këtë zonë çarjet me origjinë tektonike dhe çarjet e krijuara nga erozioni, krijojnë një sistem hidraulik të lidhur mirë, që përmban ujëra nëtokësore pa presion. Sasia dhe regjimi i tyre është i lidhur drejtpërsëdrejti me kushtet klimatike. Drenimi i ujërave në këtë zonë bëhet në formë burimesh të vegjël, me regjim që ndryshon shumë dhe është në varësi të stinëve.



Zona e poshtme hidrodinamike lidhet kryesisht me shkëputjet tektonike të pasmineralizimit. Ujërat nëntokësore në thellësi të kësaj zone ushqehen gjithashtu nga reshjet atmosferike, të cilat përmes zonës së sipërme qarkullojnë nëpër çarjet me origjinë të ndryshme deri sa drenojnë në sipërfaqe me burime me prurje të ndryshme. Burimet kanë dalje në sipërfaqe edhe në kuota të larta. Faktorët kryesorë që kushtëzojnë ujëmbajtjen e akuiferit janë çarshmëria e shkëmbinjëve dhe shkëputjet tektonike të pasmineralizimit. Çarshmëria e shkëmbinjëve ka gjenezën e vet të formimit. Në akuifer takohen çarje që krijohen nga ftohja e magmës që në kohën e formimit të shkëmbinjëve si dhe çarje që krijohen nga veprimi i agjentëve atmosferikë. Ato të krijuara për efekt të ftohjes së magmës, janë të përhapura në zonë dhe përfaqësohen me tre sisteme çarjesh.

Shkëputjet tektonike të pasmineralizimit

Vërehet se predominojnë tektonikat me azimuth 0-70 gradë. Këndet e rënies së tektonikave natyrisht që ndryshojnë dhe variojnë nga 0-90 gradë. Materiali mbushës i tektonikave paraqitet kryesisht i imët (argjilë dhe ranorë i imët). Në thellësi prania e ujërave nëntokësore është e lidhur thuajse krejtësisht me shkëputjet tektonike. Duke u mbështetur në vrojtimit hidrogjeologjike, sidomos në minierat e kromit në vendin tonë, jo të gjitha tektonikat janë ujëmbajtëse. Materiali mbushës i rrafshëve të shkëputjeve tektonike, kur është i imët, në disa raste tapos të carat duke krijuar rezistencë për qarkullimin e ujërave nëntokësore duke ulur në këtë mënyrë vlerat e koeficientit të filtrimit, pra pakëson prurjen e ujit në këto plane. Raste të tilla janë të shumta dhe kjo lidhet me materialin shumë të imët të formuar nga agjentët atmosferikë që futen nëpër çarje gjatë infiltrimit të ujit në to. Zakonisht rezultojnë me ujëmbajtje më të lartë ato që kanë lidhje me zonën e sipërme hidrodinamike dhe kanë mundësi për magazinimin e ujit nëntokësor në to. Zhvillimi i rrafshëve tektonike me azimute dhe kënde rënie të ndryshme, si dhe zhvillimi i saj në kohë të ndryshme gjeologjike i kanë dhënë rajonit karakter tektonik bllokor. Një karakter i tillë i zhvillimit të tektonikës reflektohet me një komunikim hidraulik të vështirësuar për ujërat nëntokësore, veçanërisht në zonën e poshtëme hidrodinamike. Ky lloj akuiferi ka shtrirjen më të madhe në Bashkinë e Krumes. Akuiferi drenon përmes shume burimeve me prurje të përgjithëshme $Q=76$ l/s. Nga këto ka burime që janë me prurje nga 0.1-0.8 l/s. Siç shihet shumica dërmuese e burimeve kanë ujëmbajtje të vogël.



Fig. - 22 Golaj



Fig. - 23 Fajza



Akuiferë me porozitet çarje-karst me ujëpërshkueshmëri të përdhueshme nga shumë e lartë deri shumë e ulët.

Ky akuifer ka një shtrirje të konsiderueshme dhe zotëron rezervat më të mëdha ujore nga akuiferët e tjerë. Përbëhet nga: Depozitime të T3-J1 me përfaqësues gëlqerorë me megalodonte, gëlqerorë stromatolitikë, gëlqerorë dhe dolomite. Depozitime të T2-J2 të përfaqësuar nga gëlqerorë pllakorë me silicorë. Depozitime të T2I (Ladinian) të përfaqësuar nga gëlqerorë algorë, gëlqerorë me gastropodë e dolomite. Depozitime të T2-3 të përfaqësuar nga gëlqerorë të përzier me silicorë. Depozitime të Cr1 të përfaqësuar nga gëlqerorë argjilorë, gëlqerorë porcelanikë, konglomeratikë dhe silicorë. Depozitime të Cr2 të përfaqësuar nga gëlqerorë shtresorë dhe pllakorë biomikritikë me globotrunkana, gëlqerorë turbidikë dhe silicorë etj. Shtrirjen më të madhe ky akuifer e ka në territorin e Bashkisë Krume.



Fig. - 24 Gurra e Hasit (ujësjellës i Krumës) **Fig. - 25** Quku i Dunishës (ujësjellësi i B.Currit)

Jo akuiferët

Konsiderohen jo akuiferë të cilët nuk kanë porozitet të mjaftueshëm ndërkorrizorë apo çarje-karst të zhvilluar nëpër të cilët uji nëntokësor qarkullon me vështirësi. Në Bashkinë e Krumes, jo akuiferët zënë një sipërfaqe të konsiderueshme. Përfaqësohen nga formacione të moshave të ndryshme gjeologjike. Nga formacionet shkëmbore të këtyre jo akuiferi drenojnë burime me prurje nga 0.1 deri në 0.9 l/s. Ka burime me prurje nga 1-5 l/s, dy burime me nga 10 l/s secili, një burim me 15 l/s, një me 70 l/s, një me 100 l/s, një me 120 l/s dhe një burim të madh me rreth 600 l/s. Sasia e përgjithëshme e ujit të burimeve që drenojnë nga jo akuiferi është 991 l/s. Vetitë e tyre fiziko-kimike janë të mira dhe plotësojnë të gjithë parametrat për tu pirë. Nga ana hidrokimike ujërat janë të tipit $\text{HCO}_3\text{-Ca-SO}_4$.

Vlerësimi i resurseve dinamike të U.N. dhe shfrytëzimi i tyre.

Në Bashkinë Krume, përveç resurseve ujore sipërfaqësore, ka edhe resurse të ujërave nëntokësore të cilat shfaqen përmes burimeve të shumta. Resurset më të mëdha ujore i përkasin akuiferit me porozitet çarje-karst. Një pjesë e konsiderueshme e burimeve që drenojnë nga këto akuifer përdoret për furnizimin e popullsisë me ujë të pishëm siç tregohet në tabelë.

Tab. - 1 Resurset dinamike të U.N. të Qarkut Kukës dhe përdorimi për ujë të pijshëm.

Vendndodhja	Koordinatat (X)	Koordinatat(Y)	Sasia që shfrytëzohet (l/s)	Pika ujore
Ujësjellësi i Krumës			41	Burim

Presionet mbi akuiferët

Presionet mbi akuiferët e qarkut Kukës janë përqëndruar në:

- Kërkesën më të mëdhe për resurset ujore (turizmi dhe bujqësia) në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur disponibiliteti i resurseve të ujërave nëtokësore është më i ulëti;
- Rritjen e vazhdueshme e të pa pakontrolluar e të një numuri të madh shpimesh private për furnizim me ujë pijshëm dhe për vaditje(në zonat fushore).
- Ritmet e larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në 2 dekadat e fundit.

4.8 SISTEMI UJOR

Në lidhje me sistemin ujq PPK identifikon një sërë dobësish dhe problemesh që kanë të bëjnë me çështje si: (a) të menaxhimit, (b) të sasisë së burimeve ujore, (c) të cilësisë së burimeve ujore (d) ndotjes nga burime të ndryshme dhe përparon në rekomandimet përkatëse, si psh përdorim racional i ujit, kontroll të aktiviteteve ilegale, koordinim dhe bashkëpunim midis shërbimeve lokale, rajonale dhe qendrore, me synim për të përmirësuar kuadrin institucional në lidhje me monitorimin, menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave nëtokësore, duke përfshirë pusët, kontrollin dhe shfrytëzimin të ujërave të shiut, investime për kërkime dhe njohuri mbi burimet ujore. Propozimet kanë të bëjnë me:

- Miratimin e politikave të dendësimit urban.
- Krijimin e korridoreve natyrore të mbrojtjes përgjatë luginave të lumenjve.
- Përcaktim të vijës blu për mbrojtjen e zonave bregdetare nga përdorime të ndaluara, monitorimin e aktiviteteve dhe rigjenerimin e korridoreve natyrore
- Njohjen dhe mbrojtjen e vlerave të peizazhit natyror në të gjithë territorin kombëtar të vendit, që nga bregu deri në kreshtat e rajoneve malore.
- Mbrojtjen e basenit të Vjosës për shkak të karakteristikave të saj të veçanta: shkallën e lartë të ujëshmërisë, ndërtimin gjeologjik të formacioneve dhe larminë e peizazheve përgjatë luginës.








Fig. - 26 Njësitë vendore brenda dhe jashtë shoqërive U dhe UK

Fig.-27 Basenet ujore sipas pellgut ujëmbajtës e burimeve

Hasi bën pjesë në basenin ujëmbledhës të Drinit, ku një pjesë e liqenit të Fjerzës depëron në territorin e bashkisë, më saktësisht në pjesën perëndimore të tij. Kjo gjë mundëson shfrytëzimin e ujit të liqenit për vaditje në sektorin e buqësisë, për këtë pjesë. Ndërsa vaditja e tokave buqësore në pjesët e tjera të Hasis, behet me rezervuare artificiale të krijuar pasra viteve 90'. Të cilët janë të tipit kaskadë të dikruar nga terreni malor. Gjithsej janë 9 të tillë me kapacitete të ndryshme ujëmbledhëse, të shtrijë nga veri-perëndimi dhe vashdinë shpërmdahen drejt jugut të territorit të





Hasit.

Fig.-28 . Potencialet për shfrytëzimin e ujit në raport me nevojat për ujë të pishëm

Cilësia e baseneve dhe ujërave sipërfaqesore në territorin e bashkisë Has, janë kategorizuar si të këqija, që do të thotë që kemi të bëjmë me një ndotje të këtyre ujëravë dhe ku lind natyrshëm marrja e masave për evitimin e ndonjë ndotje mjedisore me pasojë për zonën. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e grumbullimit të mbetjeve që vijnë me prurjet e lumit drin nga kosova dhe maqedonija. Për këtë situatë madje është dhe një projekt i BE-së për pastrimin dhe mbrojtjen e ketij baseni nga ndotja e mundëshme ne vijimësi.






Fig. -29 Vlerësimi i vulnerabilitetit të ujërave nëntokësore

Për sa i përket ujërave nëntokësorë, në këtë territor ndodhen akuiferë porozë gjithë që sjell.... Ku paraqitet një nivel vulnerabiliteti i ulët dhe shumë i ulët në shkallën e rrezikut që shfaq zona për ndotjen ose dëmtimin e tyre. Hasi vlerësohet të ketë një potencial mesatarisht të ulët, në mundësinë e furnizimit me ujë të pishëm, gjithsesi nga harta vërejmë se te paktën gjysma e territorit të bashkisë Has është e mbuluar nga shërbimi i ujësjellësit. Një pikë e fortë për këtë bashki. Territori i bashkisë Has nuk njihet për rrezikshmëri në lidhje me përmbytjet apo erozionet, të paktën jo në masën që sjellin probleme për zonat e banuara, bujqësinë, etj. Megjithatë nga harta e vlerësimit të këtyre rreziqeve konstatohet që ato janë të lokalizuara përgjatë lumenjve që rrjedhin nga malet drejt liqenit të Fjerzes. Përgjatë të cilëve vërehen dhe zona të banuara që preken në raste katastrofash natyrore apo vërshime të pazakonta të ujërave dhe erozionit. Prandaj duhet të merren masa, duke vlerësuar rrezikun potencial rregullisht dhe duke hartuar projekte dhe vepra për mbrojtje nga to kur është e nevojshme.




Fig-31 Sistemi uhor ne Bashkine Krume



SHPJEGUESI

Njësitë hidrogeologjike

Akufier

Me porozitet ndërkorrizor



Akufier me porozitet ndërkorrizor dhe lëvizshmëritë mesatare - të ulët (argjila + rëra + shungjtë)

$10^{-2} - 10^{-1}$

Me porozitet poro - çarje



Akufier me porozitet poro - çarje dhe lëvizshmëritë mesatare - e ulët (rëra + argjila + konglomerate)

$10^{-2} - 10$

Me porozitet çarje - karst



Akufier me porozitet çarje - karst dhe lëvizshmëritë të larta - shumë e ulët (gëlqeror, dolomite)

$10^{-4} - 10^{-2}$

Me porozitet çarje



Akufier me porozitet çarje dhe lëvizshmëritë të ndryshueshme mesatare - e ulët (shkëmbinj magmatikë, metamorfikë)

$10^{-2} - 10^{-1}$

Jo akufier



Shkëmbinj pa porozitet të mjaftueshëm ndërkorrizor ose çarjeesh (argjila, ftoh, gjeo)

$< 10^{-1}$

Litologjia

Shkëmbinj të shkrifët

Sedimente



Argjila, rëra, zhevera

Shkëmbinj kompakt

Shkëmbinj Sedimentar



Argjila, rëra, konglomerate



Rëra, shungje, konglomerate, argjila dhe material i ndryshëm tepër



Rreshpe



Flot



Gëlqeror



Dolomite

Shkëmbinj Magmatik dhe Metamorfik



Intruziv ultrabazik



Intruziv bazik



Intruziv acid



Vulkanite



Konglomerate, rëra të metamorfuar

Ujërat sipërfaqësorë



Lumen



Lum



Ujëtarë



750

Infero i detit



Kull i zarrës me lartësi shumë të zhvilluar

Të dhëna gjeologjike



Kull gjeologjike rëndë



Kull gjeologjike me pishm



Kull gjeologjike mesatare



Kull tektonik shpirtëruar



Kull tektonik rëmbete



Kull tektonik rëmbetur



Kull të rrethuesve dhe bllozave gravitativë

Të dhëna topografike



Kulla të rrethuesve të detit



Zonë e banuar



Autostrada



Rrugë



Ferret



Izohete kryesore



Izohete ndërkësore

Të dhëna për burimet

Shumë të vegjël

Të vegjël

Mesatare

Të mëdhenj

Shumë të mëdhenj

< 1 l/s

1-10 l/s

10-10² l/s

10²-10³ l/s

$> 10^3$ l/s



Burime

Të dhëna për shpimet



Shpim në akufier me presion



Shpim në akufier pa presion

Të dhëna për ujërat nëntokësorë



Drejtimi i lëvizjes së ujërave nëntokësorë (i vërtetuar)



Drejtimi i lëvizjes së ujërave nëntokësorë (i supozuar)



Kull të spërfaqësve të ujërave me presion ose artizan

Vepra të ndërtuara për shfrytëzim ujërash nëntokësorë



Me prurje mesatare nën 10 l/s



Me prurje mesatare 10 - 100 l/s



Me prurje mesatare 100 - 1000 l/s



Me prurje mesatare mbi 1000 l/s


nuk është gjithmonë i garantuar. Aktivitetet çlodhëse janë të mundura vetëm në qoftë se kontakti me ujën ndodh për arsye të jashtëzakonshme. Ngjyra e tyre është e verdhë.

- **Klasa 3** - Cilësia e këtyre ujrave është mesatare, e aftë vetëm për ujitje, për ftohje dhe për lundrim. Në këto ujra mund të ekzistojë jeta e peshqve, por ajo mund të zhduket në periudhat e prurjeve të vogla dhe të temperaturave të larta. Ngjyra e tyre është e kuqe.
- **Jashtë klase** - Këto ujra i kalojnë vlerat maksimale të lejuar në klasën 3 të aftë për një ose disa parametra. Ato konsiderohen të papërshtatshme për pjesën më të madhe të përdorimeve dhe mund të përbëjnë një rrezik për shëndetin e njerëzve dhe për mjedisin. Ngjyra e tyre është e zezë.

4.10 TIPARET E RELIEVIT

Hasi shtrihet në mes gjerësive gjeografike veriore $42^{\circ}05'45$ nga fshati Brut dhe $42^{\circ}17'57$ në veri në majën e Krajlicës si dhe në gjatësinë gjeografike lindore $20^{\circ}13'11$ në Kosturr dhe $20^{\circ}32'50$ në majën e Pashtrikut në lindje. Ka një sipërfaqe prej 393 km^2 , gjatësia e vijës kufitare është 85.8 km , nga këta kufij tokësore 27.8 km me Hasin e Rrafshit, lumor 14 km me rrethin e Tropojës dhe 44 km kufij liqenor me rrethin e Kukësit. Relievi është i larmishëm si në aspektin morfologjik ashtu edhe në atë morfogjenetik. Në përbërje të tij dallohen kurrize malore, pllaja, gropa dhe lugina. Shumëllojshmëria e relievit lidhet me ndërtimin gjeologjik, sidomos me copëtimin e strukturave gjeologjike. Evolucionin e relievit të rajonit të Hasit ka kaluar në disa faza sheshimi. E para dhe më e hershme, përfaqësohet nga gëlqerorët e vendosur mbi hekur-nikelin ndërsa faza tjetër, ajo neogjenike, përfaqësohet nga pllaja e karstifikuar e Hasit dhe ujëndarësit (të butë e deri të sheshtë) mes gropave e luginave. Në modelimin e relievit një rol tepër të rëndësishëm kanë luajtur dhe lëvizjet diferencuese neotektonike me regjim dominues në tërheqje.

Relievi i zonës së Hasit (një nga bashkitë më të veçanta në zonën malore veri-lindore) ka një karakter të theksuar kodrinor dhe malor. Ai shquhet për një larmi formash morfologjike, tipesh gjenetikë dhe pjerrësi të mëdha të shpateve. Relievi dallohet për amplitudë të madhe hipsometrike (1721 m) dhe shtihet nga 268 m (pasqyra e liqenit të Fierzës) deri në 1989 m (mali i Pashtrikut). Lartësia mesatare është 662 m mbi nivelin e detit ndërsa lartësitë $400-800 \text{ m}$ mbi nivelin e detit zënë rreth 80% të rajonit. Nga këto të dhëna të hipsometrisë së rajonit rezulton se relievi ka karakter kryesisht kodrinor-malor. Relievi dallohet për vlera të mëdha të copëtimit horizontal nga 3 km/km^2 deri në 519 km/km^2 . Kjo lidhet drejtpërdrejt me mbizotërimin e shkëmbinjve ultrabazikë me shkallë të dobët përshkueshmërie si dhe me depozitimet pliokuaternare lehtësisht të gërryeshme dhe të kapura nga lëvizjet neotektonike ngritëse. Territorët me copëtim të vogël horizontal, $0,3-1 \text{ km/km}^2$, takohen në pllajën e Hasit dhe janë të ndërtuar nga formacione karbonatike. Vlerat e ulëta të copëtimit horizontal në këtë pjesë lidhen me zhvillimin intensiv të karstit që kushtëzon mungesën e rrjedhjeve sipërfaqësore. Territorët me copëtim horizontal, $1-3 \text{ km/km}^2$, shtrihen në pjesën veriperëndimore të rajonit, në fshatrat Kostur e Helshan, për shkak të ndërtimit nga formacione ultrabazike që kanë përshkueshmëri të dobët e që janë të copëtuara nga rrjedhjet



sipërfaqësore. Territoret me copëtim horizontal, 3-5km/km², takohen në grupën e Krumës për shkak të depozitimeve molasike dhe shtimit të rrjedhjeve sipërfaqësore, përroskave, pra përrenjve që derdhen ujërat e tyre në përroin e Krumës.

Relievi karstik shtrihet tërësisht në pllajën e Hasit, aty ku takohen forma të shumta karstike. Mbi tërë sipërfaqen e shkëmbinjve karbonatikë janë formuar disa forma karstike me përmasa të ndryshme, si fusha e madhe karstike në nivelin e sipërm, shpella, lapieze, uvala karstike. Format e relievit karstik të zhvilluara në pllajën e Hasit impresionojnë me kontrastet e theksuara të relievit sipërfaqësor, me botën e misterhme të boshllëqeve, me galeritë e labirinteve të shpellave të shumta nëntokësore dhe me rrjetin e varfër hidrografik. Në këtë rajon format e relievit karstik shfaqen nga më fillestaret (lapiezat, brazdat, ulluqet) e deri tek uvalat me përmasa të ndryshme. Këto të fundit ndahen mes tyre nga disa maja si ajo e Domajve (1355m), rrethi i Kasollës (1383m) dhe Maja e Qytezës (1440m).




Fig.33 – Harta fiziko-geografike e rajonit në studim

4.11 BIODIVERSITETI - FLORA DHE FAUNA

Koncepte të Përgjithshme

Sipas përditësimeve me Nëntor 2013 të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), 109 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme taksonomike janë konsideruar si të kërcënuara. Përveç kësaj, lista e llojeve të rrezikuara të bimëve në nivel kombëtar është shumë më e madhe, gjithsej 319 lloje, nga të cilat janë të rrezikuara në formë kritike 76 lloje, konsiderohen në rrezik 123 lloje dhe të përkeqësuar 120 lloje, të cilat përballen me një rrezik të lartë në kontekstin kombëtar. Kërcënimet kryesore ndaj biodiversitetit janë: zhvillimi industrial, urbanizimi, gjuetia ilegale, peshkimi, erozioni i tokës, energjia dhe minierat, transporti dhe turizmi, sektorë këto që kanë ndikim në shumëllojshmërinë biologjike. Aktivitetet antropogjene ku shpyllëzimi dhe shkretëtirëzimi i tokës së punueshme, aq sa shkatërrimi i livadheve dhe kullotave, kanë pasur një



ndikim të madh në ndryshimet e habitateve në të kaluarën e afërt. Ndërtimi i rrugëve dhe ndryshimet në rrjedhën e ujit ose ndërtimi i digave, ndërtimi i tubacioneve, ndotja që vjen nga origjina të ndryshme, zjarret, sëmundjet dhe ndryshimet klimatike janë arsyt e degradimit dhe fragmentimit të habitateve në Shqipëri. Mbrojtja e biodiversitetit mund të arrihet vetëm duke pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në sektorë që lidhen me biodiversitetin, të tilla si bujqësia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi. Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka arritur progres dhe ka bërë një investim të madh në mbrojtjen e ardhshme të pasurive unike natyrore dhe të peizazhit. Në përputhje me fushat kryesore të punës të identifikuar nga 2000 NBSAP, dhe gjithashtu si rezultat i Programit Kombëtar të Punës për Zonat e Mbrojtura (PKPZM) për periudhën 2006-2009, rrjeti i zonave të mbrojtur është zgjeruar. Që nga viti 1996 sipërfaqja e shpallur ligjërisht si zonë e mbrojtur në Shqipëri është më shumë se trefishuar (nga 108,475 ha në 378,748 ha), duke e çuar përqindjen totale të zonave të mbrojtura nga 5.7 % në vitin 2002 në 13.17 % në vitin 2011. Ky trend pozitiv shihet qartë në mënyrë të veçantë në përkufizimet ligjore të zonave të mbrojtura të cilat përkojnë me kategoritë e IUCN dhe së fundmi përfshijnë rreth 16% të sipërfaqes së vendit.

Një ndër objektivat më të rëndësishëm është “Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, i zonave dhe llojeve të mbrojtura, si dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe mjedisit në përputhje me angazhimet evropiane dhe ndërkombëtare. Bashkia Krume, ndonese eshte malor-kodrinor, ka pozicion gjeografik, reliev, vecori klimatike dhe faktore hidrologjike, gjeologjike e pedologjike qe favorizojne zhvillimin mjaft te madh e te shumellojshem te habitateve natyrore dhe te ekosistemeve komplekse malore qe ofrojne kushte per ekzistencen e shume lloje bimesh te larta ku vec te tjerash, spikatin mjaft lloje relike, endemike dhe subendemike. Mbrojtja e biodiversitetit është një ndër elementët kyç të zhvillimit të qëndrueshëm. Që nga viti 1999, është adoptuar Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (SPVB). SPVB është një dokument kyç që përcakton qëllimet, objektivat dhe masat që duhen marrë lidhur me menaxhimin e biodiversitetit në Shqipëri për periudhën kohore 2000 – 2015, gjë e cila reflektohet edhe në Strategjinë Kombëtare të Mjedisit. Qëllimet themelore të ruajtjes së biodiversitetit janë:

- Përfaqësimi i të gjithë zonave të dallueshme natyrore në rrjetin e zonave të mbrojtura dhe në peizazhet e ruajtura;
- Mirëmbajtja e proceseve evolutive dhe ekologjike që mundësojnë një Biodiversitet të qëndrueshëm.
- Ruajtja e specieve të llojeve të qëndrueshëm;
- Ruajtja e grupeve të habitateve të mëdha natyrore aq sa mund të jenë elastike në një shkallë të gjerë nga shqetësimet rastësore dhe ato afatgjate.
- Përmirësimi i menaxhimit të zonave dhe llojeve të mbrojtura ekzistuese duke u siguruar që objektivat e zonave janë përmbushur;

- Zgjerimin e rrejtit të zonave të mbrojtura për të siguruar një mbulim të plotë të të gjithave habitateve të detit, bregdetit dhe atyre tokësore;
- Përmirësimi dhe përshtatja e ligjeve ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit;
- Përmirësimi i informacionit dhe i të dhënave për menaxhimin e biodiversitetit.

Një game e gjerë aktiviteteve ndikojnë mbi biodiversitetin, për rrjedhojë një game po aq e gjerë masash duhet marrë. Për këtë arsye numri i masave që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave për mbrojtjen e biodiversitetit janë të përfshira në seksione të tjera të strategjisë ku bëjnë pjesë ndër të tjera edhe:

- Planifikimi i menaxhimit të shtratit të lumenjve- menaxhimi i burimeve ujore;
- Përdorimi dhe ndotja e ujit- menaxhimi i burimeve ujore;
- Planifikimi i kufizimeve të përdorimit të tokës dhe – peizazhit;
- Menaxhimi i vend grumbullimit të mbetjeve - Menaxhimi i mbetjeve urbane

Integrimi i konsideratave dhe i prioriteteve të biodiversitetit është i rëndësishëm për këto zona. Prandaj një vëmendje e veçantë i është kushtuar azhurnimit dhe mbështetjes së iniciativave të mëparshme të integrimit të lëna pas dore. Janë të nevojshme të merren shtatë masat e mëposhtme në tabelë:

Tabela. – 1 Masat përparësore për mbrojtjen e Biodiversitetit

	Përshkrimi i Masave	Masat kryesore përparësore publike
1	Forcimi i Kuadrit Ligjor për Mbrojtjen e Natyrës	Përmirësimet afat-shkurtra të legjislacionit për mbrojtjen e natyrës; zbatimi i Ligjit të Biodiversitetit duke përfshirë trajnimin e Qyteteve, Zbatimi i Direktivës së Zogjve (2008-2009)
2	Forcimi i Menaxhimit të Administratave të Mbrojtjes së Natyrës	Forcimi i Llogorasë, Divjakës, Lurës, Dajt, Hotova. Menaxhimi i Zonave të mbrojtura (2009)
3	Zhvillimi i Planeve të Menaxhimit për të gjitha Zonat e Mbrojtura	Është menduar që të gjitha vendet të cilat janë përcaktuar para fundit të vitit 2012 do të kenë plane të menaxhimit të plotë deri në fund të 2015.
4	Rritja e Menaxhimit të Specieve të Mbrojtura	Forcimi i Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit (2010), Ndërmarrja e fushatës për të zvogëluar numrin e armëve të zjarrit pa leje
5	Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur dhe Specieve	Sigurimi i objektivave për menaxhimin e zonës së mbrojtur janë përfshirë si kritere kyç në udhëzuesin shëndetësor të MM.
6	Integrimi i objektivave të Strategjisë së Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit në politikën e Shtetit	Sigurimin që udhëzuesi përmbledhës i instruksioneve të MMP&AU për Ministrinë kryesore të asistojë për integrimin e objektivave të biodiversitetit në sektorët strategjik si pjesë e procesit të VSM-së.



7	Monitorimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Informacionit	Krijimi i Njësisë së Mbrojtjes së Natyrës në kuadër të Agjencisë së Pyjeve dhe Mjedisit (2009).
---	--	---

Njësia e Mbrojtjes Natyrore vepron si një qendër ekspertize për biodiversitetin, e cila do të sigurojë mbështetje dhe këshillim si për Ministrinë ashtu edhe për autoritetet lokale. Detyra tjetër kryesore e saj është hartimi i fazës së parë të të dhënave GIS si dhe sistemi i menaxhimit të informacionit për biodiversitetin si pjesë e EIMS. Kjo përfshin:

- Krahasimin, vlerësimin cilësor dhe futjen e të dhënave për të kompletuar fazën e parë të procesit të sistemimit të informacionit për biodiversitetin.
- Sigurimi i aksesit në sistemit të informacionit për biodiversitetin për të mbështetur integrimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit- Prezantime nëpërmjet internetit dhe CD -së

4.12 VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

Tipet aktuale te pyjeve dhe potenciali natyror

Nga pikpamja e kushteve stacionale. e zonalitetit vertikal dhe e gjeomorfologjise, kemi te bejme me nje vend tipik te pyjeve te lisit, te cilat karakterizohen nga rritje e shpejte dhe e shendeteshme. Ne keto pyje ka nderfutje te lajthise,shkozës,panjes,krekezes,ulezes,frasherit – gje e cila eshte trajtuar rast pas rasti ne pershkrimin parcelar. Ne fshatrat Cahan dhe Mujaj kemi karakteristikat e zonave fitoklimatike Fagetum dhe Castanetum. Jane kullotat alpine ne shpatet e Malit Pashtrik dhe masivet e pyjeve te ahut kufi me fondin e pyjeve komunal.Ky studim rekomandon qe dhe fondi i pyjeve te larte te Ahut qe aktualisht mbeten me regjim pronesishtetere, te kaloje ne fond komunal. Kjo, pavaresisht se i mbetet te ardhmes, ka anet e mira si me poshte:

- 1.Te ardhurat shkojne aty ku krijohen.
- 2.Papullata e fshatrave Cahan e Mujaj, perfiton drejtperdrejt ne planin ekonomik.
- 3.Mundesia e rritjes e konvertuar ne mundesi shfrytezimi vilet nga vete fshataret dhe kjo shkon ne te mire te tyre.(me kontroll teknik rigoroz)
- 4.Rritet interesi dhe ky fond i pyjeve te larte ruhet qofte nga mbishfrytezimi, qofte nga degradimi,qofte nga zjarret. Kete pune me mire se fshati nuk mund ta beje asnjelloj strukture shtetere.
- 5.Ne keto kushte, zona e pyjeve te ahut mund te marre edhe destinacion me karakter hedonistik, duke siguruar te ardhura ne shume drejtime.

Ne zonen per te cilen hartohet ky projekt, takohen keto tipe te vegjetacionit potencial.

- A. Klasa *Quercetae pubescentis* (Liosel 1971).



Ne kete klase ben pjese rendi Quercetalia pubescentis.

1.Grupimet me melleze dhe me shkoze.

2.Grupimet me qarr.

B. Klasa Quercetae robri petraea (Br.-Bl.&Tuxen 1943)

Si specie karakteristike eshte bunga (Quercus petraea L.) qe pas geshtenjes eshte druri me i dobishem ne kete klase.

Duke analizuar zhvillimin e perhapjen e llojeve, themi se ato jane pershtatur mjaft mire me kushtet stacionale te mjedisit. Nderhyrja e njerezve ne kete vegetacion per te plotesuar nevojat, ka qene e vazhdueshme dhe per pasoje eshte vene re fenomeni i degradimit, ne bunge dhe qarr.

Sipas klasifikimit tipologjik fondi pyjor komunal mund te grupohet ne keto tipe.

- Pyje lisi me shoqerim.(shkoze,melleze,frasher,panje etj)
- Pyje lisi te paster.
- Pyje me shkoze te zeze.

Ne formularet e pershkrimtit parcelar, jane percaktuar tipet, perzierja, shoqerimi, nenpylli si dhe shkalla e natyralitetit.Kjo shkalle eshte percaktuar si me poshte.

- Pyje natyrore, te cilet nuk e njohin nderhyrjen e dores se njeriut. Ato jane te virgjier. Per kete kategori ne bashki nuk behet fjale, per vete faktin e teritorit te urbanizuar.
- Pyje gjysemnatyror. Jane grumbuj afersisht natyrore sepse menyra e instalimit eshte natyrore, por njeriu ka nderhyre ne to here pas here per nevojat e tij personale. Ne kete kategori futen te gjitha pyjet e bashkise Krume.
- Pyje artificiale. Ne kete bashki pyje te tille nuk ka.

Jepet rekomandim qe ne te ardhmen, shoqerimet te ruhen, si vlere e paperseriteshme e biodiversitetit natyror.

4.13 BIOTOPE TE VEÇANTE

Nga vezhgimi i kujdesshem i terrenit, mbeshtetur ne kerkesat e manualit te pyjeve shteterore, duke patur parasysh kategorizimin e biotopeve, na rezulton ne si biotop i veçante shpalla – habitat i lakuriçit te nates, me emrin “Shpella Lakuriçit” ne fshatin Mujaj.



Foto - 1 Shpella lakuriçit Mujaj.

Eshte shpelle mbi formacione gelqerore, mjaft interesante, me stalaktite dhe stalakmite, me hapësira te medha dhe labirinte te shumte. Ka lakuriçe nate me shumice prej te cileve e ka marre emrin. Duhet te jete krijuar mijera vjet me pare. Ka vlera shkencore e turistike, vetem se duhet te kete dhe infrastrukturen e nevojeshme. Sugjerojme masa te veçanta per ruajtjen e saj. Shpella eshte hedhur ne harte me:

X = 4453945.

Y = 4672305.

H = 1067 m. Mbi nivelin e detit.

4.14 PROBLEMET E MJEDISIT

1. Ne bashkine Krume kur shoqeria ballafaqohet me mjaft probleme dhe privacione, menjehere duhet te kujtohem se problemet e mjedisit pervecse karakter lokal, kane me teper karakter global. Ne lidhje me mjedisin nuk paraqiten shqetesime, por gjithsesi te gjitha rekomandimet qe kemi dhene kane impakt ne mjedis dhe dihet se mjedis i shendetshem sjell per pasoje vend atraktiv, me njerez te shendetshem dhe te kanaqur me jeten.


2. Pylli, kullota, bujqesia, ujerat, bimesia barishtore, flora, fauna, kerpudhat, njerezit me urbanizimin qe sjellin, ne teresi krijojne mjedisin dhe sigurisht synojme ta kemi te paster, qe ne fakt e kemi.

Kafshet E Egra

Fondi pyjor ne bashki eshte favorizues edhe per zhvillimin e faunes. Kjo eshte nje vlere qe njihet vetem nga ata qe merren me gjah (edhe ata si shfrytezues), por popullata akoma nuk ka nje ndergjegjesim adekuat.

Bota e zhvilluar ekonomise faunistike e jep rendesi te jashtezakoneshme, ne funksion te zhvillimit te turizmit dhe sidomos atij familjar. Ne teritorin e bashkise kane habitatin e tyre disa lloje qe jane autoktone, qe lindin e vdesin ne kete habitat. Te tilla specie jane:

1. Lepuri eger (*Lepus europaeus*)(Zahrisht, Gajrep, Krume)
2. Derri eger (*Sus scropha*) (Cahan, Mujaj)
3. Dhelpra (*Volpes volpes*) (ne gjithe teritorin)
4. Ujku (*Canis lupus*) (ne gjithe teritorin)
5. Macja e eger (*Felis silvestris*)(mbi 1000 m mbi det)
6. Baldosa (*Meles meles*)(zona ulet bujqesore)
7. Thellenxa e fushes (*Coturnix coturnix*)(Zahrisht, Gajrep)
8. Shapka (*Scolopax rusticola*) (zona dushkut – Zahrisht)
9. Turtulli (*Turdus merula*)
10. Gjeli eger (*Tetrao urogallus*)(zona ahut – Cahan, Mujaj)



E te tjera si Bubo bubo, Accipiter gentilis, Circus pygargus, Corvus cornix, Dendrocopos minor, Buteo buteo, Hirundo rusticola, Sylvia communis, Parus major, Phoenicurus phoenicurus etj.

Per sa thame me siper vlerat rezultojne si me poshte:

- Jane pasuri me indikacion te nje natyre te paster e te shendeteshme.
- Kane vlera te karakterit studimor.
- jane nje resurs mjaft i mire ne favor te turizmit dhe sidomos te atij familiar.

Flora:

Bimesia pyjore e kesaj zone eshte mjaft e pasur. Lloje te shumta takohen sidomos ne brezin e shkurreve mesdhetare ku gjenden: marja, shqopa, perralli, shkoza, mretja, xina, ilqja, e me pak lloje dushqesh. Ky brez shtrihet deri ne 600 – 800 m mbi nivelin e detit ne vartesi te kundrejtimit te shpateve. Mbi shkurret mesdhetare shtrihet zona e dushqeve ne lartesine 500 – 1000 m mbi nivelin e detit e cila dallohet me mire gjithandej. Ne disa lugina te fresketa dushku ketu zbret deri 100 – 400 m. Perfaqesohet sidomos nga Ilqia, Bunga, Shparthi, Qarri, Melleza etj. Në të gjithë shtretet e lumenjve e përrenjve vërehet një ripërtëritje dhe zhvillimi vrrullshëm i rrapishteve. Me poshte rendisim llojet floristike kryesore, me te perhapura dhe ato te rralla qe takohen ne territorin e Bashkise.

A. Druret

- | | |
|-----------------------|---|
| 1. Dushqet | <i>Quercus ssp. (Qarr, Bunge, Shparth, Ilqe)</i> |
| 2. Pishat | <i>Pinus ssp. (Pisha e Zeze, Pishat Bregdetare, Rrobulli)</i> |
| 3. Bredhi | <i>Abies ssp.</i> |
| 4. Tisi (Dushnjere) | <i>Taxus baccata</i> |
| 5. Rrapi | <i>Platanus orientalis</i> |
| 6. Akacje | <i>Robinia pseudoacacia</i> |
| 7. Melleza | <i>Ostrya carpinifolia</i> |
| 8. Vidhi | <i>Ulmus campestris</i> |
| 9. Verriu | <i>Alnus glutinosa (i rralle)</i> |
| 10. Uleza | <i>Acer tataricum</i> |
| 11. Panja | <i>Acer pseudoplatanus</i> |
| 12. Frasheri i Bardhe | <i>Fraxinus Ornus (i rralle)</i> |
| 13. Shelgjet | <i>Salix ssp.L</i> |
| 14. Plepat | <i>Populus ssp. Drure te rralle</i> |



15. Kumbulla e eger *Prunus cocomilia*

B. Shkurret

1. Perralli *Quercus coccifera*
2. Mare *Arbutus Unedo*
5. Krifsha (Mbrete) *Fillorea media*
4. Xina *Pistacia lentiscus*
5. Shkoza *Carpinus orientalis*
6. Shqope *Erica arborea*
7. Grathate (mengjerisht) *Erica herbacea*
9. Qelbesi *Pistacia terebinthus*
10. Dellinj e kuqe *Juniperus oxycedrus*
11. Murrizi njeberthamsh *Crataegus monogyna*
12. Trendafili i eger *Rosa canina.*
13. Driza *Paliurus Spinachristi*
14. Shtogu *Sambucus nigra*
15. Molla e eger *Malus silvestris*
16. Thanat *Cornus ssp.*
17. Kulumbria *Prunus spinosa*

C. Dru – Frutoret e Bute

Percet druveve, shkurreve dhe shkurrezave pyjore ne territorin e Bashkise takohen shume lloje

dru – frutore te bute, si: fiku, bajamja, arra, dardhat, kumbullat, mani, ftoi, qershi, ulliri dhe lloje te ndryshme rushi ne forme pjergulle e vreshti (hardhi), etj. Në disa mikrozona të mbrojtura nga erate ftohta dhe ngircat janë kultivuar dhe agrume. Në fshatrat e tjere ka qenë traditë e hershme kultivimi i hardhive në formë pjergullash të hedhura në drurët e lartë të përrallit, lisave, reepeve por edhe të drurëve të tjerë pyjor ose frutor. Llojet e shumta dru – frutore dhe kushtet e favorshme tokesore e klimatike bejne te mundur qe ne kete Bashki zhvillimi i frutikultures te jete me mjaft perspektive dhe nje rezerve e madhe per shfrytezimin e tokave te dobeta dhe rritjen e te ardhurave te popullates vendore.

D. Bimesia Barishtore



Bimesia barishtore e territorit të Bashkise e në vecanti ajo e kullotave malore me interes për blegtorinë përfaqësohet nga:

1. Bime të familjes së Graminaceve me llojet e mëposhtme:

Bari i hollë ose barimeza (*Agrostis alba* – *A. capillaris*) që kërkohej shumë nga delja, Bishtdhelpra (*Phleum pratense*) për kullotë në gusht, Antaksanta eremire (*Anthoxanthus odoratum*), Rudithi pendor dhe Rudithi pyjor (*Brachypodium pinnatum* dhe *B. sylvaticum*), Festukat ose bishtpelezat: bishtpeleza e permbysur (*Festuca supina* ose *F. ovina* Var. *duriuscula*), bishtpeleza e verdheme (*F. xanthina* ose *F. varia*, ssp. *Valida*), bishtpeleza gjethendryshme (*F. heterophylla* ose *F. rubra*, ssp. *Fallax*), Bishtqeni (*Cynosurus cristatus*), Telishi (*Dactylis glomerata*), Keleria e shndritshme (*Koeleria splendens*), Xhufka (*Nardus stricta*), Flokeza qepore (*Poa bulbosa*), Presja: presja e ndarë (*C. divisa*), presja kreshtake (*C. hirta*) dhe subspecie të tjera, Ramonda (*Ramonda serbica*), Mjedra (*Rubus idaeus*), Takellina me e vogla (*Rhinanthus minor*), Kamaroshja pyjore (*Geranium sylvaticum*), Njegjira: njegjira e ares (*Asperula arvensis*), njegjira e purpurt (*A. purpurea*), njegjira qenmbytesë (*A. cynanchia*), Bishtmiu ssp. (*Mikromeria thymifolia*, *M. cristata*, *M. parviflora*), Veshlepuri, Gjemb gomarit, etj.

2. Bimet e familjes Bishtajore ose Leguminoze përfaqësohen nga: Terfilat: terfili malit (*Trifolium alpestre*), terfili zvarrites (*T. repens*), terfili livadhit (*T. pratense*), Jonxha e vogël (*Medicago minima*), Thuepula (*Lotus corniculatus*), Grashina kraka (*Vicia cracca*), Gjineshtrat: gjineshtra ngjyrosesë (*Genista tinctoria*), gjineshtra pyjore (*G. sylvestris*)

3. Bime të demshme dhe helmuese: Keto lloje bimesh takohen me shumicë në territorin e Bashkise e sidomos në kullotat malore. Ato përfaqësohen nga: Fieri (*Pteris aquilina*), Shtara (*Vertrum album*), Bexga ose cfaka (*Phlomis fruticosa*), Xherrokulli i Kupanit (*Colchicum cupanii*), Arithja gjethengushtë, ose Trumthi me gjemba (*Astragalus angustifolius*), Halmuce vezake (*Aegilops ovata* L.), Halmuce me tri hala (*Aegilops triuncialis* L.), Halëza (*Stipa Capitata* L.), etj. Duhet hequr dhe ulur përqindjet e këtyre bimëve të demshme e helmuese, që ulin ndjeshëm kapacitetin kullësor, mbasi shumë sipërfaqe mbulohej plotësisht prej tyre dhe ka vështirësuar kullotjen e të leshtave dhe të të trashave. Për këtë arsye kemi parashikuar nderhyrje për shkëlqjen e pastrimin e tyre nga kullotat.

Biotopet

Duke e parë si një faktor të rëndësishëm për konservimin e biodiversitetit të llojeve gjatë fazës së grumbullimit të të dhenave në terren janë lokalizuar dhe përshkruar tipet e biotopeve për të gjithë grumbujt pyjor të bashkisë. Në bazë të këtij vlerësimi grumbujt pyjor të kësaj zone bëjnë pjesë në tipet e biotopeve (1, 2, 3, 6, 9 e 14).

1. Bashkeshoqerimet pyjore afersisht natyrore.

2. Pjesë e mbetur, ish shoqerime pyjore që kanë qenë të rralla për shkak të menaxhimit.

3. Shoqerime pyjore dikur shumë të përhapura që kanë mbetur në forme ishujsh të vegjël për shkak të mbi shfrytëzimit të mjedisit.



4. Ane pylli, kufiri i jashtem i pyllit (qe kufizohet me kullota me brezin e siperm te zhvillimit te pyjeve, me sipërfaqe ujore, me toke bujqesore etj).

Resurset Gjenetike

Ne teresi grumbujt pyjor te kesaj ekonomie i jane nenshtuar nje ndikimi te fort nga njeriu dhe para kesaj gjendje te ndryshimeve e adoptimeve qe iu jane bere mbartin potencialisht ekzistencen e llojeve tradicionale te cilat ne kuadrin e ekosistemeve pyjore konservojne biodiversitetin e llojeve. Nje rast i tille eshte i mireshprehur per llojet pjesemarrese. Elementet dendrometrike e silvikulturor te tyre jepen ne pershkrimet parcelare respektive. Ato vleresohen si raste te lokalizuara ne gjendje natyrore. Per tu permendur ketu jane tre resurse me vlere te vecante:


- a. Parcelat trungishte me llqe e Bunge.
- b. Parcelat me Perrall (dy te tilla) me zhvillim interesant.

Kategorite e mbareshtimit te Zonave te Mbrojtura

Grumbujt pyjore te kesaj ekonomie nuk kane qene trajtuar si teritore me interes te vecante, keshtu qe ato nuk bejne pjese e per rrjedhoje nuk jane futur ne asnje kategori te IUCN-S. Gjithashtu edhe gjate studimit per hartimin e ketij plani mbareshtimi nuk propozohen grumbuj pyjor qe plotesojne cilesite e menaxhimit te zonave te mbrojtura.

Mbareshtimi i Faunes se Eger

Historikisht kjo zone ka qene shume e pasur me lloje shpendesh e kafshesh te egra, mbasi territori i gjere kodrinoro – malor i mbuluar me pyje e kullota lejonte ne te kaluaren vendqendrim te sigurta e ushqime te bollshme. Deri ne vitin 1940 jane hasur ekzemplet e fundit te Rriqebullit ne zonen e lartë malore, ndërsa me mbrapa nuk eshte konstatuar. Derri dhe kaprolli kane qene me shumice dhe gjenden edhe sot me efektiva te vogla si kalimtarë që hyjnë herë pas here në këtë zonë. Dhia e eger ka qene banore e te gjithë maleve, tani nuk takohet më. Çakalli ka qene i pranishem deri ne vitin 1965 – 1966. Nga llojet e gjahut interes te vecante faunistik e ekonomiko – turistike ka thelleza e malit. Kjo eshte e perhapur ne te gjithë zonen malore te bashkisë, si dhe ne ate kodrinore te larte. Efektivat e saj jane shume te rendesishme edhe per popullimin e teritoreve te tjera qe jane ne kufi me bashkinë Krume. Po ashtu edhe lepuri i eger eshte ne gjendje te mire, sidomos ne zonen malore siper vendbanimeve te fshatrave e ne kullotat verore. Per mbareshtimin e faunes jane perdorur dy metoda pune: inventarizimi direkt (per thellezen e malit dhe lepurin e eger) dhe marrja e te dhenave nga inventarizimet e mepareshme te gjahut duke i ballafaquar ato me te dhenat e rinovuara e me ato te gjuetareve te zones. Ne kushtet stacionale ku habitatet e specieve faunistike jane te favorshme verejm nje larmi e shtim te llojeve te gjahut. Persa i perket Thellezes se malit e Lepurit te eger qe deri diku jane nen presion nga kullota dhe aktiviteti i gjuetise, duhet qe gjuetia e tyre te behet rigorozisht e kontrolluar ne menyre qe te mos ulen efektivat, por te arrihet te sigurohet nje shtese graduale e ne vazhdimesi, mbasi jane lloje me leverdi ekonomike. Ne kete zone kalojne gjate shtegëtimit gjate gjith dimrit shpende te ndryshem shtegtar qe preferohen nga gjuetaret vendas e te huaj. Keshtu llojet si shapka, tusha e malit e mellenja, gugashi, etj gjenden me shumice. Po keshtu edhe llojet e tjera te kafsheve e shpendeve te egra te vendit



kane nje shtim te dukshem vitet e fundit si: dhelpra, kunadhja, ujku, baldosa, ketri, qelbsi, lundra, nuselales, shqiponja e malit, kali i qyqes, sorrat, laraskat, korbat e grifshat. Macja e eger eshte shume e rralle.

E pare ne linjen e ushtrimit te gjuetise sportive e turistike disa specie te faunes si shapkat, tushat, mellenjat, gugashi, thelleza e malit, lepuri i eger, ujku, dhelpra, kunadhja, etj paraqesin interes te madh. Ne vitet ne vazhdim per keto lloje duhet te organizohet me mire gjuetia per ta kthyer ate ne nje aktivitet turistik, qe do te ndikojte ne rritjen e te ardhurave te kesaj bashkie. Ne baze te dhenave D.SH.Pyjore, sipërfaqja e fondit te gjuetise per kete Bashki eshte rreth 6000 ha. Ne perputhje me kete dhe gjendjen e efektivave te gjahut, eshte percaktuar ecuria e efektivave, parashikimi i vjeljeve e i te ardhurave nga gjuetia.

Kuadri kombëtar për ruajtjen e natyrës


Rrjeti i sotëm i Zonave të Mbrojtura në Shqipëri, mbulon një sipërfaqe prej 165,455 hektarë e barazvlefshme me 5.8 % të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Sipas Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin, planifikohet që deri më 2020, ZM-të të mbulojnë 25 % të territorit shqiptar. Në vitin 2002, Parlamenti Shqiptar aprovoi dy ligje të rëndësishëm (Ligji Nr. 8934 i datës 05.09.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” dhe Ligji Nr. 8906 i datës 06.06.2002, “për Zonat e Mbrojtura”, (i amenduar me Ligjin nr. 9868, date 4.02.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”) që së bashku krijuan një strukturë të re ligjore për Zonat e Mbrojtura. Ligji jep gjithashtu parimet e zhvillimit të turizmit mjedisor, të perfitimeve të tjera ekonomike si dhe ato të përcjelljes së informacionit dhe edukimit në drejtim të publikut. Disa zona të mbrojtura të rangut Park Kombëtar të kategorisë së dytë, si Tomori për Bashkinë e Skraparit dhe Drenova për Bashkinë e Hasis mund të lidhen me anë të një zone tjetër që duhet propozuar si ajo e Ostovicës, e cila mund të shërbejë si bioqendër. Së bashku mund të formojnë një biokorridor shumë të rëndësishëm, duke vendosur komunikim midis zonave të mbrojtura. Ostovica mund të propozohet kështu si zonë e mbrojtur.

4.15 GJEOMONUMENTET

Rrethi Has

Prerja e Pashtrikut: Vlahen-Maja e Pashtrikut (1889m). Gjeomonumente stratigrafik. Nga perëndimi në lindje përgjatë shpatit nga Vlahna deri në Majë dalin shkëmbinjte ultrabazikë (harzburgitë të serpentinuara), prerje e kores së tjetërsimit me mineralizimin e hekur-nikelit, gëlqerorët shtresor me pamje shumë të bukur të Kretakut të poshtëm dhe në afërsi të majës së Pashtrikut gëlqerorët shtresorë të Kretakut të sipërm. Përveç aspektit kompleks stratigrafik prerja formon edhe një peisazh shumë tërheqës, të veçantë.

Fusha Karsike Maja e Rrasës së Bogut (1308m) deri në lindje të fshatit Cahan. Gjeomonument gjeomorfologjik, karstik. Eshtë një fushë karstike e zgjatur nga jugu në veri në gëlqerorët neritike të






Fig. - 34 HARTA E GJEOMONUMENTEVE, QARKU KUKËS

- Zona Ne Studim, Bashkia Krumë






Fig. - 35 Harta E Gjeomonumenteve, Bashkia Krume

4.16 GJEOMONUMENTE ME VLERA RAJONALE

Rrethi Has

Burimi i Krumes. Gjeomonument gjeomorfologjik, karstik, hidrogeologjik.

Burimet e Brudit Gjeomonument gjeomorfologjik, karstik.

Peizazhi me formë të gishtëzuar Kabash (Zahirsh), në anën veriore të liqenit, në shtratin e përrenjve të dikurshëm.

Qafë Ahmataj. Kontakti midis shkëmbinjve gabrore me harzburgite të serpentinizuara. Gjeomonument magmatik.

Dalja e graniteve në fashatin Kopicë. Gjeomonumente magmatik.

7.2 ZONAT DHE OBJEKTET ME RËNDËSI KOMBËTARE

Në përputhje me nenin 33 të VKM-së Nr.671, datë 29.07.2015, të shtyrë, në të dhënat dhe në zonat me rëndësi kombëtare përfshihen: (a) zonat e mbrojtura dhe monumentet e mjedisit natyror,

(b) zonat e mbrojtura dhe monumentet e mjedisit kulturor, (c) resurset natyrore, (ç) infrastruktura e rëndësishme për prodhimin dhe transferimin e energjisë, (d) qendrat më të rëndësishme urbane, (dh) rrugët shtetërore, (e) zonat minerare dhe (ë) zonat me rrezik natyror.

a. Në përputhje me Ligjin me Nr.8906/6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", *zonat natyrore të mbrojtura* të vendit kategorizohen në gjashtë kategori me kufizime përkatëse, nivele mbrojtjeje dhe zona buferike (shih analitikisht Kapitulli 2.2.6). Kategorizimi u bazua në kriteret e IUCN

Në territorin e Hasit ka shumë mnamente natyre, ndër ta dhe një zonë të shpallur të mbrojtur, sic është Rezervati Natyror i Menaxhuar "Tej Drini i Bardhë", i shpallur me VKM Nr.102, datë 15.01.1996. Gjithashtu, bazuar në VKM nr.676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë të mbrojtur të monumenteve të natyres shqiptare" në Bashkinë Has janë shpallur si të mbrojtura një sërë monumentesh natyrore:

Nr.	Emri i Monumentit	Vërejtje
1.	Burimi i Krumës	Sipas Ligjit Nr.81, datë 4.5.2017 "Për zonat e mbrojtura", monumentet natyrore i përkasin kategorisë III dhe kanë zonë buferike deri në 200m (neni 17)
2.	Burimet e Brudit	
3.	Gurra e Vranishtit	
4.	Gurra e Domajve	
5.	Pisha e Gjinajve	
6.	Shpella e Pëllumbave	
7.	Shpella me oborr	
8.	Shpella që tingëllon Mazrek	
9.	Maja e Qytezës	
10.	Ahishija e Liqenit të Kuq	
11.	Pisha në Gjinaj	

b. Bazuar në Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë Kulturore" objektet e trashëgimisë kulturore të mbrojtura klasifikohen në Objekt nën vrotim, Objekt në mbrojtje paraprake, Monument kulture të kategorisë II dhe Monument kulture të kategorisë I. Sipas Nenit 32 të Ligjit, institucioni përgjegjës i shpalljes së një monumenti përcakton zonën mbrojtëse për monumentet kulturore në varësi të vlerës së tyre arkitektonike, estetikën e tyre dhe hapësirën përreth. Nëse nuk përcaktohet një zonë e tillë nga legjislacioni në fuqi ose nuk njoftohet nga ministria kompetente, sipas VKM nr.71, datë 29.07.2015 (neni 96), vlen gjerësia minimale prej 100m. Monumentet kulturore të Bashkisë Has, me vlera arkitektonike e arkeologjike, i përkasin

kategorisë së I-rë të mbrojtjes, për të cilën vlejnë kushtet dhe kufizimet e nenit 28, në përputhje me tabelën e mëposhtme.

Nr.	Emri i objektit	Kategoria	Vendimi i shpalljes	Zonë e mbrojtur
1.	Banesa e Bajram Ukës	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendimi Nr.1886, datë 10.06.1973	Jo
2.	Banesa e Mus Hasanit	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendimi Nr.1886, datë 10.06.1973	Jo
3.	Banesa e Man dhe Hate Ferizollit	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendimi Nr.1886, datë 10.06.1973	Jo
4.	Banesa e Selim Sadri Rahmanit	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendimi Nr.1886, datë 10.06.1973	Jo
5.	Banesa e Man Celës (Sali Cela)	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendimi Nr.1886, datë 10.06.1973	Jo
6.	Banesa e Selman Zymer Dautit (Bajram Dauti)	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendimi Nr.1886, datë 10.06.1973	Jo
7.	Banesa e Ibrahim Sadikut	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendimi Nr.1886, datë 10.06.1973	Jo
8.	Banesa e Deli Kovacit dhe Kulla Pranë Saj	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Urdhëresë datë 08.01.1977	Jo
9.	Banesa e Ali Dhe Adem Pavdojës	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Urdhëresë datë 08.01.1977	Jo
10.	Banesa e Cardakut e Ibrahim Gjonit	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Urdhëresë datë 08.01.1977	Jo
11.	Shkolla dhe Internati	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Vendimi Nr.1886, datë 10.06.1973	Jo
12.	Banesa e Hysen Alisë	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Urdhëresë datë 08.01.1977	Jo
13.	Banesa e Uk Harkullës	I	Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Urdhëresë datë 08.01.1977	Jo

c. Burimet natyrore me rëndësi kombëtare përfshijnë ujin, pyjet dhe rezervat minerare. Ata bashkërendojnë dhe bashkëveprojnë me pasurinë kulturore, janë kritike për mbijetesën e zonës në studim, veçanërisht për zonat më pak të favorizuara dhe ato malore dhe janë të ndjeshëm ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Rezervat e mineraleve dhe toka pyjore janë të shumta dhe burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore) janë të pasura dhe zakonisht janë në gjendje të mirë. Është i nevojshëm menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve, përmirësimi i menaxhimit të tyre, sigurimi i rezistencës së tyre dhe kontrollimi i metabolizmit dhe vlerësimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve ciklike midis burimeve natyrore dhe popullsisë.

d. Të rëndësishme në nivel kombëtar quhet infrastruktura kryesore për prodhimin dhe transmetimin e energjisë, dhe specifikisht HEC-et dhe linjat e tensionit të lartë të energjisë elektrike.

e. PPK mbështet zonat me rëndësi kombëtare, duke sygjyeruar zgjerimin e tyre apo shpalljen e të rejave. Megjithatë, brënda këtyre zonave ka edhe të ashtu-quajturat "ishuj territorialë", të cilat duhet të përjashtohen nga kufizimet e zonave me rëndësi kombëtare pasi nuk ndajnë karakteristika të njëjta.

f. Me rëndësi kombëtare janë të gjitha akset rrugore shtetërore (SH) që përshkojnë Bashkinë.

g. Brënda bashkisë janë përcaktuar zonat minerare të kërkim - zbulimit dhe shfrytëzimit në përputhje me Programin e Veprimit 3 vjeçar, 2016-2018, për zhvillimin e aktivitetit minerar dhe përcaktimin e zonave minerare të rrezikshme (VKM nr.726, datë 2.9.2015 dhe VKM nr.751, 26.10.2016).

h. Si zona me rreziqe natyrore përfshihen:

- zonat e rrezikshme, siç përcaktohen në Programin e Veprimit 3-vjeçar, 2016-2018, për zhvillimin e aktivitetit minerar dhe përcaktimin e zonave minerare të rrezikshme (VKM nr.726, datë 2.9.2015 dhe VKM nr.751, 26.10.2016).
- rreshqitje e dimensioneve të ndryshme, të shkaktuara nga faktorët gjeologjikë me karakter aktiv dhe pasiv, sipas studimit të SHGJSH (2014) "Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë - Qarku i Kukës"

Monumentet natyrore janë një tjetër pikë e fortë e propozimeve për konservim dhe ruajtje të PPK, strategji që i sjell hasit pasurim të mëtejshëm në kapitalin natyror që zotëron. Monumente natyrore në mbrojtje marrë nga inventari i bashkisë janë:

- Burimi i Krumës
- Burimet e Brudit
- Gurra e Vranishtit
- Gurra e Domajve
- Pisha e Gjinajve
- Shpella e Pëllumbave
- Shpella me oborr
- Shpella që tingëllon Mazrek



- Maja e qytezës
- Ahishtja e Liqenit te Kuq
- Pisha në Gjinaj

PËRFUNDIME E REKOMANDIME

- 1- Administrimi i gjeomonumenteve të integrohet në politikat, planet territoriale, programet që ndërmerren në nivel qarku;
- 2- Sensibilizimi i komunitetit vendas, për pasurite natyrore që ndodhen në zonën ku ata banojnë dhe rëndësinë e ruajtjes së tyre;
- 3- Vendosja e tabelave për gjeomonumentet kombëtare dhe lokale pranë vendndodhjes së tyre me shpjegime përkatëse të shoqëruara me harta, shpjegim gjeologjik të formimit të tij dhe foto të ndryshme.
- 4- Organizimi i ekspeditave me nxënës të shkollave të ciklit parauniversitar për njohjen e fenomeneve gjeologjike si dhe dukurive që kanë lënë gjurmë në kufijtë administrativë të fshatit, komunës, bashkisë apo qarkut.

4.17 PYJET

Funksionet kryesore te pyjeve ne bashkine Krume jane:

1. Funkzioni mbrojtës por ky nuk është në kuptimin klasik. Ai është i nenkuptuar sepse pa mbrojtje nuk mund të sigurojme as prodhim. Këtu si përpjesia me e madhe hyn mbrojtja nga zjarret dhe nga prerjet abuzive.
2. Funkzioni prodhues. Në përgjithësi pyjet e komunes kanë këtë funksion, sepse tani e tutje ato do të jenë në dorë të përdoruesve të cilët do të rritin mirëqenjen e tyre edhe nëpërmjet produkteve që rezultojnë nga pylli.

Në përcaktimin e funksioneve, jemi konsultuar dhe kemi marrë sugjerimin e banorëve. Emri funksion prodhues, nuk e përjashton, përkundrazi e nenkupton funksionin mbrojtës, prandaj nuk kemi pasur të trembemi nga ky ndryshim konceptual në kushtet e reja.

Dëmtimet nga Zjarret, Ortiqet, Semundjet, Dëmtuesit

Sa i përket dëmeve nga insektet dhe semundjet tani për tani në pyjet e bashkisë nuk ka patur ndonjë problem shqetësues. Gjendja sanitare e grumbujve paraqitet e mirë. Edhe për rreziqe nga faktorë atmosferikë siç janë ortiqet, ky problem nuk ekziston qoftë për sasinë dhe llojin e reshjeve vjetore, qoftë për natyrën e terrenit që është i butë. Sa i takon rrezikun nga zjarret mund të themi se është problemi më themelor për pyjet jo vetëm në bashki, por dhe në shkallë vendi. Do të duhet që në të ardhmen, vetë fshati i monitoruar nga pushteti vendor, të organizojë sistemin e vrojtimit – sinjalizimit në funksion të qëllimit që trajtojmë.

Para vitit 1945



Shteti i Zogut nuk i preku rregullat e te drejtes zakonore. Keshtu ne fshat, mbi pyjet dhe kullotat u ruajt ajo maredhenje qe historikisht kishte ekzistuar.

- E drejta per te patur zabele rrotull shtepive.
- E drejta mbi merate e katundit per kullote dhe lende drusore.
- E drejta e fitimit dhe humbjes se pronesise mbi pyjet.(me be, me gjak etj.)

Prej ketyre te drejtave dilnin per rrjedhoje edhe disa detyrime qe mbikqyreshin nga pleqesia ose organi vendim marres "Islihati"(Turq.).

- Moscenimi i prones se individeve, zabeleve, i pyjeve rrotull varrezave dhe i pyjeve ne vendet te tilla si. vorr i mire, xhami, mriz, krua etj.

- Kujdesi per administrimin, ruajtjen, shtimin dhe prerjen me kriter, te prones se fshatit.

Beheshin perjashtime nga rregullat ne raste emergjente si djegje shtepie, vdekje etj.

Nga viti 1945 deri ne vitin 1992:

Shteti komunist, beri shtetezimin e plote te pyjeve dhe kullotave, proces i cili perfundoi totalisht ne vitin 1967, kur fshataret hyne perfundimisht ne kooperative, kur kishat e xhamite u mbyllen dhe humben çdo lloj prone.

Administrimi behej nga ndermarjet shteterore, por duhet thene se pati degradim te plote mbi pyjet e kullotat sepse fshataret e humben çdo lloj interesi per to. Shfrytezimi behej ne menyre te planifikuar shteteror dhe me kriter formalisht "teknike",por me praktike arbitrare,mjafton te japim keta shembuj.

- Vetem per rritjen e vleres se dites se punes ne kooperative me 2(dy) leke, p[riteshin masive te tera pyjesh.
- Per te siguruar bazen ushqimore per blegtorine e kooperatives apo fermes shteterore, priteshin me tonelata gjeth.
- Per te hapur "toke te re" buke, shpyllezoheshin me qindra hektare.
- Jane prere me mijera m3 dru zjarri ne fshatin Zahrisht te Bashkise Krume, dhe jane derguar ne NSHLD, drejt Tiranes, Durresit, Fierit etj per ngrohjen e popullates.
- Barren e "Ndertimit socialist" e kane "vuajtur" dhe suportuar totalisht pyjet.

Keshtu u be fakt nje degradim dhe shfarosje masive ne pyje dhe kullota.

Pas vitit 1992:




- U themelua legjislacioni i ri mbi pyjet. U njohen tre format e maredhenjes mbi pyjet e kullotat, shteterore, kolektive, private. Vazhdohet me fazen e implementimit bazuar ne kete legjislacion, te rregulluar ne proces me akte te tjera ligjore dhe n/ligjore.

- Interesi nda j pyjeve e kullotave eshte rikthyer dhe tashme kjo ekonomi po lidhet ne menyre te drejtperdrejte me mireqenjen e fermereve.

4.18 TERRITORI DHE GJENDJA VEXHETATIVE EPYJEVE DHE KULLOTAVE


-Fondi pyjor i Bashkise, per efekt mbareshtimi eshte organizuar ne tre ekonomi pyjore:

- Ekonomia pyjore "Helshan" 444.9 ha.
 - Ekonomia pyjore "Krume" 3368.0 ha.
 - Ekonomia pyjore "Tejdrini Bardhe" 472.5 ha.
- Siperfaqe totale Pyje dhe Kullota: 4285.4 ha.



- Fondi jopyjor i Bashkise:

- 1.Siperfaqe bujqesore dhe urbane = 1751.5 ha.
 - 2.Siperfaqe ujore = 153.0 ha.
 - 3.Siperfaqe shkembore = 43.8 ha.
 - 4.Siperfaqe kenetore = 17.5 ha.
- Siperfaqe totale jopyjore: = 1965.8 ha.



- Teritori ne teresi i Bashkise:

1.Siperfaqe pyjore = 4285.4 ha.

2.Siperfaqe jopyjore = 1965.8 ha.

Total teritori: = 6251.2 ha.



Ne teritorin e Bashkise Krume, shtrihen 5 (pese) fshatra: Krume, Gajrep, Zahrisht, Mujaj dhe Cahan. Pyjet jane marre ne mbrojtje nga shume fermere, dhe kane nje zhvillim shume te mire. Kjo ka zgjuar interes ne pergjithesi ne popullaten ne komunes dhe ka patur impakt te mire duke bere te mundur kufizimin e prerjeve. Ndjenja e prones dhe e pushtetit mbi pyjet, tashme eshte zgjuar me se miri tek fshatari, vetem se kerkohet nje menaxhim i kujdesshem sepse procesi eshte ne fillesat e tij. Shume fermere, kane marre ne zoterim siperfaqe pyjore, i kane ruajtur dhe permiresuar, ne menyre vullnetare.(sigurisht pa konflikt me fqinjin e tyre) Pra kemi te bejme me nje situatë “fakti” te cilen na duhet qe ta drejtojme.

Te dhenat biometrike

Te dhenat biometrike aktuale te pasqyruara ne pershkrimin parcelar, aktualisht nuk jane aspak te kenaqeshme ne raport me ate qe synojme.Per te ardhmen perdoruesit i rekomandojme:

- 1.Duke realizuar prerje per plotesimin e nevojave, vetem te karakterit kopeshitor, shfrytezues, dritesues, higjenizues, mosha duhet te shkoje nga “ e rinise “ ne “ e pjekurise “.
- 2.Diametri zoterues duke patur parasysh se kemi te bejme me cungisht, nuk mund te na jape vlera impersionuese, per nga 3-12 cm qe eshte sot duhet dhe mund te shkoje 15-20cm, qe i pergjigjet prodhimit te lendes se holle dhe te mesme te ndertimit.
- 3.Lartesia aktuale ne pershkrimin parcelar qe kemi bere shkon 4 deri 12 m. Duke perjashtuar disa ngastra ne Krume,Gajrep e Mujaj, ku kushtet e stacionit nuk jane te mira, duhet te synohet lartesia 13m deri 16 m.sepse eshte plotesisht e mundur.

4.19 TE DHENA MBI FUNKSIONET E PYJEVE E KULLOTAVE, SIPAS PERDORIMIT DHE QELLIMIT


Ne raport me funksionin e pyllit, kemi treguar nje shkalle te mire fleksibiliteti, sepse tashme kemi te bejme me pyje e kullota qe do ti kalojme ne perdorim te individit dhe te fshatit. Per kete aresye duke ditur se fshatari do te hyje ne pyll per nevojat e tij dhe te familjes se tij, pyjet i kemi konsideruar me funksion prodhues. Tani e tutje jemi te ndergjegjshem se raportet per cilesoret “prodhues” dhe “mbrojtjes” do te jene te nderfutur dhe ne korelacion organik.

Tab-1 Pyjet sipas perdorimit (klasifikuar nga origjina)

Nr	Fshati	Pyje gjithsej (ha)	Menyra e perdorimit			Menyra e perdorimit			Menyra e perdorimit		
			Trung. (ha)	Si fshat (ha)	Lagje, Familje (ha)	Cung(ha)	Si fshat (ha)	Lagje,Familje (ha)	Shkurre (ha)	Si fshat	Lagje,Familje (ha)

0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Krume	1037.7	0	0	0	515.8	498.9	16.9	521.9	208.7	313.2
2	Gajrep	257.6	0	0	0	245.9	245.9	0	11.7	11.7	0
3	Zahrishit	822.1	0	0	0	804.4	803.9	0.5	17.7	17.7	0
4	Cahan	378.7	6.6	6.6	0	40.1	0	40.1	332	332	0
5	Mujaj	442.3	0	0	0	203.8	69.9	133.9	238.5	64.6	173.9
	Bashkia	2938.4	6.6	6.6	0	1810	1618.6	191.4	1121.8	634.7	487.1

Tab-2 Fondi Dhe Funkshonet E Pyjeve Te Bashkise Jepen Me Poshte:



Tab-3 Pyjet sipas perdorimit.(total)

Nr.	Fshati	Pyje kullota	Menyra perdorimit Pyje			Menyra perdorimit Kullota		
			Gjithsej ha	Fshat ha	Lagje Familje ha		Fshat ha	Lagje Familje ha
0	1	2	3	4	5	6	7	8
1	Krume	1126.7	1037.7	707.6	330.1	89	89	0

2	Gajrep	265.6	257.6	257.6	0	8	8	0
3	Zahrisht	822.1	822.1	821.6	0.5	0	0	0
4	Cahan	1323.6	378.7	338.6	40.1	944.9	944.9	0
5	Mujaj	747.4	442.3	134.5	307.8	305.1	61	244.1
	Bashkia	4285.4	2938.4	2259.9	678.5	1347	1102.9	244.1

Tab-4 Pyjet sipas funksioneve te propozuara

Nr.	Fshati	Siperfaqe pyjore gjithsej(ha)		Funksion mbrojtës(ha)		Funksion prodhues (ha)		Te tjera(ha)	
		1	2	3	4	5	6	7	8
1	Krume		1037.7	0		1037.7		0	
2	Gajrep		257.6	0		257.6		0	
3	Zahrisht		822.1	0		822.1		0	
4	Cahan		378.7	0		378.7		0	
5	Mujaj		442.3	250		192.3		0	
	Bashkia		2938.4	250		2688.4		0	

4.20 PRODHIMET PYJORE

Drute e zjarrit, vazhdojne akome te mbeten si burimi me kryesor i energjiise qe perdoret per ngrohjen e popullates. Ato jane njeherazi edhe burimi me tradicional. Ne bashki ka ekzistuar edhe fenomeni i shfrytezimit te druve te zjarrit per treg, per aresye te forta ekonomike,(Zahrisht,Mujaj) por kjo nuk shihet me sy te mire nga fshataret biles ekziston edhe nje shprehje qe thote:”Nuk behet kush zengjin me dru”. Kete synojme edhe ne dhe ne fakt e rekomandojme ne projekt qe te shkohet drejt burimeve alternative te energjiise.Ne fakt ka tendence te mire drejt burimeve alternative. Veme ne dukje se kane hyre burime alternative dhe kerkesat per dru zjarri kane rene si rezultat i cilesise me te mire te banesave. Me poshte te shohim nevojat per dru zjarri dhe peshen qe zene burimet alternative te ngrohjes.

Tab-5 Te dhena per burimin e ngrohjes

		Nevoja per d.zjarri	Mbledhur nga.
--	--	---------------------	---------------

Nr.	Fshati	Numeri familjeve	Per familje (m3)	Totali (m3)	Pyjet komunal (m3)	Pyjet Shtetror (m3)	Burime te tjera		
							Qymyr (kv)	Elektrik (kw/h)	Gaz (L)
0	I	2	3	4	5	6	7	8	9
1	Krume	330	5	1650	1650	0	0	0	8250
2	Gajrep	125	5	625	625	0	0	0	1250
3	Zahrisht	184	5	920	920	0	0	0	1840
4	Cahan	40	15	600	0	600	0	0	0
5	Mujaj	82	15	1230	0	1230	0	0	0
	Bashkia	761		5025	3195	1830	0	0	11340

Lenda e ndertimit drusore, eshte perdorur edhe ne te kaluaren, perdoret edhe sot, ne formen e lendes se punimit te sharruar, dhe lendes se holle te ndertimit. Keshtu historikisht jane ndertuar banesat, stallat, objektet sociale etj. Tashme lende drusore per punim, nuk ka ne pyjet komunale,po keshtu edhe lende ndertimi,por mund te themi se synojme qe ne strategjine e menaxhimit te pyjeve komunale te shkojme drejt lendes se ndertimit, sepse kushtet e stacionit dhe te grumbullit jane te pershtateshme.(Ne Zahrisht, ne Krume per disa ngastra dhe Gajrep disa ngastra) Edhe per ndertim ne fshatrat e bashkise ka nje tendence drejt materialit ndertimor alternativ si hekuri, betoni, plastika, duroalumini, etj.

Tipet Aktuale Te Pyjeve Dhe Potenciali Natyror

Nga pikpamja e kushteve stacionale. e zonalitetit vertikal dhe e gjeomorfologjise, kemi te bejme me nje vend tipik te pyjeve te lisit, te cilat karakterizohen nga rritje e shpejte dhe e shendetshme.Ne keto pyje ka nderfutje te lajthise,shkozës,panjes,krekezes,ulezes,frasherit – gje e cila eshte trajtuar rast pas rasti ne pershkrimin parcelar. Ne fshatrat Cahan dhe Mujaj kemi karakteristikat e zonave fitoklimatike Fagetum dhe Castanetum. Jane kullotat alpine ne shpatet e Malit Pashtrik dhe masivet e pyjeve te ahut kufi me fondin e pyjeve komunal.Ky studim rekomandon qe dhe fondi i pyjeve te larte te Ahut qe aktualisht mbeten me regjim pronesie shtetror, te kaloje ne fond komunal. Kjo, pavaresisht se i mbetet te ardhmes, ka anet e mira si me poshte:

- 1.Te ardhurat shkojne aty ku krijohen.
- 2.Papullata e fshatrave Cahan e Mujaj,perfiton drejtperdrejt ne planin ekonomik.
- 3.Mundesia e rritjes e konvertuar ne mundesi shfrytezimi vilet nga vete fshataret dhe kjo shkon ne te mire te tyre.(me kontroll teknik rigoroz)



- 4.Rritet interesi dhe ky fond i pyjeve te larte ruhet qofte nga mbishfrytezimi, qofte nga degradimi,qofte nga zjarret. Kete pune me mire se fshati nuk mund ta beje asnjelloj strukture shteterore.
- 5.Ne keto kushte, zona e pyjeve te ahut mund te marre edhe destinacion me karakter hedonistik, duke siguruar te ardhura ne shume drejtime.

Ne zonen per te cilen hartohet ky projekt, takohen keto tipe te vegjetacionit potencial.

B. Klasa Quercetae pubescentis (Liosel 1971).

Ne kete klase ben pjese rendi Quercetalia pubescentis.

- 1.Grupimet me melleze dhe me shkoze.
- 2.Grupimet me qarr.

B. Klasa Quercetae robri petraea (Br.-Bl.&Tuxen 1943)

Si specie karakteristike eshte bunga (Quercus petraea L.) qe pas geshtenjes eshte druri me i dobishem ne kete klase.

Duke analizuar zhvillimin e perhapjen e llojeve, themi se ato jane pershtatur mjaft mire me kushtet stacionale te mjedisit. Nderhyrja e njerezve ne kete vegjetacion per te plotesuar nevojat, ka qene e vazhdueshme dhe per pasoje eshte vene re fenomeni i degradimit, ne bunge dhe qarr.

Sipas klasifikimit tipologjik fondi pyjor komunal mund te grupohet ne keto tipe.

- Pyje lisi me shoqerim.(shkoze,melleze,frasher,panje etj)
- Pyje lisi te paster.
- Pyje me shkoze te zeze.


Ne formularet e pershkrimet parcelar, jane percaktuar tipet, perzierja, shoqerimi, nenpylli si dhe shkalla e natyralitetit.Kjo shkalle eshte percaktuar si me poshte.

- Pyje natyrore, te cilet nuk e njohin nderhyrjen e dores se njeriut. Ato jane te virgjier. Per kete kategori ne bashki nuk behet fjale, per vete faktin e teritorit te urbanizuar.
- Pyje gjysemnatyror. Jane grumbuj afersisht natyrore sepse menyra e instalimit eshte natyrore, por njeriu ka nderhyre ne to here pas here per nevojat e tij personale. Ne kete kategori futen te gjitha pyjet e bashkise Krume.
- Pyje artificiale. Ne kete bashki pyje te tille nuk ka.

Jepet rekomandim qe ne te ardhmen, shoqerimet te ruhen, si vlere e paperseriteshme e biodiversitetit natyror.

Pyjet ne bashkine Krume

Jane dushkaja karakteristike te Shqiperise Qendrore dhe Veriore dhe shtrihen ne gjithe teritorin e bashkise Krume.Jane forma te perziera me speciet Q.petraea, Q.frainetto, Q.cerris, Q.pubescens,etj. Ne dushkajat e bashkise lisi gjendet i shoqeruar me ekzemplare te tille,si Fraxinus excelsior L. Acer



Pseudoplatanus L., *Acer tataricum L.*, *Sorbus aria L.*, *Crantz*, *Chotynus coggyria L.*, *Cornus mass L.*, *Juniperus communis L.*, *Forsythia europaea L.*, *Crataegus monogyna L.*, etj. Keto lloje kemi sugjeruar qe me masat e menaxhimit qe do te merren, te ruhen per ti dhene grumbullit shumllojshmeri, por edhe per vlerat e veçanta qe kane disa prej tyre.

Edhe nenpylli qe ekziston ne pergjithesi ne pyjet e lisit si *Cotinus coggyria Scop.*, *Juniperus communis L.*, *Cornus mas L.*, *Crataegus monogyna Jacq.*, *Rosa canina L.*, etj, jane me vlere dhe kemi rekomanduar qe te ruhen, si per vleren ne biodiversitet, ashtu edhe per prodhimet jodrusore qe japin. *Bimesia barishtore* e paraqitur me hollesi ne pershkrimin parcelar per çdo ngaster,

Paraqet nje potencial mjaft te mire qofte ne kuptimin e vlerave ushqyeshe per blegtorine, qofte ne vlerat mjeksore dhe eterovajore, qofte ne permiresimin e raporteve te biodiversitetit.

Ne kuptimin e potencialit natyror qe kane, me nje menaxhim te kujdesshem, synojme qe pyjet e lisit ne komune ti qojme drejt prodhimit te lendes se ndertimit te holle dhe te mesme, per te permbushur dhe nje nevoje ekonomike, qe eshte kerkesa qe ka tregu per kete produkt. Prerjet per gjeth do te vazhdojne edhe per nje fare kohe duke plotesuar nevojat e blegtorise, por gjithsesi duhet menaxhim teknik i mire per te shmangur degradimin e grumbullit. Pra kjo pune do te jete ne harmoni me kerkesat silvikulturore dhe drejt kufizimit ne te ardhmen.

Tipet E Pyllit

Nga pikpamja e kushteve stacionale. e zonalitetit vertikal dhe e gjeomorfologjise, kemi te bejme me nje vend tipik te pyjeve te lisit, te cilat karakterizohen nga rritje e shpejte dhe e shendeteshme. Ne zonen per te cilen hartohet ky projekt, takohen keto tipe te vegjetacionit potencial.

C. Klasa *Quercetae pubescentis* (Liosel 1971).

Ne kete klase ben pjese rendi *Quercetalia pubescentis*.

- 1. Grupimet me melleze dhe me shkoze.
- 2. Grupimet me qarr. (Krume, Mujaj)

B. Klasa *Quercetae robri petraea* (Br.-Bl.&Tuxen 1943)

Si specie karakteristike eshte bunga (Zahrisht) (*Quercus petraea L.*) qe pas geshtenjes eshte druri me i dobishem ne kete klase.

Duke analizuar zhvillimin e perhapjen e llojeve, themi se ato jane pershtatur mjaft mire me kushtet stacionale te mjedisit. Nderhyrja e njerezve ne kete vegjetacion per te plotesuar nevojat, ka qene e vazhdueshme dhe per pasoje eshte vene re fenomenet e degradimit, ne bunge dhe qarr.

Sipas klasifikimit tipologjik fondi pyjor komunal mund te grupohet ne keto tipe.

Si specie karakteristike eshte bunga (*Quercus petraea L.*) qe pas geshtenjes eshte druri me i dobishem ne kete klase.



-Ne llojshmerine nuk kemi gjykuar te japim rekomandime sepse ne fakt eshte ajo llojshmeri qe pershtatet me kushtet fitoklimatike dhe stacionale.

- Lloje si bunga,bungebuta,qarri,shparthi,me shoqerim frasher,panje,ulez,vadhe etj,me nenpyll ate qe kemi pershkruar ne fakt,eshte shume mire te ruhen.

- Pesha e ketyre llojeve ne grumbull eshte nje qeshtje qe diskutohet sepse eshte mire qe nga pylli i thjeshte te shkohet drejt pyllit te perzier, nga grumbulli me nje kat te shkohet drejt grumbujve shumekatesh.

4.21 SISTEMI I MENAXHIMIT TE PYJEVE

Per plotesimin e nevojave te perditshme te tyre, dhe ne varesi te gjendjes aktuale te pyjeve, jane percaktuar edhe format kryesore te menaxhimit te pyllit. Ne menyre te permbledhur kemi keto forma kryesore;

- pyje trungishte
- cungishte
- cungishte e përbërë
- shkurre.

Ne format e propozuara te menaxhimit (synimi), mbeshetur edhe ne idete e perdoruesve dhe idene e rritjes se cilesise dhe sasise se prodhimeve drusore, është lënë i hapur synimi përtej kufijve të këtij PM ne rastet e cungishteve, që te tentohet drejt konvertimit te tyre. Ky konvertim do te behet fillimisht ne cungishte te perbera, dhe me pas ne Trungishte.Megjithe kete ky eshte nje fakt qe lidhet me interesat e fermerit. Konvertimi nga cungishte ne trungishte, kerkon shume kohe dhe interesa mjaft afatgjate, qe bien relativisht ne kundershtrim me interesat e perdoruesit. Ne ne PM kemi sugjeruar mbajtjen e ketij sistemi menaxhimi por duke shfrytezuar kapacitetet stacionale dhe duke siguruar pyll cilesor.




Fig. - 36 Harta e gjendjes egzistuese, Bashkia Krume

Permirsimi i cungishteve

Ne fletet e pershkrimtit parcelar, jepet per cdo njesi mbareshtimi, masat qe do ndermerren, prioriteti dhe sasia e tyre. Kryesisht jane parashikuar te behen rrallime, ne parcelat ku diametri eshte mbi 4-8 cm. Ne cdo fshat jane parashikuar te behen nderhyrje permiresuese, ne varesi te gjendjes se pyllit, por edhe te propozimeve te perdoruesve.


Shfrytezimi i cungishteve dhe shkurreve

Shfrytezimi do te realizohet, duke mbajtur ne qender te vemendjes dy treguesit e meposhtem:

1. Mundesine qe ofron pylli me gjendjen qe ka dhe potencialin rigjenerues qe ofron.
2. Nevojat qe ka popullata per dru zjarri dhe lende ndertimi.
 - Nevojat bashkiake jane $5025\text{m}^3/\text{vit} \times 10 = 50250 \text{ m}^3/10 \text{ vjete}$.
 - Rritja ne Komune eshte $5338 \text{ m}^3 \times 10 = 53380 \text{ m}^3/10 \text{ vjete}$.

Nga sa shihet nevoja ze rreth 94% te mundesise vjetore te shfrytezimit. Ne procesin e shfrytezimeve te mbahet parasysh:

1. Prerja me te zgjethur (kopeshtore).
2. Prerja me perparesi e druveve te shtrember e te degraduar.
3. Prerja te jete dritesuese dhe ne funksion te llojeve e ekzemplareve cilesore.
4. Prerja te jete higjeno sanitare duke eliminuar druret e semure dhe te demtuar nga kerpuhdhat apo insektet.



5.Nderhyrja te behet me skema teknologjike te hartuara nga strukturat teknike.

Ngastra dhe n/ngastra pyjore

Ne te gjitha rastet eshte patur parasysh ndarja ekzistuese parcelare. Kjo edhe per faktin, se ne planet ekzistuese te inventarizimit per ekonomite pyjore qe perbjne zonen e projektit ndarja parcelare paraqitet e sakte.Për këtë jemi referuar në ndarjen egzistuese me kufij të qartë duke mos bërë ndryshime në ndarjen parcelare, ose duke bere ndryshime te vogla. Për ndarjen e parcelave dhe nënparcelave janë pasur parasysh edhe vetite stacionale e dendrometrike të kombinuara këto me të dhënat ekologjike. Për c’do ngastër janë pasur parasysh:

- Të dhëna ekologjike
- Të dhëna biometrike (përbërja, lartësia, volumi, rritjet)
- Të dhëna në lidhje me dendësine dhe moshën.
- Të dhëna strukturore që lidhen me faza të ndryshme të zhvillimit
- Vëzhgime të vecanta për ruajtjen e natyrës, mbrojtjen e mjedisit dhe ndikimet e tyre në mbarështrim.
- Të dhëna në lidhje me masat përmirësuese për ngastrën.

4.22 RITJA VJETORE E PYJEVE NE KRUME

Rritja mesatare vjetore per te gjitha pyjet e kaluara ne perdorim te Bashkise Krume eshte 5338 m³/vit, ose e raportuar per nje hektar eshte 2.95 m³/ha/vit.

1-Rritja vjetore per gjithë fondin komunal = 5338 m³.

2-Rritja e raportuar per 1 ha. = 2.95 m³/vit/ha.

Perllogaritja e rritjes eshte bereper cungishtet, per shkak se trungishte kemi vetem 6.6 ha.

Nga sa shihet rritja ne pyjet e rinise,eshte relativisht e mire dhe indirekt,edhe me kete tregues mund te veme ne korelacion klasat moshe-prodhimtari, gje e cila provon se puna ne terren ka qene me pergjegjesi dhe stafi teknik ka punuar me seriozitet.

Mundesia vjetore e shfrytezimit

Ne se do te veme ne nje korelacion teknik rritjen vjetore, pra teorikisht dhe mundesine e shfrytesimit vjetore me kerkesen qe ka bashkia ne nje vit per dru zjarri dhe lende ndertimi, me nje menaxhim te kujdesshem dhe me durim per pak vite, mund tja lejojme vetes qe te jemi optimis per nje bilanc pozitiv per sot dhe per te ardhmen.

-Me poshte te shohim raportet:

1-Ritja vjetore aktuale per pyjet komunale 5338 m³/vit.

2- Kerkesa qe aktualisht ka komuna 5025 m³/vit.


BILANCI eshte + 313 m³/vit. Gje qe do te thote se ne treg do te plotesohen dhe me nje menaxhim te kujdesshem pyjet do te rriten dhe rigjenerohen.



4.23 PRODHIMET DRUSORE, MUNDESIA VJETORE E SHFRYTEZIMIT

Mundësia e shfrytëzimit është sasia e prerjeve të llogaritura për nevojat e përdoruesve, për përdorim familiar, social apo për treg, e prerjeve në dobi të menaxhimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të grumbujve pyjorë (pastrime në fazë, rralime silvikulturale dhe tregtare) nga njëra anë dhe e potencialit rigjenerues që ka vetë pylli nëpërmjet rritjes vjetore nga ana tjetër.

1. Rritja vjetore në komune = 5338 m³/vit.
2. Kërkesa nga konsumatori komunal. = 5025 m³/vit.



Megjithatë raportet të cilat i kemi komentuar edhe më parë, për të ardhmen duhet të kemi parasysh dhe faktorët e mëposhtëm.

1. Raporti konsum – rritje vjetore, ndryshon nga fshati në fshat dhe pyjet në kuptimin zhvillimor kanë karakter disproporcional nga fshati në fshat. Ka fshatra në komune që kanë mjaft pyje të degraduar (Cahan, Mujaj, Gajrep), pavarësisht se ka dhe fshatra të tjera me pyje në gjendje mjaft të mirë (Zahrisht).

2. Në kuptimin e klasifikimit moshor pyjet janë në fazën “Te rinise” rralle “Te parapjekurise”. Kjo do të thotë se në lidhje me funksionet dhe menaxhimin që synojmë duhet që shfrytëzimet të jenë të kufizuara dhe lenda për nevojat e fshatit të tentohet të merret nga produkti që buron nga nderhyrjet silvikulturale. Pra të kemi “durim” edhe për disa vite deri sa ti sjellim pyjet në parametrat që dëshirojme.

Prodhimet pyjorë jodrusore

Në tabelën e mëposhtme, jepen sasitë dhe cmimet e disa prej prodhimeve jo drunore (bime mjeksore, fruta etj.)

Nr	Emërtimi	Sasia që grumb. kv/vit	Mundësia për grumbullim kv/vit	Cmimi mes. lek/kv	Sasia për 10 vjet, kv	Te ardhurat për 10 vjet (000 lek)
1	Cermedelli	3	165	3000	1650	4950
2	Dellinja zeze	17	90	5000	900	4500
3	Thana	25	95	4500	950	4275

4	Aguliçe	5	15	20000	150	3000
Te ardhurat per 10 vjet						16725

Ekosistemi i territorit të bashkise Krume përveç prodhimeve drusore, bujqësore e blegtorale është i pasur edhe me prodhime të tjera natyrale që përfitohen nga bimët e ndryshme industriale, mjekësore dhe aromatike që vegjetojnë në këtë ekonomi. Më kryesore këtu përmëdim dellinja,cermedelli,lajthia, trendafili i eger, thana,vadha, etj. Nje pjese e herbes dhe e frutave jane grumbulluar ne menyre spontane nga popullsia duke krijuar dhe demtime gjatë grumbullimit të tyre. Kjo ka ardhur per shkak se ne komunitet nuk eshte ngulitur nje ndergjegjesim i tille se kjo pasuri eshte me vlere te pazevendesueshme edhe per te ardhmen. Përveç këtyre në këtë ekonomi rriten dhe një numur i konsiderushëm bimesh me vlere industriale, mjekësore e aromatike si lule basani, njemijefleteshji, luleshtrydhja, kullumbria, tërfili,aguliçja etj. Mund të themi se bashkia Krume është zonë me pozicion interesant fitoklimatik për grumbullimin e bimëve mjekësore ne kuadrin e zhvillimit të qëndrushëm të zonës. Prandaj për sigurimin e te ardhurave nga grumbullimi dhe tregtimi i ketyre bimeve mjekesore kerkohet nje menaxhim me i drejte dhe i kontrollur mbi baza teknike




Foto.-3 Çeltite me aguliçe dhe femije qe e kane mbledhur per treg.

Funksionet kryesore

Funksioni kryesor i pyjeve te bashkise eshte ai prodhues. Kjo per faktin se ky ka qene edhe propozimi i banoreve si dhe ne fakt ka nderhyrje per nevojat e fshatit.Behet perjashtim per rreth 250 ha ngastra qe jane parashikuar per sekuestrimin e karbonit. Kuptohet qe ky eshte funksioni kryesor, ndersa pylli ka kryer dhe do te kryeje edhe funksine te tjera, sic eshte ai rekreativ, mbrojtes – prodhues, mbrojtes etj. Edhe vete banoret jane te ndergjegjshem per kete, dhe ne aktivitetet e tyre te perditshme ne pyll, do te konsiderojne edhe keto funksione te tjera.

Menaxhimi i risqeve

1. Prerjet te realizohen me rekomandimin teknik te pylltarit komunal ose te specialistit te DSHP.Natyra e prerjeve duhet te orientohet drejt asaj kopeshtore,pa prekur mbizoteruesit.
2. Popullata por sidomos barinjte te ruhen nga zjarret e mundeshme. Ne rast se nje gje e tille ndodh, atehere shpejtesia eshte faktori baze per izolim te shpejte dhe per shuarjen e tij.Te

organizohen struktura te MNZ, fshatqe dhe si komune. Te organizohet sistemi i vrojtimit dhe i sinjalizimit.

3. Prerja e gjethit pa kriter per blegtorine e degradon pyllin. Kjo pune te behet me drejtim teknik, duke marre masen e njome periferike dhe ate mase qe siguron dritesim per pyllin.
4. Ne rast semundjesh apo demtuesish, ne konsulte me specialistin te behet izolimi dhe asgjesimi i vates me groposje ose djegie.
5. Hyrja ne-pyll e njerezve te panjohur per çfaredolloj qellimi te behet me njoftim dhe te jete ne syte e perdoruesit dhe pylltarit komunal apo te DSHP.
6. Prodhimet e dyta te pyllit te merren me moton "vile por do vjelesh dhe vitin qe vjen".
7. Ekonomia e gjahut kerkon organizim me te gjere se kuadri i nje perdoruesi te vetem. Gjahu eshte i lakmuar nga vendasit dhe te huajt. Te mos gjuhet ne fazen e riprodhimit dhe mbi normat e lejuara. Te mos hyhet ne pyll per gjah pa shoqerim nga perdoruesi apo pylltari komunal. Te behet pune me e madhe per te sqaruar se çfare rendesie ka fauna.

Rigjenerimi natyral

Ne kushtet e vendit tone ne pergjithesi dhe te bashkise Krume ne veçanti, kur rigjenerimi artificial eshte i kushtueshem dhe me kosto te paperballueshme, e vetmja rruge mbetet gjetja e formave te menaxhimit per riparteritje natyrale. Ne rastin e cungishteve ne kete bashki forma e riparteritjes natyrale historikisht ka patur sukses. Kjo menyre e riparteritjes do te zoteroje edhe per te ardhmen por duke patur parasysh si me poshte:

1. Prerja do te behen me te zgjedhur duke ruajtur druret e shendetshem dhe zoterues.



drejtim të trashëgimisë kulturore, mund të sjellë përfitime të shumta ekonomike dhe sociale për destinacionin si rritjen e punësimit, rritjen e të ardhurave, zbutjen e problemeve sociale dhe rritjen e interesit për mbrojtjen e mjedisit.

Trashëgimia kulturore ne Krume

Prodhimet e artizanatit të sotëm kuksian, janë në vazhdim të traditave shekullore që datojnë nga koha Ilire. Tradita e poçarisë ka qenë një traditë e lashtë. Gdhendja e gurit, drurit, punimi i hekurit janë përdorur gjerësisht dikur për zbulimin e shtëpive, duke filluar që nga periudha e mesjetës e në vazhdim. Prodhimet qilimave të artizanave Kuksiane, kanë qenë po aq të famshme, sikurse dhe prodhimet e artizanave të Hasi dhe të Krujës. Një vend të rëndësishëm ka zënë përgatitja e kostumeve tradicionale popullore të grave dhe burrave. Ato janë ruajtur origjinale dhe janë një shprehje e qartë e identitetit Kuksian. Kostumet popullore, sidomos të grave, shquhen për bukurinë, elegancën, koloritin e pasur dhe shumëllojshmerinë dhe janë unike në llojin e tyre. Tradita e prodhimit të artikujve të tillë të artizanatit sot po humbet pasi numri i personave që merren me këto mjeshtri po zvogëlohet së tepërmi. Ka një gamë të gjerë veprimtarish kulturore-artistike që zhvillohen në këtë zonë, kryesisht në qendrën e saj të Krumes si manifestime, festivale, konkurse letrare, panairë, ekspozita. Festa të veçanta si Festa e Gështenjës, Festa e Patates, Dita e Artizanatit, Dita e Bujarisë, Festat e Komunave, Ditë Peshkimi, Festa e Mjaltit, Pelegrinazh Pashtrik, Dita Rajonale e Arsimit, Kolonia Kombëtare e Piktoreve "ArtKukës" janë aktivitete të cilat shërbejnë për të mbledhur komunitetin e zonës, por edhe për të tërhequr turistë. Edhe pse Kruma ka një histori të tijen të shkuar, apo edhe të afërt me mbështetjen e bërë popullsisë kosovare gjatë luftës në Kosovë, pak është bërë deri tani për evidentimin historik, apo edhe artistik, të kësaj periudhe nëpërmjet objekteve që mund të ktheheshin në një atraksion turistik.

Folklori koreografik i krahinës së Hasit përbëhet nga vallet, muzika, pantomimat, termat, elementet koreografike në lodrat dhe argëtimet popullore dhe etimologjia. Vallja ne Has, ashtu si në të gjithë vendin tonë, është pjesë përbërëse e jetës shpirtërore të popullit dhe një nga format e shprehjes së emocioneve dhe mendimeve të tij nga më të ndryshmet. Vallet praktikohen dhe sot e kësaj dite në raste festash dhe gëzimesh shoqërore e familjare.

Vallet e grave-Në krahasim me vallet e burrave, janë më të shumta në numër dhe gjejnë një praktikim më të dendur. Krijimet koreografike të grave, përta i përket gjinisë, formacionit, tematikës, ekzekutimit, strukturës dhe mënyrës së shoqërimit muzikor, paraqiten në tipe dhe lloje të ndryshme. Nga pikëpamja e gjinisë, ato i përkasin kryesisht lirikës, por ka edhe elemente epike, nga pikëpamja e formacionit dallojmë valle njëshe, dyshe, treshe dhe në grup, nga pikëpamja e tematikës dallohen disa valle, të cilat, në bazë të fabulës që trajtojnë, kanë marrë emërtimet përkatëse por mund të shtojmë edhe larminë e argëtimeve koreopantomimike.

Tabela 1- Burimet Turistike te bashkise Krume-Qarku Kukës



kënga epike, e cila i përshtatet atmosferës së përmbajtur e solemne si dhe shijeve ideoestetike të hasianit.


Tirqet janë veshja më tradicionale dhe tipike e burrave të Hasit. Një veçori për vallet e burrave përbën shoqërimi i tyre melodik, komponent ky i rëndësishëm, që influencon në fizionominë dhe larminë e tyre. Është dhe një tjetër fakt se vallet e burrave hasianë kurrë nuk janë luajtur pa u shoqëruar me muzikë. Ata thonë se: < asht zor me kçye n't'hat, sepse nuk ja din nrrimin e kajdes. Ndryshe nga kërcimet apo vallet e grave, ato të burrave kurrë nuk janë shoqëruar me këngë. Ky tipar është karakteristik për folklorin tonë koreografik të burrave në krahinat malore të Shqipërisë së Mesme, Veriore dhe Verilindore.

Përmbajtja epike e këtyre valleve lidhet me patosin heroik dhe frymën e tyre trimërore. Kjo duket më shumë në strukturën e motiveve, ku bien në sy kthesat e shumta të trupit, ngritjet e mëdha e të gjera të këmbëve gjysmë të thyera n'ajër, zhvendosjet e theksuara të këmbëve, lëvizjet e gjera e të prera të duarve, plastika monumentale e trupit dhe pozicionet e tij krenare, ngritjet e herë pas hershme në majë të gishtave si të diktuar nga dëshira për të qëndruar sa më lart e sa më lirshëm, përkuljet e prera e të forta të trupit, etj. Fryma trimërore e këtyre valleve manifestohet edhe gjatë interpretimit artistik të tyre prej valltarëve. Këta artistë popullorë dinë të fusin këtu shpirtin dhe talentin e tyre në funksion të mendimeve dhe përmbajtjes ideore të valles; prandaj ata i karakterizon një qëndrim serioz, krenar e burrëror. Ndërsa tek elementet lirike që hasen në vallet e burrave janë më tepër ndikime nga fondi koreografik i grave, gërshetime midis elementëve të këtij fondi me fondin e burrave ose elemente që lidhen me situata shpirtërore dhe ndjenja të caktuara të individualitetit krijues të kërcimtarëve popullorë.

Muzika- Një veçori për vallet e burrave përbën shoqërimi i tyre melodik, komponent ky i rëndësishëm, që influencon në fizionominë dhe larminë e tyre. Një ndër instrumentet që ka shoqëruar vallet e kësaj krahine, ashtu edhe ato të malësisë së Shqipërisë së Mesme dhe Veriore e Verilindore është çiftelia, *Sharkia, Culet, Tupanat, Fyelli e Bishnica*. Për shoqërimin e valleve të burrave instrumentat janë përdorur jo vetëm në mënyrë solistike, por edhe si grup. Dhe ky formacion në grup mund të jetë i përbërë prej instrumentash të njëjta apo të llojeve e familjeve të ndryshme. Në Hasin brenda kufirit për shoqërimin e valleve të burrave nuk janë përdorur kurrë instrumenta membranofonë si dajreja apo lodra, megjithëse këto, përdoren gjerësisht në shumë krahina malore të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, bile dhe në krahina kufitare me Hasin (Luma dhe Malësia e Gjakovës). Afrimi dhe lidhjet koreografike të Hasit me krahinat e tjera shtrihen në tregues të tillë si: struktura, trajta dhe formacioni i valleve.

4.25 MONUMENTET NATYRORE TE KRUMES

Kruma ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella si dhe liqenet dhe lumenjtë spektakolar. Është bërë një anketim me bizneset që operojnë në sektorin turistik, në kuadër të strategjisë së turizmit dhe planit të veprimit për rajonin e Krumës. Ky anketim tregon se rajoni



ka kapacitete turistike te pashfrytëzuara maksimalisht. Norma e zënies së shtretërve në hotele dhe shtëpitë pritëse është vetëm 17% në vit. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në rajon është 2.9 ditë. Shpenzimi për një ditë është 7.705 lekë pjesa më e madhe e të cilit shkon për akomodim, ushqim/pije dhe blerje. Strategjia e turizmit të rajonit përfshin një plan strategjik gjithëpërfshirës për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, si dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në këtë qark. Ajo merr në konsideratë njëherazi fokusin e politikës së BE-së për zhvillimin e turizmit dhe atë të strategjisë kombëtare që në thelb të dyja kanë si synim promovimin e aktivitetit ekonomik në zonat rurale të privuara dhe rritjen e cilësisë së jetës atje. Strategjia e vendit thekson gjithashtu zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor.

Bjeshkët e Krumës

Ofrojnë gjithashtu peizazhe të bukura, ajër të pastër dhe destinacion të favorshëm veror për banorët vendas. Potencialet turistike të zonës përfshijnë: Klimë të shëndetshme dhe bukuri natyrore Destinacione pelegrinazhi Kullota të pasura Shpellat si dhe pamje natyrore dhe arkeologjike, ngjitje alpinistike ne maje te Qytezes etj. Ngjitje në mal behet me makine nga Cahani ose ne kembe e kafshe nga Kruma.

Shpella e Daçit

Shpella e Daçit (2600 PES—1200 PES) rreth 10 km në lindje të Krumës. Kjo shpelle gjendet ne Lagjen Daç te fshatit Mujaj Eshte nje shpell shume kararkterisite ne lloin e vete ajo daton qe ne kohe shume te lashta nga germimet arkeologjike e kryera ketu tregojen se Kjo shpell eshte banuar qe ne lashtesi dhe gjithë zona per rrethe ka tuma te ndryshme. Ne ket shpell jan ber kerkime ne vitin 1985 -1987 nga arkiologu Muhamet Bela dhe sipas kerkimve kjo shpelle eshte e banuar qe ne epoken e bronzit hekurit e deri ne antiken e hershme. Gjat kerkimeve te ketyre vitve jan zbuluar shpata thika dhe lloje te ndryshme qeramikash. Si kjo shpell e ngjashme esht dhe nje ne Qytezen e Daçit dhe quhet shpella me oborr per te cilen nuk esht folur dhe kontrolluar asnjeher dhe ne afersi te ksaj lagje te fushat e robit ndodhen disa tuma te pa kontrolluar

Shpella e Pellumbave (Shpella e Llapatanava)

Kjo shpelle ka marr emrin e shpella e Pellumbave (ose ne te folmen e Hasit quhet shpella e llapatanave sepse aty qendroje shume pellumba te eger ne dimer dhe ne vere), ajo shtrihet ne vargmalin e Pashtrikut ne kufirin mes fshatave Vlaken , Dobrone, Nikoliq dhe Greçine. dhe shtrihet mes nje pyelli te dendur dhe nje bimesie shume te rralle e cila eshte shume e larmishme dhe ne pranvere pamja e luleve karakter te kesaj zone jane nje bukuri e veçant dhe shume terheqese, kjo zone vazhdimisht eshte pedorur si vend ekskursioni turistik nga shkollat e rrethit tone. kjo shpelle nuk eshte e eksploruar nga asnje njeri deri me sot, te pakten nuk ka te dhena te tilla. Megjithate ne pamje te jashte dhe kur futesh brenda ajo ka disa karakteristika te veçanta qe te josh te explorosh ne te.

Pisha e Gjinit

Kjo ka nje pamje shume te bukur e cila eshte shume karakteristike per zonen sepse e gjithe zona per rrethe eshte e zhveshur dhe e mbuluar me shkurre te vogla kjo pishe eshte si kurore mes tyre dhe fshatit prej mese nje shekulli, ajo eshte dhe mes dy burimeve te cilet jane ne mes te fshatit Gjinaj.

Burimet karakteristike.

Lumi i Krumes (Vrella) Ne vendin ku buron ky lume ka nje pamje shume te mahniteshme por per shkak te shfrytesimit te saj per uje te pishem ajo e ka humbur shume bukurine Por po te vazhdosh ne rredhen e saj deri ne lumin drin (Liqeni Firzes) ajo ka pamje shume te bukura ku per gjate gjithe rrjedhjes aty ka shume peme dhe veçanarishte arrat e saj karakteristike uji keti lumi perdoret nga fermeret per vaditje e tokave bujqesore.

Gurra e Domaj Eshte nje burim shume karakteristik me uje te kristalete qe akoma dhe sot ruan origanilitetin e saj pasi ajo nuk eshte transformuar si ajo e Krumes , legjendat thone se keto dy burime vijne nga bjeshket e Cahanit dhe kane te njejtin uje dhe rrejdhin nga i njeiti burim i nedheshme dhe per te vertetuar kete dhjetara vjete me pare ne nje shpell ne qender te Cahani eshte hedhur boje ne shpellle dhe kjo boje ka dal ne Vrellen e Krumes dhe ne Gurren Domajve. Ky burim karakteristik per gjate gjithe rrjedhjes se saj deri ne drdhjen ne drin shtohet me disa burime te tjera burime te vogla me uje shuem karakteristik ne pasterin e tij.

4.26 LLOJET E TURIZMIT

Turizmi rural

Zona funksionale e Krumes ka potenciale të rëndësishme të zhvillimit të turizmit rural e në mënyrë të vecantë të turizmit malor. Sasati në lartësinë e mbi 1700 metrave mbi nivelin e detit, është një vend mjaft tërheqës pasi në stinën e verës ai mbushet plot me vizitorë që qëndrojnë deri sa vjen dimri. Kanioni i Shkallës së Keqe (Gjallicë) është një nga më madhështorët me një thellësi prej 2000 m i paeksploruar deri më sot. Kroji i Bardhë, në malin e Gjallicës është një pikë turistike që po bëhet gjithnjë e më e njohur jo vetëm nga vendasit, por edhe nga turistë e gjuetarë nga zona të tjera të vendit. Pika turistike pranë Gurit të Mëngjesit në Shishtavec vizitohet nga vizitorët vendas dhe nga zona të tjera, apo nga Kosova.

Monumentet Natyrore	
-	Pisha e Gjergjanit
-	Gryka e Çajes
-	Cirku akullnajor i Zepes
-	Kroi i Bardhe
-	Kanioni i Bicajt
-	Kanioni i Vanave
-	Lisat e Kalisit
-	Karsti i Arnit
-	Keneta e Kukësit
-	Kroi i Kuq, Gjallice
-	Guri i Mëngjesit, Shishtavec
-	Guri i Shqipës (Borje)
-	Burimi i Kolosianit
-	Dushkajat e Novoset

Tab 2- monumentet natyrore



Një tjetër pikë turistike është edhe Pylli i Mështeknave, ku thuajse çdo ditë janë të pranishëm vizitorë të ardhur nga zona të ndryshme, madje edhe të huaj, kryesisht nga Kosova. Po kështu ndodh edhe me stanet e Novosejit, "Kroji i Kuq", 'Kroi i Bardhë", që kanë nisur të vizitohen jo vetëm gjatë verës, por edhe në dimër. Në zonën e bjeshkëve në Shishtavec ndodhet një shkëmb i lartë në mes të gjobërimit dhe të një bari të rritur shëndetshëm. Banorët e quajnë Guri i Mëngjesit sepse aty lind dielli. Pranë liqenit artificial të Kallabakut, ndodhet fshati i vogël turistik i Novosej i pasur me lugina të gjelbëruara dhe pyje.

Zhvillimi i turizmit malor ka bërë hapa të rëndësishëm përpara duke çuar në shtimin e numrit e banesave turistike në zonat rurale. Po ashtu edhe ndërtimi i autostradës, dhe i aeroportit të Kukësit kanë krijuar mundësi efikase për zhvillimin cilësor të turizmit malor, për të cilin kërkesat janë gjithnjë në rritje si nga vizitorët nga shqipëria dhe zonat e Kosoves, si Prizrenit e Dragash. Marrëveshjet ndërmjet Qarkut, Bashkisë e komunave po i japin një zhvillim këtij lloj turizmi.

Turizmi Natyror -Dimëror

Zona e Shishtavecit njihet si një nga zonat ku, edhe pse modest, zhvillohet turizmi dimëror. Ushtrimin i sportit të skive tashmë realizohet tashmë prej më shumë se 7 dekadash. Në të kaluarën, si rezultat i masivizmit të sportit të skive, mes Shishtavecit dhe Voskopojës ndahej vit pas viti organizi i kampionateve të skive. Kjo praktikë më ardhjen e tranzicionit është ndërprerë. Shishtavecit ka sot ekipin e tij të skive të federuar nga Federata Shqiptare e Skive dhe po ashtu edhe fshati Mborje. Fshati Novoseje njihet për mundjen dhe fshati Borje për hipizmin. Ndërsa pika të tjera turistike si Kroji i Ramës, Kroji i Kishës dhe Kroji Tatzot, vizitohen vetëm nga pasionuarit pas alpinizmit dimëror.

Në se flasim për turizmin ndërkuftar apo marrëdhënie të tjera në këtë hapësirë, sërish Shishtavecit ka përparësi të dukshme, për shkak të pozicionit, potencialeve njerëzore, ekonomike e kulturore. Turizmi përbën prioritetin e parë për zhvillimin e Komunës së Shishtavecit, e cila zotëron burime të virgjëra natyrore e të pa shfrytëzuara. Gjithashtu edhe në Komunën e Tërthorës, megjithëse infrastruktura ka bërë që bjeshka të mos frekuentohet, mbetet një resurs i pashfrytëzuar për turizmin alpin për vitet e ardhshme. Kjo është shprehur qartë edhe në Planin e Zhvillimit të Komunës e ka nevojë për incentiva që të mund të zhvillohet.

Në Bicaj për shembull, e gjithë pjesa e bjeshkës (duke filluar nga Laku i dardhës e deri tek kroi i kuq) është një vend i mrekullueshëm për vizitorët dhe turistët që janë të interesuar për klimën e freskët malore. Para disa vitesh në këtë zonë kalonin pushimet verore mjaft vendas dhe të huaj. Zhvillimi i turizmit shoqërohet me zhvillimin e prodhimeve bujqësore, blegtorale, riparimin, përmirësimin e shtëpive të banorëve, rregullimin/ ngritjen e vendeve të përshtatshme për kalimin e kohës së lirë të vizitorëve, si dhe përmirësimi i prodhimeve lokale, etj. Duke pasur parasysh natyrën shumë të pasur të kesaj zone, zhvillimi i turizmit mund të jetë gjithëvjetor duke u shfrytëzuar për gjatë gjithë stinëve të vitit.

Turizmi Liqenor

Zona e Krumes shtrihet në anën juglindore të liqenit artificial të Fierzës. Ekzistenca e liqenit në

këtë zonë është një potencial i madh për zhvillimin e turizmit, pasi pika të caktuara të tij mund të shfrytëzohen gjatë verës si plazhe që mund të përdoren nga banorët vendas si pika për larje dhe banjo dielli, por njëkohësisht mund të frekuentohen edhe nga banorët e zonave kufitare më Kosovën, të cilëve të tilla vende ju mungojnë. Po kështu, edhe zhvillimi i akuakulturës është një potencial për t'u konsideruar pasi liqeni i Kukësit njihet për peshkun që rritet aty, i cili sot preferohet nga turistët që vizitojnë qytetin. Sporte të tilla si garat me kanoe mund të jenë një mundësi e mirë për t'u zhvilluar nisur nga sipërfaqja e madhe e liqenit dhe lidhja e tij me degët e Drinit.

Por marrja e masave për pastrimin dhe mbajtjen pastër të liqenit dhe krijimin e infrastrukturës së duhur për sportet liqenore apo pikat e plazheve përgjate liqenit duhet të jenë në vëmendjen e autoriteteve lokale.

Përmbledhje skematike e Avantazheve dhe Problematikës që has sektori i turizmit jepen në figurën e mëposhtëme



Figura 38: Avantazhet dhe Problematika e Sektorit të Turizmit


Edhe pse potencialet ekzistuese janë të mëdha zhvillimi i turizmit në këtë zonë has disa sfida, të cilat paraqiten më poshtë:

< **Kapacitetet akomoduese:** Në qytetin e Krumes janë në funksionim 10 hotele bujtina janë ndërtuar në zonën e Shishtavevit. Krahas tendencës në rritje të numrit të bujtinave, jo rrallë shumë prej turistëve kalojnë natën në banesat e banorëve vendas, apo në verë edhe në çadra. Ndërsa rritet numri i vizitorëve, i domosdoshëm mbetet zgjerimi i shërbimit të hotelerisë, përmes ndërtimit të hoteleve turistike, apo bujtinave në zonat e thella malore. Vihet re tendenca e ndërtimit të bujtinave nga qytetarë të larguar prej kohësh drejt kryeqytetit, të cilët po i rehabilitojnë banesat e tyre duke i kthyer në bujtina.

< **Cilësia e shërbimeve** megjithë përmirësimet e kohëve të fundit ende mbetet një problem që kërkon vëmendje dhe ngritje të kapaciteteve e akukeshtësive të si menaxheriale edhe të shërbimeve;



- < **Infrastruktura e dobët:** problemet me infrastrukturën rrugore, të furnizimit me energji elektrike, kanalizimeve, furnizimit me ujë, ndikojnë direkt në cilësinë e shërbimit dhe lehtësimin e aktivitetit turistik
- < **Sinjalistike rrugore e dobët;**
- < **Mungesa e promovimit intensiv** nëpërmjet rritjes së marketimit dhe informacionit, duke shfrytëzuar operatorët e ndryshëm turistikë



Harta 39: Përqëndrimi i hoteleve dhe bujtinave

Problem i pronave dhe ndërtimet pa leje, sjell një ndikim negativ si në lidhje me sigurinë e zhvillimit të bizneseve në këtë fushë edhe me problemet e zhvillimit urban në funksion të turizmit.

Mungesa e një qasje të koordinuar dhe të integruar të ofertës turistike: edhe pse produktet turistike në zonë në momentin aktual mbeten të limituara, për të rritur sa më shumë mundësinë e shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese është e nevojshme që të zhvillohen paketa të cilat integrojnë ture të alternuara së bashku me zona të tjera si Valbona, apo dhe me pikat në vendet kufitare si Sharri, Brezovica në Kosovë, në mënyrë që të rrisi mundësinë e thithjes sa më shumë të turistëve vendas e të huaj duke i ofruar në të njëjtën kohë një program të alternuar. Zhvillimi i rrjetit të bujtinave do të ndihmojë në koordinimin e përpjekjeve për të ofruar sa më shumë mundësi akomodimi të kërkesave në një periudhë të vetme. Nga kjo analizë del në pah se Hasi ka burime të shumta për zhvillimin e turizmit në një sërë degësh të tij por nga ana tjetër vërehen dhe një sërë mangësish të cilave duhet t'u jepet zgjidhje sa më shpejtë, dhe kjo mund të arrihet vetëm në rastet kur hartohen politika turistike të studiuara mbi bazën e gjendjes aktuale në të cilën ndodhet zona, dhe duke mbajtur parasysh një qasje të integruar.

4.27 TURIZMI NË BASHKINË KRUMË DHE PËRGJEGJËSIA E QYTETARËVE

Turizmi në Bashkinë Krumë është tokë djerr dhe ka shumë për të thënë e për të bërë. Tre janë rrugët për promovimin e turizmit:

1. Ajo e marketingut, ku të zotërojë një koncept i ri për publikime;
2. Ajo e infrastrukturës mjedisore, për mbetje urbane, për ujëra urbane dhe ujë të pijshëm;
3. Ajo e infrastrukturës rrugore;

Kjo kërkon që të arrihet të krijohet një mbulesë pozitive me anë të medias së shkruar e vizive, si dhe të dixhitalizohen të dhënat turistike, që shteti të ketë kurdoherë situatën në dorë, për rrjedhojë duhet të ketë CD turistike.

Ka ardhur koha që turizmi të konsiderohet dhe duhet të jetë kontribut i te gjithëve, sepse të gjithë përfitojnë prej tij. Imagjinoni një turist të huaj apo vendas, i cili vjen për turizëm dhe “qethet” për disa vlera të tjera të veçanta. Në këto kondita duhet të nxiten festa tradicionale, qoftë dhe ato pagane, folklorike deri në ato të sotmet, si Sofra ilire, Festivali i piktorëve të vegjël, Konkurse dhe pazare një javore të ullirit, të rakisë, verës, konkurse të sajuara për diçka karakteristike të zonës, të ndeshjes së kaponjëve. Jo vetëm kaq, të nxiten dhe të mbahen gjallë nivele të reja e të caktura turistike, ku studiues, operatorë, vizitorë dhe studentë të mund të përkushtohen në studime mbi kafshët dhe shpezët endogjene, shtegëtarë, folepërkohshëm, etj., mbi speleologjinë, mbi gjeologjinë, etj.

Ka ardhur koha, të mendohet dhe të organizohet një grup të rinjsh, ku mbasi të trajnohen për menaxhim të problemeve mjedisore dhe të turizmit kulturor të kthehen në berthama kyçe për ngritjen, nxitjen dhe formatimin e niveleve turistike. Në funksion të turizmit kulturor vjetor mund dhe duhet të nxitet roli i të rinjve drejt tij dhe nëpërmjet një cikli të rregullt shkollimi, të rinjtë do të kualifikohen në fushën e mjedisit (trajtim i integruar i mbetjeve bashkiake, të mbrotjes dhe ruatjes së mjedisit), në fushën e vlerësimit dhe të ruatjes së gjeomonumenteve natyrore, në fushën e vlerësimit dhe të ruatjes së monumenteve kulturore, në fushën e vlerësimit dhe të përdorimit të burimeve natyrore, në fushën e njohjes dhe vlerësimit të gjeorreziveve natyrore, në fushën e vlerësimit dhe të zhvillimit të trashëgimisë kulturore (veshje, gatim, këngë, muzik). Çdo njësi administrative do të ketë 2-3 persona, që më vonë pas një kualifikimi do të jenë të aftë të hapin qendra apo axhensi, duke shumëfishuar punësimin në njësitë administrative përkatëse, të denjë të marrin përsipër informimin e turistëve në rolin e guidatorit, përgatitjen e guidave për të gjitha nivelet e sipërmendura, shoqërimet dhe cicërimet për në vendet e caktuara turistike, krijimin e festave dhe kthimin e tyre në simbol apo traditë për të tërhequr turistë deri në rolin e organizatorit të brendshëm në kuadrin e një operatori apo axhensie turistike. Detyra e tyre do të jetë të qenurit këmbëshpejtë, të qenurit organizatorë, të qenurit menaxherë, të qenurit kujdestarë të të gjitha festave nacionale, lokale, tradicionale. Ata do të kujtojnë dhe bashkërendojnë aktivitetin me vendimarrësit, dhe duke qenë pjesë e shoqërisë civile edhe do t'i kontrollojnë ata. Kështu do të ngrihet një filozofi, ajo e bashkimit të popujve, të kombeve, por edhe të vetë njerëzve të një kombi apo të një qyteti, nëpërmjet ambasadorit të saj, “turizmit kulturor”.

Kështu do të rritet përgjegjësia e qytetarëve për të zgjedhur alternativën e tyre të zhvillimit.



Turizmi në Bashkinë Krumë - vlerë e pavlerësueshme

Sot, turizmi dhe kultura po kthehet në një plan konkret veprimi, duke i paraprirë strategjive të tjera, si asaj të transportit dhe të mjedisit. Në praktikat botërore, turizmi dhe kultura përgjithësisht pararendet nga infrastruktura rrugore dhe ajo mjedisore, ndërsa këtu, ajo i thërret të ecin të paktën paralel, si në një sinenergji me kalje pozitive. Kjo zonë mund të ofrojë turizëm të tipit:

1. harabel (njëditor),
2. të tipit dallëndyshe (kthim i një grupi njerëzish në të njëjtin vend),
3. tipit rosë (turistë që vijnë në grupe të vogla nga larg në një vend me tipare të veçanta),
4. të tipit pulëbardhë (turistë që vijnë në grupe të vogla nga larg në një vend me veçori kulturore e mjedisore).

Në varësi të këtyre tipeve, turistët ndërkombëtarë dhe ata vendas kanë shumë mundësi të vijnë dhe të bien në “grackën” e llojeve të mëposhtme të turizmit (nëse reklamohen dukshëm vlerat e tyre), si ai gjeomumental, gjeografik, speleologjik, ekoturizëm, gjeoturizëm, agroturizëm, turizëm familjar, turizëm të pensioneve, turizëm malor, aventuror, sporte popullore, sportiv (ski, hipizëm,), gara me motora, makina, festa fetare, ditë të shënuara, pelegrinazhe, etnografik, turizëm muzeal, turizëm historik, pajtone, karnavale, pazare artizanale, shkolla artizanale, etj. Si asnjëherë më parë, duket se po instalohet psikologjia, se nuk është shteti dhe qeveria, që zhvillon një vend turistik, por njerëzit me përgjegjësinë e tyre, që zgjedhin filozofinë bazë të zhvillimit të tij, duke filluar nga kontrata morale dhe e gjelbërt me natyrën, me qeverinë deri në atë me vehten. Çfarë? Të llobojnë për një infrastrukturë rrugore, të llobojnë që të zgjidhin më parë problemet mjedisore, të llobojnë që të mirë menaxhojnë burimet natyrore, ku inxhiniera, mendimtarë e edukatorë të formojnë filozofinë, se zhvillimi bëhet me projekte, projektet bëhen me studime, studimet bëhen me punë dhe puna do mendje, krahë e zemër, por mbi të gjitha shpirt, madje shpirt vullkan.

Nxitja e turizmit familjar në Bashkinë Krumë

Turizmi sot në Bashkinë Krumë ndodhet në një fazë më të lartë se ai diell-ujë, për shkak se presupozohet dhe kërkohet një shtrirje e sezonit turistik, ku pothuajse gjithë viti duhet të jetë i tillë. Objekte dhe tradita me vlerë mund të ofrojnë turista, por problemi qëndron te fakti se çfarë di qytetari i Tiranës apo i Prishtinës për turizmin në Krumë. Brenda kësaj zone ka zbulime, që të çojnë deri në mijëvjeçarin e tetë dhe një turist kupton qëndrimin e një kombi ndaj vlerave të trashëgimisë kulturore, çka tregon edhe shkallën e civilizimit të tij. Nga ana tjetër kërkohet të dixhitalizohen të dhënat turistike, që turisti të ketë kurdoherë situatën në dorë. Për këtë mund të realizohet:

- Ngritja e një zyre të thjeshtë turistike;
- Turizëm komplementar dhe jo konkurrencë, për të plotësuar atë që i mungon një qyteti tjetër. Kombinimi i turizmit familjar me atë hotelier;

Por, mund të kryhen edhe nivele të tjera të turizmit si ai:

- i piktorëve ndërkombëtarë,
- i verërave,

- lëvizja me kafshë,
- lojra sportive,
- turizëm mjedisor,


Kombi ka përgjegjësinë e vet për vlerësimin e personaliteteve. Figura të shquara të tilla mund të përdoren si ikona me vlerë.

Mënyrat:

1. Ndërgjegjësimi i banorëve për rritjen e potencialit turistik;
2. Rritja e cilësisë së shërbimit turistik;
3. Zhvillimi i infrastrukturës lokale;

Hapat:

1. Takime ndërgjegjësuere me banorët;
2. Seminare për ndërgjegjësimin, si dhe njohjen e vlerave kulturore dhe turistike të zonës;
3. Organizimi i një fushate publicitare nga strukturat e turizmit për tërheqjen e turistëve;
 - përgatitjen e fletëpalosjeve;
 - pankarta apo tabela orientuese gjatë rrugës;
 - publicitet në median elektronike dhe të shkruar;
 - përgatitja e videoklipeve me pamje të zonës;
 - pasqyrimi i tyre në çdo panair, ku Ministria merr pjesë.
4. Rritja e cilësisë së shërbimit turistik, duke u bazuar në trainime të organizuara me banorët, kryesisht gra si:
 - gatimin tradicional;
 - kushtet higjienike të nevojshme për turistët;
 - mënyrën tradicionale të të jetuarit, duke krijuar në këtë mënyrë interes më të madh për jetesën e turistëve në fshat;
 - ngritjen e një pazari artizanal dhe një shkolle artiznale.
5. Krijimi i një shoqate mjedisore turistike, e cila do të shërbejë si urë lidhëse e komunikimit me qytetin, duke siguruar transportin e turistëve në zona të veçanta të qytetit;
6. Përgatitja e një guide sezonale, e cila do t'i orientojë banorët apo personat përgjegjës në fshat për kujdesjen dhe organizimin e turistëve në pika dhe vende të ndryshme përreth, si dhe shëtitjet me varka në liqen;
7. Hapja e një dyqani apo mini-tregu në fshat për shitjen e sendeve tradicionale të zonës, si dhe libra apo revista me pamje të zonës, kulturën e tyre, libra gatimi tradicional, etj.



Zhvillimi i infrastrukturës së zonës,

1. Sistemimi i mbeturinave urbane. Pra, pajisja me kazane dhe kosha, jo më larg se 100m nga njëri-tjetri, kur dihet se:
 - Kosha me plehëra jashtë
 - Kosha me plehëra brendaAtje, ku mungojnë kosha
2. Përmirësimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimit të zonës.
3. Ndërtimi i një stacioni pastrimi për ujërat e përdorura urbane, stacion ky të cilit mund t'i përshtatet modeli i trajtimit me lagunazh.
4. Përmirësimi i sistemit të ndriçimit.
5. Sistemimi i bregut të liqenit dhe krijimi i kushteve komode për bërjen e plazhit, etj.
6. Ndërtimi i një pontili për ankorimin e varkave turistike.
7. Ndërtimi i rrugës lidhëse fshat-qtet, si dhe ndonjë rrugë tjetër me infrastrukturë të pazhvilluar.

4.28 HAPAT PËR NJË TURIZËM TË QËNDRUESHËM

Kjo duket të jetë një përpjekje diplomatike dhe politike. Mbulimi në shtypin ndërkombëtar vazhdon të jetë neutral deri në negativ. Bashkia në fjalë, sikundër dhe vetë shteti ynë nuk e kanë menaxhuar me shumë sukses këtë aspekt të imazhit publik të saj. Turizmi, natyra dhe kultura ofrojnë mundësi të shkëlqyera për të dhënë mesazhe pozitive. Ndaj lipsen hapa të sigurtë, të mëdhenj e të qëndrueshëm dhe të një kuadri të gjerë si:

Hapi - 1 Hartimi i profilit për tregun e turizmit, duke përcaktuar segmentet ekzistuese dhe ato prioritare potenciale të tregut. Ndaj dhe hapi fillestar është zbulimi sa më shumë të jetë e mundur i karakteristikave të këtyre segmenteve të tregut. Kësisoj rezulton së janë 14 segmente të ndryshëm tregjesh që zotërojnë potenciale për të nxitur vizitat në këtë bashki. Bazuar në analizat e përgjigjeve të pyetjeve për secilin segment, radhiten si me të rëndësishmet për zhvillimin e turizmit në zonën në studim:

1. Turistët e malit;
2. Turistët familjarë që vijnë të shlodhen;
3. Turistët e apasionuar pas sportit;
4. Turistët e apasionuar pas natyrës;
5. Turistët që vizitojnë miqtë dhe të afërmit;

Hapi - 2 Lista e vlerave turistike, të cilat tregojnë një vlerë në industrinë turistike të zonës si: Vlerat-Tërheqjet Turistike, Ngjarjet dhe Aktivitetet:

1. Uji i mirë dhe ajri i pastër;
2. Natyra (pylli) dhe klima e shëndetshme malore;
3. Mikpritja e popullsisë lokale dhe përfaqësuesve të biznesit;



4. Bujtinat;
5. Punishtet e prodhimit.

Hapi - 3 Lista e problemeve të turizmit

1. Ide ose vlera turistike potenciale, të cilat nuk janë vënë në përdorim (promovimi i historisë);
2. Humbja e bukurive natyrore, për shkak të prerjes dhe djegies së pyjeve natyrore;
3. Mungesa e një vendi të përshtatshëm të depozitimit të mbeturinave;
4. Mungesa e fondeve për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sportive, festivaleve dhe festave.

Probleme të infrastrukturës Turistike

- Problematika në pronësinë e tokave private dhe shtetërore;
- Mungesa në infrastrukturën urbane;
- Mungesa e energjisë elektrike;
- Mungesa e shkollave profesionale, shkollave teknike të turizmit;
- Mungesë njohjeje mbi stilin e jetës së të huajve dhe mbi pritshmëritë e tyre;
- Mungesa e operatorëve turistik;
- Mungesa e një fushe skish dhe teleferiku;

Për të realizuar hapat e mësipërme dhe për të kapërxyer problemet që ka zona, do të kërkoheshin në një kuadër më të ngushtë hapat e vogla, por shumë të rëndësishme, si më poshtë:

I. Zhvillimi i një koleksioni me materiale promocional

1. **Zhvillimi i një koleksioni me materiale promocional** për turizmin ndërkombëtar, për t'ju shpërndarë shtypit dhe i një stende me materiale të printuara, video, shkrime dhe materiale të tjera që lejojnë një prezantim të lehtë të zonës në çdo vend me prioritet.
2. **Rritja e mbulesës pozitive nga media në tregjet e synuara.** Bashkia duhet të jenë më agresive në komunikimin e mesazheve pozitive në tregjet e synuara. Lajmet pozitive mbi çështjet natyrore dhe kulturore duhet të sigurojnë përfitime të rëndësishme.
3. **Të punohet ngushtë me Diasporën Shqiptare.** Është shumë e rëndësishme që Shqiptarët jashtë vendit të ndjehen krenarë dhe të kenë dëshirë të vizitojnë Shqipërinë dhe Krumën me farefisën dhe miqtë.
4. **Pajtimi i një firme ndërkombëtare për marrëdhëniet publike** me eksperiencë në pozicionimin strategjik të destinacioneve të turizmit.
5. **Angazhimi në një përpjekje agresive** për të rritur praninë e Shqipërisë në publikimet e drejtuesve të opinionit.
6. **Investimi për prani në hapësirat e "paguara" të një reviste me cilësi të lartë.** Profesionistët e marketingut provojnë se një artikull i mirë rreth një produkti apo destinacioni në një publikim të besueshëm është 5 deri 10 herë më i vlefshëm se sa e njëjta shumë e paguar në hapësirën e reklamave të të njëjtit publikim. Rritja e kontakteve ndërmjet kompanive të specializuara të udhëtimit që sjellin udhëtarë në tregjet e synuara dhe

kompanive lokale të turizmit

7. **Rritja e pranisë në panairët kryesore** që karakterizojnë destinacionet e turizmit të natyrës, kulturës, aventurës dhe atij “alternativ”. Panairët tregëtare konsiderohen nga shumica e vendeve promotorë si një “djall i nevojshëm”.
8. **Organizimi i një Panairi Ndërkombëtar** “Turizmi në Krumë”, sepse vendi më i mirë për të treguar Krumëën është vetë Kruma.
9. **Forcimi i pranisë së Krumës në internet.** Hartimi i një strategjie për praninë e përgjithshme në internet që përfshin një gjeneratë të dytë të Website-it të Entit Kombëtar të Turizmit për të përfshirë shpjegime më të detajuara dhe informacion mbi rrugët si dhe kontaktet me kompanitë e licënuara të turizmit dhe portalin e sektorit privat.

II. Krijimi i mekanizmave financiare afatshkurtra

1. **Mekanizma dhe struktura të tjera** duhet të krijohen për të siguruar rritjen e fondeve për mbrojtjen e zonave natyrore dhe zhvillimin e turizmit.
2. **Kërkim agresiv** për financime të huaja shtesë.
3. **Mbajtja dhe zgjerimi i mekanizmit financiar** që përdoret aktualisht për të ardhurat nga pyjet dhe gjuetia, në të cilin mbahen në një llogari të veçantë 70% e të ardhurave të caktuara automatikisht për ri- investime në zonat natyrore.
4. **Pagesa e shërbimeve të mjedisit.** Ekosistemet (në veçanti pyjet) sigurojnë shërbime jashtëzakonisht të vlerësueshme për ekonominë, që nuk janë mallra tregu tradicionale (psh., ato nuk kanë çmim). Këto ekosisteme sigurojnë ndërmjet të tjerave: mbajtjen e ujit dhe filtrimin, kontrollin e klimës (globale dhe lokale) mbajtjen e faunës dhe të biodiversitetit, bukuritë natyrore, hapësirat për çlodhje. Shumë vende kanë filluar të krijojnë tregje të brendshme për të njohur vlerën dhe për të korrigjuar deformimet ekonomike që kanë çuar në përdorimin e tokës nën optimumin e saj.¹
5. **Krijimi i mekanizmave të rinj financiarë** për të drejtuar fondet drejt zonave natyrore.
6. **Përsheptimi i zhvillimit dhe miratimi i planeve të turizmit për zonat natyrore.** Mbarështrimi tradicional i zonave të mbrojtura ka nevojë për zhvillimin e planeve të mbarështrimit të përgjithshëm që përfshijnë si komponent edhe planet e turizmit.
7. **Ngulitja e kulturës së “Parkut Kombëtar” ndërmjet shqiptarëve duke filluar me Munellën.** Kjo përpjekje do të fokusohet në tre aspekte kryesore të këtij: Mali për të filluar edukimin e shqiptarëve mbi rëndësinë e “kënaqësisë dhe përkujdesjes për parqet”.
8. **Standartet e sinjalistikës.** Krijimi dhe zbatimi i standarteve nacionale për sinjalet e ekoturizmit, në atraksionet dhe vendet me interes, duke u bazuar në simbolet dhe ngjyrat e

¹ Për shembull, në shumë vende hidrocentralet u paguajnë pronarëve të tokës (përfshi zonat e mbrojtura) për të mbajtur apo rritur mbulesën pyjore në basenin e tyre në mënyrë që të sigurojnë rrjedhjen e ujit, sidomos në stinën e thatë, kur uji është në sasi më të pakët (apo çmimi i blerjes së energjisë është më i lartë). Në teori, taksat për hyrje në park janë një tip i pagesës së shërbimit mjedisor, nëse fondet janë përdorur për mirëmbajtjen apo rivlerësuar parkun.

njohura në nivel ndërkombëtar. Këto standarde duhet të bëhen pjesë e Planit të Zhvillimit nga pushtetet vendore.

III. Krijimi i mekanizmave financiare afatgjata

1. *Mekanizma dhe struktura të reja* për të siguruar rritjen e financimeve për mbrojtjen e vendeve kulturore dhe zhvillimin e turizmi
2. *Mekanizma ekonomike për të ngadalësuar shkatërrimin e ndërtesave historike dhe trevave.* Kostoja e lartë e mirëmbajtjes së ndërtesave historike kombëtare në pronësi private është përtej mundësive të shumë (në mos të shumicës) pronarëve privatë. Zonimi i vendosur saktë dhe legjislacioni i planifikimit urban krijon rregullat dhe qëndrimet e lejueshme.
3. *Eksplorimi i suksesshëm (ose jo) i eksperiencave të vendeve të tjera* në krijimin e mekanizmave ekonomike për ruajtjen e ndërtesave private historike.
4. *Rritja e përpjestimit për ndarjen e shpenzimeve* për rehabilitimin e ndërtesave historike për bujtina (hane) dhe për infrastruktura të tjera turistike. Spanja ka një sukses të veçantë me sistemin e saj të “Paradores”, duke promovuar përdorimin e “kështjellave, pallateve, manastireve dhe ndërtesave të tjera unike të pasurisë së Spanjës” në një rrjet hotelesh historikë dhe bujtinash (hanesh) “të cilësisë së lartë”. Në mënyrë të ngjashme Franca ka patur sukses në promovimin e një rrjeti kombëtar me synime të njëjta të “Bujtinave (haneve)” (*auberges*) dhe të “Shtëpizave buzë detit” (*chalets*).
5. **Përmirësimi i aksesit kulturor në muzeume.** Pika e dobët, sigurisht jo vetëm në Krumë, por si kudo janë muzeumet që jo vetëm mungojnë, por edhe kur ekzistojnë kanë mungesa të informacionit shpjegues kuptimplotë (në shqip apo anglisht). Fillimi i një projekti pilot me ngritjen dhe plotësimin e disa shtëpive muze për figura të shquara të Bashkisë Krumë.
6. *Mbështetja, rivlerësimi dhe publikimi i ngjarjeve kulturore dhe i festivaleve folklorike.* Kultura e jetesës është një produkt turistik tepër i kërkuar. Një numër i madh turistësh kërkojnë të planifikojnë udhëtimet e tyre që të përputhen me ngjarje të rëndësishme folklorike (konkurse të valleve dhe muzikës, ngjarje fetare, ditë festive, festime lokale të zonës, shfaqje të rëndësishme vallesh dhe muzike, etj.).
7. *Publikimi i ngjarjeve ekzistuese.* Bashkia Krumë ka një numër të madh ngjarjesh të tilla që duhet të paktën të dokumentohen dhe të vendosen në një “kalendar kombëtar dhe rajonal zyrtar të ngjarjeve kulturore”. Ky informacion do të duhet të publikohet në wëb-site-in kombëtar dhe lokal të turizmit dhe të përfshijë historinë e ngjarjes, përshkrimin e veprimtarive, fotografi dhe deklarata të shkurtra dhe lidhjet në internet (links) me kompanitë e turizmit të afta për të siguruar shërbimet.
8. *Zhvillimi i një plani afatgjatë* për të drejtuar mbështetjen e sektorit shtetëror dhe privat në ngjarjet prioritare kulturore me interes për vizitorët e huaj.

IV. Burimet njerëzore



Bashkia duhet të investojnë në burime të ndryshme kritike njerëzore në mënyrë që sektori i turizmit të zhvillohet efektivisht.

1. **Krijimi i një trupe "Elitë" të udhërrëfyesve (guideve) turistike.** Kyçi për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit do të jetë sigurimi i vizitave të përsëritura dhe arritja e rekomandimeve gojore. Gatishmëria e turistëve të arsimuar për të paguar guida me cilësi të larta është shumë e madhe. Në shumë destinacione natyrore me cilësi të lartë guidat turistike janë ndërmjet të punësuarve të paguar më shumë në sektorin e turizmit. Një Trupë Elitë e Guideve do të bëhet marka (shenja) e turizmit në këtë zonë dhe do ta diferencojnë atë nga cilësia në përgjithësi mikse e guideve turistike që gjenden kryq e tërthor rajoneve të tjerë. Kjo do të sigurojë gjithashtu mundësi për gjenerim të ardhurash për të diplomuarit nga fushat respektive në universitete, aktualisht me punësim të përkohshëm.
2. **Trajnimi i menaxherëve të vendeve natyrore dhe kulturore.** Rritja e rëndësisë së vendeve natyrore e kulturore të vendit do të kërkojë ekspertizë menaxhimi më të sofistikuar. Drejtorët e parqeve dhe vendeve kulturore tentojnë të kenë personel teknik të trajnuar mirë (specialistë pyjesh, kuratorë arkitektë), të cilëve në përgjithësi i mungon trajnimi (apo interesi) për t'u bërë menaxherë efektivë.
3. **Trajnimi i profesionistëve dhe personelit të mikpritjes.** Bashkia Krumë do të kërkojë shumë individë të trajnuar mirë në mënyrë që të përballojnë nje sektor turizmi ndërkombëtar.
4. **Trajnimi profesional për të rinjtë.** Sektori i turizmit do të kërkojë individë të trajnuar, ndërmjet të tjerave, në mjeshtëri të tilla si hidraulikë, elektrikistë, karpentjerë, mirëmbajtës, guzhinierë, shërbim hotelerie, shoferë.
5. **Arsimimi i vazhduar.** Shumë të rritur aktualisht në sektor apo që duan të hyjnë në sektor kërkojnë dhe dëshirojnë të përmirësojnë mjeshtërinë apo të fitojnë mjeshtëri të reja.
6. **Ngritja e aftësive gjuhësore.** Përpjekje shtesë duhet të drejtohen për t'u siguruar që personeli i industrisë së turizmit, në veçanti ai në zonat tona rurale, të zotërojë aftësitë bazë të gjuhëve të huaja që kërkohen për të kryer me efektivitet punët e tyre. Prioritetet kryesore janë anglishtja dhe gjermanishtja.
7. **Përmirësimi i rrugëve kritike në veri.** 1) Përmirësimi i afërsisht 22km rrugë që lidhin parkun e Munellës me rrugën kombëtare për të lejuar kalimin e makinave me katër rrota aktive gjatë muajve turistike të verës.
8. **Mirëmbajtja e rrugëve dytësore kombëtare.** Eksperiencat e turizmit të natyrës dhe kulturës nxjerrin në pah lëvizjen e vizitorëve (me autobus, taksì, makina me qera) në rrugët dytësore. Janë pikërisht rrugët dytësore që sigurojnë mundësi për të parë zonat shqiptare, kulturën, njerëzit dhe mënyrën e jetesës.
9. **Lidhja me veriun.** Kushtet aktuale të rrugës dhe mungesa e alternativave të transportit e bëjnë rajonin e veriut shumë të largët nga pjesa tjetër e vendit. Në një periudhë afatshkurtër do të ndihmojë vazhdimi i përmirësimeve të rrugës ndërmjet Bashkinë Krumë dhe zonave të tjera që i rrethojnë. Megjithkëtë, është e domosdoshme për të siguruar mjete shtesë për të mbërritur në Veri.

10. **Rritja e lidhjeve të telekomunikacionit rural dhe provincial.** Interneti dhe telefonia janë tejet të rëndësishme për zhvillimin e turizmit. Aksesit me cilësi të lartë i lejon bizneset lokale për të tregëtuar direkt produktet e tyre dhe për të mbajtur gjallë kontaktet me klientët dhe furnizuesit e tyre, në mënyrë më direkte dhe të rrjedhëshme.
11. **Përmirësimi i sinjalistikës.** Ka një mungesë të sinjalistikës rrugore që tregon drejtimet për në Krumë dhe zonat përreth, për në monumentet e kulturës dhe zonat natyrore. Mungesa e sinjalistikës e bën të komplikuar lëvizjen për profesionistët lokalë dhe gati të pamundur për vizitorët.

V. Formalizimi i sektorit të turizmit

1. **Formalizimi i sektorit të turizmit.** Bashkia duhet të krijojë një mekanizëm të qartë dhe të thjeshtë për aktorët informalë në sektorin e turizmit që të veprojnë sipas rregullave. Stimujt me kosto të ulët, të tilla si përfshirja në website-in kombëtar dhe një mbështetje e shpenzuar nga fondi promociional i turizmit (për të cilin kontribuon) kanë provuar të jenë efektive në shumë vende. Do të ishte e detyrueshme për sektorin privat (sidomos për shoqatat e tij) që të nxiste formalizimin si një pjesë e nevojshme dhe e rëndësishme e punës së shoqatave. Bashkia duhet të sigurohet që liçensimi dhe kërkesat e tjera janë të përshtatshme dhe nuk mund ta pengojnë në mënyrë të panevojshme formalizimin. Sektori i turizmit është i fortë. Kjo duhet të bëhet e qartë, por stimujt e thjeshtë inkurajojnë turizmin.
2. **Kalibrimi i standarteve ndërkombëtare të turizmit.** Bashkia duhet të inkurajojë kompanitë e tyre të turizmit për të konkuruar në nivelet më të larta të cilësisë. Një nga mekanizmat më të volitshëm për të inkurajuar këtë është promovimi aktiv (nga Bashkia dhe sektori privat) për të aderuar në standartet ndërkombëtare. Midis të tjerëve, më të rëndësishmit janë sistemi ndërkombëtar i “yjeve” për klasifikimin e hoteleve, Globi i Gjelbër 21 (*Green Globe 21*) për praktikatat e turizmit të qëndrueshëm dhe standarte të ndryshme të BE për transportin, bujqësinë organike dhe sigurinë ushqimore. Përdorimi i gjerë i këtyre standarteve rrit cilësinë dhe bën më të vetëkuptueshme se cilat kompani janë prapa.
3. **Hartimi dhe krijimi i një programi për cilësinë e turizmit kombëtar.** Arritja e niveleve të larta të cilësisë në të gjitha shërbimet e turizmit (bujtja, ushqimi, vendet e kulturës, transporti dhe logjistika, guidat) do të jetë një karakteristikë e rëndësishme për ta diferencuar zonën nga konkurruesit e saj.
4. **Azhornimi i sistemit të taksave të turizmit.** Bashkia duhet ta rishikojë sistemin e tyre dhe ta rregullojë atë për të plotësuar pozicionin aktual të sektorit të tyre të turizmit dhe të nevojave për gjenerimin e të ardhurave.
5. **Sigurimi i një detyrimi strikt për planet urbane në zonat bregdetare dhe trevat historike.** Evazioni më i kushtueshëm i rregullave për Bashkinë është ai që çon në shkatërrimin e pasurisë kulturore apo zhvlerëson cilësinë e vizitorëve. Pushteti vendor kërkon burime, njohuri dhe vullnet politik për të mbajtur kontrollin mbi përdorimin e tokës. Pushteti qendror

dhe sektori i turizmit duhet ta ndihmojnë atë në këto fusha.

VI. Rivlerësimi i eksperiencës së turistëve

- **Parandalimi i risqeve fizike për vizitorët.** Bashkia duhet të mënjanojnë me të gjitha kostot vdekjen apo sëmundjet e rënda të turistëve. Kur turistët kuptojnë që ka disa risqe në të gjitha udhëtimet, ata presin një vend (sidomos një vend evropian) që të marrë masa të arsyeshme për sigurinë e tyre. Vdekja e një turisti apo e një grupi turistësh mund ta mbyllë vërtet sektorin e ri në zhvillim. Katër shqetësimet më të mëdha të identifikuara nga vizitorët ndërkombëtarë, nga autorët e guidave turistike dhe nga një numër ekspertësh lokalë janë:
- **Përmirësimi i sigurisë në rrugë.** Ndërsa cilësia e keqe e rrugëve është e kapërcyeshme, kombinimi i rrugëve të këqia me shoferët e padisiplinuar dhe me shpejtësinë e lartë përbëjnë një shqetësim të madh.
- **Rritja e ndërgjegjësimit për parandalimin e sëmundjeve.** Sëmundjet e shkaktuara nga uji dhe nga insektet (mushkonjat dhe këpushat) zakonisht paraqesin një rrezik të madh për shëndetin.
- **Përmirësimi i praktikave të sigurisë ushqimore nëpërmjet fushatave të edukimit në sektorin e mikpritjes dhe shkollave profesionale.** Fushat prioritare duhet të përfshijnë 1) higjienën personale, 2) zbatimin e praktikave më të mira në përdorimin e mishit, pulave, peshkut dhe midhjeve, 3) temperaturën e ujit dhe teknikën e pastrimit.
- **Vëmendja për urgjencën mjekësore.** Bashkia Krumë duhet të krijojnë një sistem lokal për trajtimin e vizitorëve që sëmuren rëndë apo plagosen. Mungesa e infrastrukturës dhe njohja e gjuhëve në sektorin shëndetësor të vendit është e dobët, sidomos në zonat tona në fjalë, në të cilat vendi kërkon të zhvillojë turizmin.
- **Çmilitarizimi i destinacioneve turistike.** Prania e madhe e policisë në rrugë, në zonat fushore dhe në destinacionet malore është një faktor shumë negativ. Kjo prani u dërgon vizitorëve të huaj një mesazh pasigurie (sidomos atyre nga Europa dhe Amerika e Veriut) në një vend që është dukshëm i lirë nga krimi, dhuna apo problemet politike. Ky fenomen është veçanërisht i dukshëm në formën e postbllqeve në rrugë, në destinacionet turistike bregdetare, dhe në disa destinacione malore.
- **Reduktimi i plehrave në zonat turistike.** Qëndrimet lokale ndaj plehrave janë shqetësuese. Qytetet turistike, lumenjtë, rrugët dhe brigjet e liqeneve janë tejet të mbuluara. Nivelet e plehrave shokojnë shumicën e të huajve dhe mesazhi që marrin të huajt është se shqiptarët nuk e duan apo nuk e respektojnë qytetin apo fshatin e tyre, apo kulturën e tyre.
- **Menaxhimi i ujërave të zeza.** Menaxhimi efektiv i ujërave të zeza duhet të jetë një pjesë integrale e zhvillimit të vendbanimeve. Në destinacionet e lumenjve dhe liqeneve vizitorët dhe banorët lokalë marrin pjesë në mënyrë të mirëfilltë në aktivitetet mbi mënyrën e trajtimit të ujërave të zeza (edhe në ato të qytetit që vizitojnë). Menaxhimi i papërshtatshëm i ujërave të zeza është një shqetësim i madh për shëndetin, projekton një imazh shumë negativ dhe

shkatërro cilësinë e produktit të turizmit që vendi po shet në tregjet ndërkombëtare.

VII. Të dhënat dhe menaxhimi i informacionit

Të dhënat mbi tregjet ndërkombëtare të turizmit dhe të dhënat përmbledhëse mbi sektorin shqiptar janë absolutisht thelbësore për planifikimin e turizmit, marketingun dhe monitorimin.

1. *Departamenti i të dhënave në Ministri.* Krijimi i një zyre brenda Ministrisë që të jetë përgjegjëse për grumbullimin, analizimin dhe shpërndarjen në kohë të të dhënave për industrinë e turizmit dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm.
2. *Mbajtja dhe analiza e të dhënave të turizmit ndërkombëtar.* Organizata Botërore e Turizmit (WTO) dhe Grupi Konsultues Menlo (Menlo Consulting Group, Inc) janë burimet e të dhënave që përdoren më gjerësisht për turizmin.
3. *Zbatimi i sistemit të të dhënave për numërimin e turistëve me satelit (Tourism Satellite Accounts – TSA).* WTO ka promovuar një metodologji të përgjithshme ndërkombëtare të zhvilluar për grumbullimin sistematik dhe prezantimin e informacionit të turizmit vendas.

VII. Çështjet institucionale

Suksesi i Krumës në tregjet ndërkombëtare të turizmit do të kërkojë një nivel të lartë kooperimi dhe lirshmërie ndërmjet pushtetit lokal dhe pushtetit qendror si edhe ndërmjet privatëve dhe pushtetit qendror e shoqatave të shoqërisë civile.

Pushteti vendor

Pushteti lokal do të kërkojë shkallë të ndryshme asistence dhe mbështetjeje në çështjet procedurale dhe në problemet që kërkojnë ekspertizë. Prioriteti më i lartë për Ministrinë dhe për ministrinë e tjera është që të bëhen aleatë, mbështetës dhe lehtësues të procesit të zhvillimit të turizmit nga qeverisja vendore. Zona që kemi në studim dhe rajonet me interes turizmi kanë burime të rëndësishme njerëzore për çështjet e kulturës dhe të natyrës dhe kanë një kuptim shumë të qartë për destinacionet dhe produktet e turizmit në zonën e tyre. Ata duket se janë të paqartë mbi mënyrën se si vepron në rrugë administrative dhe institucionale për të

marrë autorizimet dhe miratimet e duhura dhe se si mund të kenë akses për burime komplementare njerëzore dhe financiare. Prioritetet kryesore të pushtetit vendor janë që:

- 1) Të krijojnë një “hartë rrugore” të qartë për pushtetin vendor, se si do të zhvillojë turizmin në qytetin e vet, ku të jepen hapat, kërkesat për informacion, procedurat, asistencën e disponueshme dhe kërkesa për t’i asistuar ata gjatë gjithë këtij procesi.
- 2) Të gjejnë mënyrat për të kanalizuar procesin për të siguruar që janë ndjekur të gjitha rregullat dhe janë plotësuar të gjitha kërkesat, por në mënyrën më të butë të dobishme pa hapa të panevojshëm apo pa pengesa.



- 3) Dhënia direkte e fondeve të disponueshme për asistencë (të bazuara në projekte) për pushtetin vendor dhe nëpërmjet programeve të OJF-ve që asistojnë pushtetin vendor.

Koordinimi publik – privat – civil


Zbatimi me sukses i strategjisë së turizmit kulturor dhe natyror do të kërkojnë përfshirjen e sektorit publik të sektorit privat dhe të OJF-ve si dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet tyre. Operatorët e sektorit privat do të drejtojnë zhvillimin e produktit. Sektori është përgjegjës për zhvillimin e akomodimit, lehtësive të mikpritjes, operatorëve turistikë dhe të udhëtimit, infrastrukturës në vend, aktiviteteve të marketingut logjistikës, etj. Ata gjithashtu duhet të kontribuojnë në menaxhimin e destinacioneve bazuar në njohuritë e tyre, të asaj çka pret turisti dhe të tregut. Shoqatat e turizmit në Shqipëri janë institucione kyç në zhvillimin e industrisë së turizmit. Shoqata e Agjensive Shqiptare të Turizmit, Unioni i Operatorëve Shqiptarë të Turizmit, Shoqata Shqiptare e Hotelierisë dhe OJF të tjera të lidhura me turizmin sigurojnë shërbime me vlerë për anëtarët e tyre dhe sigurojnë lobimin e sektorit në diskutimet me qeverinë.

Përmbledhje e informacionit për promovimin e Turizmit për Bashkinë Krumë

Fatkeqësisht, Bashkia Krumë ka një paraqitje të lehtë në gjithë broshurat dhe guidat lokale. Aty ku ato përmenden, përgjithësisht ato paraqiten në një hartë ose si një pikë kalimi për udhëtimet.

ASPEKTE GJEOMJEDISORE PËR BASHKINE E HASIT.

Hasi historikisht shfaqet pa praninë e resurseve të bollëkshme natyrore në territorin e tij, prandaj dhe historikisht është njohur me emrtimin Hasi i thatë. Megjithatë pozita gjeografike e tij bën që të jetë në mes të disa zhvillimeve në kontekstin natyror, të propozuara në PPK për këtë zonë. Kufizimi që ka në jug-perëndim, jug dhe jug-lindje nga liqeni i Fjertzës, bën që bashkia Has të kufizohet në këto drejtime nga korridori natyror i propozuar në PPK, i cili parashikohet të jetë finalizuar deri në 2030. Ky korridor që shtrihet përgjatë kufirit jugor të bashkisë dhe shtrihet pjesërisht dhe në territorin e Hasit në këtë zonë. Bën që bashkia Has të ketë detyrim ligjor, i cili rrjedh nga PPK-ja, që të japë kontributin që i takon në realizimin e tij. Por nga ana tjetër dhe cka është më rëndësi, është interesi që bashkia Has ka në realizimin e këtij korridori, nga i cili asaj do i shtohen vlerat dhe atraksionet natyrore. Pikërisht pozita gjeografike e Hasit bën që ai të jetë me të gjithë territorin e tij, pjesë e Brezit të Gjellbër European, pozitë nga e cila i lindin detyrime dhe të drejta, por dhe përfitime në sferën e hapësirës natyrore. Të diktuar nga legjislacioni i BE-së. Propozime të tjera të rëndësishme të PPK nga i cili Hasi përfiton vëmëndje dhe rritje të frekuentimit nga vizitorë, për pasojë dhe rritje të turizmit. Është intinerari i bicikletave, që nis nga parku i Valbonës, përshkon përmes territorit të bashkisë Has dhe përfundon në liqenin e Fjertzës. Një intinerar që është pjesë e rrjetit të rrugëve të bicikletave në hapësirat natyrore të gjithë shqipërië. Propozim tjetër është dhe krijimi i intinerarit Vozitës, i cili lidh të gjithë qytetet bregdetare të shqipërisë me rrugë detare. Dhe vazhdon nëpërmjet grykëderdhjes së lumit Drin në Velipojë, drejt liqenit të Fjertzës në Kukës, një intinerar gjatë së cilit përshkon thujse të gjithë kufirin liqenor të




territorit të bashkisë Has. Nga ku bëhet pjesë e inegruar e guidave turistike që do të përfshijnë këtë itinerar. Evidentimi i problemeve gjeomjedisore sipas qarqeve, që lidhen me ndotjet nga aktiviteti minierar, dhe në veçanti evidentimi i ndikimit ndotës nga:

- minierat e mbyllura; nga minierat në aktivitet; nga punimet e shfrytëzimit në qiell të hapur, (karrerat) si dhe nga stoqet e këtyre punimeve minerare;
- fabrikat dhe ish fabrikat e pasurimit, metalurgjike, kimike etj, me mbetjet e tyre industriale, dambat, stokimet e lëndëve kimike, minerale, ish stoqet hekurudhore etj; mbetjet e ndryshme urbane, sidomos nëpër qytete dhe qendra të përqendruara; hot spotet historike dhe të reja. Këto lloje ndotjesh janë pasqyruar me shenjat e tyre përkatëse në hartat gjeomjedisore të qarqeve, në shkallë 1:100 000, (Aneksi V.1).

Fig. 40. HARTA
GJEOMJEDISORE, QARKU
KUKES

**Ndikimet mjedisore të
Industriave minerare**



Bashkia e Krumës, disponon një gam të gjerë mineralesh metalore dhe jometalore si: krom, bakër, hekur-nikel, bokside, platin, polimetale, uranium, qymyre, argjila, kuarc e kuarcite, olivinite, asbest, gurë dekorativ, inerte të ndryshme etj, shfrytëzimi i të cilëve, krahas rëndësisë ekonomike sjell dhe impakte negative në ndotjen e mjedisit. Përveç shfrytëzimit me punime nëntokësore apo në qiell të hapur, (me karriera), të këtyre mineraleve, burime ndotjesh janë edhe stoqet e mineraleve apo të sterileve të tyre, sidomos fabrikat e pasurimit dhe të shkrirjes, me dambat e tyre përkatëse. Dambat dhe stoqet e mineralizimeve të bakrit, për vetë përbërjen lëndore (kimizmin), granulometrinë e imët të tyre, sasinë e madhe të materialit të tyre si dhe mos mbajtjen nën kontroll rigoroz, paraqesin një rrezik potencial për mjedisin. Jonet e metaleve të rëndë që vazhdimisht kalojnë në tretje, sjellin rrisqe serioze në bimësinë dhe gjallesat që jetojnë në ambiente tokësore dhe ujore të ndotura nga këto jone (Bode-2012; Daci-2013; Shushku, Çausi etj, 2013).






Fig. - 41 HARTA GJEOMJEDISORE, BASHKIA KRUMË

Minierat e mbyllura dhe stoqet e tyre të sterileve dhe të mineraleve

Në Bashkinë e Krumës, përpara dhe gjatë viteve '90, industria minerare ka qenë ndër degët më të zhvilluara, e cila krahas zhvillimit ekonomik, ka sjellë rrisqe negative mjedisore, si në toka, ujra dhe ajër, duke sjellur dëmtime të shumë sektorëve rreth tyre por edhe pasoja për njerëzit, florën dhe faunën e rajonit, sidomos minierat e bakrit (Karaxha etj, 2005; Mema, Guskolli etj, 2010; Çaushti, Shushku etj, 2013; Guri etj, 2011- 13; Shushku, Çaushti etj, 2013). Për këtë Qark janë:

minierat dhe karrierat e kromit, me stoqet e sterileve të tyre si: minierat në Çabrat, Rogam 1, 2, 3, Çorraj, Lajthizë, Kam, Kepenek, Zogaj 1, 2, 3, Skatinë, Shpati i Vishisë; Vlahën, Përollaj, Qafë Prushi, - Prroi i Batrës, Kalimash 1, 2, 3, etj.

Minierat dhe karrierat e bakrit, me stoqet e sterileve të tyre si: minierat në Gjegjan, Gdheshtë, Shëmri (Leproji), Golaj, Nikoliq, Krumë (Kullaj, Guskolli etj, 2009; Mema, Guskolli etj, 2010; Çaushti, Shushku etj, 2013). Nga aktiviteti minerar i këtyre minierave janë shkaktuar:

Transformime gjeomekanike dhe ndotja e tokave si nga:

- a. Gërmimet sipërfaqësore;
- b. Shembjet, rrëshqitjet, vidhisjet;



c. Depozitimet (stoqet) e mëdha të sterileve, (shpesh edhe mineraleve përkatëse),

në afërsi të vendburimeve, të transportuara nëpër përrenj, lumenj dhe liqene si dhe në tokat për rreth, duke ndikuar në strukturën dhe përbërjen e tyre litologjike, në dëmtimin e kullotave dhe të bimësisë, ku ndodhin edhe dalje të hinkave në sipërfaqe, nga shembja e punimeve nëntokësore dhe shpesh për pasojë edhe demtime shtëpish si në Golaj, Vlahën etj. Stoqet e sterileve të mineralizimeve të bakrit përmbajnë copra minerali sulfur si dhe vet rreshpet dhe bazaltet përmbajnë pikzime sulfuresh. Në kushtet e agjentëve atmosferik si lagështia dhe oksigjeni, ndodh procesi i oksidimit dhe elementët e çliruar shpërndahen nga rrjedhjet ujore sipërfaqësore si dhe me anë të vaditjes, në tokat poshtë minierave, duke shkaktuar ndotje të tyre, ku ndikojnë edhe ndotjet që vijnë nga pluhurat që ngrihen nga dherat e karrierave dhe stoqeve të sterileve, si pasojë e të cilave rrjedh degradimi i florës dhe faunës së këtyre zonave. Përveç kësaj nga pusët, karrierat, (shfrytëzimi sipërfaqësor), shembjet dhe rrëshqitjet e krijuara në terren, rrezikohet jeta e njerëzve dhe e kafshëve.

Ndotja e ujrave

Nga ky aktivitet minierar etj), ku siç dihet nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve në përgjithësi, shoqërohet me grumbullim steriles në sipërfaqe, si dhe me shkarkime të gazrave në atmosferë. Pra nga minierat dhe nga stoqet e tyre, nga dambat e fabrikave të pasurimit të kromit por sidomos të bakrit, shkarkohen në sipërfaqe vazhdimisht ujra të ndotura, që ndikojnë në florën, faunën dhe tek njerëzit. Përveç këtyre që thamë, në ndotjen e ujrave sipërfaqësore rol kryesor luajnë edhe shkarkimet e lëngëta urbane, industriale dhe bujqësore, që janë dukuri të cilat në mënyrë progresive ndikojnë në uljen e cilësisë së ujrave të lumenjve, liqeneve dhe të mjedisit në përgjithësi. Substancat ndotëse pasi kalojnë në ujërat e lumenjve ose të liqeneve, sillen në mënyra të ndryshme: disa treten dhe pësojnë zhvendosje për shkak të rrymave ujore, disa të tjera përthithen nga grimcat e ngurta pezull dhe sedimentojnë, ndersa të tjerat mund të hyjnë në cikle biokimike të ndryshme, duke kaluar nga njëri organizëm në tjetrin. Po këto reaksione zhvillohen edhe për mineralet e tjera të squfurit, duke çuar nga mineralet në solucion në trajte sulfatesh, në jonet e metaleve të bakrit, zinkut, nikelit, hekurit, plumbit, arsenikut, kobalitit etj. Këta jone të metaleve të rëndë derdhen në përrenjtë dhe në lumenjtë dhe përfundojnë në liqenin e Fierzës, duke shkaktuar kudo ndotje dhe rrisqe për biotën akuatike, si edhe në tokat me anë të vaditjes së tyre me këta ujra të kontaminuar me këta elementë të rëndë (natyrisht shpesh edhe në ujrat nëntokësore).



5.2 MINIERAT AKTIVE, SHFRYTËZIMET SIPËRFAQËSORE (KARRIERAT), STOQET E TYRE

Në Bashkinë e Krumës janë aktive disa miniera kromi dhe një numer i madh karrierash kryesisht kromi, por edhe Fe-Ni, Fe-Ni silikat, Ni silikat si dhe për gurë dekorativë, gëlqerorë të mermerizuar, dunite, olivinite, inerte karbonatike, kuarc, gurë gëlqerorë, si dhe për shfrytëzim të inerteve lumore. Konkretisht në Bashkinë e Krumës janë regjistruar pak leje minerare.

Pluhurat janë një nga ndotësit e ajrit që realisht shkaktojnë probleme serioze në shëndetin e njeriut. Madhësia e grimcave është faktori kryesor që përcakton se sa thellë depërtojnë ato në mushkëri. Efektet nga ndotësit e ajrit paraqesin vështirësi në frymëmarrje, nuhatje, kollitje si dhe probleme kardiake e respiratore etj. (Ministria e Mjedisit-2012). Punimet e shumta minerare të shfrytëzimit, në përgjithësi kryhen jashtë rregullave dhe kriterëve të caktuara, dhe rrjedhimisht sjellin prishje të ekuilibrave natyrore si:

- *morfologjike*, ku sipërmarresit nuk i rehabilitojnë ambientet e dëmtuara, pra nuk i mbyllin gërmadhat (karrierat), grykat e puseve, hyrjet e galerive, (duke sjellë rrezik për njerëzit dhe kafshët), dëmtojnë bimësinë, kullotat dhe tokat bujqësore), ku shpesh ndodh dalja e hinkave në sipërfaqe

nga shembja e punimeve nëntokësore deri edhe dëmtime shtëpish banimi nga ndikimi i këtyre shembjeve si në Golaj, Vlahën etj;

- *ndotjet e ajrit, të ujrave dhe të tokave*, kryesisht me pluhurat e madhësive të ndryshme, deri PM10, PM2,5, PM1, që rrjedhin nga plasjet e minave, nga thyerjet dhe fraksionimet për prodhimin e inerteve të ndërtimit, nga transportimi i tyre etj;

- *ndotjet e ajrit me gazra* të çliruara nga shfryrjet e minierave dhe të stoqeve të tyre, nga plasjet eksplozive, nga makinat e transportit, motorret e makinerive etj;

- *ndotjet e ujrave dhe të tokave me grimca* të madhësive të ndryshme, të larguara nëpërmes agjentëve atmosferik, nga këto stoqe karrierash të kudondodhura, të favorizuara nga vet pozicioni kodrinor me relief të thyer, që lehtësojnë transportimin e këtyre sterileve drejt kuotave me të ulta, nëpër toka, përrenj, lumenj dhe liqene.




Fig. – 42 Miniera e kromit në Qafë Perolli (Has), stoku i sterileve dhe pamja e hyrjes.

Në Bashkinë e Krumës, mbas mbylljes së aktiviteteve industriale, mund të themi se nuk ka ndotje të rënduar të ajrit nga shkarkimet e gazrave që vinin kryesisht si pasojë e këtyre aktiviteteve. Megjithatë pas vitit 1992 vërehet shtim i shkarkimeve të gazrave në atmosferë, si pasojë e rritjes së numrit të makinave, (kryesisht të vjetra) nga përdoruesit privat, si dhe nga pluhurat e punimeve të shumta minerare që i kemi përshkruar më sipër, si të kromit, hekur-nikelit, të gurëve dekorativë, atyre ndertimore etj. Por si dhe më parë, as për këtë periudhë nuk janë bërë matje për ndotësit e ajrit, nga ana e Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor, prandaj nuk mund të arrijmë në një përfundim konkret për cilësinë e ajrit.

Impiantet e shfrytëzimit të inerteve lumore

Në Bashkinë e Krumës nuk kemi raste aq të theksuara në këtë lloj aktiviteti, përveçse në lumin Valbona (në fshatin Bujan - B. Curri), në Perbreg-Kukës (në lumin Luma) etj. Këto veprimtari, nga shfrytëzimi intensiv dhe pa kriter, jashtë çdo kontrolli, sjellin pasojë në shtratin e lumenjve dhe për rrjedhojë edhe në ekuilibrin natyror të tyre, duke sjellë edhe ndryshime në ekosistemin gjeokimik, në vijimsinë e këtyre lumenjve. Gërmimet e pastudjuara si në thellësi dhe në gjerësinë e shtratit të lumenjve, sjellin shembjen e brigjeve të tyre duke humbur sipërfaqe të tëra toke, rrisin rrezikun për shkatërrimin e trojeve dhe banesave në afërsi të tyre. Shfrytëzimi intensiv çon deri në devijim të shtretërve të lumenjve dhe në përmblyjen e tokave përreth, (në rastet e rreshjeve intensive), gjithashtu çon në zbulimin e këmbëve të urave etj. Kjo veprimtari përveç këtyre që thamë, sjellë edhe ndotje të theksuar të ujrave të vet lumenjve, nga përzierjet dhe turbullirat që krijohen me vet materialin lumor, (fraksionimin dhe larjen e tij), nga shembjet përkatëse, nga vajrat dhe mbetjet që rrjedhin nga impiantet dhe makineritë e transportit etj. Të gjitha këto sjellin rrisje negative të theksuara si për faunën e këtyre lumenjve, ashtu edhe të ujrave nëntokësore që furnizohen nga këta akuiferë të përhershëm.





SHPJEGUESI

-  Miniere në aktivitet
-  Miniere e mbyllur
-  Hot spot
-  Karriera në shkëmbinj rrënjësor
-  Landfill
-  Karriera në argjila
-  Inerte lumore
-  Dampa
-  Mbetje urbane
-  Karriera në minerale

Fig. - 43 Harta e gjeomjedisit në bashkinë Krume

Ndërtimet e ndryshme

Probleme në këtë aspekt sjell edhe *industria ndërtimore*, që nga hapja e gropave të bazamenteve të pallateve, transportimi i këtyre dherave, ku pothuajse nuk zbatohen as normat elementare për mbrojtjen e mjedisit, duke dëmtuar rrugët si dhe hedhja ku të munden e këtij materiali. Po kështu edhe pluhurat e shumta që vijnë nga inertet që përdoren në fabrikat e betonit, të cilat ndodhen brenda ose shumë afër qendrave të banimit. Probleme kryesore në ndotjen urbane sjellin pluhurat dhe materialet inerte të prishjes së ndërtimeve të vjetra ose të atyre të ndërtuara pa leje. Përmbajtja e grimcave totale (LNP)

dhe atyre të respirueshme (PM10, PM2.5, PM1), në atmosferen urbane të këtyre qyteteve veriore nuk është sinjifikative ku në përgjithësi është brenda normave të lejuara të Standartit Shqiptar, (Ministria e Mjedisit-2012).

Industria kimiko - metalurgjike dhe mekanike

Përsa u përket ndotjeve të kësaj fushe, në Krumë, nuk bëhet fjalë për ndonjë industri kimiko-metalurgjike, përveç-Uzinës së shkrirjes së bakrit në Rexhepaj (Kukës), që përshkruhet më poshtë. Në këto qendra si dhe nëpër ferma bujqësore mund të përmendim edhe uzinat mekanike, parqet e automjeteve me ofiçinat, me torneritë dhe repartet e ndryshme mekanike të tyre. Këto reparte mekanike etj, nga veprimtaria e tyre shumë vjeçare dhe me një teknologji të vjetruar dhe me prodhime mbetjesh jo të pakta, padyshim kanë shkaktuar dhe shkaktojnë ndotje të ambjentit, (si ndotje të ajrit, ujrave dhe të tokave), aty ku ndodhen dhe më gjerë, duke pasur parasysh mos marrjen e masave të duhura për shmangien e tyre. Ndotës janë edhe kimikatet, (pesticidet dhe plehrat kimike bujqësore), depot e tyre, depot e lëndëve plasëse që kanë qenë dhe janë të shpërndara në territoret minerare, etj.

4.29 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Aktiviteti Minerar në vite, si minierat e mbyllura, ato aktuale, punimet minerare sipërfaqësore (karrierat), si për minerale metalore, (Cr, Fe-Ni, boksit etj), por sidomos për jometaloret, (për gurët dekorativë, gëlqerorët, granitet, dunitet, olivinitet, argjilat etj), fabrikat e pasurimit dhe të shkrirjes së këtyre mineraleve, sidomos të bakrit, sjellin ndotje të shkallëve të ndryshme në ajër, (me gazrat dhe pluhurat që çlirojnë), dëmtim të sipërfaqeve dhe ndotje të tokave me sterile dhe metale të rëndë si dhe ndotje të ujrave, (deri në ujra acide, të pasura me sterile dhe me metale të rëndë që shpajnë këto punime, stoqet dhe dambat e tyre);
2. Industria Ndërtimore (sidomos në këto vite), ka sjellë ndotje të theksuar në mjedis me pluhurat dhe mbetjet inerte të shumta që prodhohen, si nga shembjet, ndërtimet, transporti, ku pothuajse në të gjitha këto procese nuk zbatohen normat për mbrojtjen e mjedisit;
3. Shfrytëzimi intensiv i shtretërve të lumenjve ka sjellë rrisqe negative në ekosistem dhe në vet ekuilibrin natyror të këtyre lumenjve (shembje dhe humbje tokash bujqësore, rrezikim shtëpish, shpesh devijim shtrati dhe përmbytje tokash), si dhe ndotje të ujrave nëntokësore meqë lumenjtë shërbejnë si akuifer ujëdhënës për to;
4. Zhvillimi i bizneseve të ndryshme ka sjellë sasira të mëdha dhe të pakontrolluara të mbetjeve, ku në mungesë të sheshdepozitave ose landfilleve të përshtatshme, hidhen vend e pa vend, (sidomos në brigjet e lumenjve), mbetje urbane, spitalore dhe industriale, pra edhe mbetje të rrezikshme, duke ndotur ajrin, tokën dhe ujrën;
5. Hedhja e MbRr dhe mbetjeve spitalore së bashku me mbetjet urbane, pa një ndarje paraprake, çon në nxjerrjen jashtë standardi edhe të landfilleve e mbetjeve urbane;



Për këtë duhet që:

1. Të rritet informacioni dhe ndërgjegjësimi si në industri në lidhje me kërkesat ligjore për teknologjitë përkatëse, ashtu edhe në jetën e përditëshme, në lidhje me këto lloje mbetjesh dhe ndotjet që sjellin ato në mjedis.
2. Trajtimi me projekte të posaçme i ujërave sipërfaqësore dhe atyre që dalin nga minierat, pra projekte për neutralizimin e ujërave të minierave, të stoqeve të minierave dhe sterilet e dambave të fabrikave të pasurimit dhe të shkrirjes, kryesisht të bakrit.
3. Duhet të krijohet koncepti i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme, sepse deri më sot pothuajse ato konsiderohen si mbetje të thjeshta urbane;
4. Duhet të krijohet koncepti i ndarjes që në burim, i mbetjeve urbane nga MbRr, sipas një kompozimi “praktik” të koshave të riciklimit, në përputhje me strategjinë e Ministrisë së Mjedisit si: Të riciklueshme (të thata); Organike/të ndryshme (të njoma); Të rrezikshme;
5. Ndërtimi i **landfilleve**, duhet të bëhet me kritere tepër rigorozë si gjeologjike edhe teknike, nën mbikqyrjen dhe përgjegjësinë e plote të specialistëve të kësaj fushe.
6. Duhet bërë grososje të sigurta ekologjike për trajtimin e MbRr dhe asgjësimin e tyre;

4.30 INFRASTRUKTURA MJEDISORE

Mbetjet e lëngëta

Situata e përgjithshme në Shqipëri

Shqipëria prej kohësh ndeshet, ndër të tjera, me një nga problemet më shqetësuese për mjedisin, siç është derdhja e ujërave të patrajuara, qofshin ato industriale dhe ato të zeza. Ndaj, nga qeveritë shqipëtare, më parë dhe tani, janë marrë masa për trajtimin e tyre, duke ngritur një seri impiantesh të mëdha deri në 200,000 banorë, siç janë rastet Durrës, Korçë, Vlorë, dhe për popullsi më të vogla, si rastet Sarandë, Lezhë, Velipojë, Kavajë, Pogradec, deri te kjo më e madhe rasti Tiranë, ku pas pak kohe edhe ky impiant do të jetë në shërbim të qytetarëve. Por ekziston një problematikë tjetër, ajo e trajtimit të ujërave të përdorura, që në pamje të parë duket, sikur janë një fabrikë e vogël përpunimi të të leshtave apo thertore apo ushqimore, një punishte prodhimi baxho apo ushqimore, një teknologji e caktuar, si karburant apo lavazh, hoteleri apo kompleks turistik deri në shqetësimet që vijnë prej mos trajtimit të ujërave të zeza në qytete apo qyteza nga 200 deri në 10,000 banorë, të cilat duhet të jenë axhendë e punëve të Qeverisë sa më shpejt të jetë e mundur. Për sa më sipër, si punishtet e fabrikat për ujra të përdorura dhe qytezat për ujëra të zeza bëjnë po aq ndikim në mjedis dhe në shëndetin njerëzor, për shkak se ndikojnë direkt në ujrat sipërfaqësore. Po aq, dhe nga pak nga pak, por gjatë një sezoni të tërë bëjnë shumë ndotje, janë edhe komplekset turistikë, hotelet apo komplekset rezidenciale pranë bregdetit, çka e bëjnë jetën të cënueshme dhe të pa argëtueshme të turistëve të huaj dhe të shplohësve shqiptarë.

Sasitë vjetore aktuale dhe në perspektivë

Nga përllogaritjet e përafërta të bëra nga grupi studimor rezultojnë vlerësimet e mëposhtme, për mbetjet ujore në këtë zonë janë rreth 800m³ mbetje të ujërave të zeza në ditë për zonën në studim. Aktualisht, ato nuk trajtohen në basene të kontrolluara dhe zakonisht mblidhen ose drenohen drejt sistemeve të

përrenjve dhe atyre lumorë për në det dhe nëpër çfarëdo lloj toke. Në të gjitha rastet, elementët e dëmshëm të saj që ndodhen në përqindje të larta (potas, fosfor) komunikojnë me thellësinë, (tokën e shkrifët, ujin, etj.), për shkak të përbërjes së lartë të kokrrizave rërore – gravelitike.

Gjendja e sistemit të depozitimit dhe përpunimit

Sa i përket ujërave të zeza të kësaj bashkie, ato administrohen ende në mënyra primitive nga vetë banorët, duke parë si zgjidhje të vetme grumbullimin e tyre në gropa septike ose jo. Për pasojë, aktualisht nuk ka asnjë metodë për përpunimin e tyre. Perspektiva në lidhje me këtë çështje mendohet të jetë grumbullimi i tyre në bazë lagjeje ose grupe banesash, në gropa septike të ndërtuara sipas kriterëve të kushteve teknike. Kështu, duke mos pasur një infrastrukturë të caktuar, ujërat e zeza janë shqetësuese pasi ato rrezikojnë të ndotin mjedisin

Menaxhimi i mbetjeve të ujërave të zeza

Bashkia duhet t'i përgjigjen skemave të reja të trajtimit ekologjik të ujërave të zeza, sikundër jepen në figurën poshtë. Kjo skemë funksionon, nëse Bashkia me mjetet e saj (autobote) bën largimin herë pas here të ujërave të zeza për në pikat e caktuara. Aktualisht, një propozim i tillë lidhet me aplikimin e kriterëve ligjore dhe urbanistike për funksionimin e infrastrukturave dhe shërbimeve të zonave urbane, si dhe detyrave që shtrohen përpara autoriteteve të Bashkisë.




Fig. - 44 Paraqitje skematike e trajtimit të ujërave shtëpiake

METODIKA MBI TRAJTIMIN E UJRAVE TË PËRDORURA

Trajtimi i ujërave të përdorura me lagunazhe natyrore

Duke qenë se rajoni në fjalë sidomos zonat suburbane, kryesisht ndërtimet dhe banesat vendosen në zona të ngritura mund të sigurohet trajtimi i ujërave të përdorura me anë të lagunazhit natyror. Për aq kohë sa ato nuk sistemohen në një magjistral pranë.



Fatmirësisht, të gjitha godinat e banimit rrafsh drejt një zone të ulët fushore, tokë buke ose tokë djerre, me lumenj ose përrenj pranë, ku më pak kujdes për secilin fshat mund të zgjedhesh një sipërfaqe për të ngritur një teknologji të thjeshtë, të trajtimit të ujrave të përdorura. Ky ujë vjen në mënyrë gravitative pa kosto




Fig.45- Pamje e sistemit të trajtimit të ujrave me lagunazhe natyrore

energji në drejtim të këtij sheshi, ku një basen me profil vertikal të dherave dhe zhavorëve dhe kallamishteve filtruese arrin të pastrojë ujërat e ngarkuara me lëndë nitrite fosfate (ujëra të zeza) deri në ujra të kategorisë së tretë, të cilat lehtësisht mund të derdhen në përrnj, liqen ose mund të përdoren për qëllime të tjera. Në rastin e banesave që bien jashtë skemës gravitative të përgjithshme të fshatit rekomandohen ndërtime të gropave septike ekologjike të cilat parashikohen me dhomëza të përbëra dhe të ndertuara ma mure hermetikisht të izoluar, ku uji i ingarkuar me nitirite dhe fosfate mund të transformohet në ujë të pranueshëm për tu derdhur në ujërat sipërfaqësorë, por rast pas rasti ka një skeme specifike enkas për të.

Impliant i trajtimit të ujrave të zeza për 1000-10, 000 banorë

Instalohen nën toke, nuk ka aroma të pakëndëshme, kontroll, komandim, informim elektronik, personel të impiantit - 1 person

- Screens-ekranet – përdoren për të mbajtur mbetjet e ngurta.
- Largimi (heqja) e vajit dhe yndyrnave - Vaj i lirë mund të hiqet në kushte qetësisë
- Ekuilizatori - Ofron një rrjedhje më uniforme dhe qëndrueshmëri të ujrave të zeza.
- Depozita rrethore e precipitimit primar - Kjo teknike mund të heqë deri në 80%




Fig. - 46 Skemë e impiantit të trajtimit të ujrave të zeza

- *Bioreaktori me membranë* – përdoret për mbajtjen pezull, ruajtjen e një biomase
- *Koagulatori* - nevojshme për proceset e mëtejshme që kryhen.
- *Tretësi i llumit* - shkalla e lartë e tretjes konsiderohet e përshtatshme për procesin,
- *Depozita për ujrën që largohen nga llumi* – heq ujin nga llumi.

Sistemi i integruar i fitodepurimit – SIFD

Veçoritë kryesore të SIFD -së




Fig. – 47 Skema të sistemit të integruar të

Përshtatshmëria:	nga 500 deri në 10,000 ban.
Hapësira e nevojshme:	0.5m ² për banor.
Mundësia	integrim me impiantet ekzistues.
Përdorimi	bimëve autoktonë me gjelb. të përhershëm.
Bezdisja	asnjë insekt i bezdsshëm apo erë.
Llum biologjik	nuk prodhohet
Trajtime kimike	nuk duhen.
Kostoja	e ulët e ndërtimit të impianteve
Përfitime	rikuperon mjedisin e degraduar.
Zbatimi	në të gjitha kushtet klimatike,

Analiza e përfitimit të kostove ekonomike për trajtimin e ujrave të zeza dhe urbane


Një llogaritje e tillë do të na siguronte mundësinë e përfitimit dhe të humbjeve, si në njërin rast dhe në tjetrin, si dhe masat kompesuese për secilin rast. Vlera aktuale neto dhe skontimi – krahason fluksin në kohë të kostove dhe përfitimeve në periudha të ndryshme. Norma e skontimit përdoret për shndërrimin e kostove dhe përfitimeve të ardhshme në një vlerë të vetme, e cila quhet "vlera aktuale neto" duke

mundësuar krahasimin e tyre. Vlera aktuale e kostos dhe përfitimit shprehet si më poshtë në formulat 1, 2 & 3:

$$\text{NPV Total kost} = \sum_{t=0}^T a_t K_t = \frac{-K_1}{(1+r)^0} + \frac{-K_2}{(1+r)^1} + \dots + \frac{-K_t}{(1+r)^t} \quad 1)$$

$$\text{NPV Total Perfitim} = \sum_{t=0}^T a_t P_t = \frac{P_1}{(1+r)^0} + \frac{P_2}{(1+r)^1} + \dots + \frac{P_t}{(1+r)^t} \quad 2)$$

$$a_t = \frac{1}{(1+r)^t} \quad 3)$$



ku: NPV kost = vlera e kostos aktuale neto (e tanishme, K_t = kosto në vitin t e shprehur në Euro

r = norma reale e skontimit referuar Bankës së Shqiperisë, t = periudha e vlerësimit në vite

Pt = përfitimet në vitin t shprehur në Eur, $at = 1 / (1+r)^t$, koeficienti i zbritjes

Zgjedhja e normës së skontimit e cila është modeluar dhe diktohet nga dëmet e gazrave serë dhe janë vlerësuar, që të jetë, 3%.

PERFORMANCA E MBETJEVE SI KONCEPT

Bazuar në Ligjin Nr.9010, datë 13.2.2003 "PËR ADMINISTRIMIN MJEDISOR TË MBETJEVE TË NGURTA", neni 1, mbi Qëllimin e ligjit, i cili synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme. Për këtë arsye, duhet vendosur që të bëhen hapat e parë për përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, duke përdorur "Standardin e Shërbimit të Pastrimit", si masë e cilësisë dhe efektivitetit të këtij shërbimi, në mënyrë që të gjithë qytetarët të përfitojnë sa më shumë prej tij, të optimizojmë kostot dhe të përmbushen standardet e menaxhimit të mjedisit sipas Bashkimit Europian. Pesë parimet që duhen zbatuar për të zgjidhur krizën e mbetjeve në një mënyrë sa më të mirë mjedisore, si dhe nga ana e kostove ekonomike, janë:

- Zgjidhja duhet të jetë sa më e thjeshtë;
- Zgjidhja duhet të jetë lokale;
- Njehësimi i zgjidhjes me ekonominë lokale;
- Njehësimi i zgjidhjes me zhvillimin e komunitetit lokal;
- Zgjidhja e bazuar në metodat inxhinierike.

Situata në Administrimin e Mbetjeve

Administrimi i mbetjeve urbane në vendin tonë është i decentralizuar, ku në qytete menaxhohen nga bashkitë ndërsa zonat rurale nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër shpatet e përrenjëve dhe të lumenjëve ose në anë të rrugëve, ose grumbullohen në venddepozita të hapura në natyrë, pa asnjë lloj përpunimi; vendosen në depozitime të shkrifta, toka bujqësore (kuaternare), digjen në gjendje të lirë etj. (Guri, S., etj., 2013). Duke patur parasysh numrin e popullsisë sipas INSTAT dhe shumën totale vjetore të mbetjeve të ngurta urbane, rezultojnë se sasia mesatare është 332 kg për banor në vit. Probleme serioze sjell mungesa e ndarjes së mbetjeve që në burim, kështu që grumbulluesit dhe kompanitë hasin vështirësi në gjetjen e mbetjeve të pastra dhe të ndara. Mbetjet bashkiake kanë një përqindje të lartë të mbetjeve organike dhe nuk përdoret ndonjë metodë riciklimi për të reduktuar sasinë e këtyre mbetjeve organike që hidhen në venddepozita. Mbetjet organike në venddepozita janë burimi kryesor i emetimit të CH

në ajër. Gjithashtu si pasojë e shkarkimeve të lëngëta urbane rritet përmbajtja e NH₄, ndërsa nga shkarkimet e ujrave të zeza rritet përmbajtja e NO₂ dhe NO₃

Tab. – 1 Shkarkimet e mbetjeve

Rryma e Mbetjeve	% Mesatare në Hedhjen e Mbetjeve Bashkiake	Pesha e Mbetjeve Bashkiake të Shqipërisë/ditë (0.7kg/person/ditë)	Pesha e Mbetjeve Bashkiake të Shqipërisë/vit (266kg/person/vit)
		2,335 T/Ditë	852,360 T/vit
Organike	47.36	1,106	403,690
Dru	1.43	33	12,045
Letre	5.37	125	45,625
Kartoni	8.13	190	69,350
Total te Biodegradueshme	62.3	1,454	530,710
Plastike me densitet të ulët	8.46	198	72,270
Plastike me densitet të lartë	4.75	111	40,515
Qelq	5.75	134	48,910
Tekstile	5.27	123	44,895
Metale - Ferroze	0.56	13	4,745
Metale - Me Ngjyra	0.57	13	4,745
Mbetjet Spiralore	0.17	4	1,460
Produkte Gome	0.2	5	1,825
Mbetje Inerte	7.2	168	61,320
Mbetje nga produkte sanitare	3.25	76	27,740
MPEE	0.31	7	2,555
Baterite	0.02	1	365
Prodhime të Mbetjeve nga Kalshët	1.08	25	9,125

Burimi: Agjencia Evropiane e Mjedisit

Menaxhimi i mbetjeve ne Bashkine Krume

Menaxhim i integruar i mbetjeve është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit. Theksojmë se këto mbetje depozitohen në gjendje të lirë dhe nuk meret asnjë masë mbrojtëse dhe kjo ka shumë ndikime negative. Zona duhet riparuar dhe të restaurohet plotësisht, duhet të hartohet një plan i mirëfilltë për menaxhimin e mbetjeve në lidhje me këtë zonë, sepse sjell një ndotje të vazhdueshme dhe është problem për biodiversitetit. Vend-depozitimi nuk është asgjë më tepër, vecse një venddepozitim i pozicionuar në buzë të rrugës. Zona është e pagardhurar, e pa populluar, nuk përdoret ndonjë makineri dhe shpesh u vihat zjarri. Hasi si të gjitha qyetet e tjera ka dhe ajo problem me ujërat e ndotura urbane sepse uji është një element jetik për jetën

tonë. Uji i ndotur urban shkarkohet në kolektor pa pasur asnjë llojë trajtimi. Detyra e bashkisë është të projektojë një stacion pastrimi të ujit të ndotur dhe më pas të vendosë se ku do të ndërtohet ky stacion. Ujërat e ndotura industriale janë ujërat e përdorura nga veprimtari industriale, tregtare dhe çdo lloj tjetër. Këta ujëra të ndotura mbledhen në kolektorin e fushës së Vajkalit që është mes dy qyteteve. Trajtimi është i domosdoshëm sepse është në të mirë të komunitetit dhe detyra e një impjanti është të zvogëlojë ngarkesat ndotëse për çdo njësi operacionale. Bashkia duhet të ketë synim pastrimin e ujërave të ndotura urbane në të gjithë zonën për t'i kthyer ato në ujra të përdorura dhe për të siguruar një mjedis sa më të pastër për qytetin.

Menaxhimi i mbetjeve - viti 2017

Nga monitorimet ka rezultuar:

- gjenerimi i mbetjeve urbane ka pasur tendencë rritje ndërsa gjenerimi i mbetjeve inerte ka pasur luhatje.
- pavarësisht përmirësimeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, ai mbetet ende një problem shumë i rëndësishëm.
- mbetjet depozitohen në venddepozitime të përkohëshme të miratuara nga vetë njësitë e qeverisjes vendore.
- organizimi i grumbullimit, transportimit, depozitimit dhe asgjësimit të mbetjeve paraqet vështirësi të mëdha dhe një kosto të lartë financiare që përballohet nga buxheti i shtetit, mbasi NJQV nuk kanë patur mundësi financiare.
- vazhdojnë depozitime të mbetjeve në vende të pa autorizuar dhe brigjeve të rrjedhave ujore.
- ka djegje të mbetjeve urbane nuk bëhet ndarja e mbetjeve me origjinë ndërtimore me ato urbane dhe organike
- ka probleme me teknikën e përdorur për pastrimin dhe transportimin e mbetjeve. Teknika është e vjetër dhe nuk plotëson standarte minimale për këtë shërbim.
- sasitë e mbetjeve të gjeneruara gjatë vitit 2017 ka qënë mbetje urbane afërsisht 7000 ton/vit.
- për mbetjet spitalore krahas ndryshimeve pozitive ka probleme të cilat duhen trajtuar sipas nenit 21, pika 5 dh 6, te ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

Mbështetur në Vendimin Nr. 687, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”. Për këtë rrymë nuk ka shërbim të dedikuar. Nuk ka pika të posaçme për grumbullimin dhe largimi i tyre bëhet në baza sporadike dhe jo sipas një planifikimi të rregullt. Mbetjet inerte raportohen si një problem në rritje për shkak të kostove të larta që kërkon shërbimi për grumbullimin dhe transportimin e tyre. Për mbetjet inerte nga NJQV nuk kemi asnjë informacion por për mbetjet urbane në bashkinë e Krumes kemi shifren prej:

Tab. - 2 Gjenerimi i mbetjeve inerteve (*Burimi: Bashkia*)

Nr.	Tipi I mbetjeve	Sasia e prodhuar	Sasia qe digjet ne impiante incenerator	Teknologjia e perdorur (temp °C)	Sasia qe digjet ne ambiente te hapura
1	Mbetje urbane (organike)	7000 ton/vit	Nga informacioni i marre nga Bashkia mbetjet depozitohen ne fushen e perpunimit te mbeturinave, dhe ne kete vend keto mbeturina shtypen dhe shtyhen me traktor.		
2	Mbetje spitalore (mjekesore/farmaceutike)	15000 kg/vit		-	-

Gjendja e venddepozitave urbane dhe inerte

Mbetjet klasifikohen në:

1. Mbetje jo të rrezikshme, të cilat quhen ndryshe mbetje urbane ose “plehra” në gjuhën e përditshme, të cilat edhe pse quhen si jo të rrezikshme mund të rezultojnë shumë të dëmshme për popullsinë dhe mjedisin dhe

2. Mbetje të rrezikshme, të cilat kanë karakteristika kimike e fizike toksike, gërryese, kancerogjene dhe që mund të kenë efekte të dëmshme, (këtu bëjnë pjesë edhe mbetjet spitalore si dhe mbetjet radioaktive, të cilat janë tejet toksike dhe ekspozimi ndaj tyre mund të shkaktojë sëmundje nga më të ndryshmet, madje dhe të shkaktojë vdekjen). Miratimi dhe zbatimi i strategjisë kombëtare për administrimin e mbetjeve të ngurta dhe ligjit për administrimin e integruar të mbetjeve, do të sigurojë një menaxhim të mbetjeve duke ruajtur mjedisin, si ajrin, tokat dhe ujërat sipërfaqësore e nëntokësore; zvogëlon ndikimin negativ në shëndetin e popullsisë. Një vend të rëndësishëm në zbatimin e këtij legjislacioni dhe direktivave të Bashkimit Europian, ka trajtimi dhe shfrytëzimi i mbetjeve industriale.

Situata në Administrimin e Mbetjeve të Ngurta

Administrimi i mbetjeve urbane në vendin tonë është i decentralizuar, ku në qytete menaxhohen nga bashkitë ndërsa zonat rurale nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve, të cilat zhvendosen nga përrenjtë ose grumbullohen në venddepozita të hapura në natyrë, ku nuk kryhet asnjë lloj përpunimi; vendosen në depozitime të shkrufta, toka bujqësore (kuaternare); digjen në gjendje të lirë etj. (Ministria e Mjedisit-2012).

Riciklimi është përkufizuar si një operacion tjetër rikuperimi nga ku mbetjet përpunohen në produkte, materiale ose substanca për qëllime parësore ose të tjera. Aktualisht në vendin tonë ka disa kompani private riciklimi që grumbullojnë dhe përpunojnë tipe të ndryshme mbetjesh :skrap, alum in, letër, dru, plastikë, tekstile, tulla, mbetje vajore, goma të përdorura etj. Nuk ka grumbullues individual, informal dhe as kompani grumbulluese për mbetje të ndryshme të riciklueshme. Riciklimi do të ishte shumë produktiv si në zvogëlimin e volumit ashtu edhe të ndotjeve të tyre. Emetimet ose lëshimet në

ajër nga djegiet në natyre të mbetjeve urbane përmbajnë nivele të larta të metaleve të rëndë si: plumbi, kadmiumi, merkur, kobalti, zinku, bakri etj. Metalet e rëndë paraqesin rrezik për shëndetin edhe në përqëndrime të vogla, për shkak të helmueshmërisë së lartë të tyre siç janë *merkuri, plumbi, kadmiumi* etj. Metalet tipike të emetuara nga djegia termike dhe demet e tyre janë:

Plumbi, i cili shkakton çrregullime nervore;

Kadmiumi, i cili shkakton dëme në veshka, hipertension dhe dëmtime gjenetike;

~~*Kobalti* që rezulton nga dambat e pambuluara, është element bioakumulues në trupin e njeriut, si dhe është helmues për veshkat dhe sistemin nervor;~~

~~*Merkuri* ndikon në zhvillimin normal të trurit, sapo shndërrohet në formën e tij organike. Femrat shtatzane, si dhe femrat në moshën e riprodhimit duhet që të mos konsumojnë produkte bujqësore të prodhuara në këto zona të infektuara. Keta elemente futen në zinxhirin ushqimor, deri të marrësi i fundit që është njeriu. Njerëzit që jetojnë brenda 7 km prej tyre kanë më shumë të ngjarë që t'u shkaktohen kancere të ndryshme, (Guri etj, 2011-13).~~

~~*Njohuri të pergjithshme për landfillet dhe mënyrat e përpunimit të mbetjeve.* Një landfill i sigurt është një vaskë në toke, ku hidhen mbetjet urbane. Qëllimi i ndertimit të tij është për të shmangur çdo lidhje mes këtyre mbetjeve dhe mjedisit përreth, (ajër, toke, ujra sipërfaqësore e nëntokësore).~~

Landfillet ose vend- depozitimet ndahen në tre kategori, (Manastirliu-2013):

1. landfille për mbetje të rrezikshme (mbetje të lëngshme, spitalore, eksplozive, gërryese;
2. landfille për mbetje jo të rrezikshme (mbetjet urbane etj);
3. vend-depozitime (landfille) për mbetjet inerte.

Landfilli nuk duhet që të dëmtoje peisazhin ose vendet me interes të veçantë. Kur ky mbushet dhe e kryen funksionin e tij, i duhet bërë mbulimi përfundimtar, rehabilitimi i gjithë zonës me gjelbërim, duke e kthyer në një zonë rekreative dhe me peisazh stimulues, megjithëse duhet monitoruar përreth 30 vjet pas mbylljes. Në mbështetje të politikave të BE-se, landfilli është parë si zgjidhja e fundit dhe duhet të përdoret vetëm atëherë kur mbetjet nuk riciklohen apo nuk trajtohen, pra vetëm atëherë duhet të shkojnë në landfill.

Gjendja e venddepozitave urbane dhe atyre inerte, në qytetin e Hasit

Në dalje të Qytetit të Krumës në veri të tij në të majtë të rrugës automobilistike Krumë- Golaj rreth 1 km larg tij është vendi i depozitimit të mbetjeve urbane, në një luginë me sipërfaqe 1 ha toke. Venddepozita është në kushte të pershtatshme dhe për momentin zgjidh problemet e komunitetit të Krumës, (Karaxha etj, 2005). Ndërsa venddepozita e inerteve në Kukës, ndodhet në pjesen veriore të qytetit, ngjitur me rrugën që shkon për Krumë (Has), në një sipërfaqe prej 1.2 hektar. Ndodhet në një luginë me pjerrësi të konsiderueshme 45-50°, në shpatin e liqenit të Fierzës, ku në anën e poshtme të saj është ndërtuar një digë (pritë) me lartësi 3 m dhe që vendoset në depozitimet konglomeratike të pliocen-kuaternarit, që është planifikuar për plotësimin e nevojave të qytetit për një periudhë 10

vjeçare. Në të ardhmen duhet ndërtuar një venddepozite të re në një vend më të përshtatshëm dhe me parametra optimale.

Hot Spotet

Të ashtuquajturat "Pika të nxehta" ose "Hot Spote", krijohen nga mbetjet e rrezikshme, (MbRr), të cilat kanë karakteristika kimike e fizike toksike, gërryese, kancerogjene dhe që sjellin efekte të dëmshme, (këtu bëjnë pjesë edhe mbetjet spitalore si dhe mbetjet radioaktive, të cilat janë tejet toksike dhe ekspozimi ndaj tyre mund të shkaktojë sëmundje nga më të ndryshmet, madje dhe të shkaktojë vdekje). Menaxhimi i situatës së mbetjeve të rrezikshme (MbRr) në vend, e shprehur me anë të "Hot Spoteve", është përcaktuar qartë nga projektet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Koncretisht si lloje prioritare të MbRr, në 35 sheshet e përcaktuara, (Ministria e Mjedisit-2012; UNEP-2008; UNDP-2010), konsiderohen mbetjet që dalin nga:

- minierat dhe proceset minerare; - mbetjet e naftës dhe mbetje të tjera të hidrokarbureve;
- mbetjet acide apo solucionet bazike; - mbetjet nga reshirat, adesivët (ngjitësit);
- mbetjet nga bojrat, ngjyrosjet, pigmentet etj; - mbetjet e arsenikut;
- mbetjet nga lëkurat, gëzofet dhe industria tekstile etj.
- mbetjet nga trajtimet e sipërfaqeve të metaleve;

Të dhëna për mbetjet spitalore

Nga inspektimi i ARM-së, spitali në Bashkinë Krumes është edhe gjeneruesi më i madh i kësaj rryme. Po ashtu spitali së bashku me disa njësi të tjera farmaceutike, laboratorë apo klinika dentare kanë nënshkruar një kontratë me kompani të certifikuar në Tiranë për trajtimin e mbetjeve spitalore.

Të dhëna për menaxhimin e vajrave lubrifikantë: Nuk ka verifikime nga ARM-ja për: *GJENERUESIT E VAJRAVE LUBRIFIKANTË* për vitin 2017


Zonat Urbane, vend depozitat e mbetjeve urbane

Mbetjet klasifikohen si: mbetje organike; mbetje të ngurta; mbetje patologjike dhe spitalore; mbetje industriale dhe mbetjet agrokulturore. Mbetjet klasifikohen në:

- Mbetje jo të rrezikshme, të cilat quhen ndryshe mbetje urbane ose "plehra" në gjuhën e përditëshme, të cilat edhe pse quhen si jo të rrezikshme mund të rezultojnë shumë të dëmshme për popullsinë dhe mjedisin.
- Mbetje të rrezikshme, të cilat kanë karakteristika kimike e fizike toksike, gërryese, kancerogjene dhe që mund të kenë efekte të dëmshme, (këtu bëjnë pjesë edhe mbetjet spitalore si dhe mbetjet radioaktive, të cilat janë tejet toksike dhe ekspozimi ndaj tyre mund të shkaktojë sëmundje nga më të ndryshmet, madje dhe të shkaktojë vdekjen).

Rëndësia

Miratimi i strategjisë kombëtare të administrimit të mbetjeve dhe ligjit për administrimin e integruar të tyre do të sigurojë një menaxhim të mbetjeve duke ruajtur mjedisin, si ajrin, tokat dhe ujrat



sipërfaqësore e nëntokësore; zvogëlon ndikimin negativ në shëndetin e popullsisë dhe ndihmon për një zhvillim të qëndrueshëm. Synimi kryesor është zbatimi i plotë i tyre duke filluar me parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve, riciklimin, trajtimin e tyre për shfrytëzimin e nxehtësisë apo Energjisë për qëllime industriale, shtëpiake etj, dhe depozitimi i tyre në landfille. Një vend të rëndësishëm në zbatimin e këtij legjislacioni dhe direktivave të Bashkimit European, ka trajtimi dhe shfrytëzimi i mbetjeve industriale. Këto mbetje përveç nevojës dhe rëndësisë së riciklimit dhe përdorimit të tyre, kanë vlera ekonomike në shfrytëzimin e Energjisë termike, të gjeneruar gjatë procesit të incinerimit (djegies), (Ministria e Mjedisit, 2012&2013).

Paradokset e menaxhimit të mbetjeve

- Grumbullohen në venddepozita të hapura në natyrë;
- Nuk kryhet asnjë lloj përpunimi;
- Vendosen në depozitime të shkriфта, toka buke;
- Hidhen pranë sistemeve ujore (lumenj, perrenj);
- Digjen jo rallë në gjendje të lirë;
- Jashtë kushteve të kontrollit mjedisor;


Studimi mbi mbetjet, nga njëra anë informon shoqërinë civile dhe publikun, nga ana tjetër jep gjendjen e menaxhimit të mbetjeve urbane, përsa i përket grumbullimit të tyre, trajtimit, reduktimit, riciklimit, kompostimit dhe groposjes, me qëllim përmirësimin e këtyre proceseve në të ardhmen, të cilat ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mjedisin përreth dhe në shëndetin e popullsisë. Secila Bashki duhet të zhvillojë strategjinë e vet të depozitimit të mbetjeve, ku rindarja në shesh grumbullimi dhe më pas vendgroposja, pa dyshim luajnë rolin më të rëndësishëm. Strategjia duhet të mbështetet mbi:

- Vlerësimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbanë në shesh grumbullim;
- Pastrimin dhe disefektimin e vendeve përreth kontenierëve;
- Larjen dhe disifektimin e kontenierëve;
- Mirëmbajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane gjatë ditës; dhe
- Pajtueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, zhurmat, dridhjet, rrjedhjet ujore dhe të lëngshme.

Më tej, duhet të fokusohet në vlerësimin e zgjedhjes së metodave dhe teknologjive për trajtimin e integruar të mbetjeve urbane apo të ndikimeve pozitive dhe negative në mjedis dhe shëndetin njerëzor. Gjithashtu, ai duhet të vlerësojë sesi janë zbatuar masat zbutëse në rastin e ndikimeve negative dhe të masave të kontrollit dhe montorimit, si nga kompania dhe autoriteti mjedisor.

Mbetjet dhe emetimet

Mbledhja, depozitimi dhe deponimi i mbetjeve tashmë është në kompetencë të Bashkive. Çdo Bashki është kërkuar që të përcaktohet një vënd për deponimin e tyre. Një problem tjetër është trajtimi i ujërave të ndotura urbane. Ato shkarkohen në lumenj ose kolektorë pa patur asnjë lloj trajtimi. Për shembull, ujërat e ndotura të dampave mblidhen në kolektor dhe shkarkohen në ujra sipërfaqësor. Mbulimi në të



gjithë bashkinë është rreth 30%. Kruma mbledh pjesën më të madhe të tarifave për grumbullimin e mbetjeve, krahasuar me 43% të tarifave të pastrimit që mbledhen në të gjithë Qarkun. Vend-depozitimi i mbetjeve të Krumes, i pozicionuar buzë rrugës, është i zbuluar dhe ka një sasi të madhe mbeturinash të depozituara, të cilat trajtohen me djegie. Mbeturinat depozitohen të pandara, duke rritur shumë volumin e mbetjeve. Prandaj shfaqet si i domosdoshëm. Qyteti përballet me një shqetësim të vazhdueshëm, në drejtim të pastrimit të qytetit dhe largimit të mbetjeve urbane. Gjendja në fshatin Vajkal është shumë e rëndë, pasi në asnjë rast nuk janë marrë masat e duhura për përmirësimin dhe shtimin e kujdesit ndaj mjedisit. Po ashtu, në qytet raporti 26.48 familje/një kosh kolektiv është relativisht i madh dhe në shumë raste mosfunksional. Bashkia duhet të marrë masa si në përmirësimin e situatës në qytet ashtu dhe në krijimin e venddepozitimit të mbetjeve. Disa kriteret bazë duhet të kihen parasysh në përcaktimin e vendit optimal për venddepozitim të mbetjeve. Venddepozitimi duhet të:

- Respektojë distancën e lejuar nga ndërtesat e banuara, shtretërit e lumenjëve e përrenjve, nga pusët, shpimet në zonat ujëmbajtëse që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm etj.
- Duhet të ketë hapësirë për të lejuar veprimtarinë e përditshme si ngjeshja e mbeturinave urbane që hidhen çdo ditë.
- mbulimi i tyre me dhe.
- disinfektimi i tyre.
- Regjistrimi i sasisë të mbetjeve të çdo makinë që do hyjë në vendgrumbullim.
- Venddepozitimi do përdoret vetëm për territorin e Bashkisë Krume.
- Do eliminohen ndikimet negative në mjedis.

Varrezat janë një çështje delikate. Sot në territorin e Krumes gjenden kater varreza në varësi të fshatrava, këto duhet të grumbullohen në varrezat qendrore, meqënëse këto varreza i plotësojnë dhe nevojat e popullsisë të ardhshme.

Kufizimet

Për elementet e përmendur më sipër gjatë hartimit të planit vendor do të merren në konsideratë brezat mbrojtës dhe distancat e sigurisë bazuar në legjislacionin në fuqi:


- Kufizime për ruajtjen e mjedisit natyror

Ruajtja e mjedisit natyror për shkak të vlerave specifike natyrore ose vlerës se pejsazhit. Rreziqe hidro-geologjike (si p.sh. erozioni dhe përmytjet)

Kufizime për arsye sigurie

- Rreziqe që vijnë nga afërsia me rrugët urbane dhe ekstra urbane, hekurudhat dhe kabllot e tensionit të lartë.
- Rreziqet për arsye sanitare
- Rreziqet që vijnë nga afërsia me varrezat, zonat industriale, zonat e grumbullimit të mbeturinave dhe landfill-eve, impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, thertoret, burimet e ujit.

Mbetjet inerte dhe vend depozitat e tyre



Nga fluksi i ndërtimeve krijohen mbetje inerte të shumta, të cilat në të shumtën e rasteve i hedhin ku të mundin, në anët e rrugëve, në shpatet e përrenjëve, afër atyre urbane, (shpesh të përziera me to), ku edhe sot këto mbetje inerte (ndoshta edhe të reja), gjenden anës së rrugëve dhe në shpatet e përrenjëve dhe lumenjëve. Mbetjet e inerteve, nën ndikimin e agjentëve atmosferik, erërave dhe reshjeve, sjellin ndotje të ajrit, të ujërave dhe të ambientit përreth, duke dëmtuar botën akuatike.

Konsideratat bazë për legjislacionin në vend


Performanca e menaxhimit të mbetjeve urbane mund të merret si sfidë reale, jo vetëm për zhvillimin e moduleve të kërkuara nga strategjia kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve, por edhe për nivelet e performancës së qeverisjeve lokale në këtë drejtim. Koha është për të bërë një zhvillim ndryshe, më të fokusuar, më të koordinuar dhe më të përgjegjshëm. Besojmë se objektivat e Qeverisjes dhe ato të MSA-së sigurojnë një mundësi për të bërë pikërisht këtë. Shtylla kurrizore e manaxhimit të infrastrukturës mjedisore për çdo rajon të caktuar në fushën legjislative mbështetet në ligjin Nr.10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ndërkohë ajo e administrimit të mbetjeve urbane është sipas Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”. Në mënyrë të përgjithshme përfshihen:

Katalogu i klasifikimit të mbetjeve

- Rregullore për çdo metodë të trajtimit të mbetjeve të ngurta (ndarje, ripërdorim/riciklim, kompostim, djegie, groposje);
- Rregullore për trajtimin e mbetjeve ndërtimore dhe shkatërrimore;
- Rregullore për mbetjet industriale si dhe kushtet për instalimin dhe funksionimin e impianteve të trajtimit të tyre;
- Problem më i madh në administrimin e mbetjeve nuk qëndron te mungesa e ligjeve (Strategjia Kombetare Shqiptare mbi mbetjet, Prill 2010), por te mungesa e një plani administrimi institucional, teknik dhe kapacitete njerëzore, burime financiare dhe investime në infrastrukturë;
- mungesë experience/traditë në administrimin e këtij sektori;
- mungesë e mjeteve ekonomike të përdorura për administrimin e mbetjeve;
- komunikim i dobët midis qeverisë lokale dhe qendrore mbi çështjet e mbetjeve;
- bashkëpunim i dobët midis komunitetit, biznesit dhe ndërmarrjeve menaxhuese mbi çështjen e mbetjeve;
- mungesë mbi monitorimin, treguesin dhe statistikën e mbetjeve dhe mungesa e rrjeteve për të mbledhur dhe përpunuar ato, etj.

Konsideratat bazë për legjislacionin në BE mbi mbetjet urbane

Direktivat Europiane mbi të gjitha fiksojnë objektivat, procedurat dhe kriteret e përgjithshme, disa detyrime të veçanta dhe të rëndësishme dhe koha për të arritur këto objektiva. Vendet anëtare dhe/ose Administrata Lokale krijojnë ligjin dhe rregulloren me ankesat teknike në kërkesë të bërjes së mundësisë të realizimit dhe funksionimit të landfillit (vendgroposje). Për parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve është vendosur një rend prioriteti në hierarkinë e mbetjeve.



- a. Parandalim;
- b. Përgatitje për ripërdorim;
- c. Riciklim;
- d. Rikuperim tjetër, p.sh. rikuperim energjie;
- e. Groposje.

Eliminimi i mbeturinave urbane përbën një hallkë jetike në konceptin fillim-përfundim të menaxhimit të mbeturinave urbane. Theksi aktual mbi parandalimin e ndotjes, si dhe zhvillimi i teknologjive të trajtimit, ka si rezultat pakësimin e volumit të mbetjeve urbane, të cilat duhet të eliminohen.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Qyteti i Krumes përballet me një shqetësim të vazhdueshëm, në drejtim të pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane. Gjendja është shumë e rëndë, pasi në asnjë rast nuk janë marrë masat e duhura për përmirësimin dhe shtimin e kujdesit ndaj mjedisit. Po ashtu, në qytet raporti 20 familje / një kosh kolektiv është relativisht i madh dhe në shumë raste mosfunksional. Pjesa dermuese e popullsisë shprehet se nuk janë të kënaqur me shërbimin e pastrimit, ndaj në të ardhmen duhet të merren masat e duhura për përmirësimin e gjendjes në përputhje me standartet e reja të BE.




Fig. - 48 Skema e opsioneve të trajtimit të mbetjeve të ngurta (majtas dhe skema e trajtimit të mbetjeve të ngurta në zbatim (djathtas)

4.31 GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTI I MBETJEVE

Mënyrat e grumbullimit

Në rajonin e Krumes ushtrohet një aktivitet i ulët teknologjik, që nuk arrijnë të ndikojnë dukshëm në mjedisin përreth me mbetjet e tyre. Gjithsesi, i vetmi burim ndotje mendohet se janë dampat minerare aktuale, por më tepër ajo historike pa lënë mënjane dhe ato antropogjene. Që nga viti 1994, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve, si dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve vendore, duke i bërë plotësisht përgjegjëse për manaxhimin e tyre. Sistemet që trashëguan dhe sot operojnë, konsistojnë në grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane në një rrymë të vetme dhe transportimin e tyre në vendet lokale të depozitimit të tyre. Procesi i delegimit të kompetencave, pavarësisht përmirësimeve graduale të vërejtura është kthyer në një sfidë

për autoritetet vendore. Ato janë ballafaquar me mungesën e instrumenteve të nevojshme për manaxhimin mjedisor të mbetjeve, mungesën e teknologjive dhe të investimeve, si dhe të kapaciteteve të mjaftueshme të burimeve njerëzore dhe financiare.

Shërbimi i ofruar

Deri më tani ka qënë mjaft i kufizuar dhe larg realizimit të standardeve dhe kërkesave të kohës. Ai konsiston thjesht në largimin e mbetjeve urbane nga disa rrugë kryesore, një herë në javë, me anë të një kamionçini, por pa patur mjetet e nevojshme për menaxhimin e duhur të tyre. Aktualisht, situata është akoma dhe më e rëndomtë, sepse ky shërbim, prej rreth një viti mungon krejtësisht dhe koshat për depozitimin e këtyre mbetjeve nuk ekzistojnë në asnjë rrugë të fshatrave që përbëjnë këto Komuna. Kjo situatë është paradoksale, përderisa rajoni në fjalë ka nën funksionet e tyre edhe shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane përcaktuar në Ligjin Nr. 8652 datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" (i ndryshuar). Çdo ditë e më tepër këto mbetje urbane përbëjnë një shqetësim të vazhdueshëm për banorët e këtyre zonave, të cilët e perceptojnë kërcënimin real që po iu ushtrohet.

Sasitë vjetore aktuale dhe në perspektivë

Nga përlllogaritjet e përafërta të bëra nga grupi studimor rezulton se në këtë zonë mund të formohen jo më tepër se 20 ton mbetje urbane në ditë ose rreth 600 ton në muaj, që po t'i shpërndajmë në njësinë e madhe, nga njëra anë nuk përbën ndonjë ndotje të madhe, por nga ana tjetër paraqet vështirësi për grumbullim dhe sistemim të tyre. Edhe në perspektivë duke qenë se lëvizjet demografike tashmë paraqiten në ekuilibër mendohet se gjenerimi i mbetjeve urbane apo familjare për banorë do të jetë jo më shumë se shifrat e mësipërme. Aktualisht, mbetjet mbliidhen sipas një norme të thjeshtë civile dhe depozitohen në fushë të hapur, e cila ndodhet jo larg nga qendra e qytetit. Nga aktiviteti i depozitimit të mbetjeve në ndodh ndotja e ajrit nga emetimet në formë gazrash të dëmshëm dhe era të rënda, që përbëjnë kërcënim për punonjësit e fushës së mbetjeve dhe banorët përreth zonës, si edhe ndotja e tokës dhe ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga precipitimi i leksiviatit të mbetjeve. Prania e kafshëve dhe shpendëve përbëjnë shqetësim për përhapjen e sëmundjeve infektuese. Ajo që është më paradoksale, ato, hidhen në/dhe pranë sistemeve lumore, si në kanalet kullues që çojnë ujërat në hidrovor. Nëpërmjet proceseve të komplikuar kimike dhe fizike, substancat e rrezikshme depërtojnë në zinxhirin ushqimor të njerzve, bimëve dhe kafshëve. Gjenerimi aktual i mbetjeve urbane nuk mund të klasifikohet për momentin, por pritet të jenë në vlera jo të vogla dhe të shumëllojshme, duke filluar nga mbetjet solide, familjare, spitalore, industriale deri në ato bujqësore. Nga studimet rezulton se jo të gjitha mbetjet urbane thjesht mund të groposen. Në bazë të kësaj kostoje të re specifike për çdo kategori ne mund të llogarisim tarifën për çdo familje, biznes dhe institucion që duhet të paguajnë për mbulimin e kostos operative për kryerjen e këtij shërbimi: Tarifa për një familje/vit = 100 lekë /vit. Tarifa për një biznes (mes) = 20000 lekë /vit Tarifa për institucionet = 20000 lekë /vit. Nga të dhënat paraqitet qartë se llogaritja e tarifës nuk duket se është e lartë si për qytetarët, ashtu dhe për bizneset, por llogaritur me ndikimet indirekte që sjell mosmenaxhimi i mbetjeve, këto kosto të bëjnë të mendosh që janë të ulta ose të përballueshme. Gjithësesi ka nevojë për rishikime të një plani të ri, ku njëkohësisht të analizohen mundësitë për



uljen e shpenzime për këtë shërbim.

Tab. - 3 Përbërja e mbeturinave në rajonin në studim

<i>Materiali</i>	<i>Përbërja në %</i>	<i>Sasia ton/vit 2009</i>	<i>Sasia ton/vit 2015</i>	<i>Potenciali per Kompostim</i>
<i>Organik</i>	53,70	17248	18860	18860

<i>Letër dhe karton</i>	10,54	3385	3702	3702
<i>Plastikë e riciklueshme</i>	13,70	4400	4812	
<i>Qelq</i>	5,25	1686	1844	
<i>Metale</i>	0,70	225	246	
<i>Lëndë Drusore</i>	0,62	199	218	218
<i>Tjeter</i>	15,50	20,80	5444	
<i>Totali i vleresuar</i>	100,00	100,00	100,00	22780



Sistemi aktual i menaxhimit të mbetjeve, dobësitë, problemet

Mungesa e menaxhimit të Trajtimit të Integruar të Mbetjeve Urbane ka shkaktuar një shpërndarje të pakontrolluar të plehrave, të cilat shkaktojnë ndotje të mëdha që lidhen me tokën, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrin dhe erën (aromat). Në rajonin e Krumes, për shkak të terrenit dhe zonës së varfër që vjen nga mungesa e investimeve nuk gjenerohen në sasi problemore mbetje të ngurta. Kështu, sasi të vjetore janë jo të larta dhe nuk paraqiten problematika shumë serioze lidhur me to. Gjithsesi, shihet i nevojshëm një plan menaxhimi për mbeturinat. Sistemimi i Mbetjeve Bashkiake është kryer dhe vazhdon të kryhet, në mënyrë primitive. Aktualisht nuk bëhet asnjë lloj ndarje dhe trajtimi.

Dobësitë, problemet

Aktualisht, ato jo vetëm nuk sistemohen diku, në një vendgroposje të kontrolluar, madje as nuk mblidhen sipas një norme të thjeshtë civile. Ajo që është më paradoksale, ato, si në çdo Komunë tjetër hidhen në dhe pranë sistemeve të përrrenjve dhe ato lumore. Aq sa, nëpërmjet proceseve të komplikuar kimike dhe fizike, substancat e rrezikshme depërtojnë në zinxhirin ushqimor të njerëzve, bimëve dhe kafshëve. Në të gjitha rastet, ato komunikojnë me thellësinë, (tokën e shkrifët, ujin, etj.) për shkak të sedimenteve të shkrifta, që ka formacioni mbulesor i Kuaternarit.

Plani i menaxhimit të mbetjeve urbane

Zgjidhjet teknike për eliminimin e mbetjeve të ngurta me një kosto efektive duhet të jenë gjithashtu të pranueshme edhe nga ana sociale. Menaxhimi i mbeturinave urbane është më kompleks se thjesht vend depozitimi i tyre në vend groposje të kontrolluar inxhinierike (landfill).

Administrimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane përfshijnë:

- Reduktim të mbeturinave që në burim;
- Ndarje, vend depozitime familjare;
- Ripërdorim të mbeturinave;
- Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave;
- Riciklim jashtë vendit të grumbullimit;
- Trajtim primar i mbeturinave (biologjik, kimik/trajtim fizik, kompostim);
- Verifikim i sistemit për transportin dhe venddepozitimin e mbeturinave urbane;
- Vend depozitim përfundimtar (landfill).



Përveç mungesës së informacionit dhe të një tradite, e cila vjen dhe si pasojë e kohës së shkurtër të bashkëjetesës së banorëve, prejardhjet e ndryshme kulturore, mungesat e koshave të ndarë, ndikojnë dhe bëjnë të pa realizueshme zhvillimin e Reduktimit, Ripërdorimit dhe Riciklimit. Këto metoda janë zgjidhje mjedisore të integruara me zgjidhjen ekonomike, duke ju përmbajtur parimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane, uljen e sasisë së mbetjeve dhe njohjes së praktikës më të mirë. KRR ka bërë diçka për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të ngurta në zonat e ish Komunave. Mbetjet familiare, si dhe ato të rrezikshme, shpesh përzihen me mbetjet e ngurta urbane. Përgjithësisht mbledhja e mbeturinave të ngurta dhe pastrimi i rrugëve rezultojnë të jetë jo efektiv në këto zona. Ndaj theksojmë nevojën e trajtimit të këtij shërbimi në grumbullimin, largimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta urbane e cila konsiston në:

- Zbrazen e kontenerëve me makinën e përshtatshme teknologjike vetshkarkuese;
- Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10m nga çdo kontener;
- Pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30m² rreth çdo pike grumbullimi;
- Dezinfektimi i brendësisë së konteniervë dhe sipërfaqes përreth, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori;
- Rivendosja e kontenerëve të sistemuar në vendin e caktuar;
- Transportin e mbeturinave në fushën e përpunimit të tyre me makinat teknologjike vetshkarkuese.
- Kontenerët të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike në mjedisin urban të paracaktuar nga njësia vendore përkatëse. Dezinfektimi bëhet pas zbrazjes së çdo konteneri, duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

Plani i vendosjes së kontenerëve dhe grafikët e punimeve

Njësitë vendore duhet të përcaktojnë sipas një gjenplani, pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenerëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e administruar në nivel vendor, ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës së administrimit vendor.

Kriteret bazë për hartimin e planit të menaxhimit të mbeturinave

Plani për Menaxhimin e Mbeturinave u hartua duke u mbështetur si në disa kriteret standarde teknike, po ashtu dhe duke marrë në konsideratë kushtet konkrete dhe mundësitë reale për një përmirësim të shërbimit të pastrimit sa më afër plotësisht të nevojave të qytetarëve shoqëruar dhe me rritjen e efikasitetit të burimeve financiare dhe njerëzore që Bashkia do të përdori. Ky plan përmban në vetvete propozimet për skemën e re të grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave, trajtimin e vend depozitimit të mbeturinave, riorganizimin e strukturës së ndërmarrjes së pastrim-gjelbërimit sipas shërbimeve specifike, prezantimin për ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit, mbulimin e kostos së shërbimit me rritjen e efikasitetit në menaxhim, ngritjen e një skeme monitorimi dhe shtrirjen e këtij shërbimi edhe në zona të tjera në të ardhmen sipas analizave përkatëse. Plani i menaxhimit të mbeturinave përcakton rekomandimet për ndërhyrje në kohë afatshkurtër. Skema për

grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave. Skema për grumbullimin, transportimin dhe depozitimin e mbeturinave bazohet në një analizë të detajuar të të dhënave mbi vëllimin e mbeturinave, mënyrën e grumbullimit, përzgjedhjen e llojit të mjeteve për realizimin e grumbullimit dhe transportimit, mënyrën e transportit si dhe mundësitë reale të depozitimit të tyre. Për këtë arsye, sasia e mbeturinave që prodhohet në vit është rreth 7000 ton, shifër mbi të cilën ngrihet një plan i caktuar. Skema propozon shpërndarjen e 10 pikave grumbullimi të mbeturinave për mbledhjen e tyre (duke shpërndarë një kontenier metalik për çdo pikë grumbullimi) dhe duke mbuluar gjithë territorin e Komunave. Pasurimi i hartës për vend-vendosjen e

10 pikave të grumbullimit bazohet në kritere si:


- Pikat ekzistuese e grumbullimit të mbeturinave prej banorëve;
- Densiteti i popullsisë;
- Distanca nga një pikë grumbullimi në tjetrën të mos kalojë kufirin 600-700m;
- Përshtatshmëria me infrastrukturën/hapësirat publike;
- Siguria për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e kazaneve;
- Krijimi i lehtësisë për një sistem standard të grumbullimit të mbeturinave.

Nisur dhe nga propozimet dhe interesi i bashkisë, përzgjedhja e llojit të kazaneve konsistoi në kazane plastik të vëllimit $1,1m^3$, duke qenë se synimi konsiston në futjen në përdorim të makinës teknologjike. Llogaritja për numrin e kazaneve plastik si dhe shpërndarja e tyre bazohet në numrin e familjeve, duke respektuar normative 40-50 kazane, në total (sipas studimeve të bëra për të shfytëzuar me efikasitet kontenieret llogaritet që një kontenier t'u shërbejë rreth 25-35 familje, në varësi të dendësisë së shtëpive), por duke marrë në konsideratë nevojën për shërbimin e pastrimit të banesave të veçanta (grupe me 2-3 shtëpi të shpërndara për shkak të largimit të popullsisë pas viteve '90).

Trajtimi i vendgrumbullimit

Procesi i transportimit të mbeturinave duhet të realizohet me një makinë vetshkarkuese drejt vendit të depozitimit, i cili është i vendosur në një rreze prej 5km larg nga qendra e qytetit, i pozicionuar në mënyrë të pjerrët në pyll me sipërfaqe rreth $2000-3000m^2$. Sheshimi që ka nevojë kjo dampë do mundësojë lehtësimin e praktikës për ndarjen e mbeturinave. Si rezultat do të përftojë zvogëlimin e volumit të tyre duke i bërë të gatshme për në venddepozitimin regional. Riorganizimi i strukturës së ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit:

- Reformë në lidhje me përmirësimin e shërbimeve publike në terësi dhe atë të shërbimit të pastrimit në veçanti.
- Ngritja e një strukture të re pranë Bashkisë do të mundësojë menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe proceseve lidhur me të.
- Riorganizimi i skuadrës së pastrimit të rrugëve dhe mekanizimi i procesit të ngarkimit dhe transportimit të mbeturinave, duke vendosur në punë makinën teknologjike së bashku me kazanet plastik do të mundësojë uljen e kostove të shërbimit të pastrimit dhe rritjen e efikasitetit.



Landfillet, menaxhimi i mbetjeve urbane, riciklimi i tyre

Bazuar në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (PKMM) 2010-2025 ku është parashikuar që menaxhimi dhe trajtimi i mbetjeve të bëhet në nivel rajonal për 12 qarqet ekzistuese, objektivi kryesor është vendosja në gjendje sigurie të venddepozitimeve ekzistuese dhe ndërtimi i vend depozitimeve rajonale sipas standarteve të BE, (landfilleve). Aktualisht janë ndërtuar dhe janë në fazë studimi dhe ndërtimi, një sërë landfillelesh, në disa zona urbane të vendit, (Ministria e Mjedisit, 2012&2013).

Faktorët analizues në përzgjedhjen e sheshit të venddepozitave

- Përputhshmëria me përdorimin e tokës në të gjithë zonën;
- Pranueshmëria nga ana e infrastrukturës;
- Prezenca e njaftueshme e dherave që shërbejnë si material mbulues;
- Zgjedhja e sheshit në përputhje me interesat e banorëve;
- Mjaftueshmëri e sheshit për funksionimin e vendgroposjes 10-30 vjet;
- Sheshi dhe funksionimi i vend-groposjes (funksionimin për shumë vite, mbylljen, kujdesin pas mbylljes), të mbulojë shpenzimet buxhetore, si dhe kostot e trajtimeve;
- Funksionimi i planit duhet të parashikojë edhe koordinimet me Riciklimin, Reduktimin, Ripërdorimin e mbulimit të burimeve të mbetjeve.

Kostot e menaxhimit të mbetjeve

Kostoja e menaxhimit të mbetjeve duhet të përballohet nga prodhuesi i mbetjeve ose nga poseduesi i kaluar ose aktual i mbetjeve — në përputhje me principin ndotësi paguan. Menaxhim i mbetjeve do të thotë mbledhje, transport, rikuperim dhe trajtim i mbetjeve, përfshirë veprimet e ndërmarrasi tregtar ose komisionar.

Gjenerimi aktual i mbetjeve urbane

Gjenerimi aktual i mbetjeve urbane nuk mund të klasifikohet për momentin, por pritet të jenë në vlera jo të vogla dhe të shumëllojshme, duke filluar nga mbetjet industriale historike, familjare, spitalore, industriale të sotme deri në ato bujqësore, të cilat mendohet të jenë në shifrën rreth 1000 ton, (Guri, S., etj.. 2013). Emetimet, (lëshimet në ajër) nga djegiet përmbajnë nivele të larta të metaleve të rëndë si: plumbi, kadmiumi, mërkuri, kobalti, zinku, bakri etj.

Metalet e rëndë janë të pranishëm në shumë rrjedhje të mbetjeve dhe nuk mund të shkatërrohen as kur digjen në qiell të hapur, por ato përfundojnë në hi ose çlirohen si emetime ajrore. Metalet e rëndë paraqesin rrezik për shëndetin edhe në përqëndrime të vogla, për shkak të vetive të larta helmuese të tyre, siç janë mërkuri, plumbi, kadmiumi etj.

Plumbi, i cili shkakton çrregullime nervore.

Kadmiumi, i cili shkakton dëme në veshka, hipertension dhe dëmtime gjenetike.

Kobalti që rezulton nga dambat e pambuluara dhe me nënshtrojë të përshkueshme. Ai është element bioakumulues në trupin e njeriut, dhe është helmues për veshkat dhe sistemin nervor.

Mërkuri shkakton dëme në zhvillimin normal të trurit, sapo shndërrohet në formën e tij organike në mjedis. Femrat shtatzëna, si dhe femrat në moshën e riprodhimit duhet që të mos konsumojnë produkte bujqësore të dala nga këto zona, ose të prekura nga ujërat lokale. Ai shkakton defekte në lindje, dëmtime

në sistemin imunitar dhe çrregullime nervore, (Guri, S., (2013); Manastirliu, O., 2013). Përbërës të tjerë të rrezikshëm janë edhe ata organike, si heksakloro butadina, heksakloro benzina dhe heksakloro etani, që janë të theksuara tek mbetjet. Këta tre përbërës, meqë përmbajnë shumë klor, janë të rezistueshëm edhe ndaj djegies, kështu që vazhdojnë në zinxhirin ushqimor, deri tek marrësi i fundit që është njeriu. Banimi brenda rrezes 7 km rrezikon për kancere të ndryshme (studim i vitit 1996 për 14 milion njerëz që jetojnë pranë tyre).

Dioksina dhe përbërësit klorikë organikë që lidhen me to, janë substanca jashtëzakonisht helmuese që kanë një sërë ndikimesh të kundërta tek njerëzit dhe tek kafshët, edhe në doza të vogla. Ato janë të



pranishme për shkak të djegies së mbetjeve dhe rrezikojnë të gjithë banoret që banojnë pranë këtyre djegieve. Këta përbërës janë të qëndrueshëm dhe janë në përqëndrime të mëdha, duke lëvizur në zinxhirin e ushqimeve, veçanërisht tek yndyrnat, sidomos tek qumështi. Dioksina dihet që shkakton zhvillimin e qelizave kancerogjene. Kjo ndërhyr edhe në metabolizmin tiroid të foshnjave si dhe në sistemet hormonale. *Furanet* si dhe dioksinat janë përbërës helmues, të prodhuar po nga djegia e plehrave. *Furanet* bëjnë pjesë në një familje kimikatesh të ngjashëm me dioksinën dhe mund të shkaktojnë dëmtime shëndetësore të njëjta si kancere dhe veprojnë si një përçues endokrinal me kundërndikime në sistemin e riprodhimit, zhvillimit dhe imunitetit.

Njohuri të përgjithshme për landfillet dhe mënyrat e përpunimit të mbetjeve

Një landfill i sigurt është një vaskë në tokë, ku hidhen mbetjet urbane. Qëllimi i ndërtimit të tij është për të shmangur çdo lidhje mes këtyre mbetjeve dhe mjedisit përreth, (ajër, tokë, ujra sipërfaqësore e nëntokësore). Landfillet ose venddepozitimet ndahen në tre kategori:

1. landfille për Mb. Rr. (mbetje të lëngëshme, spitalore, eksplozive, gërryese).
2. landfille për mbetjet jo të rrezikëshme, (mbetjet urbane etj.).
3. venddepozitime, (landfille) për mbetjet inerte.

Asgjësimi i mbetjeve duhet bërë pa vënë në rrezik shëndetin e njerëzve dhe pa përdorimin e proceseve ose metodave që dëmtojnë mjedisin. Në përgjithësi ekzistojnë katër kategori kryesore të praktikave të përpunimit dhe trajtimit të mbetjeve. Këto janë: riciklimi i tyre, trajtimi biologjik, trajtimi termal dhe landfili sanitar.

Riciklimi i mbetjeve është rikalimi i tyre, në procesin e riprodhimit. Për riciklim mund të shfrytëzohen disa materiale: si metalet, qelqi, letra dhe plastika. Kjo kërkon një ndarje paraprake të mbetjeve që në burim (kosha të veçantë), grumbullimin e tyre të veçantë si dhe transportin në pika të veçanta (pika të depozitimit të përkohshëm), për një përzgjedhje dhe ndarje të mëtejshme.

Trajtimi biologjik ka të bëjë me dekompozimin e materialeve organike nëpërmjet veprimtarisë mikrobike, në kushte të pranisë dhe mungesës së ajrit, për të prodhuar material organik të qëndrueshëm që përmban plehra ushqyese për bimët.

Teknologjitë termale që përdorin nxehtësinë për të shpërbërë mbetjet dhe për të prodhuar një masë mbetjesh, (hirin) të gatëshme për t'u depozituar dhe kryesisht të parrezikshme. Mbetjet e ngurta urbane kanë një vlerë të caktuar kalorifike dhe një pjesë e kësaj energjie mund të rikuperohet duke përdorur këto teknologji, në formën e nxehtësisë apo elektricitetit. Kjo çon në ulje drastike të mbetjeve që depozitohen në landfill.

Problemet mjedisore që shkaktohen nga landfillet

Në landfillet që nuk menaxhohen sipas rregullave të mësipërme, problemet mjedisore janë të shumta, sidomos për efektet atmosferike dhe hidrologjike.

Efektet atmosferike janë mjaft të theksuara kur mbetjet organike janë të hedhura në landfill në mënyrë të çrregullt, pasi ato i nënshtrohen degradimit anaerobik, duke u bërë burim i theksuar i gazeve të tillë si

metani CH₄, (një gaz serë që është shumë më i fuqishëm se dioksidi i karbonit CO₂), bile mendohet se CH₄ i prodhuar nga kalbëzimi i mbetjeve organike në tokë, ka efekte negative rreth 20 herë më të larta se CO₂. Nga djegia e mbetjeve krijohet një tym i trashë që përmban monoksid karboni (CO), blozë dhe monoksid azoti (NO), të cilët degradojnë cilësinë e ajrit dhe janë të rrezikshëm për shëndetin e njeriut. Nga ana tjetër, djegia e plastikave (PVC-s) shkakton prodhimin e dioksinave të cilat degjenerojnë lehtë në komponime kancerogjene.

Efektet hidrologjike ndodhin nga reshjet-atmosferike, apo gjatë dekompozimit të mbetjeve të ndryshme, ku landfillet krijojnë një përzierje ujore toksike të kimikateve industriale dhe detergjentëve kimike që përdoren për pastrim në shtëpi. Nga ana tjetër, dekompozimi i mbetjeve organike shoqërohet me rritje të nutrientëve të tretshëm në ujë, (si fosfate, nitrate, nitrite apo amonium), të cilët sjellin ndotje të sistemeve ujore. Shllami është mbetja e lëngët që infiltron përgjatë landfillit si rezultat i dekompozimit të mbetjeve, i cili përmban lloje komponimesh organike dhe inorganike. Kështu që ujrë sipërfaqësore dhe nëntokësore mund të kontaminohen nga këto derdhje të patrajuara të landfillit.

4.32 GJENDJA E TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE NË BASHKINË E HASIT


Të përgjithshme

Si kudo edhe në Bashkinë e Krumes, më përpara mbetjet urbane, me përbërje të tilla si: mbetje organike, mbetje inerte, mbetje letre, mbetje plastike, mbetje qelqi, hekurishte, madje edhe ato sanitare, hidheshin ku të mundnin, duke ndotur ambientin për faktin se të gjitha mbetjet e lehta si plasmaset dhe grimcat e tjera largohen nga era, të tjerat dekompozohen por sidomos djegjet në natyrë duke sjellë ndotje të theksuara kudo në ambientin rrethues, si në ajër, në ujëra dhe në toka, duke dëmtuar kështu si florën, faunën dhe gjithë botën e kafshëve si dhe njerëzit. Në këtë qytet, tashmë funksionon një sipërmarrje private për pastrimin e mbetjeve urbane që financohet nga shteti, ku aktualisht mbetjet transportohen në dampen përkatëse të kësaj Bashkie.

Mbetjet inerte dhe vend depozitat e tyre Nga fluksi i ndërtimeve krijohen mbetje inerte të shumta, të cilat në të shumtën e rasteve i hedhin ku të mundin, në anët e rrugëve, në shpatet e përrenjëve, afër atyre urbane, (shpesh të përziera me to), ku edhe sot këto mbetje inerte (ndoshta edhe të reja), gjenden anës së rrugëve dhe në shpatet e përrenjëve dhe lumenjëve. Mbetjet e inerteve, nën ndikimin e agjentëve atmosferik, erërave dhe reshjeve, sjellin ndotje të ajrit, të ujërave dhe të ambientit përreth, duke dëmtuar botën akuatike.

Karburantet

Pikat e furnizimit të automjeteve me karburant, siç dihet janë të shpërndara gjithandej, deri në zemër të qyteteve. Këto karburante përveç ndotjeve që sjellin, si në ajër, në rrugët dhe ambientet përreth tyre, me avujt dhe praninë fizike të produkteve të hidrokarbureve, si naftë, benzinë, vajra etj, paraqesin gjithnjë rreziqe imediate nga zjarret apo shpërthimet e mundshme të tyre, nga difektet e mundshme apo nga pakujdesitë e punonjësve gjatë punës. Pra ato ju qëndrojnë banorëve si bomba mbi kokë.



“Varrezat” e Automjeteve


Vatra ndotjeje janë edhe “varrezat” e automjeteve që gjenden të shpërndara në shumë pika të hapësirave të bashkive të vendit, të cilat prodhojnë ndotje të përditëshme si në ujrat dhe në tokat përreth. Ato përmbajnë sasi të konsiderueshme substancash me shkallë të lartë ndotjeje, përfshirë naftën, vajrat, tretës dhe produkte të tjera petrokimike. Edhe pse në të gjithë Shqipërinë ka qendra dhe reparte për çmontimin e automjeteve të tilla, pjesa më e madhe e tyre nuk janë të pajisura me masat e mjaftueshme për parandalimin e ndotjes ose praktika të sigurta pune.

PËRFUNDIME

- Aktiviteti Minerar në vite, si minierat e mbyllura, ato aktuale, punimet minerare sipërfaqësore (karrierat), si për mineralet metalore, edhe për jometaloret, (për kromin, gurët dekorativ, gëlqerorët, etj), sjellin ndotje të shkallëve të ndryshme në ajër, (me gazrat dhe pluhurat që çlirojnë), dëmtim të sipërfaqeve dhe ndotje të tokave me sterile dhe metale të rëndë si dhe ndotje të ujrave, (deri në ujra acide, të pasura me sterile dhe me metale të rëndë, që shpëllajnë këto punime. stoqet dhe dambat e tyre).
- Industria Ndërtimore (sidomos në vitet e demokracisë), ka sjellë ndotje të theksuar në mjedis me pluhurat dhe mbetjet inerte të shumta që prodhohen, si nga shembjet, ndërtimet, transporti, ku pothuajse në të gjitha këto procese nuk zbatohen as normat elementare për mbrojtjen e mjedisit.
- Shfrytëzimi intensiv i shtretërve të lumenjëve ka sjellur rrisqe negative në ekosistem dhe në vet ekuilibrin natyror të këtyre lumenjeve, (shembje dhe humbje tokash bujqësore, rrezikim shtëpishë, shpesh devijim shtretërisht dhe përmytje tokash), si dhe ndotje të ujrave nëntokësore meqë lumejtë shërbejnë si akuifer ujëdhënës për to.
- Zhvillimi i bizneseve të ndryshme ka sjellë sasira të mëdha dhe të pakontrolluara të mbetjeve, ku në mungesë të sheshdepozitave ose landfilleve të përshtatëshme, hidhen vend e pa vend, (sidomos në brigjet e lumenjëve), mbetje urbane, spitalore dhe industriale, pra edhe mbetje të rrezikshme, duke ndotur ajrin, tokën dhe ujrat.
- Hedhja e MbRr dhe mbetjeve spitalore së bashku me mbetjet urbane, pa një ndarje paraprake, çon në nxjerrjen jashtë standardi edhe të landfilleve të mbetjeve urbane.

REKOMANDIME

- Duhet të rritet informacioni dhe ndërgjegjësimi si në industri në lidhje me kërkesat ligjore për teknologjitë përkatëse, ashtu edhe në jetën e përditëshme, në lidhje me këto lloje mbetjeshdhe ndotjet që sjellin ato në mjedis.
- Trajtimi me projekte të posaçme i ujrave sipërfaqësore dhe atyre që dalin nga minierat, pra projekte për neutralizimin e ujrave të minierave, të stoqeve të minierave dhe sterilet edambave të fabrikave të pasurimit dhe të shkrirjes, kryesisht të bakrit.
- Sistemimi i karrierve me taraca dhe mbushja e hapësirave të tyre me sterile të stoqevpërkatëse si dhe mbyllja e grykave të puseve të kërkim-shfrytëzimit, si dhe të galerive.
- Duhet të krijohet koncepti i menaxhimit të mbetjeve të rrezikëshme, sepse deri më sotpothuajse ato konsiderohen si mbetje të thjeshta urbane.



- Duhet të krijohet koncepti i ndarjes që në burim, i mbetjeve urbane nga MbRr, sipas njëkompozimi “praktik” të koshave të riciklimit, në përputhje me strategjinë e Ministrisë sëMjedisit si: Të riciklueshme (të thata); Organike/të ndryshme (të njoma); Të rrezikshme.
- Ndërtimi i landfillleve, (që lënë për të dëshiruar), duhet të bëhet me kriteret tepër rigorozet sigjeologjike edhe teknike, nën mbikqyrjen dhe përgjegjësinë e plotë të specialistëve të kësajfushe dhe jo të lihet në dëshirën e biznesmeneve.
- Duhet bere groposje te sigurta ekologjike për trajtimin e MbRr dhe asgjësimin e tyre;

DIREKTIVAT EUROPIANE MBI MBETJET

Direktivat Europiane mbi të gjitha caktojnë objektivat, procedurat dhe kriteret e përgjithshme, detyrime të veçanta e të rëndësishme dhe kohën për të arritur këto objektiva. Në vendet anëtare të BE, administrata lokale krijon ligjin dhe rregulloren me anekset teknike për realizimin dhe funksionimin e landfillit (vend-groposje). Për parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve është vendosur një rend prioriteti në hierarkinë e mbetjeve:


- a) Parandalim;
- b) Përgatitje për ripërdorim;
- c) Riciklim;
- d) Rikuperim tjetër, p.sh. rikuperim energjie;
- e) Groposje.

Teknika që përdoren aktualisht janë ripërdorimi, riciklimi dhe groposja, ku dy të parat (riciklimi dhe rikuperimi) funksionojnë në rrugë gjysëm-informale ose plotësisht informale private, ndërsa e fundit është e organizuar me mangësitë e veta në nivel politikash publike.

RIKIKLIMI

Shoqata e Ricikluesve Shqiptarë (SHRSH) është krijuar kohët e fundit. Rreth 60 kompani private janë në treg, të cilat po merren me riciklimin e mbetjeve. Jo të gjitha prej tyre kanë leje për të vepruar nga MM-ja. Grumbullimi mbetjeve për riciklim nga këto kompani bëhet në mënyrë të thjeshtë. 92% e komunitetit rom merret me mbledhjen e tyre, të cilët janë të regjistruar si të papunë. Janë regjistruar rreth 12,000 individë që merren me mbledhjen e metaleve. Ata nuk janë pajisur mirë dhe të patrajtuar dhe mbi të gjitha nuk kanë një kontratë zyrtare me blerësit e tyre. Barrierat që pengojnë riciklimin:

- çmimi i lartë i energjisë;
- si dhe çmimi i transportit ;
- fuqia e dobët ekonomike e grumbulluesve, individët dhe kompanitë së bashku;
- mungesë e veçimit që në fillim;
- mungesë informacioni në nivel publik, administrativ dhe tregtar;
- mungesë në stimulimin dhe promovimin e ripërdorimit, riciklimit dhe përpunimit;
- mungesë eksperience nga vetë bizneset;




- vëzhgimi në hyrjen e burimeve financiare për të zhvilluar biznese të tilla.

Kohët e fundit ka pasur disa iniciativa pozitive për ndarjen e mbetjeve në dy grupe kryesore, organike dhe jo organike. Nuk ka një rrjet të integruar dhe të përshtatshëm impiantesh për trajtimin dhe heqjen e mbetjeve, si dhe rikuperimin e mbetjeve. Ata nuk marrin në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme (TMD).

QËNDRIMI I EKSPERTËVE MJEDISOR

Ekspertiza shkencore mjedisore, i kërkon dhe i ofron aktorëve politikbërës dhe faktorëve vendimmarrës, qendror e lokal, zgjidhjen e ekuacionit të menaxhimit dhe trajtimit të integruar të mbetjeve urbane në

Reduktimi, Ripërdorimi, Riciklimi (3R) – Metoda Ekologjike të Trajtimit të Mbetjeve Urbane



M.sc. Harvanthi Guri



Shkupito "Mevgrup", Rr "Samir Frasheri", Godina 13, Kat B - Tel. 04 222 5174

10

vendin tonë, duke iu dhënë mekanizmat e mënyrat përkatëse:

1. Sesi mbetjet nëpër dampat të mbylljen e të rehabilitohen me praktikat më të mira europiane.
2. Sesi tarifit t'i përgjigjen zbatimit të standarteve, njëherësh shërbimit dhe kostove reale.
3. Sesi të nxitet dhe zbatohet skema e grumbullimit dhe ndarjes së mbetjeve në burim, duke i dhënë prioritet kompostimit, riciklimit, e më pas rikuprimin të energjisë, dhe më pas asgjësimin me metodat efektive, eficiente dhe ekonomike industriale.

4. Sesi lënda organike që zë 54% të mbetjeve të vendit duhet t'i drejtohen proceseve të përdorimit (kompostimit), përndryshe të konsidrohesh krim mjedisor ose vepër penale, kur ato i përzier me mbetjet e tjera.
5. Sesi mbetjet organike nga përpunimi ose gatimi i prodhimeve të detit dhe mishit, të cilat klasifikohen si mbetje të rrezikshme, për të cilat mungon edhe baza ligjore dhe subjekti grumbullues në treg, të mbledhen dhe të asgjësohen si mbetje të rrezikshme.
6. Sesi të zhvillohen teknologjitë e riciklimit, që nëse do të kishte një teknikë për të trajtuar mbetjet, ato do të ngelen të parat në hapjen e rrugës për përpunimin e tyre.
7. Sesi kompanitë e riciklimit të marrin të gjithë sasinë e gjeneruar si material të pastër prej supermarketeve, bizneseve dhe institucioneve shqiptare (mbi 100,000 biznese), që të arrihet sasia bazë e lëndës së parë për riciklim.
8. Sesi qytetarët të ndihen pjesë e shitjes dhe e kujdesit ndaj mbetjes, duke e trajtuar mbetjen si mall apo si aset që kursen dhe prodhon energji për në treg të lirë.
9. Sesi të kuptohet që mbetja është mall dhe qytetari të përfitojë nga kjo skemë, duke e tregtuar si të tillë në supermarkete apo njësi grumbullimi me qëllim shitje, dhe nga ana tjetër, vetë këto njësi të shërbejnë si burime lëndësh të para për kompanitë e riciklimit.
10. Sesi kompanitë e riciklimit të japin modelin e parë të shkëlqyer për lëshimet në ajër, për trajtimin e ujrave të ndotura apo të përdorura dhe për sistemimin e mbetjeve të mbetjes. Qeveria të investojë në teknologji matëse dhe laboratorike, si dhe në personel teknik, në mënyrë që të monitorohen me rreptësi të gjitha proceset industriale.
11. Sesi të kuptohet që midis katër metodave të përpunimit të mbetjeve (kompostim, riciklim, djegie e vendgroposje ekologjike), me patjetër duhet të ketë raport dhe ekuilibre të tyre, ku asnjëra nuk përjashton tjetrën, me parimin që secila kombinon me tjetrën. P.sh një teknologji inceneratori mund të marrë për lëndë të parë, jo më shumë se 30% të sasisë së mbetjeve të gjeneruara në shkallë vendi dhe pjesa tjetër t'iu përkasë kompanive përdoruese e ricikluese.
12. Sesi rastet e metodave, me inceneratorë, tashmë me vendimmarrje, të jenë të kufizuar në kapacitete, të kufizuar në numër, prodhim "state of art", i viteve pas 2015, me filtra të kontrolluara "online" dhe me vendgroposje speciale pranë.
13. Sesi të studiohen më parë sheshet e vendosjes së impianteve inceneratorë, në mënyrë që të mos kemi përplasje me publikun?
14. Sesi vendi ynë nuk mund të ketë më nevojë për incenerator tjetër derisa funksionimi i tyre të na tregojë e provojë për 10 vjet, sesa me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet kanë qenë këto vendimmarrje.
15. Sesi mbetjet, vajra të fastfood-eve, restoranteve dhe serviseve, të konsidrohesh dhe të zgjidhen përfundimisht, si një çështje e mprehtë për ndotjet që ato sjellin në ujra, në tokë dhe në ajër. Asnjë prej këtyre mbetjeve nuk tërhiqet nga subjektet e licensuara për këtë qëllim. Subjektet prodhuese të tyre janë në situatë të tillë që detyrohen t'i derdhin e hedhin kudo këto mbetje.
16. Sesi mbetjet e vajrave lubrifikante dhe hidraulike, apo mbetjet e filtrave të karburantit, vajit, kondicionereve dhe ajrit të motorrave, pjesa më e madhe e të cilave klasifikohen si të rrezikshme sipas katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve, të mbledhen nga kompani të licensuara dhe



trajtohen me anë të metodave ricikluese për të qenë lëndë primare në prodhimin e produkteve të tjerë.

17. Sesi mbetjet e gomave të automjeteve, mbetjet e ferrotave, mbetjet elektrike dhe ato nga paketat elektrike të automjeteve, pjesa më e madhe e të cilave klasifikohen si të rrezikshme sipas katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve, të mblidhen nga kompani të licensuara dhe trajtohen me anë të metodave ricikluese për të qenë lëndë bazë në prodhimin e produkteve të tjerë. Asnjë prej këtyre mbetjeve nuk tërhiqet nga subjektet e licensuara për këtë qëllim. Subjektet prodhuese të tyre janë në situatë të tillë që detyrohen t'i derdhin e hedhin kudo këto mbetje.
18. Sesi mbetjet e baterive jashtë përdorimit, të cilat klasifikohen si të rrezikshme sipas katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve, të mblidhen nga kompani të licensuara dhe trajtohen me anë të metodave ricikluese për të qenë lëndë bazë në prodhimin e produkteve të tjerë.
19. Sesi mbetjet jo bashkiake spitalore të mblidhen, të menaxhohen dhe të trajtohen në mënyrë të integruar si mbetje të rrezikshme, me anë të autokllavave nëpër vetë spitalet rajonale, me anë të një djegësi termik kombëtar enkas për to ose alternativës asgjësuese së CDF, (vendgroposje e tipit sarkofag e mbyllur hermetikisht), dhe jo të flaken në sistemet lumorë.
20. Sesi mbetjet dentare, farmaceutike të shkojnë drejt një menaxhimi dhe një trajtimi përfundimtar dhe jo drejt një drejtimi të paditur. Asnjë prej këtyre mbetjeve nuk tërhiqet nga subjektet e licensuara për këtë qëllim. Subjektet prodhuese të tyre janë në situatë të tillë që detyrohen t'i derdhin e hedhin kudo këto mbetje.
21. Sesi mbetjet historike (si psh dampat minerare Hasi) ku disa të tilla në territorin Shqiptar me studimet përkatëse rehabilituese mjedisore presin asgjësimin e tyre me anë të CDF in situ dhe disa të tjera prej këtyre dampave presin studime mjedisore rehabilitimi dhe më pas asgjësimin final me anë të CDF përkatëse.
22. Sesi të kryhen studime, duke analizuar kostot dhe përfitimet, prej nga të dalë se cila metodë është më e mirë, dhe më së fundi fiton ajo, më pas kompania.
23. Sesi të kthehet në Direktivë Ligji i Importit të Mbetjeve, ku mund të diskutohet në kuadrin e tregtisë së lirë për to pas një studimi strategjik të kujdesshëm për çdo rrymë mbetje, kur kjo lloj lënde është e trajtuar deri në kufij të mos gjetjes në vend ose drejt niveleve zero, kur ato përdoren direkt si lëndë e parë në kompanitë industriale, kur prodhimi i tyre në vend është i pamundur, kur prodhimi i tyre në vend jep shumë më tepër ndotje, kur kompanitë e riciklimit kanë sigurinë e trajtimit të ujrave të përdorura, sigurinë e matjeve në oxhak, me ekran të dukshëm dhe të vizitueshëm 'online';
24. Sesi të arrihet toleranca zero ndaj të gjitha fabrikave e punishteve për trajtimin e ujrave të përdorura, duke filluar nga baxhot deri te kombinatet, nga bujtinat me dy shtretër deri te komplekset turistike, ku secili duhet dhe mund të ketë "deporatorin" e vet për pastrimin e ujit.
25. Sesi vendi ynë nuk ka më nevojë për profilaktikë, por për ndërhyrje kirurgjikale. Mjaft më, me projekte sensibilizimi, ndërgjegjësimi të shoqatave (jo) fitimprurëse.
26. Sesi të shpallet situatë emergjente vendosja e filtrave dhe kontrollet "online" nga punishtet e përpunimit deri te fabrikat e cimentos, të përpunimit mineral deri te inceneratorët.



27. Sesi të gjitha aparaturat matëse të treguesëve mjedisorë "portabël" të përdoren për misionin që kanë, siç mund të jenë aksidentet, dhe jo të paraqesin situatë të shtrembëruar mjedisore të kompanive.
28. Sesi nuk mund të vazhdojë vendi ynë pa miratuar, ende, plane kombëtare e lokale të veprimit për cilësinë e ajrit, madje, as Strategji Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të vënë në zbatim.
29. Sesi të mos vazhdojmë të kemi sisteme të monitorimit ende të pa akredituara, duke lënë kështu përgjegjësinë pa përgjegjës, ku numri i stacioneve vazhdon të jetë i vogël, dhe stacionet e tjera janë të levizshme që monitorojnë në periudha dy javore në 4 sezonet e vitit.
30. Sesi të mos vazhdojmë me kushtet, ku ndëshkimi ndaj ndotësve të ajrit është i papërfillshëm dhe sistemi i monitorimit nuk është gjithë përfshirës dhe as prezantues për të gjetur mesataren e qytetit.
31. Sesi të kemi ngritjen e një **Enti Rregullator të Menaxhimit të Mbetjeve** për përcaktimin e një tarife, në zbatim të parimit ndotësi paguan për hedhje, për sasi e për tipologji mbetje, PAYT. Në Komitet duhet të jenë të përfaqësuar qeveria, pushtetet lokale, shoqatat e sipërmarrjeve të sektorit, Dhomat e Tregëtise, shoqëria civile, ekspertët mjedisorë, bota akademike, etj. Ai duhet të financohet pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga grupet e interesit dhe pushtetet lokale dhe në përbërje të bordit, sipas pjesëmarrjes në buxhet, përvec "aksionereve", të garantohet përfaqësimi edhe i shoqërisë civile dhe eksperteve mjedisorë. Bordi emëron administratorin. Njëkohesisht, ky Ent i Menaxhimit të Mbetjeve administrohet nga Autoriteti Kombëtar. Enti duhet të ketë si objektiv vetfinancimin progresiv, nëpërmjet të ardhurave nga procesi i menaxhimit të mbetjeve dhe nga taksa e amballazhit.
32. Sesi për stabilizimin e situatës, për një periudhë afatmesëm deri në vitin 2025, kur mendohet pranimi në BE, të kemi ngritjen e një **Agjencie Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve**, sipas nje koncepti modern dhe apolitik (me një bord drejtues të gjerë dhe të hapur kundrejt përfaqesuesve të grupeve të interesit, botës akademike, ekspertëve, etj.), që do të shërbejë si një Ent Rregullator dhe administrues i te gjithë procesit.
33. Sesi për çdo mbetje ose produkt jashtë përdorimit, duhet të aplikohet taksa e riciklimit/ asgjësimit/menaxhimit që në produktin bazë të ri të importuar apo prodhuar.
34. Sesi të nxiten nëpërmjet politikave të rimbursimit ose financimit shtetëror hapja e subjekteve të reja grumbulluese, ricikluese ose asgjësuese për të gjitha këto kategori mbetjesh.
35. Sesi të ndërtohet Kodi mjedisor, ku të ripërcaktohet në kushtet aktuale pozicioni i së drejtës së mjedisit midis asaj penale, civile dhe administrative, me pikësynim që të ashpësohet dhe të zgjerohet Kodi Penal me çështje mjedisi.

4.33 ENERGJIA

Burimi kryesor i energjisë elektike është ai i hidrocentraleve. Burimet ujore me potencial hidroenergjitike të zonës krijon mundësinë e ndërtimit të HEC-ve të rinj.






Fig. – 49 Potenciali hidroenergjitik i zonës

Por para ndërtimin të këtyre veprave hidroenergjitike duhen pasur parasysh disa aspekte mjedisore dhe ligjore

Hec-et që marrin ujëra të pishëm, por më tepër kurativë

Sipas Shtojcës IV, të Direktivës 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe KE, dt. 23.10.2000, (Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave), thuhet se rregjistri i zonave të mbrojtura sipas Nenit 6 të këtij ligji përfshin zona të përcaktuara për grumbullimin e ujit që synohet për konsumim njerëzor. Sipas nenit 7, në shumë raste, uji që buron nga shpellat, i cili është jo thjesht për përdorim njerëzor, por për shërim njerëzor, sepse kur dalin prej shpellave pajisen me ozon O₃ që ka propocionin më të mirë në botë për m³ ajër, ndaj dhe janë më tepër se kurativë për mbarë njerëzimin, dhe pikërisht këto ujëra nuk shpëtojnë dot së nënshtruar veprës së marrjes për energji për Hec-et përkatës.

Sipas Direktivës 76/160/EEC përcaktohen zona ushqyese sensitive, duke përfshirë edhe zona të përcaktuara si shumë të prekshme apo të ndjeshme sipas direktivës 91/676/EEC. Këtu futen edhe zona të përcaktuara për mbrojtjen e specieve ujore ekonomiksht të rëndësishme, ekonomi familjare me akuakulturë të ngritura më parë; ente të ujit të percaktuar si ujëra rekreative, duke përfshirë dhe rajonet të përcaktuara si ujëra për larje dhe zona të përcaktuara për mbrojtjen e mjedisëve ose specieve, ku mirëmbajtja ose përmirësimi i statusit (gjendjes) së ujit është një faktor i rëndësishëm në mbrojtjen e tyre, të përcaktuara sipas Direktivës 92/43/EEC. Kujtojmë se në vendet europiane, vepra për marrje apo devijim të ujërave të lumenjve bëhet deri në ato lartësi ku shkon e shumëhet peshku përkatës i lumit dhe në asnjë rast në gjatësinë e lumit që lëviz për shumim peshku përkatës.

Neni 52, i ligjit 111/2012 që flet për dhënien e një leje, autorizimi, koncesioni, ku organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore përkatëse të ujit do të mbështeten në përparësitë e mëposhtme:

- a. Furnizimin me ujë të popullsisë, përfshirë edhe kërkesat e industrive që ndodhen brenda vijës kufizuese të qendrave të banuara dhe që kanë një nivel të ulët konsumi.

- b. Përdorimet për ujitje, bujqësi e akuakulturë.
- c. Transport ujqor. Argëtim e turizëm, përfshirë lundrimin për zbavitje. Me sasi të ujore që lihen në lumenjt tanë, nuk mund të shërbehet për qëllimet e tjera të mësipërme të përcaktuara me ligj, si e drejtë për të jetuar ekologjikisht një shtetas sipas nenit 59 të kushtetutës së vendit.





Fig. - 59 Përçqasja e përgjithshme e marrëdhënieve që krijon lumi me ujrat nëntokësorë, dhe me lagështinë lokale.

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 59, pika d, thekson se Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, “synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”. Duke qenë se nuk lihet sasia e duhur për ekuilibrin ekologjik, bujqësor dhe njerëzor, me patjetër që prishet ekuilibri jetik në rastin e aktivitetit të veprës ujore.

Neni 6, i ligjit 111/2012 ‘Të menaxhimit të ujërave’ dikton se ‘Parimet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe respektimi i integritetit të baseneve ujore, duhet të jetë i bazuar në kërkesat sociale dhe ekonomike për burime ujore, duke mbrojtur dhe ruajtur cilësinë e këtyre burimeve dhe cilësinë e mjedisit për brezat e ardhshëm. Praktikisht, marrja me mbi 90% të sasisë së ujërave të lumenjve duke lënë 40 herë më pak, bën që të kemi po 40 herë ulje të sasisë së ujit në burimet nëntokësorë, si në ato të shpellave, në ato termalë, si dhe në pusët që furnizohen banorët poshtë rrjedhjes së lumit, aq më tepër që në të gjitha rastet kemi formacione shkëmbore karbonatike dhe dolomitikë të cilët janë shkëmbinj të përshkueshëm ndaj ujërave nëntokësorë.

Fig. - 51 Përçqasja e përgjithshme e marrëdhënieve që krijon lumi me ujrat nëntokësorë gjeotermalë.



Referuar, Neni 203, të kodit të procedurës penale Ndotja e ujërave, të Kodit Penal vërejmë se veprat ujore shkaktojnë pasoja të rënda direkte për jetën e shëndetit, mesatarisht të 1650 banorëve për çdo Hec, për shkak se “lehtës vërtetohet prishja e ekuilibrit ekologjik, në rastin e lënies së ujit prej 50 – 200 litra/sek në rrjedhën natyrore të Lumenjve apo marrjes së mbi 2,000 -10,000 litra/sek prej tyre”, ku prurja ekologjike prej 33,3% duhej të lihej e papërkur, prurja bujqësore prej 33,3% e papërkur gjithashtu, dhe pjesa tjetër quhet dhe merret për qëllime energjitike, me kushtin që prurja energjitike mund të ndihmohesh me prurjen bujqësore në varësi të kushteve klimaterike. Ose të paktën duhej të lihet e papërkur prurja minimale ekologjike që natyra ka përcaktuar



me ligjet e saj (Qershor – Shtator) dhe përgjat shfrytëzimit 8 mujor duhet të lihet e paprekur mesatarja e prurjes ekologjike të këtyre katër muajve.

Referuar, po Nenit 203, të kodit të procedurës penale (ndotja e ujërave), gjatë gjithë periudhës së ndërtimit të Hec-eve në lumenj e zonës, ata përjetojnë ndotjen dhe pothuajse shkatërrimin total të tyre, ku të gjitha kompanitë, dhërat e gërmuara për hapjen e kanaleve apo të tuneleve i hedhin pikërisht në sistemet lumorë, duke mbytur apo asfikësuar jetën e gjallë.

Informimi i publikut

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 56 thekson se: “Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”, në një kohë që Kompanitë organizojnë takime me komunitetin, që shpesh prishen, dhe firmat merren më pas, me njerëz të mashtruar sepse banorët me intuitën e tyre mijravjeçare në marrëdhënie me ujin nuk bien dakord me qëllimin e paraqitur për ndërtimin e Hec-eve.


Neni 4 i Konventës së AARHUS-it, që thotë se “*çdo palë do të parashikojë pjesëmarrjen e hershme të publikut, ku të gjitha alternativat janë të hapura dhe publiku mund të marrë pjesë në mënyrë efektive*”. Për rrjedhojë, edhe procedurat e mëpasme janë të pavlefshme. Kjo thuhet edhe nga neni 46 i Direktivës 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e KE, e dt. 23.10.2000, (Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave), që të sigurohet informacioni i përshtatshëm i masave të planifikuara dhe të raportohet për progresin e bërë për zbatimin e tyre, me synim përfshirjen e një publiku të gjerë, para se të merren vendimet përfundimtare për masat e nevojshme.

Konventat ndërkombtare për përdorimet ujore

Neni 19, i ligjit 111/2012 për menaxhimin e burimeve ujore thotë se ‘Për mbrojtjen e gjendjes natyrore të ujërave veprojnë të gjitha aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë, si dhe marrëveshjet, konventat, protokollet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë’. E drejta Ndërkombëtare, gjithashtu, trajton nëpërmjet garancive të nenit 7 të KEDNJ që mishëron një parim të përgjithshëm, sipas të cilit, çdo vepër penale duhet të parashikohet me ligj, dhe individit duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë përmbajtjen e normës penale, dhe nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të saj, se ‘çfarë veprimesh apo mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht’. Kjo e drejtë na mëson se kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, ‘nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute’.

Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe për këtë arsye, një standart i një parashikueshmërie të arsyeshme është i majftueshëm. (GJEDNJ KËRKESA NR. 45771/99, Veber kundër Estonisë, 21 Janar 2003).

Konventat Ndërkombëtare mbi Ujrat si: Vendimi i 10 shtatorit 1929, i Gjykatës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare për çështjen ‘Jurisdiction of the River Order’; Akti final i Kongresit të Vjenës, më 1815; Konventa ESPOO 1991, në të cilën është palë Shqipëria (4 tetor 1991); Konventa e Helsinkit,



1992, në të cilin është palë Shqipëria (06.09.1996); Konventa e Nju Jorkut, 1997, ku Shqipëria, ende, nuk është palë dhe Direktiva 2000/60EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit Europian, e datës 23 Tetor 2000, me titullin "Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave", etj., riafirmojnë dhe saksionojnë parimin e rëndësishëm se për ujjrat e komuniteteve, nuk duhet të ndërmerren punime/veprime që çënojnë sasinë dhe cilësinë e ujrave pa u marrë vesh me palët

Llogaritjet e krahasuara (Benefit-Cost) midis alternativës HEC dhe alternativës me prioritet turistike e agrobiznesi

Një llogaritje e tillë do të na siguronte mundësinë e përfitimit dhe të humbjeve, si në njërin rast dhe në tjetrin, si dhe masat kompesuese për secilin rast. Vlera aktuale neto dhe skontimi –krahason fluksin në kohë të kostove dhe përfitimeve në periudha të ndryshme. Norma e skontimit përdoret për shndërrimin e kostove dhe përfitimeve të ardhshme në një vlerë të vetme, e cila quhet "vlera aktuale neto" duke mundësuar krahasimin e tyre. Vlera aktuale e kostos dhe përfitimit shprehet si më poshtë në formulat 1, 2 & 3:

$$NPV_{\text{Total kost}} = \sum_{t=0}^T a_t K_t = \frac{K_1}{(1+r)^0} + \frac{K_2}{(1+r)^1} + \dots + \frac{K_t}{(1+r)^t} \quad 1)$$

$$NPV_{\text{Total Perfitim}} = \sum_{t=0}^T a_t P_t = \frac{P_1}{(1+r)^0} + \frac{P_2}{(1+r)^1} + \dots + \frac{P_t}{(1+r)^t} \quad 2)$$

$$a_t = \frac{1}{(1+r)^t} \quad 3)$$


ku: NPV kost = vlera e kostos aktuale neto (e tanishme, K_t = kosto në vitin t e shprehur në Euro
 r = norma reale e skontimit referuar Bankës së Shqipërisë, t = periudha e vlerësimit në vite

P_t = përfitimet në vitin t shprehur në Eur, $a_t = 1 / (1+r)^t$, koeficienti i zbritjes

Zgjedhja e normës së skontimit e cila është modeluar dhe diktohet nga dëmet e gazrave serë dhe janë vlerësuar, që të jetë, 3%.

Fillimisht, dëmi që silltet nga ndërtimi i veprave me marrje ujore, si me derivim apo tunel apo diga për ndërtimin e një apo pak Hec-eve në dukje të vegjël, është i vogël, pakëz i përfillshëm, por kur gjithë gjatësia e pjesës së sipërme të lumenjve prej 10-20km merret e tëra (sa nga një Hec te tjetri) dhe kur gjithë sasia ujore prej 97% merret në tub apo në kanal apo tunel derivues, at'herë dëmi kthehet në i pamatshëm dhe kapërcen kufijtë e jetesës së banorit. Të gjithë hec-et sot, veç e veç, e së toku kërcënojnë, jo thjesht, lumin me mjedisin përkatës, por kërcënojnë sigurinë kombëtare, jetesën e banorëve që kanë lidhur fatin e jetës së tyre me fatin e lumit qysh 10,000 vjet.

Ndërtimet dhe gërmimet për veprat Hec, duke qenë pranë veprave për ujë të pishëm kanë bërë që të nxjerrin jashtë funksionit, me dhjetra raste, prishjen e investime të infrastrukturës për ujë të pishëm.



Duke ditur që 40% e sasive ujore lumore shkon për lagështinë e ajrit dhe 30% e tyre shkon për furnizim apo mirëmbajtje të ujrave nëntokësorë, marrja me anë të tubove prej 97% të sasisë ujore, dhe marrja e të gjithë gjatësisë ujore për më tepër se 8 muaj në vit, bëhet e mundur që të mungojë si avullimi, si transpirimi për lagështinë lokale të ajrit dhe furnizimi me ujë të freskët të ujrave nëntokësorë që nevojiten për lagështinë nëtokësore për produktet bujqësore, për puset e banorëve, për vetë furnizimin më pas të vet ujrave lumorë.

Ç'ndodh në zinxhirin e jetës?!

Fig. - 52 Ekuilibrat e vendosur në mijëra vjet në sistemet tokë-lumë –pyll –bujqësi –kullotë – ujraneëntokësor – reshje bore – reshje shiu, prishen në disa vjet.



Një numër i madh bimësh si misri, jonxha, gruri fasulja, patatja, perimet, kur temperatura shkon mbi

35° celsius, për shkak të mungesës së lagështisë nga poshtë (nëntoka), por më tepër nga ajri, ato ndërpresin procesin e fotosintezës, që d.t.th 'vdekje' e ngadaltë dhe mos zhvillim i tyre.

Mungesa e lagështisë në ajër, bën që reja që vjen e mbarsur me lagështi nga një lumë më i madh, apo reja që vjen nga deti, nuk gjen një ngarkesë tjetër të lagështi lokale dhe nuk formon dot kështu sasinë përkatëse ujore për të formuar reshjet e shiut për zonat e ulta ose ato dëbore për zonat e larta, që d.t.th ujë më pak për vetë Hec-et që e pësojnë të parët, dhe pastaj për klimën lokale, që me siguri brenda ciklit 11 vjeçar të pertubancave diellore sjell ndryshime të ekosistemit.


Fig. - 53 Cikli hidrologjik i sotëm pa hec, nesër me hece i munguar.

Ndryshimi i ekosistemit bën që të mos kemi formimin e biomasës te pyjet e larta dhe ato të ulta, që për pasojë nuk do të kemi dot thithjen e gazeve serrë si CO₂, CH₄, etj., ku një ton gaz karbonik kushton në bursë 48USD/ton, ndërsa në vendin tonë blihet apo shitet me 2USD/ton, por më shumë se vlera është pasoja në ekosistem që e bën më të rrezikshëm stilin e të jetuarit të banorit në këto zona dhe më gjerë.



Formula për llogaritjen e emetimeve të CO₂ CO₂ = CH₄ e prodhuar x (1-FCH₄/F CH₄ + OX) x 44/16
 = 3833t x (1-0.5/ 0.5 + 0.1) x 44/16 = 12883t, Ku F CH₄ = % e CH₄ në volumin e biogazit; OX = faktori i oksidimit; 44 = pesha molekulare e CO₂ kg/kg-mol;
 16 = pesha molekulare e CH₄ kg/kg-mol

Fig. 54- Mbas prishjes së ciklit hidrologjik vijoj prishja e zinxhirit ushqimor (të jetës).





Sot, lumenjt shqiptarë, por më shumë tributarët e tyre ndodhen në pozicionin më të disfavorshëm të shtratit të tyre, ku miliona m³ dhëra janë hedhur brenda dhe pranë tyre, duke bërë që tabani i shtrëtërve të tyre të ngrihen nga 3-4m pjesën e sipërme të tributarit deri në 2-3m në pikën e bashkimit me lumenjt mëmë, çka sjell shkaqe për përmytje të shpeshta e të shpejta, erozion të pashoq ndaj tokave të bukës, (nga 14 ton/ha/vit arrijn në 180ton/ha/vit – studimi S.Guri, Sh.Lushaj, 2013), prishjen dhe varrosjen e pritave malore, por mbi të gjitha zhavorrimin e tokave të bukës, largimin e shtresës humus apo cipës minerare të tokave të bukës dhe shkatërrimin e cilësisë së jetës së banorëve në pjesën e poshtme të rrjedhjes lumore.

Rezultatë Forumi Shkencor, Tetor 2018

Forumit shkencor me pedagoge, akademik, student, inxhinierë, shoqata mjedisore, perfaqesi nga komunitete te ndjeshem per ate qe po iu ndodh, hidrolog, hidrogeolog, ekspert mjedisore, qytetarë, etj. të mbledhur më dt. 08.10.2018, ora 11:00 te salla e Rektoratit të UPT, dolën me një Rezolute, ku i kërkuan dhe i ofruan Qeverise shqiptare gjetjen e mekanizmave për frenimin e numërit të madh të Hec-eve mbi lumenj, përrrej e rrëke në vendin tonë, duke bërë të mundur:

1. *Vendosjen e raporteve të reja në marrjen e sasisë se ujit* me anë të ndërhyrjeve me 'amendamente shtesë' në ligjin e përdorimit të burimeve ujore, duke ndryshuar 'debitin Q - si sasi minimale të 355 diteve në Q të 300 diteve, aq sa në lumë të ngelë sasia minimale e rreth 33% sasi ujore per ekosistem dhe 33% sasi ujore për bujqësinë.
2. *Ndalimin e marrjes dhe përdorimit për Hec-e të te gjitha burimeve të ujit të pishëm* deri në 200m largësi në përputhje me Ligjin e Zonave të Mbrojtura.
3. *Vendosjen e raporteve te nr. te Hec-eve për gjatesi lumore*, duke lënë të paprekur, jo më pak se 1/3 e gjatësisë së lumit si hapësirë e domosdoshme dhe minimale për ruajtjen e ekulilibreve ekologjikë, si dhe gjatësine e llogaritur dhe e dëshiruar për ruajtjen e ekulilibreve bujqësorë .
4. *Ndalimin e atyre Hec-eve ne zona te mbrojtura, me shkalle te pare* e te dyte te mbrojtjes, punimet e te cileve kane filluar pas daljes se Ligjit te Ri per Zonat e Mbrojtura.
5. *Mosmarrjen dhe devijimin e përjetshëm të ujrave* nga një lumë në një lumë tjetër.
6. *Pjesëmarrjen e publikut* në vendimmarrje me më shume se 50% të njerezve nga Komuniteti qe preken nga këto aktivitete.
7. *Shpalljen e një 'Moratoriumi' për një periudhë pesë vjecare* deri në ristudimin dhe përcaktimin e qartë te vlerave dhe/ose dënimeve që rrjedhin nga aktiviteti i Hec-eve, si në fazën e ndërtimit



dhe atë operacionale gjatë funksionimit, duke sjellë në vëmendje të Qeverisë llogaritjet e krahasuara (Benefit Cost) midis alternativës me HEC-e dhe alternativës me prioritetet turistike, ekonomike e bujqësore, që burojnë nga potencialet e stisura të natyrës.

Mbi të gjitha, u kërkërkua që të anulohet Neni 39 “Përdorimi i burimeve ujore” i LIGJ-it Nr.111/2012, datë 15.12.2012 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE”, pika 4, ku tekstualisht shprehet se:

“Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ujo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355).

Është ky nen që i jep mundësinë koncesionarëve të shrytëzimit të ujrave në Shqipëri që lumenjve shqiptarë t’iu merret 97,5% ujë si prurje energjitike dhe t’iu lihet 2,5% ujë si prurje ekologjike. Kjo përbën rast të pashembullt për përdorimet ujore të lumenjve, në një kohë që me patjetër dhe domosdoshmërisht në sistemet lumore duhet të zhatohen praktika pothuajse propocionale midis prurjeve ekologjike, bujqësore dhe energjitike si:

Prurjeve ekologjike - 33.3% Prurje bujqësore - 33.3% Prurje energjitike - 33.3%

Energjia alternative


Energjia Diellore mund të shfrytëzohet kryesisht për prodhimin e ujit të ngrohtë dhe fare pak për prodhim energjie elektrike. Ajo pothuajse nuk shfrytëzohet.

Energjia e Erës përfitohet përmes turbinave të erës. Në instalimin e një sistemi kërkon kushte të caktuara të shpejtësisë së erës dhe sipërfaqe të konsiderueshme toke.

Energjia e biomasës përfitohet si energji e pastër nga përpunimi i nënprodukteve të drurit ose të agrikulturës, nëpërmjet teknologjive të ndryshme. Biomasa, si lëndë energjetike përdoret në formën e saj tradicionale për ngrohje dhe gatim, nëpërmjet druve të zjarrit apo mbetjeve të tjera të agrikulturës. Sipas vlerësimeve paraprake të përafërta, energjia e biomasës në vendin tonë është rreth 7 Mtoe, kurse energjia e biomasës e siguruar nga mbetjet bujqësore është llogaritur në rreth 130 toe/vit, ku rajoni i Hasis zë vend kryesor në këtë prodhim.

Energjia gjeotermale. Sipas studimeve në Shqipëri ekzistojnë disa zona në të cilat ka mundësi shfrytëzimi i energjive gjeotermale. Në qendrën e Ultësirës Perëndimore, dendësia e fluksit të nxehtësisë është 41.3 mW/m², në Masivin Malor të Hasis, llogaritet që dendësia e fluksit të nxehtësisë të luhatet nga 40 mW/m² deri në 61. 8 mW/m².

Një filozofi tjetër që shoqëron Planin e Përgjithshëm Urban është që të gjitha ndërtimet, si në zonën urbane (qytet), apo në zonen suburbane (fshat) të gjitha ndërtimet duhet të kenë për mbulesë atë të tipit çati, pse jo pjesë të kesaj çatie të përshtatura me pajisje si panele diellore për përfitim energjie, ndërtesa me çfarëdolloj kati. Mbulimi me çati na siguron jo vetem termoizolim apo kursim energjie por edhe



moskthim të energjisë diellore për shkak të së cilës kemi një rritje të temperaturave lokale, përpos një vizioni absurd joestetik.

Sigurimi i ndërtesave me Energji 0

Një koncept tjetër i Planit të Përgjithshëm Urban që duhet të shoqërojë funksionimin e një bashkie është arritja apo sigurimi i ndërtesave me Energji 0, të paktën e atyre që ndërtohen rishtaz, kjo dmth që të gjitha ndërtesat e planifikuara për ndërtim, do të nënshtrohen një procesi analitik të shfrytëzimit të energjive alternative. Ku rrjeti do të punojë me dy kahje, edhe të marrë nga rrjeti kombëtar por edhe një zgjidhje lokale dhe specifike (mulli ere, panele diellore, biomas) t'i japi rrjetit kombëtar. Këto quhen ndërtesa të tipit me energji 0 dhe në rastin kur jep më shumë seç merr quhen ndërtesa me energji pozitive në përputhje të plotë me legjislacionin European.

Probleme në Menaxhimin e Energjisë

Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë është i bazuar në prodhimin e saj nga burimet hidrike (më shumë se 98%), prandaj dhe besueshmëria e sistemit tonë elektroenergjetik është shumë e varur nga kushtet hidrike. Fuqia e instaluar e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar është rreth 1531MW dhe prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e vendit, duke qenë se është nga burimet hidrike, ka natyrë propabilitare, që lëviz nga rreth 3 miliard kWh/vit deri në 7,7 miliard kWh/vit, në varësi të kushteve hidrike (rreth 7,7 miliarde kWh në vitin 2010). Prodhimi mesatar vjetor është rreth 4.2 miliard kWh. Duke patur në konsideratë, që kërkesa për energji elektrike në vendin tonë aktualisht është 7.342 TWh/vit, dhe prodhimi vendas rreth 4.2 TWh/vit, pra është i pamjaftueshëm, bën të detyrueshëm që aktualisht, mbulimi i nevojave duhet të përballohet nëpërmjet importit të energjisë elektrike. Nga ana tjetër, duhet të vëmë në dukje, që kapacitetet importuese të vendit tonë janë të limituara. Kjo vjen si pasojë e kapaciteteve të limituara, që kanë linjat tona të interkonjeksionit me vendet fqinjë, por edhe të linjave të interkonjeksionit të vendeve të rajonit, pasi vendi ynë është pikë fundore në rrjetin rajonal të energjisë elektrike.

4.34 PRESIONET NATYRORE

4.34.1 FENOMENET E RREZIKUT GJEOLOGJIK, PËRHAPJA DHE PËRSHKRIMI I TYRE.

Në territorin e Bashkise Krumë gjejnë përhapje shumë elementë të rrezikut gjeologjik të cilat krijojnë shqetësime dhe dëmtime të veprave inxhinierike qëkryhen në këtë territor. Më poshtë po përshkruajmë këto rreziqe, duke dhenë edhe fushëpërhapjen e tyre.

Rrëshqitjet janë një fenomen i përhapur në zone e Bashkise Krumë. Në hartën e përhapjes së rreziqeve gjeologjike, janë hedhur rreth 300 rrëshqitje të njohura, por kjo nuk do të thotë se në këtë territor nuk ekzistojnë rrëshqitje të tjera. Gjithashtu duhet theksuar se territore të ngjashme me ato ku kemi konturuar rrëshqitjet e njohura, janë po aq të rrezikshme sa ato në të cilat ende nuk ka ndodhur rrëshqitje, por me krijimin e kushteve edhe ato shpate rrezikohen nga i njëjti fenomen. Nga një analizë e kryer për të gjitha

rrëshqitjet e ndodhura deri tani në Bulqize, rezulton se shumica e rrëshqitjeve bien në formacionet argjilore, por dhe në shpatet me gjerësi 10° - 20° , në shpatet e ekspozuar, gjithashtu shumica e rrëshqitjeve bien në zonat urbanë dhe tokë arë, në distanca të afërta nga shtrati lumit, ose përroit. Rrëshqitjet kanë prekur si shkëmbinj të bazamentit ashtu edhe mbulesën e dherave të Kuaternarit. Faktorët kryesorë të ndodhjes së tyre janë pasive (Ndërtimi gjeologjik, litologjia, struktura, tektonika, etj) dhe aktive (erozioni, përmbajtja e lartë e ujrave nëntokësore, reshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet e njeriut me ndërtime të ndryshme, etj.)




Fig-55 Rrëshqitja Qafa e Liqenit në fshatin Muzhakë. Koms (burimi: studimit "Gjeoresurset dhe Gjeorrezizet në Qarqet e Shqipërisë" për rajonin e Dibres)

Rrëzimet Ndodhin në zonën malore atje ku pjerrësia e shpatit i kalon 40° , dhe ku kemi vendosje të shkëmbinjve më të fortë mbi ata më të butë në profilin e shpatit. Situata të tilla janë të shumta në territorin e qarkut. Ky fenomen ndihmohet edhe nga zhvillimi i madh i tektonikave bllokore dhendrydhëse, të cilat e kanë coptuar së tepërmi bazamentin shkëmbor.



Foto. - 3 Rrëzime gurësh në aksin rrugor Koms-Qafë Shtamë

Shembjet (Ose të ashtuquajturat subsidenca). Përputhen me zonat minerare të braktisura. Klasifikohen si fenomene rreziku me kërcënuese se të gjithë elementet e tjerë të rrezikut gjeologjik. Kanë ndodhur dhe rrezikojnë të ndodhin në fushat minerare dhe punimet e braktisura etj. Shfrytëzimi i shtresave në thellësi, ka krijuar hapësira boshe nëntoke, të cilat rrezikojnë shembjen e materialit të sipërndodhur dhe për pasojë deformimin e sipërfaqes së tokës nga ai real. Këto janë zona tepër të rrezikshme për objektet inxhinierike, sepse shembja ndodh në mënyrë të menjëhershme dhe vertikalisht. Për pasojë ndodhin



çedime nga disa mm, deri në disa metra të cilat mund të rezultojnë katastrofike si për veprat inxhinierike, ashtu edhe për banore. Fenomene të tilla janë evidentuar në Bulqizë ku dallohet qartë dëmtimi i disa objekteve. Në këto zona nukduhen lejuar ndërtimet mbi to. Edhe në rastet kur ndërtimet janë kryer, duhet të merren masa për largim të banoreve prej tyre dhe prishjen e këtyre objekteve inxhinierike.

Vatrat e erozionit. Është fenomeni më i përhapur në Krume. Zona të tëra, kryesisht në fushëpërhapjen e formacioneve argjilore e flishore, janë të prekura nga ky fenomen, i cili nga ana e tij është ndihmuar në një masë shumë të madhe nga shpyllëzimet e shumta që u bënë gjatë viteve '80-'90 të shekullit të kaluar. Erozioni sipërfaqësor, prek zona të mëdha të shpateve të lumenjve e përranjve.

Erozioni sipërfaqësor është karakteristike për gjithë vendet mesdhetare. Ai varet nga veçoritë e relievit, ndërtimi gjeologjik, klima dhe mbulesa vegjetale. Rol kryesor luan relievi malor dhe kodrinor, copëtimi horizontal dhe vertikal, etj. Në përgjithësi nga ana gjeomorfologjike më shumë i janë nënshtruar lartësitë deri 800 m dhe më rrallë 1000 m, ku shkëmbinj të janë më të butë, copëtimi horizontal është i madh dhe mbulesa vegjetale është më e vogël. Nga ana gjeologjike, gërryerje më të fuqishme kanë pësuar formacionet terigjene që kanë pësuar ngritje të shpejtë (flishet, mollasat e Plio-kuaternarit dhe rreshpet argjilore) që përbëjnë rreth 58 % të territorit të Shqipërisë dhe më pak të gërryeshëm janë shkëmbinj të magmatik dhe gëlqerorët. Nga ana klimatike, zona më përhapje më të madhe të erozionit sipërfaqësor janë ato zona që dallohen për intensitet dhe sasi reshjesh, sidomos ato më 100 - 200 mm dhe më shumë për 24 orë, zonat më zgjatje shirash disa ditore (5 - 6 dite) ose zonat më shkrirje të ngadalshme të dëborës.

Erozioni sipërfaqësor, në varësi të faktorëve të lartpërmendur është në stadi të ndryshme zhvillimi, duke filluar nga rrekëzat në rrëketë, përroskat deri në përranjë me thellësi dhe gjerësi disa dhjetëra metra. Erozioni sipërfaqësor intensiv ka provokuar edhe rrëshqitje të përmasave dhe llojeve të ndryshme. Si rezultat i rrebesheve ose shkrirjes së menjëhershme të dëborës krijohen selet të cilat favorizohen nga pjerrësia e përranjëve dhe materialet eluvialo-deluvial.

Erozioni fundor zhvillohet më së shumti në fushëpërhapjen flisheve të zonës "Krasta - Cukali" dhe "Njesia Dibra". Për këtë shkak në rast reshjesh të bollshme copërat e shkëmbinjve të fortë lëvizin nëpër shpate, dhe sidomos në shtretërit e përranjve e përroskave që kalojnë në shkëmbinj argjilo - alevrolitore, duke i copëtuar atë drejtim të thellësisë.

Shtretërit e lumenjve. Janë trajtuar si fenomene rreziku gjeologjik për vetë natyrën e tyre të paqëndrueshme. Kjo natyrë rrjedh nga dy aspekte:

1. Përbërja litologjike, e cila në shumicën e rasteve është e tipit dhera pa kohezion;
2. Prezenca e lartë e ujrave rrjedhës sipërfaqësore, të cilët kanë energji e cila varet nga stadi i zhvillimit të lumit dhe nga sasia e reshjeve që bie në territor. Këto zona (shtretërit e lumenjve) përbëjnë rrezik për veprat inxhinierike të ndërtuara mbi to, por në rastet e veprave rrugore ato kalojnë me ura, të cilat ndodhen nën kërcënim të vazhdueshëm të këtij elementi rreziku.

Kone depozitimi. Janë trajtuar si fenomene rreziku dhe janë konturuar në territorin e qarkut dy tipe konesh depozitimi: deluviale dhe proluviale. E përbashkëta e tyre është grumbullimi në territore jo shumë të gjera i copërave me rrumbullakim të keq, të cilat shpesh ndodhen në kufijtë e ekuilibrit natyror, i cili mund të prishet nga çasti në çast. Konet e depozitimit me origjinë deluviale lokalizohen në fundet e shpateve të ndërtuara nga shkëmbinj të fortë dhe mund të kenë pamje të brekçieve të shpatit apo të koluvioneve. Konet e depozitimit me origjinë proluviale janë bazamente shumë të mira për ndërtimet (përbërja e tyre litologjike gëlqerorë apo shkëmbinj të tjerë me fortësi të madhe), por që janë pre e rrezikut të madh të shkatërrimit të tyre si rezultat i prurjeve të menjëhershme dhe të bollshme në kohë rrebeshesh.

Zonat karstike. Këto zona rreziku gjeologjik shfaqen në fushëpërhapjen e shkëmbinjve gëlqerorë. Tipik është masivi gëlqeror i Malit me Gropa, në të cilin shfaqen në mënyrë të theksuar pasojat e një procesi karstik që ka prekur masivin si në sipërfaqe ashtu edhe në thellësi. Në sipërfaqe shfaqet një reliev tipik karstik me gropa, hinka, puse dhe fusha karstike, të cilat shpesh kamuflohen nga mbushje deluvionesh me përbërje dherash të shkrifet.


Linjat tektonike aktive. Krijojnë zona të paqëndrueshme në hapësira të gjera, paqëndrueshmëri e cila vjenshi rezultat i jonjëtrajshmërisë së lëvizjes së blloqeve të ndryshëm të tokës dhe për pasojë ndodhin çedimetë diferencuara të trojeve. Edhe pse këto lëvizje janë shumë të ngadalta, ato mund të bëhen tepër kërcënuesenë rastet e ndodhjes së tërmeteve. Në territorin e Dibres gjejnë përhapje tektonikat e tipit shkallore deri bllokore.

Tërmetet - Janë rreziqe permanente ndaj veprave inxhinierike, për faktin se janë goditje dhe lëvizje të menjëhershme dhe me energji të lartë të tokës mbi themelet e objekteve inxhinierike. Zona në studim bën pjesë në zonën neotektonike kontinentale të vendit tonë, në treven e brendshme me regjim në tërheqje. Kjo zonë karakterizohet nga lëvizje diferenciale të fuqishme gjatë etapës neotektonike me regjim në tërheqje horizontale. Duke patur parasysh lidhjen ose jo të elementeve të rrezikut gjeologjik me kriterin morfologjik, elementet e rrezikut gjeologjik i kemi ndarë në dy grupe:

1) Rrezikun që vjen nga aktiviteti tektonik në rajonin e studimit, gjë që reflektohet me sasinë dhe intensitetin e tërmeteve që ndodhin në territor, pavarësisht nga kushtet gjeologo-inxhinierike të trojeve të ndërtimit. Bazuar në këtë kriteri territori është ndarë në 4 nënzona:

- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VI ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VII ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet VIII ballë
- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet IX ballë

2) Rrezikun që vjen nga fenomenet gjeodinamike të shpateve. Është gama tjetër e fenomeneve të rrezikut gjeologjik të mara në konsideratë, të cilat lidhen ngushtësisht me ndarjet e sektoreve me bazë kriterin morfologjik. Duke patur parasysh edhe shkallën e hartës 1:50.000, dhe për pasojë edhe detajimet që



mundëson kjo shkallë, territori është ndare në tre sektorë, pavarësisht ndarjes në zona dhe nënzona të përshkruara me lart. Këta sektore janë:

- a. Sektori pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili përputhet me njësinë fushore.
- b. Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të nuk gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknike të shtresave të tokës, duhet të japi të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund ti kërcënojë këto ndërtime, si dhe të rekomandojë edhe masat mbrojtëse perkatëse, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.
- c. Sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të kuqe. Në hartë, pjesë e këtij sektori, janë konturuar sipërfaqet e rrëshqitjeve të ndodhura e të njohura deri tani, zonat e shëmbjeve (subsidence) në fushat minerare të shfrytëzuara, si dhe sipërfaqet e zonave nën erozion. Duke patur parasysh dinamikën e shpateve, ky sektor tenton të rritet dhe të fitojë sipërfaqe të reja nga sektori b (Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, me ngjyrë të verdhë). Në këta sektorë parimi i përgjithshëm është se nuk duhet të ndërtohet, por nëse është e nevojshme, atëherë studimi gjeologo-inxhinierik duhet të jetë shumë i thelluar, ku të jepen të dhëna për atë çka ka ndodhur dhe të llogariten mirë efikasiteti i masave mbrojtëse që mund të rekomandohen.

Tërmeti është dukuri komplekse, në hapësirë dhe në kohë, e rëndësishme, që dëshmon dinamizmin e tokës. Ai është dukuri, sepse procese të shumta e të ndërlikuar janë të lidhura me të dhe së ai kurrë nuk e përsërit vetveten. Veç dëmeve të shumta që shkakton, nga studimi i tërmetit përcaktohet sjellja dinamike e lëvizjeve në thyerjet tektonike në kohën e sotme, në rajonet e deformimeve. Pranohet së tërmetet shkaktohen nga çlirimi i menjëhershëm i sforcimeve tektonike, të cilat për arsye të ndryshme, akumulohen në mënyre të pabarabarte në rajone të ndryshme të tokës.

Fig. – 56 Harta Aktive e Shkeputjeve ne Shqiperi (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

 -Zona ne studim, Bashkia Krumë



Sizmiciteti historik i Shqipërisë është përshkruar në katalogë të ndryshëm si; Sulstarova dhe Koçiaj, 1975 etj. Nga të dhënat e derisotme, rezulton së në periudhën nga shekulli II-III para Krishtit, deri në vitin 1900, vendi ynë është goditur nga 55 tërmete të fuqishëm me intensitet mbi 8 ballë (MSK-64), 15 prej tyre kane pasur intensitet mbi 9

ballë (MSK-64)(1). Nga këto 55 tërmete që njihen për një periudhë më shumë se 2000 vjeçare, 36 i takojnë shekullit të XIX-te , gjë që tregon së numri real i tërmeteve të këtyre përmasave nuk është i sakte. (Sulstarova.E.1980),(Koçiaj.S. 1976),(Muço.B. 1996).

Sizmiciteti instrumental. me ngritjen që nga fundi i shekullit të kaluar dhe sidomos nga fillimi i shekullit të XX-te, të stacioneve sizmologjike në Evropë, u mundësua evidentimi i tërmeteve të ndodhur në Shqipëri e pranë saj. Tërmete të tjerë që gjithashtu kanë bërë dëme gjatë këtij shekulli janë: tërmeti i Selos (Gjirokastër), 9 shkurt 1967 (Mallakastër), 19 gusht 1970 (Kudhes, Sarande), 16 shtator 1972 (Dhiver), 22 nëntor 1975 (Mallakastër), etj. Me ngritjen e Shërbimit Sizmologjik si dhe të parit stacion sizmologjik të Shqipërisë në Tiranë, më 1968 dhe veçanërisht pas ngritjes dhe shtimit vit pas viti të Rrjetit Sizmologjik të vendit, u bë e mundur të merret informacion më i plotë e më i gjerë lidhur me shpërndarjen në kohë dhe hapësirë të mikroaktivitetit sizmik e të tërmeteve të vegjël. Sot Shërbimi, sizmologjik i vendit tone përbehet nga 13 stacione sizmologjike.

4.35 RREZIQET NGA TEKTONIKAT DHE NEOTEKTONIKAT AKTIVE


Nga pikëpamja tektonike, kemi të bëjmë njëherësh me disa zona tektonike të mëdha, që përbëjnë element të madh strukturor në Albanide. Si pjesë përbërëse e saj, rajoni në studim preket nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputjet tektonike janë shume aktive dhe në relief shprehen me kontraste të theksuara. Pasojë e tyre janë dhe levizjet, megjithëse jo të shpeshta sizmike, që trondisin zonën. Si pjesë përbërëse e një strukture neogenike në zhvillim, zona në studim është e prekur nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputja tektonike vepron në kuadrin e regjimit aktiv ngjeshës, por në kohët e sotme Holocenike paraqitet me ritme më të ulta të aktivitetit. Theksojme se, shkëputja origjineton nga thellësia dhe në vetvete shpreh njëherësh dhe aktivitetin sizmik të rajonit.

Linjat tektonike aktive - Krijojnë zona të paqendrueshme në hapësira të gjera, paqendrueshmëri e cila vjen si rezultat i jonjëtrajtshmërisë së lëvizjës së blloqeve të ndryshëm të tokës dhe për pasojë ndodhin çedime të diferencuara të trojeve. Edhe pse këto levizje janë shumë të ngadalta, ato mund të bëhen tepër kërcënuese në rastet e ndodhjes së tërmeteve.

Risqe nga lëkundjet e tjera të tokës

Duke u bazuar në ballafaqimin sizmotektonik të mësipërm rezulton se zona e shkëputjeve sizmogjene ka gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojë edhe në të ardhmen tërmete me potencial sizmik të pritshëm $M_{max}=6.0-6.9$.

- Zona në studim ndodhet jo larg nga thyerjet tektonike, që mund të gjenerojnë lëkundje të tokës në formën e tërmeteve;
- Zona në studim ndodhet pranë rezervuarëve e liqeneve ujorë, që mund të shkaktojë lëkundje të tokës;
- Zonat në studim përgjithsisht ndodhen në, mbi dhe pranë tokave të mbushura me dhera të hedhura, që mund të shkaktojë lëkundje të tokës;



- Zonat në studim ndodhen edhe mbi formacione me shkëmbinj magmatik, ku nuk është e mundur të shkarkojnë ujëra nëntokësorë, dhe bëjnë që të mos shkaktohen lëkundje të tokës;

Megjithatë, parimi më i mirë për një investitor është të ndërtojë një godinë të mirë edhe pranë qendrës së tërmeteve sesa një godinë të dobët larg tij.

Risku i lëngëzimit të truallit

Procesi i lëngëzimit të truallit ndodh, si në rastet kur formacioni përbëhet ose ndërtohet prej ranorëve ose rërave, dhe në rastet kur ai përbëhet prej argjilave, të cilat në rastet e tërmeteve ose të lëkundjeve të tokës për shkaqet e sipërmendura bëhen shkak për lëvizje të reja subsidente ose lëvizje të tokës në formë rrjedhjeje. Shpesh këto procese lidhen me mungesën e një migrimi anësor të ujërave, duke bërë që të ushtrohet presion për të dalë lart, duke lëngëzuar në këtë mënyrë rërat. Tërmeti i ndihmon akoma më shumë këto procese. Lëngëzimi i argjilave ndodh, kur zëvendësohen porët me ujëra të kripura me ujëra të ëmbla, kur struktura argjilore dobësohet shumë dhe gjatë tërmeteve ose vibrimeve transformohet në masë viskoze, që rrjedh në drejtimin poshtë. Në rastin tonë përqasen raste nga këto probabilitete, duke i dhënë vlera pozitive ndikimeve prej këtyre parametrave. Megjithatë, investitori duhet të jetë i kujdesshëm në këqyrjen dhe marrjen e masave pararendëse, si në vlerësimin e ngjarjeve të vogla sizmike, çlirimin e gazit radon, ndryshimi i nivelit të ujërave nëntokësorë, sjelljen dhe reagimin e kafshëve, fryrjen e pjerrësive, fryrjen e sipërfaqeve etj.

Sugjerime

Dëmtimi i objekteve, nëse nuk do të merren masa antisizmike do të konsistojnë:

- Në prishjen e qëndrueshmërisë së truallit, ku do të vendoset bazamenti.
- Në rënien në rezonancë të periodës lëkundëse vetjake të objektit me atë të lëkundjeve sizmike të tërmetit.
- Në veprimin dhe ndjerjen e tërë forcës goditëse të tërmeteve.

Për sa më sipër, rekomandohet që:

- Objektet duhen ndërtuar solid, me disa breza e të lidhur mirë;
- Të përdoren si taban shtresa të rekomanduara nga studime enkas gjeoteknike;
- Të mënjanoen ujërat sipërfaqësorë;

- Të përdoren material ndërtimi me cilësi të kontrolluar;
- T'i kushtohet kujdes cilësisë së punimeve të ndërtimit të objekteve;

Rreziqet nga subsidenca

Subsidenca është e pranishme në rastet kur kemi shfrytëzim të ujrave nëntokësorë ose të trupave të tjerë të lëngët në thellësi të tokës si hidrokarbure etj. Në rastin tonë nuk do të kemi të bëjmë me shfrytëzim të ujrave nëntokësorë, pasi e gjithë zona, ku do të ndërtohet rruga është ujë mbështetëse. Pra, subsidenca nga shfrytëzimi i ujërave do të jetë pothuajse e papërfillshëm dhe nuk do të mund të formohet hinka depresive, për shkak të shfrytëzimit irracional të ujit. Subsidenca do të formohet edhe në rastin nëse do të kishim një formacion:




Fig. - 57 Rreziqet nga ndërhyrjet antropogjene dhe natyrore të brigjeve (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

-Zona ne studim, Bashkia Krumë

- mbi sedimente të ngjeshëshme kokrrizimi në argjila, që rrudhen dhe fryhen, të cilat ndryshojnë përbërjen e ujit;
- në dekompozimin e lëndëve organike;
- në nxjerrjen e ujërave të naftës, në miniera, në shembjen e minierave, që shtrihet mbi gëlqerorët që treten me shumë çarje, pranë sipërfaqeve, duke u shfaqur nëpërmjet çarjeve strukturale, çarjeve të sipërfaqeve, prishjeve, shkëputjeve, etj.

Rreziqet nga vullkanet

Në rajonin në studim nuk njihen raste të shpërthimit apo të rreziqeve të kanosura prej vullkaneve ose hiri të tyre. Nuk njihen gjithashtu, as ndikimet e tyre, si rrjedhjet argjilore apo gazi helmues.

Rreziqet nga tokat

Përhapja e vogël e formacioneve të sotme të Kuaternarit, bimësia e varfër dhe shumë e varfër, relievi pothuajse i coptuar dhe reshjet tipike të zonës favorizojnë siç duhet proceset pedogjenike, për pasojë krijohen mundësi për mosformimin e shtresës së dhëut.

Rreziqet nga Radoni



5-10% e ndërtimeve kanë përqëndrime të rrezikshme të radonit. Ajri i brendshëm në ndërtesa ka 1-2 pci/l. (piko/curie për 1 litër ajër). Ajri i tokës ka 20-100 pci/l. dhe i ujërave nëntokësorë që çlirohet nga toka ka 100-3000 pci/l. Gjysma e zbërthimit të radonit është rreth 4 ditë. 40% e ndotjes me radon përhithet nga toka me shkëmbinjë magmatik ose shiste argjilor, që janë të pasur në silica dhe alumin, si dhe argjilat e zeza të pasura me fosfor që çlirojnë në sasi radonin. Shkëmbinjë të tjerë që çlirojnë radonin janë dhe ata metamorfikë si shiste, gnejse etj. Sa më të mbyllura të jenë ndërtimet aq më përqëndrohet edhe radoni. Përqëndrime më të mëdha janë në dimër se sa në verë për shkak të avullimeve. Përqëndrimet e larta mbi normën e lejuar shkaktojnë kancer në mushkëri. Bazuar në interpretimet e bëra mendojmë se ndotja nga radoni është e shumë e përfillshme, për shkak se treguesit e sipërmendur rezultojnë të jenë pjesëmarrës në formacionin tonë në sipërfaqe e në thellësi, ose në zonat përreth saj. Investitorët duhet të marrin masa, duke bërë zbutjen e saj me anë të izolimit të themeleve, ventilimit të përshtatshëm për raste zyrash apo ndërtime, etj.




Fig.- 58 Harta e Rrezikut nga permbytjet (Burimi Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

 Zona ne studim, Bashkia Krumë

Rreziqet nga estuaret dhe tokat e lagëta

Zona jonë e studimit nuk ndodhet larg tokave apo brigjeve në kontakt me estuaret dhe tokat e lagura, për pasojë mund të vuajë efektet negativë, që shoqërojnë këto elementë ekologjikë.

Rreziqet nga ndërhyrjet antropogjene dhe natyrale të brigjeve

Zona jonë e studimit ndodhet afër tokave apo brigjeve në kontakt me lumenj e përrrenj, për pasojë mund të vuajnë efektet negativë, që shoqërojnë këtë element ekologjik.

Rreziqet nga përmbytjet

Brenda sektorit të kërkuar ndodhen me shumicë burime uji, edhe pse sipërfaqja ujëmbledhëse është e madhe. Vetë konfiguracioni i terrenit dhe përbërja formacionale krijon premisa për depozitime uji. Në shumë sektorë të zonës në studim shtrihet formacioni magmatik, me prurje ujore dhe depozitime të kuaternarit me ujë, por që fryhen disi për pellgun ujëmbajtës në rastet e reshjeve të bollshme dhe ndodh që fryhen edhe më. Duke llogaritur përmbytjet për njëzet vitet e fundit mund të ndërtohet harta e rrezikut të përmbytjeve, që sipas shpërndarjes së reshjeve me probabilitet 1% siguri rajoni në studim ndodhet

në rastisjen me bollshmëri reshjesh deri në 110 mm. Për të gjetur më ekzakhtësisht kalimin e plloteve të lumit që kalon pranë duhet të përdoret metoda e karbonit C-14 në materialet organike, si dhe duke dalluar mbulesat vegjetative. Në territorin e bashkisë Has gjejnë përhapje shumë elemente të rrezikut gjeologjik, të cilat krijojnë shqetësime dhe dëmtime të veprave inxhinierike që kryhen në këtë territor. Më poshtë po përshkruajmë këto rreziqe, duke dhënë edhe fushëpërhapjen e tyre.

Mbulesa vegjetale luan një rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e shpatit. Bimësia sidomos ajo më lartësi të vogël, luan rol pozitiv sidomos në ruajtjen e qëndrueshmërisë së shpatit. Ajo, nga njëra anë, ruan shpatin nga depërtimi i lagështisë, nga ana tjetër, konsumon një vëllim të madh uji gjatë transpiracionit duke e mbajtur shpatin të thatë. Në zonën e Hasi pothuaj në të gjitha rastet e rrëshqitjeve bimësia mungon totalisht ose është tepër e varfër. Shpyllëzimet e kryera në vendin tonë gjatë viteve 1968-1990 në zonat kodrinore, të përbëra kryesisht nga depozitimet flishore dhe mollasike aktivizuan në shpate shkëputjen e masave shkëmbore të tjetërsuara. Në praktiken botërore njihet roli pozitiv i akacieve, mimosave dhe dushkut, të cilat për një lartësi mesatare së cila avullon 10-15 m³ ujë në vit. Në qëndrueshmërinë e shpateve një rol të rëndësishëm luan edhe veprimtaria inxhinierike gjatë ndërtimit të objekteve inxhinierike, veprave hidroteknike, bonifikuese, hapjes ose shfrytëzimit të materialeve të ndërtimit ose të vendburimeve të mineraleve me karriera. Shembuj tipike në Qark të rolit të veprimtarisë inxhinierike të njeriut në qëndrueshmërinë e shpateve njihen rrëshqitjet në lagjen “11 Janari” viti 2008 dhe Rruga Dunavat – Manalat në vitin 2013







Fig. - 59 HARTA E RREZIKUT GJEOLGJIK QARKU KUKËS

Zona ne studim, Bashkia Krumë





SHPJEGUESI

- Zona I - Shkëmbinj të fortë
- Zona II - Shkëmbinj mesatar
- Zona III - Shkëmbinj të butë
- Zona IV - Dherra pa kohzion
- SEKTORI a - Pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik
- SEKTORI b - Me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik
- SEKTORI c - Me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik
- 7 - IZDORJA 1 - Termete 7 balle
- 8 - IZDORJA 2 - Termete 8 balle

Fig. - 60 Zonimi ne bashkine Krume

4.36 STANDARDET E BE DHE OBESH PËR CILËSINË E AJRIT

Efektshmëria e veprimeve të ndërmarra nga autoriteti publik për të luftuar ndotjen e ajrit duhet të konfrontohet përfundimisht me përqendrimit e matura të ndotësve të veçantë të ajrit në krahasim me standardet e cilësisë së ajrit.

Standardet evropiane të cilësisë së ajrit u vendosën në Direktivat e Cilësisë së Ajrit të Ambientit (2004/107 / EC, 2008/50 / EC).



OBSH-ja ka hartuar Udhëzime për Cilësinë e Ajrit, të cilat përgjithësisht janë më të rrepta se rregulloret e BE-së. OBSH nuk ka rekomanduar një vlerë udhëzuese për BaP (Benzoalfapirenet). Megjithatë OBSH ka vlerësuar nivelin referues për këtë ndotës.




Fig. - 61 Udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë OBSH, (2005)

Ndotësi	Short-term ekspozimi maksimal (µg/m³)	Mesatare vjetore (µg/m³)
Ndotësi (pluhur i imët) me diameter më pak se 10 µm, PM ₁₀	50 (24-hr mean)	20
Pluhur ii mët me diameter më pak se 2.5 µm, PM _{2.5} *	25 (24-hr mean)	10
Ozoni, O ₃	100 (8-hr mean)	Not set
Dioksidi i azotit, NO ₂	200 (1-hr mean)	40
Dioksidi i sulfurit, SO ₂	20 (24-hr mean) 500 (10-min mean)	Not set

* WHO preferon PM_{2.5} gjatë matjes PM₁₀

OBSH nuk ka vendosur një kufi për sulfur hidrogjeni, megjithatë, i referohet një vendimi bazuar në një studim të ndërmarrë mbi rreziqet shëndetësore të sulfurit të hidrogjenit (H₂S). Efektet shëndetësore të përqendrimit të ndryshme të sulfurit të hidrogjenit si citohet në këtë studim janë të paraqitura në tabelën 2.3.

Fig - 62 Ndikimet në shëndetin njerëzor prej përqendrimeve të ndryshme të gazit sulfidrik

Exposure (mg/m³)	Efekt / vrojtim	Referencat
0.011	Pragu i erës	Amoore & Hautala, 1983
2.8	Shtrëngim bronchial në individët astmatik	Jappinen et al., 1990
5.0	Rritja e ankesave nga sytë	Vanhoorne et al., 1995

7 ose 14	Rritja e përqëndrimit të kripës dhe acidit laktik në gjak, ul aktivitetin e muskulit skeletar, ul marrjen e oksigjenit	Bhambhani & Singh, 1991; Bhambhani et al., 1996b, 1997
5-29	Acarim sysh	IPCS, 1981
28	Lodhje, humbje oreksi, dhimbje koke, nervozizëm, ulje e memories,	Ahlhorg, 1951
>140	Paralizë e nuhatjes	Hirsch & Zavala, 1999
>560	Kriza në frymëmarrje	Spolyar, 1951
≥700	Vdekje	Beauchamp et al., 1984

4.37 ÇFARË DËMTIMESH MUND TË SJELLË NË SHËNDETIN E NJERIUT PËRQËNDRIMI I ATYRE SUBSTANCAVE TEJ NIVELIT TË SIPËRËRSHKRUAR?

Dioksina dhe përbërësit klorikë organikë që lidhen me to janë substanca jashtëzakonisht helmuese që kanë një sërë ndikimesh të kundërta tek njerëzit dhe tek kafshët, edeh kur janë në doza jashtëzakonisht të vogla. Këta përbërës janë të qëndrueshëm në mjedis dhe grumbullohen në përqëndrime të mëdha, ndërsa lëvizin në zinxhirin e ushqimeve, duke u përqëndruar tek yndyra, veçanërisht te qumështi. Ato janë të shpërndara në të gjithë zonën e vendit për shkak të djegies së mbetjeve, dhe në këto raste janë të pranishme në çdo banor të popullsisë pranë djegies. Dioksina dihet që shkakton zhvillimin e qelizave kancerogjene. Duke bashkëvepruar direkt me AND-në nëpërmjet një mekanizmi të bazuar në receptor, dioksina vepron gjithashtu edhe si një përçarës endokronal me ndikime të kundërta mbi sistemin e riprodhimit, zhvillimit dhe imunitetit. Organizmat në zhvillim janë të prekshme në të gjitha speciet e studiuara dhe ekspozimet embrionale ndaj dioksinës, zakonisht kanë ndikime të qëndrueshme afatgjata. Dioksina është në gjendje të ndërhyjë në metabolizmin tiroid të foshnjave. Ato ndërhyjnë në sisteme hormonale. Emetimet e dioksinës mund të takohen lehtë në zinxhirin e ushqimit. Është llogaritur se një litër qumësht do të përhap aq dioksinë sa një njeri mund të marrë duke thithur ajrin, duke qëndruar pranë një lope për tetë muaj.

Furanet, sikundër dhe doksinat janë një tjetër përbërës helmues të prodhuar nga djegia e plehrave. Furanet bëjnë pjesë në një familje kimikatesh me ngjashmëri të madhe me dioksinën, të cilat mund të shkaktojnë dëmtime shëndetësore, njësoj si dioksina. Të dy këta elementë mund të shkaktojnë kancer dhe vepron si një përçues endokronal me kundërndikime në sistemin e riprodhimit, zhvillimit dhe imunitetit. Në vendin tonë, djegia termike e plehrave mund të jetë përgjegjëse për mbi 90% të emetimeve e dioksinës të transportuara në rrugë ajrore.

Metalet e rënda janë të pranishme në shumë rrjedhje të mbetjeve dhe nuk mund të shkatërrohen as edhe kur digjen në qiell të hapur, si rasti në fjalë. Ato përfundojnë në hi ose çlirohen si emetime ajrore. Metalet e rënda parashtrajnë rrezik për shëndetin në përqëndrime të vogla, për shkak të helmueshmërisë së lartë



të metaleve të veçanta si merkuri, plumbi dhe kadmiumi. Metalet tipike të emetuara nga djegia termike përfshijnë:

Kobalti që rezulton nga procesi i dampave të pambuluara, dhe me nënshtrojë të përshkueshme, si rasti i dampës në fjalë. Ai është element bioakumulues në trupin e njeriut, si dhe është helmues për veshkat dhe sistemin nervor.

plumbi, i cili shkakton çrregullime nervore; kadmiumi, i cili shkakton dëme në veshka, hipertension dhe dëmtime gjenetike.

Merkuri ndërhyr në zhvillimin normal të trurit, sapo shndërrohet në formën e tij organike në mjedis. Në vizionin tonë, niveli i merkurit, për shkak të djegies dhe ndotjes së ujërave nga poshtë dampës duhet të jetë e mjaftueshme për të nxitur shtetin të paralajmërojnë femrat shtatzane, si dhe femrat në moshën e riprodhimit që të mos konsumojnë produkte bujqësore të dalta nga kjo zonë ose të prekura nga ujërat lokale. Ai shkakton defekte në lindje, dëmtime në sistemin imunitar dhe çrregullime nervore; **Metale të tjera** të rënda përfshijnë Cadmiumin, Zinkun dhe Bakrin.

Produktet e djegies së pa plotë janë kimikate, që nuk gjenden në rrjedhjen e mbetjeve fillestare, por që formohen gjatë djegies. Ato përfshijnë kimikate të rrezikshme, siç është benzeni, kloroformi dhe tetraklorur karboni.

Ndotësi	Ndikimet mbi shëndetin dhe mjedisin
I. Gazet okside	
Dioksidi i sulfurit	Keqëson simptomat e zemrës dhe të sëmundjes së mushkërive, duke përfshirë kollën dhe të ftohurën, astmën, bronshit dhe emfizemën. Është helmuese për bimët. Mund të gërryjë statujat dhe metalet. Shenjë paralajmëruese për shirat acidë.
Oksidet azotit	Përqëndrimet e larta mund të jenë fatale; në nivele më të ulëta mund të rrit ndjeshmërinë për infeksionet virale, siç është gripi, të ngacmojë mushkëritë, shkaktojë bronshit dhe pneumoni. Është helmues për bimët. Shenjë paralajmëruese për shirat acidë.
II. Organikët	
Dioksina dhe furanet	Një kancerogjen i vërtetuar njerëzor sipas Organizatës Botërore të Shëndetit të Agjencisë Ndërkombëtare për Kërkimet mbi Kancerin. Një hormon ambjental, ku dioksina bie ndesh me sistemin endokronat të trupit. Shkakton probleme të riprodhimit dhe të zhvillimit. Është e lidhur me endometriosis. Nivelet e larta të ekspozimeve ndaj aksidenteve industriale kanë dhënë si rezultat chloracne, kanë shndërruar funksionin e mëlçisë, si dhe kanë shkaktuar probleme në lëkurë. Sëmundjen e Chico-edima tek kafshët, që lidhet me neglizhimin e të ushqyerit për harenga dhe pulëbardhat.
PCB	Në ekspozime të larta mund të shkaktojë chloracne, çrregullime në mëlçi dhe të verdhët. Mund të shkaktojë gjithashtu dhe defekte në lindje.
III. Metalet e rënda	



Plumbi	Në ekspozimet kronike dhe të mprehta, fëmijët mund të vuajnë çrregullime neurologjike, si dhe femrat mund të ndjejnë probleme të riprodhimit.
Merkuri inorganik	Mund të shkaktojë çrregullime serioze neurologjike si dhe probleme të veshkave. Është kancerogjen i mundshëm për njerëzit sipas EPA-s të Shteteve të Bashkuara.
Metili merkurit	Helm riprodhues. Është vërtetuar që shkakton tumor tek minjtë në rast se dozat janë të mëdha. Është gjithashtu dhe një kimikat i përcimit endikronal, duke shkaktuar një keqësim të funksioneve të gjendrave tiroide.
Kadmiumi	Sipas EPA-s është një kancerogjen i mundshëm për njerëzit. Mund të shkaktojë kancerin e mushkërive, që lidhet gjithashtu me çrregullimet e veshkave.
Kromi	Mund të shkaktojë dëmtime në mëlçi dhe në veshka si dhe çrregullime në frymëmarrje.
Arseniku	Sipas EPA-s është një kancerogjen i mundshëm për njerëzit. Mund të shkaktojë dëmtime në mëlçi dhe në veshka.

4.38 TEKTONIKA

Nga pikëpamja tektonike kemi të bëjmë me zonë tektono-strukturore Zona Jonike brezi i Kremenares. Rajoni në studim preket nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputjet tektonike janë shumë aktive, dhe në relief shprehen me kontraste të theksuara. Pasojë e tyre janë dhe lëvizjet e shpeshta sizmike, që trondisin zonën. Si pjesë përbërëse e një strukture neogenike në zhvillim, zona në studim preket nga forcat tektonike orogjenike dhe sidomos nga ato neotektonike. Epiqendrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive. Përcaktimi i zonave sizmogjene ose zonave të burimeve sizmike, siç quhen ndryshe, përbën hapin e parë fundamental në analizën probabilitiste të rrezikut tërmetor. Zonat e burimeve sizmike paraqesin terrene me tipare të perbashkëta sizmologjike dhe neotektonike; kjo nënkupton që sizmiciteti në një zonë të burimeve sizmike të jetë uniformisht i shpërndarë në të gjithë zonën dhe tërmetet e ardhshëm mund të ndodhin kudo në zonë. Kështu, zonat e burimeve sizmike përcaktohen nga dy instrumenta fundamentalë: nga profili i sizmicitetit dhe nga regjimi tektonik i sotëm i rajonit në shqyrtim.




Fig. – 63 Harta e zonave sizmogjene me potencial sizmik të pritshëm (Burimi: Qendra e Sizmologjisë, Tiranë)


-Zona në studim, Bashkia Krumë

Nga studimet e kryera këto 20 vitet e fundit janë përcaktuar katër modele sizmotektonike, ndër të cilët modeli sizmotektonik nga Sulstarova, Aliaj e Muço (2005b) i përfaqësuar me nëntë zona të burimeve sizmike është pranuar bazë për llogaritjen e rrezikut sizmik të Shqipërisë që paraqitet në këtë studim. Nga konsideratat e regjimit tektonik të sotëm dhe të dhënat e katalogut të tërmeteve (Sulstarova etj., 2005a), sizmiciteti rajonal është ndarë në 9 zona të burimeve sizmike (Sulstarova etj., 2005b), që përfshijnë njëfarë ripërcaktim të 8 zonave të trajtuara për Shqipërinë (Aliaj, 2003) së toku me një zonë që modelon tërmetet në rajonin e Shkupit (Talaganov etj., 2003), si dhe në modelin sizmotektonik të vitit 2004 (Aliaj etj., 2004), të cilat janë:

1. Zona Lezhë-Ulqin (LU) me $M_{max}=7.2$;
2. Zona e Ultësirës Pranadriatike (PL) me $M_{max}=7.0$;
3. Zona e Bregdetit Jonian (IC) me $M_{max}=7.0$;
4. Zona Korçë-Ohër (KO) me $M_{max}=6.9$;
5. Zona Elbasan-Dibër-Tetovë (EDT) me $M_{max}=6.9$;
6. Zona Kukës-Peshkopi (KP) me $M_{max}=6.5$;
7. Zona Shkodër-Tropojë (ST) me $M_{max}=6.5$;
8. Zona Pejë-Prizren (PP) me $M_{max}=6.8$;
9. Zona e Shkupit (SK) me $M_{max}=6.5$.

Fig. – 65 Harta Neo-Tektonike e Shqipërisë ((Burimi: Qendra e Sizmologjisë, Tiranë)

Zona në studim, Bashkia Krumë



Vlerësimet e magnitudës më të lartë janë bërë për çdo zonë të burimeve tërmetore, duke marrë në konsideratë tërmetin më të madh të vrojtuar në zonën në shqyrtim, madhësinë e tërmeteve të ndodhur në brezat sizmikë përkatës, dhe logjikën tektonike të ndodhjes së tërmeteve të mëdhej. Vlerësimet më të mira të M_{max} janë bërë duke marrë në konsideratë tërmetet më të mëdhej të njohur në mjediset tektonike të ngjashme. Vatrën e tërmeteve të Shqipërisë përqëndrohen kryesisht përgjatë shkëputjeve aktive, të cilat janë 3 zona shkëputje aktive gjatësore dhe 2 tërthore si më poshtë: Shkëputje me mbihijpe joniane-adriatike, me shtrirje në drejtim VP-VVP;

- Zona e shkëputjes graben Shkodër-Mat-Librazhd (drejtimi VP);
- Zona e shkëputjes graben Peshkopi-Korçë (drejtimi VJ);
- Zona e shkëputjes normale Shkodër- Tropojë (drejtimi VL);
- Zona e shkëputjes normale Elbasan-Dibër (drejtimi VL).

Karakteristikat sizmotektonike të zonës




Një lidhje e ngushtë ekziston midis tërmeteve dhe shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive, që herë pas here gjenerojnë tërmete. Analizës dhe sintezës sizmotektonike të vendit tonë u është kushtuar vëmendje e veçantë (Aliaj,1979; 1988; Aliaj & Sulstarova,1994; Sulstarova et al.,1980).

Lidhja e ngushtë midis tërmeteve dhe zonave të shkëputjeve aktive është evidentuar për secilën prej këtyre të fundit, duke përcaktuar edhe potencialin sizmik maksimal të pritshëm, bazuar në të dhënat e deri sotme për sizmicitetin (Aliaj, 1988). Sinteza sizmotektonike ka evidentuar në Shqipëri tre zona sizmogjene gjatësore dhe tre zona sizmogjene tërthore, (shih hartën përkatëse).

Fig. – 66 Harta aktive e shkëputjeve në Shqipëri (Burimi Qendra e Sizmologjisë, Tiranë)


 -Zona ne studim, Bashkia Krumë



Kjo hartë (Fig. e mëposhtme) përfaqëson intensitetet e pritshme për kushtet e tokës mesatare për 100 vitet e ardhshme, me një normë probabilitet 70%. Në bazë të përpunimit statistikor për të gjitha të dhënat e tërmeteve të ndodhur në vendin tonë, duke marrë për truell mesatar shkëmbinj të shkrifët si ranor, argjila e suargjila, siç ndodhen në këtë zonë studimi, mendojmë se kemi të bëjmë me intesitet tërmetesh të paktën deri në 8,5-9 ballë ose me magnitudë 6,0-6,5. Drejtime kryesore të punës duhet të jenë dhe përcaktimi i:

- Dukurive të lëngëzimit të rërave të vrojuara nga tërmetet e së kaluarës;
- Tërmeteve maksimal të mundshëm;
- Vetive fiziko mekanike të rërave.

Veçori këtu është se sektorë të ndryshëm kërkojnë masa dhe kushte gjeoteknike të ndryshme. Nisur nga kërkesat e kohës, janë ndërtuar edhe harta të shpejtimitve maksimale referencë të trojeve. E tillë është edhe harta e paraqitur me poshtë, e përpiluar në vitin 2003 në kuadër të projektit “Vlerësimi i Rrezikut




në Shqipëri” – PNUD. Sipas kësaj hartë, shpejtimi maksimal referencë në truall të fortë për periudhë rikthimi 475 vjet për zonën Shirokë është 0.275g. Harta të reja sismike, që plotësojnë kërkesat e Eurokodit 8 (EN1998, “Projektimi i strukturave për rezistencë ndaj tërmetit”) pritet të jenë në të ardhmen e afërt pjesë e praktikës së projektimit në Shqipëri. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, ka paraqitur në botimin “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sismik në Shqipëri” – 2010 një studim të detajuar mbi vlerësimin e rrezikut sismik. Përveç hartave të shpejtimitve referencë në truall shkëmbor, studimi i lartpërmendur paraqet të dhëna mbi rrezikun sismik, të shprehur në terma të shpejtimitve maksimale (PGA) si dhe si vlera spektrale për periode 0.1, 0.5, 1.0 dhe 2.0 sekonda (shih hartën)

Fig. – 67 Harta e shpejtimitve maksimale referencë në truall të fortë (tipi A sipas EN 1998), për periudhë rikthimi 475 vjet (Burimi: Qendra e Sizmologjisë, Tiranë)
 Zona ne studim, Bashkia Krume

4.39 AKTIVITETI SIZMIK

Të dhënat historike për aktivitetin sismik, janë relativisht të mangëta. Rajoni është prekur nga tërmete historike me intensitet deri në 8 ballë (MSK-64) dhe gjatë shekullit të kaluar, nga tërmete me magnitudë 5.3 deri 5.6. Nisur nga kerkesat e kohes, jane ndertuar edhe harta te shpejtimitve maksimale reference te trojeve. E tille eshte edhe harta e paraqitur me poshte, e perpiluar ne vitin 2003 ne kuader te projektit “Vleresimi i Rrezikut ne Shqiperi” – PNUD. Sipas kesaj harte, shpejtimi maksimal reference ne truall te forte per periudhe rikthimi 475 vjet eshte 0.25g. Harta te reja sismike, qe plotesojne kerkesat eEurokodit 8 (EN 1998, “Projektimi i strukturave per rezistence ndaj termetit”) pritet te jene ne te ardhmen e afert pjese e praktikes se projektimit ne Shqiperi. Akademia e Shkencave te Shqiperise, ka paraqitur ne botimin “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vleresimi i rrezikut sismik ne Shqiperi” – 2010 nje studim te detajuar mbi vleresimin e rrezikut sismik. Pervec hartave te shpejtimitve reference ne truall shkembor, studimi i lartpermendur paraqet ne forme tabelare te dhena mbi rrezikun sismik per 370




komuna e bashki te Republikes se Shqiperise, te shprehur ne terma te shpejtimeve maksimale (PGA) si dhe si vlera spektrale per periode 0.1, 0.5, 1.0 dhe 2.0 sekonda.

Risku sizmik për rajonin

Referuar rrezikut sizmik (që është i konsiderueshëm), vulnerabilitetit të veprave të ndërtimit ekzistuese (që është relativisht i ulët) si dhe shkallës së ekspozimit të këtyre veprave ndaj rreziqeve sizmike (që është e ulët, nisur nga dendësia e popullsisë së komunës), mund të thuhet paraprakisht se risku sizmik nuk është i lartë. Megjithatë, shkalla e ekspozimit të strukturave ndaj rreziqeve sizmike ka ardhur duke u rritur, sidomos pas viteve '90 me rritjen e intensitetit të ndertimeve në zona të. Sipas hartës së meposhtme të rajonizimit sizmik të përpiluar në fund të viteve '70, rajoni përfshihet në një zonë ku mund të priten tërmete me intensitet $I_0=7-8$ ballë (sipas MSK-64) për kushte mesatare trualli.

Fig. - 68 Epiqendrat e tërmeteve në Shqipëri me $M \geq 5.0$ për shekullin e 20^{te}. Shënohen epiqendrat e zonave të dallueshme sizmike dhe pozicioni i Bashkisë Bulqize. (Burimi: Aliaj S. et al., 2010)

 - Zona në studim, Bashkia Krumë






Fig. - 69 Risku sismik për Bashkinë Krumë (Burimi: Qendra e Sizmologjisë, Tiranë)

4.40 KUSHTET GJEOLOGO-INXHINIERIKE NË BASHKINË HASI

Formacionet litologjike, inkuadrimi gjeologjik i tyre

Territori i Bashkisë së Krumës, nga ana e ndërtimit gjeologjik është shumë i larmishëm si nga ana litologjike ashtu dhe nga koha e formimit. Në të marrin pjesë shkëmbinj nga më të vjetrit siç janë formimet e paleozoit e deri te formimet e sotme kuaternare që përfaqësohen nga dherat. Në territorin e Bashkisë, në sipërfaqe shfaqen shkëmbinj rrënjësorë, si dhe dhera të Kuaternarit të tipit mbulesor. Shkëmbinjtë ndahen në tre grupe:

1. Shkëmbinj të fortë;
2. Shkëmbinj mesatarë;
3. Shkëmbinj të butë.

Kriteri i ndarjes së tyre është rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh), e cila për shkëmbinjtë e fortë ka vlera më të mëdha se 500 bar (ose kg/cm^2), për shkëmbinjtë mesatare 50-500 bar dhe për shkëmbinjtë e butë < se 50 bar. Kriteri i ndarjes së dherave ka qenë kohezioni (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse). Dherat janë klasifikuar në dy grupe:

1. Dhera pa kohezion;
2. Dhera me kohezion.

Në Bashkinë e Krumës janë evidentuar këto formacione litologjike.



A – Shkëmbinjtë e fortë, Rsh >500 bar. Në hartë ngjyrosen me ngjyre të kuqe. Përfaqësohen nga shkëmbinjtë e moshave të ndryshme dhe llojeve shkëmbore të ndryshme. Janë intruzivë, efuzivë e sedimentarë.

Shkëmbinjtë magmatikë ultrabazikë të fortë (Iu) të jurasikut të mesëm që përfaqësohen nga:

δJ (U)₂₂ Intruzione ultramafike (verlite,piroksenite etj). Kanë dalje të kufizuara në Visocë, Berishë e Kalimash, Qaf Tobli, Qaf Barak etj. Janë pjesë përbërëse e masivit ofiolitik. ΨJ (P) Piroksenite.




Fig. - 70 HARTA GJEOLGO- INXHINIERIKE, QARKU KUKËS

- Zona Ne Studim, Bashkia Krumë






Fig. - 71 Harta Gjeologjiko-Inzhinierike, Bashkia Krumë

SHpjEGUESI

Klasifikimi gjeologjiko-litologjik i shkëmbinjëve dhe shtrësve

- Shkëmbinjë të forta
- Magmatike intruzive, ultrabazike
- Magmatike intruzive, bazike
- Magmatike intruzive, Mesatare acid
- Magmatike efuzive, bazike
- Magmatike efuzive, Mesatare acid
- Metamorlike reshpa
- Gëlqerore
- Gëlqerore shtazore
- Gëlqerore djalmitike
- Brekçe dhe konglomerate me lartësi të ndryshme
- Shkëmbinjë mesatar
- Konglomerate e ranore me çimentim deri mesatar
- Eëzho sedimentar
- Flishë rëmbike shtrësso hollë argjilo-alevoolito-ranore
- Mollesa argjilore
- Mollesa ranore-konglomeratike

Shkëmbinjtë magmatikë intruzivë bazike (Ib) të jurasikut të mesëm



Perfaqësohen nga: J2 (Γ) (troktolite, gabro, norite, gabronorite, gabro amfibolike e kuarcore, gabrodiabaze). Në përgjithësi këta shkëmbinj kanë një trashësi të madhe të pjesës së kapur nga shkatërrimi fiziko-kimik, duke krijuar kështu një sipërfaqe më të butë e të veshur me pyje.

Shkëmbinj gëlqerorë (G)

Janë të moshave nga T1 - Cr2. Janë gëlqerorë, gëlqerorë dolomitikë, gëlqerorë shtresore me thjerrza silicorësh, gëlqerorë turbididikë, gëlqerorë shtresorë pllakë trashë, pllakë mesëm e të hollë, gëlqerorë me nderthurje (Z. Alpeve) rreshpe argjiloro-sericitike, konglomeratë, gëlqerorë, konglobrekçiore, rreshpe karbonatike (në Kukës). Vendosen me kalim gradual mbi P-T1.

Depozitimet karbonatike të Kretakut Cr

Janë gëlqerorë shtresorë biomikritikë e biomikrilitikë, orbitolitikë, gastropodë e bivalvorë me thjerrza stralli me faunë e karst të zhvilluar.

Fig. - 71 Pamje e prerjes së poshtme të formimeve të Cr1 (Mamëz).



Shkëmbinjtë gëlqerorë-silicore (Gsi)

Gëlqerorë me silicorë e silicorë radiolaritik të kuq, gëlqerorë biomikritikë, mergelorë, mergele, rreshpe argjilosilicore, gëlqerorë, tufe (të zonës Mirdita, Cukali e n/zona Alpeve). Në rajonin e Tropojës dalin aty ku vendosen dhe ato të mësipërmet, në Kukës ndërtojnë zona të kufizuara në Resk, Tejdrinë, Draj, Reç. (J) Jurasiku i pandarë i n/zonës Valbonës vendoset në territorin e Tropojës në formën e një kornize në pjesën veriore e juglindore të gëlqerorëve në tërësi.

Shkëmbinjtë brekçorë dhe konglomeratikë (B)

P-T1 Permian-Triasik i poshtëm. Ranorë, gravelite, konglomeratë të kuqërremte të ndërthurrur me shiste mergelore e gëlqerorë radiolaritikë. Del në territorin e Kukësit në Matranxh, Fshat, dhe Lojme-Belë, Orcikël, Shishtavec e Novosej.


Grupi i shkëmbinjve të dobët. Rsh<50 bar. Në hartë ngjyrosen me ngjyrë të gjelbërt (jeshile ulliri).

Depozitime të vjetra kuaternare pjesërisht të çimentuara (De) (sh. dobët)

Qp-h (pleistocen-holocen) Formime kuaternare të pandara (depozitime akullnajore, eluviale, deluviale) (Kukësi) në përgjithësi të pa studiuar.

Qp.-h. Pleistocen-holocen. Depozitime të perziera deluvionalo-koluvionale-proluviale me argjila.

Koluvionet (C). Pleistocen, depozitime të deluvioneve-koluvioneve (Qp). Vendosen në fund të shpateve. Kryesisht janë karbonatike (në përgjithësi pak të studiuar).



Serpentine e millonite (Ms)

Këtu janë futur serpentinitet e Fush-Dukagjinit (Kukës) (Hs). Dalin në zonën Fush-Dukagjin-Kolsh. Janë me ngjyrë gri, gri të çelur.

Grupi i shkëmbinjve të shkrifët pa lidhje kohezonale. Në hartë paraqiten me ngjyrë portokalli. R - Zhavore dhe rëra kryesisht karbonatike të Qp (Pleistocen i mesëm - i sipërm). Tarracat e vjetra (Tropojë) P- Depozitime aluviale dhe aluviale-proluviale (të sotme Holocen (Qh). Material i pa sortuar nga ranorë deri zhavorre kokërrtrashë deri në poplor (kryesisht Kukës). Dalin në jug të rajonit në shtratin e lumit të Drinit të Zi dhe lumit të Veleshicës në pjesën e poshtme të rrjedhjes përgjithësisht materiali i depozituar është më i imët.

4.41 KUSHTET GJEOLIGO-INXHINIERIKE TË TROJEVE TË NDERTIMIT

Për vlerësimin e kushteve gjeologo-inxhinierike të trojeve të ndërtimit, rolin kryesor e luajnë vetitë fiziko mekanike (ose gjeoteknike) të tyre.



Fig. - 72 Pamje e serpentiniteve të Fush Dukagjinit.

Kushtet gjeomorfologjike; B. Vetite fiziko – mekanike (gjeoteknike)

A – Kushtet gjeomorfologjike.

Bashkia e Krumës kap një teritor të gjerë dhe për vetë ndërtim gjeologjik dhe tektonik dhe hidrografik, ai paraqitet me një reliev shumë të larmishëm e të komplikuar. Në territor paraqiten pothuajse të gjitha format e relievit. Theksojmë se relievi në përgjithësi paraqitet shumë i aksidentuar. Ai vendoset nga lartësia 200m mbi nivelin e detit deri mbi 2000m dhe në tërësinë e tij ai ka shumë maja me lartësi të madhe.






Fig. - 73 Pamje e depozitimeve të lumit të veleshicës në pjesën e poshtme të tij (takimi me lumin e Drinit të Zi).

Disa herë lartësitë ngrihen në mënyrë të menjëherëshme. Relievi në përgjithësi paraqet shumë kontraste. Ngritja e shpateve të maleve është e menjëherëshme e cila bën që në shumë raste të jenë të vështira për tu kaluar. Kjo sidomos kur shpatet ndërtohen nga shkëmbinj gëlqerorë. Kontrastet në reliev janë pasqyrim i ndërtimit gjeologo-tektonik dhe i rrjetit hidrografik i cili ka krijuar prerje të thella erozionale. Formacionet gjeologjike që ndërtojnë këto teritore janë të moshave të ndryshme e me qëndrueshmëri jo të njejte (veti fiziko mekanike) kundrejt faktorëve veprues. Zona në përgjithësi ka një rrjet hidrografik të zhvilluar ku më kryesori dhe që shërben si bazë erozionale është lumi i Drinit të Zi i cili përshkon mospërmes territorin e rrethit të Kukësit nga jugu në drejtim të veriut dhe Drini i Bardhë në veri që bashkohen në Kukës duke harkuar e lëvizur në veriperëndim. Ky ka krijuar dhe luginën më të madhe. Në dy anët e këtij lumi është një rrjet i tërë lumenjsh të vegjël e përrenjsh malor të cilët e aksidentojnë shumë territorin. Janë përgjithësisht përrenj të thellë të cilët kanë fuqi gërryese e transportuese. Në përgjithësi lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë malor në fundin e rrjedhjes së tyre bëhen më pak të rrëmbyeshëm dhe depozitojnë prurjet e ngurta të tyre. Luginat bëhen më të gjera e me pjerrësi më të vogël.

Vetitë Fiziko-Mekanike (Gjeoteknike)

Të dhënat gjeoteknike janë nxjerrë nga literatura e studimeve gjeologo-inxhinierike të realizuara në vite. Nuk kemi kryer analiza për këtë qellim por jemi mbështetur në metodën e analogjisë, dhe klasifikimin e shkëmbinjve sipas llojit litologjik (dhe tabelës së klasifikimit). Sipas kësaj në territorin e qarkut kemi veçuar:

- Shkëmbinj të fortë
- Shkëmbinj mesatarë



- Shkëmbinj të butë.

- Dhera pa kohezion

- Dhera me kohezion

Shkëmbinj të fortë kanë rezistencë në shtypje $> 500 \text{ kg/cm}^2$. Këta shkëmbinj, në shumë raste janë të shkatërruar nga fenomenet e ndrydhjeve tektonike dhe paraqiten me shumë çarje. Në këtë grup bëjnë pjesë:

Shkëmbinj të ultrabazikë (Iu): Perfaqësohen nga harzburgite, dunite, lercolite etj. në përgjithësi janë kompaktë e masivë, por dhe të serpentinizuar e coptuar nga tektonika etj.

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,6 - 2,8 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2,0 - 5,0 \%$ Rezistenca në shtypje njëboshtore
Rsh 500 - 800 kg/cm ²	
Moduli i elasticitetit	$E = 103 - 104 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,26 - 0,28$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 10 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinj të bazikë (Ib): Përfaqësohen nga gabro, traktolite etj. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,7 - 2,8 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 1,0 - 2,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 1000 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 104 - 105 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,14 - 0,24$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 10 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinj të mesataro-acidë (Ima): Përfaqësohen nga dioritet, dioritet kuarcore, plagjiogranitet,

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,65 - 2,85 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2,0 - 4,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 1100 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 103 - 104 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,1 - 0,18$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 10 \text{ kg/cm}^2$



Shkëmbinjtë efuzive bazikë (Eb): Përfaqësohen nga llavat bazike, diabazet me pak carje etj. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,2 - 2,6 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2,0 - 6,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 850 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 104 - 105 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,14 - 0,26$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 10 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë efuzivë mesataro-acidë (Ema): përfaqësohen nga hialoandezitet, keratofiret kuarcore

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,2 - 2,55 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2,0 - 5,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 600 - 800 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 104 - 105 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,11 - 0,15$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 10 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë metamorfike rreshpore (Rm): Janë shkëmbinj të përbërjeve litologjike të larmishme. Brenda tyre ekzistojnë shkëmbinj shumë të forte dhe të forta, por që shpesh të coptuar dhe të ndrydhur tektonikisht. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,3 - 2,6 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2,0 - 8,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 700 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 105 - 5 \times 105 \text{ bar}$
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,2 - 0,3$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë metamorfike gelqeroro rreshpore (GR): Edhe këta shkëmbinj kanë përbërje litologjike të larmishme, por mbizotërojnë ato të përbërjeve karbonatike. Brenda tyre ekzistojnë shkëmbinj të fortë, por që janë shpesh të coptuar dhe të ndrydhur tektonikisht.



Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,5 - 2,7 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2,5 - 5,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 800 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 105 - 4 \times 105 \text{ bar}$
Koefiçienti i Puasonit	$\nu = 0,2 - 0,3$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Gëlqerorët (G): Janë shkëmbinj kompaktë masivë deri pllakorë. Në ta është prezent fenomeni i karstëzimit, kryesisht është i përhapur karsti i çarjeve i drejtimit vertikal dhe të kombinuar me fenomenin e mbushjeve të tyre me material kryesisht çimento karbonatik që vjen nga tretja kimike e gëlqerorëve dhe më pak material argjiloro-humusor që vjen nga shpatet duke lëvizur nën veprimin e ujrave rrjedhës sipërfaqësor e nëntokësorë.


Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,4 - 2,7 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 0,1 - 5,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 1100 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 105 - 3 \times 105 \text{ bar}$
Koefiçienti i Puasonit	$\nu = 0,1 - 0,2$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 20 \text{ kg/cm}^2$

Gëlqerorët silicorë (Gsi): Edhe këta, si gëlqerorët, janë shkëmbinj kompaktë, kryesisht pllakorë, por nuk mungojnë rastet kur kemi ndërthurje të shtresave gëlqerore me ato silicore, ose kur shkëmbinj të me pamje silicore shfaqen brenda gëlqerorëve në forme të linzave. Në këta shkëmbinj, në përgjithësi nuk gjen përhapje fenomeni i karstëzimit.

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,6 - 2,75 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 0,1 - 2,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 500 - 1100 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	$E = 105 - 3 \times 105 \text{ bar}$



Koefiçienti i Puasonit	$\nu = 0,1 - 0,15$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 20 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë brekcorë dhe konglomeratikë (B)

Kanë përbërje ranore, gravelite, konglomeratë të kuqerremtë të nderthurur me shiste mergelore e gëlqerorë radiolaritikë. Janë kalime faciale të "Serise Verrucano" ose "Luma". Përhapen kryesisht në njësinë e Çajës.

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,0 - 2,25 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 15 - 45 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh $> 500 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit	$E = 102 - 103 \text{ bar}$
Koefiçienti i Puasonit	$\nu = 0,25 - 0,35$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 10 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë mesatarë kanë rezistencë në shtypje $50 - 500 \text{ kg/cm}^2$. Mund të jenë masivë ose kombinime shtresash me veti gjeoteknike krejt të ndryshme. Për këtë arsye vetitë e tyre janë jo stabile dhe të ndryshueshme në sipërfaqe edhe në distanca shumë të vogla. Në këtë grup bëjnë pjesë: Konglomeratë e ranorë me çimentim deri mesatare (KL): Përfaqësohen nga konglomeratë e ranorë të kuqerremtë me lëndë çimentuese hekuroro-alevrolitore (Suita Luma).

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,3 - 2,5 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 5,0 - 18,0 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh $100 - 500 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i elasticitetit	$E = 102 - 103 \text{ bar}$
Koefiçienti i Puasonit	$\nu = 0,3 - 0,4$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 6 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë efuzivo-sedimentarë (Es): Përfaqësohen nga vullkanite bazike (diabaze me ndërshtresa silicore e rreshesh argjilore).

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,2 - 2,6 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 5,0 - 15,0 \%$



Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 50 - 500 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	E = 103 – 104 bar
Koeficienti i Puasonit	$\nu = 0,25 - 0,35$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 10$ kg/cm ²

Shkëmbinjtë flishore dhe me pamje flishore (Fl): Në fushëpërhapjen e tyre kemi kombinime të shtresave argjilore, ranore, alevrolitore e mergelore dhe më rrallë edhe gëlqerorë dhe qymyre, të cilat kanë trashësi nga disa cm deri në dhjetra cm.

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,3 - 2,6$ gr/cm ³
Poroziteti	n = 5,0 – 10,0 %
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 100 - 500 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	E = 104 – 105 bar
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 12 - 20$ kg/cm ²

Mollasat argjilore (Ma): Janë shkëmbinj argjilorë me veti plastike, të cilët në shumë raste ndërthurren edhe me shkëmbinj alevrolitorë e shtresa qymyri.

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 1,8 - 2,0$ gr/cm ³
Poroziteti	n = 20,0 – 85,0 %
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 50 - 100 kg/cm ²
Moduli i elasticitetit	E = 103 – 5 x 103 bar
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 2,5 - 5,0$ kg/cm ²

Mollasat ranoro konglomeratike (Mrk): Janë shkëmbinj me predominim të fraksionit ranorik e më pak të atij konglomeratik, me shkallë çimentimi të ndryshueshme. Është pikërisht kjo shkallë çimentimi e cila përcakton edhe vetitë gjeoteknike të këtyre shkëmbinjve.

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore	$\Delta = 2,2 - 2,5$ gr/cm ³
Poroziteti	n = 10,0 – 25,0 %
Rezistenca në shtypje njëboshtore	Rsh 50 - 500 kg/cm ²



Moduli i elasticitetit	$E = 103 - 104 \text{ bar}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma > 5 - 10 \text{ kg/cm}^2$

Shkëmbinjtë e dobët

Depozitime të vjetra Kuaternare pjesërisht të çimentuara (De). Janë pjesërisht të çimentuara me çimento karbonatike ose argjilore. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore në gjendje natyrale	$\Delta = 1,7 - 1,9 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 20 - 70 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	$R_{sh} < 50 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i deformacionit	$E = 100 - 103 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = < 5 \text{ kg/cm}^2$

Zhavorre e popla me origjinë aluviale dhe proluviale (C): Kanë veti të larta filtruese. Madhësia e coprave të tyre është teper heterogjene. Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:


Pesha volumore në gjendje natyrale	$\Delta = 1,6 - 2,1 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 30 - 85 \%$
Këndi i fërkimit të brendshëm	$\varphi = 28 - 42^\circ$
Kohezioni	$c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i deformacionit	$E = 150 - 250 \text{ kg/cm}^2$
Koeficienti i filtrimit	$K > 50 \text{ l/24 orë}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = 1,8 - 4,0 \text{ kg/cm}^2$

Serpentinite e millonite (Ms)

Këtu janë futur serpentinitet e Fush-Dukagjinit (Kukës) (Hs). Dalin në zonën Fush-Dukagjin-Kolsh. Janë me ngjyrë gri, gri të çelur.

Parametrat gjeoteknike të tyre janë:

Pesha volumore në gjendje natyrale	$\Delta = 2,0 - 2,4 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 2 - 20 \%$
Rezistenca në shtypje njëboshtore	$R_{sh} < 50 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i deformacionit	$E = 50 - 300 \text{ kg/cm}^2$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = < 3 \text{ kg/cm}^2$



Dherat pa kohezion ($c=0$). Karakterizohen nga mungesa e lidhjeve kohezionale midis coprave përbërës të tyre, duke i dhënë pamjen e shtresave të përbëra nga copra të palidhur me njëra tjetrën. Ndahen në bazë të madhësisë së coprave përbërëse.

Formime të shkrifëta pa lidhje kohezionale (R): Mund të jenë rëra nga kokrrizmëdha deri kokrrizimët deri në surëra, me trashësi nga 2 deri në 20 m.

Parametrat gjeoteknikë të tyre janë:

Pesha volumore në gjendje natyrale	$\Delta = 1,65 - 1,85 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 30 - 75 \%$
Kendi i ferkimit të brendshëm	$\varphi = 22 - 36^\circ$
Kohezioni	$c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i deformacionit	$E = 150 - 250 \text{ kg/cm}^2$
Koefiçienti i filtrimit	$K > 50 \text{ l/24ore}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = 1,8 - 3,0 \text{ kg/cm}^2$



P-Depozitime aluviale dhe aluviale-proluviale (të sotme Holocen (Qh)). Material i pa sortuar nga ranorë deri zhavorre kokërrtrashë deri në poplor.

Pesha volumore në gjendje natyrale	$\Delta = 1,65 - 2.1 \text{ gr/cm}^3$
Poroziteti	$n = 25 - 80 \%$
Këndi i ferkimit të brendshëm	$\varphi = 22 - 40^\circ$
Kohezioni	$c = 0.0 \text{ kg/cm}^2$
Moduli i deformacionit	$E = 150 - 250 \text{ kg/cm}^2$
Koefiçienti i filtrimit	$K > 50 \text{ l/24ore}$
Ngarkesa e lejuar	$\sigma = 1,8 - 4,0 \text{ kg/cm}^2$

4.42 FENOMENET E RREZIKUT GJEOLGJIK, PËRHAPJA DHE PËRSHKRIMI I TYRE

Në territorin e qarkut Kukës gjejnë përhapje shumë elemente të rrezikut gjeologjik, të cilat krijojnë shqetësime dhe dëmtime të veprave inxhinierike që kryhen në këtë territor. Këto elemente rreziku janë:

Rrëshqitjet. Janë një fenomen i përhapur në Bashkin e Krumës. Në hartën e përhapjes së rreziqeve gjeologjike, janë hedhur rrëshqitje të njohura, por kjo nuk do të thotë se në këtë territor nuk ekzistojnë rrëshqitje të tjera. Gjithashtu duhet theksuar se territore të ngjashme me ato ku kemi konturuar rrëshqitjet e njohura, janë po aq të rrezikshme sa ato në të cilat ende nuk kanë ndodhur rrëshqitje, por me krijimin e kushteve edhe ato shpate rrezikohen nga i njëjti fenomen. Nga ky studim rezultoi se zonat më



problematike të shfaqjes së fenomeneve të rrëshqitjeve janë zonat me pjerrësi të madhe e të zhveshura nga bimësia dhe që ndërtohen nga formacione gjeologjike të paqëndrueshme. Në përgjithësi në territorin e Bashkisë së Krumës shfaqen në formacionet e paleozoit të përfaqësuara nga rreshpe e shiste argjilore, ranorë etj. Më të theksuara janë në rastet e rënies së shtresave në drejtim të rënies së relievit. Rrëshqitjet janë të përmasave të ndryshme. Ata kapin sipërfaqe disa qindra metër katrorë, deri disa hektarë. Ka edhe rrëshqitje të përmasave të mëdha. Të gjitha vendosen në shkëmbinjtë paleozoikë. Trupi i rrëshqitur ka kapur dhe shkëmbinjtë rrënjësorë, kryesisht shiste gri e të zeza.

Erozioni anësor i shkaktuar nga lumi i Veleshicës ka ndikuar e ndikon në lëvizjen e trupit të rrëshqitur. Kemi dhe rrëshqitje të masave deluvionale për shkak të gërmimeve si në Vranisht etj. Janë rreshqitje me dimensione të vogla.

Rrëzimet. Ndodhin në zonën malore atje ku pjerrësia e shpatit i kalon 40 gradë, dhe ku kemi vendosje të shkëmbinjve më të fortë mbi ata më të bute në profilin e shpatit. Në territorin e Kukësit zakonisht takohen në shpatet e ndërtuara nga shkëmbinjtë karbonatikë.

Shembjet. (Ose të ashtuquajturat subsidenca). Përputhen me zonat minerare të braktisura. Klasifikohen si fenomene rreziku më kërcënuese se të gjithë elementët e tjerë të rrezikut gjeologjik. Kanë ndodhur dhe rrezikojnë të ndodhin në fushat minerare, tashmë të mbyllura, etj. Tipike në Kukës është ish-miniera e bakrit në Gjegjan. Por ndodh dhe në shpate shumë të pjerret (kanione) si në gëlqerorët e Fshatit (perroi Buzmadhes).



Fig. 24. Panna e pjesës së sipërme të rrëshqitjes Gashicë (Opojë).



Fig. 25. Panna e pjesës së poshtme të rrëshqitjes Gashicë (Opojë) dhe aksidentimi i sipërfaqes së sipërme të përbërjes.

Vatrat e erozionit. Është fenomeni më i përhapur në territorin e Bashkisë së Krumës. Zhvillohet në territore me formacione dherore e të buta eluvionale deluvionale, të zhveshura nga pyjet e me pjerrësi. Përgjithesisht takohet dhe në ish-tokat bujqësore të lëna djerrë dhe të parikuperuara me bimësi. Erozioni shfaqet në formën e dy tipeve kryesore: erozion sipërfaqësor dhe erozion fundor. Në sipërfaqe të pambuluara me bimësi është me i zhvilluar erozioni sipërfaqësor, por që me kalimin e kohës ai shndërrohet dhe në erozion fundor, duke aksidentuar sipërfaqen.



Fig. - 76 Pamje e pjesës së mesme të rrëshqitjes (Opoje) dhe pjesës së poshtme (Cena) të këtyre rrëshqitjeve.



Fig. - 77 Pamje e rrëshqitjes Zall-Kalis (Kukës) **Fig. - 78** Shtrati i lumit të Veleshicës



Fig. - 79 Pamje e rrëshqitjes së Vranishtit (Has).

Shtretërit e lumenjve. Janë trajtuar si fenomene rreziku gjeologjik për vetë natyrën e tyre të paqëndrueshme. Kjo natyrë rrjedh nga dy aspekte: 1. Përbërja litologjike; dhe 2. Prezenca e lartë e ujrave rrjedhës sipërfaqësorë, të cilët kanë energji që varet nga stadi i zhvillimit të lumit dhe nga sasia e rreshjeve që bie në territor. Këto zona (shtretërit e lumenjve) përbëjnë rrezik për veprat inxhinierike të ndertuara mbi to, por në raste të veprave rrugore ato kalohen me ura, të cilat ndodhen nën kërcënim të vazhdueshëm të këtij



Fig.-80 Pamje e rrëzimit të gurëve (Fshat).



Fig. - 81 Pamje e shembjes së blloqeve shkëmbore në Fshat (përroi i Buzmadhes). Ka raste kur fenomeni i rrëshqitjes shoqërohet dhe me shembje të masave shkëmbore elementi rreziku.

Kone depozitimi. Janë trajtuar si fenomene rreziku dhe janë konturuar në territorin e qarkut dy tipe konesh depozitimi: deluviale dhe proluviale. E përbashkëta e tyre është grumbullimi në territore jo shumë të gjera i coprave me rumbullakim të keq, të cilat shpesh ndodhen në kufijtë e ekuilibrit natyror, i cili mund të priset nga çasti në çast (në përgjithësi jo të hartografuara).



Fig. - 82 Erozion në Nikoliq (mbi rrugën Krumë-Golaj).

Tërmetet - Janë rreziqe permanente ndaj veprave inxhinierike, për faktin se janë goditje dhe lëvizje të menjëhershme dhe me energji të lartë të tokës mbi themelet e objekteve inxhinierike.

4.43 ZONIMI I TERRITORIT MBI BAZËN E KUSHTEVE GJEOLOGO – INXHINIERIKE DHE PREZENCËS SË FENOMENEVE TË RREZIKUT GJEOLOGJIK

Për kryerjen e zonimit të territorit të Bashkisë së Krumës është patur parasysh që në përputhje me shkallën e hartës, të jepen të dhëna të trojeve të ndryshme dhe përshtatshmërisë së tyre ndaj ndërtimeve që kryhen mbi to, nëpërmjet vetive të tyre gjeoteknike (sipas klasifikimeve dhe për analogji), si dhe të dhëna për ekspozimin e këtyre trojeve ndaj elementëve të rrezikut gjeologjik. Pra bëhet një kombinim i të dhënave që disponohen për territorin, duke e ndarë atë në zona, nënzona dhe sektorë, të cilët në vetvete kanë kushte të përafërta gjeologo-inxhinierike dhe që janë të ekspozuar ndaj rrezikut gjeologjik në shkallë të caktuar. Për ndërtimin e hartës së zonimit të territorit për përshtatshmërinë ndërtuese që kanë trojet në të, janë marre në konsideratë 3 kritere: Kriteri litologo – gjeologo – inxhinierik; Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik; Kriteri morfologjik. Duke u bazuar në kriterin litologo – gjeologo - inxhinierik, territori ndahet në këto zona:

- I – Zona e përhapjes së shkëmbinjve të forte, në hartë paraqitet me vija horizontale.
- II – Zona e përhapjes së shkëmbinjve mesatarë, në hartë paraqitet me vija vertikale.
- III – Zona e përhapjes së shkëmbinjve të dobët, në hartë paraqitet me kombinim të vijave horizontale dhe atyre vertikale.
- IV – Zona e përhapjes së dherave pa kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta majtas.
- V – Zona e përhapjes së dherave me kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta djathtas.

Është e vështirë dhe pothuajse e pamundur të konturohen zonat me veçori të veçanta, pasi zonat janë mjaft të komplikuar si nga ana e ndërtimit gjeologo-litologjik e tektonik, ashtu edhe morfologjik. Këto zonime janë mesatarizuese. Brenda tyre ekzistojnë sipërfaqe apo zona që nuk përshtaten me tërësinë.

Duke patur parasysh lidhjen ose jo të elementeve të rrezikut gjeologjik me kriterin morfologjik, elementët e rrezikut gjeologjik i kemi ndarë në dy grupe:

Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik mund të jetë i lidhur me kriterin morfologjik, dhe lidhja e tyre është organike dhe e pandashme, ose mund të mos jetë i lidhur me të. Duke patur parasysh lidhjen ose jo të elementëve të rrezikut gjeologjik me kriterin morfologjik, elementët e rrezikut gjeologjik i kemi ndarë në dy grupe:

1) Rrezikun që vjen nga aktiviteti tektonik në rajonin e studimit, gjë që reflektohet me sasinë dhe intensitetin e tërmeteve që ndodhin në territor, pavarësisht nga kushtet gjeologo-inxhinierike të trojeve të ndërtimit. Bazuar në këtë kriter territori është ndarë në 2 nënzona:

- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet 7 ballë


- Nënzona ku ndodhin tërmete me intensitet 8 ballë

2) Rrezikun që vjen nga fenomenet gjeodinamike të shpateve. Është gama tjetër e fenomeneve të rrezikut gjeologjik të marra në konsideratë, të cilat lidhen ngushtësisht me ndarjet e sektorëve me bazë kriterin morfologjik. Duke patur parasysh edhe shkallën e hartës 1:100000, dhe për pasojë edhe detajimet që mundëson kjo shkallë, territori është ndarë në tre sektorë, pavarësisht ndarjes në zona dhe nënzona të përshkruara më lart. Këta sektorë janë:

a - Sektori pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, këtu futen kryesisht zonat e rrafshëta të lartësive të vogla apo të mëdha (rrafshi i Kukësit, Hasit, Tropojës, si dhe bjeshkët e Kukësit etj.). Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, duhet të jenë të thjeshta dhe të marin në konsideratë vetëm vlerësimin e parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës.

b - Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket njësisë kodrinore dhe malore, por që në të nuk gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të verdhë, duke zënë pjesën më të madhe të territorit të qarkut. Ndërtimet që bëhen në këtë sektor (me përjashtim të zonave afër përrenjve) për momentin janë të pacënuara, por që në të ardhmen, si rezultat i prishjes së ekuilibrit të shpatit, apo avancimit të zonave nën erozion, pjesë të këtij sektori mund të klasifikohen si sektor me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik. Studimet gjeologo – inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës, duhet të japin të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund t'i kërcënojnë këto ndërtime, si dhe të rekomandojnë edhe masat mbrojtëse përkatëse, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.

c - Sektori me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, i cili i përket zonave me pjerrësi të madhe të shpateve e me erozion aktiv, njësisë kodrinore dhe malore, por që në të gjejnë përhapje të madhe fenomenet e rrezikut gjeologjik. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të kuqe. Në hartë, pjesë e këtij sektori, janë konturuar sipërfaqet e rrëshqitjeve të ndodhura e të njohura deri tani, zonat e shembjeve (subsidence) në fushat minerare të shfrytëzuara, si dhe sipërfaqet e zonave nën erozion. Duke patur parasysh dinamikën e shpateve, ky sektor tenton të rritet dhe të fitojë sipërfaqe të reja nga



sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik. Në këta sektorë parimi i përgjithshëm është se nuk duhet të ndërtohet, por nëse është e nevojshme, atëherë studimi gjeologo-inxhinierik duhet të jetë shumë i thelluar, ku të jepen të dhëna për atë çka ka ndodhur dhe të llogariten mire efikasiteti i masave mbrojtëse që mund të rekomandohen.

4.44 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Në territorin e Bashkisë së Krumës, gjejnë përhapje shkëmbinj dhe dhera me litologji të ndryshme, të moshave nga Ordoviku e deri në Kuarternar. Këta shkëmbinj dhe dhera i përkasin zonave tektoniko-faciale të Korabit, Mirditës, Gashit, Krasta Cukalit dhe Alpeve Shqiptare.
2. Përbërësit litologjikë të trojeve të Bashkisë së Krumës i kemi klasifikuar në shkëmbinj dhe në dhera. Shkëmbinjtë i kemi klasifikuar si të fortë, mesatarë dhe të butë, duke patur si kriter rezistencën në shtypje një boshtore mbi ta. Kurse dherat i kemi klasifikuar si me kohezion, pa kohezion, kjo duke patur parasysh forcat lidhëse kohezionale midis kokrrizave përbërëse të tyre.
3. Në territor gjejnë përhapje njësitë morfologjike: Reliev i lartë malor (pllaja të larta malore, kuote 1700-2500 m. Reliev i lartë malor i karstifikuar me lartësi 1800-2400 m. Reliev malor me lartësi të ulët. Karakterizohet nga një sipërfaqe mjaft e eroduar me lugina të tipit "V" me faqe me pjerrësi mesatare (400-600 m). Rrafshnalta të karstifikuara me lartësi mesatare. Lartësi 100-1400 m. Depresionet e Neogjen-Kuarternarit. Luginat e lumenjve.
4. Vetitë fiziko-mekanike të përbërësve litologjike jepen në mënyrë të plote duke treguar limitet minimale e maksimale të tyre.
5. Zonimi i territorit për përshtatshmerinë ndërtuese, merr në konsideratë 3 kritere kryesore: a) kriteri litologjik – gjeologjik – inxhinierik; b) kriterin e ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik dhe c) kriterin morfologjik. Si kriter ndihmës është përdorur edhe ai morfologjik dhe ai sizmik.


4.45 REKOMANDIME


1. Ky studim shërben për planifikuesit urbane, për të zgjedhur dhe orientuar punimet e ndërtimit në territorin e qarkut Kukës.
2. Vetitë fiziko-mekanike të përbërësve litologjikë, të treguara në këtë tekst, nuk duhet të shfrytëzohen për llogaritje të ndërtimeve të veçanta në çfarëdo pjesë të territorit të qarkut Kukës.
3. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet në sektorin pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, duhet të jenë të thjeshta dhe të marrin në konsideratë vlerësimin e parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës.
4. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet në sektorin me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës, duhet të japin të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund t'i kërcënojnë këto ndërtime, si dhe të rekomandojnë edhe masat mbrojtëse përkatëse, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.



5. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen në sektorin me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik duhet të jenë shumë të thelluara, ku të jepen të dhëna për atë çka ka ndodhur dhe të llogariten mirë efikasiteti i masave mbrojtëse që mund të rekomandohen.

6. Është e domosdoshme që gjeologu inxhinierik duhet të jete prezent në çdo mbledhje të këshillit të qarkut, kur shqyrtohen dhe merren vendime të kerkesave për zhvillim urban, të të gjitha niveleve dhe llojeve apo specifikave të ndryshme. Kjo zgjidhet duke i detyruar keshillat e qarqeve që të dërgojnë kërkesën për pjesëmarrje të specialistëve gjeologë, dhe të njoftojnë për datën e mbledhjeve të tyre pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.





SHPJEGUESI

Klasifikimi gjeologjiko-litologjiko-inzhinierik i shkëmbinjëve dhe dherave

- | | |
|---|---|
| Shkëmbinj të fortë | Shkëmbinj mesatar |
| lu Magmatike intruzive, ultrabazike | Mrk Molasa ranoro-konglomeratike |
| lb Magmatike intruzive, bazike | M Shkëmbinj të dobët |
| lma Magmatike intruzive, mesatare acid | MS Serpentinite, millionite |
| Eb Magmatike efuzive, bazike | |
| Rm Metamorlike rreshpore | |
| Q Gëlqerore | |
| Gai Gëlqerore silicore | |
| B Brekcie dhe konglomerate me forteshi të ndryshme | |



SHPJEGUESI











-  Zona I - Shkëmbinj të fortë
-  Zona II - Shkëmbinj mesatar
-  Zona III - Dhera pa kohesion
-  Zona IV - Dhera me kohesion
-  Zona V - Dhera me velli të veçanta
-  SEKTORI a - Pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik
-  SEKTORI b - Me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik
-  SEKTORI c - Me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik
-  NZONA 1 - Termale 7 ballë
-  NZONA 2 - Termale 8 ballë

Fig. 83- Harta e zonimit për përshtatshmërinë ndërtuese të trojeve, Hasi

4.46 ASPEKTE GJEOMJEDISORE TË BASHKISË HASIT

Gjeoresurset minerale në Qarkun e Kukësit sipas grupimeve përkatëse

Sipas grupimeve të pasurive minerale të vendit tonë, në Qarkun e Kukësit në kemi të përhapura minerale metalore, minerale dhe shkëmbinj industrial dhe lëndë të para energjetike (pra tre grupe) si më poshtë:

Mineralet metalore

1. Ari
2. Bakri
3. Boksitet
4. Hekuri
5. Hekur – Nikeli
6. Kromi
7. Platini
8. Polimetalet
9. Uraniumi

Mineralet dhe shkëmbinjtë industriale

1. Argjila
2. Asbest
3. Bazalte
4. Bojra dheu
5. Dolomite
6. Gëlqerorë
7. Granite dhe feldshpate
8. Gurë dekorative
9. Inerte lumore
10. Kuarci
11. Olivinite
12. Shkrifëtime

Lëndët e para energjetike

1. Qymyret

Mineralet metalore

Ari

Të dhëna të treguesve fizik dhe mineralogjikë

Në rajonin e Hasit e Shëmërisë vlerësimi i armbajtës duhet të vazhdoj në objektet e vendburimet e bakrit si dhe në daljet e damarëve kuarcor pa mineralizime bakri. * Në mineralizimet e bakrit të lidhura me vullkanogjeno – sedimentar duhen bërë vlerësime paralel me mineralizimet e bakrit.

Bakri

Të dhëna të përgjithshme



Vendburimi i bakrit Golaj

Vendoset në pjesën qendrore - perëndimore të Hasit në Bashkinë Has. Punimet gjeologjike në këtë vendburim kanë filluar pas viteve 60, në vitin 1978 ka filluar hapja e minierës së Golajt me punim vertikal Pus. Miniera ka filluar prodhimin në vitin 1986 dhe ka punuar deri në vitin 1993. Gjatë kësaj periudhe janë prodhuar gjithsej 138 000 tone mineral bakri me cilësi mesatare në dalje 0.54 %Cu. Klima është kryesisht kontinentale me vere të nxehte dhe dimër të ftohte, karakteristike për vendet malore. Për këtë vendburim ka Raporte gjeologjike me llogaritje rezervash dhe kopje të cilit ndodhen në AQGJ – Tiranë.




Fig. - 84 HARTA E PASURIVE MINERALE, BASHKIA KRUMË

4.47 MINERALIZIMET SULFURE TË TJERA NË QARKUN E KUKËSIT

Po në rajonin e Hasit duhet të kushtohet një vëmendje e madhe vlerësimit të mineralizimeve të bakrit në sektorët e Helshanit me punime bashkëkohore komplekse në drejtim të thellësisë. Edhe në rajonin e Shemërisë duhet të punohet për shtimin e rezervave të mineralizimeve të bakrit në sektorët e njohur dhe ata të rinj.

Tab.- Tabela e vb dhe e shfaqjeve të mineralizuara për mineralin e bakrit



Nr.	Nr. i B në hartë	Vb ose shfaqja e mineralizuar	Bashkia	Rezervat gjeologjike 000/ton	Përmbajtja e komponentëve në %				Perspektiva
					Cu	Zn	Co	S	
15	200	Krumë	Has	201	3				Hapur




Fig. - 85 HARTA E PASURIVE MINERALE, QARKU KUKËS

- Zona ne studime, Bashkia Krumë

Hekur - Nikeli

Të dhëna të përgjithshme: Hekuri ka simbolin kimik Fe. Ai është mjaft i përhapur në koren e tokës dhe përbën 4. 2 - 5% të përmbajtjes mesatare të saj. Njoftimet e para për hekurin janë takuar në shkrifërimet e vjetra Egjiptiane që i përkasin periudhës afërsisht 4000 vjet para erës sonë. Ai në atë kohë çmohej si një send i rrallë sepse nxirrej nga meteoritët Hekuri është një metal i butë me shkëlqim të argjendtë dhe shpejt korrodohet sepse reagon ndaj oksigjenit. Temperatura e shkrirjes është rreth 1535 °C. Temperatura e vlimit është rreth 2880 0 C. Pesha atomike është rreth 55. 85. Hekuri mund tu nënshtrohet deformimeve plastike si në gjendje të shkrirë ashtu dhe të nxire.

Inertet lumore



Të dhëna të përgjithshme: Studime gjeologjike dhe vlerësime për inertet lumore janë kryer në të gjithë lumenjtë e rajonit tonë, duke kryer studime më të detajuara, kryesisht në rrjedhjet e poshtme të tyre dhe në lumenjtë afër qendrave të mëdha urbane si në rrjedhjen e poshtme të lumit të Valbonës, Lumit të Tropojës, Grykës së Vanave, Lumit të Drinit të Zi, Rajonit të Lumit të Kalimashit dhe të rajonit të Shemërisë. Të gjithë lumenjtë e studiuar rrjedhin nga veriu dhe lindja në perëndim dhe jube duke ndërprere pothuajse të gjitha zonat tektonike, duke ndërprerë si formacionet karbonatike, ato ofiolitike dhe terrigjene. Lënda inerte e shtretërve të lumenjve (rërë dhe zhavorr) përbën një pasuri të madhe si lëndë e parë ndërtimi. Si e tillë, ajo është studiuar e vlerësuar pothuajse në të gjithë shtretërit e lumenjve, për tu shfrytëzuar me kriter, pa prishur ekuilibrat mjedisore dhe pa shkaktuar dëme në ekonomi. Deri në vitet 1991-2010 shfrytëzimi i kryer në shtretërit e këtyre lumenjve nuk shkaktoi dëme në mjedis dhe ekonomi, sepse edhe në lumenjtë afër qendrës më të madhe të si B.Curri, Kukësi, Kruma etj, shfrytëzimi vjetor nuk i kalonte sasinë e prurjeve vjetore.

Disa të dhëna për inertet lumore në rajonin tone sipas baseneve: Baseni i Drinit: Në këtë basen janë bërë studime dhe vlerësime në mbi 10 objekte të inerteve lumore, si në Dezdar në rajonin e Tropojës, në Aste të lumit të Tropojës, në Dunishe - Llugaj po në rajonin e Lumit të Tropojës, në rajonin e Lumenjve e përrenjve të Shemërisë, në rajonet e Lumenjve të Kalimashit, në lumenjtë e luginës së Drinit të Zi, në sektorët e grykës së Vanave e të tjerë. Moshë e këtyre inerteve është kuaternare dhe me forma morfologjike shtresore dhe thjerrëzore, me shtrirje nga 1 km deri në mbi 3.50 km, ku gjerësia lëviz sipas objekteve nga dhjetëra metra deri në mbi 200 m e janë me trashësi nga 2 m, deri në mbi 10 m. Ngjyra në tërësi e këtyre inerteve është gri, me peshë volumore rreth 1.7 t/m³. Me përbërje granulometrike: për fraksionin 10-100 mm, kemi përmbajtje nga 17% deri në 67 % sipas objekteve, për fraksionin 1-10 mm, kemi përmbajtje nga 7 %, deri në 49 % sipas objekteve, për fraksionin 1-10 mm (rërën), kemi përmbajtje nga 21%, deri në 69% sipas objekteve.

Shfrytëzimi i inerteve pa dëmtime mjedisore synon në: në zbutjen e përmytjeve, në menaxhimin më të mirë të shtratit dhe kanalit, në mbrojtjen e veprave inxhinierike, për drejtimin e rrjedhjes ujore në anët e brendshme të rrjedhjes dhe në ato sektorë ku nuk krijohen shqetësime dhe probleme mjedisore dhe ambientale, (Bakallbashi J. etj.-2005, Leka Gj. etj.- 2009)..

Përfundime dhe rekomandime:

- Inertet lumore në rajonin tone janë të zhvilluara sipas lumit Drin, në të kaluaren ka pasur disa sektorë që kishin interes për shfrytëzim nga Tropoja, Hasi e deri në Kukës. Me ndërtimin e Hidrocentralit të Fierzes këto inerte pothuajse u kufizuan në maksimum.
- Inerte lumore ka të vlerësuara vetëm në rajonin e Tropojës (Gri, Dezdar, Aste, Llugaj etj.).
- Në të tre rrethet Tropojë – Has – Kukës në kemi inerte lumore vetëm në rrjedhjen e sipërme të degëve të lumit Drin, ku material inert është pothuajse i papërpunuar dhe gjysme i ashpër.
- Nisur nga efektet mjedisore rekomandojmë ndalimin e shfrytëzimit të inerteve lumore në të gjithë territorin e Qarkut të Kukësi.



Shkrifërimet

Të dhëna të përgjithshme: Shkrifërimet paraqesin në vetvete material të shkrifet: rëra e zhavorre, si dhe analoget e tyre të çimentuar: ranorë, konglomerate, etj, në përbërjen e të cilave marrin pjesë minerale si dhe kristale të dobishme me vlera ekonomike. Mineralet që ndeshen në shkrifërimet janë të qëndrueshme kundrejt proceseve të erozionit, prandaj janë të grumbulluara në rëra apo ranor, duke e pasuruar atë. Quhen shkrifërimet, sepse kokrrizat e rërës nuk janë të lidhura ose të çimentuara me njëra-tjetrën. Mirëpo shpesh herë rërat kanë në përbërjen e tyre një kompleks mineralësh me vlerë, si minerale titani, zirkoni, të granateve, të volframit, të monacitit, të diamanteve, të arit, të platinit, etj. Të tilla rëra quhen vendburime të shkrifërimëve.

Disa të dhëna të përbërjes mineralogjike: Mineralet që takohen më shpesh në shkrifërimet janë: rutili, ilmeniti, sfeni, titanomagnetiti, leukokseni, granatet (almandin, androdit, grosular, spesartit, etj).

Mineralizimet e shkrifërimëve në Qarkun e Kukësit: Në rajonin e Qarkut të Kukësit takohen mineralizime të shkrifërimëve, kryesisht në zonën tektonike të Korabit, të cilat i përkasin moshës të Ordovikianit, si dhe shenja të zbehta në depozitimet e Verfianit (seria "Luma Verrucano").

Shkrifërimet e moshës së Ordovikian –Devonian: Shkrifërimet të kësaj moshe janë takuar në rajonin e Shishtavecit, të cilat lokalizohen në ranorët e metamorfizuar, në forma morfologjike thjerrëzore me përmasa të ndryshme. Përbërësit mineralë kryesorë janë: ilmeniti, zirkoni e rutili, që shoqërohen edhe me minerale dytësorë. Shkrifërimet kanë teksturë brezore dhe strukturë uniforme, ku varfërimi i tyre në drejtimet anësore është gradual. Gjenezja e tyre është sedimentare, të formuara në kushte bregdetare, ku gjatë këtij procesi është bërë fraksionimi i mineraleve sipas peshës specifike të tyre (Leka Gj. etj.- 2009).

Rekomandime:

- Rekomandojmë që të vazhdohet me punime studimore dhe atyre të kërkim – zbulimit në objektin e Shtrezes (Shishtavec). (Leka Gj. etj.- 2009).
- Në punimet kërkimore dhe atyre studimore në objektin e shkrifërimëve të Shtrezit të bëhen dhe vlerësime për minerale të rëndësishëm si: zirkoni, titanomagnetitet, monaciti etj.


4.48 POPULLSIA

Analiza demografike është baza mbi të cilën mbështeten të gjitha elementet planifikuese të planit të përgjithshëm vendor. Duke pasur parasysh të gjitha zhvillimet demografike, lëvizjet e mëdha migratore të 20-25 viteve të fundit, është shumë e rëndësishme një analizë e thelluar në këtë aspekt. Në ndryshimin e numrit të popullsisë së tij kanë ndikuar një sërë faktorësh ndër të cilët veçojmë:

- pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore jo shumë të favorshme. Territori i izoluar larg qendrave të zhvilluara, si pasojë e pozitës gjeografike, u ndje pas vitit 1913 atëherë kur rajoni u nda në dy shtete;

- faktorët politikë, socialë, historikë dhe ekonomikë të periudhave të ndryshme. Izolimi total në vitin 1949 ndërpreu të gjitha marrëdhëniet mes dy pjesëve të rajonit paralelisht me ardhjen e kolonëve serbë në Hasin e Rrafshit, etj.;
- nivelin shumë të ulët ekonomik dhe të ardhurat jo të mjaftueshme në këtë rajon duke e kthyer atë në një nga rajonet më të varfra.

Periudha e viteve 1945-1989, u shoqërua me rritje të konsiderueshme të numrit të popullsisë. Në pjesën e Hasit të Shqipërisë popullsia është rritur me 15.881 banorë. Duke analizuar popullsinë e Hasit të Shqipërisë në nivel bashkie, shohim se njësia administrative Gjinaj krahasuar me atë të Golajve, Fajzave dhe qytetit të Krumës, ka rënie të ndjeshme të popullsisë. Kjo, sepse fshatrat e kësaj njësie administrative (Kishaj, Mujaj, Gjinaj) u braktisën masivisht. Kushtet e vështira natyrore si relievi i thyer, klima e ashpër, sidomos gjatë stinës së dimrit, tokat e varfra dhe të papërshtatshme për bujqësinë, lënia "pas dore" nga ana e shtetit e këtyre fshatrave, etj. Drejtuan banorët drejt kësaj braktisjeje. Edhe pse në qytetin e Krumës vërehet një rritje e popullsisë për shkak të kushteve më të mira të jetesës dhe afërsisë me institucionet shëndetësore dhe edukative, në njësitë administrative Fajzë dhe Gjinaj popullsia vazhdon të pakësohet, përkatësisht me 54 dhe 205 banorë respektivisht. Rritja e popullsisë në këtë rajon shoqërohet nga disa faktorë. Banorët kanë krijuar bindjen se në rajonin e Hasit mund të jetohej njësoj si në çdo rajon tjetër të vendit. Krijimi i aktiviteteve fitimprurëse, kryesisht në sektorin e shërbimeve, në bizneset e vogla dhe të mesme, zhvillimi i blegtorisë dhe i bletarisë, mbledhja e bimëve medicinale, etj., janë disa nga mënyrat që banorët kanë zgjedhur për t'iu përshtatur jetesës së tyre. Nga ana tjetër rikrijimi i lidhjeve tradicionale me Kosovën, pas përfundimit të luftës dhe shpalljes së saj shtet të pavarur, ka rritur shkëmbimet tregtare dhe njerëzve, duke ofruar shërbime shëndetësore, arsimore dhe mundësi punësimi. Duhet të përmendim se largësia e rajonit nga qendrat e mëdha urbane si Tirana, Durrësi apo Shkodra i ka favorizuar së tepërmi këto shkëmbime dhe shërbime.



Vlera e dendësisë së popullsisë për Hasin e Shqipërisë ka ndryshuar vazhdimisht ndër vite. Si rrjedhojë e rritjes së popullsisë vëmë re këto shifra: në vitin 1927 ishte 15 b/km² ; në vitin 1969 mori vlerat 20.8 b/km² ndërsa në vitin 1989 arriti vlera të larta 55.6 b/km² . Po në këtë vit dendësia e popullsisë u rrit 2.6 herë më shumë ndërsa në vitin 2001 vlerat e dendësisë së popullsisë pësuan rënie në 49.8 b/km² . Kjo rënie vazhdoi dhe gjatë vitit 2011 me 42.7 b/km² , si rezultat i reduktimit të numrit të popullsisë për shkak të migrimit të saj drejt qyteteve të mëdha të ultësirës perëndimore dhe jashtë vendit. Dendësia mesatare për vitin 2011, prej 42.7 b/km² , është 2.2 herë më e vogël se dendësia e përgjithshme e popullsisë së vendit tonë, prej 98 b/km²

Mjedisi Socio-Ekonomik

Mbrojtja shoqërore dhe varfëria

Ndihma Ekonomike përbën një nga programet e Mbrojtjes Sociale, që jepet në formën e një pagese mujore në para për familjet dhe individët që kanë më shumë nevojë për mbështetje nga shteti. Po sipas të dhënave që ka bashkia, aktualisht, rezulton se përftojnë ndihmë ekonomike 1114 familje nga 3791 familje që ka gjithsej bashkia, ose 30% e tyre. Niveli i ndihmës ekonomike është relativisht i ulët dhe mesatarisht shkon tek 2800-3000 Lekë/muaj. Ndërsa pagesën e paaftësisë e përftojnë 379 individë. Me pagesë papunësie trajtohen aktualisht 380 persona që kanë mbetur papunë në vitin 2015 si rezultat i shkurtimeve për shkak të reformave apo situatës ekonomiko-financiare të kompanive.



Sfidat lidhur me skemën e Ndihmës Ekonomike

Një reformë e gjerë e skemave të NE-së dhe PAK-ut po ndodh me mbështetjen e Projektit për Modernizimin e Asistencës Sociale (PMAS) të Bankës Botërore. Lidhur me këtë skemë, Bashkitë do të kenë mundësi të krijojnë databasat e tyre për të gjithë qytetarët që trajtohen në skemën e ndihmës ekonomike dhe sociale. Hapi kryesor është evidentimi i familjeve sidomos në zonat e thella të njësisive administrative për të pasur një njohje të mirë të regjistrit të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike në të gjithë bashkinë. Krijimi i kësaj databaza dhe lidhja me shërbimet e tjera sociale mbetet një sfidë dhe një mundësi për të përmirësuar situatën sociale në bashki, punësimin, ri-integrimin social, dhe akses në shërbime të tjera të bashkisë. Kursimet nga ky fond i ndihmës ekonomike do të shërbejnë Bashkisë për investime të tjera në fushën sociale, krijimin e qendrave të shërbimeve sociale të specializuara.

Aftësia e kufizuar

“Pagesa e Aftësisë së Kufizuar” (PAK) është pjesë e programit të Mbrojtjes Sociale dhe shërben për të mbështetur njerëzit me aftësi të kufizuara dhe përmirësuar cilësinë e jetesës. Aktualisht PAK është

mekanizmi i vetëm për mbështetjen e tyre, pasi vlerësohen për nivelin e aftësisë së kufizuar nga komisionet mjeksore të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP). Shpenzimet për pagesat e aftësisë së kufizuar janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit dhe tashmë përbëjnë pjesën kryesore në shpenzimet e Mbrojtjes Sociale. Kjo është shkaktuar nga indeksimi i lartë i përfitimit dhe mbulimi i zgjeruar. Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me vlerësimin e kritereve të aftësisë së kufizuar, rishikimin e masës së pagesave të aftësisë së kufizuar në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane dhe riintegrimin e PAK-ut me shërbimet sociale dhe shëndetësore. Bashkia Hasi, duhet të planifikojë në të gjitha projektet e saj, si dhe investimet ndërhyrje për personat PAK, duke i siguruar barazi, modiskriminim, aksesueshmëri, autonomi, përfshirje etj.

Shërbimet e Kujdesit Shoqëror

Aktualisht ka mangësi në mbulimin e të gjithë nevojave për shërbime të grupeve vulnerabël në nivel kombëtar. Shërbimet të kujdesit shoqëror të specializuara janë siguruar nga organizatat jofitimprurëse e financuara në baza vullnetare ose nga partnerët. Shërbimet mund të gjenden kryesisht në zonat e mëdha urbane dhe shumë pak në zonat rurale. Ndryshe nga skemat e pagesave të NE dhe PAK, sfida këtu është ngritja e një sistemi shërbimesh të përkujdesit shoqëror që të mund mbulojë më gjerë nevojat e grupeve në nevojë për shërbime shoqërore të integruara dhe efikase. Sfidat e mëtejshme e Bashkisë mbetet njohja e nevojave për shërbime specifike, të oganizuara në qendra ofrimi shërbimesh, si në qytet dhe ne zona rurale si dhe plotësimi i tyre, duke ofruar dhe donacione të ndryshme për ti ofruar këto shërbime, ose bashkëpunime me shoqata te specializuara duke ju ofruar asete ne perdorim.

4.49 ANALIZA SWOT

ANALIZA E PIKAVE TË FORTA E TË DOBTA, SI DHE E MUNDËSIVE DHE KËRCËNIMEVE

Analiza SWOT është një analizë arsyetimësh të kontekstit territorial, mbi të cilin realizohet një program ndërhyrjesh. Qëllimi i analizës është përkufizimi i mundësive të zhvillimit të një territori apo të një fushe, që vijnë nga vlerësimi i pikave të forta dhe nga kufizimi atyre të dobëta, duke shfrytëzuar mundësitë dhe duke paraprirë kërcënimeve të mundshme.

Tab.- Analiza Swot

Kompon	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta	Mundësitë	Kërcënimet
Territori dhe zhvillimi urban	Bashki me territor relativisht të madh, ku janë të përqëndruara burime minerare dhe pyjore;		Përcaktimi në PPK si hub logjistik	Largimi i përhershëm i popullatës vendase

	Zhvillim i mirë potencial i frutikuturës, kryesisht arrorë, blegtorisë dhe bletarisë;		Potencial i mirë për zhvillimin e përpunimin e prodhimeve të mësipërme – agrobiznesi
	Reforma TAR jep mundësi për më shumë fonde në drejtim të investimeve kapitale dhe publike	Mungesa e burimeve fnanciare, në përgjithësi, për bashkinë dhe atyre që burojnë nga të ardhurat e veta, në veçanti	Politika qeveritare (nga ministritë e linjës) në mbështetje të zhvillimit bujqësor, blegtoral dhe të agrobiznesit
	Zhvillim i territorit bazuar kryesisht në instrumenta planifikimi. Ndërtimet pas viteve '90 kanë një ndikim relativisht të moderuar në pamjen dhe strukturën urbane pasi fenomeni i zhvillimit jo të rregullt dhe informal ka qenë penguar në krahasim me qytete të tjera Shqiptare.	Zona industriale në periferinë e qytetit nuk është në veprimtari, duke u degraduar dhe shpesh objektet janë të braktisura.	
Mjedisi	Rezerva të mëdha pyjore brenda territorit administrativ	Dobësi në menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, spitalore, industriale	Ndotje e burimeve ujore nga dampat minerale
	Reliev i larmishëm	Dobësi në menaxhimin e ujërave të përdorura në Njësitë Administrative;	
		Nivele të larta erozioni	Shfrytëzimi pa kriter dhe në disa raste shkatërrimtar i pyjeve



		Rreziqe nga rrëshqitjet në zona të caktuara të territorit		
	Ekzistenca e zonave dhe mikrozonave të veçanta klimatike që krijon mundësi për diversitet prodhimi	Sisteme të amortizuara ose dëmtura të kullimit dhe vaditjes për tokën bujqësore;		Dominimi i tregut me prodhime bujqësore nga importi;
Bujqësia	Zona ka traditë të hershme në pemtari dhe vreshtari. Si pemë të veçuara mbillen qershia, kumbulla, molla, arra dhe gështenja (në brigjet e përrenjëve), mani, dardha dhe pjeshka	Nga analiza e treguesve të prodhimit bujqësor e blegtoral del se ato janë në nivelin e potencialeve prodhuese që ka zona		Dominimi i tregut me prodhime bujqësore nga importi;
Natyra	Pasuri natyrore të mëdha dhe potenciale alternative të energjisë së rinovueshme;			Moratoriumi mbi shfrytëzimin e pyjeve, mund të ketë një impakt ekonomik negativ
Infrastruktura dhe Transporti		Infrastrukturë inxhinierike e degraduar në shumë fshatra të Njësisë Administrative;		Rruga e kombit e ka nxjerrë bashkinë e Hasiit nga akset kryesore të mëparshme të komunikimit, Shkodër-Kukës dhe Tiranë-Tropojë
		Mungesa e shërbimeve efkase ndaj publikut, si furnizimi me ujë të pijshëm, trajtimi i ujrave të zeza dhe atyre të larta, trajtimi i mbetjeve, shërbimet sociale, etj		



	Ekzistenca e zonës funksionale Pukë – Hasit dhe mikrozonave për rreth liqenit të Komanit dhe atij të Fierzës ofrojnë mundësi bashkëpunimi dhe zhvillimi	Mungesa e një infrastrukture rrugore të përshtatshme, qoftë në qytet ashtu edhe në komunikimin me njësitë administrative	Pozicioni gjeografik kyç, në qendër të veriut të vendit, dhe mundësia e integritimit në sistemin e turizmit malor që është zhvilluar në zonën e Alpeve	Në kuadër të zhvillimeve rajonale, bashkia Fushë Arrës mund të shikohet si një bashki me peshë specifike më të ulët krahasuar me të tjerat në qarkun e Shkodrës. Kjo mund të reflektohet tek aksesimi ndaj fondeve të zhvillimit rajonal
Administ rata publike dhe banorët	Një staf relativisht të ri, energjik dhe të arsimuar në institucionin e bashkisë	Kopetenca dhe funksione të reja me infrastrukturë të dobët, pamjaftueshmëri financiare, burimesh njerëzore dhe informacioni.		Braktisja e qendrave të banimit në Njësitë Administrative
		Të rinj të arsimuar preferojnë qëndrimin në Tiranë dhe jashtë shtetit, duke privuar qytetin nga potencialet e zhvillimit në të ardhmen. Përqindje reativisht e lartë e papunësisë dhe raporti i lartë i emigrantëve ndaj popullsisë rezidente tregon për mungesë të mundësive të punësimit dhe një treg pune jo-dinamik.	Kthimi i emigrantëve (brenda apo jashtë vendit), qoftë edhe për periudha sezonale, krijon mundësi që ata të kontribuojnë në zhvillimin e bashkisë	Tendenca/ fryma e përgjithshme migratore, sidomos nga zonat e veriut të vendit



Turizmi	Mundësi për turizëm multidimensional		Pozicioni gjeografik kyç, në qendër të veriut të vendit, dhe mundësia e integritit në sistemin e turizmit	Qendërzimi i potencialeve turistike në rajonet kufitare konkurruese;
			malor që është zhvilluar në zonën e Alpeve	
Arsimi dhe Kultura	Tradita dhe karakteristikat e banorëve të zonës, si mikpritja, toleranca, ndihma reciproke ndaj njëri-tjetrit	Mungesa e organizimit të shoqërisë që vjen si rezultat i një lloji apatie të përgjithshme		
	Shpirti artistik dhe aktivitetet konkrete të popullit të zonës	Mungesa e infrastruktures kulturore dhe artistike		
Industria	Zonë e pasur minerare me bakër e gurë dekorativ;	Degradimi i industrisë së trashëguar duke sjellë emigrimin e forcave të kualifikuara punëtore. Menaxhimi i keq i burimeve minerare të bakrit nga shoqëritë private	Riaktivizimi i procesit të shfrytëzimit të minierave të bakrit që kanë ndalur aktivitetin	Konjunkturat e pafavorshme të çmimit të bakrit në tregun ndërkombëtar
		Impakti në mjedis i derdhjeve të fabrikës së pasurimit të bakrit në lumë		

4.50 PROJEKTET PILOTE

Projektet test janë propozuar me qëllim që të testojnë veçori të caktuara të zhvillimit nga prioritetet e bashkisë. Zhvillimi i tyre pritet të promovojë mënyrën e re të drejtimeve prioritare që do të marri bashkia, si nga pikëpamja investimit ashtu edhe nga pikëpamja e funksionalitetit. Bazuar tek vizioni si dhe tek objektivat strategjikë më poshtë listojmë nëpërmjet skedave teknike projektet që propozohen në bashkinë Hasitsi projekte pilot zhvillimi dhe politikat për zhvillimin e tyre.



Asfaltimi i aksit Dobrunë-Golaj (OS4)

Aksi Dobrunë-Golaj është ka një gjatësi prej 7.19 km dhe lidh Dobrunën me rrugën Interurbane dytësore të Krumë-Gjakovë Asfaltimi i aksit Dobrunë-Golaj ndihmon lëvizjen e banorëve të Dobrunës për të shkurtuar distancën kohore për tu lidhur me fshatin Golaj qendrën e bashkisë qytetin e Krumës dhe më pikën doganore.

Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës. Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me çakull .Rikonstrukcioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Dobrunë duke shkurtuar ndjeshëm distancën kohore duke lehtësuar marrjen e shërbimeve për banorët e Dobrunës. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave. Aksi rrugor i propozuar bashkohet në Golaj me Segmentin Rrugor Kombëtar (SH23)

Asfaltimi i aksit Nikoliq- Krumë (OS4)


Fshati Nikoliq ndodhet në veri të qytetit të Krumës në një distancë prej 2.5 km. Dhe pse në distancë të afërt me qytetin e Krumës rrjeti infrastrukturës rrugore nuk është në gjendje optimale duke sjell vështirësi në qarkullimin e banorëve të zonës .Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht pasi integron fshatin Nikoliq me qendrën e bashkisë së Hasit duke lehtësuar në mënyrë të ndjeshme aksesin në shërbime, infrastrukture etj por dhe duke ndihmuar Nikoliqin në thithjen e investimeve private. Rruga ndodhet në gjendje mesatare e shtruar me çakull .Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës ,ndërtimin e veprave ingjinerike ,krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave. Aksi prej 2.5 km shtrihet nga qendra e fshatit Zahrishtë dhe lidhet me segmentin Kombëtar (SH23).

Asfaltimi i aksit Kostur-Helshan- (SH23) Has-Tropojë (OS4)

Fshatrat Helshan dhe Kostur janë dy nga fshatrat kryesorë që ndodhen në veri të bashkisë Infrastrukura rrugore që lidh këto dy fshatra me segmentin kryesor (SH23) HasTropojë. Projekti kërkon asfaltimin e rrugës të fshatrave Helshan dhe Kostur dhe lidhjen e tyre me infrastrukturën rrugore ekzistuese të bashkisë Has. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe shkurton ndjeshëm kohën për banorët e fshatrave Kostur dhe Helshan. Rruga ndodhet në gjendje mesatare e shtruar me çakull. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës ,ndërtimin e veprave ingjinerike ,krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave. Aksi prej 6.9 km shtrihet nga qendra e fshatit Kostur më pas duke kaluar nga qendra e fshatit Helshan dhe përfundon duke u intersektuar me segmentin (SH23)

Rikonstrukcion i Shkollës Mesme Vlahen (OS6)

Shkolla e mesme në fshatin Vlahen është një shkollë që përdoret nga nxënësit e fshatit Vlahen dhe Gajrep. Gjendja ekzistuese e ndërtesës ndikon negativisht në procesin e mësimdhënies.Distanca e largët nga shkollat e mesme të tjera e lidhur bashkë me aksesin e dobët në infrastrukture dhe problematikat e bllokimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit. Kjo bën të nevojshme ndërhyrjen në përmirësimin e ndërtesës së shkollës. Shkolla Mesme Vlahën ndodhet në gjendje keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar



marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatrave Vlahën dhe Gajrep. Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës të shkollës.

Rikonstruksion i Shkollës 9-vjecare Helshan (OS6)

Shkolla 9-vjecare Helshan është një shkollë e rëndësishme pasi i shërben një popullsie relativisht të madhe dhe mbulon jo vetëm zonën e Helshanit por dhe në fshatrat përreth. Shkolla 9-vjecare e fshatit Helshan i shërben dhe fshatit Kostur duke rritur ndikimin që ky investim ka në zonë. Kjo e bën të rëndësishme ndërhyrjen për përmirësimin e infrastrukturës së ndërtesës të shkollës për të ofruar një shërbim më cilësor për nxënësit frekuentues të kësaj shkolle. Shkolla 9-vjecare Helshan ndodhet në gjendje keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatrave Helshan dhe Kostur. Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës të Shkollës.

Rikonstruksion i Shkollës 9-vjecare Fshat-Krumë. (OS6)

Fshat-Krumë është një nga fshatrat më të populluara të bashkisë Has dhe ndodhet në afërsi të qytetit të Krumës. Shkolla 9 vjecare e Fshat Krumë ka një rol të rëndësishëm pasi i shërben gjithë zonave në periferi të qytetit të Krumës .Kjo bën që standartet e shkollës të përmirësohen për të përmbushur standartet. Shkolla Fillore Berishë e Vogël ndodhet në gjendje mesatare sa sa i përket infrastrukturës duke kërkuar ndërhyrje minimale në përmirësimin e saj. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e Fshat Krume dhe lagjeve në periferi të qytetit të Krumës. Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës të Shkollës.

Rikonstruksion i Qendrës Shëndetësore Pusi i Thatë. (OS6)

Fshati Pus i Thatë ndodhet në pjesën jugore të rajonit të Hasit. Distanca e largët nga spitali i qytetit të Krumës dhe infrastruktura e dobët rrugore e cila vështirëson ofrimin e shërbimit shëndetësor ndikon negativisht në marrjen e këtij shërbimi për banorët e fshatit Pus i Thatë. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinë e dimrit ku aksesimi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë për banorët e fshatit Qendra Shëndetësore e fshatit Pus i Thatë ndodhet në gjendje të keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe Brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Pus i Thatë. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës të Qendrës Shëndetësore.

Rikonstruksion i Qendrës Shëndetësore Brenogë (OS6)

Fshati Brenogë ndodhet në pjesën jug - perëndimore të rajonit të Hasit. Qendra shëndetësore Brenogë i shërben fshatit Brenogë .Distanca e largët nga qendrat shëndetësorë kryesore dhe infrastruktura e dobët rrugore e cila vështirëson ofrimin e shërbimit shëndetësor ndikon negativisht në marrjen e këtij shërbimi



per banorët e fshatit Brenogë. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesimi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë. Qendra Shëndetësore e fshatit Brenogë ndodhet në gjendje mesatare sa i përket infrastrukturës duke përfshirë marrjen e shërbimit të plotë dhe Brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Brenogë . Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtësës të Qendrës Shëndetësore

Rikonstruksion i Qendrës Shëndetësore Vlahen (OS6)

Fshati Vlahen ndodhet në pjesën veri-lindore të rajonit të Hasit. Gjendja e keqe e infrastrukturës rrugore dhe e qendrës shëndetësore vështirëson marrjen e shërbimeve në bujqësi për banorët e fshatit Vlahen. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesimi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë .Qendra Shëndetësore e fshatit Vlahën ndodhet në gjendje mesatare sa i përket infrastrukturës duke përfshirë marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Vlahën. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtësës të Qendrës Shëndetësore.

Projekt pyllëzimi për mbrojtjen e pyjeve në bashkinë Has (3 Lote). (OS1)

Projekti synon të ripyllëzojë një sipërfaqe prej 3991 Ha e shpërndarë në 3 pjesë të ndryshme të territorit. Bashkia Has është një ndër bashkitë të cilat mbartin sipërfaqen më të madh të pyjeve në Shqipëri. Sistemi Natyror zë 87.4 % të sipërfaqes së bashkisë .Shfrytëzimi i pakontrolluar i sipërfaqes pyjore dhe djegia e tyre gjatë 28 viteve ka sjellë që një pjesë e madhe e sipërfaqes pyjore është dëmtuar duke sjellë dhe dëmtim të florës dhe faunës. Loti 1-përfshin sipërfaqe pyjore ndërmjet njësive administrative Golaj, Krumë, Fajzë midis fshatit Zgjec dhe Qarr, pjesa midis fshatit Helshan dhe Liqeni Kuq dhe ka një sipërfaqe prej 559.8 Ha. Loti 2- përfshin sipërfaqe pyjore në njësinë administrative Gjinaj në jug – lindje të bashkisë, në fshatrat midis Pusit të Thatë dhe Mujaj me sipërfaqe 1952,4 Ha. Loti 3- përfshin sipërfaqe në lindje të bashkisë Has, e cila shtrihet mes njësisë Golaj dhe Gjinaj, në hapësirën mes fshatrave Dobrunë, Gajrep dhe Çahan dhe ka një sipërfaqe prej 1488.8 Ha. Mbjellja e bimësisë dhe pemëve propozohet të jetë sipas llojeve që rriten aktualisht në Has si : pisha ,dushku dhe ahu.

Krijimi i markës Brand për produktet lokale të bashkisë Has. (OS3)

Bashkia Has duhet të promovojë produktet lokale për të rritur turizmin dhe eksportin e këtyre produkteve .Projekti ka si qëllim krijimin e një logoje të njëjtë për gjitha produktet lokale të bashkisë Has Brandimi i produkteve lokale nën të njëjtën logo ndihmon në rritjen e cilësisë të produktit dhe ruajtjen e standartit. Gjithashtu ndihmon në promovimin e produkteve lokale të Has dhe në zona tjera të Shqipërisë . Ky projekt synon krijimin e një logoje që mund të përdoret për gjitha produktet lokale të bashkisë Has



Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të qytetit Krumë (OS6)

Qyteti i Hasit një nga problemet kryesore në fushën e infrastrukturës është infrastruktura e kanalizimeve .Aktualisht ujërat e zeza janë të depozituara në gropa septike e cila shkakton ndotje të nëntokës dhe probleme mjedisore për bashkinë Has.Nisur nga kjo problematikë është e nevojshme ndërtimi i një rrjeti kanalizimesh prej 7.8 km në qytetin e Hasit për largimin e ujërave të zeza të qytetit. Ndërtimi i rrjetit të ujërave të zeza ndihmon në largimin e ujërave të zeza të qytetit duke rritur dhe cilësinë e mjedisit përreth. Ky projekt synon ndërtimin nga e para e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza për lagjet kryesore të qytetit të Hasit.

Ndërtimi i pikës për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve ushqimore vendase në Has (OS3)

Bashkia Has sikundër dhe shumica e bashkive në territorin e Shqipërisë kanë toka bujqësore të cilët i shfrytëzojnë privatisht dhe më sipërfaqë të vogla, pa bashkëpunuar më njëri tjetrin. Kjo si rezultat sjell dhe prodhim më të ulët dhe kosto më të larta për prodhimin e produkteve bujqësore. Kjo bën të nevojshme ngritjen e infrastrukturës magazinuese dhe përpunuese si mënyrë për të grumbulluar sasi më të larta prodhimi nga fermerët e bashkisë dhe përpunimi i tyre për të rritur vlerën e produktit. Sipas këtij projekti është e nevojshme ngritja e infrastrukturës së duhur në mënyrë dhe banorët dhe kryesisht fermerët të bashkëpunojmë mes tyre duke bashkuar njësitë e tyre të tokavë bujqësore dhe në këtë mënyrë të rrisin prodhimin me më pak kosto dhe cilësi më e lartë. Kjo do të bëjë që produktet lokale të Hasit të jenë konkurruese në treg. Ndërtimi i pikës grumbullimit ka pjesë ndërtimin e magazinës kryesore frigoferike të ruajtjes së produktit, sektorin e paketimit dhe të jetë e pajisur me logjistikën e duhur për ngarkim-shkarkimin e kamionëve transportues si dhe të godina të ndërtohet pranë zonës agroturistike në Golaj.

Ndërtimi i një ferme mbarështrimi në Fshatin Zgjec (OS3)

Bashkia Has në teritorin e saj ka sipërfaqe të ndryshme dedikuar kullotjes. Nga ana tjetër ajo është e zhvilluar nga ana blegtorale dhe do ndikojë pozitivisht në ndërtimin e fermës për të mbarështuar bagëtitë sipas kushteve të duhura. Krijimi i fermës në zonën e Zgjecit ku ka dhe më shumë sipërfaqe për kullotje do të sjellë dhe ma pak kosto dhe më shumë zhvillim për banorët dhe kujdesin ndaj baëtive të tyre. Projekti synon krijimin e fermës më një sipërfaqe prej 1500m dhe të ketë plotësuar kushtet që i duhen një ferme për mbarështrimin e gjesë. Ndërtimi saj do bëhet me materiale sa më të përshatshme dhe për zonën ku po zhvillohet duke ruajtur dhe karakteristikat e saj..

Hartimi i një plan Menaxhimi për rrugët lokale të Bashkisë Has (OS4)

Bashkia Has ka një rrjet rrugor me 749.2 km rrugë të kategorive të ndryshme ku mbizotërojnë rrugët lokale. Problematikat më të mëdha shfaqen gjatë periudhës së dimrit, për shkak të terrenit goxha të thyer dhe dëborës. Mirëpo kapacitetet e bashkisë nuk janë të mjaftueshmë për të mirëmbajtur rrugët e saj sidomos ato lokale në mënyrë që të ofrojë shërbimin e duhur. Bashkia Has ka nëvojë për një plan



menaxhimi që të mund të propozojë disa mënyra dhe skema në favor të saj, dhe më kosto sa më të ulët dhe për buxhetin e bashkisë dhe në të njëjtën kohë të ofrojë dhe shërbimin sipas standarteve.

Krijimi i Intinerarit lëvizës në hapësirat natyrore Golaj- Fajzë (OS2)

Krijimi i intinerarit përgjatë hapësirave natyrorë midis fshatrave Golaj dhe Fajzë do krijojë mundësinë e njohjes së natyrës së Hasit. Ky projekt njëkohësisht lidh dhe fshatin Golaj me Fajzën. Ky projekt rrit aksesin e turistëve në zonë duke ofruar një rrugë peizazhistike. Krijimi i intinerarit ofron mundësi për zhvillimin e turizmit pasi ofron akses në një hapësirë të pashfrytëzueshme deri tani për shkak të mungesës të infrastrukturës .Ky projekt synon krijimin e intinerarit lëviz në hapësirat natyrore dhe gjithashtu do jetë e plotësuar me sinjalistikën e duhur dhe përkatëse për shtigjet dhe zonat natyrore. Gjithashtu dhe krijimin e një harte turistike për zonën e Hasit.

Muzeum i Varrezave të dëshmorëve. (OS7)

Ky projekt synon tju japë prioritet varrezave të dëshmorëve dhe Hasi ka qenë një ndër përkrahësit kryesor ne Luftën e Kosovës dhe ka 42 dëshmorë nga të cilët 37 nga lufta e Kosovës. Si rezultat Hasi ka nevojë për një rikthim në histori e cila të trashëgohet dhe ndër breza.Varrezat e dëshmorëve në Has zënë një sipërfaqe të konsiderueshme dhe mirembajtja si dhe krijimi i disa kushteve sipas standarteve që të sjellë në vëmendje pikërisht histrinë dhe rënien e dëshmorëve për luftën e Kosovës. Nga ana tjetër kjo do të shërbejë dhe si pikë turistike për turistët për të njohur historinë dhe si ka ndodhur dhe lufta Kosovës.

Krijimi i një memorandum bashkëpunimi midis bashkisë Has dhe Komunë Gjakovë. (OS5)

Ky projekt synon të krijojë një bashkëpunim midis bashkisë Has dhe Gjakovë e cila do sjellë ndikim për të dyja palët. Bashkëpunimi ndërkuftar do ndikojë në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe atë turistik. Sikurse Hasi dhe Gjakova ofrojnë një larmi karakteristikash, si: natyrën e bukur, peisazhet spektakolare, traditat dhe folklori, vendet kulturore dhe historike të përshtatshme për aktivitete turistike dhe kulturore. Malet, parqet kombëtare, zonat e mbrojtura dhe pyjet e njohur për bukurinë e tyre mund të jetë me interes të madh për turistët dhe ofrojë mundësinë për të organizuar sporte dimërore dhe sporte në natyrë. Një memorandum midis të dy palëve do të ishte në interes si për Hasin dhe Gjakovën. Ky projekt synon bashkëpunimin ndërkuftar mes palëve duke rritur zhvillimin ekonomik, kulturor e turistik. Ky bashkëpunim lidhet më krijimin e disa politikave të përbashkëta për zhvillim. Sëbashku do të propozojnë projekte dhe kërkojnë investimet dhe zhvillimin mbi bazën e projekteve ndërkuftare IPA, duke thithur në këtë mënyrë dhe grantet për zhvillim.



SEKSIONI 5 - TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN

5.1 TOKA

Përdorimi i tokës bujqësore dhe pyjeve


Në qoftë se Plani nuk përshtatet, vëllimi i përdorimit aktual të tokës bujqësore dhe pyjeve do të mbetet në nivelin aktual. Infrastruktura përkatëse nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive; prandaj krijimi i kësaj infrastrukture mund të jetë i paplanifikuar, gjë e cila do të ketë një efekt negativ në përdorimin aktual të hapësirës, si dhe në vëllimin e përdorimit aktual tokës bujqësore dhe pyjeve.

Përdorimi i burimeve natyrore

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, infrastruktura përkatëse nuk do të ndërtohet apo modernizohet në mënyrë të tillë që dheu i gërmuar dhe mbetjet nga ndërtimet të trajtohen, në mënyrë që shumica e tyre të ripërdoret në një kantier ndërtimi të infrastrukturës apo të riciklohet në materiale ndërtimi. Ndërhyrjet infrastrukturore të paplanifikuara apo të rastit, pengojnë gjithashtu përdorimin e sasive të mëdha të materialeve të ndërtimit të prodhuara nga riciklimi i këtyre materialeve në kantieret e tjera të ndërtimit apo nga përpunimi i llojeve të tjera të mbetjeve të cilat përdoren për të prodhuar materiale ndërtimi të cilësisë së njëjtë me materialet e ndërtimit që merren direkt nga burimet natyrore.

5.2 AJRI

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, infrastruktura përkatëse, duke marrë parasysh rritjen e parashikuar të disa sektorëve specifikë, si transporti (veçanërisht ai rrugor) dhe industria, nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë që të eliminojë dyndjet dhe bllokimet në rrugë, të cilat pengojnë trafikun e qetë dhe me barrë më të vogël ndaj mjedisit apo të eliminojë shkarkimet e pakontrolluara në ajër prej impianteve industriale. Pavarësisht nga fakti se kontributi më i madh në arritjen e objektivit mjedisor në lidhje me tavanin e emetimeve të ndotësve nga ndërhyrjet infrastrukturore pritet të vijë nga sektori i transportit, dhe më konkretisht nga përdorimi i automjeteve me më shumë efikasitet energjetike, trafiku i ç'organizuar dhe kongjestuar i rrjetit rrugor zhbën të gjitha efektet e përdorimit të automjeteve të prodhuara në përputhje me standardet teknike. Pavarësisht automjeteve të përmirësuara teknikisht, bllokimet e trafikut në rrjetin rrugor dhe shpejtësia e udhëtimit, do të sillte si pasojë tejkalimin e maksimumit të emetimeve të ndotësve, sidomos të NOx dhe CO. Përmirësimi i cilësisë së ajrit të ambientit në zonat urbane dhe arritja e standardeve të përshkruara në lidhje me cilësinë e ajrit të ambientit janë objektivat kryesore të cilat bazohen në masat për mbrojtjen e mjedisit në Plan. Në qoftë se Plani nuk adaptohet, infrastruktura përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullohet dhe në këtë



mënyrë nuk do të mundësohet ulja e nivelit të emetimit të ndotësve që kontribuojnë në shfaqjen e grimcave PM10 dhe PM2,5. Kështu që nuk do të realizohet objektivi i përcaktuar mjedisor në lidhje me cilësinë e ajrit të deri në vitin 2020.

5.3 FAKTORËT KLIMATIKË

5.3.1 Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, zbatimi i masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike nuk do të trajtohet në mënyrë sistematike gjatë planifikimit dhe rregullimit. Theksi kryesor është vendosur në reduktimin e ndjeshmërisë ndaj përmbytjeve, borës dhe ngricave. Çdo ndërtim i ri apo rikonstruksion i infrastrukturës duhet të analizohet në lidhje me ndjeshmërinë e tij ndaj fenomeneve ekstreme të motit, ndërsa kostot financiare të dëmtimit të mundshëm të infrastrukturës duhet të vlerësohen paraprakisht. Bazuar në analizën e ndjeshmërisë së infrastrukturës ndaj fenomeneve ekstreme të motit, duhet të planifikohen masa të qëndrueshme për të reduktuar efektet negative të ndryshimeve klimatike në infrastrukturë në nivele ekonomikisht dhe shoqërisht të pranueshme. Në mungesë të politikave, investimeve në infrastruktura mbrojtëse dhe të manaxhimit të fragmentuar të burimeve natyrore në pellgjet ujëmbledhëse, do të kenë efekte negative si:

- (i) humbje në tokën bujqësore dhe në disa territore të banuara afër fushave;
- (ii) rritje e presionit ndaj qendrave urbane për strehim, punësim dhe infrastruktura;
- (iii) tendenca për të lëvizur më në thellësi të *hinterland*-it malor, por kushtet e vështira gjeografike dhe klimatike, si dhe mungesa e masave institucionale ndaj efekteve të ndryshimit klimatik, do të frenojnë dëshirën që këto zhvendosje të ndodhin në masë dhe të organizuara.

Si rezultat, zhvendosjet sporadike do të fragmentojnë më tej territorin, duke rrezikuar burimet më të vlefshme që do të pakësohen gjithnjë e më shumë. Njerëzit do të zgjedhin të vendosen në zonat më lehtësisht të arritshme dhe me burime më lehtësisht të vjelshme.

5.3.2 Masat Zbutëse ndaj Ndryshimeve Klimatike

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, infrastruktura përkatëse, duke marrë parasysh rritjen e parashikuar të disa sektorëve specifikë, si transporti (veçanërisht ai rrugor) dhe industria, nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë që të eliminojë dyndjet dhe bllokimet në rrugë, të cilat pengojnë trafikun e qetë dhe me barrë më të vogël ndaj mjedisit apo të eliminojë shkarkimet e pakontrolluara në ajër prej impianteve industriale. Zbatimi i masave për zbutjen e ndryshimeve klimatike, duke ulur emetimet e gazit serë në sektorët që mbulon Vendimi Nr. 406/2009/KE do të jetë dukshëm në rrezik. Edhe në rastin e emisioneve të gazrave me efekt serë, kontributi më i madh në arritjen e objektivit mjedisor në lidhje me tavanin e emetimeve të ndotësve nga ndërhyrjet infrastrukturore pritet të vijë nga sektori i transportit, dhe më konkretisht nga përdorimi i automjeteve me më shumë efikasitet energjetike.

Megjithatë, trafiku i çorganizuar dhe i kongjestuar i rrjetit rrugor zhbën të gjitha efektet e përdorimit të automjeteve të prodhuara në përputhje me standardet teknike. Pavarësisht automjeteve të përmirësuara teknikisht, bllokimet e trafikut në rrjetin rrugor dhe shpejtësia e udhëtimit e reduktuar gjithnjë e më shumë në qendrat urbane, do të sillte si pasojë tejkalimin e maksimumit të emetimeve të gazrave me efekt serrë të përcaktuara deri më vitin 2020.

5.4 UJI


Në qoftë se Plani nuk përshtatet, infrastruktura dhe politika përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Infrastruktura nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Prandaj, ndërtimi i infrastrukturës së re mund të mos marrë në konsideratë karakteristikat ekzistuese natyrore (sipërfaqet mbrojtëse, përshkueshmërinë e tokës dhe ndikimin në cilësinë e ujërave nëntokësore, etj). Rreziku i aksidenteve që përfshijnë rrjedhje të cilat ndikojnë në statusin kimik të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë është dukshëm më i madh në sektorin e transportit. Plani parashikon edhe rivitalizimin e transportit hekurudhor. Në qoftë se Plani nuk adaptohet, transporti i mallrave më i shpeshtë në infrastrukturën rrugore, do të rrisë mundësinë e ndotjes për shkak të aksidenteve që përfshijnë rrjedhje të substancave të rrezikshme.

5.5 BIODIVERSITETI

Me përshtatjen e Planit, infrastruktura përkatëse do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Infrastruktura do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Për shkaqet e sipërpërmendura, infrastruktura do të planifikohet, që do të thotë gjithashtu më pak nevojë për të kryer ndërhyrje të reja infrastrukturore. Si rezultat, hapësira nuk do të fragmentohet në mënyrë të panevojshme dhe nuk do të preken rrugët migratore të kafshëve të egra. Masat e aktiviteteve të Planit duhet të përfshijë krijimin e kalimeve të përshtatshme për kafshët e egra nëse fragmentet ekzistuese provojnë se janë të papërshtatshme apo të pakalueshme (vendkalimet janë penguar nga gardhet ose vdekshmëria e kafshëve në rrugë është rritur). Nëse masat e Planit nuk zbatohen, vdekshmëria e kafshëve në rrugë dhe lidhjet midis popullatave mund të përkeqësohen, gjë e cila mund të ndikojë në biodiversitetin e zonave përkatëse. Masat e parashikuara përfshijnë masa për të reduktuar nivelin e zhurmës në mjedisin natyror, të cilat do të kenë një ndikim lokal pozitiv të përhershëm të kafshët e egra. Nëse masat nuk zbatohen, zhurma në mjedisin natyror do të rritet për shkak të ndërhyrjeve infrastrukturore të pakontrolluara dhe të paplanifikuara.

5.6 MBETJET

Sektorin e grumbullimit / trajtimit / riciklimit të mbetjeve është një ndër sektorët më problematikë në Shqipëri, për vetë natyrën e tij ndërlidhëse me një sërë sektorësh të tjerë (ajri, toka, uji, shëndeti etj). Aktualisht ky sektor ka një sërë problematikash, të cilat kanë gjetur reflektim dhe adresim në Plan. Këto problematika përfshijnë: praninë e zonave të ndotura të njohura si (Lloj) Spote që akoma nuk janë sistemuar; vend depozitime të hapura (të ligjshme dhe të paligjshme); kapacitetin e pamjaftueshëm të landfilleve ekzistues apo mungesa e tyre aty ku duhet mënyrësi. Mbetjeve është



akoma në nivele të ulëta; mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore; mungesa e landfilleve për mbetjet e rrezikshme; ndarja në burim e mbetjeve / riciklimi akoma nuk praktikohet në Shqipëri; kuadri ligjor, megjithëse i përgjigjet kërkesave të BE-së, nuk mund të ndryshojë realitetin për shkak të mungesës në investime; etj. Nëse Plani nuk adoptohet kjo situatë jo vetëm që do të vijojë të mbetet problematike, por do të përkeqësohet më tej për shkak të zhvillimeve të pakontrolluara në të gjithë sektorët përfshirë edhe planifikimin hapësinor / urban.

5.7 ZHURMA

Skenari 'mos bëj asgjë' nuk përfshin asnjë ndërhyrje infrastrukturore, me përjashtim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese. Nëse aktivitetet e parashikuara ne Plan nuk zbatohen apo përfshihen në programet e detajuara të masave për zvogëlimin e ndotjes nga zhurma, niveli i zhurmës do të rritet, veçanërisht më shumë për shkak të zhvillimeve të pakontrolluara infrastrukturore. Prandaj, objektivi i arritjes së standardit të BE-së mbi zhurmën (LAeq / ditën në 55dB (A) dhe LAeq / natën në 45 dB (A)) nuk do të realizohet. Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara ne Plan do të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri, dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture. Nëse masat e politikave të Plani nuk zbatohen, ekspozimi i banorëve ndaj zhurmës do të rritet. Në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe direktivat e BE-së, menaxherët e burimeve individuale të zhurmës duhet të rehabilitojnë zonat me ndotje akustike të tepërt. Megjithatë, përmirësimet e efektshme të mjedisit mund të kryhen vetëm nëpërmjet masave të kombinuara, logjistike dhe organizative.

5.8 POPULLSIA DHE ASETET MATERIALE

Pavarësisht nga disa investime të fundit në rrjetin e rrugëve lokale dhe rajonale, cilësia e infrastrukturës së transportit në Shqipëri mbetet e ulët dhe ka dallime të konsiderueshme rajonale në aspektin e qasjes ndaj tregjeve dhe shërbimeve themelore. Cilësia e ofrimit të shërbimeve në zonat rurale është ende e ulët dhe pjesa më pak e pasur e popullatës ka qasje të kufizuar në shërbimet sociale, veçanërisht shëndetësi dhe arsim. Kufizimet e transportit publik dhe kostot e larta ndikojnë në lëvizshmërinë e njerëzve dhe qasjen ndaj mundësive (dmth të punësimit) jashtë fshatrave. Menaxhimi i vazhduar i aseteve, mirëmbajtja rutinë e rrugëve, dhe qasja më e besueshme në transportin publik mund të zvogëlojë shpenzimet dhe të sjellë përfitime të rëndësishme njësoj si për familjet, fermerët dhe firmat. Edhe pse shkalla e aksidenteve fatale është në rënie (kjo shkallë është pothuajse përgjysmuar gjatë dekadës së fundit), siguria rrugore në Shqipëri është një problem i madh social dhe i shëndetit publik. Qeveria është fokusuar në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të sigurisë rrugore, në vend që t'i japë vëmendje auditimeve të sigurisë dhe përmirësimit të pikave të errëta, inkorporimit të standardeve të sigurisë në projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut. Në qoftë se Plani nuk do të adaptohet dhe masat nuk do të zbatohen, aksesueshmëria do të mbetet një shqetësim i rëndësishëm, dhe çështjet e sigurisë do të vazhdojnë të jenë një problem serioz. Si pasojë nuk priten efekte pozitive në mënyrën dhe kushtet e jetesës në qendrat e banuara.



5.9 TRASHËGIMIA KULTURORE

Në qoftë se Plani nuk përshtatet dhe nuk zbatohen aktivitetet infrastrukturore, integriteti dhe karakteristikat e zonave dhe njësive të trashëgimisë kulturore, sidomos të peizazheve kulturore, peisazheve historike, zonave të trashëgimisë urbane dhe zonave të tyre të ndikimit, dhe vendeve arkeologjike, do të ruhen në një masë më të madhe. Nga ana tjetër, zhvillimi i infrastrukturës dhe politikave përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe infrastruktura nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Prandaj zhvillimet e paplanifikuara do të kenë një efekt negativ në trashëgiminë kulturore.

5.10 PEIZAZHI

Në qoftë se Plani nuk përshtatet, dhe aktivitetet infrastrukturore nuk zbatohen, integriteti dhe tiparet e peizazheve të jashtëzakonshëm dhe zonave të peizazhit me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar, do të ruhen. Imazhi i peizazheve me cilësi të larta i zonave të ruajtura mirë dhe me elementë të rëndësishëm kulturor, do të ruhet. Nga ana tjetër, zhvillimi i infrastrukturës dhe politikave përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe infrastruktura nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Prandaj zhvillimet e paplanifikuara do të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në degradimin e peizazhit.



SEKSIONI 6 - BAZA PËR PËRGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR

6.1 PËRCAKTIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE

Bazuar në analizën e detyrimeve të specifikuar në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë, situates ekzistuese të mjedisit dhe të ndikimeve potenciale mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan, Raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndësishëm mjedisore dhe objektivat mjedisore si më poshtë:

Toka

Objektiva Mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Objektiva Mjedisore 2 (OM 2): Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastruktures.

Ajri

Objektiva Mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasi të vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

Faktorët klimatikë

Objektiva Mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Uji

Objektiva Mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat sipërfaqësorë dhe burimet e ujit të pijshëm.

Mjedisi natyror

Objektiva Mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.



Objektiva Mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Mbetjet

Objektiva Mjedisore 8 (OM 8): Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfillleve e incineratorëve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Zhurma

Objektiva Mjedisore 9 (OM 9): Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Popullsia dhe asetet materiale

Objektiva Mjedisore 10 (OM 10): Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Trashëgimia Kulturore

Objektiva Mjedisore 11 (OM 11): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Peisazhi

Objektiva Mjedisore 12 (OM 12): Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peisazhi me cilësi të lartë.

Shpjegimi i përcaktimit të objektivave mjedisore jepet në seksionet në vijim.

6.1.1 Detyrimet e specifikuar në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë


Për të përcaktuar objektivat e rëndësishme specifike, janë përdorur detyrimet e specifikuar në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë. Lidhja mes sektoreve të mjedisit dhe objektivave mjedisore, si dhe dokumentat përkatës të planeve, programeve apo politikave mjedisore është paraqitur në Tabelën e mëposhtme:

Tab. - Konventat e ratifikuara dhe Direktivat respektive të BE-së dhe të shtetit Shqiptar

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me SM	Lidhja me OM
-----------	-----------------------	--------------	--------------




<p>Strategjia tematike per Mbrojtjen e Tokes – COM (2006)231.</p> <p>Referenca ne Shqiperi gjendet ne Ligjin nr. 10431 date 9.6.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit” (neni 18)</p>	<p>Duhen marre ne konsiderate pozitat mbi te cilat eshte bazuar hartimi i Direktives qe percakton kuadrin per mbrojtjen e tokes dhe amendon Direktiven 2004/35/EC. Strategjia merr ne konsiderate nje sere funksionesh, diversitetin dhe kompleksitetin e tokes si dhe nje sere procesesh degradimi te cilave ajo (toka) u nenshtrohet.</p> <p>Objekti strategjik është mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës, bazuar në parimet e mëposhtme udhëzuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • parandalimi i degradimit të mëtejshëm dhe ruajtja e funksioneve të tokës, kur toka perdoret dhe kur funksionet e tokes shfrytezohen, si dhe kur toka sherben si mjedis prites per efektet e aktivitetit te njeritu apo fenomeneve mjedisore; • Rikthimi i tokës së degraduar në një nivel funksionaliteti konsistent të paktën me përdorimin aktual apo të synuar, duke pasur parasysh kostot e restaurimit të tokës. 	Toka	OM 1
<p>Direktiva 2008/98/EC per mbetjet.</p> <p>Direktiva 2006/12/EC per mbetjet Transpozuar ne legjislacionin shqiptar si VKM nr. 175, date 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025 dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025”</p>	<p>Qellimi thelbesor i te gjitha rregulloreve mbi mbetjet eshte mbrojtja e shendetit te njerezve dhe e mjedisit nga efektet e demshme qe shkaktohen nga grumbullimi, transportimi, perpunimi, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve. Direktiva 2008/98/KE (Direktiva Kuader mbi Mbetjet) parashikon një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve, si dhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si burim nga riciklimi dhe rikuperimi. Mbetja eshte nje burim i lendes se pare (dhe jo dicka qe duhet shperbere sa me lire qe te jete e mundur), keshtu qe duhet te merren masa per te riperdorur mbetjet sa me shume te jete e mundur.</p> <p>Riciklimi paraqet nje objektive mjedisore qe eshte ‘55% e mases totale te mbetjeve te riperdoret apo riciklohet, deri ne 2020’.</p>	Toka Mbetjet	OM 2 OM 8
<p>Direktiva 2008/50/EC mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën.</p> <p>Direktiva 2004/107/CE lidhur me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hirdokarburet aromatike policiklike në ajrin e mjedisit. Shqiperia i ka</p>	<p>Direktiva 2008/50/EC përcakton masat që synojnë si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përkufizimin dhe përcaktimin e objektivave për cilësi të ajrit të ambientit hartuar në mënyrë të tillë që shmangin, parandalojnë apo reduktojnë efektet e dëmshme në shëndetin e njerëzve dhe në mjedisin në tërësi; 2. Përlllogaritjen e cilësisë së ajrit të ambientit në Vendet Anëtare me bazë metoda dhe kriteret të përbashkëta; 3. Sigurimin e informacionit mbi cilësinë e ajrit të ambientit në mënyrë që të ndihmojë luftën kundër ndotjes dhe shqetësimit të ajrit dhe të monitorojë prirjet dhe përmirësimet që vijnë si rezultat i masave kombëtare dhe të Komunitetit; 	Ajri	OM 3



<p>perafruar plotesisht keto direktiva permes: - Ligjit nr. 162/2014, date 12.04.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit " dhe</p>	<p>4. Garantimin se informacioni i tillë mbi cilësinë e ajrit të ambientit do t'i bëhet i disponueshëm publikut; 5. Mirëmbajtjen e cilësisë së ajrit atje ku është e mirë dhe përmirësimin e saj në raste të tjera; 6. Nxitjen e rritjes së bashkëpunimit midis Vendeve Anëtare për reduktimin e ndotjes së ajrit. Objektivat e Direktives 2004/107/CE janë të: (a) të përcaktoje një vlerë të synuar për përqendrimin e arsenikut</p>		
<p>VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit "</p>	<p>, kadmiumit , nikelit dhe benzo (a) pirenit në ajrin e ambientit me qëllim shmangien , parandalimin ose reduktimin e efekteve të dëmshme të arsenikut , kadmiumit , nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në shëndetin e njeriut dhe në mjedis si një i tërë; (b) të sigurojnë, në lidhje me arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe hidrokarburet policiklike</p>		
	<p>aromatike, që cilësia e ajrit të ambientit është ruajtur atje ku ajo është e mirë dhe është përmirësuar në raste të tjera, (c) të përcaktojë metodat e përbashkëta dhe kriteret për vlerësimin e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe për depozitimin e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike; (d) të sigurojë që informacioni i duhur mbi përqendrimet e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe mbi depozitimet e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike është marrë dhe të siguroje se ajo është vënë në dispozicion të publikut.</p>		
<p>Strategjia e BE për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike (COM (2013)</p>	<p>Objektiva e përgjithshme e Strategjisë së BE për adaptimin është të kontribuojë në një Evropë me elastike ndaj klimes. Kjo do të thotë rritjen e punës përgatitore dhe të kapacitetit për t'ju përgjigjur ndikimeve nga ndryshimet klimatike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, duke zhvilluar një perfrim logjik dhe duke përmirësuar koordinimin. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit, në Tetor 1999, si dhe është anëtare e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), që nga Janari 1995. Shqipëria ka përgatitur dy Komunikime Kombëtare në 2002 dhe 2009, si dhe ka finalizuar me sukses vete vlerësimin për përgatitjen e Komunikimit të Tretë Kombëtar të UNFCCC. Në vitin 2016 është parashikuar të përfundojë hartimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, me koheshtrirje 2016-2030.</p>	<p>Faktorët klimatike</p>	<p>OM 4</p>




<p>Vendimi 406/2009/EC për përpjekjet e Shteteve Anëtare të zvogëlojnë emetimet e gazeve serë që t'i plotësojnë detyrimet e Komunitetit për zvogëlimin e gazeve serë deri më 2020</p>	<p>Vendimi 406/2009/EC percakton kontributin minimal të vendeve anëtare për të arritur detyrimin për zvogëlimin e emetimit të gazeve 'sere' për periudhën nga 2013 deri në 2020 për emetimet e gazeve 'sere' që mbulohen nga ky vendim si dhe rregullat për arritjen e këtyre kontributeve dhe vlerësimin e tyre. Angazhimi për reduktimin e emetimeve të gazeve 'sere' i referohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - emetimeve nga përdorimi i lendeve djegëse në shtëpi dhe në sektorin e shërbimeve; - emetimeve nga përdorimi i lendeve djegëse në sektorin e transportit; - emetimeve nga përdorimi i lendeve djegëse në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe në sektorin e energjisë; - emetimet që cilohen nga sektori i energjisë; - emetimet nga proceset industriale; - përdorimi i tretësve dhe produkteve të tjera; - emetimet nga bujqësia; - emetimet nga administrimi i mbetjeve. <p>- Shqipëria akoma nuk e ka transpozuar këtë vendim; është parashikuar të bëhet në vitin 2018. Pra bie brenda afatit kohor të realizimit të Planit, kështu që dëpsozitat e këtij vendim</p>	<p>Faktoret klimatike</p>	<p>OM 4</p>
<p>Direktiva 2000/60/EC (Direktiva Kuader e Ujit) (transpozuar në egjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore")</p>	<p>Direktiva percakton masat për arritjen e objektivit strategjik të statusit të mirë ekologjik për ujërat në vitin 2015.</p>	<p>Uji</p>	<p>OM 5</p>
<p>Direktiva 2008/56/EC që vendos kuadrin për veprimin e komunitetit në fushën e politikës mjedisore të lumit (Direktiva Kuader e Strategjisë Ujore). Shqipëria planifikon ta adoptojë plotësisht këtë strategji gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016 përmes një VKM-je specifike "Për përmbajtjen, zhvillimin</p>	<p>Direktiva percakton kuadrin brenda së cilit vendet anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të arritur apo mbajtur një gjendje të mirë mjedisore në mjedisin ujor deri në vitin 2020. Në përputhje me këtë Direktivë janë hartuar dhe zbatuar strategjitë ujore, me qëllim që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> -mbrojnë mjedisin ujor, parandalojnë degradimin e tij, apo, nëse është e mundur, rivendosin ekosistemet lumore në zonat e prekuara nga efektet e demshme; -parandalojnë dhe pakësojnë ndërhyrjet në mjedisin ujor me qëllim eliminimin gradual të ndotjes dhe kështu garantojnë se nuk ka pasoja të mëdha për biodiversitetin ujor, ekosistemet ujore dhe shëndetin e njeriut dhe se këto nuk janë të kercënuara. 	<p>Uji</p>	<p>OM 5</p>



dhe zbatimin e Strategjise Mjedisore Detare”.			
Direktiva 2008/105/EC per standartet e cilesise mjedisore ne fushen e politikave ujore (transpozuar ne legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”)	Kjo Direktive percakton standartet e cilesise mjedisore per substancat prioritare dhe ndotesit e tjere, sic percaktohet ne Direktiven 2000/60/EC me objektive arritjen e nje gjendjeje te mire kimike te ujerave sipërfaqësore dhe ne perputhje me parashikimet dhe objektivat e Direktives 2000/60/EC mbi parandalimin e emetimit te substancave ne uje, duke ndare ujerat e zeza. VKM-ja qe transpozon Direktiven 2008/105/EC ne legjislacionin shqiptar percakton normativa te detajuara dhe gjithëperfshirese per vleresimin e gjendjes kimike te ujerave sipërfaqësore.	Uji	OM 5
Direktiva 2006/7/EC për Menaxhimin e Cilësisë së Ujit për Larje (transpozuar ne legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”)	Direktiva percakton masat per te: a) monitoruar dhe klasifikuar sipas cilesise ujin per larje; b) menaxhuar cilesine e ujit per larje; dhe c) informuar publikun mbi cilesine e ujit per larje. Qellimi (objektiva) i kesaj Direktive eshte ‘te ruaje, mbroje dhe permiresoje cilesine e mjedisit dhe te mbroje shendetin e njerezve, duke plotesuar Direktiven 2000/60/EC’.	Uji	OM 5
Direktiva e Keshillit 98/83/EC në lidhje me cilësinë e ujit të caktuar për konsumim njerëzor (transpozuar në legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”)	Direktiva e Keshillit 98/83/EC rregullon cilesine e ujit qe perdoret per konsum nga njerezit. Uji eshte i shendetshem dhe i paster nese ai nuk permban mikroorganizma, parazite dhe cdo substance tjeter, te cilat ne sasi apo perqendrim te caktuara perbejne nje rrezik potencial per shendetin e njerezve. Objektiva e kesaj direktive eshte te mbroje shendetin e njerezve prej cdo efekti negativ apo ndotjeje te ujit qe perdoret per konsum nga njerezit, duke garantuar qe uji te jete i paster dhe i shendetshem.	Uji	OM 5
Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi (transpozuar ne legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”)	Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi percakton masa specifike per te parandaluar dhe kontrolluar ndotjen e ujerave nentokesore ne perputhje me Direktiven 2000/60/EC. Keto masa kryesisht perfshijne: -kritere per vleresimin e statusit kimik të ujit nëntokësor, dhe -kritere per identifikimin dhe kthimin mbrapsht te tendencave te konsiderueshme dhe te qendrueshme te rritjes, dhe per percaktimin e pikenisjeve per tendencat e kunderta.	Uji	OM 5



<p>Direktiva 2007/60/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet (Direktiva e Përmbytjeve). Shqipëria e ka përfunduar pjesërisht këto direktive përmes:</p> <p>- Ligji nr. 9860, date 21.01.2008 që amendon Ligjin nr. 8518, date 30.7.1999 "Për Ujitjen dhe Kullimin"- VKM nr. 835, date 3.12.2004 "Për Planin Kombëtar të Emergjencave Civile"- VKM nr. 267 date 07.05.2014 "Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore"</p>	<p>Direktiva ka përcaktuar negociatat nderkufitare lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet, dhe përfshin angazhime të rëndësishme për të rritur transparencën dhe integrimin e qytetareve.</p> <p>Objektiva e direktives se menaxhimit të rreziqeve nga përmbytjet është të reduktojë rreziqet dhe pasojat negative të përmbytjeve në BE.</p> <p>Përsa i përket Shqipërisë, në fund të 2015, dhe gjatë tremujorit të parë të 2016, është parashikuar miratimi i dy VKM-ve: VKM "Për kushtet dhe kriteret e nevojshme për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore" VKM "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Ujërat, planete menaxhimit të baseneve të lumenjve dhe planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet"</p>	Uji	OM 5
<p>Direktiva 2009/147/EC për mbrojtjen e zogjve të eger. Shqipëria e ka përfunduar pjesërisht këto direktive, përmes ligjeve:</p> <p>- Ligji nr. 9587, date 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit" i ndryshuar - Ligji nr. 10006, date 23.10.2008; "Për mbrojtjen e faunës së eger" - Ligji nr. 10253, date 11.3.2010 "Për Gjuetinë"</p>	<p>Direktiva ofron një kornizë të plotë për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e të gjithë zogjve të egër që ndodhen në BE. Direktiva udhëzohet shtetet anëtare të marrin masa për të mbajtur popullacionin e të gjitha llojeve të zogjve të egër që ndodhen në shtetin e BE-së. Masa të tilla mund të përfshijnë mirëmbajtjen dhe/ose ri-krijimin e vendbanimeve në mënyrë që të mbajnë këto popullata të zogjve.</p> <p>Për të gjitha speciet e zogjve që referohen në Shtojcën I të Direktives si dhe për të gjitha speciet e rregullta migratore, që kanë nevojë për mbrojtje, vendet anëtare duhet të krijojnë Zonat e Vecanta të Mbrojtjes (ZVM), apo të quajtura zonat Natura 2000. Në këto ZVM duhet garantuar që popullatat e specieve gjenden në një situatë të favorshme. SKZHI II përcakton si objektive strategjike "Ngritjen e rrejtës ekologjike "Natura 2000". Gjatë periudhës 2015 – 2016 është parashikuar amendimi i ligjit "Për gjuetinë", gjë që do të sigurojë përfundimin e plotë të kesaj Direktive në legjislativën shqiptare.</p>	Mjedisi natyror	OM 6
<p>Direktiva e Keshillit 92/43/EEC për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të flores e faunës së eger. Shqipëria e ka përfunduar pjesërisht këto direktive</p>	<p>Direktiva e habitateve kërkon që Shtetet Anëtare duhet të marrin masa të duhura për të mënjanuar në zonat e vecanta të ruajtjes shkatërrimin e habitateve natyrore dhe të habitateve të specieve si dhe shqetësimin e specieve për të cilat janë përcaktuar zonat e Natura 2000, në rastet kur ky shqetësim është dukshëm i lidhur me objektivat e kesaj Direktive. Kjo</p>	Mjedisi natyror	OM 6



<p>permes ligjeve:- Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit";Ligji "Për Zonat e Mbrojtura", nr.8906, datë 6.6.2002, të amenduar;Ligji nr.</p>	<p>dispozite aplikohet per ZVM-te e propozuara, sic percaktohet ne merputhje me procedurat dhe kriteret e direktives se habitateve. SKZHI II percakton si objektiva strategjike: -Nje rritje e synuar me 17% e siperfaqes se Zonave te Mbrojtura ne gjithe territorin, permes zgjerim dhe menaxhimit te integruar te zonave te mbrojtura; - Garantimi i statusit te mbrojtur per 5% te specieve dhe habitateve te kercenuara.</p>		
<p>10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër"; and- VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Permiratimin e listes se habitateve natyrore,</p>	<p>Ne tremujorin e trete te vitit 2016 eshte parashikuar aprovimi i projektligjit "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906. date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura" i ndryshuar", gje qe do te siguroje perafrimin e plote te kesaj Direktive ne legjislacionin shqiptar</p>		
<p>flores, faunes dhe zogjve me interes per KE</p>			
<p>Konventa e Bernes (Bern, 1979) me Ligjin nr. 8294, date 2.3.1998)</p>	<p>Per ruajtjen e flores dhe faunes se eger dhe mjedisit natyror evropian.</p>	<p>Mjedisi natyror</p>	<p>OM 6</p>
<p>Konventa Ramsar (Ramsar, 1971) (ratifikuar ne 29.3.1996)</p>	<p>Shtetet pale kane rene dakort qe te:</p> <ul style="list-style-type: none"> •percaktojne ligatinat e territorit te tij te pershtatshme per tu perfshire ne listen e ligatinave me rendesi nderkombetare; - formulojne dhe zbatojne plane per promovimin dhe mbrojtjen e ligatinave te perfshira ne Liste, si dhe per perdorimin sa me racional te ligatinave ne territorin e tyre • promovojne ruajtjen e ligatinave dhe shpendeve ujore duke krijuar rezervate natyrore ne ligatina, te perfshira ose jo ne Liste, dhe siguron ruajtjen e tyre ne menyren me te pershtatshme; •marrin ne konsiderate pergjegjesine e tij nderkombetare per ruajtjen, menaxhimin dhe perdorimin racional te grupeve shtegtare te shpendeve ujore, si kur percakton nje <p>hyrje ne Liste ashtu dhe kur ushtron te drejta e tij per ndryshim ne kete Liste ne lidhje me ligatinat ne territorin e tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> •konsultojne njera tjetren rreth zbatimit te detyrimeve te dala nga kjo Konvente vecanerisht ne rastet kur nje ligatine shtrihet ne territorin e me shume se te nje shteti pale ose kur nje sistem ujqor ndahet mes disa Shteteve Pale. 	<p>Mjedisi natyror</p>	<p>OM 6</p>
<p>Direktiva 2002/49/EC për vlerësimin & administrimin e zhurmës në mjedis. Shqipëria e ka perafuar pjeserisht kete Direktive</p>	<p>Objektivi kryesor është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve. përcaktojnë kërkesa specifike për zhurmat e gjeneruara nga sektorë të tjerë, siç është transporti rrugor, ajror, hekurudhor, zhurmat e gjeneruara nga pajisjet dhe makineritë.</p>	<p>Zhurmat</p>	<p>OM 9</p>



<p>permes Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis".</p>	<p>Ne tremujorin e fundit te vitit of 2017 eshte parashikuar miratimi i dy VKM-me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - "Për kriteret, procedurat dhe rregullat për certifikim, pezullimin dhe heqjen e certificates së ekspertit të zhurmës në mjedis" -Për përbërjen dhe organizimin e Komitetit Teknik të Zhurmave (KTZH)"Kjo gje do te siguroje peraftrimin e plote te kesaj Direktive ne legjislacionin shqiptar. 		
<p>Direktiva 2008/96/EC mbi sigurine e infrastruktures rrugore (e perafruar plotesisht nepermjet Udhëzimit Nr. 9, datë 3.07.2012 "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore"</p>	<p>Objektiva e kesaj Direktive eshte 'garantimi i infrastruktures se sigurt rrugore per te gjithë perdoruesit e rruges'.</p>	<p>Popullsia & asetet materiale</p>	<p>OM 10</p>
<p>Konventa Europiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike–Konventa e Maltës(MEKVAD) (Shqipëria ka aderuar përmes miratimit të Ligjit nr. 9806 datë 17.9.2007)</p>	<p>Konventa i referohet konceptit gjithëpërfshirës të ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike. Ajo përcakton lidhjen mes ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike dhe planifikimit hapësinor. Konventa kërkon që çdo palë firmosëse të:</p> <ul style="list-style-type: none"> -kërkojë të pajtojë dhe ndërthurë kërkesat përkatëse të arkeologjisë me planet hapësinore duke siguruar që arkeologët marrin pjesë në hartimin e politikave të planifikimit hapësinor dhe në faza të ndryshme të zbatimit të këtyre politikave; -sigurojë që arkeologët, planifikuesit urbanë dhe ata hapësinorë konsultohen sistematikisht me njëri-tjetrin me qëllim lejimin e modifikimit të atyre planeve hapësinore që kanë të ngjarë të dëmtojnë trashëgiminë arkeologjike -sigurojë kohë dhe burime të mjaftueshme për një studim të duhur shkencor që duhet të bëhet në zonën përkatëse dhe që të publikohen rezultatet e atij studimi -sigurojë që vlerësimi për ndikimin në mjedis dhe vendimet rezultuese përfshijnë konsideratën e plotë mbi zonat arkeologjike dhe shtrirjet e tyre -garantojë konservimin <i>in situ</i>, kur është e mundur, të elementëve të trashëgimisë arkeologjike që janë gjetur gjatë kryerjes së aktiviteteve hapësinore; -sigurojë që zonat arkeologjike janë të arritshme nga publiku, dhe se rrugët hyrëse për pranimin e një numri të madh vizitorësh, nuk dëmtojnë veçoritë arkeologjike dhe shkencore të këtyre zonave dhe mjedisit përreth. 	<p>Trashëgimia kulturore</p>	<p>OM 11</p>



<p>Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitektonike të Europës – Konventa e Granadës (Shqipëria ka aderuar përmes miratimit të Ligjit nr. 9806 datë</p>	<p>Konventa përforcon konceptin gjithëpërfshirës në ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike(monumente, njësi arkitektonike, zona apo struktura memoriale). Konventa kërkon që çdo palë pjesëmarrëse të:</p> <p>-zbatojë mbikëqyrje dhe procedurat e autorizimeve të duhura në përputhje me kërkesat e paracaktuara për mbrojtje ligjore të strukturave në fjalë;</p>	<p>Trashëgimia kulturore</p>	<p>OM 11</p>
<p>17.9.2007)</p>	<p>- parandalojë dëmtimin, rrënimin ose shkatërrimin e strukturave të mbrojtura.</p> <p>Politika e ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë arkitektonike i detyron të gjitha palët firmosëse që të:</p>		
	<p>-përfshijnë mbrojtjen e trashëgimisë arkitektonike si objektiv të rëndësishëm në planifikimin hapësinor dhe atë urban;</p> <p>- nxitin programet për restaurimin dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë arkitektonike;</p>		
<p>Strategjia Kombetare për Zhvillim dhe Integrim, drafti i 2-të, 2015 - 2020</p>	<p>Strategjia e dytë Kombetare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II) paraqet vizionin e Shqipërisë për zhvillimin e saj social, demokratik dhe ekonomik për periudhën 2015-2020, si dhe aspiratën për integrimin evropian. SKZHI-II shpjegon se si do të arrihet ky vizion përmes politikave dhe strategjive të qeverisë, duke synuar në:</p> <p>Shndërrimin e Shqipërisë në një vend të denjë për t'u anetaresuar në Bashkimin Evropian,</p> <p>Arrijtjen e standarteve që i shërbejnë qytetarëve, rritjes së mireqenies së tyre dhe garantimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre, dhe Hartimit të politikave që nxitin konkurrueshmërinë dhe prosperitetin ekonomik në Shqipëri si dhe krahasuar me vendet e rajonit dhe me gjere. SKZHI-II është një komponent kyç i</p> <p>Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) në Shqipëri. SPI përbëhet nga një komplet parimesh operationale, të cilat garantojnë se planifikimi dhe zbatimi i politikave të qeverisë behen në një mënyrë koherente, efektive dhe të integruar.</p> <p>Kuadri kohor 2015-2020 i SKZHI-II është harmonizuar me periudhën vijuese 2014-2020 të planifikimit financiar të BE-së, me Strategjinë e Lisbonës deri në 2020, dhe me tre ciklet vijues Kuadrit A fatmesem Buxhetor. Përveç këtyre proceseve, SKZHI-II është harmonizuar edhe me procese dhe dokumente të tjera kyç të zhvillimit dhe reformimit strategjik, si me poshte:</p>	<p>Toka</p> <p>Ajri</p> <p>Faktoret klimatike</p> <p>Uji</p> <p>Mjedisi natyror</p> <p>Mbetjet</p> <p>Zhurma</p> <p>Popullsia & asetet materiale</p>	<p>OM 1</p> <p>OM 2</p> <p>OM 3</p> <p>OM 4</p> <p>OM 5</p> <p>OM 6</p> <p>OM 7</p> <p>OM 8</p> <p>OM 9</p> <p>OM 10</p> <p>OM 11</p> <p>OM 12</p>



	<p>Dokumenti Tregues Strategjik per Shqiperine (2014-2020), referuar gjithashtu edhe si</p> <p>Dokumenti Strategjik i Komisionit Evropian per Vendin;</p> <p>Programi Kombetar i Reformave Ekonomike (PKRE) 2015-2017, perfshire Strategjine e</p> <p>Zhvillimit te Bizneseve dhe Investimeve 2014-2020;</p> <p>Strategjia e Administrimit te Financave Publike 2014-2020;</p> <p>Strategjia e Administrimit te Financave Publike 2014-2020;</p> <p>< Strategjia e Evropes Jug-Lindore 2020 (SEE2020) Punesimi dhe Prosperiteti ne Perspektiven Evropiane;</p> <p>Plani Kombetar per Integrimin Evropian (PKIE) 2014-2020;</p> <p>Raportet e progresit te BE dhe Bankes Boterore (sic eshte Kuadri i Financimit te Vendit 2015-2020); dhe kombetar dhe integrimin ne BE. Integrimi ne BE eshte qellimi madhor. Mireqeverisja, demokracia dhe sundimi i ligjit perbejne themelet mbi te cilat do te arrihet vizioni i SKZHI-II.</p>	<p>Trashegimia kulturore</p> <p>Peisazhi</p>	
--	---	--	--

6.1.2 Identifikimi i ndikimeve mjedisore

Ndikimet mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan janë përvijuar në Tabelën më poshtë:

Tab. - Ndikimet mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan

Sektori i mjedisit	Percaktimi i ndikimeve qe mund te vleresohen ne raportin e VSM-se	Vleresimi PO/JO
Toka	<ul style="list-style-type: none"> fragmentimi i zonave me aktivitet te dendur bujqesor apo zona pyjore perdorimi i burimeve te energjise se rinovueshme dhe karburanteve 'bio' administrimi i mbetjeve te gjeneruar nga aktivitetet e nderhyrjeve infrastrukturore 	PO
Ajri	<ul style="list-style-type: none"> emetimi i ndotesve ne ajer, te cilet kane ndikime te demshme tek ekosistemet dhe biodiversiteti emetimi i ndotesve per te cilet jane percaktuar kufijte e siperm ne nivel kombetar ndikimi ne shendet (sistemi respirator) ne rastet e nje pranie te larte te ndotesve ne ajer 	PO
Faktoret klimatike	<ul style="list-style-type: none"> ndjeshmeria e rrjeteve dhe strukturave ndaj situatave ekstreme te motit emetimet e gazrave 'sere' qe shkaktohen nga djegia e karburanteve 	PO
Uji	<ul style="list-style-type: none"> siguria nga permbytjet ndikimet e substancave te rrezikshme ne cilesine e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore, ne rast te derdhjeve aksidentale te tyre 	PO

	<ul style="list-style-type: none"> • ndikimet tek ujeshjellessat dhe cilesia e ujit te pijshem • ndikimet mbi ujerat qe perdoren per larje (plazh) 	
Mjedisi natyror (biodiversiteti, habitatet, zonat e mbrojtura)	<ul style="list-style-type: none"> • fragmentimi i habitateve • ndikim ne linjat e migrimit te kafsheve • ndikim ne integritetin dhe funksionalitetin e zonave te mbrojtura dhe te zonave te Natura 2000 • ndikime mbi tipologjine dhe cilesite e vecorive te cmuara natyrore 	PO
Mbetjet	<ul style="list-style-type: none"> • ndikimet nga zona te ndotura te njohura si Hot-Spote (mbetje kimike, materiale te rrezikshme) qe akoma nuk jane sistemuar • ndikimet nga vend depozitime te hapura (te ligjshme dhe te paligjshme) • kapaciteti i pamjaftueshem i landfilleve ekzistues / mungesa e tyre • mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kerkesave ligjore • ndarja në burim e mbetjeve / riciklimi (kuadri ligjor është plotësuar që prej vitit 2011, por nuk zbatohet në praktikë) 	PO
Zhurma	<ul style="list-style-type: none"> • ndotja akustike qe shkaktohet gjate ndertimit dhe shfrytezimit te infrastruktures perkatese dhe ndikimi tek shendeti i njerezve 	PO
Popullsia dhe asetet materiale	<ul style="list-style-type: none"> • ndikime mbi asetet materiale per shkak te nevojës per hapësire • aksesibiliteti dhe lidhjet mes zonave/rajoneve te ndryshme • ndikimet qe lidhen me sigurine rrugore 	PO
Trashegimia kulturore	<ul style="list-style-type: none"> • ndikime ne elementet e trashegimise kulturore 	PO
Peisazhi	<ul style="list-style-type: none"> • ndryshimi i peisazhit dhe i vecorive pamore te hapësires 	PO

6.2 METODIKA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

6.2.1 Metodika e Vlerësimit

Vlerësimi i paraqitur në Seksionin 9 është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, ku jepet edhe përvijimi dhe përmbajtja e raportit të VSM-së. Ndikimet e rëndësishme të Planit në mjedis dhe objektivat mjedisore janë analizuar dhe vlerësuar sipas shkallëve të mëposhtme:

- A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv;
- B – ndikim i parëndësishëm;
- C – ndikimi bëhet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse;
- D – ndikim i rëndësishëm;
- E – ndikim shkatërrues;
- X – vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur.



Vlerësimi i ndikimeve të Planit sipas shkallës A, B dhe C do të thotë që ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore janë të pranueshme. Ndikimet e parëndësishme janë vlerësuar me B, ndërsa ndikimet që bëhen të pranueshme vetëm pas zbatimit të masave zbutëse përkatëse, janë vlerësuar me C. Shkallët D dhe E nënkuptojnë se ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore janë të papranueshme. Më poshtë janë përshkruar indikatorët dhe kriteret e vlerësimit si dhe shkallët përkatëse të vlerësimit për secilën objektivë mjedisore.


6.2.2 Përshkrimi i Krieteve Dhe Metodologjisë së Vlerësimit për Objektivat Mjedisore

6.2.1.1 Toka - Në tabelën 32 janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për

OM 1: Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshem të tokës dhe mbrojtja e saj.

Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM1

Indikator / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
<p>Ndryshimi i strukture aktuale të përdorimit të tokës dhe pyjeve</p> <p><i>(zbatimi i aktiviteteteve që lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në toka bujqesore dhe zona pyjore do të çojë në humbjen dhe/ose ndryshimin e perhershëm të kategorise së përdorimit të tyre (nga toka bujqesore apo zona pyjore në truall ndertimi apo ndonjë kategori tjetër)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ndryshimi i strukture së përdorimit të tokës bujqesore me potencial të mirë prodhues <p><i>(zbatimi i aktiviteteteve që lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në toka bujqesore me potencial të mirë prodhues do të çojë në humbjen e perhershme të tokës bujqesore me cilësi të lartë)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> probabiliteti i zbatimit të aktiviteteteve që lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në zona pyjore me status të vecantë <p><i>(zbatimi i aktiviteteteve që lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në zona pyjore me status të vecantë mbrojtjeje / konservimi mund të preke në mënyrë të konsiderueshme ato cilësi për të cilat zona është vënë nën këtë status)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> probabiliteti i zbatimit të aktiviteteteve që lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në zona pyjore me 	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk prekin zonat pyjore apo token bujqesore, sipas ndarjes aktuale të përdorimit të tokës.</p> <p>B – ndikim i parëndësishëm: Nëse zbatohen dispozitat ligjore, ndikimi mbi përdorimin e qëndrueshem të tokës bujqesore dhe pyjeve do të jetë i parëndësishëm, pavarësisht faktit se aktivitetet do të zbatohen në toka bujqesore me potencial të mirë prodhues, apo në zona pyjore me një funksion të mirëpercaktuar të prodhimit të lëndës drusore.</p> <p>C – ndikimi bëhet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Probabiliteti i ndryshimit të strukture aktuale të përdorimit të tokës bujqesore dhe pyjeve është i lartë. Infrastruktura do të shtrihet në toka bujqesore me potencial të mirë prodhues, apo në zona pyjore me një funksion të mirëpercaktuar të prodhimit të lëndës drusore. Duhet parashikuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimin.</p> <p>D – ndikim i rëndësishëm: Probabiliteti i ndryshimit të strukture aktuale të përdorimit të tokës bujqesore dhe pyjeve është shumë i lartë. Ndikimi mbi përdorimin e qëndrueshem të tokës bujqesore dhe të pyjeve do të jetë i konsiderueshem. Infrastruktura do të shtrihet në toka bujqesore me potencial të mirë prodhues, apo në zona pyjore me një funksion të mirëpercaktuar të prodhimit të lëndës drusore. Nuk mund të merren masa zbutëse për të reduktuar ndikimin.</p> <p>E – ndikim shkatërrues: Probabiliteti i ndryshimit të strukture aktuale të përdorimit të tokës bujqesore me potencial të mirë prodhues, apo të zonave pyjore me një funksion të</p>



nje funksion te mirepercaktuar te prodhimit te lendes drusore (zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zona pyjore me nje funksion te mirepercaktuar te prodhimit te lendes drusore do te coje ne humbjen e perhershme te ketyre zonave)	mirepercaktuar te prodhimit te lendes drusore eshte kaq i madh sa qe ndikimi ne bujqesi dhe pyje do te kete pasoja shkaterruese. X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.
--	---

Ne tabelen me poshte jane pershkruar kriteret e vleresimit dhe metodologjia per


OM 2: Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.

Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM2

Indikator / kriteri i vleresimit	Shkalla e vleresimit
Niveli i riciklimit te mbetjeve qe gjenerohen gjate ndertimit / rehabilitimit te infrastruktures fizike (aktivitetet qe lidhen me ndertimin / rehabilitimin e infrastruktures fizike duhet te garantojne se te pakten 55% e mbetjeve qe gjenerohen duhet te riciklohen, dhe materiali qe germohet duhet, sa me shume te jete e mundur te riciklohet duke u perdorur ne mbushjet gjate ndertimeve)	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk do te shkaktojne mbetje nga punimet e ndertimit apo germimet.</p> <p>B – ndikim i parendesishem: Zbatimi i aktiviteteteve do te gjeneroje mbetje nga ndertimi. Megjithate, ato do te perpunohen totalisht, nderkohe qe 55% e tyre do te riperdoren si mbetje ndertimore e riciklueshme.</p> <p>C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese: Zbatimi i aktiviteteteve do te gjeneroje mbetje nga ndertimi. Megjithate, per shkak te vecorive cilesore te mbetjeve, ato nuk mund te perpunohen dhe nuk mund te garantohet se 55% e tyre do te riperdoren, ne rast se nuk zbatohen masat zbutese.</p> <p>D – ndikim i rendesishem: Zbatimi i aktiviteteteve do te gjeneroje mbetje nga ndertimi. Megjithate, per shkak te vecorive cilesore te mbetjeve, te pakten 55% e tyre nuk mund te perpunohen dhe riperdoren. Nuk mund te merren masa zbutese per te rritur sasine e mbetjeve te ricikluara.</p> <p>E – ndikim shkaterrues: Zbatimi i aktiviteteteve do te gjeneroje mbetje nga ndertimi, per te cilat duhet te organizohet procesi i largimit.</p> <p>X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.</p>

6.2.1.2 Ajri - Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për

OM 3: Garantimi i arritjes se objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.



Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM3

Indikator / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
<p><i>Sasia vjetore e emetimeve të ndotesve në ajër, dmth e oksideve të squfurit, oksideve të azotit, lëndës organike volatile pa përmbajtje metani, amoniakut dhe pjesezave</i></p> <p>(permiresime të matshme të cilësive së ajrit duke arritur nivelet e synuara të ndotesve të ajrit në lidhje me shenjetin e njerezve, sipas vlerave respektive: për NOx - 40 µ/m³, për PM10 - 40 µ/m³, për PM2,5 - 25 g/m³ dhe 20 g/m³ dhe SO2 - 125 µ/m³.</p> <p>Numri vjetor i diteve kur tejkalohet niveli i ndotjes së ajrit me pjeseza, i matur në pikat e monitorimit, të cilat janë të ekspozuara ndaj emetimeve të ndotesve (duhet të reduktohet me 40% numri i diteve kur tejkalohet niveli i ndotjes së ajrit me pjeseza; sa më pak dite me ndotje të lartë të ajrit, aq më i ulët është ndikimi tek shëndeti i njerezve dhe kostoja për shoqërinë, për shkak të numrit relativisht të lartë të njerezve të ekspozuar, shëndeti i të cileve preket nga ky faktor)</p>	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk do të shkaktojnë emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar. Zbatimi i aktivitetëve do të reduktojë emetimet e ndotesve.</p> <p>B – ndikim i parëndësishëm: Zbatimi i aktivitetëve do të shkaktojë emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar, por jo deri në atë masë sa të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II.</p> <p>C – ndikimi bëhet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutese: Zbatimi i aktivitetëve do të shkaktojë emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. Për të reduktuar emetimet duhet të parashikohen dhe zbatohen masa zbutese në mënyrë që niveli maksimal i emetimeve të zbrese në kufijtë e parashikuar në SKZHI-II.</p> <p>D – ndikim i rëndësishëm: Zbatimi i aktivitetëve do të shkaktojë emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. Nuk mund të merren masa zbutese për të reduktuar nivelin e emetimeve nën kufijtë e përcaktuar dhe për të mbajtur ndikimin në nivelin e përcaktuar të ndotjes së ajrit me pjeseza.</p> <p>E – ndikim shkatërrues: Zbatimi i aktivitetëve do të shkaktojë emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe pjesezat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II do të tejkalohen në mënyrë të konsiderueshme dhe ndotja e ajrit me pjeseza do të jetë në nivel të tillë që do të ketë një efekt të konsiderueshëm dhe të demshëm mbi shëndetin e njerezve.</p> <p>X – vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave</p>

6.2.2.3 Faktorët Klimatikë - Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për OM 4: *Adaptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.*

Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM4

Indikator / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
<p>• adaptimi i infrastrukturës përkatëse ndaj ndryshimeve klimatike</p>	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo një gjë e tillë s'ka nevojë të</p>

<p>(aktivitetet qe lidhen me ndertimin / rehabilitimin e infrastruktures perkatese duhet te perfshijne aktivite qe zvogelojne apo parandalojne pasojat e ndryshimeve klimatike, vecanerisht te permbytjeve, debores dhe ngricave)</p>	<p>garantohet; aktivitetet e parashikuara nuk do te shkaktojne rritje te emetimeve te gazeve 'sere'. Zbatimi i aktiviteve do te reduktojte emetimet e gazeve 'sere'.</p> <p>B – ndikim i parendesishem: Aktivitetet e parashikuara garantojne adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo nje gje e tille s'ka nevojte te garantohet. Emetimeve e gazeve 'sere' do te rriten, por por jo deri ne ate mase sa te tejkalohen kufijte e percaktuar ne SKZHI-II.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • sasia vjetore e emetimeve te gazeve 'sere' 	<p>C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese: Aktivitetet e parashikuara garantojne adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo nje gje e tille s'ka nevojte te garantohet. Emetimeve e gazeve 'sere' do te rriten deri ne ate mase sa do te tejkalohen kufijte e percaktuar ne SKZHI-II. Per te reduktuar emetimet duhet te parashikohen dhe zbatohen masa zbutese, te cilat do te garantojne qe niveli i emetimeve nuk do te kaloje kufijte e parashikuara ne SKZHI-II.</p>
<p>(sasia maksimale e emetimeve te gazeve 'sere' nuk duhet te tejkalojte sasine e synuar vjetore prej 18,000 Gg CO2 ekuivalent ne 2020</p> <p>Ndikimet kumulative te te gjitha aktiviteve te Planit nuk duhet te shkaktojne nje sasi vjetore nga te gjitha burimet e emetimeve te gazeve 'sere' qe te tejkalojte vlerat e synuara qe jepen ne SKZHI-II lidhur me Reduktimin e Emetimeve te Gazeve 'Sere' ne 2020.)</p>	<p>D – ndikim i rendesishem: Aktivitetet e parashikuara garantojne adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo nje gje e tille s'ka nevojte te garantohet. Emetimeve e gazeve 'sere' do te rriten deri ne ate mase sa do te tejkalohen kufijte e percaktuar ne SKZHI-II. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar nivelin e emetimeve nen kufijte e percaktuar.</p> <p>E – ndikim shkaterrues: Aktivitetet e parashikuara nuk garantojne adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo zbatimi i aktiviteve do te rrite emetimet e gazeve 'sere' deri ne ate mase sa kufijte e percaktuar ne SKZHI-II do te tejkalohen ne menyre te konsiderueshme.</p> <p>X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.</p>

6.2.2.4 Uji - Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për

OM 5: Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat breglumore dhe burimet e ujit të pijshëm.

Tab. - 36 Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM5

Indikator / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> • mundesi nderhyrjeje ne zonat me burime ujore te mbrojtura (zbatimi i aktiviteve jashte zonave me burime ujore do te thote me pak mundesi per ndotjen e ujit nentokesor qe perdoret si burim furnizimi me uje) 	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet nuk do te ushtrojne trysni shtese mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat liqenorë dhe burimet e ujit të pijshëm, apo ndikimi do të jetë pozitiv.</p> <p>B – ndikim i parendesishem: Nëse zbatohen dispozitat përkatëse ligjore, ndikimi mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat liqenorë dhe burimet e ujit të pijshëm do të jetë i parendesishem, pavarësisht faktit se aktivitetet mund të zbatohen në zona me burime ujore të</p>

<ul style="list-style-type: none"> • mundesi nderhyrjeje ne zonat me burime ujore per larje <i>(zbatimi i aktiviteteve ne zonat me burime ujore per larje do te thote me shume mundesi per ndotjen e ujerave qe perdoren per larje)</i> • mundesi nderhyrjeje ne zonat me rrezik permbyteje <i>(zbatimi i aktiviteteve ne zonat me rrezik permbyteje redukton zonat mbrojtese dhe rrit mundesine per deme nga permbytjet)</i> • mundesi nderhyrjeje ne zonat ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise <i>(zbatimi i aktiviteteve ne zonat ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise do te thote me shume mundesi per ndotjen e ujerave nentokesore)</i> 	<p>mbrojtura, ne zona ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise, ne zona me burime ujore per larje apo ne zona me rrezik permbyteje.</p> <p>C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te</p> <p>masave zbutese: Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujerat nentokesore dhe siperfaqesore, ujerat e njelmet, ujerat liqenorë dhe burimet e ujit te pijshem mund te jete e madhe, sidomos per shkak se probabiliteti i zbatimit te aktiviteteve ne zona me burime ujore te mbrojtura, ne zona ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise, ne zona me burime ujore per larje apo ne zona me rrezik permbyteje, eshte i larte. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>D – ndikim i rendesishem: Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujerat nentokesore dhe siperfaqesore, ujerat e njelmet, ujerat liqenorë dhe burimet e ujit te pijshem do te jete e madhe, sidomos per shkak se probabiliteti i zbatimit te aktiviteteve ne zona me burime ujore te mbrojtura, ne zona ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise, ne zona me burime ujore per larje apo ne zona me rrezik permbyteje, eshte shume i larte. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>E – ndikim shkaterrues: Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujerat nentokesore dhe siperfaqesore, ujerat e njelmet, ujerat liqenorë dhe burimet e ujit te pijshem do te jete jashtezakonisht e madhe, sidomos per shkak se probabiliteti i zbatimit te aktiviteteve ne zona me burime ujore te mbrojtura, ne zona ujembajtese me nje nivel te larte te prekshmerise, ne zona me burime ujore per larje apo ne zona me rrezik permbyteje, eshte shume i larte. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.</p>
---	--

6.2.2.5 Mjedisi Natyror - Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për **OM 6: Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.**

Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM6

Indikator / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> • mundesia e nderhyrjes ne zonat qendrore te habitateve te mishngrenesve te medhenj <i>(zbatimi i aktiviteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zonat e rendesishme ekologjike te habitateve te mishngrenesve te medhenj do te sjelle nje trysni me te madhe mbi keta lloje dhe do te nderprese linjat e migrimit; ka mundesi potenciale per</i> 	<p>A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv: Nuk do te kete ndikim ne kohezionin e popullatave dhe ne mbrojtjen e biodiversitetit, apo ndikimi do te jete pozitiv.</p> <p>B – ndikim i parendesishem: Nese zbatohen dispozitat perkatese ligjore, ndikimi ne kohezionin e popullatave dhe ne mbrojtjen e biodiversitetit do te jete i parendesishem.</p> <p>C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese: Megjithe zbatimin e dispozitave ligjore, nuk mund te garantohet</p>



<p><i>ndikim tek biodiversiteti ne nivel rajonal dhe nderkufitar)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • mundesia e nderhyrjes ne zonat me pyje te dendura <p><i>(planifikimi i infrastruktures se re ne zona me pyje te dendura do te sjelle</i></p>	<p>kohezioni i popullatave dhe mbrojtja e biodiversitetit. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimet e rendesishme.</p> <p>D – ndikim i rendesishem: Megjithatë zbatimin e dispozitave ligjore, nuk mund te garantohet kohezioni i popullatave dhe mbrojtja e biodiversitetit. Nuk eshte e mundur te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>E – ndikim shkaterrues: Megjithatë zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi mbi kohezionin e popullatave dhe mbrojtjen e biodiversitetit eshte shkaterrues. Nuk eshte e mundur te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p>
<p><i>ndikime negative mbi kafshet e egra dhe do te nderprese linjat e migrimit; ka mundesi potenciale per ndikim tek biodiversiteti ne nivel lokal dhe rajonal)</i></p>	<p>X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.</p>

Ne tabelen me poshte jane pershkruar kriteret e vleresimit dhe metodologjia per

OM 7: Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM7

Indikator / kriteri i vleresimit	Shkalla e vleresimit
<ul style="list-style-type: none"> • mundesia e nderhyrjes ne zonat e Natura 2000 dhe/ose zonat e mbrojtura <p><i>(zbatimi i aktiviteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zonat e mbrojtura do te sjelle ndikime negative ne funksionimin dhe kohezionin e ketyre zonave, si dhe tek speciet dhe llojet e vecanta te habitateve)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • mundesia e nderhyrjes ne zonat me vlera te vecanta natyrore <p><i>(zbatimi i aktiviteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne zonat me vlera te vecanta natyrore do te sjelle ndikime negative ne llojin dhe cilesine e ketyre vlerave te vecanta natyrore)</i></p>	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Nuk do te kete ndikim ne zonat natyrore me status mbrojtjeje, apo ndikimi do te jete pozitiv.</p> <p>B – ndikim i parendesishem: Nese zbatohen dispozitat perkatese ligjore, ndikimi ne zonat natyrore me status mbrojtjeje do te jete i parendesishem, megjithatë faktin se ka mundesi te nderhyrjes se aktiviteteve ne zonat natyrore me status mbrojtjeje dhe ne zonat me vlera te vecanta natyrore.</p> <p>C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese: Megjithatë zbatimin e dispozitave ligjore, zonat natyrore me status mbrojtjeje nuk mund te mbrohen. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimet e rendesishme.</p> <p>D – ndikim i rendesishem: Megjithatë zbatimin e dispozitave ligjore, zonat natyrore me status mbrojtjeje nuk mund te mbrohen. Nuk eshte e mundur te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>E – ndikim shkaterrues: Megjithatë zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi mbi zonat natyrore me status mbrojtjeje eshte shkaterrues. Nuk eshte e mundur te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.</p>



6.2.2.6 Mbetjet - Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për OM 8: Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfillleve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.


Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM8

Indikator/ kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> sasia e mbetjeve që gjenerohen dhe depozitohen në landfill <p><i>(zhvillimet e reja do të rritin sasinë e mbetjeve që gjenerohen, përfshir mbetjet e ngurta, të lengeta dhe të rrezikshme, dhe ky fakt bën që të priten ndikime negative në cilësinë e tokës, të ujërave nentokesore, të ajrit dhe në shëndetin e njerezve)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> sasia e mbetjeve që riciklohen <p><i>(SKZHI II deklaron se deri në 2020 sasia e mbetjeve urbane të ricikluara do të jetë 55%)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ndertimi i landfillleve të reja <p><i>(kjo gjë do të ndikojë pozitivisht në procesin e trajtimit dhe riciklimit të mbetjeve; megjithatë gjatë ndertimit dhe shfrytëzimit të tyre priten disa ndikime, të cilat do të jenë të përendesishme nëse aplikohet strategjia e duhur e zbutjes)</i></p>	<p>A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e pritshme nuk do të rritin sasinë e mbetjeve të gjeneruara. Zbatimi i aktiviteteve do të përmirësojë procesin e grumbullimit/trajtimit të mbetjeve.</p> <p>B – ndikim i përendesishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të rritë sasinë e mbetjeve të gjeneruara, por jo deri në atë masë sa të influencojë procesin e grumbullimit/trajtimit të mbetjeve dhe të prekë mjedisin natyror dhe njerezor.</p> <p>C – ndikim i përendesishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Zbatimi i aktiviteteve do të rritë sasinë e mbetjeve të gjeneruara, gjë që do të shkaktojë ndotje të tokës, ujit, ajrit dhe rreziqe për shëndetin e njerezve. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimin, të cilat garantojnë se procesi i grumbullimit/trajtimit të mbetjeve i përgjigjet sasisë së rritur të mbetjeve dhe se niveli i ndotjes ulët deri në kufijte e vlerave të pranuar/pecaktuara.</p> <p>D – ndikim i rëndesishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të rritë sasinë e mbetjeve të gjeneruara, gjë që do të shkaktojë ndotje të tokës, ujit, ajrit dhe rreziqe për shëndetin e njerezve. Nuk ka mundësi të merren masa zbutëse për ta mbajtur ndikimin nën kufijte e vlerave të pranuar/pecaktuara.</p> <p>E – ndikim shkatërrues: Zbatimi i aktiviteteve do të rritë sasinë e mbetjeve të gjeneruara, dhe ndotja e tokës, ujit, ajrit dhe rreziqet për shëndetin e njerezve janë në një masë të tillë që kanë efekt të konsiderueshëm dhe të demoheshëm për shëndetin e njerezve.</p> <p>X – vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.</p>

6.2.2.7 Zhurma - Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për OM 9: Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM9

Indikator/ kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit



<ul style="list-style-type: none"> ekspozimi ndaj zhurmes se shkaktuar prej nderhyrjeve ne infrastrukture <p><i>(sa me pak shqetesime qe te kete mjedisi nga zhurma, aq me i ulet eshte ndikimi ne cilesine e mjedisit, shendetin e njerezve dhe kostot e shoqerise, per shkak te numrit te njerezve te ekspozuar, shendeti i te cileve preket direkt)</i></p>	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e prishme nuk do te rritin ekspozimin ndaj zhurmes. Perkundrazi keto aktivitete do ta ulin kete ekspozim.</p> <p>B – ndikim i parendesishem: Zbatimi i aktiviteve do te rrite pak ekspozimin ndaj zhurmes, por nese zbatohen dispozitat perkatese ligjore, ndikimi do te jete i parendesishem.</p> <p>C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese: Zbatimi i aktiviteve do te rrite ekspozimin ndaj zhurmes. Megjithate zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi do te jete i rendesishem. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>D – ndikim i rendesishem: Zbatimi i aktiviteve do te rrite ekspozimin ndaj zhurmes. Megjithate zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi do te jete i rendesishem. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutese shtese per te reduktuar ndikimin. Nuk ka mundesi te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>E – ndikim shkaterrues: Zbatimi i aktiviteve do te rrite ekspozimin ndaj zhurmes deri ne nje mase te tille qe kjo gje do te kete nje efekt te konsiderueshem dhe te demshem per shendetin e njerezve e me tej.</p> <p>X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.</p>
---	--

6.2.2.8 Popullsia dhe Asetet Materiale - Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për **OM 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.**

Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM10

Indikator / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> lidhja mes vendbanimeve dhe qendrave rajonale <p><i>(nje lidhje me e shpejte dhe me e mire permireson kohezionin social: lidhja me e shpejte me qendrat e qyteteve perben nje baze me te mire per zhvillimin e turizmit dhe aktiviteve ekonomike, te cilat nga ana e tyre sjellin ndikime pozitive ne te ardhurat individuale dhe komunitare, ne menyren e jeteses dhe ne vleren e asetete materiale – pasurite e paluajtshme)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> perfshirja e aktiviteve per te permiresuar sigurine e trafikut 	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet nuk do te ndikojne ne arritjen e objektives, ose zbatimi i tyre do te permiresoje lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, do te permiresoje sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme.</p> <p>B – ndikim i parendesishem: Zbatimi i aktiviteve do te garantoje lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme, por krahasuar me gjendjen aktuale keto lidhje do te jene disi me te dobeta.</p> <p>C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese: Zbatimi i aktiviteve</p>



<p><i>(me shume aktivitete te kesaj natyre sjellin permiresim te sigurise rrugore dhe me pak aksidente)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • perfshirja e aktiviteteve per te rritur efektivitetin e transportit publik <p><i>(perdorimi sa me i madh i transportit public sjell nje levizshmeri me efektive dhe te qendrueshme; nje transport publik me efektiv sjell uljen e ngarkese se trafikut ne rruge dhe ruan vleren e aseteve materiale sic eshte toka dhe pasurite e paluajtshme; gjithashtu nje transport publik me efektiv redukton sforcen financiare per familjet, pasi redukton nevojen per te patur apo perdorur makina personale)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • perfshirja e aktiviteteve per te rritur mundesite per nje menyre te shendetshme te jeteses <p><i>(aktivitetet qe lidhen me levizshmerine e qendrueshme, kerkojne nje organizim te mire te infrastruktures clodhese/agetuese (per shembull korsite e bicikletave, monopetet e ecjes me kembe, perfshire edhe mberrijen deri aty); clodhja/argetimi ndikon pozitivisht ne gjendjen mendore dhe fizike te njerezve dhe ne kete menyre redukton kostot e shoqerise, pasi shfrytezohet nje menyre e shendetshme e jeteses)</i></p>	<p>do t'i beje me te dobeta lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme, krahasuar me gjendjen aktuale. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>D – ndikim i rendesishem: Zbatimi i aktiviteteve do t'i beje konsiderueshem me te dobeta lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme, krahasuar me gjendjen aktuale. Nuk ka mundesi te merren masa zbutese.</p> <p>E – ndikim shkaterrues: Zbatimi i aktiviteteve do t'i shkateroje plotesisht lidhjet mes zonave te vecuara me qendrat rajonale, sigurine e trafikut dhe levizshmerine e qendrueshme, krahasuar me gjendjen aktuale.</p> <p>X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.</p>
---	---

6.2.2.9 Trashëgimia Kulturore - Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për **OM 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.**

Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM11

Indikator / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> • probabiliteti qe infrastruktura te shtrihet ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore <p><i>(zbatimi i aktiviteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne njesite e trashegimise kulturore mund te rrezikojne seriozisht integritetin e trashegimise dhe te modifikojne vecorite e saj cilesore. Vecanerisht te rrezikuar jane peisazhet kulturore dhe peisazhet</i></p>	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk shtrihen njesite e regjistruara te trashegimise kulturore. Perderisa hapësira nuk do te cenohet, edhe mbetjet arkeologjike nuk do te demtohen.</p> <p>B – ndikim i parendesishem: Ka mundesi potenciale qe aktivitetet te shtrihen ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore. Perderisa aktivitetet shtrihen prane apo pergjate infrastruktures ekzistuese, probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore dhe qe mbetjet arkeologjike te demtohen, eshte i ulet. Duke zbatuar dispozitat perkatese ligjore, ndikimi mbi vecorite cilesore te njesive te regjistruara te trashegimise kulturore do te jete i parendesishem.</p>



<p><i>historike te zonave te trashegimise arkitektonike dhe arkeologjike)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • probabilitet i shkaterrimit te mbetjeve arkeologjike <p><i>(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne</i></p>	<p>C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese: Probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore, dhe per pasoje te zvogelojne permasat e tyre, eshte i larte. Megjithatë zbatimin e parashikimeve ligjore, ndikimi i aktiviteteteve mbi trashegimine kulturore do te jete i rendesishem. Per shkak se aktiviteti shtrihet ne zone te gjere, probabiliteti i demtimit te mbetjeve arkeologjike eshte i larte. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p>
<p><i>njesite e trashegimise kulturore nenkupton cenimin e tokes dhe si pasoje mbari nje probabilitet te larte per shkaterrimin e mbetjeve arkeologjike)</i></p>	<p>D – ndikim i rendesishem: Probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne njesite e regjistruara te trashegimise kulturore, dhe per pasoje te zvogelojne permasat e tyre, eshte shume i larte. Megjithatë zbatimin e parashikimeve ligjore, ndikimi i aktiviteteteve mbi trashegimine kulturore do te jete i konsiderueshem. Per shkak se aktiviteti shtrihet ne zone te gjere, probabiliteti i demtimit te mbetjeve arkeologjike eshte shume i larte. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p>
	<p>E – ndikim shkaterrues: Ndikimi i aktiviteteteve mbi vecorite cilesore te njesive te regjistruara te trashegimise kulturore, do te jete shkaterrues. Edhe ndikimi mbi mbetjet arkeologjike do te jete shkaterrues.</p> <p>X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.</p>

6.2.2.10 Peisazhi - Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për

OM 12: Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peisazhi me cilësi të lartë.

Tab. - Indikatorët dhe shkalla e vlerësimit për OM12

Indikator / kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> • probabiliteti qe infrastruktura te shtrihet ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar <p><i>(zbatimi i aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne njesite e peisazhit mund te rrezikojne seriozisht integritetin e peisazheve te vecanta dhe zonave peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar, dhe te shkatërrojë vecorite e tyre cilesore)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • probabiliteti qe infrastruktura te shtrihet ne zonat peisazhistike me elemente te mbrojtur te natyres 	<p>A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk shtrihen ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar. Do te ruhet imazhi i peisazhit me cilesi te larte, pasi aktivitetet do te integrohen ne zona me nje shkalle te larte te degradimit te peisazhit.</p> <p>B – ndikim i parendesishem: Ka mundesi potenciale qe aktivitetet te shtrihen ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar, apo ne zona peisazhistike imazhi i te cilave eshte ne prishje e siper. Ndikimi mbi imazhin eksitues te peisazhit do te jete i parendesishem, pasi shumica e aktiviteteteve do te integrohen ne zona me nje shkalle te larte te degradimit te peisazhit.</p> <p>C – ndikimi behet i parendesishem per shkak te zbatimit te masave zbutese: Probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar, eshte i larte. Ndikimi mbi vecorite cilesore te ketyre zonave eshte i madh. Aktivitetet do te shtrihen ne zona te konservuara peisazhistike natyrore apo</p>



<p>dhe ne zonat me peisazhistike kulturore jashtezakonisht te ekuilibruara, te cilat mbartin edhe simbolika te vecanta</p> <p><i>(zbatimi i aktiviteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore ne njesite e peisazhit mund te ndryshoje ne menyre te konsiderueshme imazhin ekzistues te peisazhit. Ndikimi eshte vecanerisht i dukshem ne zonat peisazhistike me elemente te mbrojtur te natyres dhe ne zonat me peisazhistike kulturore jashtezakonisht te ekuilibruara)</i></p>	<p>kulturore, keshtu qe ndikimi ne peisazhet me cilesi te larte te imazhit te tyre, do te jete i rendesishem. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>D -- ndikim i rendesishem: Probabiliteti qe aktivitetet te shtrihen ne peisazhe te vecanta dhe zona peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar eshte i madh, keshtu qe edhe ndikimi eshte i konsiderueshem. Aktivitetet do te shtrihen ne zonat peisazhistike me elemente te mbrojtur te natyres dhe ne zonat me peisazhistike kulturore jashtezakonisht te ekuilibruara, keshtu qe ndikimi ne peisazhet me cilesi te larte te imazhit te tyre, do te jete i rendesishem. Nuk mund te merren masa zbutese per te reduktuar ndikimin.</p> <p>E -- ndikim shkaterrues: Ndikimi i aktiviteteve mbi vecorite cilesore te peisazheve te vecanta dhe zonave peisazhistike me vecori dalluese ne nivel kombetar do te jete shkaterrues. Peisazhet me cilesi te larte te imazhit te tyre dhe qe permbajne elemente te jashtezakonshem natyrore dhe kulturore, do te shkatërrohen.</p> <p>X -- vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur: Ndikimi nuk mund te vleresohet per shkak te mungeses se te dhenave.</p>
---	--



SEKSIONI 7 - VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE

7.1 VLERËSIMI I PËRPUTHSHMERISË


Objektivat e përcaktuara mjedisore duhet të jenë në përputhje me Ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedor”, objektivat e përcaktuar në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikën dhe projektet që parashikon Planin për të arritur objektivat e tij. Për të përcaktuar rëndësinë e objektivave mjedisore, duhet të vlerësohet përputhshmëria e objektivave dhe politikave të Planit me objektivat e përcaktuara mjedisore. Vlerësimi i përputhshmërisë krijon konflikte apo veprime të ndërsjellta mes objektivave dhe politikave të ndryshme, si dhe konflikte të theksuara të interesit mes objektivave; të gjitha këto duhen vënë në dukje veçanërisht në pjesën e vlerësimit të projekteve specifike të Planit. Përputhshmëria e politikave të Planit është vlerësuar duke i kombinuar këto politika me objektivat mjedisore të kësaj VSM-je. Vlerësimi është bërë duke përdorur përafrimin standart në formë matrice. Për të kryer vlerësimin numerik të nivelit të përputhshmërisë është përdorur grafiku i vlerësimit që jepet më poshtë.

Tab. - Grafiku i vlerësimit të nivelit të përputhshmërisë mes objektivave

Niveli i përputhshmërisë	Vlerësimi numerik
Objektivat përputhen plotësisht	3
Objektivat përputhen pjesërisht	2
Lidhja mes objektivave është e zbehtë	1
Nuk ka lidhje mes objektivave	0
Objektivat nuk përputhen	-1

7.2 VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE DHE POLITIKAVE TË PLANIT ME OBJEKTIVAT MJEDISORE

Rezultatet e vlerësimit të përputhshmërisë së politikave të Planit me objektivat mjedisore janë paraqitur në Tabelën më poshtë. Tabela tregon se, në parim, të gjitha politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore.



Objektiva Strategjike 2 (OS 2): Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit												
<i>Politika 1:</i>	Ngritja e një sektori në bashki për turizmin edhe marketimin e tij në Hasit	2		2	2	2	2	2	2	2	2	2.17
<i>Politika 2:</i>	Krijimi i hartave turistike dhe Itinerarit lëvizëse në pyjet e Bashkisë	2		2	2	2	2	2	2	2	2	2.17
<i>Politika 3:</i>	Ndërtimi i intenerareve turistike kulturore natyrore – gastronomike (agroturizmi) në bashkëpunim me rajonin	2		2	2	2	2	2	2	2	2	2.17
<i>Politika 4:</i>	Bashkërendimi me bashkitë kufitare për të krijuar itinerare	2		2	2	2	2	2	2	2	2	2.17
<i>Politika 5:</i>	Krijimi i guidave dhe trajnimi i tyre për turizmin në Bashkisë	2		2	2	2	2	2	2	2	2	2.17
<i>Politika 6:</i>	Ndërtimi i InfoPoint në pika të ndryshme të territorit të Bashkisë	2		2	2	2	2	2	2	2	2	2.17
Objektiva Strategjike 3 (OS 3): Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase												
<i>Politika 1:</i>	Ngritja e strukturave menaxhuese të posatshme të sektorit të bujqësisë prane bashkisë (politika, monitorim dhe certifikim)	2		2	2	1	1	3	3	3	3	2.08
<i>Politika 2:</i>	Marketimi i produkteve vendase të zonës	2		2	2	1	1	3	3	3	3	2.08
<i>Politika 3:</i>	Zhvillimi i prodhimit vendas i formave autoktone të bimëve, si përnarija dhe bimë medicinale	2		2	2	1	1	3	3	3	3	2.08
<i>Politika 4:</i>	Krijimi i pikave të agroturizmit në zona të përshatshme për kultivimin e bimëve dhe mbarështimin e kafshëve	2		2	2	1	1	3	3	3	3	2.08
<i>Politika 5:</i>	Ndërtimi i pikës për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve ushqimore vendase për të furnizuar nevojat lokale dhe	2		2	2	1	1	3	3	3	3	2.08
<i>Politika 6:</i>	Krijimi i markës Brand për produktet lokale të bashkisë Hasit	2		2	2	1	1	3	3	3	3	2.08
Objektiva Strategjike 4 (OS 4): zhvillimi i infrastrukturës ekzistuese edhe asaj lidhëse me vendet fqinje												
<i>Politika 1:</i>	Programe afatgjata për mirëmbajtjen e tyre	3		3	3	2	1	1	1	1	1	2.08
<i>Politika 2:</i>	Përmirësimi i rrugëve lokale ekzistuese për të rritur aksesin: Aksi Has - Çchan; Asfaltimi i rrugës së fshatit Zahrisht.	3		3	3	2	1	1	1	1	3	2.08
<i>Politika 3:</i>	Përmirësimi i rrugëve me rëndësi kombëtare	3		3	3	2	1	1	1	1	3	2.08
<i>Politika 4:</i>	Krijimi i aksit të rrugëve me fshatrat	2		2	2	1	1	3	3	3	1	2.08
<i>Politika 5:</i>	Sistemimi i rrugës Nikoliq - Krumë-Gola, Krumë -Zahrisht, Dobrunë-Golaj	2		2	2	1	1	3	3	3	3	2.08

Objektiva Strategjike 7 (OS 7): Programi I Permissimit te Sherbimeve Publike te Bashkise												
<i>Politika 1:</i>	Mbrojja e monumenteve të kulturës dhe atyre historike	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00
<i>Politika 2:</i>	përmirësimi i aksesit në infrastrukturë dhe përfshirja e monumenteve të kulturores dhe historisë si pjesë e guidave turistike	2	2	1	1	3	3	3	3	3	3	2.5
<i>Politika 3:</i>	restaurimi dhe përdorimi i këtyre monumenteve si pika atraksioni turistik	2	2	1	1	3	3	3	3	3	3	2.5
<i>Politika 4:</i>	Ndërtimi i Muzeum i Varrezave të dëshmorëve	2	2	1	1	3	3	3	3	3	3	2.5
Objektiva Strategjike 8 (OS 8): Zhvillimi i qëndrueshëm i industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të produkteve minerare												
<i>Politika 1:</i>	Hartimi i një Plan studimi për rezervat minerale të bashkisë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1.00
Hasit												
<i>Politika 2:</i>	Restaurimi i pikave ekzistuese të zonave minerare	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1.00
<i>Politika 3:</i>	Hartimi i një Plan studimi për nxjerrjen e produkteve minerare në mënyrë të qëndrueshme dhe pa dëmtuar mjedisin	2	2	2	0	1	0	1	0	2	0	1.00



Në këndvështrimin e lidhjes mes politikave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Konkretisht:

1. Politikat që lidhen me Përmirësimin e Cilësisë Urbane dhe ato që lidhen me Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Cilësisë së Mjedisit kanë klasifikimin më të lartë në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore.
2. Politikat që lidhen me Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik dhe Përmirësimin e Infrastrukturës kanë klasifikimin më të ulët në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore. Sidoqoftë, secila prej këtyre politikave është në përputhshëri të plotë me të paktën një, dhe në shumicën e rasteve me 2 dhe 3 objektiva mjedisore.
3. Dy politika të Planit, specifiku: Vendosija e standarteve të projektimit urban, dhe Krijimi i Parqeve Rajonale, janë në përputhshëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore, duke marrë rezultatin maksimal të mundshëm.
4. Secila prej politikave të planit (përveç dy politikave që klasifikohen me përputhshëri të plotë) nuk kanë lidhje me të paktën 1 objektivë mjedisore dhe në shumicën e rasteve me 2 objektiva.
5. Dy objektiva të Planit që lidhen me Sistemin Urban janë pothuajse në përputhshëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore.
6. Politika e cila ka lidhje me Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik dhe më specifiku Programin specifik për zhvillimin e biznesit, financave të qëndrueshme, nuk ka lidhje me asnjë prej objektivave tona mjedisore.

Edhe në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore diversifikimi i përputhshmërisë është i lartë. Konkretisht:

- Objektiva mjedisore 1 që lidhen me menaxhimin e tokës, dhe objektiva 10 që lidhen me popullsinë, janë në përputhshëri të plotë me pjesën më të madhe të politikave të planit;
- Duhet theksuar se të dyja këto objektiva janë ose në përputhshëri të plotë, ose nuk lidhen me politikave të planit;
- Objektiva 11 që lidhet me ruajtjen e trashëgimisë kulturore është objektiva që nuk lidhet me pjesën më të madhe të politikave të Planit;
- Të gjitha objektivat e tjera mjedisore paraqesin një diversitet të madh lidhur me nivelin e përputhshmërisë së tyre me politikave përkatëse të Planit.

Si konkluzion mund të thuhet se, në këndvështrimin e përgjithshëm, objektivat dhe politikave të Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore



SEKSIONI 8 - VLERËSIMI I PROJEKTEVE

Plani i Përgjithshëm urban i bashkisë së Hasit përcakton projekte konkrete për çdo politikë, të cilat janë gjykuar si më të përshtatshmet për zbatimin e politikës përkatesë. Projektet janë listuar për çdo politikë, sipas përcaktimeve në Plan.

Në Tabelën e mëposhtme janë identifikuar projektet specifike dhe vlerësimi i tyre për ndikime direkte apo indirekte në mjedis, në lidhje me objektivat mjedisore të përcaktuara. Shkurtimisht, këto projekte përfshijnë rigjenerimin e qendrave urbane dhe rurale, projekte që lidhen me përmirësimin e shërbimeve publike dhe private, urbanizimin, stilin e jetesës, hapësira argëtimi/çlodhjeje, turizmin, bujqësinë, mjedisin etj. Ky seksion përfshin vlerësimin e projekteve specifike në lidhje me përputhshmërinë e tyre me objektivat mjedisore. Vlerësimi i projekteve specifike është bërë mbi bazën e përcaktimit të klasifikimit mesatar të përputhshmërisë së secilit projekt me të 12 objektivat mjedisore. Projektet e listuara më poshtë do të përputhen plotësisht apo pjesërisht me objektivat mjedisore, gjatë zbatimit dhe funksionimit të aktiviteteve përkatesë, dhe për të gjitha aktivitetet duhet të garantohet zbatimi i masave zbutëse për të reduktuar ndikimin në mjedis, sipas kërkesave të legjislacionit përkatesë.

Fisha e projektit 1

Emri i projektit	Asfaltimi i aksit Dobrunë-Golaj (OS4)
Vendodhja	Dobrunë-Golaj, Njësia Administrative Golaj
Përmasa	7.19 km ,1 kat ,Viti i Ndërtimit 1945-1960
Kosto e ndërhyrjes	359,500,000 ALL
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afatshkurter (1 vit) , Afatmesëm (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rritja e aksesit në infrastrukture me shkurtimin e distances kohore dhe rritjen e cilësisë
Përshkrimi i projektit	Asfaltimi i aksit Dobrunë-Golaj ndihmon lëvizjen e banorëve të Dobrunës për të shkurtuar distancën kohore për tu lidhur me fshatin Golaj qendrën e bashkisë qytetin e Krumës dhe më pikën doganore . Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe i jep mundësi zhvillimit të zonës. Rruga ndodhet në gjendje të keqe e shtruar me çakull . Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Dobrunë duke shkurtuar ndjeshëm distancën kohore duke lehtësuar marrjen e shërbimeve për banorët e Dobrunës.



	<p>Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës ,ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhëpave për shkëmbimin e makinave.</p> <p>Aksi rrugor i propozuar bashkohet në Golaj me Segmentin Rrugor Kombëtar (SH23).</p>
--	--

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 2

Emri i projektit	Asfaltimi i aksit Zahrisht-Krumë (OS4)
Vendodhja	Zahrishtë, Krumë
Përmasa	4.1 km ,
Kosto e ndërhyrjes	205,000,000 ALL
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afatshkurter (1 vit) , Afatmesëm (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rritja e aksesit në infrastrukture me shkurtrimin e distances kohore dhe rritjen e cilësisë.
Përshkrimi i projektit	<p>Gjendja e keqe e rrugës ka shkaktuar që të mos shrytëzohet sa duhet nga ana e banorëve të fshatit Zahrisht. Asfaltimi i këtij aksi do ndihmojë në uljen e distancë kohore dhe integron fshatin Zahrisht me qytetin e Krumës duke krijuar dhe mundësi më të mira për zhvillimin e Zahrishtës</p> <p>Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhërrit flukset e përdorimit për banorët e Zahrishtës .</p> <p>Rruga ndodhet në gjendje mesatare e shtruar me cakull .</p> <p>Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Zahrisht duke shkuruar ndjeshëm distancën kohore duke lehtësuar marrjen e shërbimeve për banorët e Zahrishtës.</p> <p>Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës ,ndërtimin e veprave inxhinierike ,krijimin e xhëpave për shkëmbimin e makinave.</p> <p>Aksi prej 4.1 km shtrihet nga qendra e fshatit Zahrishtë dhe lidhet në Fshat-Krumë ku bashkohet me segmentin Kombëtar (SH23)</p>

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.



Treguesit e monitorimit	Rritja e aksesit në infrastrukture me shkurtimin e distancës kohore dhe rritjen e cilësisë.
Përshkrimi i projektit	Dhe pse në distancë të afërt me qytetin e Krumës rrjeti infrastrukturës rrugore nuk është në gjendje optimale duke sjell vështirësi në qarkullimin e banorëve të zonës . Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht pasi integron fshatin Nikoliq me qendrën e bashkisë së Hasit duke lehtësuar në mënyrë të ndjeshme aksesin në shërbime, infrastrukture etj, por dhe duke ndihmuar Nikoliqin në thithjen e investimeve private . Rruga ndodhet në gjendje mesatare e shtruar me cakull. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike ,krijimin e xhëpave për shkëmbimin e makinave. Aksi prej 2.5 km shtrihet nga qendra e fshatit Zahrishtë dhe lidhet me segmentin Kombëtar (SH23)

Fisha 3

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 4

Emri i projektit	Asfaltimi i aksit Kostur-Helshan- (SH23) Has-Tropojë (OS4)
Vendodhja	Kostur ,Helshan
Përmasa	6.9 km ,
Kosto e ndërhyrjes	345,000,000
Burimet financiare	Investim publik
Emri i projektit	Asfaltimi i aksit Nikoliq- Krumë (OS4)
Fazat	Afatshkurter (1 vit) Afatmesëm (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Përmasa	2.5 km ,
Burimet njerëzore	
I reguesit e monitorimit	Rritja e aksesit në infrastrukture me shkurtimin e distancës kohore dhe rritjen e cilësisë.
Burimet financiare	Investim publik
Përshkrimi i projektit	Projekti kërkon asfaltimin e rrugës të fshatrave Helshan dhe Kostur dhe lidhjen e tyre me infrastrukturën rrugore ekzistuese të bashkisë Has. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe shkorton ndjeshëm kohën për banorët e fshatrave Kostur dhe Helshan. Rruga ndodhet në gjendje mesatare e shtruar me cakull . Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike ,krijimin e xhëpave për shkëmbimin e makinave. Aksi prej 6.9 km shtrihet nga qendra e fshatit Kostur më pas duke kaluar nga qendra e fshatit Helshan dhe përfundon duke u intersektuar me segmentin (SH23)



Emri i projektit	Rikonstruksion i Shkollës 9-vjecare Helshan (OS6)
Vendodhja	Helshan
Përmasa	281m ² , 1 kat, Viti i Ndërtimit 1960-1980
Kosto e ndërhyrjes	5,268,750
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afatshkurter (1 vit) Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rritja e cilësisë së infrastrukturës të ndërtesës dhe ofrimi i procesit të mësimdhënies sipas standarteve
Përshkrimi i projektit	Shkolla 9-vjecare e fshatit Helshan i shërben dhe fshatit Kostur duke rritur ndikimin që ky investim ka në zonë. Kjo e bën të rëndësishme ndërhyrjen për përmirësimin e infrastrukturës së ndërtesës të shkollës për të ofruar një shërbim më cilësor për nxënësit frekuentues të kësaj shkolle. Shkolla 9-vjecare Helshan ndodhet në gjendje keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatrave Helshan dhe Kostur Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës të Shkollës.


Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 5

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 6

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.




Emri i projektit	Rikonstruksion i Qendrës Shendetësore Pusi i Thate (OS6)
Vendodhja	Pusi i Thate
Përmasa	49 m ² , 1 kat
Kosto e ndërhyrjes	918,750
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afatshkurter (1 vit), Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rritja e aksesit së infrastrukturës të ndërtesës dhe lehtësimi i marrjes së shërbimeve në Shendetësi
Përshkrimi i projektit	Distanca e largët nga spitali i qytetit të Krumës dhe infrastruktura e dobët rrugore e cila vështirëson ofrimin e shërbimit shëndetësor ndikon negativisht në marrjen e këtij shërbimi për banorët e fshatit Pus i Thatë .Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesit në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë për banorët e fshatit Qendra Shëndetësore e fshatit Pus i Thatë ndodhet në gjendje të keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Pus i Thatë. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës të Qendrës Shëndetësore

Fisha 7

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 8

Emri i projektit	Rikonstruksion i Qendrës Shendetësore Brenogë . (OS6)
Vendodhja	Brenogë
Përmasa	41 m ² , 1 kat
Kosto e ndërhyrjes	768,750
Burimet financiare	Ivestime publike
Fazat	Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	



Treguesit e monitorimit	Rritja e aksesit së infrastrukturës të ndërtesës dhe lehtësimi i marrjes së shërbimeve në Shendetësi.
Përshkrimi i projektit	Qendra shëndetësore Brenogë i shërben fshatit Brenogë. Distanca e largët nga qendrat shëndetësore kryesore dhe infrastruktura e dobët rrugore e cila vështirëson ofrimin e shërbimit shëndetësor ndikon negativisht në marrjen e këtij shërbimi për banorët e fshatit Brenogë. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesit në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë Qendra Shëndetësore e fshatit Brenogë ndodhet në gjendje mesatare sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Brenogë. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës të Qendrës Shëndetësore
Emri i projektit	Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjecare Fshat-Krumë (OS6)
Vendodhja	Fshat-Krumë
Përmasa	537m ² , 2 kat, Viti i Ndërtimit 1960-1980
Kosto e ndërhyrjes	10,068,750
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afatshkurter (1 vit), Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësin	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rritja e cilësisë së infrastrukturës të ndërtesës dhe ofrimi i procesit të mësimdhënies sipas standarteve
Përshkrimi i projektit	Shkolla 9 vjecare e Fshat Krumë ka një rol të rëndësishëm pasi i shërben gjithë zonave në periferi të qytetit të Krumës. Kjo bën që standartet e shkollës të përmirësohen për të përmbushur standartet . Shkolla Fillore Berishë e Vogël ndodhet në gjendje mesatare sa sa i përket infrastrukturës duke kërkuar ndërhyrje minimale në përmirësimin e saj. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e Fshat Krumë dhe lagjeve në periferi të qytetit të Krumës Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës të Shkollës.

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejperdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.



Fisha 9

Emri i projektit	Projekt pyllëzimi për mbrojtjen e pyjeve në bashkinë Has (3 Lote). (OS1)
Vendodhja	Bashkia Has
Përmasa	3991 Ha
Kosto e ndërhyrjes	1,161,600,505
Burimet financiare	Bashkëpunim publik-privat
Fazat	Afashkurter (1 vit), Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rritja e sipërfaqes pyjore me 3991 Ha e shpërndarë në 3 pjesë të ndryshme të territorit
Përshkrimi i projektit	<p>Bashkia Has është një ndër bashkitë të cilat mbartin sipërfaqen më të madh të pyjeve në Shqipëri. Sistemi Natyror zë 87.4 % të sipërfaqes së bashkisë .Shfrytëzimi i pakontrolluar i sipërfaqes pyjore dhe djegia e tyre gjatë 28 viteve ka sjellë që një pjesë e madhe e sipërfaqes pyjore është dëmtuar duke sjell dhe dëmtim të florës dhe faunës .</p> <p>Loti 1-përfshin sipërfaqe pyjore ndërmjet njësive administrative Golaj, Krumë, Fajzë midis fshatit Zgjec dhe Qarr, pjesa midis fshatit Helshan dhe Liqeni Kuq dhe ka një sipërfaqe prej 559.8 Ha.</p> <p>Loti 2- përfshin sipërfaqe pyjore në njësinë administrative Gjinaj në jug – lindje të bashkisë, në fshatrat midis Punit të Thatë dhe Mujaj me sipërfaqe 1952,4 Ha.</p> <p>Loti 3- përfshin sipërfaqe në lindje të bashkisë Has, e cila shtrihet mes njësisë Golaj dhe Gjinaj, në hapësirën mes fshatrave Dobrunë, Gajrep dhe Çahan dhe ka një sipërfaqe prej 1488.8 Ha.</p> <p>Mbjellja e bimësisë dhe pemëve propozohet të jetë sipas llojeve që rriten aktualisht në Has si : pisha ,dushku dhe ahu.</p>
Emri i projektit	Ndërtimi i pikës të Agro-Turizmit në Golaj (OS2)
Vendodhja	Golaj,
Përmasa	500 m ²
Kosto e ndërhyrjes	19,640,500
Burimet financiare	Investim privat
Fazat	Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Zhvillimi dhe rritja e Agro-Turizmi për zonën në studim.
Përshkrimi i projektit	<p>Strukturat agro-turistike ofrojnë një mundësi të mirë për zhvillimin e zonave rurale duke ruajtur dhe identitetin e tyre. Ndërtimi i një strukture të tillë me funksion akomodues dhe ofrimi shërbimi për turistët ndihmon në rritjen ekonomike lokale.</p> <p>Ndërtimi i saj shërben dhe si projekt pilot për të matur shkallën e suksësit të saj në momentin e funksionimit .</p>



	Ky projekt synon ndërtimin e ndërtesës të agroturizmit ku përfshihet struktura akomoduese, restoranti, punishtet e përpunimit të produkteve lokale. Arkitektura e ndërtesës propozohet të jetë në sinkron me arkitekturën e zonës përreth duke ruajtur identitetin e zonës së Golaj, dhe të pozicionohet pranë rezervuarit në Golaj dhe për peizazhin e përfluar nga ky aktivitet.
--	--

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 10

Emri i projektit	
Rikonstruksion i Qendrës Shendetësore Vlahen (OS6)	
Vendodhja	Vlahen
Përmasa	71 m ² , 1 kat
Kosto e ndërhyrjes	120,161,600
Burimet financiare	Bashkëpunim publik-privat
Fazat	Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rritja e aksesit të infrastrukturës të ndërtesës dhe lehtësimi i marrjes së shërbimeve në Shendetësi .
Përshkrimi i projektit	Gjendja e keqe e infrastrukturës rrugore dhe e qendrës shendetësore vështirëson marrjen e shërbimeve në bujqësi për banorët e fshatit Vlahen. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesit në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë. Qendra Shëndetësore e fshatit Vlahën ndodhet në gjendje mesatare sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Vlahën. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës të Qendrës Shëndetësore

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në eliminimin e trafikut duke sjellë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së ajrit etj. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 11

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në rritjen e aksesit të turistëve në zonë duke ofruar një rrugë peizazhiste. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, dhe nuk kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së përzgjedhjes.




Emri i projektit	Krijimi i markës Brand për produktet lokale të bashkisë Has. (OS3)
Vendodhja	Bashkia Has
Përmasa	1200 m ²
Kosto e ndërhyrjes	375,000
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Krijimi i markës dhe përdorimi i saj në produktet lokale..
Përshkrimi i projektit	<p>Bashkia Has duhet të promovojë produktet lokale për të rritur turizmin dhe eksportin e këtyre produkteve .Projekti ka si qëllim krijimin e një logoje të njejtë për gjitha produktet lokale të bashkisë Has</p> <p>Brandimi i produkteve lokale nën të njëjtën logo ndihmon në rritjen e cilësisë të produktit dhe ruajtjen e standartit.Gjithashtu ndihmon në promovimin e produkteve lokale të Has dhe në zona tjera të Shqipërisë .</p> <p>Ky projekt synon krijimin e nje logoje që mund të përdoret për gjitha produktet lokale të bashkisë Has</p>

Fisha 12

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja e zhvillimit të turizmit, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në ndihmen e turistëve për marrjen e informacionit dhe ndihmon ata në lehtësimin e marrjes së shërbimeve plotësuese. Ky projekt përputhet me objektivat e zhvillimit të turizmit, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 13

Emri i projektit	Hartimi i një Plan studimi për rezervat minerale të bashkisë Has (OS8)
Vendodhja	Bashkia Hasi.
Përmasa	-----
Kosto e ndërhyrjes	375,000
Burimet financiare	Bashkëpunim publik-privat
Fazat	Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Hartimi i një Plan studimi për rezervat minerale të bashkisë Has
Përshkrimi i projektit	<p>Hasi është një bashki e cila ka me rezerva të mëdha minerare. Një pjesë e këtyre mineralave është e lokalizuar bashkë me sasinë e mineraleve, ku njëkohësisht ka ndikuar dhe në ekonominë e zonës. Bashkia mund të hartojë një studim më të detajuar të cilës mund ta nisë si rezultat i studimeve paraprake dhe të njoftojë në pah pikat më të rëndësishme në favor të</p>



	zhvillimin ekonomik të gjithë territorit të bashkisë. Ky dokument ndihmon bashkinë në thithjen e investitorëve të ndryshëm në sektorin mineral . Ky projekt synon hartimin e Plan Studimit që do i shërbejë bashkisë Has për thithjen e investimeve në zhvillimin e minierave
Emri i projektit	Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të qytetit Has (OS6)
Vendodhja	Bashkia Has
Përmasa	7.8 km
Kosto e ndërhyrjes	51,441,000
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për qytetin e Hasit
Përshkrimi i projektit	Qyteti i Hasit një nga problemet kryesore në fushën e infrastrukturës është infrastruktura e kanalizimeve .Aktualisht ujërat e zeza janë të depozituara në gropa septike e cila shkakton ndotje të nëntokës dhe probleme mjedisore për bashkinë Has. Nisur nga kjo problematikë është e nevojshme ndërtimi i një rrjeti kanalizimesh prej 7.8 km në qytetin e Hasit për largimin e ujërave të zeza të qytetit . Ndërtimi i rrjetit të ujërave të zeza ndihmon në largimin e ujërave të zeza të qytetit duke rritur dhe cilësinë e mjedisit përreth. Ky projekt synon ndërtimin nga e para e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza për lagjet kryesore të qytetit të Hasit

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja agrobujqesore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e produkteve bujqësore të zonës dhe konkurruese në treg dhe të arrijnë tregjet rajonale kryesore. Ky projekt përputhet me objektivat agroturizmit, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 14

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja agroturizmit, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në rritjen e cilësisë të produktit dhe ruajtjen e standartit. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 15

Emri i projektit	Ndërtimi i fermes mbarështrimi në Fshatin Zgjec (OS3)
Vendodhja	Fshati Zgjec, Njësia Administrative Golaj



Përmasa	1500 m ²
Kosto e ndërhyrjes	41,137,200
Burimet financiare	Investim privat
Fazat	Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Ndërtimi i fermes mbarështrimi dhe zhvillim blegtoral dhe vendosja në funksion e saj
Përshkrimi i projektit	Bashkia Has në teritorin e saj ka sipërfaqe të ndryshme dedikuar kullotjes. Nga ana tjetër ajo është e zhvilluar nga ana blegtorale dhe do ndikojë pozitivisht në ndërtimin e fermës për të mbarështuar bagëtitë sipas kushteve të duhura. Krijimi i fermës në zonën e Zgjecit ku ka dhe më shumë sipërfaqe për kullotje do të sjellë dhe ma pak kosto dhe më shumë zhvillim për banorët dhe kujdesin ndaj bahtive të tyre. Projekti synon krijimin e fermës më një sipërfaqe prej 1500m ² dhe të ketë plotësuar kushtet që i duhen një ferme për mbarështrimin e gjesë. Ndërtimi saj do bëhet me materiale sa më të përshatshme dhe për zonën ku po zhvillohet duke ruajtur dhe karakteristikat e saj.

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja historike, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në njohjen e historisë së zonës. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave mbrojtëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 16

Emri i projektit	Hartimi i plan Menaxhimi për rrugët lokale të Bashkisë Has (OS4)
Vendodhja	Bashkia Hasi
Përmasa	----
Kosto e ndërhyrjes	2,500,000 ALL
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afashkurtër (1 vit)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rritja e aksesit në infrastrukture me shkurtime të distancës kohore dhe rritjen e cilësisë.
Përshkrimi i projektit	Bashkia Has ka një rrjet rrugor me 749.2 km rrugë të kategorive të ndryshme ku mbizotërojnë rrugët lokale . Problematikat më të mëdha shfaqen gjatë periudhës së dimrit, për shkak të terrenit goxha të thyer dhe dëborës. Mirëpo kapacitetet e bashkisë nuk janë të mjaftueshme për të mirëmbajtur rrugët e saj sidomos ato lokale në mënyrë që të ofrojë shërbimin e duhur.



Bashkia Has ka nevojë për një plan menaxhimi që të mund të propozojë disa mënyra dhe skema në favor të saj, dhe më kosto sa më të ulët dhe për buxhetin e bashkisë dhe në të njëjtën kohë të ofrojë dhe shërbimin sipas standarteve.

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në cilësinë e jetës së banorëve, në largimin e ujërave të zeza të qytetit duke rritur dhe cilësinë e mjedisit perreth. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 17

Emri i projektit	Krijimi i Intinerarit lëvizës në hapësirat natyrore Golaj- Fajzë (OS2)
Vendodhja	Golaj, Fajzë. Njësia Administrative Golaj dhe Fajzë
Përmasa	11.3 km
Kosto e ndërhyrjes	33,900,000 ALL
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afat Mesëm (1-3 Vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Krijimi i Intinerarit lëvizës në hapësirat natyrore Golaj- Fajzë
Përshkrimi i projektit	Krijimi i intenerarit përgjatë hapësirave natyrorë midis fshatrave Golaj dhe Fajzë do krijojë mundësinë e njohjes së natyrës së Hasit. Ky projekt njëkohësisht lidh dhe fshatin Golaj me Fajzën. Ky projekt rrit aksesin e turistëve në zonë duke ofruar një rrugë peizazhistike. Krijimi i intenerarit ofron mundësi për zhvillimin e turizmit pasi ofron akses në një hapësirë të pashfrytëzueshme deri tani për shkak të mungesës të infrastrukturës. Ky projekt synon krijimin e intenerarit lëviz në hapësirat natyrore dhe gjithashtu do jetë e plotësuar me sinjalistikën e duhur dhe përkatëse për shtigjet dhe zonat natyrore. Gjithashtu dhe krijimin e një harte turistike për zonën e Hasit.

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në ndihme të bashkisë në thithjen e investitorëve të ndryshëm në sektorin minerar. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.



Fisha 18

Emri i projektit	Rikonstruksion i Shkollës Mesme Vlahen. (OS6)
Vendodhja	Vlahën
Përmasa	526m ² , 1 kat ,Viti i Ndërtimit 1960-1980
Kosto e ndërhyrjes	9,862,500
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afatshkurter (1 vit) Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rritja e cilësisë së infrastrukturës të ndërtesës dhe ofrimi i procesit të mësimdhënies sipas standarteve
Përshkrimi i projektit	Gjendja ekzistuese e ndërtesës ndikon negativisht në procesin e mësimdhënies. Distanca e largët nga shkollat e mesme të tjera e lidhur bashkë me aksesin e dobët në infrastrukture dhe problematikat e bllokimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit . Kjo bën të nevojshme ndërhyrjen në përmirësimin e ndërtesës së shkollës Shkolla Mesme Vlahën ndodhet në gjendje keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatrave Vlahën dhe Gajrep. Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës të shkollës

Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja mjedisore, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në mbrojtjen e pyjeve të zonës, në Rritjen e sipërfaqes pyjore. Ky projekt përputhet me objektivat mjedisore, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.

Fisha 19


Për këtë projekt prioritar, mund të themi se impaktet e tij janë të pranueshme nga pikepamja e zhvillimit të turizmit, madje konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim, pasi dhe impakti pozitiv do të jetë i menjëhershëm në zhvillimin e zonave rurale duke ruajtur dhe identitetin e tyre. Ndërtimi i një strukture të tillë me funksion akomodues dhe ofrimi shërbimi për turistët ndihmon në rritjen ekonomike lokale. Ky projekt përputhet me objektivat e zhvillimit të turizmit, por kërkon aplikimin e masave zbutëse gjatë fazës së ndërtimit.



Emri i projektit	Ndërtimi i Muzeum i Varrezave të dëshmorëve (OS6)
Vendodhja	Krumë, njësi administrative Krumë
Përmasa	8341 m ²
Kosto e ndërhyrjes	85,000,000
Burimet financiare	Investim publik
Fazat	Afatmesem (1-3 vjet)
Përgjegjësia	
Burimet njerëzore	
Treguesit e monitorimit	Rikthimi i historisë së varrezave të dëshmorëve dhe hapja muze.
Përshkrimi i projektit	Ky projekt synon tju japë prioritet varrezave të dëshmorëve dhe Hasi ka qenë një ndër përkrahësit kryesor në Luftën e Kosovës dhe ka 42 dëshmorë nga të cilët 37 nga lufta e Kosovës. Si rezultat Hasi ka nevojë për një rikthim në histori e cila të trashëgohet dhe ndër breza. Varrezat e dëshmorëve në Has zënë një sipërfaqe të konsiderueshme dhe mirembajtja si dhe krijimi i disa kushteve sipas standarteve që të sjellë në vëmendje pikërisht historinë dhe rënien e dëshmorëve për luftën e Kosovës. Nga ana tjetër kjo do të shërbejë dhe si pikë turistike për turistët për të njohur historinë dhe si ka ndodhur dhe lufta Kosovës. Projekti synon të rrehojë dhe zhvillim turistik dhe historik të zonës



Dimensioni	Vizioni	Objektivat Strategjike	Programet	Projektit	Perpueshmëria	Impakti në mjedis
Asetet kulturore dhe monumentale	Ruajtja e aseteve kulturore natyrore dhe monumentale	Ruajtja e aseteve kulturore natyrore dhe monumentale.	Program për Ruajtja e aseteve natyrore dhe kulturore	Mbrojtja e monumenteve të kulturës dhe atyre historike	++	A
	OS 7			përmirësimi i aksesit në infrastrukturë dhe përfshirja e monumenteve të kulturës dhe historisë si pjesë e guidave turistike	+	B
Infrastruktura	Përmirësimi i aksesueshmërisë së territorit nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës	OS 4	Perpueshmëria e aksesueshmërisë së territorit nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës eksiztuase dhe asaj lidhese me vendet fqinje	restaurimi dhe përdorimi i këtyre monumenteve si pika atraksioni turistik	+	X
				Programet afatgjata për mirëmbajtjen e tyre	++	X
			Programi i Perpueshmërisë së rrjetit rrugor të bashkësive dhe shërbimeve të transportit	Perpueshmëria e rrugëve lokale eksiztuase për të rritur aksesin psh: Aksti Has-Cahan, Asfaltimi i rruges së fshatit Zahrisht, Gjinaj, Dobruqe	+++	C
				Rritja e aksesit të rrugëve me fshatrat	+	X
				Perpueshmëria e rrugëve me Rëndësi Kombëtare	+++	C
				Sistemi i rruges Nikoliq-Krume-Gola, Krume-Zahrisht, Dobruqe-Golaj	++	C



Përmirësimi bashkëpunimi ndërkufitar pasojë pozicionit gjeografik të saj	OS 5	Rritja e marrëdhënies me vendet kufitare nëpërmjet politikave të import-eksportit të produkteve lokale	Program specifik për bashkëpunimi ndërkufitar	Rritja e pikave turistike të përmendura në OS 3 për rritjen e prurjes së turistëve ndërkombëtar	++	X
Ngritja dhe fuqizimi i nje rjeti te mbeshtetjes institucionale dhe infrastrukturore per zhvillimin e Bujqesise si nje motor i zhvillimit ekonomik te zones ne teresi	OS 3	Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase	Program i Mbeshtetjes Infrastrukturore per Bujqesine	Zhvillimi i prodhimit vendas i formave autoktone të bimëve, si pemtaria dhe bimë medicinale Krijimi i pikave të agroturizmit në zona të përshiatshme për kultivimin e bimëve dhe mbarëshumimin e kafshëve Ndërtimi i pikës për grumbullimin dhe përpunimin e prodhimit vendas për të furnizuar nevojat lokale dhe eksport në vendet kufitare	++	C
Ngritja e strukturave menaxhuese te sektorit te bujqesise prane bashkise (politika, monitorim dhe certifikim)				Marketimi i produkteve te vendase të zonës	+	X
Zhvillimi i intenerareve turistike kulturore natyrore – gastronomike (agriturizmi) në bashkëpunim me rajonin	OS 2	Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore	Zhvillimi i qëndrueshëm i Turizmit	Ngritja e një sektori në bashki për turizmin edhe marketimin e tij	+++	X
Bashkëpunimi me bashkitë kufitare për të krijuar itinciare turistike në vazhdimësi nga njëra bashki në tjetrën				Krijimi i markës Brand për produktet lokale të bashkisë Hasi	++	X

Cilësi e jetës	Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve të Bashkisë Has përmes ofrimit të shërbimeve publike të nivelit të lartë duke përmirësuar gjendjen ekzistuese të kushteve të	OS 8	Zhvillimi i qëndrueshëm i industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të produkteve minerare	dhe monumentale ne Has	Krijimi i hartave turistike dhe Intinerarit lëvizës në pyjet e Bashkisë	++	C
			Rivitalizimi i sektoreve të Industrisë		Krijimi i guidave dhe trajnimi i tyre për turizmin në Bashkinë Has mbrojtjes së monumenteve kulturore	+++	C
		OS 8			Ndërtimi i InfoPoint në pika të ndryshme të territorit të Bashkisë	+++	C
					Hartimi i një Plan studimi për rezervat minerale të bashkisë Hasit	+	X
					Restaurimi i pikave ekzistuese të zonave minerare	++	C
					Hartimi i një Plan studimi për nxjerrjen e produkteve minerare në mënyrë të qëndrueshme dhe pa dëmtuar mjedisin	++	A
					Mundësimi i Furnizimit me ujë të pijshëm i popullsisë së bashkisë	+	C
					Rikonstrukcioni i qendrave shëndetësore në veri të Bashkisë, të cilat për momentin nuk mbulohen (si në Golaj)	+	C
		OS 6			Krijimi i pikave të vogla për urgjencë (në zona ku nuk ka popullsi të madhe për nevojë për Qendra Shëndetësore, si Perollaj, Letaj)	+	C
					Rikonstrukcioni i Qendrës Shëndetësore Pusi i Thatë, Qendrës Shëndetësore Brellogë, Vlahen	+	C
					Rikonstrukcioni i fushave dhe ambienteve rekreative të shkollave ekzistuese	+	C
					Furnizimi me pajisjet bazë shkollave ekzistuese dhe ato potenciale (sidomos në pjesët veriore të Bashkisë	+	C



	ujësjellës-kanalizime, shërbime, shëndetësi, arsim				Rikonstruktimi i Shkollës së Mesme Vlahen, Shkollës 9-vjeçare Fielshan, shkollës 9-vjeçare Fshat Krumë	+	C
					Ristrukturimi dhe përmirësimi i rrjetit ujësjellës-kanalizime, energjisë elektrike në qendrat kryesore të banuara si Golaj, Perollaj	+	C
					Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të qytetit Hasi	+++	C
					Propozimi i krijimit të zonave të mbrojtura si: pyjet e Hasis, me rrezik natyror, të përhapura në bjeshkën e Krumës, Vranishtit, Gjinajve, Dajcit Mujajve, Cahanit & Kishajve	+++	A
					Ruajtja e bimëve mjekësore që rrezikojnë të zhduken, si sherebeli	+++	A
					Shfrytëzimi i florës së pasur për rritjen e bletëve	+++	A
					Krijimi i itinerarëve lëvizëse me bicikleta në pyje, identifikimi i tyre	+++	A
					Përcaktimi i kufijve të saktë të zonave natyrore dhe duke rritur zonat bufer pranë tyre, shtratave të lumenjve, puseve ekzistuese për të mos lejuar ndërtim	+++	A
					Ruajtja edhe mbrojtja e pyjeve nga shpyllëzimi dhe djegia	+++	A
					Fushata sensibilizuese publike në lidhje me përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe ruajtjen e florës dhe faunës,	+++	A





Përpuethshmëria me objektivat mjedisore

Projekti përputhet plotësisht me objektivat mjedisore	+++ shumë mirë
Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore është e kushtëzuar	++ mjaftueshëm
Projekti përputhet pjesërisht me objektivat mjedisore	+ mirë
Projekti nuk përputhet me objektivat mjedisore	-
Projekti nuk përputhet fare me objektivat mjedisore	- -

Impakti në mjedis

impakt pozitive	A
impakti parëndësishëm	B
impakti është i parëndësishëm pasi zbatohen masat zbutëse	C
Nuk ka impakt në mjedis	X

Në marrëdhënie me objektivat mjedisore, të gjitha projektet janë vlerësuar sipas impaktit që këto projekte japin në mjedis dhe sipas përpuethshmërisë me objektivat mjedisore në këtë projekt. Si konkluzion mund të themi se niveli i përpuethshmërisë në përgjithësi është i lartë, megjithatë ka projekte ku niveli i përpuethshmërisë është i kushtëzuar, kështu që kërkohet zbatimi i masave zbutëse për projektet e parashikuara për arritjen e këtyre objektivave.

Në përgjithësi, konkludohet se duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Krahasimi i projekteve specifike individuale paraqet si më poshtë:

Në marrëdhënie me objektivat mjedisore, të gjitha projektet specifike që lidhen me Objektivën Strategjike "Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit" janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, bile konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim.

Projektet e parashikuara për Objektivën Strategjike “Infrastruktura”, konkretisht janë në përputhshmëri mesatare me objektivat mjedisore, ndërkohë disa nga projektet, kanë një përqindje të konsiderueshme përputhshmërie të pjesshme apo të kushtëzuar, për shkak të ndikimeve që priten të shkaktojnë, dhe që kërkojnë zbatimin e masave përkatëse zbutëse.

Lidhur me projektet e parashikuara për arritjen e Objektivës Strategjike “Përmirësimi i bujqësisë edhe blegtorisë” mund të thuhet se shkalla e përputhshmërisë është e pranueshme. Zbatimi i masave zbutëse për të gjithë projektet e parashikuar përbën një detyrim thelbësor për të realizuar me sukses këto projekte dhe për arritjen e objektivës përkatëse.

Përsa i përket Objektivës Strategjike “Përmirësimi i Cilësisë së Jetesës”, përgjithësisht projektet janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore; sidoqoftë niveli i përputhshmërisë së kushtëzuar këtu është i lartë, kështu që kërkohet zbatimi i masave zbutëse për të katër projektet e parashikuara për arritjen e kësaj objektive.

Projektet që parashikohen për arritjen e Objektivës Strategjike “Mbrojtja dhe zhvillimi i qendrueshem i mjedisit bazuar në burimet vendore të Bashkisë” përgjithësisht kanë një nivel të lartë përputhshmërisë me objektivat mjedisore. Projektet në përgjithësi janë plotësisht në përputhje me objektivat mjedisore, ndërkohë që ka projekte ku përputhshmëria është konsiderueshëm e lartë.

Në përgjithësi, konkludohet se duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.



SEKSIONI 9 - VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE

9.1 VLERËSIMI I PASOJAVE NGA ZBATIMI I PLANIT DHE NDIKIMET E PASOJAVE TË ZBATIMIT TË PLANIT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE MJEDISORE TË PLANIT

Seksioni 9.1 përfshin vlerësimin e përpueshmerisë së Planit me zonat e veçanta mjedisore dhe objektivat e rëndësishme mjedisore. Udhëzimet, masat zbutëse dhe masat specifike paraqiten në Seksionin 10.

9.1.1 Toka

Objektivi Mjedisor 1: Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj

- Ndikimi më i madh gjatë fazës së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj ndërkohë që nga fusha të tjera do të jenë të kufizuara në një territor më të ngushtë lokal. Nuk priten ndikime në ato sektorë ose nën sektorë ku përqëndrimi më i madh i aktiviteteve do të ketë të bëjë me plotësimin e boshllëqeve ligjore dhe të strukturës (aktivitete soft) ku gjithë detyrat dhe angazhimet do të jenë të natyrës institucionale dhe organizative;
- Toka bujqësore dhe pyjet do të pësonin shkatërrim të pakthyeshëm në seksionet e marra nga ndërtimet e reja ose ato të rindërtuara mbi seksionet e vjetra. Shpesh ndërtimet e reja krijojnë edhe fragmentime të tokës bujqësore. Ndikimet afatshkurtër (të riparueshme) që mund të ndodhin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë lidhjet përmes tokave bujqësore ose pyjore, dëmtimet dhe okupimet e tokave ose dëmtimin e produkteve për shkak të afërsisë me sheshet e ndërtimit, ndotjet e tokës etj;
- Për shkak të zhvillimeve të reja në infrastrukturë, përdorimi i tokës bujqësore ekzistuese pëson ndryshim nga ana e pozicionimit të lidhjeve të reja infrastrukturore. Masat që zbatohen mund të sjellin rënien e përhershme të potencialit dhe prodhimtarisë të tokës bujqësore që nënkupton humbjen e përhershme të funksionimit të tokës për prodhimtarinë bujqësore. Nëse masat e infrastrukturës shtrihen edhe përtej territoreve aktuale të zhvillimit, fragmentimi i tokës bujqësore do të rritet dhe kushtet për prodhimtarinë bujqësore do të përkeqësohen edhe më tej;
- Pozicionimi i vendosjes së strukturave infrastrukturore të reja në hapësira të hapura dhe me natyrë për të konservuar biodiversitetin do të sjellin ndërhyrje direkte tek aktivitetet e



vazhdueshme të zonave pyjore të cilat duhet të kryejnë funksionet vegetative bimore me anë të drurëve si aktivitet primar (dëmtime të pakthyeshme);

- Plani i Përgjithshëm Urban në përputhje me direktivat e Planin e Përgjithshëm Kombëtar si dhe në përputhje me direktivat e legjislacionit European ka menduar se tokave urbane tju mbivendosen vepra urbane. Ndërkohë që tokat me bonitet të kategorisë së pestë, të mund të diskutohet prekja apo zënia e tyre dhe ato të kategorisë 6 dhe të kategorisë 7 normal që mund të preken nga veprat urbane.

Objektivi Mjedisor 2: Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.

- Aktivitetet ndërtimore në përgjithësi (rindërtime ose të reja) të infrastrukturës janë burim i prodhimit të sasive të mëdha të mbetjeve, dhe gjithashtu krijojnë presione mbi përdorimin e burimeve natyrore. Mbetjet gjenerohen jo vetëm përkohësisht gjatë fazës së ndërtimit, por edhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës operationale si edhe për efekt të proceseve të mirëmbajtjes së strukturave. Impakti nga gjenerimi i mbetjeve është i përhershëm dhe në mjaft raste i pakthyeshëm në lidhje me impaktin ndaj burimeve natyrore. Prandaj, ky impakt negativ ndaj mjedisit duhet të pakësohet me anë të masave për menaxhimin e mbetjeve.
- Duke konsideruar mënyrën sesi gjenerohen dhe llojin e strukturës, sasitë e mbetjeve të gjeneruara nga zhvillimet në infrastrukturë prej çdo sektori ekonomik duhet të konsiderohen si sasira të mëdha, sidomos prej veprave të nivelit rajonal, ndërkohë që sasitë e mbetjeve nga zhvillimet në nivel lokal priten të jenë më të lokalizuara dhe më të pakta krahasuar me dy nivelet e para, Shqipëria ka kryer transpozimin e Direktivës 2008/98/EC mbi mbetjet, me anë të VKM no. 175, datë 19.1.2011 siç referohet edhe në "Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025 dhe në "Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025". Në këtë aspekt, SKZHI II prezanton si objektivi mjedisor 55 për qind të masës totale të mbetjeve të ripërdoret ose riciklohet deri në 2020".
- Ndërtimet e reja ose zgjerimet e infrastrukturave sipas sektorëve, brenda kuadrit të zbatimit të masave specifike të angazhimeve për secilin nga drejtimit e veprimeve prioritare respektive të Planit, ofrojnë një mundësi ideale gjatë fazës së ndërtimit për ripërdorimin ose procesimin e materialeve dhe mbetjeve industriale të prodhuara, ku efekti i sinergjisë reflektohet veçanërisht në faktet e mëposhtme:

- Sasira të mëdha mbetjesh mund të përdoren veçanërisht në ndërtimet e rrugëve dhe infrastrukturave të ngjashme ku materialet mbushëse janë mjaft të nevojshme;
- Substanca potenciale toksike të mbetjeve mund të mobilizohen në mënyrë permanente në rast se ato përdoren në mënyrën e duhur;
- Kompozite të reja të ndërtimit shpesh kanë karakteristika më të mira funksionale në krahasim me ato konvencionale.

Në vijim të zbatimit të masave specifike që paraqiten në Plan, administrimi ekonomik i burimeve natyrore duhet të mbështetet nga masa të tjera të përgjithshme shtesë që promovojnë pakësimin e ndotjes së mjedisit duke përdorur materiale të riciklueshme në ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës së parashikuar për çdo sektor. Prandaj, masa të tilla duhet të përgatiten dhe të përfshihen që në fazat e hershme të programeve të zhvillimit në çdo sektor dhe për çdo masë specifike me vete.

9.1.2 Ajri

Objektivi Mjedisor 3: Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasi të vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.

Shkarkimet e ndotësve janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit të infrastrukturës dhe atë të operimit në një sërë aktivitetesh nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, por në lidhje direkt me Planin ndikimi kryesor vjen nga sektori i transportit.

Gjatë fazës së ndërtimit ose të rindërtimit të infrastrukturës, shkarkimi i ndotësve krijon impakt afatshkurtër në mjedis, kështu që shumica e efekteve të tyre janë të kthyeshme.

Gjatë fazës së operimit të infrastrukturës, shumica e shkarkimeve janë të pranishme si në ajër edhe në ujë e tokë, në varësi të proceseve të aktiviteteve që krijohen nga operimi i infrastrukturës përkatëse.

Zbatimi i masave specifike që synojnë arritjen e qëllimeve të Planit pritet të kenë një impakt pozitiv për shkak të pakësimit të shkarkimeve të ndotësve, së pari për shkak të masave të parashikuara lidhur me transportin e pasagjerëve me mjetet rrugore dhe bicikleta. Masa të tjera nga sektorët që emetojnë shkarkime të ndotësve në ajër priten gjithashtu të kontribuojnë me efekte pozitive për shkak të pakësimit të ndotësve të shkarkuar, në veçanti të atyre që synojnë pakësimin e bllokimeve të shkarkimeve në ajër nga industritë mosfunksionuese.



Gjithsesi, impaktet negative me përmirësimin e rrjetit rrugor mund të pakësohen dhe bile të parandalohen përmes marrjes njëkohësisht të masave të përgjithshme për promovimin e përdorimit të rrjetit publik të transportit të pasagjerëve dhe biçikletave.

Sfidat kryesore dhe prioritetet që pasqyrohen edhe në Plan janë:

- (1) kompletimi i adoptimit dhe zbatimit të standarteve Europiane mbi cilësinë e ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër;
- (2) konsolidimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit sipas standarteve Europiane;
- (3) adoptimi e zbatimi i planeve të veprimit mbi cilësinë e ajrit si në nivel qendror dhe atë lokal.

Duke konsideruar që sektori i transportit prodhon sasira të konsiderueshme shkarkimesh të ndotësve të ajrit brenda sasisë së lejuar tavan të shkarkimeve në ajër të përcaktuara/syhuara për Shqipërinë, mund të ishte më e përshtatshme të supozohej për vlera më të ulta të përcaktuara/syhuara për shkarkimin total të ndotësve në Shqipëri në mënyrë që të pakësohen shkarkimet e ndotësve nga transporti.

Objektivi strategjik është “Arritja e përmirësimeve të matshme në 2020 për cilësinë e ajrit përmes”:

- Objektivi prej 40% pakësim në nivelin e ndotësve në zonat urbane; dhe
- Arritja e niveleve objektiv të ndotësve të ajrit duke u bazuar në shëndetin human, sipas vlerave respektive: për NOx - 40 µ / m³, për PM10 - 40 µ / m³, për PM2,5-25 g / m³ dhe SO2-125 µ / m³.

Shpërndarja reciproke e ngarkesës për të arritur tavanet e shkarkimeve kombëtare vjetore për çdo sektor (energjia, industri, tregti dhe shërbime, transport, bujqësi dhe menaxhim i mbetjeve) do të përcaktohet më në detaje përmes amendimeve prej Programit Operacional të përputhshmërisë me tavanet e shkarkimeve kombëtare. Gjithsesi, kërkesat për pakësimin e shkarkimeve nga transporti nuk priten të jenë më të ulta sesa pakësimi mesatar i përcaktuar për shkarkimin total të ndotësve në Shqipëri. Për këtë arsye, tavanet e shkarkimit për NOx dhe PM2.5 që janë ndotësit kryesorë prej transportit rrugor janë përcaktuar në bazë të pakësimit indikativ në shkarkimet ndotëse.

Indikatori	Njesite e matura / Vendmatjet	Burimi	Vlera e fundit e vlefshme		Synimi ne 2017	Synimi ne 2020
			Viti	Vlerat	Vlerat	Vlerat
Cilesia e ajrit (mesatarja vjetore e perqendrimit te 3 ndotesve te ajrit	mg/ m ³ te PM10; SO2; NO2 në Has	Ministria e Mjedisit	2014	35.2	30	15-25 % pakesim i vleres
				17.5	16	
				14.35	14	

Tab. - 47 Indiktorët kryesorë kumulativë dhe synimet lidhur me cilësinë e ajrit në Hasi

Rinovimi i mjeteve motorike kontribuon së tepërmi në pakësimin e shkarkuesve ndotës, si edhe zhvillimi i standarteve sipas tipave të aprovuar për mjetet siguron që shumica e shkarkimeve të ndotësve të synuara për transportin të arrihen. Masat për promovimin e transportit publik të pasagjerëve dhe transportin me bicikleta kontribuojnë gjithashtu në pakësimin e shkarkimit të ndotësve.



Plani nuk mund të adresojë specifikisht promovimin e rinovimit të mjeteve, por me anë të të gjithë masave/veprimeve, veçanërisht atyre që promovojnë transportin publik të pasagjerëve dhe transportin me bicikleta, ka ndikim pozitiv në mjedis dhe kontribuon qenësisht në arritjen e synimeve për shkarkimet kombëtare.

Përsa i takon shkarkimeve të grimcave pezull në ajër, ato do të pësojnë rritje të përkohshme në zonat ku do të zbatohen masat e rindërtimit të infrastrukturës sipas sektorëve (impakte të kthyeshme). Në përputhje me rregullat që rregullojnë masat për pakësimin e shkarkimeve të grimcave nga sheshet e ndërtimit, zbatimi i punimeve në ndërtim garanton që rritjet e përkohshme lokale të ndotësve të mjedisit në ajër të jenë ende të pranueshme për mjedisin dhe njerëzit. Problemet më të shumta në sigurimin e cilësisë së ajrit të përshtatshëm të mjedisit lidhet me arritjen e tavanit të përcaktuar për grimcat.

Transporti është burimi kryesor ndotës i ajrit të mjedisit përmes grimcave pezull në ajër. Grimcat mund të japin një sërë impaktesh negative mbi shëndetin: ato shkaktojnë dhe rëndojnë astmat, krijojnë aterosklerosa, përkeqësojnë përvijimin e sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare, shkaktojnë kancer. Raporti i mortalitetit në zonat ku ndotja me grimca pezulli është i lartë është 15 – 20 për qind më i lartë në krahasim me zonat me ajër relativisht të pastër.

Pritet që zbatimi i masave të Planit të ulin në mënyrë permanente shkarkimet e grimcave nga transporti rrugor, së pari për shkak të eliminimit të bllokimeve të trafikut, menaxhimit më të mirë të shtresave sipërfaqësore të rrugëve dhe përdorimit të më shumë mjeteve rrugore me efikasitet energjie. Siç u përmend më sipër, sfidat kryesore dhe prioritetet prezantohen në NSDI II dhe ato janë përmbledhur në tabelën më poshtë në raport me pakësimin e ditëve kur PM10 tejkalon standartet.

Indikator	Njesite e matura		Vlera e fundit e vlefshme		Synimi ne 2017	Synimi ne 2020
	/Vendmatjet	Burimi	Viti	Vlerat	Vlerat	Vlerat
Numri i diteve ne nje vit kur PM10 tejkalon standartin e 50µg/m³ ndaj diteve te monitoruara	Numri i diteve qe tejkalojne ne % ne ketë bashki	AKM, Ministria e Mjedisit	2014	Hasi 25%	Hasi 15%	Hasi 10%

Tab. - 48 Indikator PM10 dhe synimet lidhur me cilësinë e ajrit në Shqipëri

Në mënyrë që të arrihen objektivat e eliminimit të mos - përputhshmërisë së cilësisë së ajrit me standartet e përcaktuara për cilësinë e ajrit, që ndodh shpesh në disa zona të kufizuara, zakonisht në bashkitë me densitet të lartë, është imperative që Qeveria dhe Institucionet respektive të përgatisin dhe adoptojnë Planet e Cilësisë së Ajrit në ato zona që tejkalojnë ndotjen e ajrit në mjedis. Programe të detajuara të veprimit për të reduktuar ndotjen nga grimcat PM10 do të vijojnë përgatitjen e këtyre planeve. Këto programe dhe veprime që vijnë nga Plani do të duhet të jenë në bashkëpunim të plotë me njëri tjetrin.

5. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimeve me institucione përgjegjëse për:
 - g. Zvogëlimin e numrit të makinave nëpërmjet përmirësimit të transportit publik;
 - h. Menaxhimi i rrjetit rrugor dhe trafikut;



- i. Promovimi i teknologjive të pastra të automjeteve;
 - j. Promovimi i përdorimit të biçikletave;
 - k. Kontrolli dhe përmirësimi i cilësisë së karburanteve;
 - l. Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta, pastrimi dhe larja e rrugëve.
6. Forcimin e kapaciteteve teknike për monitorimin e të gjitha llojeve të shkarkimeve në ajër në vendin tonë.
7. Ngritjen e kapaciteteve për modelim të shpërndarjes së ndotjes, hartimin e studimeve dhe analizave për gjendjen e ajrit.

9.1.3 Faktorët klimatikë

Objektivi Mjedisor 4: Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.


Nje sërë aktiviteteve ndërtimore të infrastrukturës dhe praktika sektoriale kanë impakt permanent (të kthyshëm) mbi shkarkimet e gazeve serë (GHG), që përbëjnë shkaku kryesor të ndryshimeve klimatike. Për shkakun që karburantet fosile (nafta dhe derivatet) çlirojnë GHG në ajër gjatë përdorimit përfaqësojnë në këto momente burimin më të rëndësishëm të energjisë në sektorin e transportit e bëjnë sot këtë sektor të parin si burim shkarkimesh të gazeve serë në Shqipëri, pasi sektori i energjisë këtu është hidro. Impakti në ndryshimet klimatike është gjithashtu pasojë në kushtet e motit dhe klimës që po rriten çdo vit. Një tjetër pasojë pasojë e temperaturave të larta globale janë ndryshimet në modelimet e fenomeneve mesatare klimatike dhe ngjarjet më të shpeshta të kushteve ekstreme të motit (thatësira, përmblytje, erozione, stuhi me breshër, valë të nxehta, temperatura të ulëta me ngrica, etj.

Vendimi 406/2009/EC përcakton minimumin e kontributit të Shteteve Anëtare të EU për të kapur angazhimin e reduktimit të shkarkimeve të gazeve serë të Komunitetit për periudhën nga 2013 në 2020 për te gazet serë që mbulohe nga ky vendim dhe rregullat për të bërë këto kontribute si dhe për vlerësimin e tyre më pas. Shqipëria ende nuk ka bërë transpozimin e këtij vendimi; që planifikohet të ndodhë në 2018. Kjo periudhë është brenda kohës së zbatimit të Planit; prandaj parashikimet e këtij vendimi në lidhje me faktorët klimatikë duhet të adresohen në avancë. Për më tepër, SKZHI II vendos synimin për shkarkimet e gazeve serë në 2020 si vijon:

- Një synim 8% reduktim të GHG siç krahasohet me skenarin bazë; dhe
- Një synim 40% reduktim në sasinë e HCFC-s (hidroklorofluorokarbon).

Në nivelin strategjik të zhvillimit të sektorëve, masat në lidhje me fushën e adaptimit të ndryshimeve klimatike mund të trajtohen si të përgjithshme. Përpara projektimit dhe zbatimit të çdo veprimi individual do të jetë e nevojshme të krijohen udhëzues specifikë, metodologji dhe procedura për grumbullimin e informacionit rreth ngjarjeve ekstreme të motit dhe për të planifikuar dhe zbatuar detyrat respektive.

Shkarkimet e gazeve serë nga sektorë të tillë si transporti rrugor, bujqësia, energjia, etj., përfaqësojnë një rrezik të konsiderueshëm për masat zbutëse të ndryshimeve klimatike. Në vijim veç shkarkimeve të përkohshme të gazeve serë gjatë fazës së ndërtimit të veprave infrastrukturore të parashikuara në Plan, shkarkimet e gazeve



serë priten të rriten edhe pse do të merren masa për të eliminuar mjaft pengesa. Zbatimi i masave specifike duhet të garantojnë përdorim më të madh të transportit publik, metodave të reja bujqësore të kultivimit dhe vaditjes, energjisë të rinovueshme, etj. Promovimi i këtyre masave dhe përdorimi i mjeteve të reja të energjisë eficiente do të kontribuojë në parandalimin e shkarkimeve nga sektorët kontribues në GHG në fazën afat - mesme dhe ndoshta një rënie pas 2020. Transporti ngelet sektori kyç në arritjen e objektivave kombëtare mbi masat për ndryshimet klimatike i vijuar nga sektori bujqësor dhe përdorimi i tokës.

9.1.4 Uji

Objektivi Mjedisor 5: Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat breglumore dhe burimet e ujit të pijshëm.

Impaktet më të mëdha për arritjen e këtij objektivi mjedisor pritet nga zhvillimet e sektorëve kyç të lidhur me ujin si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore. (ujësjellës/kanalizimet, vaditja dhe bujqësia e blegtoria në përgjithësi, industria ushqimore dhe përpunuese, shërbimet dhe turizmi, shëndetësia, etj)

Impaktet mbi ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, ujërat e njelmët, ujërat sipërfaqësore dhe burimet e ujit të pijshëm janë karakteristikë të periudhës së ndërtimeve ose rindërtimeve të infrastrukturës dhe gjithashtu në vijim të operimit të strukturave edhe më tepër. Kjo në varësi respektive të sektorëve përkatës në lidhje me nevojën për përdorimin e ujit ose ndërveprimet me burimet dhe trupat natyrore ujore. Në shumicën e rasteve këto impakte krijohen si të limituara në mjedisin lokal, megjithatë në mjaft raste ndodh efekti kumulativ i impaktit dhe krijohen ngarkesa ndotjeje të mëdha ndotëse që ngrihen në nivel rajonal dhe disa herë edhe ndërkufitar përtej kufijve. Impaktet ndërtimore të infrastrukturës ngelen në përgjithësi afat - shkurtër dhe të rikthyeshme (rasti psh i cilësisë së ujrave). Pas fazës ndërtimore, impaktet janë kryesisht më pak të përhapura, port e parikthyeshme permanente (rasti psh i impaktit të morfologjisë së vijës ujore natyrore, kushteve hidrologjike, ruajtja e zonave). Impaktet e mësipërme mund të prodhojnë ndryshime në elementet cilësore për krijimin e statusit ekologjik të ujrave sipërfaqësore, që janë elementet biologjikë, hidromorfologjik, mbështetës, kimik dhe fiziko-kimik dhe në statusim kimik të ujrave. Nëse udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse vëzhgohen, ndryshimet në elementet cilësore nuk do të kapërcejnë së tepërmi që të kërcënojnë arritjen e objektivave mjedisore. Veprimet e sektorëve që ndikojnë në ujrë dhe objektivat mjedisore mbi ujrë, përmbledhen si më poshtë:

- Pozicionimi i veprave infrastrukturore mund të ndikojë në mënyrë permanente të drejtpërdrejtë ose indirekt situatën hidrologjike në një zonë të caktuar duke sjellë edhe situatë eko-morfologjike mbi rrjedhën e ujit;
- Rrjedhja e vazhdueshme e substancave të rrezikshme që rezultojnë nga burime të ndryshme ndotëse (impakt në cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore);
- Dërdhja e substancave të rrezikshme për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (impakt potencial direkt, në distancë të largët deri ndërkufitar mbi cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore, impakt potencial mbi ujrë balneare);



- Rrezik i lartë ekzistent nga përmytjet (aplikimi i zgjidhjeve ndërtimore më këtë kriter si rrezik i lartë) në zonat që përmyten ose masa rregulluese në rrjedhën e ujrave; ndryshime në situatën hidrologjike në një zonë të caktuar, përfshirë pakësimin në zonat mbajtëse (direkt ose në distancë);
- Ndryshimet në regjimin ujqor të ujrave nëntokësorë për shkak të ujrave të ndërhyrjeve të veprave infrastrukturore (psh tunelet);
- Pozicionimi i strukturave infrastrukturore në zonat akuifere me ndjeshmëri të lartë ose shumë të lartë mund të kenë impakt negativ mbi burimet ujore ekzistuese dhe potenciale (direkt, indirekt, ndërkuftar);
- Pozicionimi në zonat e ujrave të mbrojtur të burimeve ujore (ndikim lokal, potencialisht rajonal dhe ndërkuftar).

Shqipëria ka aprovuar *Ligjin No. 111/2012 "Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore"* dhe "Strategjinë Kombëtare Sektoriale për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet 2014-2040", "Në Strategjinë Ndërsektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025" dhe "Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025". Midis të tjerave, këto dokumente përcaktojnë që aktivitete në ujë dhe tokat anash ujrave mund të kryhen vetëm nëse ato janë bazuar mbi planet e zhvillimit hapësinor dhe nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa gjeneruar kosto të larta disproporcionale. Pozicionimi i këtyre aktiviteteve mund të ndikojnë thelbësisht mbi statusin ekologjik të rrjedhave ujore dhe të pakësojnë zonat e mbajtjes dhe impaktet kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës.

9.1.5 Natyra

Objektivi Mjedisor 6: Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit

Impaktet që kanë të bëjnë me fragmentimin e habitateve dhe biodiversitetin janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës dhe më tej. Ato vërehen më tepër në mjedisin lokal, ndërsa në rastin e projekteve me shtrirje të gjerë impaktet ndihen edhe në nivelin rajonal dhe përgjate kufijve (psh në migrimin e karnivoreve të mëdhenj, rrugët e migrimit të shpendëve, vijat ujore të kalimit ndërkuftar etj.). Gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshme (psh ndotje nga zhurmat e sheshit të ndërtimit, kafshët largohen prej makinerive të ndërtimit, etj.). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës (psh ndërprerja e rrugëve të migrimit, rritja e zhurmës nga strukturat e zhvilluara në vend, pengesa në mjedis – linja elektrike, etj.). Ndërtimi i strukturave të reja dhe rindërtimi ose modernizimi i infrastrukturës ekzistuese mund të rezultojë në:

- Humbje të zonave të habitatit dhe llojeve të habitatit dhe përfaqësuesve individualë të llojeve të bimëve dhe kafshëve (impakt direkt, i përherëshëm);
- Impakt direkt, permanent mbi funksionimin e disa habitateve për shkak të fragmentimit të habitatit;
- Në rastin e aktiviteteve me shtrirje të gjerë në një habitat më të rrezikuar, një impakt direkt është i mundshëm mbi biodiversitetin e zonës më të ngushtë ose të gjerë (impakt permanent);



- Kalimet e reja shpesh fragmentojnë habitatet e kafshëve të egra dhe ndërpresin rrugët migratore dhe rrugicat e fluturimit ose pengojnë migrimin e disa grupeve të kafshëve (veçanërisht të gjitarëve dhe amfibëve, nëse një rrugë kryqëzohet me një korridor migrimi ose fluturimi, konflikte me shpendët dhe lakuriqët e natës janë gjithashtu të mundshme), të cilat mund të pengojnë në mënyrë permanente migrimin e kafshëve individuale midis popullatave individuale dhe të shkaktojnë një rënie të biodiversitetit në disa zona (impakt direkt, kumulativ, i largët);
- Shumica e problemeve të migrimit ndodhin në fazat e ndërtimit të infrastrukturave të mëdha ku nuk ka përkujdesje për rindërtimin e kalimeve dhe komunikimeve të shkëputura të habitateve (psh ndërtimi i urave të gjelbërta). Kjo duhet të merret parasysh kur projektohet dhe ndërtohet (impakt direkt, në distancë);
- Në zonat ku nuk merren masa mbrojtëse ekziston mundësia e konflikteve mes infrastrukturës së ngritur dhe gjitarëve gjatë lëvizjeve ditore dhe amfibëve që levizin gjatë sezonit të migrimit (impakt direkt, në distancë); dëmtime të rregullta dhe të shpeshta mund të shkaktojnë gjithashtu rënie të përmasave të popullatave (impakt direkt, kumulativ, në distancë);
- Zhurma ka impakt negativ veçanërisht për shpendët dhe gjitarët dhe nuk është i pranishëm vetëm në distancën më të afërt të aktivitetit, por përhapet mjaft më gjerë (impakt në distancë);
- Rrezatimi në drejtim të qiellit prej ndriçimit të strukturave të ndryshme të infrastrukturave mund të krijojë shqetësim direkt në ciklin jetësor, veçanërisht për kafshët që janë aktive natën dhe ato që janë aktive në mbrëmje;
- Pozicionimi i aktiviteteve në ujë ose në tokat në krahë të vijave ujore (që lejohet për marrëveshje me rëndësi kombëtare dhe që nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa gjeneruar kosto të përmasave të mëdha), mund të krijojë impakte negative permanente dhe direkte për habitatet ujore dhe ato përgjatë vijave, veçanërisht kur infrastruktura shtrihet përgjatë rrjedhave ujore.

SKZHI II prezanton sfidat kryesore lidhur me mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë:

- (1) nevoja për të krijuar rrjetin ekologjik Natura 2000 për Shqipërinë dhe Komunitetin Evropian;
- (2) ristrukturimin dhe forcimin organizativ të strukturave menaxhuese të zonave të mbrojtura; dhe
- (3) nevoja për të garantuar zbatim më efektiv të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe planet e veprimit për llojet dhe habitatet.

Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve migratore të kafshëve dhe në këtë mënyrë të arrihet objektivi i SKZHI II “Përmirësimi dhe forcimi i mbrojtjes së natyrës”.

Objektivi Mjedisor 7: Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.



Zhvillimet infrastrukturore në mjediset natyrale përfaqësojnë një humbje permanente të habitateve dhe ndikojnë në mënyrë negative permanente në përhapjen natyrale të tipeve të habitateve dhe ato të habitateve të llojeve të bimëve dhe kafshëve, në cilësinë e tyre dhe në integrimin e habitateve të popullatave. Nëse zhvillimi vendoset në zona me status natyror të mbrojtur, impaktet mund të jenë veçanërisht të zgjeruara dhe shkatërruese, pasi ato mund të degradojnë në mënyrë permanente nivelin e konservimit të mjedisit natyror dhe objektivat e mbrojtjes për zonat e mbrojtura, siç janë ato për pikat e Natura 2000,

Zonat me Rëndësi Ekologjike (IEAs) dhe veçoritë e vlerave natyrore. Vëmendje e veçantë duhet të kushtohet nëse strukturat e infrastrukturës pozicionohen në zonat e mbrojtura ku mund të ndodhin humbje permanente të sipërfaqeve të kualifikuara, tipet kyç të habitateve, habitatet e llojeve, impakte mbi integritetin, funksionalitetin dhe kohezionin e zonave. Këtu janë të mundshme edhe impaktet permanente dhe direkte mbi cilësinë e veçorive të vlerave dhe të tipeve të tyre për shkak të të cilave është bërë deklarimi i veçorisë. Duke qenë se një pjesë e mirë e territorit të Shqipërisë është deklaruar zonë me një status natyror të mbrojtur, ka mjaft mundësi që ndërtimet e reja të kalojnë pranë ose hyjnë në territoret e këtyre zonave.

Impaktet në zonat me status natyror të mbrojtur janë të mundshme gjatë periudhës së ndërtimeve të reja ose rindërtimeve të sistemeve të infrastrukturës dhe në vijim. Ato janë më të dukshme në mjedisin lokal, ndërkohë që për aktivitete të zgjeruara, ato mund të ndjehen në nivel rajonal dhe përtej kufirit (psh, impakti mbi kohezionin dhe integritetin e rrejtës të Natura 2000). Gjatë periudhës së ndërtimeve të reja ose rindërtimeve të sistemeve të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshëm (psh, ndotje nga zhurma në kantierin e ndërtimit, turbullimi i vijave ujore). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës (psh, rritje e ndotjes nga zhurmat prej transportit, pengesat në mjedis, shkatërrimi i habitateve të një lloji të kualifikuar, etj.

9.1.6 Mbetjet

Objekti Mjedisor 8: Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfillëve e incineratorëve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Problemet / shqetësimet kryesore që lidhen me këtë sektor janë listuar më poshtë:

- Prania e zonave të ndotura të njohura si Hot-Spote (mbetje kimike, materiale të rrezikshme) që akoma nuk janë sistemuar (ndotja e tokës nga aktivitete Industriale përpara vitit 1990). Nga 36, janë rehabilituar vetëm 5 pika të rrezikshme mjedisore;
- Prania e vend-depozitimeve të hapura (të ligjshme dhe të paligjshme) të hedhjes së mbetjeve. MZHU po punon për saktësimin e numrit;
- Kapaciteti i pamjaftueshëm i landfillëve ekzistues/mungesa e tyre (SKMM pozicionin politikën 1 landfill për rajon);
- Menaxhimi i mbetjeve është akoma në nivele të ulta, sisteme grumbullimi miks ka vetëm në qytete;
- 70% e ish komunave nuk e ofrojnë fare shërbimin e mbledhjes së mbetjeve;



- Mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore, mungesa e landfillleve për mbetjet e rrezikshme. Nuk ka landfill të veçanta, trajtim i veçuar bëhet vetëm nga sektori privat;
- Ndarja në burimin e mbetjeve / riciklimi, e cila megjithëse është kërkesë ligjore që prej vitit 2011, nuk realizohet në praktikë;
- Kuadri ligjor i përgjigjet kërkesave të BE-së, por nuk mund të ndryshojë realitetin për shkak të mungesës në investime.

Zhvillimi i zonave të caktuara mund të çenojë integritetin e shtresave të ujrave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore. Mund të shkaktojnë sëmundje kancerogjene deri në largësi të mëdha prej zonave në fjalë. Pikat e vjetra e të nxehta përbëjnë rrezik jo vetëm për shëndetin e njeriut, por krijojnë ambient për investime të reja para pastrimit të duhur.

Planet sektoriale mund të parashikojnë ndërhyrje teknike, rinovime urbane, pra të krijojnë kushte për një rritje ekonomike të qëndrueshme. Planet nuk mund të garantojnë zhvillime në këto pika/sheshe. Kritcret e forta mjedisore-shëndetsore përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi urban.

Djegje të mbetjeve në fushë, përhapja e ndotësve nëpërmjet ajrit konsiderohet si një rrezik serioz për shëndetin, gjë që krijon rreziqe potenciale për shëndetin e banorëve lokalë. Rrjedhjet e mbetjeve nga fusha ndotin ujërat sipërfaqësorë të lumenjve që kalojnë pranë. Pamje e shëmtuar vizive e territorit që ndikon në imazhin e tij të përgjithshëm dhe tërheqës për aktivitetet, vizitorët dhe banorët. Mbetjet e këtyre zonave depozitohen në lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga ujrart dhe në këtë mënyrë zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore.

Plani synon eliminimin duke kryer rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve përgjatë lumenjve si dhe mbulimin e venddepozitimeve të hapura dhe përdorimin e tyre si hapësira të gjelbra.

Nuk ka zbatim të direktivës së BE për landfillet. Ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Ka dhe një efekt të drejtpërdrejtë në aktivitetet turistike dhe ekonomike të vendit.

Plani parashikon rritjen e numrit të landfillleve dhe promovim të incinerimit

Në qytetet breglumore është e domosdoshme të ndërtohen edhe pika për përpunimin e mbetjeve pasi ndotja është një nga shkaqet kryesore që ul cilësinë e mjedisit në qytetet kryesore.

Nevoja dhe investime të shtuara për landfill, nga menaxhimi jo i diferencuar i mbetjeve. Nuk kursehen hapësira dhe ka impakte negative në mjedis mungesa e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve (kontenierë), nxitja e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit. Nga Zonat rurale që nuk mbulohen me shërbim një sasi e konsiderueshme mbetjesh qarkullojnë në rrjetin hidrik duke krijuar një potencial ndotës, duke ndikuar kështu veçanërisht në degradimin e zonave të mbrojtura breglumore dhe ulur kështu aftësinë e tyre ripërtëritëse. Ndikim tjetër negativ është edhe degradimi i peisazhit dhe mjedisit. Shumica e ish



komunave (sot njësi administrative), rreth 70% e tyre, nuk e ofrojnë fare shërbimin e mbledhjes së mbeturinave. Ndërtesat e shumta informale nuk kanë mbledhje të rregullt të mbetjeve të ngurta.

Plani parashikon ngritjen e infrastrukturës së duhur për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe bashkitë duhet ta konsiderojnë këtë një prioritet me nisjen e planeve të përgjithshme vendore. Strategjitë në Infrastrukturë dhe përpunim të Mbetjeve duhet të ndërmerren nga ministritë e linjës dhe NjQV- të.

~~Rrezik-potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme (MRR) dhe atyre klinike në zona të pacaktuara. Shkarkimi i MRR në ujë, ajër ose tokë shkakton rreziqe për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, sjell ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore pastrimi i të cilave kërkon kosto të mëdha. Hedhja e MRR në kanale dëmton sistemin e kanalizimeve dhe vë në rrezik funksionimin e impianteve të trajtimit të bimëve. MRR në skrap metali ose materiale të tjera të ricikluara shkakton rreziqe mjedisore dhe të shëndetit në industrinë e riciklimit.~~

Plani parashikon ngritjen e landfilleve industriale rajonale

Aktivitetet e riciklimit kufizohen te sektori informal dhe sektori privat zhvillon mbledhjen e pjesëve të riciklueshme të mbetjeve jo nëpërmjet sistemit.

Plani parashikon riciklimin përkrah rritjes së kapacitetit të landfilleve. Gjithashtu rekomandohen masa dhe programe për riciklimin e mbetjeve të cilat do të kishin një impakt në zgjatjen e përdorimit të landfilleve duke siguruar edhe përfitim ekonomik. Strategjia e menaxhimit të mbetjeve duhet të përfshij dhe mundësitë e incentivimit të riciklimit nga konsumatorët si dhe krijimin e zonave të dekompozimit të mbetjeve organike në çdo zonë rurale për të krijuar lëndë të parë për industrinë bujqësore për një ekonomi ciklike.

Probleme të tjera që shfaqen në këtë sektor janë: mosrealizimi i objektivave të synuara në dokumentat strategjike dhe afatet përkatëse, dhe gjetja e zgjidhjeve të përkohshme qendrore, rajonale, vendore që ndikojnë negativisht mjedisin.


Në këtë kuadër, Plani duhet të përcaktojë qartë standartin e detyrueshëm sektorial të shërbimit që imponon më tej rregullime financiare në funksion të mbrojtjes së burimeve dhe zhvillimit të turizmit

9.1.7 NDOTJA PREJ ZHURMËS

Objektivi Mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Në zona individuale pritet një nivel më i lartë ndotjeje mjedisore gjatë fazës së ndërtimit dhe më tej gjatë fazës së operimit. Për këtë, masat zbutëse do të duhet të realizohen gjatë fazës së ndërtimit, veçanërisht mbikqyrja e shkarkimeve të përshkruara prej makinerive të ndërtimit, vendosja e një kohe të limituar për ndërtimin dhe nëse nevojitet zbatimi i masave për të parandaluar zhurmën të përhapet në mjedis.

Impaktet gjatë fazës operationale do të jenë afat-gjatë. Si rregull, projektet me shtrirje të gjerë ose si korridore (rrugë, linja tubacionesh, shtylla elektrike, etj) nënkuptojnë kanë impakt më të madh mbi mjedis dhe në mënyrë



direkte përgjatë korridoreve, por në të njëjtën kohë mund të zbuten me ridrejtimin e aktiviteteve ato bëjnë të mundur të pakësojnë impaktet lokale sidomos aty ku densiteti i popullsisë është i lartë.

Në përputhje me legjislacionin mbi mbrojtjen nga zhurmat, kushtet e mëposhtme mund të aplikohen gjatë fazës së operimit të strukturave të reja në infrastrukturë:

- Një burim i ri zhurme nuk duhet të prodhojë ndotje përtej kufirit të lejuar të zhurmës në mjedis;
- Një burim i ri zhurme nuk duhet të rrisë ndotjen nga zhurma, në një zonë ku zhurma ishte tashmë përtej kufirit të lejuar, përpara se të vendosej ky aktiviteti i burimit të ri;
- Masat e mbrojtjes nga zhurma duhet të garantojnë parandalimin dhe pakësimin e zhurmës që vjen nga përdorimi ose operimi i një burimi në mjedis.

Nga aspekti i mbrojtjes prej zhurmave, këto masa mbrojtëse të referuara në legjislacion duhet të përdoren për të pakësuar ndotjen nga zhurmat në të gjitha aktivitetet e pritshme për të ulur dhe mbajtur më poshtë se niveli ligjor i përcaktuar. Zbatimi i masave të mëtejshme shtesë për mbrojtjen nga zhurmat do të jetë i nevojshëm në zonat e qendrave të mëdha urbane dhe korridoret e lidhjeve të infrastrukturës.

Veprimet më të rëndësishme në Plan, nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit nga zhurmat janë ato aktivitete që garantojnë pakësimin e shkarkimit të zhurmës, siç janë modernizimi i mjeteve dhe i vetë infrastrukturës dhe teknologjisë si dhe masat për pakësimin e impaktit të zhurmës në mjedis. Veprime që influencojnë indirekt në riorientimin e rrjedhës së trafikut në korridoret e transportit të distancave të gjata dhe në mjedisin urban (transporti publik) janë gjithashtu të rëndësishme.

Në pozicionimin e veprimeve mbi infrastrukturën sipas sektorëve të zhvillimit në hapësirë, zgjidhjet e përgjithshme dhe teknike do të duhet të sigurohen të tilla që garantojnë se ndotja nga zhurmat nuk e tejkalon kufirin e lejuar. Gjithë masat zbutëse që kërkohen burojnë nga legjislacioni dhe synimet janë të vendosura në SKZHI-II.

9.1.8 Popullatat dhe asetet materiale

Objektivi Mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Në vijim të impakteve mbi shëndetin human, arritjet e këtyre objektivave influencojnë gjithashtu konsiderueshëm situatën ekonomike të njerëzve dhe asetet materiale që ata kanë në dispozicion. Gjithashtu, ato kanë sinergji të rëndësishme pasi synojnë të kufizojnë rritjen e mbipopullimit, kërkojnë përdorim në rritje të zgjidhjeve mbi ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës, hapësirës dhe energjisë, si edhe të efekteve të dëmshme mbi asetet materiale për shkak të ekspozimit të tyre në mjedise të ndotura. Impaktet do të jenë pozitive, permanente dhe rajonale.

Sipas SKZHI-II, objektivat kryesore mbi popullsinë dhe asetet materiale janë :

- (i) Mundësi më të mëdha dhe cilësi më të mirë të arsimit;
- (ii) Një sistem kujdesi shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm;



- (iii) Zgjerimi i mundësive për punësim;
- (iv) Forcimi i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale;
- (v) Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse;
- (vi) Garantimi i barazisë gjinore;
- (vii) Fokus më i madh tek artet dhe kultura;
- (viii) Forcimi i rolit të sporteve.

Për sa i takon problemeve kryesore që lidhen me çështjet e mirëqënies, sigurisë dhe shëndetit, në mënyrë të përmbledhur ato kanë të bëjnë me aksesimin e trafikut dhe transportit në zonat urbane dhe rurale, lidhur ngushtë me lëvizshmërinë drejt tregjeve dhe ruajtjen e lidhjeve në komunitet. Ndërkohë komunitetet lokale e kanë sfidën më të madhe me ruajtjen e situatës social-ekonomike (përfshirë bujqësinë, hortikulturën, akuakulturën, pyjet, shërbimet utilitare, edukimin etj). Zhvillimet e parashikuara në Plan detyrimisht që do të shkaktojnë më shumë trafik, më shumë emetime, më shumë zhurmë dhe më shumë trysni mbi burimet natyrore. Për të patur një zhvillim të qëndrueshëm Plani parashikon, ndër të tjera edhe zhvillimin e sistemeve të trajtimit të mbetjeve dhe të ujërave të zeza. Në këtë këndvështrim problemet që shkaktohen nga menaxhimi i dobët i këtyre sistemeve ka gjasa të zvogëlohen. Ndër rreziqet dhe shkaqet e tyre mund të përmendim:

- Rritjen e nivelit të zhurmave dhe uljen e cilësisë së ajrit, që shkaktohen nga shtimi i trafikut, rritja e aktiviteteve urbane dhe shtimi i zhurmave nga aktivitetet e shërbimeve në komunitet;
- Uljen e cilësisë së ajrit që shkaktohet nga trafiku i rënduar;
- Cilësia e ulët e ujit të pijshëm e shkaktohet nga pakësimi i burimeve ujore për shkak të keqmenaxhimit të tyre si dhe për shkak të rritjes së ndotjes dhe eutrofikimit;
- Rritja e sasisë së mbetjeve në vendet e paautorizuara që vjen si pasojë e keqmenaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe mungesës së ndërgjegjësimit;
- Zhvillimet e reja në qendrat urbane dhe industriale do të sjellin rritjen e numrit të banorëve dhe të përdoruesve të rrugëve, duke sjellë kështu një rrezik real për sigurinë e njerëzve.

Fokusimi në zhvillimet infrastrukturore që i përgjigjen realizimit të qëllimeve dhe objektivave përkatëse, kryesisht për t'i shërbyer rritjes së pritshme të numrit të vizitorëve në zonat përkatëse, mbart me vete rrezikun që komunitetet dhe vendbanimet ekzistuese mund të neglizhohen nga pikëpamja e shërbimeve komunitare. Ndërkohë që zhvillimi i përgjithshëm social-ekonomik pritet që të kontribuojë në rritjen e mirëqënies së njerëzve, ekziston rreziku që rritja ekonomike të ketë një shpërndarje të çekuilibruar.

Ndër rreziqet dhe shkaqet e tyre mund të përmendim:

- Mungesa e transportit dhe lëvizshmërisë së shkaktohet nga humbja e lidhjeve me tokën bujqësore, plazhet dhe shërbimet sociale, si dhe nga nje transport publik i pamjaftueshëm;
- Prishja e cilësisë së jetës që vjen si pasojë e zhvillimeve të reja të cilat dëmtojnë mënyrën tradicionale të jetesës dhe sjellin rritje të kostove bazë të jetesës.

Ndërgjegjësimi i njerëzve mbi problemet mjedisore nuk rezulton automatikisht me ndryshimin e sjelljeve të tyre. Duke dhënë informacione, rritur ndërgjegjësimin, dialogimin me të gjitha palët e interesuara dhe me përfshirjen e publikut në proceset vendimarrëse për politikat e propozuara do të kontribuojë së tepërmi në ndryshimin e

modeleve të sjelljes përsa i takon zgjidhjeve të qëndrueshme, gjë që është theksuar së tepërmi edhe në udhëzimet strategjike të Planit Kombëtar Mjedisor të Veprimit.

Plani ofron zgjidhje që kanë të bëjnë me mobilitete të qëndrueshme alternative si është rasti i trafikut të biçikletave që klasifikohet midis mënyrave më të përshtatshme të transportit në terma mjedisor dhe të shëndetit. Në nivel kombëtar ky përafrim me anë të sistemit të rrugëve për biçikletat mund të lehtësojë transferimet në distancat e zakonshme të lëvizjeve nëpër qytete dhe zonat fushore dhe breglumore në distancë të shkurtër dhe për rekreacion në distancë të gjatë. Krijimi i rrugëve të biçikletave dhe rrugicave të marshimeve me anë të aksesimit të përshtatshëm në qendrat e rekreacionit do të kishte një impakt pozitiv në shëndetin human (impakt lokal). Sa i takon përhapjes gjeografike të zonave të banuara në Shqipëri, veprimet e paraqitura në Plan do të sjellin zonat e largëta më afër (në kohë dhe hapësirë) me qendrat kryesore dhe veçanërisht me tregjet dhe shërbimet. Ky është impakt pozitiv, rajonal dhe permanent.

9.1.9 Trashëgimia kulturore

Objektivi Mjedisor 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Zhvillimet e infrastrukturës mund të krijojnë impakte direkte në njësi dhe zona të trashëgimisë kulturore gjatë fazës së ndërtimit dhe më tej të operimit si rezultat i efekteve të mëposhtme:

- Degradimi i veçorive të peisazhit përreth njësive të trashëgimisë kulturore (impakt indirekt, i pakthyeshëm);
- Dëmtimi i strukturave të trashëgimisë kulturore (impakt direkt, i pakthyeshëm);
- Shkatërrim i mbetjeve arkeologjike gjatë fazës së ndërtimit (impakt direkt, lokal, i pakthyeshëm);
- Vibrime që mund të shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë kulturore (impakt indirekt, i pakthyeshëm);
- Çlirime gazrash ndotës që bëjnë pjesë në kontribuimin e shirave acid dhe që shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë (impakt indirekt, kumulativ, në distancë).

Duke qenë se Shqipëria ka një diversitet të madh të trashëgimisë kulturore, në terma kompozimi dhe përhapjeje në të gjithë vendin, gjë që ka të ngjarë që ndërtimet e reja të infrastrukturës do të përzihen në këto zona, veçanërisht me peisazhin kulturor, peisazhin historik, trashëgiminë arkitekturore dhe zonat e tyre të influencës si edhe pikat arkeologjike. Pozicionimi i infrastrukturës sipas sektorëve do të ndryshojë në mënyrë permanente përdorimin e hapësirës në këto zona. Për këtë, duhet të zbatohen masa të përshtatshme për të ruajtur veçoritë e zonës së trashëgimisë kulturore. Nga aspekti i ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (psh gërmimet). Kërkime paraprake arkeologjike në plan të gjerë do të duhet të kryhen, rezultatet e tyre do të duhet të merren në konsideratë kur të pozicionohen strukturat e infrastrukturës dhe masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike do të duhet të zbatohen.

Në vijim të ndikimeve direkte të vazhdueshme, zbatimi i veprimeve të Planit mund të ndikojë gjithashtu në trashëgiminë kulturore në mënyrë indirekte, dmth duke përkeqësuar veçoritë e peisazhit në mjedisin përreth



njësisë së trashëgimisë kulturore, vibracionet mund të shkaktojnë dëmtime në strukturat e trashëgimisë kulturore, dhe shkarkimet e gazeve që janë përbërës të shirave acide mund të shkaktojnë dëme në strukturat e monumenteve. Për më tepër në efektet indirekte, impakti i gazeve mund të jetë kumulativ dhe të ndikojë në distanca të mëdha.

9.1.10 Peisazhi

Objektivi Mjedisor 12: Garantimi i ruajtjes së peisazheve të veçanta dhe zonave peisazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i nje imazhi peisazhi me cilësi të lartë.

Përcaktimi i ndikimit në cilësinë e peizazhit kryesisht buron nga veçoritë e dukshme të hapësirës dhe të peizazhit karakteristik të elementëve të pranishëm në hapësirë. Peisazhi është më i shkelur nga lidhjet e transportit që shtrihen në hapësirë të hapur, ku ndikimet e transportit janë më të dukshme për shkak të një niveli më të lartë të ruajtjes së tij (i përhershëm, ndikim i pakthyesëm). Ndikimi është veçanërisht i madh në rast të ndërtimit të një korridori të infrastrukturës në zonat me pamje të jashtëzakonshme apo të zonave të peizazhit me karakteristika të dallueshme, dhe peisazhet me elemente të ruajtura natyrore dhe elemente jashtëzakonisht të balancuara kulturore të cilat kanë domethënie të madhe simbolike.

Ndikimet në karakteristikat e peizazhit të zonave mund të përkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të largëta. Objektet e infrastrukturës në hapësirë bëhen elemente të peizazhit dhe pjesë e përvojës së saj. Prandaj, marrëveshja e tyre duhet të jetë në përputhje me llojet ekzistuese të peizazheve. Duke marrë parasysh karakteristikat natyrore dhe topografinë e zonës të aktivitetit do të zvogëlojë fragmentimin e peizazhit.

9.1.11 Konkluzioni mbi Vlerësimin

Ky raport paraqet vlerësimin e impakteve mbi zbatimin e Planit bazuar në realizimin e objektivave mjedisore, të paraqitura për secilin veprim.

Impaktet mbi objektivat mjedisore mund të ndodhin gjatë zbatimit të secilit prej veprimeve individuale (niveli A, B dhe C). Në përgjithësi, u vu re që me anë të pozicionimit të përshtatshëm të aktiviteteve hapësinore dhe duke ndërmarr gjithë masat zbutëse, të gjithë grupet e veprimeve janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor. Në përputhje me gjetjet, janë propozuar masa zbutëse të përgjithshme dhe specifike në Seksionin 10.

Gjatë zbatimit të veprimeve, priten të ndodhin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatikë duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave. Për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm

prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe koridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave.

Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe impaktet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

9.2 IMPAKTET KUMULATIVE

Impaktet mjedisore kumulative përcaktohen në këtë Raport si një kombinim i impakteve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit.

Në zbatimin e veprimeve të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit.

Kur vlerësohen impaktet mbi tokën, ajrin dhe faktorët klimatikë, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- tokën, zona toke bujqësore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integritetit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen;
- asetet minerale, shkalla e riciklimit të gjenerimit të mbetjeve ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit dhe rindërtimit që kombinohen;
- ajrin, shkarkimet e ndotësve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- faktorët klimatikë, shkarkimet e gazeve serë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatikë, impaktet kumulative si shumë e impakteve të të gjithë veprimeve të Planit janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore të përcaktuar për sektorët e Shqipërisë për 2030 në lidhje me:

- menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit;
- shkarkimet tavanë të ndotësve
- sasia vjetore më e lartë e shkarkimit të gazeve serë.

Kur vlerësohen impaktet mbi ujin, natyrën, trashëgiminë kulturore dhe peisazhin, impaktet kumulative zakonisht nuk mund të shprehen si një shumë e impakteve të të gjithë veprimeve për të arritur synimet e Planit. Kur vlerësohen impaktet kumulative në aspektet e përmendura më sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në impaktet kumulative janë shumë të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe në distancë) dhe kohës (afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë, përkohësisht dhe permanent) të impaktit.



Kur vlerësohen impaktet mbi shëndetin human, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si një kombinim i impakteve që kontribuojnë në shëndetin dhe mirëqënien e njerëzve dhe zakonisht referohen për:

- reduktimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të zhurmës;
- reduktimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis; dhe
- masat që lehtësojnë veprimtari shlohëse dhe rekreative në një mjedis të shëndetshëm për distanca të shkurtra, veçanërisht gjatë shkëmbimeve ditore (impaktet u vlerësuan midis popullatës).

Kur vlerësohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve në Plan shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për të arritur synimet e Planit janë pozitive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse impaktet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë.

9.3 IMPAKTET NDËRKUFITARE

Ligji 91/2013 “Mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor” kërkonjë përcaktimin dhe konsultimin mbi efektet ndërkufitare për planet dhe programet e hartuara.

Impaktet ndërkufitare mbi objektivat mjedisore për veprimet mbi prioritet dhe synimet nuk paraqesin asnjë efekt negativ apo pozitiv.



SEKSIONI 10 - UDHËZIME DHE MASAT ZBUTËSE

10.1 TË PËRGJITHSHME

Ky paragraf përcakton udhëzimet dhe masat mbrojtëse për të siguruar arritjen e objektivave të rëndësishëm mjedisorë në fushat e veçanta. Duke zbatuar udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse, ndikimet negative të përshkruara në Seksionin 6.1 do të parandalohen dhe do të sigurohet arritja e objektivave mjedimore. Për më tepër, ky seksion ofron disa masa specifike zbutëse të zbatueshme për projektet specifike të përshkruara në Plan. Është e rëndësishme të theksohet se lista e dhënë më poshtë e masave specifike për zbutjen nuk është shteruese. Masa më të detajuara në aspektin e përmbajtjes dhe analizës do të duhet të përgatiten si pjesë e VNM-ve individuale për çdo projekt specifik të Planit.

10.2 UDHËZIMET DHE MASAT MBROJTËSE

10.2.1 Toka

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedorë 1 dhe 2

Duke zënë një territor të caktuar, ndërtimi i infrastrukturës së parashikuar do të shkaktojë ndikime të gjera të përhershme, të cilat do të pasqyrohen si një ndryshim në strukturën e përdorimit të tokës. Prandaj, kur planifikohet integrimi i infrastrukturës së parashikuar në mjedis, duhet të garantohet menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj. Aktivitetet në tokën bujqësore dhe pyjore duhet të reduktohen në nivelin më të ulët të mundshëm, dhe duhet t'i jepet prioritet i lartë planifikimit të aktiviteteve në tokë me potencial më të varfër të prodhimit, dhe tokë jashtë zonave të dendura pyjore apo zonave pyjore me funksione të rëndësishme të prodhimit të lëndës së parë të drurit. Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja. Infrastruktura e parashikuar duhet të planifikohet në atë mënyrë që mos të rritë probabilitetin e rrëshqitjeve të tokës në zonën përreth aktiviteteve. Për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, do të duhet që projektet specifike të plotësohen me udhëzime për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të ndërtimit në ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës së re, dhe më e rëndësishmja, përdorimin e materialeve të certifikuar të ndërtimit, prodhuar nga riciklimi i post-produkteve ose mbetjeve nga sektorët e tjerë. Kur përdoren materiale ndërtimi për infrastrukturën e re, të cilat nuk janë me origjinë primare natyrore, duhet të merret parasysh fakti se:

- kërkohen sasi më të mëdha të materialeve të ndërtimit, kryesisht si mbushje;
- mobilizohen në mënyrë të përhershme disa substanca të rrezikshme nga materialet e mbetjeve;
- materialet e reja të ndërtimit mund të kenë cilësi më të mira funksionale se materialet me origjinë natyrore.



Masa Zbutëse Specifike

Punimet në dhera të ndotura

- a. Gjatë punimeve mund të zbulohen dhera të ndotura. Këto dhera duhen larguar. Pastaj duhet vendosur tokë artificiale me gjeomembranë, argjile dhe shtresë plehu, mbi të cilën duhet të mbillet bar dhe pemë. Kjo tokë artificiale duhet të mbulojë edhe sipërfaqet e ndotura që nuk do të lëvizin.
- b. Të gjithë materialet ndotës (dherat dhe mbetjet) që do të largohen, duhet të depozitohen dhe groposen në vende të caktuara ku duhet të jenë të izoluara nga ujërat nëntokësore.

Ndotja e tokës

- a. Toka që shtrihet nën rrugë mund të jetë në rrezik gjatë ndërtimit, pasi mund të ndotet nga derdhjet e hidrokarbureve dhe ato kimike. Pastaj toka mund të shërbejë si një burim ndotjeje kur përshkohet nga ujërat nëntokësore.

Metoda e thyerjes e shkëmbit


- a. Në zonat ku kërkohen prerje të mëdha, do të ndeshen shkëmbinj të cilët mund të kërkojnë zhvendosje. Metoda e zhvendosjes mund të variojë nga gërmimi me një ekskavator, deri tek shpërthimi, i cili do të sjellë zhurmë të konsiderueshme dhe dridhje që lidhen me të.

Ripërdorimi i materialit të gërmuar

- a. Materiali, i cili gërmohet nga prerja e seksioneve është një burim natyral dhe përdorimi i tij në bazë të një skeme do të maksimizohet duke përdorur teknika konstruktive të cilat intensifikojnë ngjeshjen e materialeve për t'u përdorur si mbushje inxhinerike.
- b. Megjithatë, pashmangshmërisht do të ketë një sasi të konsiderueshme material, i cili, për shkak të veçorive të tij fizike dhe strukturore, nuk është i përshtatshëm për t'u përdorur si mbushje inxhinerike brenda skemës. Megjithatë, ky material mund të jetë i përshtatshëm për aktivitete të tjera, siç është krijimi i peisazhit, ku nuk aplikohen kërkesa kaq të rrepta strukturore. Ripërdorimi i këtij materiali do të maksimizohet brenda skemës, dhe çdo material i tepërt do të transportohet jashtë.
- c. Materiali i gërmuar i parashikuar për ripërdorim do të trajtohet dhe transportohet në minimum, dhe do të depozitohet në mënyrë të tillë që të minimizojë ndikimet e gërryerjes. Koha midis gërmimit dhe ripërdorimit gjatë periudhës së lagësht duhet të jetë sa më e vogël. Gjatë periudhave të zgjatura me lageshtirë, kontraktori duhet të ndërpresë gërmimin dhe vendosjen e materialit për të parandaluar degradimin për shkak të lageshtirës.

Erozioni

- a. Përcaktimin e vijes ujore që nënkupton përcaktimin nga ana ligjore të asaj që quhet vija zero e ujit mbi bazën e së cilës do të realizoheshin më mirë vlerësimet e erozionit ujor, dinamikës së lëvizjes së ujit dhe të sedimenteve.
- b. Duhet ndërmarrë mbrojtja e argjinaturës nga erozioni, me qëllim që të sigurohet stabilizimi i argjinaturës, përfshirë edhe përzgjedhjen e material më pak të erodueshëm, përdorimin e gabionëve dhe gurëve të thyer, si dhe një ngjeshje të mirë, veçanërisht përreth urave dhe tombinove.



- c. Mbjellja duhet përfunduar sa më shpejt të jetë e mundur, menjëherë pas mbushjes, për të lehtësuar rigjenerimin e një mbulese stabilizuese të tokës. Aty ku është e nevojshme do të kërkohet hapje e kanaleve për të siguruar mbjelljen e suksesshme të bimëve.
- d. Aty ku është e nevojshme, zonat e shkarkimit prej strukturave kulluese do të pajisen me gurë të thyer, për të reduktuar erozionin, veçanërisht në rastet kur janë instaluar strukturat e kullimit dhe/ose nivelet e formacioneve të rrugës janë ngritur dhe krijojnë shpate të zhveshura, të cilat kërkojnë stabilizim, përpara fillimit të sezonit të shirave.

10.2.2 Ajri

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 3

Në planifikimin e politikave dhe aktiviteteve të Planit në zonat e ndotjes së tepruar të ajrit, duhet të merren parasysh objektivat e SKZHI II dhe standartet e lejuara të emetimeve, të përcaktuara nga BE, OBSH dhe legjislacioni përkatës shqiptar.

Duhet të përgatitet një program i detajuar i masave për zvogëlimin e ndotjes me grimca PM10 dhe PM2.5 për zonat problematike. Programi do të duhet të vërehet gjatë planifikimit të politikave dhe projekteve specifike të Planit për zonat problematike, në një shkallë më të gjerë. Prioritet në procedurën e përzgjedhjes duhet t'i jepet varianteve të cilat ofrojnë përmirësimin më të madh të cilësisë së ajrit të ambientit. Gjatë përgatitjes së politikave dhe projekteve të reja në infrastrukturë, duhet të respektohen udhëzimet dhe masat në vijim, në mënyrë që të arrihen objektivat e reduktimit të ndotjes së ajrit të ambientit në zonat e ndikimit të aktiviteteve përkatëse:

Cilësia e ajrit - komuniteti

- Monitorim të rasteve të sëmundjeve dhe shkaktarëve;
- Përcaktimi i zonave urbane të reja me cilësi të lartë ajri për popullsinë;
- Dizenjim me kushtet dhe kriteret e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, mirëmbajtje dhe zëvendësim i materialeve rezistente ndaj ndryshimit të temperaturave dhe lagështisë;
- Përdorim i mjeteve të transportit publik me emetime të gazeve në nivele të ulëta ose me filtra ajri të edukimit maksimal ;
- Përcaktimi i zonave industriale me teknologji të lartë dhe me emetime të gazeve në sasi të ulët.

Cilësia e ajrit - ekosistemet

- Identifikimi dhe monitorimi i burimeve të gazeve që shkaktojnë shiun acid;
- Komunikim ndërkufitar institucional për të shmangur incidentet mjedisore të qarkullimit të ajrit si dhe përcaktimi i masave konkrete të veprimit në raste të incidenteve ndërkufitare;
- Përcaktimi i kriterëve të tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës dhe qëllimit të përdorimit të saj që në fazat e projektimit;
- Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi;
- Strukturimi i kërkesave për lëndë drusore;



- Përcaktimi i masave të emergjencave në rastet e aksidenteve industriale për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis dhe në cilësinë e tij.

Masa Zbutëse Specifike

- Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e vendit duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane dhe ato rurale (të gjitha bashkitë të kenë dy- tre stacione monitorimi sipas specifikës së zonave industriale dhe të banimit);
- Koordinimi midis institucioneve qendrore dhe vendore për vlerësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e ajrit dhe me masat ndaj ndryshimeve klimatike.

Gjate fazës së ndërtimit, masat më të zakonshme specifike të rekomanduara në punimet infrastrukturore rrugore konsistojnë në:

- Implementimi i sistemit të shtypjes së pluhurit: ujëtja e anëve të rrugëve,
- përdorimi i ndarjeve të rrugëve për të kufizuar nxjerrjen e pluhurit (për shembull përdorimi i larjes së rrotave, etj);
- Kufizimi i shpejtësisë së impianteve të lëvizshme në rrugë.

Ulja e ndikimit nga ndërtimi përfshin gjithashtu:

- vendodhjen potenciale të zonave që kërkohen instalimin e kantierit, magazinim si dhe zonat e stabilizimit të tokës;
- rrugët e transportit që përdoren për shpërndarjen e materialeve.

Përsa i përket fazës së shfrytëzimit të infrastrukturës propozohen masat specifike të mëposhtme:

- kontrolli i kufijve të shpejtësisë së automjeteve gjatë sezonit me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit me pezulli në qendrat kryesore urbane;
- mirëmbajtje e rregullt e sipërfaqeve rrugore për të pakësuar sa më shumë që të jetë e mundur ringritjen e pezullive.

10.3 FAKTORËT KLIMATIKË

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 4

10.3.1 Masat zbutëse ndaj ndryshimeve klimaterike

Zbatimi i masave për të arritur objektivat e Planit duhet të marrë parasysh të ashtuquajturat objektiva indikative për të reduktuar emetimet e gazit, të cilat janë të përcaktuara deri në vitin 2020 në SKZHI II për reduktimin e emetimeve të gazit serrë. Në këtë kudër duhet mbajtur në vëmendje si më poshtë:

- përcaktimi i protokolleve dhe monitorimi i rasteve të trajtimit të sëmundjeve që vijnë si pasojë e ngjarjeve të motit;
- përcaktimi i masave të emergjencave civile për të shmangur/zbutur ndikimet nga kushtet ekstreme të motit;



- Përcaktimi i kriterëve dhe politikave për futjen e teknologjive bashkëkohore në bujqësi si dhe praktikave më të mira të bujqësisë organike zbatimi i një politike parkimi kufizuese në zonat urbane;
- integrimi i çështjeve të ndryshimeve klimatike në kuadrin politik dhe ligjor duke specifikuar institucionet dhe përgjegjësitë për identifikimin, zbatimin dhe monitorimin e masave zbutëse/përshtatëse ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

10.3.2 Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Projektet specifike të Planit duhet të hartohen në një mënyrë të tillë që të sigurojnë një përdorim efektiv të burimeve, që do të thotë se ndjeshmëria e infrastrukturës së parashikuar ndaj ndryshimeve klimatike, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive antropogjenike duhet të vërehet siç duhet. Kjo do të thotë se kur planifikohet infrastruktura, duhet të merren në konsideratë masa nga vlerësimet e rreziqeve, të cilat do të rrisnin elasticitetin e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike në mënyrën e duhur, veçanërisht në lidhje me reshjet, përmytjet, temperaturat e larta dhe valët e të nxehtit, thatësitrat, rritjet e nivelit të detit dhe stuhitë. Në këtë kuadër, është e nevojshme të:

- përgatitet një analizë e ndjeshmërisë së infrastrukturës së parashikuar ndaj ndryshimeve klimatike;
- zbatohen masat dhe orientimet e bazuara në rezultatet e analizave të cilat përmirësojnë në mënyrën e duhur elasticitetin e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike.

Për të arritur objektivin mjedisor në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të sigurohen si më poshtë:

- në terma afatgjatë, infrastruktura duhet të jenë më pak e ndjeshme ndaj pasojave të reshjeve ekstreme (shirave, debores, apo edhe ngricave);
- gjatë planifikimit të çdo ndërtimi të ri apo zgjerimi të strukturave ekzistuese, duhet të kryhet një analizë ndjeshmërie e infrastrukturës së parashikuar në kushtet ekstreme të motit, dhe në bazë të rezultateve të saj, duhet të përgatitet një plan masash për të reduktuar në mënyrë të përhershme pasojat e këtyre fenomeneve;
- zbatimi i masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës ndaj kushteve ekstreme të motit duhet të bëhet një detyrë qëndrore e menaxhimit të çdo lloji infrastrukture. Qëllimi i zbatimit të këtyre masave duhet të bazohet sidomos në reduktimin e dëmit të shkaktuar për përdoruesit e infrastrukturës së ndjeshme ndaj motit, nëse ata nuk mund ta përdorin atë;
- duhet të përcaktohen qartë udhëzimet për metodologjinë, procedurat dhe realizimin e mbledhjes së informacionit mbi kushtet ekstreme të motit, si dhe për planifikimin dhe zbatimin e masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës së parashikuar ndaj kushtet ekstreme të motit.

Masa Zbutëse Specifike

- Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi;
- Strukturimi i kërkesave për lëndë drusore;




- Dizajnimi dhe përcaktimi i kritereve të ndërtimit të infrastrukturave nëntokësore me materiale dhe struktura rezistente ndaj kushteve të motit dhe në veçanti ndaj temperaturave të larta dhe lagështisë;
- Ndalimi i ndërhyrjeve ilegale në infrastrukturën nëntokësore;
- Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve ekologjike të mjedisve natyrore;
- Monitorimi i dinamikës së vijës breglumore dhe nivelit të ujrave;
- Monitorimi i vijës breglumore dhe sasisë së sedimenteve që vijnë nga lumenjve;
- Monitorimi i lëvizjes së tokës dhe tjetërsimit të saj;
- Monitorimi i marrjes së zhavorreve nga shtretërit e lumenjve;
- Përcaktimi i zonave të lejuara për ndërtim HEC-esh dhe digash për bujqësinë;
- Monitorimi i gjendjes së monumenteve dhe veprave të trashëgimisë kulturore;
- Monitorimi i lëvizjes së popullsisë në zonat urbane dhe rurale;
- Zbatimi i kodeve të reja të ndërtimit për ndërtesat sociale dhe kulturore duke përdorur materiale termoizoluese dhe rezistente ndaj kushteve të motit;
- Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lëngëta urbane dhe industriale për të zvogëluar sasinë e lëndëve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore; dhe
- Përcaktimi i zonave buferike për rastet e ndikimeve nga rritja e nivelit të ujrave.

10.3.3 Uji

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 5

Në mënyrë që të kufizohen efektet e presionit që do të ushtrojë infrastruktura e parashikuar në burimet ujore dhe kështu të parandalohen ndikimet negative në cilësinë e ujit (sidomos ujit të pijshëm), duhet të shmangët integrimi hapësinor i infrastrukturës së re në zonat e mbrojtura ujore.

- Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së re, është e nevojshme që të shmangët integrimi i objekteve në zonat në rrezik nga përmytjet dhe erozioni si pasojë e tyre. Në rast të ndërhyrjeve në këto zona, duhet të provohet se niveli ekzistues i rrezikut nga përmytjet në zonën përreth nuk do të rritet. Udhëzimi i lartpërmendur duhet të merret parasysh në mënyrë që të reduktojë presionin e infrastrukturës së re në zonat në rrezik nga përmytjet, dhe për të siguruar se niveli i rrezikut nga përmytjet në zona të veçanta nuk do të rritet;
- Kur planifikohen ndërhyrjet në zonat me rrezik jashtëzakonisht të lartë, shumë të lartë dhe të lartë të akufereve, është e nevojshme që të studiohen dhe planifikohen zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit, si dhe në rastin e ngjarjeve të



jashtëzakonshme (p.sh. rrjedhjet e substancave të rrezikshme). Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të reduktojë probabilitetin e ndotjes nëntokësore, duke siguruar ndikime të kufizuara të presionit të infrastrukturës së re në ujërat nëntokësore;

- Sa më shumë që të jetë e mundur, infrastruktura e re nuk duhet të ndërhyjë në tokën pranë liqenit. Aktivitetet e tilla mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në statusin ekologjik të rrjedhave ujore, të zvogëlojnë basenet mbrojtëse ujore, dhe të prodhojnë ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës. Në rastet e përjashtimit të kesaj mase, kjo duhet të bëhet e mundur vetëm në bazë të argumentimit të ekspertëve, duke deklaruar se elementi i infrastrukturës nuk mund të integrohet në vende të tjera pa shpenzime jashtëzakonisht të larta. Në llogaritjen e këtyre shpenzimeve duhet të përfshihen edhe kostot që vijnë si pasojë e pakësimit të shërbimeve që vijnë nga ekosistemi. Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të bëjë llogaritjen e kostove më të saktë dhe të balancuar. Duhet të priten më pak aktivitetet e zonat breglumore. Kjo do të parandalonte ndikime të rëndësishme negative në gjendjen ekologjike të rrjedhave ujore.

Masa zbutëse specifike

- Në rast se zbatimi i një projekti specifik do të ndikojë ndjeshëm në ndonjë akuifer, gjatë hartimit të dokumentacionit të projektit duhet bërë edhe një vlerësim i dëmit ndaj ujërave nëntokësore. Vlerësimi duhet të përfshijë gjithashtu edhe një mënyrë për ta kaluar këtë zonë (si psh ndërtimin e një ure) për të garantuar mbrojtjen e ujit nëntokësor;
- Duhet planifikuar zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative mbi ujërat e larjes, gjatë fazave të ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës, si dhe në rastet e ndodhive të jashtëzakonshme (psh derdhjet e substancave të rrezikshme).

Ndikimet e ndotjes do të shmangen duke adoptuar praktika të mira të menaxhimit të punës në terren, siç janë:

- Nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të dëmshme në një distancë më pas se 50 m nga Lumi si dhe do të kufizohet pranë rrjedhave të tjera ujore siç janë kanalet kulluese;
- Ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbulohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- Kanalet anësore do të ndërtohen përpara ndërtimit të rrugës, për të parandaluar derdhjen e rrjedhjeve të rrugës gjatë ndërtimit, në lumë, apo kanalet kulluese;
- Hedhja e betonit duhet të bëhet duke përdorur armaturën e duhur, për të shmangur ndotjen;
- Kur derdhjet nga kantieri duhet të shkarkohen në një lumë, norma e derdhjeve duhet të kontrollohet, në mënyrë që ajo të mos shkaktojë përmytje lokale në rrjedhen e ujit, apo erozioni;
- Në rast se ka derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, kontraktori duhet të hartojë një program të masave për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Marrja e mostrave të ujërave nëntokësore duhet të bëjë gjithashtu matjen e pH, turbullirës dhe përcjellshmërisë elektrike. Të gjitha veprimet e kërkuara dhe, nëse nevojiten, analizat, duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar.



10.4 MJEDISINATYROR

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisorë 6 dhe 7

Për të ruajtur në mënyrë të përhershme mjedisin natyror dhe biodiversitetin, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:


- Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese ka përparësi mbi ndërtimin e infrastrukturës së re;
- Nëse aktivitetet në mjedisin e paprekur nuk mund të shmangen, duhet të shmangen aktivitetet në zonat e mbrojtura, zonat me rëndësi mjedisore dhe zonat me karakteristika të çmuara natyrore;
- Prioritet duhet t'i jepet varianteve me më pak ndikim në rrugët e migrimit të kafshëve të egra (variante të cilat kalojnë më shumë nëpër tunele dhe variante të cilat ndërpresin më pak rrugët e migrimit);
- Duhet të sigurohen pasazhe të pershtatshme për kafshët e egra, gjë që është në përputhje me praktikat më të mira evropiane. Para se të planifikohet çdo ndërtim i ri, duhet të kryhet një studim apo të përmbliidhen rezultatet e studimeve ekzistuese, të cilat do të lehtësonin integrimin në mënyrë të pershtatshme të një strukture të caktuar në një vend (formën, madhësinë, dhe sistemimin e objektit dhe rrethinave të tij). Planet duhet gjithashtu të parashikojnë pasazhe për kafshët e vogla (amfibët, gjitarët e vegjël, zvarranikëve) në bazë të studimeve ekzistuese ose, nëse është e nevojshme, hulumtimeve shtesë.

Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, duhet të shmangët ndërhyrja e projekteve në zonat me karakteristika të çmuara natyrore. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë ruajtjen e llojeve dhe karakteristikave të vlefshme natyrore.

Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, duhet të shmangët ndërhyrja e projekteve në zonat e mbrojtura. Nëse aktivitetet në zona të tilla nuk mund të shmangen, dhe nëse kjo është e lejuar në bazë të aktit për mbrojtjen e një zone të caktuar, duhet të merren parasysh udhëzimet, bazat dhe kushtet për ruajtjen e zonave të mbrojtura të natyrës të cilat janë në regjim mbrojtjeje, të miratuar me aktet për mbrojtjen. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë mbrojtjen e zonave të mbrojtura.

Tab. - Masat për mbrojtjen e Biodiversitetit

Masat përparëse për mbrojtjen e Biodiversitetit		
Masat	Përshkrimi	Masat kryesore përparëse publike
1	Zbërthim i kuadrit ligjor, në menaxhimin e Biodiversitetit. Përgjithësim dhe veçori të relievit dhe biodiversitetit në këte bashki.	Përmirësime afat-shkurtra të legjislacionit për mbrojtjen e natyrës; zbatim i Ligjit të Biodiversitetit duke përfshirë trajnimin e e specilaistëve në këte bashki.
2	Njohje dhe menaxhim shkencor i zonave të Mbrojtura	Menaxhimi i GJEOMONUMNTEVE të mbrojtura



3	Zhvillimi i Planeve të zgjerimit të zonave të Mbrojtura në kete bashki.	Është menduar që të gjitha vendet të cilat janë përcaktuar para fundit të vitit 2019 do të kenë plane të menaxhimit të plotë deri në fund të 2022.
4	Rritja e Menaxhimit të Specieve të Mbrojtura, në kete bashki.	Ndërmarrja e fushatës për të zvogëluar numrin e armëve të zjarrit pa leje
5	Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur dhe Specieve	Sigurimi i objektivave për menaxhimin e zonës së mbrojtur janë përfshirë si kritere kyç në udhëzuesin e MM.
6	Monitorimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Informacionit në krijim të një GIS për Biodiversitetin.	Bashkëpunim i Administratës së Bashkisë dhe NjAV për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të Agjencisë së Pyjeve dhe Mjedisit.

Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, ndërhyrja e projekteve në zonat e Natura 2000 duhet të shmanget. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë mbrojtjen e lidhjes dhe integritet të zonave të Natura 2000. Periudha për zbatimin e projekteve duhet të rregullohet sipas cikleve jetësore të kafshëve dhe bimëve, dmth:

- duke ju përshtatur kafshëve pa apo me aktivitete me një shtrirje në një masë të vogël, që përkon me periudhën kur kafshët kanë nevojë për qetësi, ose nuk mund të lëvizin larg, sidomos gjatë periudhës së riprodhimit, shumimit, rritjes, dhe dimërimit;
- duke ju përshtatur bimëve duke lehtësuar prodhimin e farës, mbjelljen natyrore dhe format e tjera të riprodhimit.

Respektimi i masës do të zvogëlojë shqetësimet për ciklet e jetës së kafshëve dhe bimëve dhe do të rrisë probabilitetin për të arritur apo ruajtur një gjendje të favorshme të popullsisë. Mundësitë e arritjes së objektivit për ruajtjen e biodiversitetit do të jenë më të larta.

Në përputhje me objektivin SKZHI II "nje rritje e synuar te 17% e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura të territorit nëpërmjet përmirësimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura" sipërfaqja e zonave të mbrojtura pritet të rritet. Prandaj, ndërhyrja hapësinore e infrastrukturës së parashikuar në zonat e propozuara për mbrojtje duhet të shmanget për të parandaluar konfliktet e mundshme dhe ndikimet negative në arritjen e objektivave mjedisore të ruajtjes së natyrës.

Sa më shumë që të jetë e mundur, infrastruktura e re nuk duhet të ndërhyjë në tokë breglumore. Aktivitetet e tilla mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në statusin ekologjik të rrjedhave ujore, për të zvogëluar basenat mbrojtëse ujore, dhe për të prodhuar ndikime kumulative mbi biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës. Në rastet e përjashtimeve, kjo duhet të bëhet e mundur vetëm në bazë të argumentimit të ekspertëve, duke deklaruar se elementi i infrastrukturës nuk mund të integrohet në vende të tjera pa shpenzime jashtëzakonisht të larta. Në llogaritjen e këtyre shpenzimeve duhet të përfshihen edhe kostot që vijnë si pasojë e pakësimit të shërbimeve që vijnë nga ekosistemi. Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të bëjë llogaritjen e kostove më të saktë dhe në mënyrë të balancuar sic duhet. Në zonat breglumore pritet të zhvillohet më pak ndërhyrje, për të parandaluar kështu ndikime të rëndësishme negative në biodiversitetin e këtyre zonave.



Masa Zbutëse Specifike

Projektet specifike duhet të plotësohen me detyrën për të mbrojtur në mënyrë më adekuate llojet e veçanta të kafshëve prej rreziqeve që vijnë si pasojë e ndërtimit të infrastrukturës së re. Duhet të zbatohet masa zbutëse specifike: *Sigurimi i korridoreve të migrimit dhe siguria e kafshëve*. Përmbajtja e kësaj mase duhet të jetë si më poshtë:

- Të ulet fragmentimi i habitateve të llojeve, duke krijuar pasazhe për kafshët e egra në linjat ekzistuese të lëvizjes (veçanërisht për gjitarët dhe amfibet). Për këtë qëllim, fillimisht, duhet të kryhet një studim apo të përmbliidhen të dhënat nga monitorimet ekzistuese rreth vdekshmërisë së kafshëve të egra në rrugë. Pastaj, bazuar në gjetjet e studimit, do të krijohen lehtësira për migrimin e kafshëve të egra. Në kuadër të kësaj mase, do të përgatitet një listë prioritare e zonave 'të zeza' ku kafshët rrezikohen më shumë dhe në këto zona do të zbatohen masat zbutëse përkatëse (sisemim të vendkalimeve, gardhe anësore etj.). Gjithashtu kjo gjë ndikon pozitivisht në përmirësimin e sigurisë së trafikut;
- Në zonat ku planifikohet infrastruktura e re, duhet të sigurohet ruajtja e rrugëve ekzistuese të migrimit, duke ndërtuar strukturat e duhura dhe duke kryer gjithë sistemimet e tjera për të parandaluar lëvizjen e kafshëve të egra (sidomos mishngrënësve, drerëve, lakuriqve të natës dhe amfibëve). Për nevoja të planifikimit, do të përgatitet në fazën e parë një studim (ose nëse është e mundur do të përmbliidhen rezultatet e studimeve tashmë të kryera), i cili do të përfshijë të dhëna për speciet, migrimi i cilave do të preket nga aktiviteti, si dhe udhëzime për projektuesin që do të planifikojë objektin apo ndërhyrjen (vendndodhja, forma, madhësia, gjelbërimi i objektit dhe rrethinave, etj);

Këto masa do të lehtësojnë lidhjet mes habitateve (rivendosin apo ruajnë rrugët e migrimit) të specieve dhe arrijnë e objektivat mjedisore që lidhen me mbrojtjen e natyrës.

10.5 MBETJET

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 8

Zhvillimet e parashikuara padyshim që mbartin pasojën e gjenerimit të shtuar të sasisë së mbetjeve, të cilat mund të çenojnë integritetin e shtresave të ujrave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore. Nga ana tjetër mund të shkaktohen sëmundje kancerogjene deri në largësi të mëdha prej zonës së ndotur. Pikat e vjetra e të nxehta përbëjnë rrezik jo vetëm për shëndetin e njeriut, por krijojnë ambient për investime të reja para pastrimit të duhur. Gjenerimi i mbetjeve ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore.

Masat zbutëse që duhen parashikuar dhe zbatuar lidhur me administrimin e mbetjeve janë si më poshtë:

- Rehabilitimi /Inkapsulimi i pikave të nxehta mjedisore, rinovimi urban dhe ripërdorimi i tokës, duke i kthyer në zonë të gjelbra me vlerë rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë;



- Propozohet të studiohen të gjitha territoret e objekteve industriale që kanë përdorur ose gjeneruar kimikate të rrezikshme për shëndetin dhe të priorizohen mbi bazën e shkallës së rrezikut, duke zbatuar të gjitha direktivat e BE-së që lidhen me kontaminimin e rrezikshëm të tokës;
- Plani të përcaktojë dhe të ndajë zonat e ligjshme dhe të paligjshme të hedhjes së mbetjeve;
- Inventarizimi dhe diagnostifikimi i vend-depozitimeve, si dhe përcaktimi i prioritetëve, planifikimi dhe duhet bërë dhe raportimi. Rekomandimin e rregulimeve institucionale dhe financiare për të arritur këtë ;
- Duhet riparë norma 1 landfill/rajon sipas strategjisë kombëtare, kur pritet rikompozim i rajoneve në kuadrin e reformës së re territoriale. Rekomandimin e rregulimeve institucionale dhe financiare për të arritur këtë ;
- Hartimi i projekteve të standardizuara dhe mbështetja teknike duhet t'u ofrohen zonave të mbetjeve dhe autoriteteve lokale për të garantuar cilësinë e përshtatshme të planeve dhe që rezultatet e tyre të jenë të krahasueshme. Në kuadrin e reformës territoriale bashkitë duhet të zgjerojnë shërbimin në këto zona ;
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe përfshirja në planet rajonale e vendore të menaxhimit të mbetjeve ;
- Janë të domosdoshëm buxhete të mjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve, që përfshijnë gjithashtu dhe sektorin privat ;
- Planet duhet të saktësojnë orientimin drejt trajtimit të tyre sipas hierarkisë që është më praktikja dhe më e arritshmja në nivelet e ulta, të ndërlidhura me masa që varen shumë nga aktorët kryesorë në qeverisjen qendrore, politikat e saj dhe përgjegjësitë e prodhuesve. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve duke vendosur standarde lokale, për të cilat kanë rënë dakord të 3 nivelet ;
- Duhet planifikuar zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit, kompostimit, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis ;
- Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë (veçanërisht për fondet e BE-së) për të financuar infrastrukturën e nevojshme ;
- Mobilizimi i një instrumenti financues nga niveli kombëtar, rajonal dhe lokal, me qëllim që të plotësohen funksionet e tij në fushën e menaxhimit të mbetjeve ;
- Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave dhe zbatimi i sanksioneve ;
- Përcaktimi i zonave ndërkufitare ujore për menaxhimin e incidenteve të ndotjes industriale.

10.6 ZHURMAT

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 9

Kur të planifikohen politikat për zhvillimin e infrastrukturës së parashikuar, në mënyrë që të zvogëlohet ndotja akustike në mjedis në përputhje me objektivat e përcaktuara në SKZHI II, është e nevojshme të sigurohen masa që kontribuojnë në:

- reduktimin e ekspozimit të zonave urbane ndaj ndikimeve negative;
- mbrojtjen e mjedisit.



Ndotja akustike në Shqipëri është veçanërisht e lartë në qendrat urbane dhe në zonat e qendrave më të rëndësishme me zhvillime infrastrukturore. Prandaj është e domosdoshme që të merren masa për të zvogëluar ndotjen e mjedisit. Zbatimi i masave është i nevojshëm në zonat me ndotje të tepruar akustike në situatën aktuale, ndërsa duhet gjithashtu të merren masa zbutëse në të gjitha zonat ku Plani parashikon infrastrukturë të re. Gjatë përgatitjes së akteve hapësinore për projektet e infrastrukturës, duhet të respektohen udhëzimet e mëposhtme për të arritur objektivin e reduktimit të ndotjes nga zhurma:

- duhet të sigurohen për aq sa të jetë e mundur, masa për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim (masa në rrjetin apo strukturën përkatëse infrastrukturore, automjetet në përdorim, masa logjistike, riorganizimin e përkohshëm ose të përhershëm të lëvizjeve tranzite, reduktimi i orareve të punës apo zvogëlimi i shpejtësisë në zonat e ekspozuara ndaj zhurmës, etj) ;
- në zonat ku tejkalohehen tavanet e ndotjes, duhet të merren masa për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis (nëpërmjet barrierave të zhurmës dhe argjinaturave, galerive të mbuluara, etj) dhe për të siguruar kushte të mira jetese në ndërtesa (mbrojtja pasive);
- duhet të shmangët sa më shumë që të jetë e mundur ndërhyrja në zonat e qeta të banuar dhe / ose në zona të cilat janë të përcaktuara në bazë të legjislacionit për mbrojtjen nga zhurma si veçanërisht të ndjeshme ndaj zhurmës (ndërtesat e banimit, objektet e kujdesit shëndetësor, zonat turistike);
- duhet të shmangët sa më shumë që të jetë e mundur ndërhyrja në zonat e qeta në natyrë (zonat e mbrojtura në përputhje me rregullat për ruajtjen e natyrës).

Masat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma në duhet të përqëndrohet kryesisht në: (a) masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim; (b) masat për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis; dhe (c) nëse është e nevojshme, masa për krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në ndërtesat e mbiekspozuar.

Masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim janë më të efektshme. Emetimet e reduktuara të zhurmës nga burimet e saj mund të arrihet kryesisht përmes modernizimit të logjistikës në përdorim, riorganizimit të flukseve të trafikut dhe orareve të kryerjes së ndërhyrjeve infrastrukturore, etj. Qëllimi i SKZHI II në lidhje me vlerat e zhurmës në vitin 2020 është të arrijë objektivin e 56 dB / ditë dhe 45 dB / natë.

Masat për të parandaluar përhapjen e zhurmës në mjedis (barrierat e zhurmës / argjinaturat dhe mbrojtja pasive) janë përdorur kryesisht për të mbrojtur mjedisin nga zhurmat e shkaktuara prej sektorit të transportit. Masat janë të përshtatshme kryesisht për mbrojtjen e zonave me dendësi të madhe të popullsisë përgjatë rrjetit rrugor, ndërkohë që zbatimi i këtyre masave përgjatë rrugëve ekzistuese që kalojnë përmes vendbanimeve me një strukturë urbane të formuar dhe të dallueshme tashmë, është i arsyeshëm vetëm në raste të jashtëzakonshme.

Masat për të siguruar kushte të duhura jetësore (përmirësimi me hapësira mbrojtëse i izolimit nga zhurma i dritareve në ndërtesat e ekspozuara së tepërmi) janë të përshtatshme në zonat ku masat e tjera nuk janë teknikisht të zbatueshme apo ekonomikisht të qëndrueshme.



Masa Zbutëse Specifike

Rritje e ndikimeve të ndotjes akustike pritet gjithashtu gjatë zbatimit të aktiviteteve të infrastrukturës. Ndikimet e fazës së ndërtimit do të jenë afatshkurtër dhe të kthyeshme. Në veçanti, për të reduktuar ndikimet gjatë zbatimit të aktiviteteve, duhet të merren masat e mëposhtme zbutëse:

- Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit të prodhuara në përputhje me normat e emetimeve të zhurmës nga makinerive të ndërtimit, në përputhje me rregullat mbi emetimet e zhurmës nga makineritë e përdorura në vende të hapura dhe në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së;
- Do të ndiqen mënyrat më të mira të praktikueshme, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e duhur të impianteve, për të minimizuar zhurmat e prodhuara nga operacionet në terren, dhe në të gjitha rastet, në përputhje me rregullat shqiptare;
- Sheshet e ndërtimit dhe rrugët e transportit duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që ndotja akustike nga makineritë e transportit, funksionimi i pajisjeve në kantier dhe ndërtimet e objekteve, të mos tejkalojë vlerat kufi në ndërtesat më të afërta;
- Çdo impiant, i tillë si gjeneratorë apo pompa, që është i nevojshëm të përdoret para dhe pas orarit zyrtar të punës, do të jetë i rrethuar nga një barierë akustike apo reflektor portativ;
- Implementimi i masave të përkohshme për të mbrojtur nga zhurma zonat e populluara pranë kantierëve të ndërtimit dhe rrugëve të transportit ku janë tejkaluar vlerat kufi.
- Respektimi i afateve kohore për ndërtimin afër zonave të populluara;
- Publiku i gjerë dhe banorët e zonës do të informohen paraprakisht kur të kryhen vepra që emetojnë zhurma të konsiderueshme;
- Në kantierin e punimeve nuk do të përdoret asnjë makineri apo pajisje që shkakton shqetësim të publikut për shkak të zhurmës.

10.7 POPULLSIA DHE ASETET MATERIALE

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 10

Zhvillimet e reja infrastrukturore (sidomos qendrat multimore të transportit) pritet që të shkaktojnë një rritje të niveleve të zhurmës në mjedisin përreth tyre. Për të shmangur një përkeqësim të mjedisit ku jetohe në zonën përreth këtyre zhvillimeve, ky fakt duhet të mbahet në vëmendje kur të bëhet verifikimi i mundësive për zhvillim në fazat e mëvonshme, në kuadër të sigurimit të një lidhje multimodale në rajonin përreth.

Projektet specifike duhet të kenë në fokus edhe garantimin që infrastruktura e re vihet në dispozicion të të gjithë përdoruesve. Kjo pritet të inkurajojë përfshirjen më aktive të komunitetit në kuadër të sistemeve infrastrukturore, në mënyrë që ta bëjë atë më të arritshme për të gjitha shtresat dhe kategoritë sociale.

Kur planifikohen politikat dhe projektet e reja, prioritet duhet t'i jepet përmirësimit të lidhjeve dhe zhvillimit në zonat më pak të zhvilluara. Zbatimi i projekteve të kësaj natyre do të përmirësojë aksesin, dhe kështu do të kontribuojnë në zhvillimin më të shpejtë ekonomik në zonat më pak të zhvilluara.



10.8 TRASHËGIMIA KULTURORE

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 11

Zhvillimi i infrastrukturës së parashikuar mund të ndikojë te njësitë dhe zonat kulturore, veçanërisht në aspektin e degradimit të karakteristikave të peizazhit të rrethinave të njërive të trashëgimisë kulturore, dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe shkatërrimit të mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjatë ndërtimit të objekteve të cilat mund të shkaktojnë dëme në objektet e trashëgimisë kulturore. Për të shmangur këto ndikime, duhet të merren parasysh si më poshtë:


- Prioritet është mos vendosja e infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore. Duhet të ruhet sidomos integriteti dhe tiparet e peizazheve kulturore, zonave të ndikimit të trashëgimisë arkitektonike dhe mbetjeve arkeologjike;
- Në kuadër të ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (p.sh. gërmimi). Do të duhet të kryhen hulumtime të shumta paraprake arkeologjike, rezultatet e të cilave do të duhet të merren parasysh kur të përcaktohet vendosja e infrastrukturës së re. Gjithashtu do të duhet të zbatohen masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike;
- Zbulimet e një rëndësie të madhe mund të kërkojnë ndryshimin e punëve përgatitore (projektit) për një detyrë të veçantë. Në rast të zbulimit të gjetjeve apo mbetjeve arkeologjike, do të njoftohet menjëherë autoriteti përkatës. Zona më pas do të studiohet dhe mundësisht do të rrethohet; duke mos lejuar asnjë zhvillim të mëtejshëm në atë zonë derisa çështja të zgjidhet sipas procedurave të përcaktuara;
- Në rastet kur vendet arkeologjike mund të rrezikohen nga aktivitetet e ndërtimit, vendi do të jetë i mbrojtur nga rrethimi për të parandaluar dëmtimin e paqëllimshëm ose si pasojë e neglizhencës ndaj arkeologjisë;
- Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja;
- E gjithë puna e ndërtimit do të jetë e kufizuar brenda korridorit të punimeve. Në rast se nevojiten më shumë hapësira ose aktivitete të lidhura me ndërtimin jashtë korridorit të punimeve, do të informohen paraprakisht autoritetet kombëtare përkatëse.

10.9 PEISAZHI

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 12

Për të siguruar ruajtjen e peizazheve të jashtëzakonshme, zonave të peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar dhe një imazh të cilësisë së lartë të peisazhit, duhet të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

- Ndërhyrjet e infrastrukturës së re nuk duhet të integrohen në zonat e veçanta të peizazhit apo peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
- Në integrimin hapësinor të projekteve specifike duhet të kërkohen vende jashtë zonave me peizazhe të vecantë apo zonave me peizazhe me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
- Duhet të zbatohen masat e duhura teknike për të siguruar një imazh të cilësisë së lartë të peisazhit, veçanërisht në rastin e aktiviteteve në njësitë e ruajtura apo të pasura kulturore të natyrës;



- Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja.

10.9.1 Strategjia e Peizazhit

Në rastet kur projekti specifik i mbivendoset ndonjë peizazhi ekzistues bujqësor apo rural, duhet të ndiqet një qasje ku synohet mbrojtja e vlerave rurale dhe rezidenciale dhe pasurimi i peizazhit përgjatë anëve të rrugës. Objektivat e punimeve peizazhistike:

- Të zhvillohet një peizazh, karakteristikat e të cilit lidhen me modelin, shkallën dhe diversitetin e karakteristikave të peizazhit ekzistues ;
- Të minimizohen ndërhyrjet vizuale dhe të zvogëlohet natyra negative e çdo pengese vizuale;
- Për të mbrojtur, të rikthehen apo të zmadhohen elementet e peizazhit ekzistues, të prekur drejtpërdrejt nga propozimi;
- Të ndihmohet në krijimin e kushteve të këndshme e të sigurta të drejtimit të mjeteve.

10.9.2 Masat e përgjithshme zbutëse ndaj peizazhit

Gjatë zgjedhjes dhe projektimit të detyrave të propozuara, konsideratë duhet t'i jepet shmangies së ndikimeve kudo që të jetë e mundur. Në këtë kuadër, alternativa përfundimtare e miratuar për çdo projekt duhet të zgjidhet e tillë që të minimizojë ku të jetë e mundur ndikimin në karakteristikat e banimit, karakteristikat topografike, pemët dhe pyjet. Megjithatë, disa ndikime janë të pashmangshme, dhe masat e propozuara synojnë të zbutin natyrën negative të këtyre ndikimeve. Në rastet kur shtrirja vertikale propozon argjinatura të larta që krijojnë ndikime të rëndësishme në mjedis, këto përforsime të larta nuk duket të jenë optimizuar. Ato duhet të jenë ku është e mundur, të reduktuara deri në nivelin e tokës apo 1m lartësi.

Masa të tjera të përgjithshme përfshijnë:

- Në skarpata, për të parandaluar rënien e shkëmbinjve, duhet të jenë më preferueshme bordurat e gjera se platformat e ndërmjetme. Skajet e skarpatave duhet të rumbullakosen. Shpatet e parregullta duhet të jenë më të preferueshme se sipërfaqet gjeometrike.
- Zbatimin e standarteve kombëtare shqiptare të rrugëve për pastrimin e kantierëve dhe rivegetacionin, për të siguruar ruajtjen e komoditeve të nevojshme të peizazhit.
- Për mbushje, shpatet duhet ti nënshtrohen mbjelljes hidraulike me një përzierje farë që përfshin si farat e barit, ashtu edhe të shkurreve mesdhetare. Përveç kësaj, mbjellja në vendet e ndjeshme, veçanërisht në afërsi të ambienteve të banimit dhe rekreacionit, do të përdoret për të reduktuar apo zbutur pengesat vizuale të shkaktuara nga ngritja e argjinaturave të projektit, sidomos në kryqëzime.
- Për zonat potenciale në një nivel (pas optimizimit të lartësisë së projektit) bimësia e propozuar do të përmirësojë ndikimet negative të automjeteve, si dhe hapësirën vizuale të projektit të propozuar.
- Përgjatë gjatësisë së projektit përkatës do të trajtohen sipas rastiit: venddepozitimet për mbeturinat, zonat e përkohshme të ndërtimit, zonat e peizazhit brenda kryqëzimeve, zonat e vogla të fushave të copëzuara, fermat apo pronat e tjera të siguruar për ndërtimin e projektit. Te pikat e mbetjeve do të



psh: mbillet në mënyrë hidraulike. Zonat e përkohshme të ndërtimit do të jenë të rrethuara dhe të integruara vizualisht duke përdorur mbjelljen e bimëve sipas kërkesës.

10.9.3 Faza e ndërtimit

- Kontratat do të jetë e përshtatur për të siguruar praktika të mira të punës në mënyrë që të zvogëlojë çfarëdo ndikimi negativ që rrjedh nga ndërtimi në nivelin më të ulët të mundshëm dhe për të siguruar që makineritë veprojnë brenda zonës përkatëse të ndërtimit të projektit. Në të gjitha rastet, rregulloret kombëtare do të mbështeten kur të jetë e mundur me udhëzime nga praktikat ndërkombëtare.
- Zonat e përkohshme të ndërtimit do të pozicionohen në një mënyrë të tillë që të shmangin ndikimet e mëtejshme në pronat ekzistuese të banimit, pemët, gardhet, kanalet e kullimit etj. Këto zona, përpara ose në fund të kontratës së ndërtimit, do të rikthehen plotësisht në gjendjen e mëparshme .
- Lidhur shfrytëzimin e materialeve inerte, nxjerrja e e zhavorrit nga shtretërit e detnjve është e kontrolluar në përputhje me ligjin 8093/96, Neni 20.
- Sa i përket zonave të magazinimit, kontraktori do të kërkohej të përgatisë dhe zbatojë një plan të magazinimit të përkohshëm në konsultim me punëdhënësin dhe Agjensinë përkatëse Rajonale të Mjedisit. Ky plan do të hartohet para fillimit të punimeve të dheut. Në këtë plan, kontraktori duhet të përcaktojë qartë sasinë e materialit që do të hidhet apo ruhet përkohësisht, para se të fillojnë punimet përfundimtare. Plani gjithashtu do të specifikojë llojin e materialit dhe burimin e tij p.sh. gërmim hendeqesh, dhe sipërfaqësor etj.
- Me përfundimin e çdo projekti përkatës, shpatet anësore, duke përfshirë gërmimet dhe argjinaturat, bankinat dhe sipërfaqet e tjera të buta do të përgatiten për t'u mbuluar me dhë, dhe do të mbillen apo vishen me bimesi mbrojtëse.

Masa Zbutëse Specifike

- Në zonat kodrinore / malore, hapësira që kërkon okupimin e tokës do të ruhet në minimum, me qëllim që të shmangët prerja e panevojshme e pemëve.
- Në zonat përgjate brigjeve lumore, sipërfaqja e tokës së okupuar do të mbahet në minimum, me qëllim shmangien e prerjes së panevojshme të pemëve në këto zona.
- Aty ku është e mundur, argjinaturat e projektit duhet të ulen në minimumin e mundshëm.
- Pjerrësitë e argjinaturave do të jenë sa më të buta. Mbi gjithë argjinaturat do të shpërndahet dhë, dhe ato do të mbillen me bimë që mund të adoptohen në kushtet lokale.
- Në vendet ku rruga kalon pranë pronave private, do të ngrihen mbulesa bimore, me qëllim reduktimin e ndërhyrjes pamore.



SEKSIONI 11 - MONITORIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Sistemi i monitorimit të ndikimeve në mjedis, të cilat do të shkaktohen nga zbatimi i Planit, është një mjet i thjeshtë për t'u përdorur për një monitorim efektiv.

Monitorimi i ndikimeve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zbatimin e Planit, dhe, në përputhje me Ligjin 91/2013 dhe Direktivën 2001/42/EC, zbatimi i një programi duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim të hershëm ndaj këtyre efekteve dhe të bëhen adaptimet e mundshme.

Në këtë kuadër, është hartuar edhe sistemi i monitorimit të ndikimeve kryesore në mjedis, të cilat pritet që të shkaktohen nga zbatimi i Planit. Këto ndikime janë identifikuar gjatë vlerësimit të ndikimeve mjedisore të planit përkatës. Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë indikatorët përkatës për çdo sektor mjedisor (biodiversiteti, cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, toka, uji, peisazhi, trashëgimia kulturore, etj.) dhe identifikon autoritetin dhe përgjegjësinë për matjen e çdo indikatorit mjedisor të propozuar.

Grumbullimi i të dhënave sugjerohet që të mbështetet në dy burime:

- (a) të dhënat e para që merren nga matja e parametrave të mjedisit, dhe
- (b) vlerësimi i indikatorëve mjedisorë.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përmes matjeve mund të realizohet duke përfshirë Autoritetet Rajonale (Qarqet), por edhe Institucionet Shtetërore (përmes Ministrisë së Mjedisit), Pushtetin Lokal, institucione kërkimore shkencore dhe ato profesionale, si dhe ndërmarrjet e shërbimeve publike (landfillet, ujësjellës – kanalizime etj.). Matja e indikatorëve mjedisorë është një proces kompleks; ai është një proces që kryhet rregullisht dhe për më tepër, në mënyrë të vazhdueshme.

Në këtë këndvështrim ne duhet që të bazohemi në eksperiencën dhe në sistemet e monitorimit që përdoren nga strukturat e tjera, duke theksuar, nga njëra anë, monitorimin e zbatimit të standarteve të nevojshme të matjeve nga strukturat e tjera, dhe kryesisht nga operatorët përkatës (përmes përfshirjes së tyre në procesin e nxjerrjes së lejeve përkatëse mjedisore), dhe nga ana tjetër, duke u përqendruar tek procesi i grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave.

- Autoritetet Rajonale duhet të luajnë një rol kyç në procesin e administrimit dhe shpërndarjes së të dhënave. Në këtë kontekst, autoritetet përkatëse duhet të planifikojnë dhe të veprojnë si një qendër mbledhjeje, analizim dhe shpërndarje të informacionit. Më konkretisht, roli i Autoriteteve Rajonale duhet të përfshijë sa më poshtë:



- Mbledhjen e të dhënave prej matjeve që kryhen nga shërbimet publike dhe private rajonale, qoftë në mënyrë të përhershme, qoftë të përkohshme;
- Mbledhjen e të dhënave bazë që kryhet nga ndërmarrjet e shërbimeve publike (landfillet, ujësjellës - kanalizime, OSHEE, strukturat e menaxhimit të zonave të mbrojtura etj).
- Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga administrata publike (si psh Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësorë, etj);
- Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga institucionet kërkimore shkencore dhe organizata të tjera;
- Analizën dhe sintezën e të dhënave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve mbi gjendjen e mjedisit në një zonë të caktuar;
- Ruajtjen e të dhënave dhe krijimin e intervaleve kohore me qëllim monitorimin e gjendjes së mjedisit në kohë të caktuara;
- Shpërndarjen e të dhënave përmes raporteve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këto raporte synojnë që:

- të plotesojnë kërkesat e legjislacionit,
- të informojnë palët që marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të Planit (vendim-marrësit),
- të informojnë publikun që preket nga Plani.

Për çdo sektor mjedisor janë dhënë indikatorët përkatës, strukturat përgjegjëse për monitorimin, parametrat mjedisorë dhe frekuenca e monitorimit. Siç u përmend edhe më sipër, theksohet që monitorimi i ndikimeve të Planit në mjedis do të realizohet, aty ku është e mundur, duke përdorur të dhëna që dalin nga:

Sistemi ekzistues i monitorimit të parametrave mjedisorë nga Ministria e Mjedisit (MM) apo institucione të tjera. Disa parametra që maten dhe japin të dhëna janë:

- < Cilësia e ajrit (niveli i ndotjes),
- < Cilësia e ujit (ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, ujërat sipërfaqësorë).

Studime të veçanta dhe të pavarura për identifikimin e ndikimeve mjedisorë në kuadër të programeve apo projekteve të tjera. Raportet e përgatitura nga kontraktorë/konsulentë të ndryshëm, me të dhëna të drejtpërdrejta ose të referuara nga VNM-të individuale të projekteve specifike infrastrukturore të financuara nga buxheti i shtetit apo donatorët e huaj.

Tab. - Monitorimi i ndikimeve në mjedis prej zbatimit të planit

Nr	ASPEKTI MJEDISOR	INDIKATORI MJEDISOR	AUTORITETI MONITORUE	PARAMETRAT MJEDISORË	FREKUENCA E MONITORIMIT	KOMENTE
----	------------------	---------------------	----------------------	----------------------	-------------------------	---------

Gjeo Konsult & CO & Prof. Ing. Sazan GURI



1	Biodiversiteti – fauna - flora	<ul style="list-style-type: none"> • Sa habitate të rëndësishme janë në gjendje të Kënaqshme? • Numri dhe /ose sipërfaqja • me zona të mbrojtura • Përmasat e biodiversitetit, • krahasuar me BE (Numri i specieve endemike dhe të rralla • Sipërfaqja e mbuluar me pyje 	<p>Strukturat e Menaxhimit te</p> <p>Zonave te Mbrojtura</p> <p>Drejtorite pergjegjese ne qarqe</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Habitatet • Numri dhe /ose sipërfaqja me zona të mbrojtura • Numri i specieve endemike dhe të rralla • Sipërfaqja e mbuluar me pyje • Numri dhe sipërfaqja e mbuluar me zona natyrore 	Sipas Planit të Menaxhimit	Çdo vit
2	Popullsia – shendeti i njerezve	<ul style="list-style-type: none"> • Vitet e jetëgjatësisë së shëndetshme • Aksidentet në punë • Përqindja e njerëzve që jetojnë nën minimumin jetik 	Drejtorite pergjegjese ne qarqe	<ul style="list-style-type: none"> • Vitet e jetëgjatësisë së shëndetshme • Aksidentet në punë • Përqindja e njerëzve që jetojnë nën minimumin jetik 	Çdo vit	
3	Toka	<ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e tokës së degraduar • Sasitë e mbetjeve të eliminuara në landfille • Gjenerimi i mbetjeve për frymë dhe totali i % e ricikluar (letër, xham, mbetje bashkiake bio të 	<p>Drejtorite pergjegjese ne qarqe</p> <p>Strukturat e Menaxhimit te Lendfilleve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e tokës së degraduar • Sasitë e mbetjeve të eliminuara në landfille • Gjenerimi i mbetjeve për frymë dhe totali i % e ricikluar (letër, xham, mbetje bashkiake bio 	Çdo vit	



		degradueshme, alumin)		të degradueshme, alumin)		
4	Uji	<ul style="list-style-type: none"> Cilësia e ujërave sipërfaqësorë Cilësia e ujërave nëntokësorë 	Drejtoria e pergjegjese ne qarqe	<ul style="list-style-type: none"> Total N, total P, BOD-et, COD, SS, TDS, pH, 	Kampionim dhe matje sipas miratimit të kushteve	Sipas Ligjit nr. 34/2013 qe
		<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i ujit nga sektori Përqindja e riciklimit të ujit Përqindja e 	Strukturat e menaxhimit te	<ul style="list-style-type: none"> përcjellshmëria pH, përcjellshmëri, fortësia, kloridet, 	mjedisore për çdo ITUN. Sistemi	amendon Ligjin nr 9115, datë 24.7.2003
		popullsisë së lidhur me shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotur	ITUN ⁶ -ve	sulfatet, COD, BOD, nitrati, nitrimi, total P, metalet, detergjentet, ngarkesa toksike e mikrobiologjik Parametrat mikrobiologjikë	Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësorë	Ligji nr. 9915, date 12.05.2008
5	Ajri	Dirët kur tejkalohe normat e cilësisë së ajrit	Ministria e Mjedisit	SOx, NOx, PM10, gazet serë, Pb, CO	Çdo vit	Sistemi i Monitorimit te Cilesise se Ajrit te Ndotur
6	Faktoret klimatike	<ul style="list-style-type: none"> Shkarkimet e Gazeve Serë shkarkimet sipas burimit (%) Zhvillimi i kërkesës për energji Alokimi i prodhimit të 	Ministria e Mjedisit	SOx, NOx, PM10, gazet serë, Pb, CO	Çdo vit	Sistemi i Monitorimit it te Cilesise se Ajrit te Ndotur
			Ministria e Mjedisit	Përqindja e Energjisë nga BER (%)		



		energjisë sipas burimit • Përqindja e BER (%)		Numri i automjeteve të udhëtarëve		
7	<ul style="list-style-type: none"> • Asetet e prekshme – • Trashëgimia kulturore (përfshirë trashëgimime arkitektonike arkeologjike) • Peisazhi 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i godinave të ruajtura që restaurohen • Numri i vizitorëve • Gjelbërim urban për frymë 	Drejtorite përgjegjëse në qarqe	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i godinave të ruajtura që restaurohen • Numri i vizitorëve • Gjelbërim urban për frymë 	Çdo vit	

Monitorimi i ndikimeve mjedisore për çdo projekt specifik të Planit, do të bëhet në përputhje me programin e monitorimit dhe mund të përmbajë informacion në formë tabelë, sipas formatit të paraqitur më poshtë.

Projektet specifike të Planit	Indikatorët mjedisore	Parashikimi i ndikimeve kumulative (nëse ka)	Ndikimi total i Planit
Projekti 001			
Projekti 002			
Projekti 003			



SEKSIONI 12 - PËRFUNDIME DHE MENDIME PËR T'U MARRË PARASYSH


12.1 PËRFUNDIME

1. Raporti Paraprak i Vlerësimit Strategjik Mjedisor – RPVSM në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e HASIT (PPVBH) është një nga dokumentet kryesore për t'iu paraprirë analizave të mëtejshme mjedisore.
2. RPVSM synon të përcaktojë drejtimit kryesore të zhvillimeve dhe mbrojtjeve përkatëse mjedisore të territorit brenda afatit të tij të vlefshmërisë, i cili zgjat 15 vite që nga dita e miratimit të tij.
3. Ky dokument i ofron lexuesit/përdoruesit të krijojë një panoramë të përgjithshme analitike të gjendjes ekzistuese mjedisore në Bashki, si dhe të kuptojë drejtimet e ardhshme të zhvillimeve mjedisore përmes vizionit të planifikimit e zhvillimit të territorit.
4. Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendim-marrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara.
5. Qëllimi i VSM-së mund të përkufizohet si garantimi që konsideratat mjedisore informojnë dhe integrohen në vendim-marrjen strategjike në mbështetje të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm nga këndvështrimi mjedisor.
6. VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin.
7. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive.
8. Në thelb të vizionimit të territorit të bashkisë HAS qëndron zhvillimi i sektorit të turizmit malor natyror - agroturizëm.
9. Qëllimi që synon të përmbushë ky Plan është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore, të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private, të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit, të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjisllacionin, dhe të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse



të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

10. Ojektivi kryesor i VSM-së është orientimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues (PPRr) së Bashkisë HAS për minimizimin e çdo ndikimi potencial negativ që mund të rezultojë nga zbatimi i tij.
11. Kjo VSM identifikon ndikimet e mundshme mjedisore të PPRr, vlerëson ndikimet e mundshme, jep rrugët e minimizimit apo shmangies së tyre.
12. Specializim, densifikim dhe mbështetje e bizneseve të vogla dhe të mesme të cilat promovojnë ekonominë lokale.
13. VSM analizon disa skenarë. Skenari “0”, pra “i të mos bërit asgjë” në këtë Bashki do të çonte me shumë gjasa në një spirale të përshpejtuar të përkeqësimit mjedisor të deritanishëm.
14. Megjithëse ka një proces të qartë në zhvillimin e legjislacionit mjedisor, pika e dobët qëndron në zbatimin e kërkesave ligjore mjedisore. Ndër to do të veçonim ligjet: “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”; “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”; “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve; “Për mbrojtjen e biodiversitetit”; “Për trajtimin e ujrave të ndotur”; “Për substancat dhe preparatet kimike”; “Për administrimin e zhurmave në mjedis”; “Për zonat e mbrojtura”; “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” dhe “Për taksën e karbonit e të ambalazhit plastik”.
15. Zhvillimi i mobilitetit dhe optimizimi i lëvizshmërisë midis zonave të kësaj hapësire me qëllim përmirësimin e ndërlihdjes midis bizneseve dhe furnitoreve të tyre, si dhe aksesin e individëve tek shërbimet e ofruara nga kjo hapësire ekonomike.
16. Ruajtja e Burimeve Natyrore dhe Mbrojtja e Mjedisit, ku konsiderohet si prioritet i zhvillimit, përmirësimi i kualitetit dhe i sigurisë së aksesit me ujërat liqenore e sipërfaqësorë, përdorimi teknologjive me zero emetim të dëmshëm.
17. Ky vlerësim shqyrton aspektet mjedisore të zhvillimit të planit në lidhje me tendencat dhe situatën aktuale dhe bën një analizë të mjedisit urban në tërësi – përdorimit të tokës, florës, faunës, cilësisë së ajrit dhe ujit, rekreacionit aktiv dhe pasiv, zonave të ndotura, zonave me bukuri natyrore apo me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, zonave potencialisht të ekspozueshme ndaj rreziqeve natyrore; mjedisit dhe trashëgimisë së ndërtuar – monumentet e godinat kulturore dhe historike, aspektet dhe vlerat peizazhistike të qytetit; veprimtarive ekonomike dhe shoqërore – të tilla si tregtia, industria, shënlumei dhe arsimit, si dhe ndikimi që këto kanë mbi mjedisin dhe infrastrukturën dhe sigurimit të shërbimeve – sigurimi (burimor) i ujit, energjisë dhe telekomunikacioneve; menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme; qarkullimi dhe lëvizshmëria në rrugë dhe transport; lëvizshmëria alternative.
18. Raporti paraprak i i vlerësimit strategjik mjedisor bën të mundur përshkrimin e qëllimit dhe objektivave kryesore të planit ose programit; përshkrimin e metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VSM-së; përshkrimin e alternativave të konsideruara gjatë hartimit, rishikimit, ndryshimit apo modifikimit të planit ose programit të propozuar; objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, nivel kombëtar, rajonal apo lokal, etj.
19. Institucionet mjedisore në Shqipëri kanë kaluar nëpërmjet një procesi reformash të thella institucionale gjatë dy dekadave të fundit.
20. Megjithëse ka një proces të qartë në zhvillimin e legjislacionit mjedisor, pika e dobët qëndron në zbatimin e kërkesave ligjore mjedisore. Ndër to do të veçonim ligjet: “Për Vlerësimin Strategjik



Mjedisor”; “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”; “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve; “Për mbrojtjen e biodiversitetit” etj.;

21. Ndikimet mbi objektivat mjedisore mund të ndodhin gjatë zbatimit të secilit prej veprimeve individuale (niveli A, B dhe C).
22. Në përgjithësi, u vu re që me anë të pozicionimit të përshtatshëm të aktiviteteve hapësinore dhe duke ndërmarr gjithë masat zbutëse të gjithë grupet e veprimeve janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor. Në përputhje me gjetjet, janë propozuar masa zbutëse të përgjithshme dhe specifike në Seksionin 10 Qëllimet themelore të ruajtjes së biodiversitetit janë: Përfaqësimi i të gjithë NjAV, në ndërgjegjësim të tyre, për burimet ujore, pyjet dhe kullotat, pejsazhin duke u përqendruar tek Zonat e Mbrojtura. Ruajtja e specieve të llojeve të qëndrueshëm; Ruajtja e grupeve të habitateve të mëdha natyrore aq sa mund të jenë elastike në një shkallë të gjerë nga shqetësimet rastësore dhe ato afatgjate., etj.
23. Bimesia pyjore është e pasur dhe përfaqësohet me ahun dhe halorët. Në kreshtat e larta të maleve ka livadhe të pasura, ndërsa në venlume e ulta rriten dushqe e shkurre të cilat janë kryesisht hapësira kullosore. Këto pyje kanë një shpërndarje hapësinore tradicionalisht të njohur.
24. Brezi i pyjeve, tipet e grumbujve pyjore, shkurret mesdhetare që shtrihen në territorin e bashkisë dhe shtrirjes së tyre sipas zonave fitoklimatike, përfaqësojnë formacionet bazë të bashkëshoqërimeve bimore që rriten në kushtet aktuale të stacionit prodhues dhe mjedisit.
25. Tokat kullosore, arat dhe arat e braktisura që të shndërruara në toka barishtore në afërsi të vendbanimeve dhe fshatrave, sigurojnë mbajtje të një numri të lartë specish zogjsh, më së shumti zogjve të vegjël.
26. Konservimi i veçorive natyrore (Monumentet e Natyrës) konsiston në zona që përmbajnë një, ose më shumë, veçori natyrore/kulturore me vlera të jashtëzakonshme ose unikale për shkak të rallësisë së pazakontë, cilësive përfaqësuese, estetike ose kulturore.
27. Të gjitha aktivitetet njerëzore që zhvillohen në veçanti në këto zona duhet të parashikojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e gjithë ekosistemit, duke u dhënë mundësi edhe brezave të ardhshëm që të përfitojnë nga ekosistemet aktuale.
28. Zhvillime industriale dhe të ndaluar në mënyrë kategorike në zonën e përdorimit të qëndrueshëm, në zonën e përdorimit tradicional dhe në zonën e rekreacionit, në rastet kur ato zenë vend në pamjen estetike, ose kur bien me pamje nga liqeni ose kur bien brenda zonës ujëmbledhëse, ose kur bien në zona gjeologjike karstike, pavarësisht se ato lejohen mbasi pajisen me Leje Mjedisore.
29. Aktivitetet industriale do të lejohen mbasi të pajisen me Leje mjedisi, vetëm në rastet kur ato zënë vend jashtë zonës së mbrojtur të kësaj kategorie (peisazh i mbrojtur), në rastet kur ndodhen jashtë kufijve të zonës buferike për gjeomonumentet e natyrës dhe të kulturës, dhe në rastet kur ndodhen prapa kodrave brenda zonës së mbrojtur, por jo në zona karstike.
30. Të gjitha ndërtimet duhet të jenë me çati për të ruajtur traditën dhe uniformalitetin.
31. Veshjet popullore janë përdorur në raste të festave, dasma dhe ceremoni të tjera.



32. Strategjia e mbetjeve urbane duhet të mbështetet mbi Vlerësimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbanë në shesh grumbullim; Pajtueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, zhurmat, dridhjet, rrjedhjet ujore dhe të lëngshme.
33. Menaxhimi i mbetjeve në vend është akoma në një nivel të ulët.
34. Nuk ka një sistem të sigurtë për administrimin e mbetjeve të rrezikshme (atyre të prodhuara nga industrinë dhe ato shtëpiake). Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme është shumë i dobët.
35. Në shumicën e rasteve industria e riciklimit varet nga lëndët e para të riciklueshme që importohen në Shqipëri.
36. Nga fluksi i ndërtimeve krijohen mbetje inerte të shumta, të cilat në të shumtën e rasteve i hedhin ku të mundin, në anët e rrugëve, në shpatet e përrenjëve.
37. Kohët e fundit ka pasur disa iniciativa pozitive për ndarjen e mbetjeve në dy grupe kryesore, organike dhe jo organike. Nuk ka një rrjet të integruar dhe të përshtatshëm impiantesh për trajtimin dhe heqjen e mbetjeve, si dhe rikuperimin e mbetjeve.
38. Burimi kryesor i prodhimit të energjisë elektrike është prodhimi nga hidrocentralet.
39. Linjat tektonike aktive - Krijojnë zona të paqëndrueshme në hapësira të gjera, paqëndrueshmëri e cila vjen si rezultat i jonjëtrajshmërisë së lëvizjes së blloqeve të ndryshëm të tokës dhe për pasojë ndodhin çedime të diferencuara të trojeve. Edhe pse këto levizje janë shumë të ngadalta, ato mund të bëhen tepër kërcënuese në rastet e ndodhjes së tërmeteve.
40. Megjithatë, investitori duhet të jetë i kujdesshëm në këqyrjen dhe marrjen e masave pararendëse, si në vlerësimin e ngjarjeve të vogla sizmike, çlirimin e gazit radon, ndryshimi i nivelit të ujërave nëntokësore, sjelljen dhe reagimin e kafshëve, fryrjen e pjerrësive, fryrjen e sipërfaqeve, etj.
41. Studimet gjeologjike – inxhinierike që kryhen për ndërtimet në sektorin me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës, duhet të japi të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund t'i kërcënojnë këto ndërtime, si dhe të rekomandojë edhe masat mbrojtëse përkatese, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.
42. Vetite fiziko-mekanike të përbërësve litologjike jepen (në mënyrë vizuale të pa përdorshme për ndërtime) duke treguar limitet minimale e maksimale të tyre;
43. Elementët e rrezikut gjeologjik janë të hedhura në hartë në sipërfaqet ku ato shtrihen, dhe në tekst përshkruhen të grupuara;
44. Zonimi i territorit për përshtatshmerinë ndërtuese, merr në konsideratë tre kritere kryesore: a) kriteri litologjiko- gjeologjiko- inxhinierik; b) kriterin e ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik dhe c) kriterin morfologjik. Si kriter ndihmës është përdorur edhe ai sizmik.
45. Analiza demografike është baza mbi të cilën mbështeten të gjitha elementet planifikuese të planit të përgjithshëm vendor. Duke pasur parasysh të gjitha zhvillimet demografike, lëvizjet e mëdha migratore të 20-25 viteve të fundit, është shumë e rëndësishme një analizë e thelluar në këtë aspekt.
46. Analiza SWOT është një analizë arsyetimësh të kontekstit territorial, mbi të cilin realizohet një program ndërhyrës. Qëllimi i analizës është përkufizimi i mundësive të zhvillimit të një territori apo të një fushe, që vijnë nga vlerësimi i pikave të forta dhe nga kufizimi atyre të dobëta, duke shfrytëzuar mundësitë dhe duke paraprirë kërcënimeve të mundshme.



47. Ndikimet e rendesishme te Planit ne mjedis dhe objektivat mjedisore jane analizuar dhe vleresuar sipas shkalleve te meposhtme: A – ka ndikim pozitiv, B – ndikim i parendesishem, C – ndikimi behet i parendesishem, per shkak te zbatimit te masave zbutese, E – ndikim shkaterrues dhe X – vleresimi i ndikimit nuk eshte i mundur.
48. Në këndvështrimin e lidhjes mes politikave të Planit dhe objektiveve mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore.
49. Politikat që lidhen me Përmirësimin e Cilësisë Urbane dhe ato që lidhen me Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Cilësisë së Mjedisit kanë klasifikimin më të lartë në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore.
50. Mund të thuhet se, në këndvështrimin e përgjithshëm, objektivat dhe politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore.
51. Plani i Përgjithshëm urban i bashkisë së Hasiit përcakton projekte konkrete për çdo politikë, të cilat janë gjykuar si më të përshtatshmet për zbatimin e politikës përkatëse. Projektet janë listuar për çdo politikë, sipas përcaktimeve në Plan. Në Tabelë janë identifikuar projektet specifike dhe vlerësimi i tyre për ndikime direkte apo indirekte në mjedis, në lidhje me objektivat mjedisore të përcaktuara. Shkurtimisht, këto projekte përfshijnë rigjenerimin e qendrave urbane dhe rurale, projekte që lidhen me përmirësimin e shërbimeve publike dhe private, urbanizimin, stilin e jetesës, hapësira argëtimi/çlodhjeje, turizmin, bujqësinë, mjedisin etj.
52. Në përgjithësi, konkludohet se duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.
53. Në marrëdhënie me objektivat mjedisore, të gjitha projektet specifike që lidhen me Objektivën Strategjike “zhvillimi i qendrueshem mjedisor” janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore, bile konsiderohen se do të kenë ndikime pozitive në këtë drejtim.
54. Projektet e parashikuara për Objektivën Strategjike “zhvillimi i industrise minerare”, konkretisht janë në përputhshmëri mesatare me objektivat mjedisore, ndërkohë disa nga projektet, kanë një përqindje të konsiderueshme përputhshmërie të pjesshme apo të kushtëzuar, për shkak të ndikimeve që priten të shkaktojnë, dhe që kërkojnë zbatimin e masave përkatëse zbutëse.
55. Lidhur me projektet e parashikuara për arritjen e Objektivës Strategjike “Zhvillimi i infrastruktures” mund të thuhet se shkalla e përputhshmërisë është e pranueshme. Zbatimi i masave zbutëse për të gjithë projektet e parashikuara përbën një detyrim thelbësor për të realizuar me sukses këto projekte dhe për arritjen e objektivës përkatëse.
56. Përsa i përket Objektivës Strategjike “Përmirësimi i Cilësisë së Jetesës”, përgjithësisht projektet janë të pranueshme nga pikëpamja mjedisore; sidoqoftë niveli i përputhshmërisë së kushtëzuar këtu është i lartë, kështu që kërkohet zbatimi i masave zbutëse për të katër projektet e parashikuara për arritjen e kësaj objektivë.
57. Projektet që parashikohen për arritjen e Objektivës Strategjike “Mbrojtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit” përgjithësisht kanë një nivel të lartë përputhshmërisë me objektivat mjedisore. Projektet në përgjithësi janë plotësisht në përputhje me objektivat mjedisore, ndërkohë që ka pak projekte ku përputhshmëria është konsiderueshëm e lartë. Përsa i përket projekteve të tjera, të cilat kanë një nivel të



kaktuar përputhshmërie të kushtëzuar, duhet që të aplikohen masat zbutëse përkatëse për të adresuar ndikimet e tyre në mjedis.

58. Në përgjithësi, konkludohet se duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.
59. Impaktet mjedisore kumulative përcaktohen në këtë Raport si një kombinim i impakteve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit. Në zbatimin e veprimeve të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit.
60. Paragrafi i udhëzime dhe masat zbutëse përcakton udhëzimet dhe masat mbrojtëse për të siguruar arritjen e objektivave të rëndësishëm mjedisorë në fushat e vecanta.

12.2 MENDIME PËR T'U MARR PARASYSH

1. Në lidhje me menaxhimin e sipërfaqeve pyjore duhet të bëjmë të mundur

- Përmirësimi i pyjeve rehabilitimit të tyre në një kohë sa më të shkurtër për rritjen e prodhimtarisë së tyre.
- Kryerja e prerjeve silvikulturale në trungishtet e pyjeve të ahut, nxjerrja prej tyre të materialit drusor si dru zjarri dhe shkurtimin e kohës për futjen në shfrytëzim të tyre.
- Pyllëzimi i kanaleve, brigjet e lumenjve, krijimi i brezave mbrojtës në fushë dhe futjen e llojeve me rritje të shpejtë.
- Të kryhen investime për përmirësimin e kullotave dhe rritjen e kapacitetit kullor të tyre.
- Të shkohet drejt dhënies në përdorim të fondit pyjor personave fizikë me banim në fshat në mënyrë që të plotësohen nevojat e tyre për material drusor.

2. Ruajtja e tokës së bukës

Plani i Përgjithshëm Urban në përputhje me direktivat e Planin e Përgjithshëm Kombëtar, si dhe në përputhje me direktivat e legjislacionit Europian ka menduar se në asnjë rast, sikundër ka ndodhur deri më sot, tokave urbane t'ju mbivendosen vepra urbane. Ndërkohë që tokat me bonitet të kategorisë së pestë, të mund të diskutohet prejka apo zënia e tyre dhe ato të kategorisë 6 dhe 7, normal që mund të preken nga veprat urbane.

Për të ardhmen në shërbim të përmirësimit të gjendjes rekomandojmë:

1. Rigjenerimin dhe ripërtrijen e bimësisë ekzistuese nëpërmjet mbrojtjes nga kullota dhe ripyllëzimeve.
2. Disiplinimi i rrjedhjeve ujore në përroska dhe përrenj

Frenimi i rrëshqitjeve dhe mbrojtja e tokave nga gërryerja, rekomandohet një sërë masash komplekse kundër me kryesoret dhe emergjente janë:

1. Ndërhyrja në grumbujt pyjorë me kuror dëndësi nën 04, ku numuri i drurëve është i rrallë dhe bimësia barishtore është e dendur me punime ndimëse për të siguruar ripërtëritjen e tyre.



2. Ndërhyrja në parcelat e eroduara me shkallë mbulimi të vogël deri në mesatare me punime biollogjike si Pyllëzime me farë e fidana, si dhe pyllëzime të kombinuara.
3. Ndërtimi i veprave si prita të bëhen në pellgjet ujëmbledhes në pjesën e sipërmë të baseneve (përroskave).
4. Ndërtimin e veprave të ndryshme hidroteknike te karakterit inxhinerik, me mure te thatë, me gabona në vëndet që rrëshqasin, si dhe me llac cemento.
5. Kryerja e punimeve përmiresuese agroteknike në kullota si: Kontrolli dhe shkulja e barneve të këqia në këto sipërfaqe; Plehrimi i tyre me qëllim rritjen e prodhimitarisë së tyre;
6. Rimbjellja e llojeve te vlefëshme në sipërfaqet që janë dëmtuar;
7. Krijimi i plantacioneve me shkurre me qëllim sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë në pikat kritike dhe duke kontrolluar erozionin;
8. Nxitja e popullsisë lokale drej zhvillimit të turizmit rural, duke patur parasysh vlerat qe afron zona;
9. Kryerja e studimeve të reja lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave agro-pyjore per zonën.

3. Një filozofi që e shoqëron përjetësisht Planin e Përgjithshëm Urban duhet të jetë:

1. Në zonën e mbrojtur të Kat.-II, nuk duhet të ketë zhvillime industriale dhe të ndaluar në mënyrë kategorike në të gjitha nënzonat e saj.
2. zhvillime industriale dhe të ndaluar në mënyrë kategorike në zonën e përdorimit të qendrueshëm, në zonën e përdorimit tradicional dhe në zonën e rekreacionit, ose kur bien në zona gjeologjike karstike, pavarësisht se ato lejohen mbasi pajisen me Leje Mjedisore.
3. Aktivitetet industrriale do të lejohen mbasi të pajisen me Leje mjedisi, vetëm në rastet kur ato zënë vend jashtë zonës së mbrojtur, në rastet kur ndodhen jashtë kufijve të zonës buferike për gjeomonumentet e natyrës dhe të kulturës, por jo në zona karstike.
4. Të gjitha ndërtimet duhet të jenë me çati për të ruajtur traditen dhe uniformitetin.

Këto duhet të jenë koncepte të panegociueshme.

4. Tipologjia e ndërtimit

1. Plani i Përgjithshëm Urban do të udhëhiqet nga filozofia e ndërtimit, duke respektuar traditen, d.m.th që ndërtimet në zona suburbane nuk duhet të kalojnë atë të peisazhit të përgjithshëm të ndërtimeve deri më sot, ku mbizotëron ndërtimi dy katësh, i cili mund të harmonizohet deri në një siluetë 2 + 1 kate.
2. Ndoshta në përcaktimin e qendrave të çdo zone administrative mund të ketë ose një institucion fetar në varesi të besimit që egziston ose një ndërtesë të tipit 'target', por jo më e lart se 4-5 kate që mund të jetë vepër banimi, siluetë arkitekturore ose objekt kulti, etj.
3. Të gjitha ndërtimet duhet të jenë me çati, për të ruajtur traditen dhe uniformitetin.
4. Një filozofi tjetër që shoqëron Planin e Përgjithshëm Urban është që të gjitha ndërtimet, si në zonën urbane (qytet), apo në zonen suburbane (fshat), të gjitha ndërtimet duhet të kenë për mbulesë atë të tipit



- çati, pse jo, pjese te kesaj çatie të jenë të përshtatura me paisje si panele diellore për përfitim energjie. Mbulimi me çati na siguron, jo vetem termoizolim apo kursim energjie, por edhe moskthim të energjisë diellore për shkak të së cilës kemi një rritje të temperaturave lokale, përpos një vizioni absurd jo estetik.
5. Çdo njësi administrative duhet të ketë një njesi tipike turistike.

5. Sugjerime lidhur me masat antisizmike për mos dëmtimin e objekteve do të konsistojnë:

1. Objektet duhen ndërtuar solid, me disa breza e të lidhur mirë;
2. Të përdoren si taban shtresa të rekomanduara nga studime enkas gjeoteknike;
3. Të mënjahohen ujërat sipërfaqësorë;
4. Të përdoren material ndërtimi me cilësi të kontrolluar;

7. Lidhur me masat ndaj erozionit dhe sitemimit të kullotave e pyjeve për të ardhmen në shërbim të përmirësimit të gjendjes rekomandojmë:

1. Rigjenerimin dhe ripërtitjen e bimësisë ekzistuese nëpërmjet mbrojtjes nga kullota dhe rryllëzimeve.
2. Disiplinimi i rrjedhjeve ujore në përroska dhe përrenj

Frenimi i rrëshqitjeve dhe mbrojtja e tokave nga gërryerja, rekomandohet një sërë masash komplekse ku ndër me kryesoret dhe emergjente janë:

1. Ndërhyrja në grumbujt pyjorë me kuror dëndësi nën 04, ku numuri i drurëve është i rrallë dhe bimësia barishtore është e dendur me punime ndimëse për te siguruar ripërtëritjen e tyre.
2. Ndërhyrja në parcelat e eroduara me shkallë mbulimi të vogël deri në mesatare me punime biollogjike si Pyllëzime me farë e fidana, si dhe pyllëzime të kombinuara.
3. Ndërtimi i veprave si prita të bëhen në pellgjet ujëmbledhës në pjesën e sipërmë të baseneve (përroskave).
4. Ndërtimin e veprave të ndryshme hidroteknike te karakterit inxhinerik, me mure të thatë, me gabona në vëndet që rrëshqasin, si dhe me llac cemento.
5. Kryerja e punimeve përmiresuese agroteknike në kullota si Kontrolli dhe shkulja e barneve të këqia në këto sipërfaqe; Plehrimi i tyre me qëllim rritjen e prodhimtarisë së tyre ; Rimbjellja e llojeve te vlefëshme në sipërfaqet që janë dëmtuar; Krijimi i plantacioneve me shkurre me qëllim sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë në pikat kritike dhe duke kontrolluar erozionin; Nxitja e popullsisë lokale drej zhvillimit të turizmit rural, duke patur parasysh vlerat që afron zona ; Kryerja e studimeve të reja lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave agro-pyjore për zonën.




12. Roli i Autoriteteve Rajonale duhet të përfshijë sa më poshtë:

1. Mbledhjen e të dhënave prej matjeve që kryhen nga shërbimet publike dhe private rajonale, qoftë në mënyrë të përhershme, qoftë të përkohshme.
2. Mbledhjen e të dhënave bazë që kryhet nga ndërmarrjet e shërbimeve publike (landfilllet, ujësjellës kanalizime, OSHEE, strukturat e menaxhimit të zonave të mbrojtura etj.).
3. Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga administrata publike (si psh Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësorë, etj).
4. Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga institucionet kërkimore shkencore dhe organizata të tjera.
5. Analizën dhe sintezën e të dhënave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve mbi gjendjen e mjedisit në një zonë të caktuar.
6. Ruajtjen e të dhënave dhe krijimin e intervaleve kohore me qëllim monitorimin e gjendjes së mjedisit në kohë të caktuara.
7. Shpërndarjen e të dhënave përmes raporteve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Çfarë synojnë Raportet

1. të plotesojnë kërkesat e legjislacionit,
2. të informojnë palët që marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të
3. Planit (vendim-marrësit),
4. të informojnë publikun që preket nga Plani.



SHTOJCA 01: Dokumenteve strategjikë në nivel kombëtar

Në tabelën e mëposhtme paraqet një përmbledhje e dokumenteve strategjikë në nivel kombëtar.

Tab. – Lista e dokumenteve strategjikë në nivel kombëtar

Nr.	Akti miratues	Titulli i Strategjisë	Objekti/qëllimi i strategjisë
1	VKM nr. 405, datë 27.6.2012	Strategjia ndërsektoriale reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020	Trajton zgjidhjen e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave; integrimin e zonave dhe ndërtimeve informale të legalizuara; përfundimi i regjistrimit fillestar të të gjitha pasurive; digjitalizimi i sistemeve.
2	VKM Nr.797, datë 14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve mbikëqyrjen e tregut	Të mbrojtë interesat ekonomike të konsumatorëve dhe vetë e konsumatorët për ushqimet, produkte joushqimore dhe farmaceutikën/medikamente.
3	VKM Nr.773, datë.14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rajonal	Të sigurojë që të gjitha qarqet të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme – dhe në këtë mënyrë të reduktojnë pabarazitë sociale dhe ekonomike në të gjithë vendin.
4	VKM Nr.1561, datë 3.10.2008	Strategjia ndërsektoriale e parandalimit, luftës kundër korrupsionit e qeverisjes transparente 2008-2013	Trajton reduktimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimi i integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave në qeverisje.
5	Ligji Nr.9322, datë 25.11.2004	Strategjia e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë	Trajton tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme e të brendshme.
6	VKM Nr. 658, date 17.10.2005	Strategjia e shërbimeve shoqërore	Trajton situatën e nevojave shoqërore, nxit mirëqenien shoqërore dhe synon/lehtëson integrimin e familjeve që jetojnë në kushte varfërie, të grupeve vulnerabël dhe personave me nevoja të veçanta.
7	VKM Nr.643, datë 14.09.2011	Strategjia kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	Trajton hartimin e politikave të përshtatshme dhe angazhimin e fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e BE-së.
8	VKM Nr.342, datë 12.3.2008	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013	Dokument i vetëm strategjik (axhenda) për zhvillim ekonomik e social të qëndrueshëm, të harmonizuar me



			axhendën e integritit në BE dhe në strukturat e NATO-s, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.
9	VKM Nr.847, datë 29.11.2007	Strategjia ndërsektoriale e mjedisit	Trajtim modern dhe i integruar i sektorit mjedisor dhe i sektorëve të tjerë me ndikim të fortë në cilësinë e mjedisit si transporti, bujqësia, rregullimi i territorit etj.
10	VKM Nr. 751, datë 7.11.2007	Strategjia sektoriale e punësimit	Vendos bazat për përmirësimin e sistemit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, dhe zbatimit të programeve aktive dhe pasive të punësimit.
11	VKM Nr.924, datë 14.11.2007	Strategjia sektoriale e bujqësisë dhe e ushqimit	Orienton dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe agropërpunimit.
12	VKM Nr.774, datë 14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale shqiptare e zhvillimit rural	Shërben si një bazë kombëtare, për zhvillim dhe më pas zbatimin e planeve për zhvillimin rural të rajoneve dhe nënraioneve të Shqipërisë për të stimuluar qëndrimin dhe rikthimin e banorëve në zonat rurale.
13	VKM Nr.519, datë 20.7.2011	Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë	Trajton përsosjen e sistemit të drejtësisë në RSH, rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e besimit të publikut në drejtësinë shqiptare paralelisht me forcimin dhe rritjen e kontributit të këtij sektori në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, si dhe nxitjen e përsheptimit e integritit europian.
14	VKM Nr.80, datë 28.01.2008	Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale	Trajton orientimin e politikave horizontale për reduktimin e varfërisë dhe luftën kundër përjashtimit social.
15	VKM Nr.844, datë 11.06.2008	Strategjia sektoriale e turizmit 2007 - 2013	Merret me strukturimin dhe zhvillimin e turizmit dhe produkteve të tij si prioritete afatshkurtra dhe afatmesme.
16	VKM Nr.59, datë 21.01.2009	Strategjia ndërsektoriale e shoqërisë së informacionit	Progresin e Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuritë, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.
17	VKM Nr.760, datë 01.09.2010	Strategjia për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Garantimi dhe zhvillimi i një sistemi bashkëkohor të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri, në funksion të konsolidimit të një sistemi social ekonomik konkurrues me të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët shqiptarë, në përputhje me të gjitha kërkesat e detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritit të Shqipërisë në BE.
18	VKM Nr.863, datë 29.07.2009	Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë	Përqendrimin e burimeve financiare në grupe kryesore kërkuesish të aftë, për të arritur një nivel ndërkombëtar njohjeje dhe ekselence.

			dhe Inovacionit 2009– 2015
19		Strategjia Kombëtare e Energjisë	Zhvillimi i një sektori energjetik efektiv që garanton sigurinë e furnizimit me burime energjetike në përgjithësi dhe energji elektrike në veçanti, dhe nxit përdorimin eficient, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis, në mënyrë të tillë që sektori energjetik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë sektorëve ekonomik dhe shoqëror.
20	VKM Nr.175, datë 19.1.2011	Strategjia kombëtare shqiptare mbi mbetjet	Zhvillimin e qëndrueshëm të vendit duke mbrojtur sa më shumë të jetë e mundur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi dhe duke promovuar vlerat mjedisore.
21	VKM Nr.479, datë 29.6.2011	Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë 2010-2025	Përcakton politikat dhe programet e veprimit të menaxhimit të burimeve minerare ekzistuese, si dhe zhvillimin e tyre në perspektivë në përputhje me zhvillimet e reja të ekonomisë shqiptare, prioritetet e zhvillimit të kësaj industrie, me objektivat afatgjatë, objektivat afat mesëm dhe imediatë, vlerësimin e potencialit minerar sipas grup-mineraleve, bazë për vendimmarrjen, planifikimin territorial, zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe infrastrukturës, luftës kundër varfërisë, sidomos në zonat rurale, punësimin në vijimësi, përmirësimin e bilancit valutor të vendit, transparencës dhe luftën ndaj korrupsionit, ka si vizion të saj një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke marrë parasysh impaktet ekonomike, mjedisore dhe sociale, bazuar mbi parimet e ndarjes së të ardhurave midis të gjitha niveleve të qeverisjes, kompanive dhe komuniteteve konkurruese për tërheqjen e investitorëve dhe balancuesë midis së drejtës së licencës minerare dhe taksimit të industrive përgjatë zinxhirit të vlerës.
22	VKM Nr. 395, datë 21.6.2006	Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillimin e turizmit kulturordhe mjedisor	Perceptimin e Shqipërisë si destinacion i pasur kulturor dhe natyror (imazhi) dhe vlerësimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore shqiptare, kuptimi i vlerave nga industria turistike dhe komuniteti i gjerë.
23	Ligji Nr. 9419, datë 20.5.2005	Strategjia ushtarake e Republikës së Shqipërisë	Vlerëson mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë, përparimet e bëra në transformimin ristrukturimin.
24	VKM Nr.1214, datë 3.9.2008	Strategjia sektoriale e transportit	Zhvillimin e transportit rrugor në Shqipëri.



Dokumente strategjike

VKM nr. 405, datë 27.6.2012 “Strategjia ndërsektoriale reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020”

VKM Nr.797, datë 14.11.2007“Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut”

VKM Nr.773, datë.14.11.2007 “Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rajonal”

VKM Nr.1561, datë 3.10.2008 “Strategjia ndërsektoriale e parandalimit, luftës kundër korrupsionit e qeverisjes transparente 2008-2013”

Ligji Nr.9322, datë 25.11.2004 “Strategjia e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”

VKM Nr. 658 , date 17.10.2005 “Strategjia e shërbimeve shoqërore”

VKM Nr.643, datë 14.09.2011 “Strategjia kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve”

VKM Nr.342, datë 12.3.2008 “Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013”.

VKM Nr.847, datë 29.11.2007 “Strategjia ndërsektoriale e mjedisit”.

VKM Nr. 751, datë 7.11.2007 “Strategjia sektoriale e punësimit”.

VKM Nr.924, datë 14.11.2007 “Strategjia sektoriale e bujqësisë dhe e ushqimit”.

VKM Nr.774, datë 14.11.2007 “Strategjia ndërsektoriale shqiptare e zhvillimit rural”


VKM Nr.519, datë 20.7.2011 “Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë”

VKM Nr.80, datë 28.01.2008 “Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale”

VKM Nr.844, datë 11.06.2008 “Strategjia sektoriale e turizmit 2007 – 2013”

VKM Nr.59, datë 21.01.2009 “Strategjia ndërsektoriale e shoqërisë së informacionit”

VKM Nr.760, datë 01.09.2010 “Strategjia për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale”



VKM Nr.863, datë 29.07.2009 “Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009–2015”

VKM Nr.175, datë 19.1.2011 “Strategjia kombëtare shqiptare mbi mbetjet”

VKM Nr.479, datë 29.6.2011 “Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë 2010- 2025”

VKM Nr. 395, datë 21.6.2006 “Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillimin e turizmit kulturor dhe mjedisor”

Ligji Nr. 9419, datë 20.5.2005 “Strategjia ushtarake e Republikës së Shqipërisë”

VKM Nr.1214, datë 3.9.2008 “Strategjia sektoriale e transportit”

SHTOJCA 02: PËRSHKRIM I PËRGJITHSHEM I PROCESIT TË PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË SEKTORIN E MJEDISIT

Detyrimi për afrimin e legjislacionit Shqiptar në fushën e mjedisit me atë të BE-së ,rrjedh nga Neni 108 i MSA-së,në të cilin citohet si mëposhtë vijon:

1. Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.
2. Bashkëpunimi përqëndrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquire Komunitetit për fushën e mjedisit.

Prioritetet

Përsa i përket mjedisit, në fushën e *legjislacionit horizontal*, disa nga prioritetet kryesore kanë të bëjnë me:

Për afrimin e plotë të Ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe Ligjit “Për lejet mjedisore ”me Direktivën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”

Forcimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor.

Garantimin siç duhet të informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje ,bazuar në detyrimet e Konventës së Aarhusit.



Miratimi i projektligjit për *cilësinë e ajrit* dhe aktet nënligjore për vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe kriteret për disa ndotës të caktuar, si dhe për afrimi i plotë i legjislacionit të BE-së, janë disa nga prioritetet kryesore në këtë fushë. Gjithashtu, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit, si prioritetet e Ministrisë së Mjedisit janë edhe:

- hartimi i planit kombëtar dhe planeve lokale të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit;
- forcimi i sistemit kombëtar të monitorimit të ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër sipas standardeve evropiane, si dhe;
- forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave të cilësisë së ajrit në strategjitë sektoriale të tyre.

Megjithëse, janë miratuar aktet nën ligjore për *menaxhimin e mbetjeve*, si dhe janë përgatitur plane të menaxhimit për Tiranën, Lezhën dhe Shkodrën, përmirësimi i menaxhimit të integruar mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore të punës së Ministrisë së Mjedisit. Ndarja e mbetjeve në burim , rritja e nivelit të riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, asimilimi i plotë i hedhjes së mbetjeve në vend grumbullime të pasigurta dhe asimilimi i plotë i djegies së mbetjeve, ndërtimi i landfilleve sipas standardeve të BE-së ,sigurimi i faciliteteve për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore,si dhe sigurimi i investimeve të reja përsa i përket ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve , janë disa nga prioritetet kryesore në këtë fushë.

Në fushën e *cilësisë së ujit* , Ministria e Mjedisit ka si prioritet të punës së saj:

- përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nën ligjore në zbatim të Ligjit Nr. 111/2012;
- vlerësimin e shkallës së dëmtimit të baseneve të lumenjve si rezultat i aktiviteteve të subjekteve që shfrytëzojnë inertet lumore dhe ndërmarrja e masave ndëshkuese;
- krijimi i regjistrit kombëtar të burimeve ujore.
- përmirësimi i menaxhimit të burimeve ujore në nivel baseni dhe kombëtar nëpërmjet hartimit të strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të burimeve ujore , hartimit të dy planeve të menaxhimit të baseneve të lumenjve (Drin-Bune) dhe krijimit të kadastrës elektronike kombëtare të burimeve ujore.

Në fushën e *mbrojtjes së natyrës*, do të punohet për të garantuar:

- Mbrojtjen e zonave të mbrojtura.
- Zbatimin e rregullave të miratuara në vitin 2011 për ngritjen e zonave të mbrojtjes së veçantë në kuadrin e Natura 2000.



- Marrjen e masave për ndalimin e veprimtarive të paligjshme si gjuetia, prerja e drurëve dhe ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura, si dhe
- Forcimin e kapaciteteve administrative të inspektoratit për goditjen e këtyre fenomeneve.

Përsa i përket *politikave për zhurmën në mjedis*, një nga prioritetet kryesore në këtë fushë është forcimi i zbatimit të vendimeve të Task– Forcës së ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike.

Përsa i përket *ndryshimeve klimatike*, përafrimi i plotë me legjislacionin e BE-së, hartimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, ngritja e sistemit kombëtar të inventarëve të shkarkimeve në ajër dhe të gazeve me efekt serrë, si dhe forcimi i bashkëpunimit me institucione e linjës për integrimin e politikave të ndryshimeve klimatike në strategjitë e tyre sektoriale, janë disa nga prioritetet në këtë fushë.



SHTOJCA 03: Përfshirja e palëve të interesuara dhe takimi publik

1. RAPORTI MBI PËRFSHIRJEN E PALËVE TË INTERESUARA DHE TAKIMET ME PUBLIKUN

Në procedurën e zhvillimit të Planit të Përgjithshëm Vendor me fazat përkatëse të tij, janë kryer 3 dëgjesa publike në lidhje me sqarimet përkatëse të cdo faze. Dëgjesat janë kryer përkatësisht si më poshtë:

1. Dëgjesa e datës 16.04.2019 për "Vlerësimin Strategjik Mjedisor" per PPV Has"
2. Dëgjesa e datës 30.05.2019 për "Vlerësimin Strategjik Mjedisor" per PPV Has"

1.1. Temat e trajtuara mbi karakteristikat e zonës

1. Prezantimi i degjeses se pare publike u krye në ambjentet e bashkisë Has, me date 16.04.2019:

Prezantimi u hap nga Sazan Guri i cili foli fillimisht për procesin rëndësorin e zhvillimit të Vlerësimit strategjik Mjedisor. Me konkretisht janë paraqitur më poshtë pikat kyçe për të cilat u prezantua:

- Analizë dhe vlerësim i mjedisit natyror(kilma, gjeologjia)
- Kushtet hidrologjeologjike
- Elemntet e mjedisit (Resurset natyrore, biodiversiteti, zonat e mbrojtura, cilësia e ajrit, ndotja e ujrave,erozioni,sizmika)
- Analizë metabolike (uji, materialet, mbetjet dhe emetimet)
- Elemntët përjashtues (ndikimet mjedisore të Industrisë minerare)

Në vazhdimësi Also Sulaj prezantoi propozimet e fazës së tretë të PPV – dhe shpjegoi procesin e saj, njësitë e krijuara, zonat ku lejohet zhvillimi, intensiteti dhe koeficientët e zhvillimit në varësi të zonës.

- 1- Pyetje
a. Si mund të ruhen zonat e mbrojtura dhe cfare strategjie duhet ndjekur për ti menaxhuar.
- 2- Pyetje
a. Cfare mund të propozohet për trajtimin e mbetjeve plastike?
- 3- Pyetje
a. A ka studim të ri për erozion në bashkinë Has pasi ka rënie të erozionit nga viti 2012 ?
- 4- Pyetje
a. Sa mund të përkthehet në vlerë ekonomike ky studim?



Përgjigje:

Pyetja 1 a. Është e rëndësishme inventarizimi i tyre dhe gjendja në të cilën ndodhen këto zona dhe më pas duke ndjekur dispozitat ligjore në fuqi të merren masa përmirësuese apo ndaluese në rast shfrytëzimi të këtyre hapësirave.

Pyetja 2 a. Hasi si një bashki me popullsi relativisht të ulët nuk e ka ekonomike ndërtimin e një LandFilli në territorin e saj dhe mënyra më e mirë është ngrija e një pike transferimi për mbetjet urbane që grumbullohen në një vend dhe më pas të dërgohen në landfillin më të afërt .Gjithashtu është e nevojshme ulja e sasisë të mbetjeve që në burim duke ripërdorur mbetjet organike vecanërisht në zonat rurale duke ulur kostot e shërbimit për bashkinë .

Pyetja 3 a. Studimi i fundit është ai i vitit 2012 i realizuar në nivel kombëtar dhe ku Hasi paraqitet me një humbje mesatare prej 100 ton /ha në vit . Duke bërë krahasimin e sistemit natyror nga viti 2012 deri më sot shikojmë përmirësim të zonave pyjore duke rritur mundësinë që humbja nga erozioni të jetë ulur . Por nuk ka një studim të ri që vërteton dicka të tilla

Pyetja 4 a. Ky studim analizon në vija të përgjithshme situatën ekzistuese mjedisore dhe propozon një set rekomandimesh në formën e strategjisë për rritjen e parametrevë mjedisorë në bashkinë Has .Kjo duke u shoqëruar me propozimet nga PPV dhe nga përkthimi i këtyrë në projekte konkrete mund të ndikojë në vlerë ekonomike të shtuar për banorët e Hasit.

Foto gjatë dëgjësës:



Foto 1.





Fig.40 Foto nga dëgjesa publike e datës 16.04.2019





DEGJESË PUBLIKE / PJESEMARRJA / 16 PRILL 2019

Nr	EMER MBIEMER	NE .TEL	E-MAIL	INSTITUCIONI	FIRM
1	Artur Peka	0693762817	arturpeka@hotmail.com	Zyra Kadastres	[Signature]
2	MAN RADA	0692267476	manrada@outlook.com	B. MORA	[Signature]
3	Avni Muhadri	0696649562	avnimuhadri@tinet.com	BASHKIA HAS	[Signature]
4	Liljana Bardhoshi	0688361165	liljana.bardhoshi@tinet.com	BASHKIA HAS	[Signature]
5	Arta Graolca	0694621532	artagraolca@tinet.com	BASHKIA HAS	[Signature]
6	Hygni MORINA	0682072516	hygnimorina@yahoo.com	BASHKIA HAS	[Signature]
7	Urim Plati	0692262562	urimplati@yahoo.com	BASHKIA HAS	[Signature]
8	Selam ZISHT	0692347998	selam.zisht@tinet.com	BASHKIA HAS	[Signature]
9	Arut Peq	0692584057	-	RTA A. GOGAJ S.B.	[Signature]
10	Enver Mehi	0682256608	envermehi@tinet.com	M.J.A. GOGAJ	[Signature]
11	Rafiq Cela	0692357203	-	BASHKIA HAS	[Signature]
12	Ferit Mazreku	0693914111	Feritmazreku@tinet.com	Bashkia - HAS	[Signature]
13	Noruz BARDHOSHI	0686265800	noruzbardhoshi@tinet.com	B. HAS	[Signature]
14	BEJIM DANI	0692957143	bejimdani@hotmail.com	ZY/MEKUR GJITHAS	[Signature]

Degjese Publike | Plani Pergjithshem Vendor HAS

Fig.41 List prezenca e degjesës publike të datës 16.04.2019

• **Prezantimi i degjeses së dytë publike u krye më datë 30.05.2019 në sallën e këshillit Bashkiak Has.**

Prezantimi u hap nga Sazan Guri i cili foli fillimisht për procesin rëndësinë e zhvillimit të Vlerësimit strategjik Mjedisor. Më konkretisht janë paraqitur më poshtë pikat kyçe për të cilat u prezantua dhe u zhvillua diskutimi:

- Analizë dhe vlerësim i mjedisit natyror (klima, gjeologjia)
- Kushtet hidrologjeologjike
- Elementet e mjedisit (Resurset natyrore, biodiversiteti, zonat e mbrojtura, cilësia e ajrit, ndotja e ujrave, erozioni, sizmika)
- Analizë metabolike (uji, materialet, mbetjet dhe emetimet)
- Elementët përjashtues (ndikimet mjedisore të Industrisë minerare)
- Projektet ,planet e Zhvillimit
- Skema mbi trajtimin e mbetjeve, ujërave të zeza, ndotjeve nga fabrikat,
- Vlerësimi i përpueshmërisë së politikave të planit me objektivat mjedisore
- Ndikimet që PPV ka në mjedis dhe masat për zbatimin e tyre
- Përpueshmëria e politikave të PPV me objektivat e VSM.

Enver Meshi

- Kërkon heqjen nga projektet të rikonstruksionit të rrugës Krume-Zahrishtë pasi është një rrugë që ka mbaruar rikonstruksioni

Flamur Thaci

- Kërkon informacione lidhur me projekte për ndërtimin e Landfillit të Kukësit nga ana e përfaqësuesit të DRM Kukës dhe gjithashtu mënyra së si mund të minimizohen kostot e mbetjeve duke bërë ndarjen në burim .

Sazan Guri Përgjigje:

- Merr në konsideratë komentin e Enverit duke bërë korrigjimin e duhur për aksin rrugor Krumë-Zahrishtë
- Shpjegim të skemës për ndarjen e diferencuar të mbejeve në burim dhe alternativave të ndryshme për minimizimin e kostove dhe uljen e ndotjes në mjedis.

Dëgjesa publike pati shume rezultat, diskutimet që patëm na dhanë shumë informacione të reja dhe gjithashtu se kush janë dhe problematikat kryesore që hasen, si dhe sugjerime prej palëve të ndryshme.



Foto gjatë dëgjësës publike për VSM.



DËGJESË PUBLIKE / PJESEMARRJA / 30 MAJ 2019

Nr	EMER MBIEMER	NR. TEL	E-MAIL	INSTITUCIONI	FIRM
15	Erida Xhupa	0699473888	eiridaxhupa@yahoo.com	Bashkia Has	
16	Xhevit Hasaj	0698918926		UK. HAS	
17	Klodian Lajç	0692422280	klodian.lajc@qendro.com	Bashkia Has	
18	Xhevdet Nenadi	0682524020	xhevdet.nenadi@gmail.com	Bashkia Has	
19	Almet Xheberti	0692894213	almet.xheberti@gmail.com	Bashkia Has	
20	Eniela Biteria	-	enielabiteria@yahoo.com	Bashkia Has	
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					

Dëgjesa Publike | Plani Përgjithshëm Vendor HAS

Fig.41 List prezenca e dëgjësës publike të datës 30.05.2019



LEGJISLACIONI REFERENCË

- Ligi Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" me të gjitha ndryshimet
- VKM nr. 686 date 22.11.2017 "Per miratimin e VKM Nr. 686 date 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit"
- VKM nr. 408 datë 13.05.2015 Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, me të gjitha ndryshimet
- Ligji nr.9244 datë 17.06.2004 Për mbrojtjen e tokës bujqësore (i azhormuar)
- VKM nr. 21 datë 12.1.2018 "Për disa shtesa në VKM nr. 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014–2020"
- Ligji nr.81 datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura"
- VKM Nr. 57, date 06.02.2019 " Per kriteret dhe mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur mjedisore
- Kodit Rrugor te Republikes se Shqiperise, i azhormuar me ndryshimet deri ne 2015
- VKM nr.153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të republikës së Shqipërisë" e ndryshuar
- Ligji nr.93/2015 Për Turizmin
- VKM Nr. 22, date 12.01.2018 "Per miratimin e kriterëve per certifikimin e veprimtarisë se agroturizimit"
- Ligji Nr. 27/2018 "Per Trashëgimine Kulturore dhe Muzete"
- VKM nr.795, datë 26.11.2003 Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedurat e vlerësimit të këtyre objekteve
- Ligji nr.139 / 2015 Për vetëqeverisjen vendore
- Ligji Nr.133 datë 05.12.2015 Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave
- VKM Nr. 766 date 20.12.2017 ndryshimi i VKM Nr. 223
- Ligji nr.9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin,urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"
- VKM Nr. 19, date 11.1.2017 "Per percaktimin e rregullave te legalizimit te objekteve me leje ndertimit ne te cilat jane kryer shtesa anesore lartesi";
- Ligji nr.8402 datë 10.09.1998 Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit
- VKM nr. 428 datë 08.06.2016 Për krijimin e të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të mbetjeve të ngurta
- Ligji Nr.9780 datë16.07.2007 Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, i ndryshuar
- VKM NR.894 date 1.11.2015 "Per unifikimin e procedurave te kontrollit te territorit nga IMT dhe IKMT"
- VKM nr.348 datë 11.5.2016 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
- VKM Nr . 961 datë 02.12.2015 Për krijimin,organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Agjencisë së zhvillimit ekonomik rajonal





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
Urbanistika

Nr. 525 prot.

Krume, me 12/03/2019.

Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të Vlerësimit Strategjik Mjedisorë (VSM) për Planin e

Përgjithshem Vendor (PPV), Loti I.

Drejtuar: MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

TIRANE

Per dijeni: "GJEOKONSULT & CO" Shpk

KËRKESË

Të nderuar Znj/Z.

Bashkia Has është duke kryer Planin e Përgjithshem Vendor (PPV), i cili shoqerohet edhe me Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë (VSM).

Duke ju paraqitur këtë kërkesë kërkojmë nga ana juaj fillimin e procedurave të Vlerësimit Strategjik Mjedisorë (VSM).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj mbetemi në pritje të përgjigjes për fillimin e procedurave ndaj këti raporti mjedisorë.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

Adem LALA

KRYETAR



Konceptoi: Novruz Bardhoshi

Adresn: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: bashkinkrume@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
Urbaniistika

Nr. 932 prot.

Date 21 / 05 / 2019

Lenda: Degjese publike per "VLERSIMI STRATEGJIK MJEDISORE" (VSM)

Drejtuar: MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

TIRANË.

Per dfteni: DREJTORIA RAJONALE E MJEDISIT,

KUKËS.

Bazuar ne kontraten Nr. 10487/10, dt. 01.10.2018, lidhur midis Ministria e Infrastruktures dhe Ergjise dhe operatorit ekonomik "Gjeokonsli & Co" Shpk me objekt "Hartimi i planit te Pergjithshem Vendore", Bashkia Has ju njojtme se degjese e dyte publike per "Vlersimi Strategjik Mjedisore" zhvillohet me dt 30.05.2019 ora 10.00, ne sallën e mbeledhjeve te keshillit te bashkise.

Duke ju falenderuar.


Adem LALA

KRYETAR



Konceptoi: Novruz Bardhoshi

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdan", Qyteti i Krimesë
Tel/Fax: +355 214 22080. E-mail: bashkinkrimese@yabon.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Nr. 2638/1 prot.

Tiranë, më 10.04.2019

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me njoftimin për marrjen e nismës për hartimin e Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) në kuadër të hartimit të "Planit të përgjithshëm vendor për Bashkinë Has

Drejtuar: Z. Adem LALA
KRYETAR
BASHKIA HAS

HAS

Për dijëni: Znj. Adelina GRECA
Drejtor i Përgjithshëm
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

TIRANË

I nderuar zoti Lala,

Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr. prot. 2638, datë 15.3.2019, në lidhje me njoftimin për marrjen e nismës për hartimin e Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) në kuadër të hartimit të "Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Has", Ju bëjmë me dije se:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pas shqyrtimit të, referuar pikës 2, neni 8 të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor", shprehet se plani i sipërpërmendur, duhet t'i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Në kuadër të procedurës të VSM-së ju duhet të ndiqni këto faza:

- Të kryeni konsultime me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së;
- Të hartoni raportin paraprak të VSM-së dhe të konsultoheni me grupet e interesit dhe publikun në lidhje me këtë raport, sipas përcaktimeve të VKM nr. 219/2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor";
- Të hartoni raportin përfundimtar të VSM-së, bazuar dhe në komentet e sugjerimet e dala nga procedurat e konsultimit me grupet e interesit dhe publikun;
- Të paraqisni pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit kërkesën për t'u pajisur me Deklaratë Mjedisore, sipas përcaktimeve të pikës 4, neni 12, të ligjit të sipërpërmendur.

Ndër çështjet që propozojmë që duhet të merreni parasysh gjatë hartimit të raportit të VSM-së janë:

- Në këtë plan një zë të veçantë të ketë trajtimi i problematikave ligjore dhe institucionale për zbatimin e planit.

- Është e nevojshme të trajtohen problematikat në lidhje me çështjen e mbrojtjes së natyrës dhe në lidhje me përfaqshjen që do të ketë ky plan kundrejt zonave të mbrojtura që mund të shpallen në të ardhmen, si dhe kundrejt zonave të cilat do të evidentohen të rëndësishme për habitatet, florën dhe faunën.
- Plani duhet të japë një informacion të detajuar veçanërisht për llojet e faunës dhe florës së egër dhe habitatet me rëndësi për komunitetin evropian, të listuara në anekset e direktivës së habitateve dhe të shpendëve, si dhe lloje të mbrojtura që bëjnë pjesë në listën e kuqe të florës dhe faunës së Shqipërisë dhe lloje të mbrojtura nga konventat ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria ka aderuar. Për zhvillimet strategjike dhe infrastrukturore kombëtare në rast identifikimi të llojeve të faunës dhe florës me rëndësi për komunitetin evropian është e domosdoshme të jepen alternativa dhe të shmangen habitatet kritike që strehojnë lloje të kërcënuara globalisht.
- Të kihet parasysh referencat ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat në territorin e Shqipërisë.
- Të bëhet një analizim i situatës aktuale të mbetjeve dhe të evidentohen problematikat pas kryerjes së analizës së sipër përmendur, si dhe të vendosen disa masa për t'u realizuar, psh: planifikimi i përmirësimit të infrastrukturës së grumbullimit; skemat e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve; nxitja e investimeve dhe e pjesëmarrjes aktive të biznesit duke nxitur riciklimin, si edhe kompostimin për të reduktuar në mënyrë progresive mbetjet për asgjësim në lëndfill; rritja e cilësisë së shërbimit për reduktimin e rrezikut në shëndetin e njerëzve e në mjedis.
- Të bëhet një analizim i situatës aktuale të mbetjeve inerte si dhe pasi të evidentohen problematikat pas kryerjes së analizës së sipërpërmendur, të vendosen disa masa për t'u realizuar.
- Të trajtohet dhe të propozohen masa lidhur me cilësinë e ajrit.
- Të trajtohet dhe të propozohen masa lidhur me emetimet e zhurmave (ndotja akustike).
- Të trajtohet dhe të propozohen masa lidhur me cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokesore. Në plan të identifikohen pikat më të nxehta të ndotjes së ujërave dhe të propozohen masa për minimizimin e kësaj ndotjeje.
- Sugjerojmë marrjen në konsideratë të ndikimeve që lidhen me ndryshimet klimatike.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,


SEKRETARI PËRGJITHSHËM

ADRIAN KAMENICA



2638
153 9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
Urbanistika

Nr. 25 prot.

Krume, me 12/03/2019.

Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të Vlerësimit Strategjik Mjedisorë (VSM) për Planin e

Përgjithshem Vendor (PPV), Loti I.

Drejtuar: MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

TIRANE

Per dijjeni: "GJEOKONSULT & CO" Shpk

KËRKESE

Të nderuar Znj/Z.

Bashkia Has është duke kryer Planin e Përgjithshem Vendor (PPV), i cili shoqerohet edhe me Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë (VSM).

Duke ju paraqitur këtë kërkesë kërkojmë nga ana juaj fillimin e procedurave të Vlerësimit Strategjik Mjedisorë (VSM).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj mbetemi në pritje të përgjigjes për fillimin e procedurave ndaj këtij raporti mjedisorë.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

Adem LAJA

KRYETAR

Konceptoi: Novruz Bardhoshi

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: bashkiakrume@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 136 Prot.

Tirane, me 19.05. 2004

Vendimi Nr.6, Nr.010 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z.Sazan GURI

Certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUKA



